

HALIL RAMA



DIBRA dhe DIBRANËT në panteonin e vlerave

Profile, esse, reportazhe letrarë

Me parathënie të Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj, Mjeshtër i Madh



HALIL RAMA

DIBRA DHE DIBRANËT
NË PANTEONIN E VLERAVE

- Profile, esse, reportazhe letrarë -

Tiranë 2025

Titulli:
DIBRA DHE DIBRANËT NË PANTEONIN E VLERAVE
- Profile, esse, reportazhe letrarë -

Autor:
HALIL RAMA

Redaktor:
Dr. HAJRI MANDRI

Recensent:
Prof.asc. dr. BERNARD ZOTAJ

Art grafik:
DASHAMIR VRANIÇI

ISBN:
9789928840134

Shtëpia botuese



PASQYRA E LËNDËS

PARATHËNIE / PATRIOTIZMI, VLERË E PËRHERSHME E DIBRANIT
Nga Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj, Mjeshtër i Madh.7

- I -

PERSONALITETE TË KRENARISË KOMBËTARE

- **DINE HOXHA** – NJË FILOZOF POPULLOR NË
OBORRIN MBRETËROR 14
- **AHMET FETAH CAMI**, ATDHETARI QË MORI PJESË NË DY
LUFTRA BOTËRORE..... 27
- **RRUGA “EMIN CIBAKU”** – PËRJETËSIMI I DËSHMORIT TË
RËNË NË BETEJEN E KOLESJANIT 38
- **HARUN DOMI** – HISTORIA E PATRIOTIT QË SOLLI ABETAREN
E PARË NË KALIS E KALA TË DODËS..... 42
- **EDIP DACI** – HISTORIA E USHTARAKUT QË REFUZOI TË
BËNTE BETIMIN FASHIST NË ROMË, U ARRESTUA PAS
NGJARJES NË AMBASADËN RUSE NË TIRANË 50
- **SAFET ZHULALI**, NË PANTEONIN E VLERAVE TË LIRISË E
DEMOKRACISË SHQIPTARE 59
- RRUGËTIMI I SUKSESSHËM I **HAMIT KOÇIT** NGA VAJKALI I
BULQIZËS 66
- DREJTËSIA E VONUAR PËR VRASJEN E SHEKULLIT..... 73
- **ADEM ISLAM HOXHA**, HEROI I REZISTENCËS NDAJ
AGRESIONIT GREK TË 2 GUSHTIT 1949 83
- **BAFTJAR RUSI**, NJË EMËR I MADH I DREJTËSISË SHQIPTARE..... 91
- **SHUAIP METHASANI**, VETERANI QË RREZATON MIRËSI
DHE VLERA..... 97
- **HALIT BERISHA** - INTELEKTUALI BASHKOHOR QË I
PËRBALLOI ME DINJITET SFIDAT E JETËS 102
- **BUJAR PATA**, NJË VLERË E VËRTETË E QYTETARISË 106
- **BESIM NDREGJONI** - EMBLEMA E DISIDENCËS SHQIPTARE 111
- **GANI STRAZIMIRI**, KRYEARKITEKTI I TIRANËS SË
VITEVE °50-60-TË 116

- **RAMAZAN SULEJMANI, PROFILI I INTELEKTUALIT SHUMËDIMENSIONAL** 123
- **PROF. SHPËTIM CAMI “KOHERENT ME ATO ÇKA THOTË E BËN”** 128
- **MUSA RIÇKU, PORTRETI I NJERIUT FISNIK** 132
- **DINASTIA E VËLLEZËRVE KETA NGA BULQIZA, KAMPIONË BOTE NË KIKBOKS** 136
- **VELO CFARKU, KRYEREDAKTORI MË JETËGJATË QË I DHA JETË “USHTIMËS SË MALEVE”** 140
- **DEFRIM METHASANI, IKONË E GAZETARISË SPORTIVE, DOKUMENTARIT TELEVIZIV DHE MODERIMIT TE EVENTEVE.....** 143
- **XHELAL MARKU - GAZETARI ME KARRIERË TË SHKËLQYER AKADEMIKE DHE PROFESIONALE** 147

- II -

PERSONALITETE DIBRANE TË ARSIMIT DHE KULTURËS

- **LUTFI HANKU – PROFILI I MËSUESIT DHE SHKRIMTARIT DISIDENT QË SFIDOI DIKTATURËN**..... 154
- **MUHARREM XHEDIKU, KOMPOZITORI I ‘TANGOS SHQIPTARE’. JETOI DY DASHURI TË VETME, MUZIKËN DHE SLLAVEN JELICA** 162
- **“NDERI I KOMBIT” HAZIS NDREU – EZOPI I DIBRËS**..... 173
- **SKËNDER CALA, I MAGJEPSUR NGA “MAGJIA E DIBRËS”** 181
- **LIRI RASHA, PASAPORTA ARTISTIKE E DIBRËS** 187
- **PËR POETIN E KËNGËS, NAIM PLAKU**..... 194
- **QERIM SULA, ZËRI I LAVDISË SHEKULLORE, IKONË E KËNGËS DIBRANE** 198
- **MUHARREM GJOKA, PROMOVUES I VLERAVE ETNOKULTURORE DHE ATYRE TË LANÇ** 203
- **LAHIM KOLA, MUZIKANTI I TALENTUAR NGA SOPOTI** 208
- **“SARINA 2002”, LIDER NË ARSIMIN JOPUBLIK SHQIPTAR**..... 213
- **OSMAN MIHA DHE ARSIMI PROFESIONAL NË BULQIZË** 221
- **SKËNDER MURRJA – 40 VJET MËSUES DHE DREJTOR SHEMBULLOR I DISA SHKOLLAVE**..... 225
- **DRITAN JASHARI - “KJO ËSHTË DIBRA MAJA-MAJA”** 232

- III -

NË USHTRINË SHQIPTARE DHE FA TË RSH

- **DALI NDREU**, STRATEGU QË DREJTOI LUFTËN PËR ÇLIRIMIN E TIRANËS 238
- **NDERIMI PËR ISH-KOMANDANTIN E FRONTIT VERILINDOR ISMAIL SHULKU**..... 245
- **MANUSHAQE SHEHU**, E VETMJA GRUA SHQIPTARE ME GRADËN MADHORE “GJENERALMAJOR” 249
- **SELMAN RAMA** – SKËNDEBEGASI NGA MUHURRI QË U BË OFICER MARINE..... 254
- **HAMDI DODA**, GJENERALI NGA MUHURRI QË KA PËRFAQËSUAR SHQIPËRINË NË NATO 258
- **PORTRETI NË BRONX I DËSHMORIT KLODIAN TANUSHI** 265

- IV -

NË ELITËN MJEKËSORE SHQIPTARE

- **DR. MEHDI CANI**, MISIONAR I MJEKËSISË SHQIPTARE..... 272
- **PROF. DR. PETRIT BARA**-PERSONALITET I SHQUAR I MJEKËSISË SHQIPTARE ME INTEGRITET TË LARTË PROFESIONAL 283
- **PROF.ASC. ISLAM DAUTI**, INTELEKTUALI I SHQUAR ME PËRMASA MBARËKOMBTARE 287
- **PROF.ASOC.DR.ALI TONUZI**, MË I VLERËSUARI NGA PACIENTËT DHE ELITA MJEKËSORE 301
- **PROF. DR. NAZMI KOÇI** - STOMATOLOGJIA NË SHQIPËRI NGA LASHTËSIA DERI NË DITËT TONA 306
- **DR. AJET XHAFI**, KIRURUGU UROLOG DUARARTË NGA BULQIZA, NË SPITALIN AMERIKAN TË PRISHTINËS..... 311

- V -

HISTORIA E DIBRËS NË LIBRA TË AUTORËVE DIBRANË

- **NAIM BERISHA**: BERISHËT E MUHURRIT, SI RAST UNIKAL NË HISTORINË SKËNDERBEGIANE..... 320
- “NGA ISHIN KASTRIOTËT” KU LINDI SKËNDERBEU?” 325
- **BESNIK S. KEBEJ**: “NGA ISHIN KASTRIOTËT” KU LINDI SKËNDERBEU?” 331

- **PROF. SAIMIR SHATKU:** SAGË E LAVDISHME SFIDASH TË ATDHETARËVE SHATKU QË BËNË EMËR NË HISTORINË E TIRANËS 340
- **PROF. DR. FATMIR TERZIU:** “TOPONIMIA E GOLLOBORDËS/ DISKURSI I DYGJUHËSISË DHE DERIVATI I ORIGJINËS”. 344
- **SAKIP CAMI:** FAKTE DHE NGJARJE HISTORIKE TË SHKRUARA ME DASHURI NJERËZORE..... 351
- **HYSEN DERVISHI** PËR “LUFTËTARIN E LIRISË” RRAHMAN DERVISH 354
- **HAKI PERNEZHA & RRUZHDI BITRI:** “TOPONIMIA E ÇIDHNËS”, NJË BOTIM ME VLERA TË RRALLA SHKENCORE..... 359
- **FAIK BRUÇI:** FISI BRUÇI I LUKANIT TË DIBRËS 361
- **KAMBER FARUKU:** “KOHA KUR PO SHKRIHESHIN AKUJT” 367
- **BEQIR SINA,** NJË BIOGRAFI NË DY KOHË 373

- VI -

DIBRA DHE DIBRANËT NË REPOPORTAZHET E MIA

- BULQIZA NË NJË FILM TË YLLI PEPOS 380
- ATY KU BANORËT SHKELIN MBI NËNTOKËN MË TË PASUR NË EUROPË 380
- “SHTËPIA E BARDHË” E SELIM RUSIT, KU U INICIU SAMITI I DIASPORËS 395
- EKSODI MASIV, MIJËRA FAMILJE DIBRANE NË KËMBË DREJT TIRANËS 403
- FLUTURON SHQIPJA MBI KORAB 410
- DIASPORA SHQIPTARE, FESTË NË FSHATIN E MARTIRIZUAR! .. 414
- VIÇISHTI, ATY KU KA MË SHUMË HERONJ SE DËSHMORË 414
- DITA E MAQELLARËS... 421
- DIASPORA DIBRANE, FESTË NË DIBËR TË MADHE..... 425
- LURA DHE PERSONALITET E LURËS NË NJË VEPËR ENCIKLOPEDIK..... 431
- FUQIA E FJALËS SË SHKRUAR NË RUAJTJEN E IDENTITETIT KULTUROR 438

PARATHËNIE

PATRIOTIZMI, VLERË E PËRHERSHME E DIBRANIT

**Nga Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj -
Mjeshtër i Madh**



Me dibranët jam njohur më herët, kur më 14 dhjetor 1967, brenda një dite u hap kanali Selitë-Fushë-Alie-Kandër, 17 km i gjatë dhe grupi polifonik i Smokthinës, Vlorë i ka kënduar këngë “O moj Dibra, heroinë”. Kënga është kjo: “O moj Dibra, heroinë/ ngrite peshë Shqipërinë/ iniciativën që more/ me një vepër madhështore/ goditja e përqëndruar/ është një zjarr që s’ka të shuar”. (Kënga gjendet në YouTube me këtë titull).

Në vitet ’70 të shekullit XX, kur isha me studimet ushtarake u njoha me Bardhyl Hoxhën nga Dibra, i cili më vonë u bë gjeneral i ushtrisë shqiptare. Me dibranët dhe historinë e saj u njoha gjerësisht nga vlonjati Ibrahim Shyti që kishte lidhje të ngushtë me “shërbëtorin e kombit” Josif Bageri nga Dibra e Madhe. Më tej kjo lidhje e njohje mori zhvillim me veteranin Pali Carapuli, i cili më dorëzoi për recensë historikun e Dibrës në LANÇ. Me fillimin e shekullit të Ri, krijova lidhje me Bujar Karoshin, i cili drejton “Botimet M&B”, si dhe botimin e gazetës “Rruga e Arbërit”, ku kam botuar disa shkrime.

Lidhja vijoi me djemtë e talentuar të Dibrës Heroike, Fatos Daci e Sakip Cami. Kështu në vijimësi kam shkuar në Peshkopi dhe kam referuar për Skënderbeun, për betejat e tij në Dibër, për luftën e Dibrës të vitit 1921, për luftimet e kryera gjatë LANÇ, për dëshmorët etj. Në disa libra të autorëve dibranë më është dhënë mundësia për të bërë recensa e për të diskutuar në promovime të librave.

Njohja vijoi me Akademik Shaban Sinani, me prof. Adem Bonguri, me komentatorin sportiv Dëfrim Methasani, Eduart Ramçi, Hysen Uka, me regjizoren Donika Mustafaj, me botuesen Miranda Karoshi, me gjeneralen Manushaqe Shehu, me poetin Demir Rusi, me Zabit Lleshin, me ministren e Arsimit Tefta Cami, me prof. Shpëtim Cami... e mjaft dibranë të tjerë, deri në njohjen me Halil Ramën.

Libri i Mjeshtrit të Madh Halil Rama “Dibra dhe dibranët në pantetonin e vlerave” është një studim i thelluar dhe në kohë, që shpalos portretin e mjaft njerëzve të pazakontë të trevës së lavdishme dibrane. Janë portretizime që vijnë, si nga historia, ashtu dhe njohja e gjatë e autorit me personazhet historikë.

Autori nuk i ka zgjedhur rastësisht këta dibranë, por ka qenë diçka e brendshme që i ka sjellë tek ai. Mundet të jenë fije të fatit apo të brengave të tij, për vlerat e tyre luftarake, patriotike, historike, artistike e letrare. Mjeshtri Halil Rama ka gjetur në qoshen e përjetshme dhe të pakontestueshme dibrane njerëz që qëndrojnë në panteonin dibran dhe brenda tyre një filozofi si mbartës e si lëvrues modest i portretit historik, por dhe i vlerave të shumta dibrane.

Të shkruash për figura historike dhe që kanë lënë gjurmë në memorien kombëtare, është një sipërmarrje e vështirë, plot rreziqe, me risk, pasi pesha specifike e tyre është e madhe. Halil Rama është nga shkrimtarët lëvrues e gërmues për të vënë në dukje, dukuritë më të mira dibrane dhe shqiptare. E gjithë vepra e tij, ndonëse e shkruar në fundshekullin XX dhe në këtë çerekshekulli të shekullit XXI, ka fituar vlera të përjetshme në historinë e Dibrës.

Duke bërë disa viza për të vizatuar portretin e Halil Ramës, si njeri, si shkruar i letrave dhe si shkrimtar, kam parasysh një thënie të Bielinskit se “asgjë nuk mund të pohohet mbi bazën e tekave personale, të ndjenjave spontane, as të bindjeve individuale, gjyqi i takon arsyes dhe jo personit dhe personi duhet të gjykohet në emër të arsyes mbarënjëzore”.

Lexuesi, ashtu si dhe unë do të jetë i lutur ta kundrojë këtë ese të gjatë, jo si një përsiatje të mirëfilltë në rrafshin e gjykimit historik, teoriko dhe estetik, por si një “çjerrje” për rivlerësimin e disa figurave dibrane. Shumë prej tyre, edhe pse janë të hipotekuara në korpusin e madh të letrave shqipe, kanë mbetur disi të mënjanuar. Autori e ka ndërjerë këtë përgjegjësi

morale dhe qytetare, dhe ja ka dhënë lexuesit të kurdokohshëm të lexojë, të rivlerësojë e të shijojë veprën e tyre si shenjë historike e atdhetare, por dhe estetike.

Mjeshtri Halil Rama në rolin e një analisti, ka operuar me parametra historik, patriotik, estetik, artistik e kumtor dhe ka pëlqyer stilin e ligjërimit publicistik.

Prodhimtaria historike e letrare e Halil Ramës është e dukshëm. Krijimtaria e tij letrare është e hershme në aspektin e letrave, duke dhënë kontribut me vlera në gjinitë letrare dhe në publicistikë. Në këtë libër ai paraqet një dimension me rëndësi të madhe në historinë e letrave, por edhe për faktin se i flet lexuesit të çdo kohe për atdhedashurinë dhe kulturën dibrane e shqiptare.

Qëllimi i këtij libri dhe i autorit nuk është të analizojë të gjithë veprimtarinë e dibranëve, as të ndalet në ndonjë nga veprat e tyre të shumta, por për të prurë në këtë kohë individë që në jetë kanë shpalosur dituri, patriotizëm dhe qëndresë. Është koha të kthejmë sytë nga patrotizmi, që është një vlerë e përhershme e dibranit dhe shqiptarit në shekuj. Halil Rama në këtë kohë të trazuar ka ditur dhe gjetur pozicionin e duhur, duke bërë luftën e tij me penë.

Libri është ndarë në gjashtë kapituj.

Në kapitullin e parë na ka sjellë personalitete të krenarisë kombëtare, duke bërë një portretizim të mjaft figurave që kanë zënë vend në kështjellën shqiptare dhe të tjerë që i janë bashkuar kësaj kështjelle. Ai ka analizuar rrethanat, figurën dhe gjurmët e tyre të lënë në jetë, duke na i sjellë për të biseduar dhe marrë vendime për të ardhmen.

Nëpërmjet një studimi të tillë, me pak faqe autori dritëson ngjarje, bëma dhe një qëndresë epike të mjaft figurave patriotike dibranëve si Dine Hoxha filozof popullor; Ahmet Fetah Cami, atdhetari në dy luftëra botërore; Emin Cibaku dëshmor i rënë në betejën e Kolesjanit; Harun Domi, patriotit që pruri abetaren në Kalis e Kala të Dodës dhe Edip Daci, ushtaraku që refuzoi betimin fashist.

Më tej autori sjell një galeri të madhe dibrane; Hamit Koçi, intelektualit patriot i Vajkalit; Artan Cuku, dëshmor i demokracisë; Adem Islam Hoxha nga Çidhna që ra më 2 gusht 1949. Prof. Shpëtim Cami, “koherent me ato çka thotë e bën” për librin “Koherencë”; Dinastia e vëllezërve Keta nga

Bulqiza, kampionë bote në kikboks; Defrim Methasani, ikonë e gazetarisë sportive, dokumentarit televiziv dhe moderuesit të mjaft eventeve.

Mjeshtëri Hali Rama ka vijuar me një përshkrim të mjaft figurave dibrane që kanë bërë emër në historinë shqiptare.

Në përshkrimin e figurave të tilla autori me plot meritë ka derdhur talentin e tij, duke gdhendur deri në detaje çdo figurë të Dibrës, për t'i dhënë më tej shkëlqimin dritës dibrane dhe ja ka arritur.

Në kreun e dytë përshkruan personalitete të arsimit dhe kulturës me Lutfi Hanku, mësuesi e shkrimtari disident; Muharrem Xhediku, kompozitori i tangos shqiptare; Hazis Ndreu, ezopi i Dibrës; Liri Rasha, pasaporta artistike e Dibrës; Qerim Sula, zëri i lavdisë shekullore dhe ikonë e këngës dibrane; poeti i këngës, Naim Plaku; Muharrem Gjoka, promovues i vlerave etnokulturore; Lahim Kola, muzikanti i talentuar; Osman Miha për arsimin profesional në Bulqizë; Skënder Murrja, për 40 vjet mësues dhe drejtor shembullor i disa shkollave dhe Dritan Jashari me këngën “kjo është Dibra maja-maja”.

Në kreun e tretë me objekt “për ushtrinë shqiptare” nis me gjeneralin e lavdishëm Dali Ndreu, strategu që drejtoi luftën për çlirimin e Tiranës; Ismail Shulku, nderimi për ish-komandantin e frontit verilindor; Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare me gradën madhore “gjeneralmajor”; Selman Rama, skëndebege nga Muhurri që u bë oficer marine; Hamdi Doda, gjenerali nga Muhurri që ka përfaqësuar Shqipërinë në NATO dhe Klodian Tanushi, portreti në bronx i dëshmorit.

Kreu i katërt përfaqësohet me elitën mjekësore shqiptare duke nisur me Dr. Mehdi Cani, misionar i mjekësisë shqiptare; Prof. Dr. Petrit Bara, personalitet i shquar i mjekësisë; Prof. asc. Islam Dauti, intelektuali i shquar me përmasa mbarëkombëtare; Prof. Asoc. Dr. Ali Tonuzi, më i vlerësuar nga pacientët dhe elita mjekësore; Dr. Ajet Xhafa, kirurugu urolog duarartë nga Bulqiza, në spitalin amerikan të Prishtinës.

Në kreun e pestë përshkruhen disa nga librat e autorëve dibranë të shkruar për historinë e Dibrës, ku një vëmendje i kanë kushtuar figurës së Skënderbeut. Kështu autorët Naim Berisha që ka shkruar për Berishët e Muhurrit si rast unikal në historinë skënderbegiane; Besnik S. Kebej, origjina dibrane e Skënderbeut; Fatos Daci, Skënderbeu ka lindur në Sinë të Dibrës.

Më tej vijon me Prof. Saimir Shatku, për “Atdhetarët Shatku”, më Prof. Dr. Fatmir Terziu, Toponimia e Gollobordës, diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i origjinës; me Sakip Cami, ngjarje dhe figura të shquara historike të komunitetit të bashkisë së Bulqizës (1839 – 1939); Hysen Dervishi, “luftëtari i lirisë” për patriotin dibran Rrahman Dervishi; Haki Pernezha dhe Rruzhdi Bitri, “toponimia e Çidhnës”; Faik Bruçi, “fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës”; Kamber Faruku, “kur po shkriheshin akujt”. Autori ka bërë një përshkrim të rëndësishëm lidhur me botimin e këtyre librave me vlera për mjaft aspekte të jetës dibrane, por dhe të shoqërisë shqiptare.

Në kreun e gjashtë trajton “Dibra dhe dibranët në reportazhe të autorit”, ku vend zënë: Bulqiza në një film të Ylli Pepos, aty ku banorët shkelin mbi nëntokën më të pasur në Europë; Përrurimi i memorialit, eksodi masiv, mijëra familje dibrane në këmbë drejt Tiranës; “Sarina 2002”, lider në arsimin jopublik shqiptar; Festë në fshatin e martirizuar, Viçishti, fshati aty ku ka më shumë heronj se dëshmorë; Dita e Maqellarës... Diaspora dibrane, festë në Dibër të Madhe dhe Fuqia e fjalës së shkruar në ruajtjen e identitetit kulturor.

Libri është një prurje e re për Dibrën, e cila në histori ka bërë që zëri i bijve të saj të dëgjohej në Shqipëri. Libri vjen si një pikënisje për të gjithë patriotët që kanë bërë dhe shkruar histori në jetën shqiptare. Në këtë madhështi të figurave dibrane, Halil Rama, vjen si një zë i veçantë dhe me përmasa, që lartëson dhe i jep dinjitet figurave dibrane, ku fama e tyre është dëgjuar në kontinentin Europian dhe më gjerë.

Libri i Halil Ramës është shkruar thjeshtë, me zemër, me një gjuhë që përcjell mesazhe nën petkun e një mendimi filozofik dhe historik të epër, me dashuri e përkushtim për Dibrën e për Atdheun dhe shpirtin e tyre liridashës. Për të gjitha këto ese dhe përshkrime mjeshtërisht prej Halil Ramës, duhet t’i jemi mirënjohës për vlerat krijuese të tij.

Historia e një kombi është e gdhendur në veprat dhe sakrificat e bijëve e bijave të tij më të përkushtuar, por prurjen në jetë dhe plotë dritë të këtyre figurave të shquara dibrane, e ka bërë Mjeshtëri i Madh, Halil Rama, i cili zë një vend të veçantë në historinë e kombit shqiptar.

Tiranë, më 6 mars 2025.

HALIL RAMA

I.

PERSONALITETE TË KRENARISË
KOMBËTARE

DINE HOXHA – NJË FILOZOF POPULLOR NË OBORRIN MBRETËROR

- “Paria ka vendosur të therë kaun e madh”, kush e shpëtoi Zogun nga atentati në Vjenë! Dine Hoxha e bëri të qartë: Rrugë për serbin në Dibër nuk ka! Miqësia me Esat Pashën dhe pse u ndanë dy miqtë



Aty ku Murra derdhet në Drinin e Zi, në një kodër dominuese, ku ngado që të hedhësh vështrimin, nëntë malet e Dibrës rrinë përkarshi, edhe sot, e rindërtuar, lëshon rreze një kullë. Kjo kullë-kështjellë është simbol i këtyre anëve, për të kujtuar një nga njerëzit më popullorë, më të dashur, më të zgjuar: Dine Hoxha. Falë zgjuarsisë, ai u quajt profesor i Universitetit të Dibrës dhe për shumë kohë qe dhe Këshilltar i Mbretit Zog. Por Dine Hoxha nuk ishte vetëm i pasur. Ai ishte dhe i zgjuar dhe bujar, trim dhe besëtar. Ai ishte dhe mbeti, pa dyshim, më i dituri ndër të diturit, më i pasuri ndër të pasurit, më bujari ndër bujarët.

Dine Hoxha, ishte këshilltari besnik i Ahmet Zogut, ishte diplomat, ambasadori shëtitës i vetë Mbretit. Zgjuarsinë e tij, dhuratë nga natyra, e vinte në shërbim të kombit, ku u jepte këshilla me vlerë figurave më të spikatura në fusha të ndryshme. Dokumentet arkivore të shumta të kohës,

por dhe kujtimet e transmetuara brezave, e sjellin pas dekadash të plotë këtë njeri me emër. Sot, në metropolin shqiptar, pikërisht aty ku fillon Rruga e Kavajës, një ndërtesë vërtet e bukur, qoftë nga arkitektura e kohës, qoftë nga madhështia e veprës, zbukuron edhe Tiranën. Kjo është xhamia që ndërtoi ato vite Dine Hoxha me shpenzimet e veta, duke e bërë dhuratë për popullin e Tiranës. Sot, minarja e saj lartohet dhe duket sikur takohet lart me retë, e njerëzit thonë: Takohemi tek Xhamia e Dine Hoxhës. Do të falim Bajramin tek Xhamia e Dine Hoxhës... Edhe pse është bërë një ristrukturim në vitin 1996, ajo përsëri mban atë konstruksion që e ndërtoi Dine Hoxha. Në fasadën e saj, një pllakatë që përjetëson këtë emër të madh të Dibrës, atë që ndërtoi një vepër monumentale në Tiranë, e k'ësisoj në kujtesën e popullit, emri i Dine Hoxhës lartohet dhe vetëm lartohet.

PREJARDHJA

Po kush është, në fakt, Dine Hoxha, ky njeri zulmëmadh, bëmat e të cilit i kanë kaluar me meritë kufijtë e Shqipërisë? Sipas dokumenteve arkivore, origjina e fisit Hoxha vjen nga zona e Mirditës. Bëhet fjalë për periudhën para myslimanizimit të vendit. Erdhën dy vëllezër, Marku dhe Shtjefni, kuptohet për arsye gjakmarrje. U ngulën në fillim në Hurdhë-Muhurr. Marku, duke qenë njeri i zgjuar, me një inteligjencë natyrale, shërbeu si prift në kishën e fshatit. Reprezaljeve të turqve për myslimanizimin e vendit nuk u shpëtoi as Muhurri. Marku, nga prift, kthehet në hoxhë. Pas Markut, tashmë rrjedh Demiri, Demir Hoxha. Demiri lindi tre djem: Dervishin, Nel dhe Can Hoxhën. Nel Hoxha ishte gjyshi i Dine Hoxhës...

LUFTA

“Shtetet ballkanike nuk e njohin Pavarësinë e Shqipërisë edhe në atë territor të cunguar ku ajo u shpall. Kjo do të thotë se ato nuk mund të pajtoheshin me idenë e një shteti shqiptar. Ushtria malazeze nisi luftën më 8 Nëntor 1912, në orën 08:00, me topat e zbrazur së pari nga princi Petar. Mali i Zi, që kishte vendosur ta pushtonte Shkodrën e rrethinat e saj, nuk iu përgjigj për tërheqje as këshillave të Rusisë dhe as kërcënimeve të Austro-Hungarisë. Mbreti Nikolla parashikonte një fitore të shpejtë, por doli krejt ndryshe. Shkodra qëndroi e pamposhtur. Në Shkodër nuk

luftonin vetëm repartet turke. Brenda në qytet, pranë divizionit të rregullt otoman që komandohej nga gjenerali turk Hasan Riza Pasha, ndodhej edhe një divizion rezervistësh shqiptarë nën komandën e gjeneralit Esat Pashë Toptani. Së bashku me ta luftonin edhe qytetarët shkodranë, për të cilët tani rreziku kryesor nuk ishte Turqia, por Mali i Zi. Forcat rezerviste të vullnetarëve shqiptarë kanë qenë gjithsej 17 batalione, një nga të cilët edhe batalioni i Dibrës. Një ndër udhëheqësit kryesorë të forcave vullnetare dibrane ka qenë Dine Hoxha. Lufta zgjati 6 muaj. Në këto luftime dhanë jetën 114 dibranë, midis tyre edhe shumë nga fisi Ndregjoni ku Dineja ishte nip. (Libri “Ndregjonët”, Xh.Martini, faqe 71-723).

MIQËSIA ME ESAT PASHËN

Dine Hoxha kishte influencë në Dibrën e Poshtme, ku kishte gjithë rrethin e tij miqësor. Por ai kishte miqësi edhe me Zogollin e Matit. Dihet tashmë se Esat Pasha ishte daja i Ahmet Zogut. Pra, për hir të miqësisë me Zogollin, Dineja me 300 luftëtarë ishte vënë në ndihmë dhe në dispozicion të qeverisë dhe të pushtetit të Esat Pashë Toptanit. Por Dineja e njihte Esatin për atdhetar dhe për këtë kishte bindje. Në Shqipërinë e viteve 1912-1918, kur Fuqitë e Mëdha jo vetëm e copëtuan më 1913, por kërkonin ta copëtonin edhe më, veprimet ushtarake të një gjenerali shqiptar si Esat Pashë Toptani ishin të diskutueshme... Premtimi i Esat Pashë Toptanit ishte bashkimi i dy Dibrave dhe krijimi i Shqipërisë etnike. Qyteti i Shkodrës u dorëzua vetëm një muaj pas nënshkrimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 22 mars 1913. Kjo luftë e detyroi këtë Konferencë që Shkodra t'i mbetej Shqipërisë. Edhe gjatë kryengritjes së Haxhi Qamilit ndaj pushtetit të Esat Pashës, Dine Hoxha, vetë i treqind, shkon në Tiranë, Durrës e Fushë Krujë, në ndihmë të Esat Pashës për shtypjen e kësaj kryengritjeje që mori përmasa të mëdha. Por, “forcat e Esatit, të komanduara nga Xhelal Zogu dhe Dine Hoxha, ikën pa mbaruar ende afati i ultimatimit që kryengritësit u kishin dërguar me fillimin e kryengritjes”, më 30 nëntor 1914. (Arkiva, G.Shpuza, “Kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme”, faqe 257, botim i vitit 1986)

AUSTRO-HUNGAREZËT

Lufta e Parë Botërore pati rrjedhoja tragjike për Shqipërinë, ndonëse kjo nuk ishte pjesëmarrëse në të. Territori i Shqipërisë u bë shesh lufte, ku secila palë përpiquej ta përdorte për të realizuar interesat e veta. Territori i Dibrës, gjatë Luftës së Parë Botërore, ishte nën pushtimin bullgar. Bullgaria u radhit përkrah fuqive qendrore dhe pushtoi disa toka shqiptare. Austro-Hungaria nuk i mbajti premtimet për sigurimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe Shqipërinë etnike. Për këto premtime kishin besuar edhe shumë personalitete politike shqiptare të kohës. “Një ndër atdhetarët dibranë që nuk i besoi politikës së Austro-Hungarisë, ishte Dine Hoxha. Kur pa se austro-hungarezët po grabitnin dhe keqtrajtonin popullin, ai me përkrahësit e vet doli në mal. Austro-hungarezët kishin ngritur një Postëkomandë në Qafë Murrë. Kjo kishte për detyrë që të siguronte rendin dhe qetësinë, të merrte nga populli me dëshirë ose me forcë, ato prodhime bujqësore dhe blegtorale për të cilat kishte nevojë ushtria e huaj. Ushtarët filluan të terrorizonin malësorët, ngaqë ata nuk dorëzonin “detyrimet”. Radha për shlyerjen e tyre kishte ardhur në Lukan. Dine Hoxha mobilizoi burrat e Katër Grykëve, që t’u binin me armë austro-hungarezëve. Malësorët iu përgjigjën thirrjes së Dines. Ata rrëmbyen armët dhe u bashkuan me të. Luftëtarët shqiptarë u pozicionuan në Qafë të Lukanit, ku u ndez beteja me ushtrinë e huaj. Ajo zgjati disa orë dhe Komandanti i ushtrisë austrohungareze u detyrua të dorëzohej së bashku me ushtarët”. Dine Hoxha dhe Llan Destan Ndregjoni, me forcat që kishin nën komandë, vrapuan për në Lis të Matit ku sulmuan një divizion austro-hungarez, të cilin e detyruan të largohej në drejtim të Milotit, Shkodrës dhe Malit të Zi. Luftëtarët dibranë u furnizuan me armë dhe municione të reja luftarake.

SHOVINISTËT

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore, më 10 tetor 1918, ushtritë serbe hynë në Tiranë me pretekstin se do të dilnin matanë lumit të Matit për të përzënë austro-hungarezët, por, në të vërtetë, ata kishin për qëllim të dilnin në Durrës dhe të okuponin të gjithë Shqipërinë e Mesme. Për sa i përket territorit të Dibrës, trupat serbe nuk u ndalën as para kufirit të

vitet 1913, por zunë vijën Kaptinë e Martaneshit-Qafë Buall-Lanë e Lurës dhe duke vazhduar nëpër malet drejt Veriut, okupuan gjithë Dibrën. Në këto rrethana, atdhetarët dibranë u organizuan për t'i dëbuar me forcën e armëve pushtuesit jugosllavë. Dine Hoxha dhe Llan Destan Ndregjoni mobilizuan popullin që të luftonte për lirinë e Atdheut. Me Dine Hoxhën ishin shumë Ndregjonas dhe malësorë të tjerë të Katër Grykëve.

KONFLIKTI

Qëllimet shoviniste serbe, jo vetëm një herë kanë synuar nënshtrimin e zonave kufitare, përfshi edhe Dibrën. Por Dine Hoxha, me parinë e drejtues të tjerë të rezistencës vihen në ballë të qëndresës. Në takimin e zhvilluar, mes të tjerave, Dine Hoxha tha: “Rrugë për serbin në Dibër nuk ka, veçse kur të kalojë mbi trupat tona!”. (AQSH, Dosja “Rezistenca e Dibrës ndaj pushtimit serb). Qeveria e Beogradit, për të realizuar qëllimet e saj, jo vetëm në Dibër, por në të gjithë Luginën e Drinit të Zi, rekrutoi, jo me shumë vështirësi, Esat Pashë Toptanin i cili kishte një influencë të padiskutueshme në Shqipërinë e Mesme. Beu Toptanas, me ndihmën e jugosllavëve dhe sigurisht për qëllimet e tyre, realizoi aspiratat e tij, duke formuar dhe një Qeveri të Përkohshme, e cila shtrihej në Shqipërinë e Mesme. Duke qenë tërësisht e painformuar për qëllimet e mbrapshta të Esat Pashë Toptanit, shumë nga paria e Dibrës fillimisht nisën bashkëpunimin me të. Fillimisht, Halit Lleshi, Tafë Kaziu, Osman Mema e Dine Hoxha dhe më vonë edhe të tjerë u lidhën me Esatin, i cili e dinte fare mirë se po të kishte parinë me vete, do të gjente mbështetje dhe në masat e gjera popullore. Dine Hoxha, i njohur për mendjemprehtësinë dhe largpamësinë e tij prej filozofi popullor, jo se besonte dhe aq shumë tek beu Toptanas, por asokohe e shihte lidhjen e përkohshme me të, si një alternativë të besueshme për të realizuar aspiratat për një Shqipëri etnike. Krisja e parë mes Dine Hoxhës dhe Esat Pashë Toptanit nisi kur me porosi të këtij të fundit, përfaqësues të parisë së Dibrës si Halit Lleshi, Tafë Kaziu, Murat Kaloshi, Selim Noka, Selman Alia dhe vetë Dineja, u nisën nga Durrësi dhe arritën në Lisivalle. Mbasi hëngrën drekë, Halit Lleshi iu drejtua Elez Isufit: – Elez aga, na ka dërgue Esat Pasha tek ju. Pasha ju ban selam dhe kërkon t’i lamë një rrugë të lirë në Dibër serbit, që të tërhiqet dhe të dalë në Durrës. Ai kërkon vetëm rrugë, as strehë, as shtrat.

Elezi e pyeti:

– A serbi apo pasha e kërkon këtë rrugë?

– Serbi, – tha Haliti, – pasi pasha nuk do që të derdhet gjak. Ai e kërkon këtë, që të mos detyrohet ushtria serbe të hyjë me përdhunue n'cullë e n'gra!

– T'i bani salam Pashës, – ia preu gjithë inat Elezi, – se Dibra asht shkel e djeg disa herë nga serbët dhe Esat Toptanit nuk i ka qarë zemra për Dibrën. E sa për cullët e gratë e Dibrës i thoni Pashës, se serbi nuk ka për t'u parë as shpinën, por të ruajë të vetët, se do t'u hiqen edhe brekët! Rrugë për serbin në Dibër nuk ka, veçse kur të kalojë mbi trupat tona. Dibranët merren vesh me dy fjalë... Ra heshtja. Haliti kërkoi ta thyente me ndihmën e parisë. Sufa heshtte kokulur dhe qeshte nën mustaqe. Heshtjen e prishi Tafë Kaziu.

– Duam apo nuk duam, serbi do të kalojë. Ne ia kemi dhanë fjalën Pashës.

– Ti, – ia ktheu Elezi, – ia ke dhanë me kohë fjalën serbit, por jo Dibra. Po, a nuk më thue, sa pare të ka dhanë serbi për këtë, meqenëse e paske marrë kaparin? Prisni të merrni kusurin kur të kalojë në Qafë Murrë!

TAKIMI ME ELEZ ISUFIN

...Pas pak, Haliti kërkoi leje me dalë. Rrugës, Tafë Kaziu i tha Halitit: – Na preu Elezi. Dine Hoxha, që deri në këto momente veçse kishte heshtur, ia ktheu: Mos u tremb, or Tafë Kaziu! Qitja fishekët pushkës, se Elez Isufi nuk ka pre ndonjë mik brenda. Takimi me Elez Isufin, për Dine Hoxhën, është më se i nevojshëm.

Kjo qe krisja e majorit muhurrak me Esat Pashën. Divorcin përfundimisht do ta bënte para 13 qershorit 1920, kohë kur u vra Esat Pashë Toptani. Ishte koha kur krerët e Dibrës po përgatiteshin për kryengritjen e përgjithshme, e zgjuarsia, urtia e trimëria e Dine Hoxhës kërkohet me patjetër. “Kohë e humbur për mua ajo që kam qëndruar larg Elez Isufit”,- u thoshte Dinja shpesh fshatarëve të tij. Është trim dhe atdhetar, dhe askush nuk është i humbur kur rreshtohet në të njëjtën llogore me të. Kjo periudhë përkon dhe me miqësinë e re që lidhi Dine Hoxha me Elez Isufin. Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës brenda një kohe shumë të shkurtër, kishte arritur rezultate të mëdha në përpjekjet për bashkimin kombëtar dhe administrimin e vendit. (Arkiva, “Lufta e Dibrës 1920” – B.Xhafa, faqe 46-47, 126).

KRYENGRITJA

“Në korrik 1920, kur ishte duke vazhduar lufta e Vlorës, nënkolonel Ramiz Dibra, senatori i Dibrës, Ramiz Daci dhe Jashar Erebara shkojnë nga Tirana në Dibër. Bëhej një mbledhje në katundin Arras, ku morën pjesë të gjithë krerët e arratisur e jo të arratisur: Ramiz Dibra, Elez Isufi, Dine e Izet Maqellara, Ramiz Daci, Shaqir e Dine Dema, Dine Hoxha, Selim Noka, Murat Kaloshi, Dervish Lusha, etj., në të cilën bisedohet çështja e një aksioni kundër Jugosllavisë, pa u këshilluar me Qeverinë. Qëllimi i këtij aksioni, ishte të detyrohej Jugosllavia të tërhiqej në kufijtë e 1913 dhe, përveç kësaj, të lirohej edhe Dibra thjesht shqiptare, përndryshe dibranët do të luftonin për këtë qëllim, njëlloj siç luftonin vlonjatët për Vlorën, mbasi për Dibrën nuk mendonte as Qeveria, as edhe viset e tjera të Shqipërisë. U bisedua mbi koordinimin e forcave në një shtab të përbashkët dhe u caktua Elez Isufi si Komandant i Përgjithshëm. U vendos data e kryengritjes dhe u caktuan sektorët e vendosjes së forcave. Dine Hoxha lajmëroi komandantin jugosllav që ta lironte Dibrën shqiptare, por ai iu përgjigj: “Kjo i është lënë Jugosllavisë dhe nuk e lirojmë. Në rast se sulmoni, dijeni mirë se do t’ju presim me armë. Ushtria ime përbëhet prej 13000 vetave”. “Jo 13 000 veta, por edhe 13 milionë ushtarë po të keni, ne e kemi da mendjen me ba pushkë, se me duar në brez nuk do të rrimë!”. Përgjigjja flakë për flakë e Dine Hoxhës e hutoi për një çast komandantin jugosllav. “Më 18:20, në mëngjes, filloi kryengritja në Lugjaprovë-Shumbat prej Sufë Xhelilit: tek Ura e Lushës, prej Dervish Lushës e Murat Kaloshit; në Cap të Brezhdanit, prej Dine Hoxhës; në Grykë të Vogël, prej Demajve e Dan Camit”.

ULTIMATUMI

Vetëm dy ditë na ndanin nga data 15 Gusht 1920, kur tek vendi i quajtur Ferra e Pashës u mbajt Kuvendi i Arrasit, një kuvend i madh burrash që nuk ishte mbajtur herë tjetër. Në të nuk merrte pjesë vetëm paria e Dibrës, por dhe 700-800 burra të tjerë. Banorët e zonës, kuvende të tilla kishin dëgjuar vetëm në legjenda. Në Kuvend merrnin pjesë burrat e Dibrës (“Tigrat” e Dibrës – i quajti E.Durham): Ramiz Bej Dibra, Dine Bej Maqellara, Izet Bej Maqellara (bejlerët e Maqellarës), Ramiz Daci, Jashar

Erebara, Ismail Strazimiri, Dine Hoxha (Hajredin Aga-Muhurri), Selman Alia (Fushë Alie), Selë Bajraktari (Arras), Selim Noka, Haxhi Noka (Grykë Nokë), Murat Kaloshi, Avdi Kaloshi, Sali e Selim Kaloshi (Sinë), Dan Cami, Selman e Hakik Mena (Bajraktari i Lurës), Llan Destani (Lukan), Kurt e Dik Spata (Grykë Nokë), Ali Tahiri (Pira-Muhurr) e shumë burra të tjerë me zë nga të gjitha trevat e Dibrës. Kishte përfaqësues nga Daci i Kalisit e Lita i Ploshtanit, por dhe nga paria e Matit. Kuvendi bashkoi malësorët luftëtarë dhe i dërgoi mesazhin gjeneralit serb. “Do të lini kokën në trojet tona!”. (“Ballafaqime Politike”, faqe 159 – S.Vllamasi)

Erdhi përballja e armatosur. Sipas burimeve serbe, numri i përgjithshëm i kryengritësve shqiptarë që kryen mësymjen mbi trupat jugosllave e mercenare më 13-15 gusht 1920, arrinte në 4000 vetë dhe ishin nën komandën e Ramiz Beut, Elez Isufit, Dine Hoxhës dhe Dine Beut (Maqellarë), kurse fshatarët vendas, të cilët ngriheshin në kryengritje me afrimin e kolonave kryengritëse, komandoheshin nga paria e tyre: Murat Kaloshi, Selim Noka, Musatafa Kurtishi, Serdar Feta Beu, etj. (AM, Skopje, Pov.br.730, 24.08.1920, Debar).

QEVERIA

Në studimet e Fatos Dacit, del edhe roli i dibranëve, mes tyre edhe i Dine Hoxhës në mbrojtje të qeverisë së Lushnjës në shtator 1920. “Më 10 shtator 1920 komitet dhe serbët kërcënojnë Tiranën dhe qeverinë e shqiptare. Këta nisën drejt Grykës së Priskës, 3 orë larg Tiranës. Në mbrojtje të Tiranës dhe të qeverisë janë vu fuqitë vullnetare të ardhura nga Kavaja, Shijaku, Dibra etj., të cilët sulmojnë këto forca banditësh. Me këtë datë, në orën 2 allaturka (14.00) z.Dine Hoxha me dibranët iu ngjiten kodrës dhe sulmuan forcat që kërcënonin Tiranën e qeverinë kombëtare. Forcat vullnetare të udhëhequra nga prijës popullorë të veshur dhe me autoritetin qeveritar janë vënë në mbrojtje të qeverisë kombëtare. Një gazetë e kohës, citon: “Janë për t’u lavdëruar edhe major Shefkiu (mendojmë se bëhet fjalë për Shefki Shatkun) dhe oficeri Dine Hoxha etj., që kryen detyrën e tyre si ushtarë besnikë të atdheut”, – shkruan Fatos Daci.

KËSHILLTARI

“Duhet secili nga ne me e vendos një gur në themelet e këtij shteti, se nesër brezat që do të vijnë, do të na urojnë. Ndryshe, mallkimi i tyre, edhe pse kemi vdekur, do të bjerë mbi ne”,- i thoshte shpesh Dine Hoxha, parisë së Dibrës. Pas vitit 1920, gjendja politike në Shqipëri ishte disi e turbullt. Paritë e vendit dhe familjet e mëdha nuk vendosnin dot se nga të qëndronin.

Në dhjetor të vitit 1924 vritet Elez Isufi, një figurë shumë e njohur në Dibër dhe në gjithë Shqipërinë. Për Dibrën dhe dibranët, kjo ishte një humbje e madhe. Dine Hoxha do të shprehej: “Mos më vini re në qoftë se do të përlothem! E kisha më tepër se mik”. (Arkiva e Muzeut Dibër).

Në këtë kohë, Ahmet Zogu ishte bërë faktor politik, ndërsa dibrani i urtë dhe i zgjuar Dine Hoxha i kishte ndjekur hap pas hapi lëvizjet e tij. Si përfundim, i dha besën e dibranit për të mos e “tradhtuar”, veçse ditën kur do të mbyllte sytë njëherë e përgjithmonë. Për Ahmet Zogun, Major Dine Hoxha nuk ishte vetëm një ushtarak rezervë me përvojë, por dhe një këshilltar tepër i besuar.

Në vitin 1928, Shqipëria u shpall Monarki dhe Ahmet Zogu, Mbret i shqiptarëve. Ky nuk ishte vendim i një pjese të Parlamentit të atëhershëm, por dhe një miratim i shumë prej parive të vendit.

Paria e Dibrës e përkrahu pothuajse unanimisht vendimin e Parlamentit. Dine Hoxha mundohej tashmë të bindte edhe të lëkundurit në Dibër, se vetëm monarkia dhe Ahmet Zogu si monark mund ta bëjnë Shqipërinë shtet. Deri më tani, shqiptarët kishin vuajtur të kishin shtetin e tyre. Lidhjet e vjetra të tij me Ahmet Zogun u forcuan edhe më shumë.

OBORRI I MBRETIT

Kështu, profesorit popullor të urtë e të zgjuar iu hap rruga për në Tiranë. Dine Hoxha do të ishte i pranishëm edhe në takimet e ngushta, edhe në drekat e darkat ceremoniale që shtronte Ahmet Zogu. Këshillat e tij, kishin vlerë të padiskutueshme në Pallatin Mbretëror. Falë zgjuarsisë, urtisë dhe alegorisë dibrane të përdorur me mjaft delikatesë, ai që i aftë të përballonte situata të ndërlikuara, të zgjidhte konflikte dhe të parandalonte gjakderdhje. Këto veti dhe mjaft të tjera si këto e justifikonin besimin që

kishte Ahmet Zogu për Dine Hoxhën...

“Ahmet Zogu e ka da mendjen me e ba Shqipninë shtet e ne shqiptarëve me na afrue sa ma shumë me Perëndimin. Ky është taman burrë kombi. Duhet secili nga ne me e vendos një gur në themelet e këtij shteti, se nesër brezat që do të vijnë, do të na urojnë. Ndryshe, mallkimi i tyre, edhe pse kemi vdekur, do të bjerë mbi ne”,- i thoshte shpesh Dine Hoxha parisë së Dibrës.

Vendosmëria për të qëndruar krah Zogut dhe për t’u bërë një përkrahës kryesor i tij, ishte e lartë. Kjo dukej dhe nga puna bindëse që Dine Hoxha kishte bërë jo vetëm në Muhurr e Katër Grykët, por në gjithë zonën e Dibrës. Dashamirësit dhe mbështetësit e Monarkisë tashmë në Dibër ishin shtuar dhe të gjithë ishin të bindur se vetëm me Ahmet Zogun në Fronin Mbretëror, Dibra dhe dibranët mund të shikonin më tepër se dritarja e shtëpisë së tyre.

USHTAR I SHQIPËRISË NË VIJË TË PARË



Dine Hoxha me parinë e Dibrës në Kuvendin e Arrasit, 13 gusht 1920.

Në qoftë se gjatë regjimit të Ahmet Zogut, mjaft nga gazetaret e pavarura shkruanin për njerëzit që i qëndronin pranë si “dallkaukët e kombit”, “sahanlëpirësit”, “servilët”, “mjeranët e politikës”, Dine Hoxhën nuk mundën

ta etiketojnë si të tillë. Shumë nga faqet e shtypit të kohës, shkruanin me shumë rezerva për të. Vlerësimet ishin nga më të ndryshmet, si: “Dibrani mendjendritur”, “Sokrati pa shkollë”, “Mbreti këshillohet nga plaku i zgjuar i Dibrës”, etj. Debati që në atë kohë Dine Hoxha bëri me Kontin Çiano, la mbresa jo vetëm tek të pranishmit, por zgjoi kureshtjen edhe tek të huajt. Njëllonj si atëherë, më 14 Gusht 1920, me Gjeneralin serb. Në një darkë që kishte shtruar për nder të tij, Ahmet Zogu pyeti:

– Or Dine, ne kemi luftue bashkë tek Shkalla e Deshëve. Unë të kam dashtë dhe ti më ke falur një nga trimat e t’u më të mirë që ke patur. A do të më thuesh në sytë e nanës teme, si burrat: A ke mendue ndonjëherë të më zash vendin?! – Po, – tha Dineja, – unë kam mendue për ty. Në qoftë se do të të shkulin nga Tirana, unë do të merresha me shtëpinë time, do të bëhesha zot i shtëpisë time dhe do të merresha me qetë.

E ëma e Zogut u zemërua shumë dhe i foli ashpër të birit:

– Bir, shtizat nuk mund t’i fusin të tjerët! Dine Hoxha shpon malin dhe jo thasët. Dine Hoxha është ushtar i Shqipërisë, në vijë të parë, sa herë që të shkelë hasmi në trojet tona dhe është mbret i mbretërve, dhe rrin mbret në kullën e tij... – E dëgjon! – i tha Dineja Zogut. Mbretërit që tremben, nuk flenë rehat se mos iu marrin fronin, vdesin para kohe. Unë dëshiroj të rrosh. Dine Hoxha e Murat Kaloshi, kurrë nuk do të ta marrin fronin ty, por do ta forcojnë atë. Ahmet Zogu kishte idenë se Dine Hoxha e Murat Kaloshi shkonin keq me njëri-tjetrin dhe kur dëgjoji se Dine Hoxha e Murat Kaloshi ishin një “pendë qe” që mund të hapnin hulli edhe në shkëmb, u ngrit në këmbë e thirri me të madhe: – “Hej, bre, Dine, si nuk ma mësuet gjuhën e Nantë Maleve të Dibrës!”

– Gjuhën e Nëntë Maleve tona e ka dijtë baba yt dhe Hoxha i Stambollit, tek i cili falej vetë Sulltani, – u përgjigj Dineja. Më pas, filozofi popullor dibran i tha Mbretit:

– Më vjen keq, Madhëri, se më duket se nuk e din nga je.

Ti je nga kulla e Gjon Zogut, që e ka vendin midis Muhurrit e Sinjës, që edhe sot quhet Kulla e Zogut. Është vetë Skënderbeu që solli të parët e tu si sundimtarë të Matit, që të mbrohej Shkalla e Deshëve kur Dibra të binte në dorë të pushtuesit serb, që nuk ra kurrë. Dibra të pru Mbret dhe nuk e di se cilët bajloza do të vijnë ta marrin fronin që të kemi dhëne ne. Në qofsha gjallë, do vritem ballë për ballë me bajlozat.

– Dëgjo, or bir! – ndërhyri e ëma e Mbretit.- Qofsha a mos qofsha unë, Dibra nuk ka me e dorzue kurrë Shqipërinë. Dibra ka për derë Dine Hoxhën...

E VETMJA “PAKËNAQËSI” NDAJ MBRETIT

Në kohën kur Ahmet Zogu do të martohej me Geraldinën, ai pyeti shumë vetë nga këshilltarët e tij. Pyeti edhe Dine Hoxhën.

– Si thua ti, Dine, a ta marr për grua Princesshën hungareze?

Dinja nuk bëzani. E pyeti përsëri. Dinja, më në fund, foli:

– Merre, or mbret, merre Geraldinën, por me atë ti do të lindësh një djalë dhe djali, kur të rritet, do të kërkojë dajat e vet! Merre, or Mbret! Dine Hoxha e paska të vështirë me të këshillue sot...

ATENTATI

Alegoria e hollë dhe brilante e Dine Hoxhës, ka bërë të mundur që mbreti Zog t'i shpëtojë për mrekulli atentatit në Vjenë... Dhe konkretisht, ja si ka ndodhur, treguar nga goja e Isuf Peçit, shofer i Ahmet Zogut. Në shtëpinë e Dine Hoxhës vjen Konsulli jugosllav, pikërisht në periudhën kur Zogu ndodhej në Vjenë për konsultë mjekësore. Me buzë në gaz, i huaji pyeti Dine Hoxhën: – Pas Zogut, kush do të jetë Mbret në Shqipëri? E Dine Hoxha, tepër i zgjuar, duke kuptuar gjithçka, flakë për flakë përgjigjet: – Pas Zogut, në Shqipëri nuk ka Mbret. Duke u ndarë ftohtë me Konsullin jugosllav, drejt Vjenës, Dine Hoxha nisi këtë telegram: “Ahmet Bej Zogut, Hotel “Imperial”, Vjenë: “Paria e këtushme ka vendosur me therë kaun e madh. Mos i leni ta therin. Me shnet, Dine Hoxha!” (Arkiva. Kujtime të Isuf Peçit, shofer i Ahmet Zogut). Arkivat dhe dëshmitë tregojnë se këshillat e Dine Hoxhës për Zogun, kurdoherë kanë qenë të sakta dhe në të mirë të punëve. Ndërsa qëndresa e njohur e Hoxhës bashkë me patriotë të tjerë dibranë e më gjërë, ishte një nga faktorët e rëndësishëm për mbrojtjen e trojeve nga ushtria pushtuese serbe.

KONTRIBUTI

Dine Hoxha përbën një figurë të rëndësishme në historiografinë shqiptare, veçanërisht në periudhën e sundimit të Ahmet Zogut (1925–

1939). I njohur si një filozof popullor në oborrin mbretëror, ai përfaqëson një ndërmjetësues mes urtësisë tradicionale dhe zhvillimeve socio-politike të kohës. Ai jetoi dhe veproi gjatë një periudhe të rëndësishme të historisë shqiptare, kur vendi kalonte nga sistemi i bejlerëve drejt monarkisë së Ahmet Zogut. Ai njihej për afërsinë me rrethin mbretëror dhe për aftësinë e tij të shquar për të shprehur të vërtetat popullore me një gjuhë të thjeshtë dhe poetike. Kjo e bëri një këshilltar të vyer për mbretin Zog, në një kohë kur filozofia dhe mendimi popullor përdoreshin për të përçarur mesazhe të mençura. Arkivat dhe burimet historike tregojnë se Dine Hoxha nuk ishte vetëm një mendimtar, por edhe një figurë e njohur për ngjarjet dhe polemikat që rrethonin oborrin mbretëror. Në arkivat historike, emri i Dine Hoxhës gjendet shpesh në lidhje me përpjekjet për ruajtjen e identitetit kulturor shqiptar në një kohë të trazirave politike. Një nga aspektet më të veçanta të Dine Hoxhës ishte prirja e tij për të përçarur filozofinë popullore nëpërmjet fjalëve të urta. Ato përçonin jetën e përditshme, sfidat e shqiptarëve dhe vlerat që ai besonte se duhet të ruheshin.

Nëpërmjet fjalëve të urta, Dine Hoxha trajtonte:

• **Drejtësinë dhe moralin:**

“Një mbret pa drejtësi, mbret nuk mund të mbetet, Populli s’e duron, se vetë gjykon e vret.”

• **Marrëdhëniet mes njerëzve:**

“Mos shiko të madhin, shiko zemrën e tij, Zoti nderon të mirin, jo fronin as lirinë.”

• **Urtësinë popullore:**

“Fjala e mençur s’ka nevojë për mburojë, Ajo mbijeton, si dielli në kupë qiellore.”

Me mençurinë dhe urtësinë e tij gërshetonte gjuhën e thjeshtë popullore me thellësinë filozofike, duke u bërë e kuptueshme për të gjithë shtresat e shoqërisë. Dine Hoxha përfaqësonte një urë të rëndësishme mes traditës dhe modernizimit në Shqipëri. Ai u bë i njohur jo vetëm për mendimet e tij të mençura, por edhe për guximin për të folur për të vërtetat e kohës. Në oborrin mbretëror, figura e tij u vlerësua për ndikimin që kishte te njerëzit e thjeshtë, por edhe te intelektualët dhe politikanët. Dine Hoxha mbetet një figurë e rëndësishme në historiografinë shqiptare si një mendimtar popullor që ndikoi në periudhën e monarkisë shqiptare.

AHMET FETAH CAMI, ATDHETARI QË MORI PJESË NË DY LUFTRA BOTËRORE

- Më 8 gusht të vitit 1900, në fshatin Viçisht të Qarkorit të Dibrës, në një familje me tradita atdhetare lindi luftëtari dhe intelektual i shquar Ahmet Fetah Cami, i cili do të hynte në analet e Historisë së Shqipërisë si pjesëtar aktiv i dy luftërave botërore dhe veçanërisht si themelues dhe komandant i Çetës të Gollobordës.



Që në moshë të re, Ahmeti u njoh dhe u frymëzua nga ngjarje dhe episode të ndryshme trimërie dhe heroizmi të popullit shqiptar, si dhe të paraardhësve të tij, si të Mahmut Camit, i vrarë në luftën kundër forcave Osmane të komanduara nga Hajredin Pasha, të Shaban Mahmut Camit, i vrarë në luftimet për mbrojtjen e trojeve shqiptare kundër mësymjeve të forcave pushtuese serbobullgare, të Fetah Shaban Camit, që është quajtur si legjenda e Luftës së Parë Botërore në atë krahinë, i cili ka udhëhequr e komanduar forcat e krahinës së Gollobordës kundër forcave pushtuese shoviniste fqinje serbo-bullgare.

Ahmeti ishte pjesëmarrës me armë në dorë gjatë Luftës së Parë Botërore me çetat që udhëhoqën gjyshi i tij, Shaban Cami dhe kushëriri Dan Cami e të tjerë pas vrasjes së Fetah Camit. Pasi vritet e masakrohet babai i Ahmetit, Fetah Cami, e merr dhe komandon çetën e Gollobordës, Shaban Cami, gjyshi i Ahmetit, i cili i vendos për herë të parë pushkën në krah Ahmetit që në moshën 16-vjeçare dhe e merr në luftime kundër forcave pushtuese serbo-bullgare deri në Shkup, ku vritet në luftime edhe Shaban Cami, gjyshi i Ahmetit. Të gjithë u flijuan si dëshmorë të atdheut. Ahmeti i përjetoi edhe ngjarjet e Kongresit të Lushnjës si dhe të Revolucionit Demokratik të Qershorit të vitit 1924. Ai ushqe simpati për qeverinë e Sulejman Delvinës dhe te Fan Noli.

Mësimet e para i mori në shkollën 7-vjeçare të Zerqanit. Kreu arsimin e plotë ushtarak në Tirane dhe studime në akademinë ushtarake. Punoi për disa vite si oficer gjatë kohës së Zogut në rrethet Shkodër e Gjirokastrë dhe për disa vite në Prefekturën e Elbasanit. Në qytetet ku punoi, Ahmeti është futur në rrethet intelektuale dhe ka marrë pjesë gjallërisht në diskutime e debate për probleme kombëtare si për organizimin e ushtrisë, të arsimit e të shkollës kombëtare etj.

Si intelektual i ndiqte me shqetësim ngjarjet që zhvilloheshin në vend dhe në botë. Ai ka mbajtur e mbrojtur anën e krahut progresist dhe demokratik. Ka denoncuar dhe kundërshtuar me indinjatë penetrimin e të huajve në ushtrinë shqiptare, veçanërisht penetrimin e Italisë që para pushtimit. Prandaj ka shkuar deri te Mbreti Zog në një takim me të dhe ia ka parashtruar gjendjen e ushtrisë.

ORGANIZATOR DHE KOMANDANT I ÇETËS SË PARË ANTIFASHISTE TË DIBRËS

Ahmet Fetah Cami e ka pritur me indinjatë të thellë pushtimin fashist italian. Prandaj që ditën e parë të pushtimit të Shqipërisë, tregon ish-kolegu i tij, Isuf Kokomiri: "...Më ka lënë një kujtim të pashlyer qëndrimi i Ahmetit, në fund të karrierës së tij ushtarake. Sapo qe kthyer nga Kapshtica, pasi i kishte përcjellë për në Greqi, Mbretin tonë, Ahmet Zogun. U fut menjëherë në zyrë dhe përgatiti ca libra e materiale, të cilat i dorëzoi. Pastaj shkroi një deklaratë që përafërsisht më duket se kishte këtë përmbajtje: 'Unë jam betuar përpara flamurit që t'i shërbej shtetit shqiptar. Tanimë që

ky shtet nuk ekziston, unë nuk mund t'u shërbej të huajve'. Pastaj doli nga zyra dhe e la çelësin të varur tek sporteli. Doli jashtë dhe iu afrua flamurit. Ahmeti i ulur në gjuhë puth flamurin kombëtar dhe jep dorëheqjen si oficer".(Libri ("Ahmet Fetah Cami – Autobiografi e shkruar me gjak nga pjesëmarrësi i dy luftërave botërore", faqe 284).

Shembullin e tij e ndoqën edhe ushtarakë të tjerë, të cilët vazhduan të jepnin dorëheqjen. Kthehet brenda natës në fshatin e tij të lindjes, në Viçisht të Dibrës. Ai e kishte më se të qartë, se vetëm me luftë të armatosur, mund të çlirohej Shqipëria nga pushtimi fashist italian.

Këtë të vërtetë historike e pohon në kujtimet e tij edhe Uke Abdulla Cami, i cili shkruan se që nga ardhja e Ahmetit nga Elbasani, në prill 1939 dhe derisa e caktuan për shoqërimin e Misionit Anglez, ka qenë shoqëruesi i tij në të gjitha aktivitetet dhe aksionet që ka zhvilluar Çeta e Gollobordës. "Më 15 janar 1940 jemi mbledhur në Golovisht të dy grupet, njëri e kishte bazën në Tiranë dhe tjetri në Elbasan, të përbërë prej 18 vetave, kemi ngritur çetën e parë në këtë zonë, për të luftuar kundër pushtimit fashist. Për ngritjen e çetës jemi mbështetur në Kuvendin e Nandë Maleve të Dibrës dhe jemi udhëhequr nga ideja kombëtare e bashkëpunimit me të gjithë ata që sadopak kanë luftuar kundër okupatorëve si gjatë Luftës së Parë Botërore, ashtu edhe gjatë Luftës së Dytë, me idenë e Vatrës dhe në zbatim të thirrjes së Antantës, për të luftuar për çlirimin e Atdheut...", shkruan Uke Abdulla Cami në kujtimet e tij.

Më tej në vlerësim të rolit dhe kontributit historik të komandantit të kësaj Çete Ahmet Fetah Cami, Ukja shkruan se: "Më 7 prill 1939, me ardhjen e okupatorit fashist në tokën shqiptare Ai (Ahmeti) dha dorëheqjen dhe u bashkua me Antantën kundër Boshtit, me idenë e plotë të Komitetit të Nandë Maleve të Dibrës (N.M.D) për bashkimin në luftë kundër okupatorit pa dallim feje, krahine e ideje... dhe për çlirimin e Atdheut dhe të kombit shqiptar, deri sa dha jetën në krye të betejës në Peshkopi, më 20 tetor 1943 kundër okupatorit nazifashist". (Libri ("Ahmet Fetah Cami – Autobiografi e shkruar me gjak nga pjesëmarrësi i dy luftërave botërore", faqe 256-257).

PAK HISTORI

Fillimet e qëndresës mbarëpopullore ndaj pushtimit fashist italian, në Dibër e në disa fshatra të zonës së Grykës së Vogël e të Gollobordës, nisën

që ditën e 7 prillit 1939. Kur kthehet në Dibër, Ahmeti mëson se kishin internuar e çuar në Berat Uke Dan Camin, kreun e Malit të Gollobordës dhe Sinan Shaban Camin, kryeplakun e Malit të Gollobordës dhe kishin internuar edhe disa krerë të tjerë të Maleve. Menjëherë organizon rezistencën në krahinë dhe bën disa aksione në disa fshatra të Grykës së Vogël dhe të Gollobordës.

Në janar 1940 organizon dhe ngre çetën atdhetare antifashiste të Gollobordës, ku si komandant zgjidhet Ahmet Cami dhe si zv/komandant Uke Dan Cami.

Të 9 Malet e Dibrës kanë funksionuar edhe gjatë viteve të para të LANÇ deri në maj të vitit 1943, kur u asgjësuan si armiq disa nga krerët, që bashkëpunuan me pushtuesit nazifashistë. Në qershor 1943, kur filloi shpërbërja e organizimit të Maleve dhe e qeverisjes kolaboracioniste, filluan të zbatoheshin vendimet e Frontit Antifashist për organizimin e këshillave nacionalçlirimtare të pushtetit të ri popullor. Synimet e organizimit dhe veprimtarive të çetave atdhetare antifashiste, në fillim, kishin karakter kombëtar sipas traditës historike të Nëntë Maleve të Dibrës.

Për krijimin e çetës së Gollobordës, Ahmeti u mbështet tek traditat atdhetare e liridashëse të popullsisë së krahinës së Grykës së Vogël dhe të Gollobordës, tek urrejtja që ushqente popullsia e këtyre fshatrave ndaj pushtimit fashist. U arrit që popullsia e krahinës, të mos e njihte pushtetin kolaboracionist të pushtuesve fashist, të mos paguante taksat dhe të mos jepte të dhjetat e tokës e të prodhimit.

bordës kundër pushtimit fashist derisa sa ndërroi jetë, i ka organizuar dhe udhëhequr Ahmet Feta Cami.

Gjatë viteve 1939-1941, veprimtaritë antifashiste janë zhvilluar në këto drejtime:

- Në mbledhjen e qindra vullnetarëve nga fshatrat e Shupenzës dhe të Gollobordës, për të shkuar dhe për të luftuar në Durrës kundër pushtimit fashist.

- Në organizimin e një pune politike kundër pushtimit fashist, me qëllim që popullsia në këto zona të mos binin pre e propagandës fashiste dhe kolaboracionistëve. Ahmeti është vënë në krye të punës politike, për sqarimin e popullit. Më 28 Nëntor 1940 ka folur para popullit në Homesh për këtë datë historike, duke u dhënë që të kuptojnë se vetëm të bashkuar

në luftë mund t'i dilet zot vendit dhe të çlirohet Shqipëria.

– Në marrjen e një informacioni të saktë për zhvillimin e situatave politike në Shqipëri e në botë, për veprimtaritë antifashiste që zhvilloheshin në rrethet e tjera të vendit; të informoheshin për lëvizjet e armiqve, me qëllim që njerëzit të mos binin në kurthet e tyre. Mbi këtë bazë është organizuar shërbimi me roje në disa fshatra, tërheqja e shtypit nëpërmjet Kurt Camit, që bënte tregti në Shupenzë e shkonte në Tiranë e Dibër të Madhe për furnizim çdo javë, nga informacioni që merrnin nga njerëzit që bënë kontrabandë në Dibër të Madhe, nga të njohur e shokë që vazhdonin të kishin pushtet, si dhe nëpërmjet rapsodit popullor, Musa Izvira, që shkonte sofër më sofër e konak më konak, siç e kujton populli i atyre fshatrave.

DISA NGA AKSIONET QË KREU ÇETA E GOLLOBORDËS

Komandanti i çetës, Ahmet Cami, organizoi punën për ndërmarrjen e kryerjen e aksioneve konkrete kundër pushtuesit fashist italian:

1. Në fund të muajit mars të vitit 1941, Ahmeti ka organizuar punëtorët e argatët, që punonin rrugën e zonës së Gollobordës, për pengimin e kolonës ushtarake italiane, që kalonte me municione nga Librazhdi në drejtim të Shupenzës dhe Dibrës së Madhe. Punëtorët kanë marrë armët dhe përmbetur në lumin Dri një makinë me municione.

2. Më 2 Prill të vitit 1941 është organizuar aksioni për të sulmuar depot e armatimit të batalionit të divizionit “Firencie” të dislokuar në Vanastrane të fshatit Tërbaç, me një efektiv prej 600 ushtarësh italianë. Në këtë aksion u kanë marrë italianëve shumë armë dhe janë vrarë disa italianë si dhe një oficer i tyre. Ndërsa forcat e çetës nuk kanë pësuar asgjë, sepse aksioni që i mirorganizuar me detaje. Me armët e rrëmbyera në dy aksionet, janë armatosur të gjithë luftëtarët e çetës e të krahinës. Për kryerjen e këtyre aksioneve forcat pushtuese italiane arrestojnë me 4 prill të vitit 1941 tetë vetë, 7 prej të cilëve ishin djem të Cameve dhe me 5 prill i fusim për pushkatim. Ejup Cami, meqë dinte italisht, u thoshte: “Do t’na pushkatojnë. Meqë nuk jemi të lidhur, kur t’na vendosin në rresht, ne të shpërndahemi nga të gjitha drejtimet, për të shpëtuar!”. Dhe kështu bënë. Por mbetën të vrarë Ejup Shahin Cami, Musa Rahman Cami dhe Mexhit Lezi nga Luznia. Ndërsa të tjerët largohen në drejtime të ndryshme

dhe nuk i kapën dot. Arrestojnë 19 burra e djem të çamëve dhe disa nga Golloborda e Shupenza dhe i burgosin për një vit e gjashtë muaj në burgun e Tiranës dhe të Burrelit si antifashist me Ahmet Camin si kryetar i tyre. Gjatë kohës së burgut ndërron jetë në burg Dilaver Cami nga torturat.

3. Në aksionin e 7 prillit 1941, gjatë përpjekjeve me pararojën e forcave pushtuese italiane apo të jugosllave, që ishin futur këtej Drinit, vritet Fasli Feta Cami, normalisti i Elbasanit, vëllai më i vogël dhe bashkëluftëtari i vendosur e besnik i Ahmet Camit. Fasli Cami njihet si dëshmor i parë i çetës atdhetare të Gollobordës dhe si mësuesi i parë dëshmor në Shqipëri. Krahina atë natë ishte e rrezikuar nga forcat pushtuese të dy vendeve nga forcat pushtuese italiane dhe ato serbe.

TË BURGOSURIT DHE DËSHMORËT E FISIT CAMI

Pas një aktiviteti të hapur dhe ilegal, Ahmeti arrestohet më 27 prill të vitit 1941 dhe dërgohet në Ostren, në Homesh dhe në burgun e Tiranës e të Burrelit së bashku me xhaxhallarët e kushërinjtë e tij për më se një vit e gjysëm. Akuzohej si organizatori kryesor i lëvizjes dhe të rezistencës në krahinë. Para Ahmetit ishin arrestuar 18 burra e djem të Camëve si dhe disa fshatarë nga Golloborda e fshatrat e Shupenzës.

Në burg Ahmeti njihet dhe zë miqësi me shumë të burgosur nga krahina të ndryshme të vendit, të dënuar apo të padënuar. Ai përmend në ditarin e burgut luftëtarë si Thanas Xhufka, Vasil Gjika dhe Naumi, studentë në Normalen e Elbasanit. Në ditarin e tij ai shkruan: “Meqë komunistët qenkan aq patriot për çështjen kombëtare, atëherë edhe unë qenkam më bolshevik”. Njeh Petro Markon, pjesëmarrësin e luftës të Spanjës. Njeh disa kosovarë e pezakë, të burgosur për të njëjtat motive. Pas vrasjes së vëllait të tij dhe pushkatimit të Ejupit e Musait dhe të Mexhit Lezit, e njoftojnë për vrasjen enigmatike e të pabesë të Sefer Ramiz Camit, i cili është dëshmor. (Më vonë bie dëshmor kushëriri i parë i Ahmetit, Mahmut Dalip Cami në luftimet me Brigadën e 18 S).

Ahmeti, me gjithë kushërinjtë dhe bashkëpunëtorët e tij, dalin nga burgu në gusht 1942 me një vendim të rremë, të cilin e kishte paguar shtrenjtë, me 300 apo 600 napolona flori. Në shkresën e zv.prefektit të Dibrës Mahmut Golemi të datës 22.6.1942 dhe të z/ministrit të MPM, Beqir Valteri shënohet lirimi. (AQSH, F.252, D.1637, V. 1942, Fl.188-189)-

Sapo u liruan nga burgju, u arratisen për 2-3 muaj nëpër malësi, sepse i kërkonin që t'i burgosnin përsëri. Ahmeti qëndroi në Grykë Nokë të Dibrës i strehuar tek Shaqir Rusi për tre muaj.

Me t'u kthyer në shtëpi, në nëntor 1942 e riorganizon përsëri çetën luftarake për zonën e Gollobordës dhe për disa fshatra të Grykës së Vogël. Kjo çetë bëri disa aksione për t'i mbrojtur këto zona, dhe punoi me fshatarët, që të mos binin nën ndikimin e propagandës fashiste e të bashkëpunëtorëve të tyre. Çeta e Gollobordës kishte simpati e besueshmëri në atë zonë dhe vepronte si njësit më vete kundër pushtuesve italianë.

Në vjeshtë të vitit 1942, ku ra në kontakt me Zoi Themelin, komandanti i Çetës së Gollobordës Ahmet Cami pranoi të bashkohej me Frontin Antifashist të LANÇ dhe në maj 1943, e shndërroi çetën antifashiste të Gollobordës në çetë partizane.

Ahmet Cami ishte ftuar nga Spiro Moisiu, për të marrë pjesë më 10 korrik 1943 në krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Labinot, por e kthejnë nga rruga nga koniunkturat politike të kohës.

ORGANIZATOR I KRIJIMIT TË BATALIONIT PARTIZAN TË DIBRËS

Ahmet Cami organizoi krijimin e Batalionit partizan me 23 korrik të vitit 1943 në fshatin Gjoricë e Epërme, si një fshat me një popullsi patriote dhe më i sigurt, sepse ishte Dalip Cami, xhaxhai i Ahmetit kryeplak, dhe dy miqtë e tij, Ramadan Mera e Shaqir Pali dhe Ferit Kaja, të angazhuar me lëvizjen antifashiste. Çeta e Gollobordës ka qenë pjesëmarrëse në krijimin e Batalionit të Dibrës, sepse Ahmeti e njëjhte artin ushtarak të kohës dhe e ndiente nevojën e organizimit të luftës në formacione më të mëdha luftarake. Ahmeti e zgjodhi Fshatin Gjoricë e Epërme si vend më të sigurt, për krijimin e Batalionit të Dibrës, për shkak të influencës që kish krijuar çeta e Gollobordës në këtë fshat, si dhe të lidhjeve të shumta familjare e fafëfisnore, miqësore e shoqërore, që kishte ai.

Çeta partizane e Gollobordës u bë një nga çetat më luftarake të lëvizjes nacionalçlirimtare në Dibër dhe kreu një seri aksionesh. Në majë të vitit 1943 si çetë partizane menjëherë pas riorganizimit kreu aksionin e parë në Drenok kundër një autokolone që po shkonte për në Strugë.

Çeta e Gollobordës ka marrë pjesë në shumë luftime si në aksionet për

çlirimin e Trebishtit, të Ostrenit, të Kërçovës, të Debërskës, të Kosovrastit dhe të Izvorit, të rrugës Dibër-Strugë, Spas e Sollokiç, Reshane, si dhe në luftimet për çlirimin e mbrojtjen e Zerqanit, në luftimet për çlirimin e Dibrës së Madhe dhe të Peshkopisë.

Ahmet ka qenë i pranishëm në dorëzimin e Shtabit të Divizionit italian “Firencia” dhe ishte ngarkuar të drejtonte forcat e Çetës së tij dhe të një pjese të Batalionit të Martaneshit për ruajtjen e rendit dhe qetësisë në Dibër të Madhe, për t’i mbrojtur nga disa banda të panjohura, që ishin organizuar për të bërë vjedhje e shkatërrime të qytetit.

Gjatë udhëtimit për në Peshkopi Çetës së Ahmetit i bëjnë dy prita. Pritën e parë në Maqellarë, por atë e kalon pa konflikt, sepse forcat kundërshtarë ulin armët, kur informohen, se po kalojnë forcat e Ahmet Camit nga lidhjet e shumta miqësore e familjare. Prita e dytë iu bë në mbrëmje në Qenok. Aty Ahmeti përdori një taktikë të ndezjes së zjarreve në kodër të Qenokut, ndërsa forcat e Çetës kaluan në pjesën anësore të kodrës së Qenokut pa pësuar asnjë përpjekje e dëme. Në Peshkopi Çeta partizane e Gollobordës vendoset në Dobrovë. Në mesnatë i jepet urdhër të kalonë në Staravec. Në krah të Çetës së Gollobordës ishte vendosur Çeta serbo-malazeze prej 45 vetësh. Në këto luftime mbetën të vrarë partizani Lil Hasa, mitralieri partizan italian, Salvatore si dhe u plagos rëndë komandanti i saj trim, Ahmet Cami, i cili pas disa ditësh ndërroi jetë nga plagët e luftës më 30 Tetor në spialin e Tiranës, duke dhënë një shembull trimërie dhe heroizmi. Në luftën e Peshkopisë u plagosën edhe partizanë të tjerë të çetës si Esat Cami, Asllan Zeneli, Hidër Manjani dhe Bajram Toçi. Kjo çetë në luftimet për mbrojtjen e qytetit të Peshkopisë u dëmtua shumë.

Ahmet Cami dha për Luftën Antifashiste Nacional-çlirimtare, për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut gjithçka kishte. Ai shkriu të gjithë pasurinë e tij, duke dhënë edhe jetën. Akti i heroizmit të Ahmetit dhe të shokëve të tij, e frymëzuan çetën e Gollobordës, për ta vazhduar më me guxim e heroizëm luftën për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazistë. Amaneti i tij i fundit për çetën ka qenë, për ta vazhduar luftën kundër pushtuesve të vendit, për të siguruar vëllazërimin e të gjithë shqiptarëve, për të evituar vëllavrasjen, që përpiqeshin të nxisnin elementë të ndryshëm kolaboracioniste me nazifashistët apo me jugosllavët. Populli i kësaj krahine e ngriti lartë emrin e Ahmet Camit, duke e vazhduar më me vrullë luftën, duke e përjetësuar në

disa këngë popullore, si dhe duke e quajtur çetën partizane e Gollobordës “Çeta Ahmet Cami”.

Duke folur në Berat, më 21.10.1944 përfaqësuesi i Dibrës, Haki Stërmilli, ndër të tjera do të theksonte: “Dibra mburret dhe krenohet pse pat edhe shumë burra që e nderuan, pat djelm të shquar që iu kushtuan altarit të lirisë, ndër të cilët Ahmet Cami e shumë të tjerë që e puthën vdekjen me kangën e lirisë në gojë”.

Skënder Menzelxhiu në botimin e tij “Ditar Partizan” (Gusht 1944-Maj 1945 shkruan: “...Trimat partizanë s’u tremben as nga plumbat as nga vdekja. Shoku yne Ahmet Fehta Cami nga Viçishti, komandanti trim i rrallë i çetës së Gollobordës, megjithëse i plagosur rëndë, në pamundësi që të fliste se plumbi i kish rrëmbyer nofullën dhe gojën, me laps e letër në dorë, gjallërisht, me besim të patundur në fitoren tonë, vazhdonte të komunikonte me shokët e tij, jepte pororsira që t’i binin armikut e mos ta linin të qetë derisa të shporresh, shkruante fjalët e tij te fundit “Te rroje Shqipëria e lire!” (Fl.2)

LIBRI QË PASURON LETËRSINË TONË DOKUMENTARE

Pas rënies së Ahmetit, Çeta Partizane e Golloborës u inkuadrua në formacionin e Brigadës së 18 S dhe ka kryer edhe shumë luftime të tjera, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë. Në listën e Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Dibrës, që i dërgohet Presidiumit të Kuvendit Popullor me 30.1.1984, është shënuar emri i Ahmet Fetah Cami si Dëshmor i Atdheut i shpallur me Vendim Nr. 50 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Dibrës, me 30.6.1972.

Ahmet Cami për kontributin e dhënë në Luftën Nacionalçlirimtare, iu akorduan menjëherë Medalja e Kujtimit, Medalja e Trimërisë dhe Medalja e Çlirimit. Ndërsa në vitin 1966 dhe 1967 nga rrethi i Dibrës i është propozuar dy vite rrjesht Presidiumit të Kuvendit Popullorë që Ahmet Camit t’i jepej titulli “Hero i Popullit” për qëndrim patriotik dhe heroik gjatë luftës Nacionalçlirimtare. Por ky titull nuk iu dha, sepse qe cilësuar si nacionalistë nga jugosllavët. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” me Vendimin Nr.5, datë 27.12.2002 i ka dhënë “Certifikata e Dëshmorit të Atdheut”.

Një pasqyrë e zgjeruar e jetës dhe veprës së tij jepet në librin “Ahmet

Fetah Cami – Autobiografi e shkruar me gjak nga pjesëmarrësi i dy luftërave botërore”, me bashkautorë djalin dhe vajzën e tij: Moisi dhe Ahmet Cami. Në këtë libër, përveç biografisë së shkurtër dhe ditarit të Ahmet Camit jepet një panoramë mbi historinë e Luftës Nacionalçlirimtare në Dibër, parë nëpërmjet dokumenteve arkivore, mbresa dhe kujtime të të afërmeve dhe bashkëluftëtarëve të Ahmetit, artikuj dhe emisione të bëra në Kujtim të përvjetorëve të rënies së tij; dëshmi dhe fakte, dokumente arkivore, fotografi e tij.

23 DËSHMORËT, TË PLAGOSURIT DHE TË VDEKURIT NËPËR BURGJE NGA ÇETA ANTIFASHISTE E GOLLOBORDËS

I. Dëshmorët e parë të çetës antifashiste të Gollobordës:

1. Fasli Fetah Cami-mësues, vrarë më 7 prill 1941;
2. Ejup Shahin Cami-student, vrarë më 12 prill 1941;
3. Musa Rahman Cami-bujk i mesëm, vrarë me 12 prill 1941
- Mexhit Lezi-bari, vrarë më 12 prill 1941;
5. Sefer Ramiz Cami, vrarë me tradhti në maj 1941;
6. Dilaver Cami-bujk, vdekur në burgun e Tiranë nga torturat në gusht të vitit 1941.

II. Dëshmorët e çetës partizane të Gollobordës:

1. Ahmet Fetah Cami. Komandant i çetës së Gollobordës plagosur me 18 tetor 1943 dhe vdekur me 28 tetor.
2. Lil Hasa-fshatar i varfër nga Tërnova, vrarë më 20 tetor 1943
3. Spiro Velko-mësues, i vrarë në kampin e Prishtinës
4. Hamdi Lleshi-bujk, vrarë në Dibër të Madhe në nëntor 1943
5. Mahmut Cami, vrarë në vitin 1944
6. Salvadore-mitralier italian, vrarë më 20 tetor 1943
7. Demir Gashi-vrarë më 1944

III. Të plagosur të çetës:

1. Asllan Zeneli-mësues nga Tërnova, plagosur më 20 tetor 1943
2. Esat Cami-bujk nga Viçishti, plagosur më 20 tetor 1943
3. Hider Manjani-mësues nga Homëzhi, plagosur më 20 tetor 1943
4. Bajram Toçi-bujk nga Kovashica, plagosur më 20 tetor 1943

DIBRA DHE DIBRANËT NË PANTEONIN E VLERAVE

5.Ibrahim Lumi-bujk nga Luznia- plagosur më 20 tetor 1943

6.Prokop Murra-nga Tirana, plagosur në korrik 1943

7.Mehmet Hajrullai-nga Brezhdani, plagosur në luftimet e Brigadës së XVIII në Kukës.

IV.Të vdekur për shkak të torturave në burg dhe 1-2-3 vjet me pas:

1.Dilaver Cami

2.Shahin Cami

3.Abdulla Cami

RRUGA “EMIN CIBAKU” – PËRJETËSIMI I DËSHMORIT TË RËNË NË BETEJEN E KOLESJANIT

- Hakmarrja serbe një vit pas humbjes së madhe në betejën e Kolesjanit! Masakrat e tmerrshme në Dibër, u vranë gra, fëmijë dhe pleq

Vlerësimi i heronjve dhe dëshmorëve të atdheut, përveçse akt juridik dhe politik, është detyrimi ynë moral, si dhe i çdo gjenerate shqiptare, ndaj historisë dhe së ardhmes të kombit tonë.



Beteja e Kolesianit

Nderimi për luftëtarët që sakrifkuan dhe flijuan jetën për lirinë e Shqipërisë është shprehja më e drejtpërdrejtë e atdhedashurisë që duhet të mbartë çdo shqiptar, pavarësisht bindjeve politike.

Parë nga ky këndvështrim, përjetësimi i emrit të dëshmorit të atdheut Emin Cibaku (me një vendim unanim të këshillit të Bashkisë Dibër) duke i vendosur emrin e tij segmentit rrugor nga kryqëzimi i rrugës Peshkopi – Kukës deri në qendër të fshatit Sohodoll, është ndër vendimet më të

vlerësuar nga komuniteti dibran e më gjerë. Kjo për faktin se vlerësimi i gjakut të derdhur për Shqipërinë është borxhi, që kemi të gjithë ne që gëzojmë lirinë ndaj sakrificës së tyre sublime.

HISTORIA

Dëshmori i atdheut Emin Habedin Cibaku ka lindur në Sohodoll të Dibrës rreth vitit 1856. Ishte i martuar me Sibe Veselin nga Cetushi, dhe kishin tre fëmije: Habedini, Qamili dhe Shiretja (Vraniçi). Jetonin së bashku me vëllain e tij më të madh, Abdullahin. Familja e tyre janë marrë me bujqësi e blegtori.

Në vitet kur Perandoria Osmane po jetonte fundin e saj, vendet fqinje shtuan përpjekjet për aneksimin e trojeve shqiptare: serbët e malazezet në Veri dhe grekët në Jug. Duke konkretizuar orekset e tyre shoviniste, deri në fillim të nëntorit 1912, serbët kishin pushtuar Prizrenin, Gjakovën e Hasin, dhe po përgatiteshin me forca të shumta për të sulmuar Lumën e Dibrën, dhe pastaj t'i drejtoheshin Durrësit.


Ndërkohë, në anën tjetër, forcat atdhetare po mobilizonin vullnetare në Dibër e Lumë, për të mbrojtur trojet amtare. Edhe nga Sohodolli dolën dhjetëra vullnetarë që rrokën armët për t'i dalë zot atdheut.

“Të shkoni e të vini shëndosh”- i uruan bashkëfshatarët që kishin dalë për të përcjellë luftëtarët. “Në qoftë se e çojmë serbin në Beograd, kthehem në Sohodoll, në të kundërt jo, se nuk e duroj serbin ndër gra e fëmijë”,- iu përgjigj Emin Cibaku.

Sipas historianëve, rreth 3 mijë luftëtarë lumjanë dhe 1 mijë dibranë, ishin vendosur në mbrojtje në Qafën e Kolesjanit përballë mbi 20 mijë ushtarëve serb.

“Ishim vendosur në vijën e parë të mbrojtjes me Eminin, Brahim Përgjegjin e Beqir Bushin”-tregonte Dalip Tafa pas kthimit në Sohodoll.

“Lufta filloi e ashpër, plumba e predha, të vrrarë e të plagosur nga të dy anët. Erdhi urdhri për një tërheqje, për të zënë pozicione të reja luftimi.



Tërhiquni ju, – thotë Emini, unë po vazhdoj të hap zjarr që t’ju mbroj gjatë tërheqjes. Por, sapo ishim larguar pak, Emini goditet në gjoks nga një plumb armik. Kthehem menjëherë, dhe me disa bashkëlufëtare, marrim trupin e pajetë të tij, dhe ia dërgojmë imamit të fshatit për ta varrosur, sepse ne u kthyem menjëherë në frontin e luftës” – ka treguar Dalipi për rënien e Eminit në luftën e Kolesjanit.

Siç shkruan akademik Fatos Daci – “Mjeshtër i Madh”: “Forcat shqiptare, dibrane e lumjane korrën një fitore të shkëlqyer, duke asgjësuar plotësisht ushtrinë serbe, e cila la në fushën e betejës plot 12.000 të vrarë. Kjo betejë, unikale për nga përmasat, heroizmi dhe të vrarët që një Termopile shqiptare dhe një Vaterlo për serbët”.

HAKMARRJA

Një vit më vonë, në tetor 1913, barbarët serbë kryen masakra të tmerrshme mbi popullsinë civile në Dibër, duke djegur e plaçkitur, duke vrarë e prerë gra, fëmijë e pleq. Në Sohodoll vranë edhe vëllain e Eminit, Abdulla Cibaku, si dhe plaçkitën bagëtitë dhe dogjën shtëpitë e tyre.

Për këtë, mjafton t’i referohemi albanologut të mirënjohur Robert Elsie, i cili në artikullin “Masakrat serbe në Dibër, 1913”, botuar në gazetën e përditshme Corriere delle Puglie, Bari, XXVI, 354, e 21 dhjetorit 1913. (nga anglishtja Gëzim Aliu) (botuar edhe në: Albanica Ekskluzive: revistë mujore për dije e kulturë, Prishtinë, 73-74, tetor/ nëntor 2007, f. 17-), ndër të tjera shkruan se: “.....Në Sohodoll, i dogjën tri shtëpi dhe i masakruan katër burra: Abdullah Abedinin, Tusun Dalipin, Sulejman Bahtiarin dhe Dalip Ismajlin, si dhe një grua me emrin Belure dhe të birin e saj gjashtëvjeçar me emrin Mazllum (Methasani). Po ashtu, i vodhën edhe 200 dele e 30 kuaj....”

Për kontributin e tij ndaj atdheut, Emin Cibaku është vlerësuar nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit Dibër, i cili me vendimin nr. 72 datë 23.5.1978 e shpall: “Dëshmor i atdheut”.

Këshilli i Komunës Kastriot, me vendimin nr. 28 datë 15.11.2012 e shpall: “Nderi i komunës”. Këshilli Bashkiak Dibër, me vendimin nr. 11, datë 31.01.2024 vendosi që, segmenti rrugor nga kryqëzimi i rrugës Peshkopi – Kukës deri në qendër të fshatit Sohodoll, të emërtohet: Rruga “Emin Cibaku”, duke përjetësuar kështu emrin e tij.

IDENTITETI

Vlerësime të tilla si ai i Këshillit të Bashkisë Dibër për dëshmorin e atdheut Emin Cibaku është në radhë të parë nderimi dhe respekti ndaj vetë identitetit kombëtar, ndaj integritetit si shqiptarë dhe dinjitetit tonë njerëzor.

Rivlerësimi i heronjve dhe atdhetarëve në këndvështrimin europian të një shoqërie demokratike i lartëson dhe përjetëson aktet e tyre në realitetet e reja aktuale dhe të perspektivës së kombit. Ai është një refleks i përmbajtjes dinamike të vetë historisë së një kombi.

Vlerësimi dhe rivlerësimi i kontributit dhe akteve historike të Heronjve, Dëshmorëve apo Atdhetarëve të shquar, përherë është lidhur dhe duhet të lidhet me interesin mbarëkombëtar dhe jashtë këndvështrimit politik aktual apo të kohës në të cilën janë kryer këto akte. Në këtë kontekst duhet vlerësuar edhe Beteja e Kolesjanit e nëntorit 1912 (e njohur si prelud i pavarësisë), kur rreth 4000 lumjanë e dibranë, të armatosur ishin pozicionuar në formë patkoi, duke harkuar mbi pozicionet serbe, poshtë Qafës së Kolesjanit, nga lindja e perëndimi.

Beteja e Kolesjanit, gjatë së cilës ra dëshmor edhe trimi Emin Cibaku nga Sohodolli, meriton vëmendjen e duhur nga historiografia jonë kombëtare, pasi ajo pengoi drejtpërdrejt forcat e Armatës së Tretë serbe, duke i gjakosur, rraskapitur e vonuar në realizimin e qëllimit serb, për të dalë në Adriatik e për të bërë fakt të kryer pushtimin e Shqipërisë para Shpalljes së Pavarësisë sonë Kombëtare.

HARUN DOMI – HISTORIA E PATRIOTIT QË SOLLI ABETAREN E PARË NË KALIS E KALA TË DODËS



- Nga Stambolli në Bukuresht, historia e mësuesit Harun Domi që solli në Kalis abetaren e parë nga Rumania! 101 djem e vajza të familjes me arsim të lartë
- Atdhetarë të shquar si Harun Domi, mbetën pishtarë të dritës në altarin e lirisë së kombit. Kjo për faktin se ai solli në një krahinë si Luma emërndritur abetaret e Veqilharxhit, të cilat u përhapën dorë më dorë dhe u bënë pishtarë drite për shqiptarët dhe halë në sy për pushtuesit
- Dhe nëse gjyshi Haruni para 100 vitesh solli abetaret nga Bukureshti për shkollën shqipe të Kalisit, në gjurmët e tij edhe nipi, Tajar Domi ka dhënë dhe po jep kontribut real për shkollimin në gjuhën shqipe të fëmijëve të emigrantëve shqiptarë në Filadelfia-SHBA. Si kryetar i Shoqatës “Bijtë e Shqipes”, për katër vite e më pas si anëtar i Kryesisë të kësaj shoqate, ka dhënë dhe jep kontribut real në mirëfunksionimin e zgjerimin e Shkollës Shqipe “Gjuha Jonë”, e cila prej rreth 20 vitesh po funksionon derë-hapur për trashëgiminë e gjuhës, kulturës e historisë tonë kombëtare, në komunitetin shqiptar të Filadelfias.

Njëqint vjet më parë, mësuesi atdhetar Harun Jakup Domi nga Cereni i Kalasë së Dodës, pasi kishte mërguar për dhjetë vjet në Rumani, solli që atje 50 abetare, të cilat do të shpërndanin rreze drite nga shkolla e parë shqipe e Kalisit të Kukësit. Ajet Mata, ish-mësues e drejtor i kësaj shkolle pohon se: *“Në historikun e shkollës Kalis, shkruhet se mësuesi Harun Jakup Domi dhe abetarja që solli, u bënë dy binjakë që mbajtën gjallë në ato vite të vështira shkollën shqipe në Kalis. Nga të gjitha trevat për rreth ka një të veçantë e cila qëndron në faktin se Harun Jakupi, jo vetëm solli abetaret nga Bukureshti, por edhe punoi aty si mësues duke përhapur dritën e diturisë. Kalisi e ka për nder kur i trokasin në fshat intelektualë si Haruni, emri i të cilit nderon krahinën ndaj nuk harrohet kurrë”*.

Po, emri i Harun Domit qëndron në pedestalin e vlerave tona kombëtare, pasi ai i përket asaj plejade të burrave të shquar të kombit që bënë histori në fushën e përhapjes së asimit. Ndaj dhe Ahmet Keça, ish-mësues e drejtor shkolle në Kalis, do të shkruante para 21 vitesh në një nga gazetatat e kohës se: *“Rreze drite ishin në Kalis abetaret që solli mësuesi atdhetar Harun Jakupi nga Cereni, në vitin 1923 kur erdhi nga mërgimi i tij 10 vjeçar në Rumani”*. Po ashtu edhe Enver Parllaku, ish mësues e drejtor në disa shkolla të Kukësit shpreh respekt të veçantë për kolosë të gjuhës shqipe si Harun Domi që bënë gjithshka për të dërguar abetaren tonë edhe në skajet më të largëta të Shqipërisë. Ndërsa shpreh respekt për familjen Domi, e cila përcjell e trashëgon kudo vlerat tona më të mira kombëtare, Enver Parllaku – nip i heroit të Popullit e Nderit të Kombit Rrahman Parllaku, shprehet me krenari se: *“Mësuesit, historia i vesh me pavdekësi, prandaj edhe mësuesi Harun Domi, lartësohet edhe në këngën e ikonës dibrane Liri Rasha:*

‘Abetarja e Naumit/ fshih në gjirin e Harunit/Ndezi dritën e Europës/ Deri në Kala të Dodës....’

Po, atdhetarë të shquar si Harun Domi, mbetën pishtarë të dritës në altarin e lirisë së kombit. Kjo për faktin se ai solli në një krahinë si Luma emërndritur abetaret e Veqilharxhit, të cilat u përhapën dorë më dorë dhe u bënë *pishtarë drite për shqiptarët dhe halë në sy për pushtuesit*.

Harun Domi lindi më 1888 në një familje atdhetare, në fshatin Ceren – Kala e Dodës, krahinë e cila deri në vitin 1952 ishte pjesë përbërëse e Lumës, ndërsa pas këtij viti administrativisht u kalua me Dibrën. Pasi mësoi

në mejtepin e Cerenit deri në nivelin e rruzhdijes dhe përjetoi pasojat e luftës ballakanike në shkatërrimin e ekonomisë, ashtu si një pjesë e madhe e blegtorëve të Kalasë së Dodës në Selanik, ndërmoi rrugën e mërgimit, fillimisht në Stamboll për pak kohë e pastaj në Bukuresht të Rumanisë. Këtu ai ra në kontakt dhe u aktivizua energjikisht me grupin shqiptar të Bukureshtit që ishte ndër në aktivët për çeshtjen kombëtare shqiptare, të organizuar në Shoqërinë “Drita” që në vitin 1884, kur sekretar i saj për disa vite ishte atdhetari Mihal Grameno.

Pas ardhjes nga mërgimi 10-vjeçar në Rumani, Harun Jakupi solli me vete, jo vetëm 50 abetaret për shkollën shqipe të Kalisit, por edhe kulturën e zhvillimit të arsimit. Për këtë qëllim madhor ai bashkëpunoi ngushtë me personalitete të shquara të Lumës, si Hoxhë Mehmeti i Shtiqnit, Sheh Jahja i Fshatit e të tjerë patriotë lumjanë.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1924, që u organizuan me përfaqësues nga çdo zonë në Bicaj të Lumës, Haruni ishte i zgjedhuri i dytë për krahinën e Kalasë së Dodës. Këto fakte i pohon edhe Prof.dr.Shefqet Hoxha, autor i disa studimeve historike e veprave madhore për krahinën e Lumës.

Harun Jakupi dhe breza të tërë të fisit Domi u rritën, u edukuan dhe arsimuan me frymën e atdhedashurisë dhe të patriotizmit, me idealet e gjakut për liri e pavarësi kombëtare. Ata ndjejnë krenari të ligjshme që i përkasin një krahine lavdiplote si Kalaja e Dodës, bijtë e së cilës, siç shkruan Ismet Kutelaj (mësues nga Dukati i Vlorës që punoi për 6 vite në Kala): *“Janë trima e patriotë, janë të kurbetit e të sakrificës, janë një popull shumë mikpritës..., janë të besës e të fjalës së kuvendit...”*.

“Të tjerë botues të Lumës, si Prof.dr.Shefqet Hoxha, studjuesi, publicisti dhe shkrimtari i mirënjohur Fatos Daci – Mjeshtër i Madh, Prof. dr. Fejzulla Gjabri, Mësuesi i Merituar Isa Halili, mësuesi e hulumtuesi cerenas Metush Skeja, Xhavit Lashi, si dhe Hasan Domi e Ismet Brika, në librat e tyre kanë plotësuar dukshëm njohjen më të mirë, jo vetëm të historisë në përgjithësi, por edhe të figurave e personaliteteve të veçanta të kësaj zone, me rolin e luajtur në kohë të ndryshme”, pohon Tajar Domi, nip i patriotit dhe mësuesit Harun Domi.

Studjuesi Beqir Shehu, ish-shef i Seksionit të Arsimit dhe Kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit Dibër për disa vite shkruan se: *“Në vend të emërtimit ‘krahinë’për fshatrat e Kalasë së Dodës, por dhe për territore*

të ngjashme të popullura si madhësi, para themelimit të shtetit shqiptar me institucionet përkatëse, është përdorur edhe emërtimi i mirëfilltë shqiptar 'dhéu'. Banorët e këtyre zonave thirreshin "Dhëtar", siç janë të njohura shprehjet: 'Burrat e dhéut', 'Janë mbledhë burrat e dhéut'(që ndodhte kur duheshin marrë vendime të rëndësishme), etj, heroizmi i të cilëve është përjetësuar edhe në vargjet e këngës: "Djemtë e Lumës hiq s'kanë dert/ Kah një luft e bajn përvjet/ Luft me krajl e luft me mbret...". Dhe njëri nga këta 'Burrat e dhéut' është padyshim edhe Harun Domi i Cerenit që ka hyrë dhe qëndron i dinjitetshëm në historinë e kombit shqiptar.

Në të njejtën linjë, edhe Prof.dr.Hajri Shehu shkruan se: "Kalaja e Dodës ka kufinj natyrorë e historik Veleshicën e Ujin e Lapave. Dhéu i saj është një dhé me kroje e kopshte, me ara e me livadhe, me kullota e me bjeshkë, me ujë e ujëvara, me nëntokë të pasur, me shtëpi të pastra e sofrë bujare... Krahina e Kalasë së Dodës është me një të folme melodioze e me një folklore magjepsës". Më të spikatura këto virtyte në fshatin Ceren të kësaj krahine e sidomos në fisin e madh Domi të këtij fshati, për të cilin siç e thotë kënga popullore: "Fisi DOMI gjithmonë me penë/ U ka mësuar brezave shqipen/ Histori të shkruar ka lënë/ Si për luftën dhe për dritën...".

Ndërsa kur bëhet fjalë për kulturën e jetesës, gazetari Llazar Vero-Kryetar Nderi i Shoqatës "Bijtë e Shqipës", Filadelfia, shkruan se: "Kam shkruar në të gjitha krahinat e Shqipërisë si gazetar, por vetëm dy herë kam fjetur si mbret: Një natë në Voskopoje dhe herën tjetër në Kala të Dodës, ku dhoma e gjumit ishte e veçantë, e shtruar me qilim e sixhade dhe ku krevati (shtrati) shkëlqente me bardhësinë e çarçafëve e jorganin prej atlas". Dhe padyshim, më mirë se kudo, këto do t'i gjeje në shtëpitë e dinastisë Domi, ndër më të njohurat për nivelin arsimor e kulturor në zonën e Kalasë së Dodës.

Proverbi popullor "Bëmë baba, të të ngjaj" jetëzohet më mirë se kudo tjetër në trungun familjar të Harun Jakup Domit. Ndaj nuk është rastësi që nga kjo familje e madhe numërohen 101 djem e vajza me arsim të lartë, mes tyre: 21 arsimtarë e pedagogë, 11 inxhinierë/ mekanikë/ elektrikë/ kompjuterikë, etj, 7 mjekë/ stomatologë, 2 diplomatë/shkenca politike/ 2 juristë, 16 ekonomistë/financier, 13 persona në fushat biznes/menaxhim, 5 me gjuhë të huaja, një i diplomuar në psikologji, një arkitekt etj..., një armatë e tërë të shpërndarë në gjithë vendin dhe në diasporë, të orientuar

në atë çfarë i pari i këtij trangu, Harun Jakup Domi bëri kryesisht me gjuhën e shkollën shqipe. Ai ishte themeli nga ku mori rrugë shkollimi i familjes deri në ditët e sotme.

Po ashtu, dy djemtë e Harunit, Shefqeti e Xhemali (që nuk jetojnë) shtruan më tej shinat e shkollimit, të ndihmuar nga babai i tyre e duke ndjekur rrugën e tij.

Dr. Shefqet Domi, emrin e të cilit mban laboratorin e spitalit të Peshkopisë, ishte dhe mbetet një nga përfaqësuesit më në zë të elitës dibrane. Ndaj dhe thuhet për të se jetoi një jetë si njeri e punoi dy jetë si mjek, pasi kontribuoi e shërbeu me devotshmëri e përkushtim maksimal ndaj pacientëve që nga Tropoja, Kukësi e Dibra, dhe pas viteve ’90 në Tiranë, në mbrojtje të jetës e në shërbim të njerëzve. Ai la të botuara dy vepra me vlera të mëdha për vendlindjen: “Cereni – Histori e Tradita” dhe “Kalaja e Dodës – Ose Qafa e Bilbilit”.

Një personalitet tjetër i kësaj dinastie është **mësuesi e historiani Xhemal Domi**. Kontributi i tij është evident në sektorin e arsimit, si mësues e drejtor i disa shkollave. Kryetari i Shoqatës “Korabi” Hasan Domi dhe sekretari i kësaj shoqate Dr. Petrit Gjorgji, në një përshtkrim të profilit të tij, ndër të tjera shkruajnë: Nga viti 1973 e deri më 1980” Xhemal Domi ka qenë drejtor i shkollës 8-vjeçare Radomirë, ndërsa kontribuoi fuqishëm për hapjen e shkollës së mesme Ceren-Kala e Dodës, të cilën e drejtoi në vitin e parë të saj më 1982. Kudo që punoi e drejtoi është dalluar për punë vetmohuese dhe arritje të larta në procesin mësimor-edukativ. Doli në pension në vitin 1993. Veçanërisht si historian, ai ishte evidentues dhe promovues i denjë i fakteve e vlerave arsimdashëse të Lumës. Për to ai shkroi e botoi disa artikuj si dhe studimin në tre vëllime librash voluminozë me titullin sinjifikativ ‘Dibra në hulli të historisë’.

Si anëtar e më pas zëvendëskryetar i Shoqatës “LUMA”, Xhemal Domi dha kontributin e tij të gjithanshëm në pasqyrimin objektiv të ngjarjeve historike e luftrave të burrave të Lumës kundër pushtuesve serbë, por edhe të zhvillimit e përparimit jetësor të kësaj zone, e cila shquhet për besë, burrëri, drejtësi, heroizëm e pjesmarrje në drejtimin e vendit.

Për këto arritje ai është vlerësuar me Çetifikatën “Mësues i dalluar” dhe me Medaljen e Urdhrin “Naim Frashëri” nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Po ashtu dhe me titullin “Personalitet i Qarkut Dibër”, akorduar

nga Këshilli i këtij Qarku.

Me nderim të veçantë kujtojnë cerenasit dhe gjithë krahina e Lumës edhe Harun Domin, djalin e parë të mësuesit atdhetar Harun Domi. Ai ishte një burrë i zgjuar, i matur, i urtë, i drejtë e me shpirt human, prandaj edhe nderohej e respektohej në gjithë krahinën. Bashkëkohësit e mbajnë mend dhe e kanë ngulitur në memorien e tyre si ish-brigadierin, ekonomistin e financierin shembullor që konkurronte në vlera me më të arsimuarit.

Në gjurmët e sipas përvojës së vyer të Jakupit do të ecnin e bënin emër ndër vite edhe pasardhësit e tij, si: Ing.Naim Sh.Domi – doktor i shkencave; Dr.Nuri Sh.Domi – fiziknat&diplomat, aktualisht ambasador i RSH në Katar; Përparim Sh.Domi – ekonomist&biznesmen; Jakup H.Domi – financier&biznesmen; Mizosa H.Domi – mësuese; Resul M.Domi – mjek; Mahmudije M.Domi – financiere; Bashkim Xh.Domi -inxhinier; Defrim Xh.Domi – mësues; Lavdrim Xh.Domi – inxhinier, Maslime Xh.Domi – financiere; Diana Xh.Domi – avokate, si dhe dhjetra të tjerë nipër e mbesa të Harunit, që si intelektualë të mirëfilltë ia rrisin emrin dhe lavdinë familjes dhe fisit të tyre.

NJË EMËR PËRBASHKUES, NDËR VEPRIMTARËT MË AKTIVË TË SHOQATËS “BIJTË E SHQIPES, NË FILADELFIA

Gjatë një takimi verën e kaluar, miku im Enver Parllaku do më fliste me krenari të ligjshme për Shoqatën “Bijtë e Shqipes” që prej vitesh zhvillon një aktivitet intensiv në Filadelfia për promovimin e vlerave kombëtare shqiptare. Dhe ndër veprimtarët më aktivë të kësaj shoqate ai do të veçonte Tajar Domin, si kontributorin shembullor të saj. Këtë të vërtetë e pohon edhe shkrimtari kukësi Hys Hasa, i cili vlerëson potencialin intelektual, urtësinë, mençurinë e vizionin bashkohor të Tajar Domit, të shpalosura në përditshmërinë e tij si dhe në çdo aktivitet të Shoqatës “Bujtë e Shqipes”.

Tajar Harun Domi do të udhëhiqte brezin e tretë të intelektualëve të këtij trugu. Nga një dokumentar i mirëpërgatitur prej ikononës së dokumentarit televiziv Defrim Methasani, mësojmë se Tajari ka lindur më 14 tetor të vitit 1956 në Ceren të Kalasë së Dodës dhe ka shkëlqyer në të gjitha nivelet e shkollimit. Studimet e larta i mbaroi në Fakultetin e Veterenarisë të Universitetit Bujqësor të Tiranës në vitin 1980. Pas diplomimit punoi fillimisht në ish-kooperativën bujqësore dhe më pas, tre vite si mësues në

Shkollën e Mesme Bujqësore të Cerenit. Në vitin 1991 zgjidhet Kryetar i Këshillit të Bashkuar Pluralist të Kalasë së Dodës dhe deri në vitin 1996 ishte zëvendëskryetar komune. Pas vitit 1997 vjen në Tiranë, dhe në harkun kohor të 7 viteve (1998-2005) punoi në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, ku la gjurmët e intelektualit shembullor, të profesionistit të spikatur e kuadrit korrekt. Në moshën 52-vjeçare (në vitin 2008) ishte përfitues i llotarisë amerikane dhe sëbashku me bashkëshorten Elhamen dhe dy djemtë Erionin dhe Arianitin jetojnë në Filadelfia të SHBA, ku kanë ndërtuar jetën e tyre të dytë. Gjithsesi, që nga dita që shkeli në tokën e premtuar, tik-taku i tij rrihte për atdheun, ndaj dhe u atashua në Shoqatën me emër partiotik e atdhetar “Bijtë e Shqipes”, kryetar i së cilës ishte për dy mandate. Pikërisht nga kjo shoqatë është vlerësuar si nderi i komunitetit për atë çfarë ai ka përfaqësuar me emrin e tij të spikatur, sepse Tajar Domi është një emër përbashkues i diasporës shqiptare në SHBA. Po, i tillë është ky pinjoll i fisit e familjes që qëndon me dinjitet në panteonin e vlerave. Nëse gjyshi i tij, Haruni para 100 vitesh solli abetaret nga Bukureshti për shkollën shqipe të Kalisit, Tajari, në gjurmët e gjyshit ka dhënë dhe po jep kontribut real për shkollimin në gjuhën shqipe të fëmijëve të emigrantëve shqiptarë në Filadelfia-SHBA. Tajar Domi prej 13 vitesh punon mësues në shkollat publike në Filadelfia (Substitute Teacher in School District of Philadelphia) ... Si kryetar i Shoqatës “Bijtë e Shqipes”, për katër vite e më pas si anëtar i Kryesisë të kësaj shoqate, ka dhënë dhe jep kontribut real në mirëfunksionimin e zgjerimin e Shkollës Shqipe “Gjuha Jonë”, e cila prej rreth 20 vitesh po funksionon derë-hapur për trashëgiminë e gjuhës, kulturës e historisë tonë kombëtare, në komunitetin shqiptar të Filadelfias.

Prej 8 vitesh ai mban me krenari e dinjitet titullin “Ambasador për Paqen”, ndërsa është vlerësuar me Mirënjohje nga Këshilli i Qarkut Kukës.

TRE PERSONALITETE TË FAMILJES DOMI “NDERI” I QARQEVE KUKËS E DIBËR

Në një ceremoni mbresëlënëse në sallën e Federatës së Paqes Universale në Tiranë, mbi 200 pjesmarrës, mes të cilëve drejtues dhe ish drejtues të qarqeve Dibër dhe Kukës, përjetuan emocionet e takimit dedikuar familjes së madhe Domi. Ky event u organizua dhe moderua më së miri nga moderatori i shumëtalentuar Defrim Methasani, me rastin e dekorimit të

tre prej tyre: Harun Domi, atdhetar dhe patriot, Xhemal Domi, ish mësues, drejtues në arsim dhe botues i historisë së arsimit në Dibër, dhe Tajar Domi, ish kryetar dhe aktualisht kryetar nderi i Shoqatës “Bijtë e Shqipes” në Filadelfia të SHBA. Të tre u vlerësuan me titullin “Personalitet i Qarkut”: Harun Domi nga kryetari i Qarkut Kukës Abdulla Domi, ndërsa Xhemal Domi dhe Tajar Domi u vlerësuan nga Prefekti i Dibrës Nexhmedin Shehu dhe ish – kryetarja e Këshillit të Qarkut Valentina Haliti Doda.

Për vlerat e patriotit dhe atdhetarit Harun Domi foli historiani Isa Halili, vlerat e prof. Xhemal Domit i evidentoi ish-Shefi i Arsimit Dibër Beqir Shehu, ndërsa për kontributin e vyer të Tajar Domit foli Bujar Gjoka, ish-kryetar i Shoqatës “Bijtë e Shqipes” që kishte ardhur nga Filadelfia.


Madhështinë këtij takimi brezash ia shtuan artistët: Margarita Xhepa – Nderi i Kombit, ikona e këngës qytetare Liri Rasha, dekoruar nga Presidenti i Republikës me Titujt “Mjeshtër i Madh” dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”, Nexhip Dida, Dritan Jashari dhe bilbili i Kalasë së Dodës Myfëtrim Kupa.

Emocionuese për të pranishmit qe përshëndetja e motrës Lije Krasniqi (Domi) dhe e mbesave të Harun Domit që kishin ardhur nga Prizreni.

Ky event qe dëshmi e faktit se vlerat e vërteta të personaliteteve i dokumenton vetë historia dhe se shkrimtarët, historianët, studiuesit e gazetarët duhet të ndalen në ngjarje, resurse e personalitete të paeksploruara të historisë, siç janë ata të dinastisë Domi të Cerenit të Kalsë së Dodës, të evidentojnë e promovojnë vlerat burimore që i shërbejnë forcimit të dinjitetit dhe ardhmërisë së kombit.

EDIP DACI – HISTORIA E USHTARAKUT QË REFUZOI TË BËNTE BETIMIN FASHIST NË ROMË, U ARRESTUA PAS NGJARJES NË AMBASADËN RUSE NË TIRANË

- Ndër 400 studentët shqiptarë që kishin studiuar në Akademinë Militare në Modena të Italisë dhe që refuzuan të bëjnë betimin fashist në Romë 85 vjet më parë, ishte edhe Edip Daci, akademisti që nuk iu nënshtroi as fashizmit, as komunizmit. Kalvarin e tmerrshëm dhe qëndresën ndaj pushtuesit, si dhe në burgjet e diktaturës të këtij pinjulli të një familjeje me tradita të forta patriotike të Dibrës së Madhe, e ka rrëfyer mjeshtërisht në një dokumentar televiziv, si dhe në librin e saj “Jetë mes dallgësh”, e bija e tij Ida Daci Abdiu.



Dokumentari si dhe monografia që u promovuan të martën, më 17 shtator 2024, në amfiteatrin e Dibrës së Madhe, prezantojnë në detaje jetën dhe veprimtarinë patriotike të Edip Dacit. Ai nuk e kishte njohur babain e tij, Muratin, që si shumë burra të tjerë të kullës së Dacit, e kishte kaluar jetën duke luftuar ndaj shovinistëve serbë. Murati ishte vranë herët duke lënë jetimë 3 djemtë e tij të vegjël, mes tyre edhe Edipin, të cilët do të rriteshin

me ndjenja të larta atdhedashurie e do të ecnin në hapat e babait të tyre martir. E ëma e tij, Fiqirie Daci (Hajdaraga), mbesë e Iljaz pashë Dibrës, edhe pse kishte mbetur vetëm pa të shoqin që në moshën 28-vjeçare, ua kishte kushtuar jetën tre djemve të saj, të cilët do të shkolloheshin e do të hynin me dinjitet në analet e historisë së Shqipërisë, ndër intelektualët më të spikatur shqiptarë të mesit të viteve 1900.

REFUZIMI PËR TË BËRË BETIMIN FASHIST

“Ishte pragu i Luftës së Dytë Botërore. Shqipëria befas do të pushtohej nga Italia fashiste në prillin e vitit 1939. Pikërisht në atë kohë, në Modena, Edip Daci dhe gjithë akademistët e tjerë shqiptarë si ai ishin revoltuar nga akti i pushtimit të vendit të tyre. Të gjithë studentët shqiptarë, pothuajse pa përjashtim, por veçanërisht ata tek akademia që studionte im atë, e pritën me indinjatë dhe me tmerr pushtimin fashist. Nuk dinin se si të shprehnin revoltën në kohën kur autoritetet italiane i morën të 400 studentë dhe nxënës shqiptarë, i çuan në një ambient shumë komod për të bërë betimin fashist në mes të Romës. U bënë prova mbi 2 javë. I çuan nëpër koncerte, nëpër hotele, nëpër veprimtari që t’u mbushnin mendjen dhe kështu betimi i tyre do të përforconte atë akt të turpshëm të autoriteteve shqiptare, që shkuan dhe zbritën në Bari dhe iu drejtuan Romës me kurorën e Skënderbeut, për t’ia dhuruar Viktor Emanuelit dhe do të përlligjte pushtimin fashist. Dhe Shqipëria të bëhej si një pjesë e Italisë.

400 studentët, aty në atë kuadrat edhe im atë, duke qarë, tepër të indinjuar, në 2 javë që iu bënë prova, nuk pipëtinë dhe në momentin kur të gjitha autoritetet italiane ishin rreshtuar në podium dhe admirali do të përmendte betimin italian, e këta do të thoshin: ‘betohem’, në 400 studentët nuk pipëtiu askush. Asnjëri nuk miratoi dhe nuk u betua nën flamurin italian. Admirali që drejtonte betimin iu kthye autoriteteve dhe tha: ‘Këta janë shqiptarë dhe nuk e kanë kuptuar mirë, po e përsëris edhe njëherë’. Dhe ndërsa ai kishte nxjerrë shpatën e po përsëriste më me forcë betimin nën flamurin italian, përsëri, asnjëri nga 400 studentët, nuk pipëtiu. Autoritetet italiane u munduan të sfumonin këtë akt heroik të studentëve dhe nxënësve shqiptarë dhe menjëherë futën diçka tjetër për të mos rënë në sy ky skandal që u ndodhi. Një grup të mirë nga studentët, si Skënder Çaçi e shumë e shumë të tjerë i burgosën, ndërsa këta të tjerët, një pjesë

i përjashtuan nga akademia dhe një pjesë i lanë për të mos bërë bujë dhe të mos e popullarizonin këtë akt heroik të studentëve shqiptarë. Një ndër këta studentë, ishte edhe im atë”, – rrëfen ndër të tjera Ida Daci Abdiu, në dokumentarin televiziv “Jetë mes dallgësh”.

Nga ky dokumentar, si dhe nga libri i saj me të njëjtin titull, mësojmë se pas diplomimit në Akademinë Ushtarake në Modena, Edip Dacit i ofrohen disa punësi, ndër të cilat mund ta vijonte karrierën e tij ushtarake. E caktojnë fillimisht të inkuadrohej si ushtarak në Abisini, por Edip Daci refuzoi, duke thënë se ai ishte shkolluar për t’i shërbyer vendit të tij.

DEZERTIMI NGA LUFTA ITALO-GREKE

“Ne i kemi dhënë fjalën dhe jemi betuar që pas mbarimit të shkollës, do t’i shërbejmë atdheut tonë, që sot kur atdheu ynë është i pushtuar nga fashistët, më shumë se kurrë ka nevojë për dijet tona”, – mendoi Edip Daci dhe u kthye në atdhe. Në këtë kohë, krahas pushtimit, ekzistonin disa batalione të ushtrisë shqiptare. Edip Dacin e caktuan në një nga këto batalione. Përsëri pushtuesit italianë donin t’i përdornin mish për top oficerët e shkolluar jashtë dhe të parët që i vunë në frontin e parë, në luftën italo-greke, ishin batalionet shqiptare të kryesuara nga Spiro Moisiu e nga shumë figura të njohura ushtarake, të cilët duke e parë që ata donin patjetër t’i shfrytëzonin këto figura të rëndësishme, jo vetëm që nuk morën pjesë, por sabotuan duke hequr gjilpërat e topave dhe të mitralozëve.

Ata dezertuan frontin grek dhe një pjesë iku në drejtim të Korçës e me radhë, ndërsa im atë me batalionin e tij u kthye nga Vlora dhe në Shqipërinë e Mesme, duke ecur në këmbë, të drobitur. Në Shqipërinë e Mesme i arrestojnë dhe i internojnë në kampin e Marikajt, ku e pa veten në listat e antifashistëve më të tërbuar që kishin përpiluar italianët. Pasi lirohet nga kampi i internimit, Edip Daci dhe shumë ushtarakë të tjerë të diplomuar jashtë si ai, dërgohen për pak kohë si pjesë e ushtrisë shqiptare në viset e Kosovës. Të gjithë ata besonin me zemër se Shqipëria etnike, ajo ëndërr e kahershme, do të bëhej realitet. Por fatet e vendit të tyre ishin shkruar më herët prej Fuqive të Mëdha e kjo rrugë nuk do të mund të ndryshonte.

Kjo u pa qartë në fund të luftës, kur pushtetin e morën komunistët dhe Kosova mbeti në Jugosllavi. Gjatë viteve të luftës, siç tregon Ida, babai i saj Edipi dhe xhaxhai Vehapi, edhe ai i diplomuar jashtë vendit, kishin mbajtur

të njëjtën qëndrim kundërshtues ndaj pushtuesve. Në atë atmosferë të viteve të luftës të dy vëllezërit ishin fejuar dhe kishin ndërtuar familjet e tyre, duke ëndërruar se lufta do të përfundonte e ata do t'i shërbenin atdheut.

ZHGËNJIMI NGA PABESIA E REGJIMIT KOMUNIST TË PASLUFTËS

“Pabesia e kohës bëri që i gjithë ky kontribut, e gjithë kjo luftë, i gjithë ky sinqeritet i madh t’u shkojë kot. I vëllai, i përqendruar me një batalion me ushtrinë shqiptare në Pogradec, bie ndesh me një skuadër partizane dhe i bën thirrje komandantit: ‘Jemi shqiptarë, mos gjuani, jemi batalion shqiptar, jemi ushtarë shqiptarë që luftojmë kundër fashizmit’! Por ishte e kotë dhe në momentin e fundit u tha ushtarëve që të iknin, të gjenin një front dhe u vetëflijuan vetëm e vetëm për të dhënë një imazh që nuk duhet të luftohet vëllai me vëlla.

Kjo qe disfata e parë që pësoi familja Daci. E ëma, pasi mori vesh këtë vdekje tragjike të djalit, e urdhëroi Edipin: ‘Nuk do ta veshësh më rrobën ushtarake, nuk ka ç’të duhet, sepse kjo punë po merr fund, shihe çfarë gjendje është’. Asokohe ai kishte kontribuar jashtë mase. Në Tiranë kishte një veprimtari me njësitet guerile sepse daja im, Petrit Strazimiri, nga bankat e shkollës shok me Qemal Stafën, lënë bankat e shkollës dhe kalojnë në ilegalitet në Tiranë, duke u ndihmuar edhe nga babai im, shumë. Dhe ai mbeti dëshmor për çlirimin e Kërçovës, ndërsa babi e hoqi rrobën ushtarake duke ia çuar në vend amanetin nënës së vet. U martua me nënën time nga një familje shumë e fisme, Strazimiri, vajza e një avokati që kishte mbaruar shkollën në Vjenë dhe kishte shërbyer në poste drejtuese të kohës”, – tregon Ida.

Nga rrëfimi i saj mësojmë se pasi kishte hequr rrobën ushtarake, duke parë situatën që po krijohej, pas martesës Edipi me familjen e tij banonin në një shtëpi të Hafëz Musait. Ai, duke parë inteligjencën dhe përgatitjen e këtij njeriu, ndërgegjegen tepër të lartë, e mori dhe i propozoi që ai të jepte teologji dhe frëngjisht në Medresenë e Tiranës. Fundi i luftës e gjen familjen e re të Edip Dacit në gjendje të vështirë. Të dy burrë e grua, Edipi dhe Remzia, kishin humbur nga një vëlla. Zia kishte pllakosur shtëpinë e tyre, por ditët e fundit të luftës lajmëronin edhe shumë sfida të tjera

që i prisnin. Filluan reprezaljet e vitit 1944, kur çetat partizane këdo që shikonin dhe që i kishte shërbyer qeverisë paraardhëse, me dhjetëra e mijëra intelektualë i pushkatuan. Në ato kushte, Hafëz Musai, kryemyftiu i republikës, duke parë gjendjen që u krijua në Tiranë, i thotë: ‘Edip, ti duhet të largohesh nga Tirana sa të stabilizohet një çikë gjendja. Nuk po marrim vesh se çfarë po bëhet’. Dhe vetë ai e ndihmoi që të ikte nga Tirana, duke marrë një shtëpi me qira në lagjen e Haverikëve në Durrës, ku filloi punë si financier në hotelin “Vollga”.

ARRESTIMI PAS NGJARJES NË AMBASADËN SOVJETIKE

Ishin vitet e trazuara 1948, 1949, 1950. I larguar nga Tirana dhe i zhytur në punën e tij, duke qëndruar larg prozhektorëve, Edipi kërkonte të ngrinte në këmbë familjen e tij të vogël. Ai ishte patriot dhe si i tillë e shihte familjen e tij të vogël si një potencial të madh për të mbrojtur atdheun e për të punuar për atdheun. Edhe pse regjimi po tregohej i ashpër me të, ai çdo ditë thurte ëndrra për familjen e tij, e cila do të shtohej në numër e fëmijët e tij do të edukoheshin e do të punonin për vendin e tyre, duke çuar në vend amanetin e të parëve. Por, a do të shkonte jeta sipas ëndrrave të tij? Ishte viti 1951. Shkurt. Në Tiranë do të shënohej një ngjarje që do të trondiste opinionin publik.

Një ngjarje e inskenuar te legata sovjetike do të çonte në pushkatim 21 intelektualë. Kjo ngjarje do të lajmëronte një fat të hidhur, edhe për Edipin dhe familjen e tij. Ida tregon se si një mesnatë, një grup policësh e shqyen derën dhe u hodhën brenda shtëpisë. Ata u ndodhën befas përballë tyre, duke e arrestuar Edip Dacin me akuzën absurde “armiku i partisë dhe i popullit”. “Ajo natë nuk do të harrohej kurrë në familjen e Edip Dacit. Ai arrestim do të bëhej shkak për një kalvar të gjatë dhimbjesh e torturash që do e ndiqnin në jetë. E marrin zvarrë tri burra dhe të tjerët vazhdonin të kontrollonin, të shqyenin, të merrnin ç’ka ndodhej në shtëpi. Në fund i erdhi radha bibliotekës të krijuar me aq mund dhe djersë. Të gjithë librat që kishte studiuar në akademi, me të cilët kishte krijuar një bibliotekë, i morën me thasë dhe me krahë. Në një komo që ndodhej në shtëpi, ishte fotografia e një ushtaraku, ish-student i akademisë militare në Modena të Italisë. Bashkëshortes së tij i afrohet një person nga ata policët dhe i thotë: Hë moj armike, moj borgjeze, edhe fotografinë e Ahmet Zogut e mbani ju

në shtëpi?!

Ajo duke u dridhur i thotë:

– Jo zotëri.

– Kujt i thua zotëri moj borgjeze. Unë jam punëtor i partisë!

– Është fotografia kur im shoq është diplomuar. Ka qenë student im shoq, çfarë Ahmet Zogu?!

Duke e thyer dhe duke e shkelur me këmbë kornizën, polici e mori me vete fotografinë, për të treguar se çfarë fotografie mbajnë këta në shtëpi. Mendoni çfarë gjendje u krijua. Të nesërmen u mor vesh që 23 intelektualë shqiptarë dhe 200 e ca burra, mos më tepër, ndër ta edhe im atë, përfunduan nëpër birucat e degëve të punëve të brendshme, pas Tiranës edhe rrethe të tjera si Durrësi, Elbasani, Korça etj..

NJËMBËDHJETË MUAJ HETUESI SPECIALE

“11 muaj hetuesi speciale, 11 muaj, nuk mundem të përmend se të gjithë kemi lexuar, tortura të jashtëzakonshme. Vetëm një refren i ditës ishte për tim atë, edhe i natës, edhe i mesnatës: unë jam Edip Daci, historia e familjes sonë. Ne për këtë atdhe kemi flijuar breza të tërë... dhe i përmendte të gjithë: Ramiz Dacin, që si oficer madhor merr pjesë në të gjithë lëvizjen demokratike krah Isuf Xhelilit, krah Iljaz pashë Qokut, Vehbi Dibrës etj., dhe pati fatin të jetë pjesëmarrës në Shpalljen e Pavarësisë, jo si delegat, por si i ftuar. Ai mori pjesë në Kongresin e Lushnjës, një ndër organizatorët dhe përçuesit e të gjitha ideve përparimtare të asaj treve dhe mbarëshqiptare... dhe paraardhësit tjerë të familjes Daci, që historikisht kishin treguar vlerat e saj patriotike, liridashëse dhe demokratike, duke u nisur nga stërgjyshërit tanë, duke i përmendur qysh nga Said Daci, i vjetër, shok, mik dhe bashkëluftëtar me Abdyl Frashërin; Xhem Daci, Shaqir Daci, si luftëtar i paepur jo vetëm për liri dhe demokraci kundër bullgarëve, turqve dhe më në fund serbëve, por ai ishte një pishtar që jo vetëm mori pjesë në të gjitha kuvendet që u organizuan nën udhëheqjen e Abdyl Frashërit, por ai ishte një ndër kontribuuesit më të mëdhenj për hapjen e shkollës së parë shqipe, në gjuhën shqipe, në Dibrën e Madhe...

Unë për këtë atdhe u ktheva nga akademitë, lashë diplomë ndërkombëtare dhe doja t'i shërbeja atdheut tim me dijet e mia. Më keni ngatërruar! Edhe ime më shpresonte se ishte bërë një gabim, se ata ishin

njerëz jo vetëm të pafajshëm, ata ishin njerëz që ëndërronin për atdheun, për Shqipërinë e shkatërruar dhe të mjeruar, t'i shërbenin atdheut. Nëna ime ishte motër dëshmori. Por, edhe babai im. I vëllai i tij kishte luftuar kundër fashizmit, edhe ai vetë. Nuk e kuptonte se çfarë po bëhej. Do të kalonte 11 muaj të vështirë në hetuesi. Pushkatimi pa gjyq, i 22 intelektualëve tek ura e Beshirit, kishte çuar shkallën e terrorit në pikën më kulmore. Pas një ngjarje të tillë makabre kur sovranit i ishte dhënë grushti i rëndë prej diktatorit, nevojitej një periudhë qetësie dhe zbutje e represionit. Kjo periudhë përkoi me kohën kur Edip Daci mbahej në hetuesi dhe vetëm falë rrethanave historike ai i shpëton pushkatimit”, – rrëfen Ida Daci Abdiu në këtë dokumentar televiziv të realizuar me mjeshtri të rrallë artistike nga gazetarja e mirënjohur Admirina Peçi, dokumentar ky që u ndoq me vëmendje dhe interes të veçantë nga qindra pjesëmarrës, përfaqësues të botës akademike e të letrave.

AKADEMISTI I MODENAS EDIP DACI NË MINIERËN E BULQIZËS

Nënës sime nuk i hiqeshin nga sytë rrobat e gjakosura nga torturat dhe nuk po i besohej që ai u kthye gjallë në shtëpi. Mendoni, 11 muaj hetuesi speciale, i tmerruar, i trishtuar, nuk di se si mund t’jua përshkruaj, kthehet në shtëpi duke parë dy fëmijët e vegjël dhe nusen e re. Por kjo qetësi relative u prish shumë shpejt. Me urdhër të prerë, ai duhej të largohej nga Durrësi dhe vendi më i përshtatshëm për të tillë njerëz do të ishte Bulqiza. Babait tim i “dhuruan” kështu Bulqizën. Nuk e njihnte atë terren, vetëm kur kishte kaluar nga Tirana në Dibër të Madhe me karvanët e kuajve. E megjithatë, në emër të jetës së dy fëmijëve do të bënte çdo sakrifice. Në një makinë i hodhën plaçkat, dy fëmijët dhe gruan e re dhe u nisën drejt Bulqizës. Ishte dhjetori i vitit 1952. Nëna ime ishte shtatzënë me mua, fëmija i tretë. Dhe unë aty lindi”, – shkruan ndër të tjera Ida Daci (Abdiu) në librin e saj.

Është vërtetë tronditës ky rrëfim për jetën e Edip Dacit, ushtarak karriere, diplomuar në Akademinë Militare në Modena Itali, i cili edhe pse me një varg kontributesh dhe vepra patriotike, nuk i kishte shpëtuar hakmarrjes komuniste. E kishte përfshirë edhe Edip Dacin, vala e tmerrshme spastruese e vitit 1951, në radhët e intelektualëve shqiptarë. E çojnë në një familje bulqizake, tepër fisnikë edhe i thonë: “për një kohë

do banoni këtu”, – duke ua hedhur plaçkat nga karrocERIA e makinës. Futen brenda të tmerruar, por dashamirësia dhe bujaria e asaj familjeje, e Abedin Duriçit, sikur ua shkriu pak akujt e shpirtit. Aty gjeti ngrohtësinë dhe besimin sepse paskan ngelur njerëz të mirë prapë, nuk qenkan të gjithë si hetuesit në Durrës, si policët, paska mbetur pak bujari dibrane asaj treve të Bulqizës. I çuan në atë barakë. Nuk u ofrohej punë as Edipit dhe as Remzies. Ata, me gjithë fëmijët e mitur, duhet t’i bënin ballë jetës së vështirë në atë qytet të vogël të ftohtë, nën survejim të pandërprerë.

Ai, akademist me pesë gjuhë të huaja, dilte çdo ditë dhe shiste gështenja që i piqte në një fuçi të prerë përgjysmë dhe gurabijet që ia përgatiste në shtëpi e shoqja. Me ato para do të mbijetonin për ca kohë. Pyetjet munduese për fatin e tij, kishin nisur të shuheshin. E rëndësishme ishte që kishte familjen dhe ishte gjallë. Shokët e tij ishin pushkatuar apo burgosur prej kohësh. Edhe pse rridhte e tillë përmes vështirësive, jeta ishte e vyer dhe ai ja dinte vlerën asaj çfarë kishte. Kështu rridhnin ditët në Bulqizë, derisa një ditë dikush ju afrua dhe i kujtoi se sigurimi i shtetit e mbante nën vëzhgim të rrepte prej kohësh... Dhe kalvari i strëmundimshëm i kësaj familjeje do të përfundonte njëherësh me përmbysjen e diktaturës, pas vitit 1990, kur tashmë fëmijët e Edipit qenë promotorë të asaj lëvizjeje të fuqishme dhe ecën dinjitetshëm, duke ngjitur me meritë shkallët e karrierës së tyre, çka do t’i bënte të ndjeheshin krenarë prindërit e shumëvujtur.

JETA DHE VEPRA E EDIP DACIT SI TESTAMENT ATDHEDASHURIE

Për autoren e monografisë “Jetë mes dallgësh”, Ida Daci Abdiu, ndonëse personazhet që i japin jetë librit janë të fisit të saj emërndritur, në të përshkruhet me dhimbje dhe krenarisht drama-tragjedia, që përfshiu dy Dibrat gjatë shekullit 20. Përshkruhet qëndresa e dibranëve ndaj pushtuesve dhe regjimeve të urryera çnjerëzore. Në promovimin e librit, në praninë e qindra përfaqësuesve të elitës dibrane, jo vetëm nga Dibra e Madhe, por edhe nga Tirana e diaspora ajo ndjehej e qetë, sepse kishte përmbushur amanetin e babait të tij, duke e sjellë atë për lexuesin si testament atdhedashurie.

“Sot jam e qetë, sepse të gjithë ju në këtë sallë, të tjerë që mungojnë, të gjitha përkatësitë e ndjeshmëritë e ndryshme, konvergojnë në një pikë

të vetme: distancimi e dënimi i shovinizmit e totalitarizmit, si dhe në përpjekjet e përbashkëta për të mbrojtur liritë dhe të drejtat themelore të njeriut; në përpjekjet që e gjithë Dibra, ajo e Poshtme dhe ajo e Epërme, si pjesë të qenësishme të kombit shqiptar, të tejkalojnë urrejtjet e ndasitë dhe të ndihmojnë në udhëtimin tonë të përbashkët rajonal drejt strukturave euroatlantike”, – tha ndër të tjera Ida Daci-Abdiu.


Librin “Jetë mes dallgësh”, si dhe dokumentarin përkatës televiziv ajo i konsideron homazh për prindërit, Edip Daci dhe Remzie Strazimiri Daci, që i rritën me aq shumë mundime, por që s’mundën të rikthehen në Dibrën e tyre të dashur. Në këtë veprimtari promovuese mbresëlënëse, të moderuar mjeshhtërisht nga “Mjeshtri i Madh” Defrim Methasani, vlerat dhe mesazhet që përcjell ky libër u evidentuan nga redaktori i tij, Lavdrim Shehu si dhe nga akademiku Adem Bunguri, ndërkohë që përsëndetën edhe ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Fehmi Abdiu (kumat i autores), prefekti i Dibrës Nexhbedin Shehu, kryetari i Komunës Dibër e Madhe, dr. Hekuran Duka, ish-kryebashkiakët e Peshkopisë dhe Bulqizës, Ilir Krosi e Roland Keta etj..

“Në të gjitha faqet e librit, (si edhe në dokumentarin televiziv) autorja, duke u shprehur në vetën e parë, shfaqet tokësore, humane dhe pagabueshmërisht e vërtetë... Duke na dhënë një pasqyrë të jetës njerëzore për gjatë gjithë shekullit 20-të, ashtu si shkëmbinjtë që mbeten të egër e të fortë, të palëvizshëm e të pandryshueshëm, në çdo detaj para syve të lotit, ashtu do të qëndrojnë e vërteta e Idës, kryelartë e krenare përpara epimit të kohës, që ka ndryshuar e do të ndryshojë vazhdimisht”, – tha ndër të tjera redaktori i librit Lavdrim Shehu.

Pjesëmarrësit pritën gjithashtu me ovacione “Mirënjohjen” që kryetari i Shoqatës Atdhetare Bulqiza, Bashkim Lami, i akordoi Edip Murat Dacit (pas vdekjes) në emër të kësaj shoqate, me motivacionin: “Mirënjohje për këtë bir të familjes patriotike Daci, nga Dibra e Madhe, që në disa breza luftuan e sakrifkuan për atdheun në luftë e në politikë, të përballur me kalvarin e dhimbshëm të disa bijve. Intelektual i shquar, akademist ushtarak shembullor në Modena e kundërshtar i fashizmit. Mirënjohje e vlerësim për jetën me sakrifica të mëdha të tij dhe familjes, që nuk iu nënshtrua as fashizmit e as komunizmit, duke u përballur me diktaturat me trimëri e burrëri. Qytetar e prind shembullor që rriti dhe edukoi me sakrifica fëmijët në Bulqizë, duke mbajtur lart dashurinë për punën, jetën e atdheun”.

SAFET ZHULALI, NË PANTEONIN E VLERAVE TË LIRISË E DEMOKRACISË SHQIPTARE

Popujt vitalë, në kapërcyell të epokave, në përballje me sfidat që nxjerrin udhëkryqet e kohërave, për të mos u shuar, përbaltur e asimiluar, për të mos humbur identitetin, lindin nga mitra e tyre e përgjakur, mes dhimbjesh të mundimshme, krijesa jo të zakonshme, me intelekt e aftësi të veçanta, që marrin përsipër përgjegjësi të mëdha për të lehtësuar lëvizjet drejt një të ardhmeje plot të papritura, plot enigma, kurthe e befasisra. I tillë ishte rasti për shqiptarët në atë fillim të viteve '90 -të të shekullit të kaluar.



Është një ndërthurje e çuditshme dhe e mistershme e rrethanave e faktorëve objektivë e subjektivë, ekonomikë e politikë, që bëjnë të mundshme daljen e shpërthimin e individëve të tillë në skenën e amfiteatrit, ku popujt vendosin vetë për fatet e tyre. Si nga një vullnet hyjnor, harmonizohen gjer në përsosmëri te këta individë thjeshtësia me heroiken, e zakonshmja me të pazakonshmen, qëndresa me vizionin, dashuria për popullin me urrejtjen për diktatorët, besimi me kontrollin, emocioni me vetëpërmbytjen. Ky është rasti për Safet Zhulalin në atë dhjetëvjeçar të fundit të shekullit të njëzetë. Një politikan, një diplomat dhe një ministër tipik në një situatë atipike, siç qe ajo e viteve 1992 – 1997.

Siç del dhe nga axhenda e tij, Safet Zhulali, në atë kontekst politiko-shoqëror, ka një veprimtari intensive në funksionin e anëtarit të Qeverisë së Parë Demokratike, në diplomacinë ushtarake si dhe në organizimin e menaxhimin e politikave elektorale. Kontributet e shquara në Reformimin e Ushtrisë me pikësnyim integrimin në NATO, në veprimtari ushtarake që kishin si qëllim ngritjen e imazhit të rrënuar të ushtrisë sonë e më pas

arritjen e objektivave madhore kombëtare, përpjekjet e mundimshme për transformimin e ushtrisë, përbënin thelbin e axhendës së Ministrit Zhulali.

MINISTËR ME KARAKTER TË PAPËRTHYESHËM E LARGPAMËS

Reformat e mëdha kërkonin një mendje të mprehtë e një logjikë të ftohtë, një karakter të papërthyeshëm e largpamës, përgjithësisht një intelektual vizionar, i cili dinte të formulonte e riformulonte ide në situata të tranzicionit të vështirë që po kalonte Shqipëria. Reformat kërkonin një reformator të madh. I tillë, për fatin tonë të mirë, qëllloi të ishte Safet Zhulali.

I ardhur nga një familje me një traditë të mirëfilltë intelektuale, një kombinim i shkëlqyer mes një babai, si Shemsiu, i cili në themel të edukimit kishte disiplinën, ndershmërinë e antikonformizmin, dhe një nëne, si Drita, model i një edukatoreje të dashur, kërkuese dhe të ngritur profesionalisht, Safeti kishte gjithë predispozitat për t'u bërë, dhe u bë, një qytetar i mirarsimuar e i miredukuar, një ekspert ekselent në fushën e mësimdhënies e të edukimit në përgjithësi, me aftësi të spikatura organizuese e menaxhuese. Kështu ai pati një përshtatshmëri të menjëhershme me detyrën e Ministrit të Mbrojtjes. Ai erdhi në këtë detyrë pas një pune të shkëlqyer që kishte bërë për ngritjen, funksionimin e konsolidimin e Degës së Partisë Demokratike në Dibrë.

Qëndrimet dhe vepra e tij shfaqeshin me një mjeshtëri të rrallë komunikimi, ku spikaste matura e racionalja, qartësia e mendimit e qëmtimi me kujdes i fjalës e i frazës, aftësia për t'u përballur me profesionalizëm dhe dinjitet me personalitetet e mëdha të vendeve me demokraci të zhvilluar, jashtë komplekseve të inferioritetit, snobizmit e ksenofobisë. Rrallë të gjendet në axhendën e një ministri, një pasion e përkushtim i tillë në shërbim të Atdheut e Kombit, ku shkrihej, nga ora 08:00 e mëngjesit deri në orën 03:00 të pasmesnatës, tërë fuqia e mendjes, trupit dhe shpirtit të tij fisnik. Prurja e shumëfishtë e mesazheve, që ai përcillte gjatë axhendës tek bashkëpunëtorët, tek ushtarakët, përgjithësisht tek qytetarët, shpërndante si në eter besim e shpresë, siguri e sinergji pozitive, për të ndërtuar shtetin ligjor, për t'u integruar në Strukturat Euroatlantike, për të arritur zgjidhjen e çështjeve madhore kombëtare.

ZHULALI ME STATUSIN E NJË MINISTRI «TË FUQISHËM»

Siç del dhe nga axhenda e tij, asnjë ministër, as para, as pas tij, nuk arriti një denduri të tillë takimesh e komunikimesh intensive me personalitetet më të larta politike e diplomatike të vendeve më të fuqishme të botës demokratike. Në Qeverinë e parë Demokratike, me mungesë përvoje qeverisëse, ai dallohej për nivelin kulturor, për këmbënguljen në kryerjen e reformave, për antikonformizmin, për ndershmërinë e transparencën dhe në mënyrë të veçantë për formimin demokratik. Ishte ndër ata ministra që trajtonte me profesionalizëm në mediat e shkruara dhe ato pamore, çështje të ditës si dhe ato të së ardhmes në fusha të ndryshme, si: në ato të mbrojtjes, të shtetit të së drejtës, të politikës etj, me një stil të saktë, konciz dhe të strukturuar. Me Zhulalin, ndodhi që fati a përzgjedhja ia shpërbleu në mënyrë të tillë, ku posti i lartë shtetëror të përkojë me vlera të tilla, si: besnikëria ndaj idealeve demokratike, karakteri i papërkulur, vizioni për ardhmërinë, përthithja inteligjente e informacioneve dhe teknologjive bashkëkohore, toleranca dhe mirëkuptimi për opozitën etj.

Veç të tjerash, Safet Zhulali ishte një humanist i madh, i adhuruar pas lirisë, paqes e demokracisë, të cilat i kishte të shenjta dhe mbi të cilat nuk vinte asgjë, as interesa partiake, as interesa vetjake. Për ruajtjen e forcimin e tyre ai përfytyronte e programonte një ushtri moderne, të ngjashme me ato të NATO - s dhe për t'ia arritur kësaj, kërkonte të shkollonte një brez të ri ushtarakësh në universitetet perëndimore me qëllim që të realizoheshin standardet e NATO-s.

Në sajë të lidhjeve e njohjeve personale të Ministrit Zhulali me kolegët e tij të mbrojtjes në vendet e NATO-s, u dërguan me dhjetra e qindra studentë në kolegjet e akademitë ushtarake më në zë, si ato të Italisë, Turqisë, Gjermanisë, SHBA - ve etj, të cilët sot janë kthyer në asete të vyera për konsolidimin e ushtrisë sonë sipas standardeve të NATO-s.

Sa i përket axhendës së Ministrit Zhulali, lidhur me përafrimin e aderimin e vendit tonë në NATO, roli i tij është i pakrahasueshem. Ai, jo vetëm u takua, por si askush tjetër u miqësua me presidentët Demirel e Shirak, me Sekretarin e Mbrojtjes Perry, me Ambasadorin Rayerson etj., miqësia me të cilët ndikoi dukshëm në mbështetjen që ata do t'i jepnin Shqipërisë në proceset e integritimit Euroatlantik. Si ministër i Mbrojtjes, Safet Zhulali, kishte në qendër të vëmendjes së axhendës së tij zhvillimet

politiko-ushtarake në rajonin tonë në përgjithësi e ato në Kosovë e Maqedoni në veçanti. Ishte ndër të parët që mori kontakte me politikanë të mirënjohur, si Ibrahim Rugova, Arbën Xhaferi, Menduh Thaçi, etj. Ndërkohë që u takua me përmallim e mësoi shumë nga Nënë Tereza. Ai si një politikan vizionar u parapriu zhvillimeve politike në Rajon, sidomos në Kosovë. Për këtë ai tregoi një kujdes e vëmendje të veçante për përgatitjen e kuadrit drejtues kosovar në territorin tonë.

VITI '97 – AXHENDA E MINISTRIT NUK U NJOLLOS ME URDHËRA BOMBARDIMESH E VRASJESH TË QYTETARËVE TË PAARMATOSUR

Jeta ka vështirësitë e kurthet, zigzaket e dritëhijet e saj, sidomos gjatë tranzicionit të tejzgjatur shqiptar. Safeti besonte në vlerat demokratike, ndaj ishte i vërtetë në atë që kumtonte.

Edhe në vitin e mbrapshtë 97- ë, kur ndodhën trauma të paparashikuara, Ministri Zhulali nuk e humbi toruan, ruajti gjakftohtësinë, vetëpërmbajtjen, respektoi ligjshmërinë. Ai nuk e përballi ushtrinë me turmat e irrituara, të manipuluara e të nxitura nga elementë karrieristë, socialkomunistë, të cilët, për të realizuar ambiciet e tyre të sëmura, sulmuan institucionet e Shtetit, dogjën gjithçka që u doli përpara, duke i bërë gjëmën Shqipërisë. Ai nuk lejoi të qëllohej mbi turmat, civilët, gratë e fëmijët. Ministri Zhulali qëndroi në krye të detyrës deri në momentin kur erdhi pasardhësi i tij. Kështu karriera e Ministrit nuk u njollos. Ajo, ashtu si filloi, u mbyll me vetëpërmbajtje, me përkushtim në mbrojtje të tërësisë tokësore e sovranitetit kombëtar, me shpirt të lartë sakrifice gjer në vetëmohim dhe me ndjeshmëri qytetare.

NJË METEOR NË POLITIKËN SHQIPTARE

Renditja në mënyrë kronologjike e axhendës së ish themeluesit dhe drejtuesit të degës së PD-së, Dibër, ish – depuetit të rrethit të Bulqizës në dy legjislatura (1992-'96 dhe 1996-'97) dhe ish-ministrit të parë të Mbrojtjes të periudhës së demokracisë e pluralizmit, argumentet dhe faktet që sjellin bashkëkohësit, na çojnë në konkluzionin se figura e Safet Zhulalit qëndron në panteonin e personaliteteve të shquara kombëtare që

personifikojnë periudhën 33-vjeçare të historisë së Partisë Demokratike dhe të qeverisjes së saj. Prandaj edhe interesimet dhe interpretimet e rolit të tij janë trajtuar nga këndvështrime të ndryshme. Përgjatë viteve, nga individë dhe me qëllime dashakeqëse, ka patur dhe interpretime me nota subjektiviste e nihiliste, çka nuk përkon me të vërtetën, e aq më pak me realitetin shoqëror shqiptar. Safet Zhulali me kontributin dhe angazhimin e tij, ka luajtur një rol të rëndësishëm në përmbysjen e sistemit komunist dhe vendosjen e demokracisë e të pluralizmit në Shqipëri, ku si një burrë shteti ka dhënë ndihmesën e tij për vendosjen e themeleve të Qeverisjes Demokratike. Pikërisht për këtë kontribut ai është dekoruar nga ish-Presidenti i RSH, z. Sali Berisha me Dekret nr. 374, datë 30.11.1992, me Urdhrin e Lirisë të Klasit të Parë me motivacionin: “Për merita të larta patriotike në sigurimin e lirisë dhe për shërbime të shquara në reformimin e Ushtrisë”. Përvoja e tij si organizator në organizimin dhe drejtimin politik të degës së Partisë Demokratike, përbën edhe tani një shembull të shkëlqyer, për t’u marrë si model nga politika shqiptare për metodën e punës, kreativitetin, inspirimin dhe aftësinë për të dhënë mesazhe shprese.

Si ministër i Mbrojtjes në vitet e vështira 1992-97, ai ia ka dalë me sukses që të paraqesë, të mbrojë dhe të avancojë Platformën e Reformimit të Ushtrisë Shqiptare dhe të çuarjes së saj drejt standardeve të NATO-s. Madje është ky vlerësim real dhe objektiv mbi të cilin Këshillat Bashkiakë të Peshkopisë, Libohovës dhe Poliçanit i kanë akorduar Safet Zhulalit titullin «Qytetar Nderi» të bashkive respektive. Autoritetet vendore, dhe mbi të gjitha qytetarët e bashkive Dibër e Libohovë, e vlerësojnë Zhulalin si shembullin e qëndrestarit e luftëtarit, shembullin e njeriut që na tregon se si duhet jetuar jeta dhe menaxhuar pushteti për të kuptuar më thellë rrënjët dhe lidhjet që ekzistojnë midis shtetit dhe shtetasit, midis politikës dhe qytetarit.

Pas Peshkopisë e Libohovës, Poliçani ishte qyteti i tretë që e nderoi ish-ministrin e Mbrojtjes Safet Zhulali, në vitin 2015 -të për punën dhe kontributin e Tij në vitet 1992-1997.

Bashkia e Poliçanit organizoi një ceremoni të veçantë për dhënien e titullit «Qytetar Nderi», Safet Zhulalit, ku merrnin pjesë qytetarë të Poliçanit, drejtues të bashkisë dhe familjarë të Zhulalit. E bija e tij, Ilda Zhulali mori titullin që i akordoi këshilli bashkiak i qytetit. Titulli iu dha

me motivacionin «Për kontribut të veçantë në reformën e punonjësve të Kombinatit Mekanik, Poliçan». Fabrika e armëve në këtë qytet ishte nga të paktat vepra industriale që vijoi të punonte dhe prodhonte edhe përgjatë viteve 1990 -të falë kontratave dhe kujdesit të Ministrisë së Mbrojtjes së atëhershme.

Në ceremoninë festive me rastin e 97-Vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura, ish - Ministri i Mbrojtjes, Arben Imami, e dekoroi Zhulalin me Medaljen «Për Shërbime të Shquara» me motivacion: «Për kontribut të shquar, si Ministër i parë i Mbrojtjes në periudhën e ndryshimeve demokratike të vendit, në reformimin, ristrukturimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura». Kjo medalje jepej në Përvjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura. Ne tashmë jemi një vend anëtar i NATO-s. Ky ka qenë një projekt për të cilin Zhulali punoi dhe besoi deri në fund. Tashmë ai u bë realitet.

Si askush tjetër, mësuesi i matematikës Safet Zhulali për 20 vjet, i vlerësuar maksimalisht nga institucionet arsimore, ishte dhe një njeri që njihej si simbol i mençurisë, guximit e stoicizmit, që linte kudo gjurmë të pashlyera në udhën e jetës, gjurmë që po i ndjekin dhe pasardhësit e tij. Ai mbahet mend nga breza nxënësish e mësuesish të gjimnazit të Peshkopisë si një njeri mjaft serioz, shumë i dashur dhe me një humor, gjithmonë të shëndetshëm. Njeri i veçantë, energjik në sjellje e qëndrime, me një mënyrë të foluri karakteristike, që të mbushte mendjen për çdo gjë që mund të fliste.

Safet Zhulali ishte një njeri shumë më i përparuar se koha që jetoi. Prej tij mësonin të gjithë, jo vetëm nxënësit dhe kolegët e tij, por të gjithë ato që patën fatin të bëhen pjesë e Ekipit të tij Ministror. Personaliteti i tij, kudo dhe në çdo rrethanë reflektonte vlera. Qe një njeri me nivel të lartë në të gjitha dijet, një filozof dhe psikolog, mësues dhe edukator shembullor që të gjendej në ditë të vështira.

Intelektualë më në zë, jo vetëm të Dibrës por nga i gjithë vendi e vlerësojnë Safet Zhulalin si një shembull të dijes! I sigurtë në fjalën që të thoshte, i qartë në konkluzionet që jepte, njohës i filozofisë dibrane, të cilën (edhe pse s'ishte dibran) e përvetësoi dhe avancoi dukshëm në Dibrën ku shërbeu për dekada të tëra, Ai dhe familja e Tij. Mbi këtë bazë, Safet Zhulali duhet kuptuar dhe çmuar si vizionar, largpamës, i cili me vendosmërinë e urtësinë e një politikani të spikatur mundi të arrijë këto

vlera për vendin dhe popullin e tij. Ai nuk e njihnte veten ndryshe, veçse i lidhur ngushtë me popullin për të cilin duhej sakrifikuar gjithçka nga vetja, duke pasur parasysh përgjegjësinë për detyrën që ushtronte në emër dhe në dobi të bashkëqytetarëve. Janë pikërisht këto merita, që jo vetëm në Shqipëri, por dhe në qarqet diplomatike ndërkombëtare, Safet Zhulali vlerësohet si figura më e rëndësishme shqiptare e këtij çerekshekulli. Kjo, për faktin se pjesë kyçe e idesë prijëse të motos së tij ka qenë besimi se fitorja e forcave demokratike do të sillte vendosjen dhe konsolidimin e shtetit ligjor në Shqipëri.

Në krye të dikasterit të Mbrojtjes ai ndërtoi një politikë të ruajtjes së substancës të Forcave tona të Armatosura, ndërkohë që shtroi shinat e reformimit të tyre sipas standardeve të NATO-s.

Mesazhi i qartë që na vjen nga jeta e Safet Zhulalit është për ne, respekti për ish-ministrin demokrat të Mbrojtjes Safet Zhulali, për Shqipërinë, për vlerat individuale të Tij dhe për të kuptuar se sa lartësohet njeriu kur përkushtohet për kombin e tij dhe për demokracinë. Ai e donte Shqipërinë, jo vetëm sepse ishte mësuar për këtë nga familja e tij për ta dashur Atdheun, por se besonte në forcën e resurseve njerëzore e pasurore, për ta bërë atë si gjithë Evropa. Ai ishte idealist dhe provë e gjallë e ëndrrës «Shqipëria si gjithë Evropa». Safet Zhulali, hyri dhe mbeti si një meteor në politikën shqiptare.

NË PANTEONIN E VLERAVE TË LIRISË DHE DEMOKRACISË

Safet Zhulali u nda nga jeta më 13 prill 2002, pas një sëmundje zemre. Homazhet që u bënë për ta përcjellë në banesën e tij të përtejme, ku morën pjesë përfaqësues nga i gjithë spektri politik shqiptar, intelektualë dhe qytetarë nga i gjithë vendi, nga Kosova e Maqedonia; dëshmuar për respektin mbarëpopullor ndaj Ministrin të ndjerë.

Kishin humbur politikanin dhe shtetarin që mund të kishte kontribuar për tejkalimin e stuhive e sfidave në rrugën e vështirë të përparimit e integritetit.

Kishin humbur strategun e konsensusit, mjeshtrin e dialogut, politikanin e mençur dhe të njerëzishëm. Të paktën, atë ditë, në ato çaste dhimbjeje e reflektimi, shqiptarët ishin në një mendje: Zbrazëtia që ai po linte pas do të ishte e vështirë të mbushej. Politikani dhe Ministri Zhulali kishte zënë vend në panteonin e vlerave të lirisë e demokracisë shqiptare.

**Ish-partizani e kuadri që u ndëshkua për shkak të dënimit
padrejtësisht të gjyshit të tij**

RRUGËTIMI I SUKSESSHËM I HAMIT KOÇIT NGA VAJKALI I BULQIZËS



- **Ai kujtohet dhe vlerësohet me nderim të veçantë edhe 47 vjet pas
ijkjes nga kjo botë, si njeriu me shpirt human që ka lënë gjurmë
tek të gjithë. Sepse ka mundur të jetë dhe të mbetet mishërues
dhe përçes i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale.
Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin KRENARI**

Pesë dekada të veprimtarisë jetësore të Hamit Koçi, si pjesëmarrës
aktiv në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, si drejtues në ushtri e në
disa sektorë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, janë shembulli më
i mirë për të kuptuar se jeta është e bukur dhe se askush nuk duhet të
dorëzohet, pavarësisht problemeve me të cilat përballlet.

Hamit Bajram Koçi nga Lagja Vajkal 1 e qytetit të Bulqizës ishte vetëm

23 vjeç kur u rreshtua në formacionet e Brigadës së 18 Sulmuese Partizane, që u krijua në Sllatinë të Dibrës më 18 gusht 1944 nga batalionet partizane të Dibrës, Çermenikës e Martaneshit, si dhe me vullnetarë të rinj nga krahinat e Dibrës, e që u organizuan në katër batalione. Ai mori pjesë aktivisht në luftimet e kësaj brigade deri në çlirimin e plotë të atdheut nga okupatori nazifashist.

Në këtë vit të jubileut të lavdishëm të 80 vjetorit të çlirimit të atdheut, ai meriton të vlerësohet dhe nderohet, jo vetëm për kontributin e tij si ish-partizan i kësaj brigade, por edhe për kalvarin e mundimshëm të viteve të pas çlirimit, ndonëse kontribuoi në sektorë të rëndësishëm.

ORIGJINA

Hamit Koçi i përket një prej familjeve atdhetare të Bulqizës, burrat e së cilës, sa herë atdheu u ndodh në rrezik nga pushtimet e huaja turke, serbe, austriake e bullgare do të rreshtoheshin me armë në dorë parkrah luftëtarëve dibranë të lirisë. Paraardhësit e Hamitit, gjyshi Isufi e babai Bajram Koçi, njihen për qëndresën ndaj pushtuesve të huaj.

Këta burra të shquar të Vajkalit, këtij fshati famëmadh e historik në qarkun e Dibrës, – vendi i dy prej betejave gjakatare që Skënderbeu zhvilloi e fitoi kundër ushtrisë osmane të drejtuar nga renegati Ballaban Pashë Badera (1465), shekuj më vonë do të ishin parkrah patriotëve shqiptarë që do të organizonin kryengritjet e mëdha kundër pushtuesve turq.

Ashtu si dhjetra patriotë nga treva e Bulqizës, edhe ata shfaqen ndër beteja si shqipja në palën e flamurit që nuk u asimilua. Përballë joshjeve të armiqve nuk u shitën e nuk u përkulën, por qëndruan heroikisht për të mos e lënë vendlindjen nën pushtimin turk. Isuf Koçi (i vjetër) ishte pjesë e rebelimit të armatosur kundër Perandorisë Osmane në pragun e shpalljes së pavarësisë kombëtare.

Isuf e Bajram Koçi i përkasin pikërisht Vajkalit, fshatit ku i madh e i vogël, burra e gra, u rreshtuan në llogore gjatë luftës 9-vjeçare të Dibrës kundër pushtuesve serbë (1912-1921). Ata do të ishin përkrah patriotit Mehmet Duriçi (1852-1925), udhëheqësit të çetës bulqizake midis viteve 1912-1921.

Ndaj nuk është e rastësishme që kulla e vjetër e Koçajve është djegur dy herë, nga pushtuesit e huaj.

Pikërisht në këtë vatër atdhetarie lindi, kaloi fëmijërinë, u edukua dhe u formua si luftëtar e patriot edhe Hamit Koçi.

KONTRIBUTI NË LANÇ DHE USHTRINË SHQIPTARE

Hamit Bajram Koçi lindi në 20.06.1920 në fshatin Vajkal, Bulqizë. Pas mbarimit të shkolles fillore dhe shtatëvjeçare ai ka mbaruar shkollën 2 vjeçare ekonomike.

Hamiti, si dhe familja e tij ka dhënë, një kontribut të rëndësishëm gjatë LANÇ-it. Madje, kur në Vajkal u regjistrua një nga aksionet e para antifashiste në Shqipëri, para se Haxhi Lleshi të kthehej nga konferenca e Pezës në shtator 1942, Hamiti ishte ndër të rinjtë më aktivë në këtë aksion luftarak.

Më pas do të ishte përkrahës i Çetës partizane të Dibrës si dhe bashkëkohës dhe bashkëluftëtar i dëshmorëve Latif Përkola e Asllan Keta.

Që me krijimin e saj më 18 gusht 1944 ai u rreshtua në Brigadën e 18-të Sulmuese si partizan, ku ka marrë pjesë në të gjitha luftimet e kësaj brigade deri në çlirimin e vendit.

Qysh me aksionet e para të kësaj brigade ai u shqua për forcën e organizimit, të disiplinës e të veprimeve, duke dhënë shembullin e një djaloshi luftarak kundër pushtuesit. Bashkëkohësit e mbajnë mend për dinamizmin, guximin dhe shpirtin e sakrificës dhe të disiplinës.

Këto virtyte do ta karakterizonin Hamit Koçin edhe pas vitit 1944 kur u transferua në Gjirokastrë si shef prapavije në Divizionin Ushtarak. Por ndonëse shquhej si kuadër me vizion bashkëkohor dhe i përkushtuar ndaj detyrës edhe ai nuk do t'í shpëtonte luftës së klasave.

KUADRI SHEMBULLOR QË E NDOQI NGA PAS “HIJA E BIOGRAFISË SË FAMILJES”

Në harkun kohor të viteve të para të pasçlirimit kur kryente me devotshmëri detyrën e shefit të prapavijës të Divizionit të Gjirokastrës, Hamit Koçi, do të ndëshkohej padrejtësisht, për faktin se gjyshi i tij, Bajram Koçi do të dënohej me 15 vjet burgim me akuzën absurde për “veprimtari kundra pushtetit popullor”, pasi kishte strehuar tre miq të tij të ardhur nga Gostivari i Maqedonisë, të cilët ishin në ndjekje nga sigurimi shtetit të asaj

kohe. Pasi beri tre vjet burg mori pafajësinë, por ndërkohë, nisur nga kjo ngjarje, Hamiti transferohet, ku për një periudhë të shkurtër ka punuar si zëvendës drejtor në Maternitetin e Tiranës. Tashmë, i martuar me Jeme Hasan Gjimi nga Fushë Bulqiza do të gëzoheshin nga lindja e djalit të parë, Isufit që ndër vite e dekada do të bëhej një nga kuadrot drejtues më të aftë që ka njohur Bulqiza. (Ai, nuk harrohet kurrë, si drejtori që drejtoi me zotësi dhe solli veç të mira për njerëzit, si drejtues i bujqësisë dhe themelues i fermës në Fushë Bulqizë)

Ndërsa Isufi rritej, ata jetonin në ish – pallatin e Qazim Mulletit, e ndërkohë familja e tij trashëgonte si pronë edhe një dyqan ushqimor tek Pazari i Ri. Këtu spikat edhe dimensionin e tij në rrafshin njerëzor, sepse kishte ndjeshmëri shumë të theksuar për miqtë e shokët, sidomos për ata nga vendlindja e tij. Ndaj nuk ishte rastësi që të priste e përcillte me bujari vajkalolet e të tjerë nga fshatrat për rreth Vajkalisë që vinin në Tiranë për hallet e tyre. Hamit Koçi përpiqej t’u gjendej pranë në çdo formë, për t’u zgjidhur problemet e tyre.

Kush trokiti asokohe në derën e Hamit Koçit dhe nuk gjeti zgjidhje për hallet e veta?!

Por megjithë kontributin gjatë LANÇ e në këto funksione të rëndësishme si kuadër shembullor, ai do të provonte kalvarin e mundishmshëm për shkak të “hijes së biografisë së familjes”, duke e degdisur si punëtor në ish-NB Peshkopi, sektori Bulqizë dhe NFP Bulqizë.

Në vitin 1946 transferohet drejtues në minierën e kromit Bulqizë, në sektorin e furnizimit të punëtorëve . Vështirësitë ishin të shumta, dhe pikërisht në ato kushte të pamundësisë së sigurimit të gjërëve më të nevojshme e më jetike, familja e tij do të shtohet edhe me dy fëmijë: Këtu lindën Uke dhe Rihana Koçi.

Megjithë përvojën dhe aftësitë profesionale, Hamit Koçi do të provonte disa herë ulje-ngritje në karrierën e tij.

Kështu, në vitin 1948 transferohet në Rubik si drejtor i NFP ku ka jetuar 8 vjet sëbashku me familjen e tij, tashmë edhe me dy fëmijë të tjerë, Kadriun dhe Dallëndyshen.

SI SHPËTOI NGA “DEFIÇITI” I 2 KG SHEQER?!

Është vërtetë sa qesharak aq edhe tronditës rrëfimi i veteranit Isan Bundo, luftëtarit, patriotit e kuadrit që e pësoi me burgje e internime, pas përplasjes me të mëdhenjtë e ish nomenklaturës komuniste në të famshmen Konferenca e Tiranës e vitit 1956.

Me urdhër të Kadri Hazbiut, atë e dërguan në Rubik të verifikonte akuzën e ngritur nga operative i sigurimit të zonës ndaj Hamit Koçit, nëse vërtetë ai kishte vjedhur dy kg sheqer nga mgazinat e NFP-së, ndërmarrje të cilën ai e drejtonte, dhe ku një nga magazinieret kishte dalë defičit, pikërisht me dy kg sheqer.

“Troktika në derën e zyrës së Hamitit dhe ai më ftoi të hyja brenda. Pasi i thashë qëllimin e kësaj vizite, Hamiti më thotë: Nëse ta bëj kafënë me sheqer, vërtetë i kam vjedhur ato dy kg! Nëse jo, duhet gjetur hajduti i vërtetë... Pas pak troket sërish dera dhe shfaqet operativi i sigurimit të zonës që kërkon të më takojë mua. Pasi i thashë të presë jashtë, Hamiti më thotë: Ja kush është hajduti i sheqerit! Kemi bërë inventarin e magazinës dhe magazinierja që doli defičit na ka deklaruar se sheqerin e ka marrë operative i sigurimit.

Pasi e takova operativin i thashë se kam ardhë me urdhër nga lart të arrestoj atë që ka vjedhur sheqerin. Pas dy ditësh vjen një grup nga Ministria e Tregtisë që provoi atë që më kishte thënë Hamit Koçi, se sheqerin e kishte marrë operativi. Zbulimi i kësaj të vërtetë më solli përplasje me Ministrin dhe përfundova në burgje e internime, por amë Hamit Koçi mbeti miku im”, rrëfen Isan Bundo”.

PËRJASHTIMI NGA PARTIA PAS PËRBALLJES ME ISH SEKRETARIN E PARË MUÇO PAJENGA

Në vitin 1960, Hamit Koçi transferohet familjarisht në Ulëz, si drejtor i NFP-së. I përkushtuar ndaj detyrës dhe familjës së tij, tashmë me 5 fëmijë sepsë këtu lind edhe Bukuroshi (sot ndër sipërmarrësit më të suksesshëm në rang vendi), kur sapo kishte mbushur dy vjet në këtë detyrë me përgjësi, për të rikthehen sërish hijenat e luftës së klasave. Në vitin 1962, ndaj tij sajohen akuza absurde që do të vijonin deri në përplajse me ish Sekretarin e Parë të Komitetit të PPSH të rrethit të Matit, Muço Pajenga dhe në një

plenum partie të atij viti e përjashtojnë nga partia.

Vërtetë situatë kritike për kuadrin vizionar që po ndëshkohej me akuzën se babai i tij ishte dënuar për veprimtari kundra pushtetit popullor. Dhe jo vetëm kaq, por falanagat e atij pushteti kishin hulumtuar edhe më thëllë, duke “zbuluar” edhe kleçka tjera në biografi, pse dajat e tij ishin shpallur “kulak”, ngaqë s’pranonin të dorëzonin tokë e bagëti në ish-kooperativën bujqësore .

Sërish Hamit Koçi nuk inkurajohet por rikthehet në vendlindje për t’iu përkushtuar familjes së tij. Nis kështu sërish rrugëtimin e jetës së tij me ecejake. Pesëmbëdhjetë vitet e fundit të jetës së tij, (nga viti 1962 deri në 7.07.1977 kur ndrroj jetë nga një sëmundje e rëndë, hemoragji cerebrale), punoi në NFP me ndërshmëri, i rrethuar nga miq e shokë të shumtë që e donin dhe e respektonin.

MESAZHET QË PËRCJELLIN SHEMBULLIN E TIJ KANË EMRIN KRENARI

Në rrugëtimin e këtij idealisti elitar, që nisi nga radhët e forcave partizane; vijoi si Shef Prapavije në Divizionin Ushtarak të Gjirokatrës, si zëvendës Drejtor i Maternitetit të Tiranës, Përgjegjës sektori e Drejtor i NFP në Bulqizë, Rubik e Ulëz, gjejmë episode dhe fakte që e rendisin personalitetin e tij me atë të personaliteteve të shquara shqiptare, të cilët gjithë jetën ia kushtuan atdheut të tyre. Ai bën pjesë në plejadën e luftëtarëve të lirisë e drejtuesve të Ushtrisë shqiptare që kontribuan për rindërtimin dhe konsolidimin e disa sektorëve të rëndësishëm dhe ia doli të jetë kurdoherë i sukseshëm. Me performancën e tij të shkëlqyer, falë përkushtimit ndaj profesionit, ai do të dallohej kudo e kurdoherë, si kuadër kompetent e me përvojë. Vlora e veprës së tij qëndron jo vetëm në kryerjen më së miri të detyrave të tij funksionale, por edhe në atë të punës praktike për t’i shërbyer sa më mirë nevojave të popullit. Kësisoj ai bëri realitet ëndrrën për t’u shërbyer hallexhinjve nga Bulqiza, Mati e Mirdita, jo vetëm me kompetencën profesionale, por edhe me papërtueshmërinë e fjalën e ëmbël. Ai ishte kuadri shembullor që manifestone cilësi të shquara profesionale, humane dhe sociale dhe si i tillë edhe me një rreth të gjerë miqsh dhe një popullaritet mahnitës. Marrëdhëniet me njerëzit i konsideronte të shenjta. Ai i donte dhe i çmonte shumë shokët e tij,

qofshin ata kolegë, shokë të rinisë, fshatarë, qytetarë, të rinj apo pleq. Përveç dashurisë për njerëzit dhe mikpritjes, kishte edhe një pikë tjetër të fortë, që ishte bashkëshortja e tij fisnike, Jeme Hasan Gjimi. Ai e vlerësonte dhe e konsideronte këtë si fat të madh. Sepse jo çdokush do të kishte qenë e gatshme që të priste pa pushim dhe në çdo orë atë fluks miqsh e vizitorësh në shtëpi. Banesa e tij (ish shtëpia e Qazim Mulletit) në Tiranë, në ato vte që kthyer në një shtëpi të dytë për bulqizakët e dibranët e shumtë, sa herë që u duhej të vinin për një vizitë në spital apo për të parë fëmijët e tyre ushtarë e nxënës. Megjithë ngarkesën në punë, Hamit Koçi kishte mirësinë dhe gatishmërinë që të angazhohej pa kursim në zgjidhjen e çdo halli të njerëzve në nevojë. Madje edhe kur ishin probleme që nuk i kishte në dorë vetë, ai shfrytëzonte të gjitha mundësitë dhe lidhjet miqësore për t'ua zgjidhur njerëzve ato. Ndaj, me të drejtë, ish partizanin e kuadrin shembullor nga vendlindja e tyre, kur shërbente në kryeqytet, bulqizakët e kanë konsideruar si "Ambasador i Bulqizës në Tiranë". Madje çdo ambasador do t'a kishte zili përfaqësimin dinjitoz të humanizmit dhe vlerave të familjes dhe vendlindjes nga ai vinte, si dhe humanizmin e pashtershëm e virtytet e pashoqe që ai shfaqte në të mirë të njerëzve. Në profilin e Hamit Koçit ishin bërë bashkë krenaria individuale, krenaria e fisit, krenaria e vendlindjes, e krahinës dhe krenaria kombëtare e bazuar tek historia, luftërat legjendare, puna dhe arritjet e të parëve të tij, punëtorë dhe bujarë, por dhe të shokëve të luftës e të Ushtrisë, si lajtmotivi i jetës dhe veprës së tij. Ai u nda nga jeta më 7.07.1977, duke mbetur në kujtesën e bashkëqytetarëve nga Bulqiza, miqve e shokëve të tij të shumtë, si simbol i njeriut të virtytshëm, duke lënë pas fëmijët e tij shembullorë (Isufin, Uken, Rihanen, Kadriun, Dallëndyshen e Bukuroshin) që të gjithë njerëz emërmirë për familjen e shoqërinë.

Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin KRENARI.

DREJTËSIA E VONUAR PËR VRASJEN E SHEKULLIT

- Artan Cuku, në librin me 50 vrasjet më të rënda në botë! Si e krijuan ekspertët e huaj “fytyrën e vrasësve”? Vlerësimet për ish-drejtuesin e Policisë



- Rrallëkush si ish-drejtuesi i Parë i Policisë së Shtetit, Artan Cuku, ka fituar pavdekësinë pas vrasjes për shkak të detyrës nga falangat e krimit të organizuar. Vlerësimi i dëshmorit të atdheut Artan Cuku, i përfshirë në librin me 50 vrasjet më të rënda në botë për arsye shtetërore të titulluar “Faces os Assassination” (“Fytyra e vrasësve”), të hartuar nga një grup ekspertësh nga e gjithë bota dhe të botuar nga organizata prestigjioze “Iniciativa globale kundër krimit transnacional” (“Global Initiative against Transnational Organized Crime”) me qendër në Gjenevë të Zvicrës, përveçse akt juridik dhe politik, është dhe detyrimi moral i institucioneve qendrore shtetërore dhe vendore shqiptare.

Parë nga ky këndvështrim, shokët, miqtë, bashkëpunëtorët e shumë dhe familja e tij, kanë vlerësuar vendimet për shpalljen e Artan Cukut

“Dëshmor i Atdheut” nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” (me vendim nr. 770, datë 02.04.2019) dhe dhënien e simbolit “Familje e Dëshmorit të Atdheut” familjes së tij; akordimin nga Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani i “Dekoratës së Artë të Shqiponjës” (pas vdekjes), si dhe akordimin nga Ministri i Brendshëm i “Medaljes së Nderit” pas vdekjes, me motivacionin “Për merita dhe shërbime të veçanta në luftën ndaj krimit, sigurimit të rendit e të qetësisë publike” (me Urdhrin nr. 464, datë 12.06.2017).

Këto, në nivel qendror, por padyshim, jeta dhe vepra heroike e Artan Cukut është vlerësuar e përjetësuar edhe nga organet e qeverisjeve vendore, si nga Këshilli i Qarkut Dibër e këshillat bashkiakë Peshkopi e Kamzë, duke i dhënë atij titullin “Qytetar Nderi” (pas vdekjes), si dhe duke emërtuar institucione e rrugë kryesore me emrin e tij. Dhe nëse Këshilli Bashkiak Kamzë, me vendimin Nr. 24 datë 18.02.2022 vendosi emërtimin “Artan Cuku” të Pallatit të Kulturës Kamzë, Këshilli Bashkiak Durrës, me Vendimin nr.35, datë 16.04.2024 ka miratuar emërtimin e Rrugës “Artan Cuku”, me vendndodhje në Lagjen nr. 2, Njësia Administrative nr. 1 e qytetit bregdetar.

Ky vlerësim më i fundit, për përjetësimin e veprës së dëshmorit të atdheut Artan Cuku, bazohet në rezultatet e tij si ish – Shef i Seksionit për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë e Policisë së Durrësit në harkun kohor të viteve 2003-2004. Referuar analizës vjetore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës, shtypi i kohës shkruante se: “Shefi i Policisë Kriminale Artan Cuku ka rezultuar si ‘Heroi i vitit 2003’, pasi ka qenë dhe mbetet më rezultativi në luftën ndaj krimit. Ana tjetër e medaljes pas leximit të raportit të (ish) kryekomisarit Tonin Vocaj, ishte evidentimi i arritjeve, pikërisht të kryepolicit të krimeve Cuku, i cili pas ardhjes së tij 8 muaj më parë në Durrës, ka rritur ndjeshëm efektivitetin e punës, duke arrestuar 50 persona më shumë se në vitin 2002, të shpallur në kërkim.”

Edhe Tonin Vocaj që e ka njohur nëpërmjet punës, pohon se jo vetëm ai, por edhe shumë kolegë mund të evidentojnë me dhjetëra e dhjetëra raste të protagonizmit të Artanit në hetimin dhe zgjidhjen e shumë çështjeve që konsideroheshin të vështira. “E them me bindje, se punonjës policie të tillë si Artan Cuku, me dhunti të jashtëzakonshme në fushën e hetimit të krimit, është vështirë që të gjenden. Artani kishte intuitë dhe

orientim të jashtëzakonshëm në ngjarjet kriminale dhe mbi të gjitha kishte vendosmëri dhe zgjuarsia për ta çuar hetimin deri në fund”,-shprehet Tonin Vocaj.

Ndërsa Ahmet Prençi, ish-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (ndër më të suksesshmit e një organi të tillë të lartë ligjzbatues dhe më i respektuari nga ish-vartësit, kolegët, miqtë e shokët e tij të shumtë), në një letër të pazakontë, kur nga bota e të gjallëve i shkruhet dikujt në botën e përtejme (botuar në “Panorama 19 janar 2018), ndër të tjera shkruan: “Sakrifikove shumë për ligjin Artan, dhurove gjithçka për rendin në këtë vend me plot halle e derte; njerëz si ti ishin të rrallë, por njerëz si ti ngjallnin besimin për një të ardhme më të sigurtë, më të mirë...Vendi kishte dhe ka nevojë jo për Habilajt, as për Balilajt, as për trafikantët dhe grupet e organizuara që bashkëqeverisin me pushtetin, vendi kishte dhe ka nevojë për njerëz si ti Artan, të përkushtuar, të vendosur, vetëm në anën e ligjit dhe të njerëzve të thjeshtë e hallexhinj të vendit tim, të vendit tend...”.

VLERËSIMET

Në kujtimet e tij, Dr. Hasan Shkëmbi, ish – Drejtues i Parë Policie dhe ish – Pedagog në Akademinë e Policisë, ndër të tjera shkruan se: “Në fundin e vitit 2002, për aftësitë profesionale të shfaqura në Shkodër, Artani përzgjidhet nga titullarët e Ministrisë së Brendshme dhe transferohet në detyrën si Shef i Seksionit për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë e Policisë së Durrësit, qytet ky shumë problematik në atë kohë, ku si një vend bregdetar, përveç krimit të rrugës ushtrohej një veprimtari dinamike e trafikeve dhe krimit të organizuar.

Eksponentë të rëndësishëm të krimit u goditën në atë kohë. Persona të rëndësishëm të botës së krimit me lidhje politike u përballën me reagimin e fortë të policisë. Artani ishte ideatori dhe drejtuesi kyç i këtyre aksioneve të fuqishme, por nga ana tjetër filluan edhe angazhimet e personave me influencë politike të lidhur me botën e krimit për ta lëvizur nga ky qytet. Këtë detyrë ai e mbajti deri në vitin 2004 për t’u transferuar në qytetin më të largët verior. Gjatë periudhës që Artani qëndroi në detyrën e shefit të hetimit të krimeve, u cilësua nga shtypi i kohës si “Heroi i vitit”.

Pasi bën një rezyme të karrierës së shkëlqyer profesionale dhe akademike, ish pedagogu i Akademisë së Policisë e vlerëson Artan Cukun

si ekspert hetimi ekselent dhe drejtues të talentuar të Policisë. Impresionet e jashtëzakonshme dhe vlerësimi për dimensionin, vlerat morale e intelektuale dhe profesionale, talentin dhe madhështinë e figurës së Drejtorit të Policisë Artan Cuku, e çojnë Dr. Hasan Shkëmbin deri atje sa që në mënyrë metaforike ta krahasojë atë me një trup qiellor të shndritshëm, “Meteor” të pashuar që vezullon e lëviz në sistemin tonë diellor. Shpirti i tij prehet në paqe atje lart në univers.

“VRASJA MORALE”

Drejtuës i Parë Pashk Tusha, ish drejtor i Policisë, Qarku Durrës, ndër të tjera vlerëson se gjatë karrierës së tij në polici nuk ka njohur oficer pasionant, të palodhur, me inteligjencë operative të mprehtë, me njohje në thellësi të Kodit të Procedurës Penale si Artan Cuku. Bazuar edhe në këtë vlerësim të tij, vendimi i Këshillit të bashkisë Durrës për përjetësimin e veprës së dëshmorit Artan Cuku është më se i drejtë. Kjo për faktin se z. Tusha thotë me bindje të plotë se nuk është zbuluar asnjë vepër penale gjatë kësaj periudhe në komisariatit e Durrësit pa mendjen e këtij oficeri.

“Aftësitë e veçanta për marrjen e informacionit, mënyra e menaxhimit të sektorit të Policisë Kriminale dhe përkushtimi për të realizuar detyrën bënë të mundur që Komisariati i Policisë së Durrësit të kishte tregues të lartë në zbulueshmërisë dhe kapjen e autorëve të veprave penale. Disa nga sektorët e Drejtorisë së Policisë së Qarkut, si ato të trafikeve dhe të antidrogës, vlerësoheshin për treguesit e punës edhe falë kontributit të shefit të Policisë Kriminale, Artan Cuku. Në çdo vendngjarje ai ishte gjithmonë i pranishëm, duke e vlerësuar profesionalisht e proceduralisht si një ndër aktet e momentet e rëndësishme për të zbuluar autorët e veprave penale. Profesionalizmi i tij evidentohet edhe me ushtrimin etributeve të Policisë Gjyqësore, pasi në çdo rast bënte një vlerësim të saktë e ligjor të të gjitha provave para se të referonte veprat penale në prokurori”.

Në këtë drejtim, Drejtuesi i lartë i policisë Pashk Tusha nuk kujton ndonjë rast që dosjet e hetuara prej tij Artan Cukut të jenë pushuar, pezulluar apo të jenë kthyer për plotësim hetimesh. Si drejtues policie që ka punuar me të, ai thotë se mund të prezantojë dhjetëra ngjarje kriminale, të cilat janë zbuluar në saj të përkushtimit, sakrificës, kontributit dhe vlerave profesionale të tij. “Ai ishte një bazë e rëndësishme informacioni për

strukturat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës. Vlerat profesionale të tij janë shoqëruar me një karrierë të suksesshme 16 – vjeçare në Policinë e Shtetit.

Pasi kishte kryer suksesshëm të gjitha nivelet e shkollimit e diplomimit, Artan Cuku do të kryente suksesshëm funksione të rëndësishme si: në Seksionin për Hetimin e Krimeve në Komisarriatin e Malësisë së Madhe; Shef i Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisarriatin e Policisë Shkodër; Shef i Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisarriatin e Policisë së Durrësit; Shef i Komisarriatit të Policisë Tropojë; në Berat në Sektorin Kundër Akteve Terroriste; Shef i Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisarriatin Nr.4 të Drejtorisë së Policisë Tiranë; Specialist Drejtimi në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, në Sektorin e Krimeve Kundër Personit në Tiranë dhe në Sektorin Kundër Krimit të Organizuar; Zëvendës drejtor i Policisë së Qarqeve Vlorë, Fier, Berat e Tiranë; Shef i Sektorit Kundër Pastrimit të Parave në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

Drejtor i Policisë Qarkut Vlorë dhe nga fundi i vitit 2013, pas ndryshimeve politike që ndodhën në Shqipëri, Artani u transferua nga Vlora e deri në Qershor 2014 ka punuar në Drejtorinë e Studimeve Strategjike në Policinë e Shtetit derisa u lirua nga policia pa asnjë shkak. Pikërisht në vlerësim të kësaj karriere të shkëlqyer akademike dhe profesionale, Drejtues i Parë Pashk Tusha, ish drejtor i Policisë, Qarku Durrës, shprehet se cilido drejtues policie që ka punuar dhe e ka njohur atë nga afër do të shprehej se ai ishte ‘i lindur polic’. Ndërkohë, sipas z.Tusha, largimi nga radhët e Policisë së Shtetit i Artan Cukut ka qenë jo vetëm i padrejtë, por edhe një vrasje morale, tepër e vështirë për t’u përballuar.

“Ishte një fatkeqësi që karriera 16-vjeçare dhe kontributi i tij në Policinë e Shtetit u ndërpre në vlerësimet e drejtuesve joprofesionistë në emër të reformave në Policinë e Shtetit. Vendime të tilla janë me pasoja shumë të rënda për Policinë e Shtetit në luftën ndaj krimit të organizuar, si dhe për të mbrojtur jetën e karrierën e punonjësve të policisë”, shprehet Drejtuesi i lartë i Policisë Pashk Tusha.

DREJTËSIA

Gazetarja e mirënjohur Klodiana Lala, kurajoze në denoncimin e krimit, është shprehur në emisionin e saj “Në shënjestër” në “Neës 24”,

se vrasja e komisarit Artan Cuku mbetet në sirtarët e drejtësisë. Ajo argumenton se si, vrasja e tij është një nga historitë më të turpshme, se si një oficer policie i suksesshëm, jo vetëm lihet jashtë radhëve të kësaj organizate dhe hidhet në rrugë, sa herë që në Shqipëri pushtetet ndërrojnë kostumet, në të majtë dhe të djathtë, por edhe se si një zyrtar i lartë i kësaj uniforme të nderuar, pavarësisht luftës që ai ka bërë ndaj krimit, lihet pa mbrojtje dhe kthehet në tabelë qitje për grupet kriminale. Dhe, sipas znj. Lala, Artan Cuku ishte jo i vetmi ndër efektivet e lartë të policisë, që i dha jetën dhe përkushtimin e tij luftës kundër krimit të organizuar, dhe që si shpërblim, me të ardhur të majtët në pushtet në vitin 2013, u përzu jashtë radhëve të policisë. Dhe për pasojë u kthye në viktimë të krimit...

“Por edhe pse kanë kaluar 7 vite, kur komisar i lirimi i policisë Artan Cuku u qëllua për vdekje, për shkak të detyrës që kishte mbajtur, ajo që duket se rëndon më shumë sot familjen, është drejtësia e munguar”, shprehet gazetarja Lala. Dhe nuk nguron që të verë gishtin tregues tek vrasësit e vërtetë, duke pohuar se “sipas dosjes hetimore të siguruar nga emisioni ‘Në shënjestër’, vrasja e komisarit të policisë, kishte kohë që ishte organizuar dhe mirëmenduar dhe gjithçka lidhet me arrestimin që Artan Cuku, në atë kohë Drejtori i Policisë Vlorë, i kishte bërë Bledar Jambellit në vitin 2012, i cili më pas ishte betuar që do ta vriste”.

Gjithsesi, familjarët dhe ish miqtë e kolegët e shumtë, besojnë në premtimin e gazetares Klodiana Lala, se emisioni “Në shënjestër” do të përpiqet t’i kthehet edhe njëherë, mbrëmjes së 8 prillit 2017 dhe asaj që njihet tashmë si saga për zbardhjen e së vërtetës së vrasjes së zyrtarit të policisë, Artan Cuku. Në të njëjtën linjë është shprehur edhe gazetari i “Neës 24” Enrik Mehmeti, që sipas tij Artan Cuku në Vlorë njihej si “Drejtori i hekurt”. Edhe gazetarja Anila Hoxha, ndër të tjera shkruan se Tan Cukun e konsideron si privilegj të jetës që pati mundësi ta njihnte... Një burrë trim, i drejtë dhe zemërmadh. Se Tani, pohon znj.Hoxha, nuk heshte për ne dhe këtë ia kam thënë çdo gazetari, sa herë kam mundur.

REAGIMI

Drejtuesi i Parë i Policisë së Shtetit, Artan Cuku, këtë 14 janar do të festonte 50-vjetorin e ditëlindjes, sikur dora kriminale të mos e kish këputur jetën e tij në moshën më të mirë, para 7 vitesh. Me datën 8.4.2017, rreth

orës 20:10, Ai u vra duke hyrë në shtëpinë e tij në “Rrugën e Kosovareve”, Tiranë, fakt për të cilin Prokuroria për Krimet e Rënda kreu hetimet në kuadër të Procedimit Penal nr.139/2017 dhe në përfundim të hetimeve, organi i akuzës ka konkluduar se vrasja e tij është kryer në bashkëpunim, për shkak të detyrës së tij, gjatë kohës kur ushtronte funksionet Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë, krim i parashikuar nga nenet 79/b e 25 të Kodit Penal (“Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”). Më parë 30 shtator 2023 gazetarja investigative Fatjona Mejdini (Drejtoreshë për Ballkanin e “Global Initiative Against Transnational Organized Crime”) ka publikuar në Facebook arsyet e pakuptimita, sipas saj, për vonesën e drejtësisë në çështjen e vrasjes së ish komisarit Artan Cuku. Mejdini thotë se drejtësia nuk është duke bërë asnjë përpjekje për “Dëshmorin e Atdheut” dhe se dëshmitë e rrëfyera në gjyq e kanë nxjerr në pah autorin. Nga ana tjetër, gazetarja tregon dhe detajin, se Bledar Jambellin, autorin e dyshuar të vrasjes e ka ndihmuar një funksionar i lartë shqiptar të mos hetohet, duke qenë se është anëtar aktiv i pakicës greke. ”Sot (30 shtator 2023) piva një kafe me Rakipin, vëllain e Artan Cukut, Kryekomisarit të Policisë të vrarë për shkak të detyrës në Prill të vitit 2017. Rakipit i dorëzova disa kopje të një publikimi të organizatës ku punoj, ku i ndjeri, tashmë i shpallur ‘Dëshmor i Atdheut’, është renditur ndër viktimat kryesore të krimit të organizuar nga e gjithë bota.

Gjashtë vite e gjysmë nga vrasja, Rakipi dhe familja Cuku janë ende duke pritur drejtësinë, të cilën shteti shqiptar ia ka borxh ish-funksionarit të lartë të tij. Dhimbja e tyre shtohet çdo ditë e më shumë, kur shohin se gjykatat dhe akoma më shumë politika, kanë fshehur kokën dhe nuk kanë gjetur guximin të bëjnë transparencë dhe t’i mëshojnë nevojës për të dhënë drejtësi

1. Artan Cuku u hodh në rrugë nga Policia e Shtetit dhe u la i vetëm, në kulmin e karrierës së tij profesionale (42 vjeç), pasi kishte kontribuar për të vënë para drejtësisë shumë kriminelë të rrezikshëm.

2. Gjykimi i autorëve të vrasjes ende nuk ka përfunduar në Gjykatën e Tiranës dhe ndonëse nga provat shkencore dhe dëshmitë, është identifikuar porositi, Bledar Jambelli. Ai është arratisur dhe ende nuk është dënua në mungesë.

3. Shteti grek ka refuzuar ekstradimin e Jambellit me motivimin se ai

është një Vorio-epiriot dhe anëtar aktiv i pakicës greke në Shqipëri dhe se gjykimi ndaj tij, do të ishte politik dhe me karakter hakmarrës ndaj veprimtarisë politike të tij. Asnjë funksionar i lartë shqiptar (ministër i Drejtësisë apo Kryeministër) nuk e ka përmendur publikisht dhe as ka mbajtur qëndrim ndaj këtij fakti.

4. Dëshmitë e fundit të bëra publike nga kolegë gazetarë japin indicie se drejtues të minoritetit grek në Shqipëri kanë pasur rol në mos ekstradimin e këtij krimineli në Shqipëri. Asnjë politikanë nga ata që i mbështesin politikisht këta drejtues të minoritetit grek, nuk ka kërkuar sqarim publik për këto akuza. Mesa duket të jesh dëshmor i këtij vendi nuk vlen dhe aq shumë! Po. Kjo pohohet edhe në dokumentarin e gazetares Etleva Delia, në ‘abc neës’, ‘Gjërat tona/ Gjashtë vjet nga vrasja e komisar Artan Cukut’, ku thuhet me zë dhe figurë se ende (gjashtë vjet pas vrasjes) iniciuesit dhe ideuesit e këtij krimi shëtisin të lirë. Gjithsesi, në këtë ditë përkujtimore, shokët dhe miqtë e tij, deri drejtues të lartë të Policisë së Shtetit, shprehen se janë shumë mirënjohës dhe përuken me respekt para jetës dhe veprës së Artanit, të cilën ai ia përkushtoi me vetëmohim mbrojtjes së jetës së qytetarëve të vendit të vet”, shkruan gazetarja investigative Fatjona Mejдини.

VRASJA

Vrasja e drejtuesit të Parë Artan Cuku është radhitur si një nga vrasjet më të bujshme të shtetit shqiptar në këto njëqind vitet e fundit dhe është përshkruar në librin “100 vrasjet më të bujshme në historinë e shtetit shqiptar (në të gjitha trojet shqiptare)” të autorit Roland Qafoku. Gjithashtu, Artan Cuku është përfshirë në librin me 50 vrasjet më të rënda në botë për arsye shtetërore. Libri titullohet: “Faces os Assassination” (“Fytyra e vrasësve”) i hartuar nga një grup ekspertësh nga e gjithë bota dhe është botuar nga organizata prestigjioze “Iniciativa globale kundër krimit transnacional” (“Global Initiative against Transnational Organized Crime”) me qendër në Gjenevë të Zvicrës. Në këto 50 vrasje janë përfshirë ekzekutime të personaliteteve shtetërore në 40 vende nga e gjithë bota pas vitit 2000, ku njëra nga këto është vrasja e Artan Cukut. Figura dhe personaliteti i Artan Cukut është përshkruar edhe në librin: “Personalitetet e Dibrës (Enciklopedia e Dibrës 3)”. Për Artan Cukun pas vdekjes janë shkruar dy libra: “ARTAN CUKU In memoriam” ideuar dhe përgatitur

nga ish-drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Ahmet Prenci në bashkëpunim me gazetarë, politikan, ish-pedagog, ish-epror, ish-kolegë të Artanit etj., si dhe “Jam pri’ Lure” të autorit Fatos Daci.

Gjithashtu, është realizuar edhe dokumentari me titull: “In memoriam Artan Cuku”, realizuar nga Ardita Bala dhe Verjana Abazaj. Për Artanin kanë shkruar dhe kanë folur personalitete të shumta të fushave të ndryshme duke vlerësuar lart figurën e tij, si dhe kanë shprehur qartë dhe fort indinjatën e hidhërimin e thellë për atë që ndodhi.

NDERIMI

Afro tre vjet më parë (10 prill 2022) Pallati i Kulturës Kamzë mori emrin e ‘Dëshmorit të Atdheut’, Artan Cuku. Kryebashkiaku Rakip Suli thotë me krenari se nismës së Policisë së Shtetit për përjetësimin e policëve të rënë nga dora e krimit, iu përgjigj e para Bashkia Kamzë, duke ndërmarrë këtë hap, për vendosjen e emrit të Pallatit të Kulturës “Artan Cuku” dhe shpalljen e tij “Qytetar Nderi i Kamzës”.

Në ceremoninë e zhvilluar morën pjesë ministri i Drejtësisë, Z. Ulsi Manja, kryetari i Bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu, dhe ish-Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, z. Gledis Nano. Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, tha se Dëshmorët e Atdheut janë pjesa më e ndërgjegjshme e vendit dhe se nuk duhet të ketë më policë të vrarë.

Emri i Artan Cukut, i skalitur me germa të arta në fasadën e këtij institucioni të rëndësishëm kulturor, është evident në çdo aktivitet, shfaqje tetrale e promovimi librash, i skalitur edhe më mendjen e zemrat e dhjetëra mijëra spektatorëve që i ndjekin këto shfaqje. Teksa ndodhem mes tyre, më vijnë ndërmend vlerësimet e kolegëve dr. Hasan Shkëmbi e Gëzim Loka, të cilët në artikujt e tyre e kanë vlerësuar “Dëshmorin e Atdheut”, Artan Cuku, si meteorin që s’do shuhet kurrë, krenari të Lurës dhe të gjithë Shqipërisë.

Komisar Artan Cuku, do të nderohej në 112- vjetorin e Policisë së Shtetit më 13 janar, ndërsa sot më 14 janar 2025 do të festonte ditëlindjen e 50-të, i rrethuar jo vetëm nga familja e tij, por edhe nga miq e shokë të shumtë.

Jo vetëm nga Lura ku lindi, u rrit, kaloi fëmijërinë e nga ku mori shkollimin bazë, por edhe Tirana, Shkodra, Tropoja, Vlora, Fieri, Berati e

pothuajse nga e gjithë Shqipëria. Kjo për faktin se Ai mbetet në kujtesën e çdo punonjësi të policisë dhe çdo njeriu që e ka njohur e punuar me të, si simbol i vlerave të larta njerëzore, inteligjencës, besnikërisë, moralit të lartë, si drejtues i talentuar i Policisë, intelektual me vlera, vendimmarrës kurajoz dhe me performancë të lartë.

Artan Cuku prehet në varrezat e Dëshmorëve të Kombit dhe ndër breza, në vite, dekada e shekuj, do të shërbejë si shembull frymëzimi se si duhet të jenë shërbëtorët e shtetit shqiptar. Burrat si Tan Cuku i rrisin vlerat dhe prestigjin shtetit...

ADEM ISLAM HOXHA, HEROI I REZISTENCËS NDAJ AGRESIONIT GREK TË 2 GUSHTIT 1949

- Kush ishte centralisti i postës kufitare “Guri” të Kapshticës Adem Islam Hoxha që e bindi komandantin e Postës kufitare të Vidohovës për të hapur zjarr, me iniciativë, pa urdhër nga lart, në mbrojtje të kufijve të atdheut nga agresioni i monarko-fashistëve grekë më 2 gusht 1949?



*Adem Hoxha, Ventotene,
qershor 1940*



*Adem Hoxha dhe Arif
Pitarka – gusht 1949*

NGJARJA E 2 GUSHTIT 1949 NË VIDOHOVË GREQIA SULMOI PAS 8 MUAJ PROVOKACIONE USHTARAKE NË KUFİ

Dokumentat arkivore, por edhe dëshmitarë okularë vërtetojnë se në sulmin e 2 gushtit 1949, grekët përdorën kundër Shqipërisë ushtrinë me topa, avionë, ushtri tokësore e gjithçka që përdor çdo ushtri që synon

të pushtoj një vend tjetër. Ushtria shqiptare iu kundërpërgjigj sulmit pushtues grek, me luftë të armatosur, në mbrojtje të kufijve e trojeve që u sulmuan. Ishte një luftë e përmasave dramatike. Ndërsa Greqia vërsuli drejt Shqipërisë mbi 70 mijë forca të armatosura, mbi 50 avionë, 80 tanke dhe një skalion artilerie me afro 400 gjuajtës, kryesisht topa, shteti shqiptar mobilizoi dhe futi në luftën mbrojtëse 10 mijë ushtarë, ndërkohë që po mbante në gatishmëri edhe 30 mijë trupa të tjerë pranë zonës së sulmuar.

Kufiri shqiptar ishte bërë prej vitesh arenë e provokacioneve të shkaktuar nga shtetet fqinje, për qëllimet e tyre agresive apo pretendimet territoriale ndaj Shqipërisë. Viti 1949 është i veçantë. Vetëm gjatë këtij viti në kufijtë shqiptare u bënë gjithsej 747 provokacione të llojeve të ndryshme (tokësore, ajrore e detare), nga të cilët 612 në kufirin me Greqinë (303 tokësore, 299 ajrore e 10 detare); 130 në kufirin me Jugosllavinë (57 tokësore, 69 ajrore e 4 detare) dhe 5 (ajrore) në sektorët bregdetare me Italinë. Të gjitha këto provokacione, u paraprinë edhe nga një propogandë e shfrenuar që bënin vendet fqinje kundër Shqipërisë, veçanërisht në sektorët e Jugut. Ata jo vetëm hidhnin në territorin shqiptar libra, broshura e gazeta me thirrje kundër pushtetit popullor në Shqipëri, por arritën deri atje sa të fabrikonin dhe përhapnin trillime, sipas të cilave rreth kufirit shqiptar ishin krijuar baza, prej nga ku furnizoheshin partizanët grekë në luftën kundër andartëve (forcave të ushtrisë demokratike greke). Robërit grekë të kapur nga Forcat e Kufirit Shqiptar, pohonin gjithashtu edhe përgatitjen psikologjike që u bëhej ushtarëve grekë për një sulm të afërt ndaj Shqipërisë.

Provokacionet greke në kufirin me Shqipërinë, arritën kulmin e tyre më datë 2 gusht 1949, kur forcat e tyre ushtarake organizuan dhe kryen sulmin e armatosur kundër rojeve kufitare shqiptare në sektorin e Devollit, duke shkelur kështu edhe integritetin territorial të RPSH-së. *“Veprime të tilla na kujtojnë metodat e nazistëve gjermanë dhe të fashistëve që krijojnë incidente në kufijtë me fqinjët e tyre me qëllim presioni e kërcënimi, për të krijuar pasiguri e armiqësi në mes të popujve ose për t`u hapur rrugë veprimeve më të gjera agresive”*, shkruante ndër të tjera në kryeartikull, gazeta *“Zëri i Popullit”* në atë kohë, duke u prononcuar forcërisht për ngjarjet e 2 gushtit, në kufirin shqiptaro-grek.

HEROI I REZISTENCËS NDAJ MONARKOFASHISTËVE GREKË

Më 2 gusht 1949, do të ishte një centralist i thjeshtë nga Çidhna e Dibrës urdhëruesi i hapjes së zjarrit ndaj provokatorëve monarkofashistë grekë në kufirin shqiptar të Kapshticës. Adem Hoxha, centralist i postës kufitare në Kapshticë të Devollit, kishte radhën e shërbimit të gatishmërisë luftarake në natën e datës 1 (një) gusht duke u gdhirë 2 (dy) gusht i vitit 1949, kur rreth orës 02:00 të mëngjesit të datës 2 gusht 1949, ra zilja e telefonit.

Mori receptorin dhe nga ana tjetër, personi që i fliste, u prezantua se ishte komandanti i Postës kufitare të Vidohovës.

Për momentin emri i tij nuk më kujtohet, – tregonte Ademi, – por mbaj mend se ai ishte një djalë i ri rreth të njëzet e dy-tre vjetëve, të cilit, sapo kishin filluar t’i dirsin mustaqet. (Sipas bashkëkohësve, ai duhet të ketë qenë Memo Nexhipi Bejko, – pak çaste para se të binte dëshmor, i cili më pas është shpallur “Hero i Popullit”).

Kur Komandanti i postës së Vidohovës, z.Memo Nexhipi Bejko i ka kërkuar centralistit Hoxha që ta lidhte me komandantin e regjimentit, Ademi, iu përgjigj se “Komandanti i regjimentit në këtë orë është në shtrat, duke fjetur në shtëpinë e tij, në Korçë. Ai nuk ka telefon në shtëpi.”

Më pas komandant Memoja i ka kërkuar kufitarit nga Dibra që ta lidhte me Ministrinë e Mbrojtjes, por sërish ka marrë përgjigje refuzuese:

“Përderisa nuk mundem me të lidhur me Korçën, si mundem me të lidhur me Ministrinë në Tiranë?! Ne nuk kemi lidhje me radio, por vetëm një central të thjeshtë, me tel !”,-i është përgjigjur Adem Hoxha. Dhe në kushtet kur forcat greke kishin shkelur 500 metra në territorin tonë kufitar, komandant Memoja, i zënë ngushtë i ka kërkuar një mendje centralistit nga Dibra se si duhej të vepronte.

-Zjarr!, – i është përgjigjur Ademi.

-Si të hap zjarr?! Me urdhër të kujt të hap zjarr?!, – i tha komandanti i postës së Vidohovës.

-Me urdhërin tim! – i është përgjigjur rrufeshëm kufitar Ademi.

-Si me urdhërin tënd?! – ka vijuar komandanti?!!

-Po të them: Me urdhërin tim! Kur forcat greke do të të vijnë te posta,

ti a do t'u japësh cigare e duhan dhe t'ua ndezish me shkrepse me dorë në zemër?! Zjarr mbi agresorët, se vetëm kështu mbrohet Atdheu!

Vetëm këto ishin fjalët e fundit që këmbyen komandant Memoja dhe centralisti Adem Hoxha ndërmjet tyre, në mëngjesin e 2 gushtit 1949, para se të fillonte lufta mbrojtëse në Vidohovë kundër agresionit të monarkofashistëve grekë të 2 gushtit 1949.

Pra, e thënë ndryshe, urdhërin luftarak për fillimin e zjarrit të parë, të pushkëve të para në Vidohovë me 2 gusht 1949 e ka dhënë, me inisiativën e vet, një ushtar i thjeshtë dibran, Adem Islam Hoxha, ish-centralist i postës kufitare të Kapshticë -Vishocicës. Më saktë, me atë arsytim logjik të pjekur, tepër bindës, në ato rrethana të jashtëzakonshme bindi me të drejtë komandantin e Postës së Vidohovës për të hapur zjarr mbrojtës kundër agresionit të monarkofashistëve grekë, më 2 gusht 1949, në atë situatë të nxehtë luftarake.

Një arsytim i tillë, si ai i Adem Hoxhës, është tepër bindës dhe i drejtë edhe tani, pas 75 VITESH, në kohë paqeje dhe në një situatë tjetër marrëdhëniesh krejt të ndryshme nga ajo e asaj kohe, kur Shqipëria dhe Greqia janë të dyja shtete anëtare të NATO-s (ndonëse Greqia vazhdon të bajë ende në fuqi Ligjin absurd të Luftës me Shqipërinë).

Nuk mund të kishte asnjë zgjidhje tjetër, përveç asaj të Adem Hoxhës, të mëngjesit të 2 gushtit 1949: për të hapur zjarr mbi agresorin.

Kjo është një e vërtetë historike, ndonëse e pashkruar ndokund, ashtu si shumë të vërteta të tjera të pashkruara të historisë së popullit shqiptar, e rrëfyer qartë nga protagonistin e kësaj ngjarjeje në vitin 1993, kur ishte në moshën 76 vjeçare.

ÇFARË SHKRUANTE “ZËRI I POPULLIT”MË 6 SHTATOR 1949

Akti heroik i çidhnakut Adem Hoxha jepet fare qartë, qoftë dhe nga një fragment i reportazhit të të dërguarit të posaçëm të “Zërit të Popullit”, Dhimiter Tona, me titull: “Në piramidën 33, në sektorin e Bilishtit”, botuar më 6 shtator 1949. Ndër të tjera në të shkruhet: “...Centralisti ndërlidhës, Adem Islam Hoxha nga Çidhën e Poshtëme i Dibrës, në mes mijëra predhash të artillerisë armike, ku s'mbeti pëllëmbë toke pa u qëlluar, ka kryer me heroizëm detyrën e tij: tri herë natën u këput linja, por të tri herët ai e lidhi përmes zjarrit të artillerisë dhe breshërit të plumbave të

mitralozit. ‘Në luftën NCÇI-thotë ushtari Adem Hoxha, i dekoruar me Medaljen e Trimërisë,- nuk pata fat të luftoja kundër armikut, tashti jam edhe unë kryelartë midis shokëve të mij se kam luftuar ashtu si vëllezërit e mij dje për çlirimin e Atdheut; sot unë luftova për mbrojtjen e tij nga monarkofashistët grekë që duan ta skllavërojnë popullin tonë dhe të sjellin në fuqi armiqtë tanë....’.

KUSH ISHTE ADEM HOXHA?

Njëqinte shtatë vjet më parë, më 9 janar 1917, në Çidhën të Dibrës lindi Adem Islam Hoxha, emri i të cilit hyri në historinë e kombit për aktin e pashembullt heroik në rezistencën ndaj monarkofashistëve grekë, gjatë provokacioneve të njohura të gushtit të ‘49.tës. I mbetur jetim që 6 muash, pasi babai Islami dhe nëna, Lihja i vdiqën nga epidemia e tifos e vitit 1917, Ademi do të rritej dhe edukohej nga gjyshi i tij, Abdurrahmani (Hoxhë Kuta). I njohur me titullin “Hoxha i 12 mijëve” në Shehër të Thatë, njëri ndër udhëheqësit popullor për organizimin e rezistencës të krahinës të Çidhnës e të mbarë Dibrës kundër pushtuesve serbo-sllavë në fillim të shekullit XX (gjatë viteve 1912-1920), do të përkujdesej që këto virtyte t’i mishëronte edhe nipi, Ademi. Edukimin e parë atdhetar me dashurinë për atdhe dhe urrejtjen kundër armiqve pushtues e mori qysh në moshën 3-vjeçare, në vitin 1920, në kohën e pushtimit serb për të shpëtuar nga masakrat e pushtueseve, kur për tre muaj rresht u strehua në një shpellë në Gjalica të Çidhnës, në një kohë që pjesa tjetër e popullsisë së Dibrës u shpërngul drejt Tiranës, ashtu si në vitin 1913. Që nga ajo kohë, dhe sot e kësaj ditë, ajo quhet “Shpella e Hoxhës”. Në vitin 1940 për veprimtari atdhetar antifashist, u burgos nga pushtuesit italianë dhe u internua më pas në kampin e përqendrimit nazifashist në Ventotene të Italisë ku u dënua me 2 vjet dhe qëndroi nga janari 1940 deri në dhjetor 1941. Ky fakt vërtetohet edhe nga regjistri që gjendet pranë Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, Tiranë në faqen nr.3 të të cilit me nr.rendor 21, z.Adem Hoxha (atëherë Kuta) figuron të ketë qenë i internuar prej nazifashistëve në kampin e përqendrimit në Ventotene, Itali, prej datës 11.02.1940 deri në dhjetor 1941, duke mos u përfshirë këtu koha e paraburgimit në Peshkopi, para transferimit në Itali dhe ajo e qëndrimit prej 24 ditësh të tjera në burgun

e Barit në Itali.

Në kampin nazifashist të Ventotenes Ademi u njoh dhe u miqësua me atdhetarë të tillë, udhëheqës të rezistencës shqiptare kundër pushtuesve nazifashistë, si Nazmi Rushiti, Sadik Bekteshi, Ibrahim Dervishi, Abdyl Këllezi, Zef Mala etj. apo dhe me nacionalistët Safet Butka, Abas Ermeni, Prof.Isuf Luzaj etj. Shoqëria dhe miqësia e tij me figura të tilla, ia rriti Ademit eksperiencën dhe pjekurinë politike.

Në dhjetor 1947, Adem Hoxha, nga Çidhna, Dibër, kur i kishte kaluar 30 vjeç, u mobilizua për të kryer shërbimin ushtarak të detyruar në Qarkun e Korçës, (gjatë viteve 1947-1950), prej të cilëve, dy vjetët e fundit në kufi, në Bilisht. Pra, në kohën kur dha urdhërin luftarak për të hapur zjarr mbi forcat agresive të monarkofashistëve grekë, Ademi i kishte të gjitha cilësitë dhe aftësitë si dhe ngritjen ideo politike dhe përgatitjen ushtarake për të komanduar e për të dhënë një urdhër luftarak me peshë të tillë që ishte vendimtar për fatet e atdheut.

Adem Hoxha, i biri i Islamit dhe i Lihes (1917-1993), nga Çidhna, Dibër, luftëtari i vijës së parë të frontit të luftimeve për mbrojtjen e kufijve të Atdheut tonë nga provokacionet e monarkofashistëve grekë në gusht të vitit 1949, ishte tepër modest, ndaj nuk ka lënë kujtime të shkruara, por vetëm këto rrëfime gojore që nuk na shqiten lehtë nga kujtesa.

Për aktin heroik ish centralisti dibran i postës kufitare “Guri” në Kapshticë të Devollit, Adem Hoxha është dekoruar me “Medaljen e Trimërisë”. Kjo vërtetohet me certifikatën e lëshuar nga ish Presidiumi i Kuvendit Popullor të RSH me nr.6749 dhe nr.i Dekretit 911, datë 23 gusht 1949 që mban nënshkrimin e ish-Presidentit Dr.Omer Nishani dhe të ish-Sekretarit Sami Baholli. Në këtë Medalje është shënuar ky motivacion: “Gjatë luftimeve për mbrojtjen e kufijve t’Atdheut në sektorin e Trestenikut nga agresioni i monarko-fashistave grekë, është dalluar për trimëri, vendosmëri e besnikëri”. Kjo certifikatë është një argument tjetër më shumë që vërteton katërcipërisht se Adem Hoxha ka qenë i saktë në rrëfimet e tij të para dy dekadave. Përpos kësaj, autoriteti i tij i padiskutueshëm në jetën civile, kur ka shërbyer mbi 60 vjet si imam, drejtues fetar dhe shoqëror, nuk lë asnjë shteg për asnjë fije dyshimi mbi të vërtetën e tregimeve të tij për organizimin e rezistencës ndaj provokacioneve të monarkofashistëve grekë të 2 gushtit 1949.

Si bashkëbisedues i para dy dekadave ruaj në memorien episode të rrëfyera mjeshtërisht nga Ademi për Provokacionet e 2 gushtit 1949. Shpesh herë ai thoshte se jetën në atë luftë ia ka shpëtuar ish- Komandanti i Regjimentit, z.Baki Starja. “Gjatë luftimeve unë kisha detyrë që të mbaja ndërlidhjen me central fushor, të lëvizshëm, atje ku zhvilloheshin luftimet. Pozicioni i centralit nuk mund të ndryshohej pa urdhërin e komandantit. Në një moment të caktuar, gjatë luftimeve ra një predhë murtajë e armikut vetëm disa metra larg, ngjitur me pozicionin ku unë kisha vendosur centralin. Pranë meje ndodhej edhe z.Baki Starja, më vonë gjeneral. Fill pas atij momenti, komandant Bakiu më urdhëroi: Adem, shpejt spostoje centralin mu në gropën që hapi predha e murtajës së armikut. Sapo unë instalova aparaturën e telefonit në vendin e caktuar, vetëm disa sekonda më pas, ra predha e murtajës së armikut, pikërisht në vendin ku unë pata më parë pozicionin e centralit. Po të mos kisha ndërruar pozicionin e instalimit të centralit, unë do të isha vrarë në atë luftë,” – tregonte Ademi, duke shprehur njëherësh edhe respektin dhe mirënjohjen për Gjeneral Baki Staren që ka qenë oficer madhor në Provokacionet e gushtit 1949. Gjatë një takimi të rastësishëm, gjenerali në pension, Baki Starja, jo vetëm ma konfirmoi plotësisht atë çka treguam më sipër, lidhur me spostimin e centralit fushor, por pasi më shprehu edhe konsideratën e lartë dhe kujtimet që ruante për ish-ushtarin e tij 32-vjeçar, nga Dibra, bashkëmoshatarin Adem Hoxhën, më tregoi edhe arsyen e dhënies së atij urdhëri, d.m.th. eksperiencën e tij luftarake.

RRËFIMI I GJENERAL BAKI STARJES

Gjeneral Baki Starja që kishte kryer shërbimin e detyruar ushtarak në kohën e luftës Italo-Greke, kujton gjithashtu kohën kur ka qenë i mobilizuar në repartin e ushtrisë shqiptare dhe shoqërinë me bashkëushtarin Vesel Bushi (Spata) nga Bllicja e Peshkopisë nga. Nga përvoja e asaj lufte ata kishin mësuar se ushtria greke, artilierët i kishte ushtarë të karrierës me rrogë dhe jo rekrutë të shërbimit të zakonshëm të detyruar. “Artilierët grekë, si profesionistë të kualifikuar, predhat e artilerisë nuk i shpërdoronin, prandaj ata nuk shenjnin me gjuajt dy herë në të njëjtin vend, por për çdo qitje e lëviznin gradimin e shenjimit, për të mos rënë dy predha radhazi në të njëjtin vend. Duke ditur këtë eksperiencë, unë e urdhërova Ademin

që menjëherë të spostonte instalimin e aparaturës së centralit pikërisht në vendin kur ra predha e mëparshme, pasi e dija se aty ishim të sigurtë nga goditjet e armikut”,-tregon gjeneral Starja. Ndërsa centralisti Adem Hoxha, me krenari pohonte faktin që të gjithë ushtarët dibranë që morën pjesë në luftimet kundër provokacioneve të gushtit, shkëlqyen, duke u dalluar ndër të tjerët. Kjo sipas tij edhe për faktin se asnjë ushtar dibran nuk u largua nga pozicioni i luftimeve, ku e kishte caktuar komanda, por të gjithë ata, në përfundim të luftimeve u gjetën në vijën e parë të frontit. Kjo, ndoshta, u bë shkak që më pas dibranët të shiheshin me një sy tjetër më të mirë, nga komanda, ndryshe nga më parë, pasi deri para provës që dhanë në luftime, ata shiheshin si të dyshimtë, për shkak të luftës që qe bërë në Fushalie të Dibrës, në korrik të vitit 1944. E thënë ndryshe, luftimet e provokacioneve të gushtit 1949 u bënë shkak që të rehabilitoheshin dibranët. Në këtë aspekt, ndër më të dalluarit, përveç oficerëve Bajram Hysen Kovaçi (gazetar dhe shkrimtar i njohur) e Isuf Daci, nga Grykë-Noka, ai kujtonte edhe Arif Pitarkën po nga Grykë-Noka, që shërbente në postën e Vidohovës, si dhe të tjerët nga reparte të tjera si Fali Konozi nga Grykë-Noka, i plagosur, Sulë Daci po nga Grykë-Noka, Sali Pana nga Kodër-Leshej (i plagosur); të gjithë të dekoruar me “Medaljen e Trimërisë” etj.

Ndër shokët dhe kuadrot drejtues të rezistencës kundër agresionit të provokacioneve greke të 2 gushtit '49, Ademi ruante respekt të veçantë për kolonel Skënder Malindin. Kjo edhe për faktin se kolonel Malindi, i sapo kthyer nga Akademia Ushtarake e Bashkimit Sovjetik, në vitin 1947, e konsideronte Ademin jo si ushtar të thjeshtë, por si shok, të barabartë me të. Ndaj dhe organizatorët dhe pjesëmarrësit e asaj rezistence të pashembullt ndaj agresionit të monorkofashistëve grekë, meritojnë nderim të veçantë.

BAFTJAR RUSI, NJË EMËR I MADH I DREJTËSISË SHQIPTARE

- Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet dhe partnerët e tij ndërkombëtarë Amerikanë dekoron një emër të madh në radhët e drejtësisë shqiptare



- I vlerësuar me titujt “Misionar i Paqes Botërore”, “Ambasador Nderi”, si dhe me Medaljen e Artë “Urdheri i Misionarit të Paqes Mahatma Gandhi”, Baftjar Rusi qëndron stoik në vitalitetin e dibranit, njeriut me vlera të larta morale të integruar në jetën moderne, të një njeriu që shpreh pa droje pozicionin e tij të pandarë nga historia jonë e përbashkët e një tranzicioni social – psikologjik ende të pambyllur

Në fund të viteve 80, kur sapo ishte diplomuar për gjuhë-letërsi, erdhi që nga Saranda mësues në gjimnazin e Bulqizës, publicisti dhe prozatori Shefki Hysa. Këtu, të parët që do ta mbështesnin mësuesin jabanxhi, genë vëllezërit nga Homeshi, Demir e Baftjar Rusi, njëri shef i Shtëpisë së Ushtrakeve Bulqizë dhe tjetri sekretar i Komitetit të Rinisë të rrethit Dibër.

Dy vëllezërit që kishin bërë emër edhe si gazetarë e poetë, mbështetjen për Shefkium e patën të pakushtëzuar e të pakursyer edhe për faktin se me reportazhet e tij në “ZP” e “Zëri i Rinisë”, sarandioti i miqësuar shumë shpejt me bulqizakët po pasqyronte më së miri jetën dhe problematikat e qytetit minator të Bulqizës. Dhe kjo miqësi e pandarë midis tyre do të farkëtohej në vite e dekada, kur të tre, Shefkium, Demiri dhe Baftjari bënë emër edhe në mëtroplin shqiptar, jo vetëm si poetë, publicistë e prozatorë por edhe në profesionet e tyre të mirëfillta.

I vendosa këto radhë si hyrje për të mbrritur te ngjarja kulmore e miqësisë së tyre. Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet dhe partnerët e tij ndërkombëtarë Amerikanë – një institucion prestigjioz ndërkombëtar ky me President Shefki Hysën, ka nderuar avokatin e mirënjohur Baftjar Rusi me titujt “Misionar i Paqes Boterore”, “Ambasador Nderi”, si dhe me Medaljen e Artë “Urdheri i Misionarit te Paqes Mahatma Gandhi”.

DY ISH KRYETARË TË KUSHTETUESËS VLERËSOJNË KARRIERËN E SHKËLQYER TE BAF TJAR RUSIT

Në ceremoninë e organizuar nga Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet dhe partnerët e tij ndërkombëtarë, ku merrte pjesë dhe Dr. Madhu Krishan, të shtunën më 11 maj 2024, personaliteti i Drejtësisë Shqiptare, *Dr. Baftjar Rusi* u vlerësua me motivacionin: *“Për angazhimin e madh dhe kontributin e çmuar në fushën e Jurispudencës, Arsimit, Qytetërimit, Politikës, Administratës Publike, Paqes, Prosperitetit dhe Njerëzimit, për frymëzimin e bashkëjetesës shoqërore dhe paqes ndërkombëtare”*,

Ky vlersim është plotësisht i motivuar për Baftjar Rusin si: *Avokat i Suksesshëm Shqiptar; si Doktor i Shkencave në Jurispudencë; si autor i librave dhe artikujve kërkimor në fushën e Drejtësisë, të Shëndetit të Jetës, Shëndetit Mendor dhe Shkencave Juridike; si Pedagog mësimdhënës; si Avokat Përfaqësues në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut’ Si Avokat në Gjykatën e Strasburgut dhe Gjykatën Ndërkombëtare Penale në Hagë; si personalitet i nderuar me shumë çmime kombëtare dhe Ndërkombëtare; si Misionar i Paqes Botërore; si Aktivist i Njohur i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut; si filantrop dhe Ambasador Nderi i DMPP; si Promovues i Misioneve të Ardhshme që sjellin Paqen dhe Prosperitetin për mbarë Njerëzimin etj.*

Këto merita të Baftjar Rusit marrin vlerën dhe dimensionin e duhur

kue në një event të rëndësishëm si ky evidentohen edhe nga personalitete të njohura të jurisprudencës, si nga dy kryetarët e Gjkatës Kushtetuese Fehmi Abdiu e Bashkim Dedja, nga kryetarja e bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri, apo dhe nga Prof. Dr. Sulejman Abazi NESHA.

Bashkim Dedja, një ndër përfaqësuesit më dinjtozë të elitës dibrane në metropolin shqiptar e më gjerë, që i ka ngjitur me meritë shkallët e karrierës deri në krye të institucionit më të lartë të drejtësisë shqiptare, vlerëson se për Z. Baftjar Rusi, nuk do mjaftonin artikuj, emisione televizive apo seri romanesh, për të nxjerrë në pah të gjithë vlerat e tij shumëdimensionale.

“E vlerësoj shumë, në radhë të parë si një prind e familjar i mirë e i përkushtuar; si një shok e mik i rrallë e me vlera të padiskutueshme; si një profesionist drejtësie i përgatitur e këmbëngulës i pashoq në arritjen e rezultatit; si një bamirës e filantrop që rrallë e gjen në realitetin shqiptar, si një studiues e akademik në ngritjen e nivelit të tij profesional e intelektual dhe në përçimin e dijeve e njohurive të tij tek të tjerët, si një bashkëpunëtor e bashkëbisedues i palodhur me një durim deri në ekstrem, që i bën nder dhe krenari vendlindës së tij, Dibrës, Shqipërisë dhe shqiptarëve kudo që ndodhen e kujtdo që i ndodhet pranë”, shprehet Z. Dedja..

BAFTJAR RUSI NJË EMËR I MADH NË RADHËT E DREJTËSISË SHQIPTARE

Prof. Dr. Sulejman Abazi NESHA – Doctor Honosis Causa për Sigurinë dhe Paqen, Profesor Nderi i ABP dhe UBP, Nev York, që mban Medaljen e Artë “Gjenerali Paqes Ajzenhauer” në fillim të fjalës së tij u shprehu mirënjohje Guvernatorit Dr. Shefki Hysa, dhe Dr. Madhu Krishan për zgjedhjen më të mirë për të akorduar këtë titull kaq të lartë Ndërkombëtar, duke e dhënë për herë të parë në Shqipëri, pikërisht njeriut të merituar, dibranit dhe shqiptarit të mirë, Dr. Baftjar Rusi. Sepse personaliteti i tij është një vlerë e shtuar e Misionit Diplomatik për Paqe e Zhvillim, e Korpusit të Madh të Njerëzve të Paqes në Botë, e atyre njerëzve që jetën e tyre ia kanë përkushtuar Drejtësisë, Lirisë, Paqes dhe Humanizmit njerëzor.

Ndryshe nga disa prezantime tashmë tradicionale në ceremonitë e dekorimeve të DMPP-së, Prof. Dr. Sulejman Abazi NESHA ,këtë herë prezantoi para këtij auditori të jashtëzakonshëm një trajtim disi më

ndryshe në shpalosjen e vlerave të një personaliteti, të një burri dibran, një shqiptari të mirë, që si shumë të tjerë në këtë vend, përballoi gjithçka që shkarkoi presioni i kohës së ndryshimeve mbi brezin dhe brezat me vështrimin nga jeta, liria dhe shpresa. Ai e konsideoi Baftjar Rusin një emër të madh në radhët e drejtësisë shqiptare, në fushën e Avokatisë.

Në një radhitje dhe rendje plotë merita e modesti, e cila na kujton se kemi shumë për të bërë dhe për të promovuar me merita të plota personalitete të veçantë të jetës shqiptare, prof.Sulejman Abazi NESHA nënvizoi vendosmërinë intelektuale që e ka shoqëruar personalitetin e Baftjarit nga mosha e re e deri më sot. Ai vjen në realitetin e kohës, duke pasur mbi supet e tij peshën e viteve të punës dhe të profesionit të vështirë.

“Përtej të zakonshmes, Doktor i Shkencave të Jurisprudencës shqiptare tashmë si një jurist – avokat me kulturë të ndërthurur evropiane, kaloi në rrugën e vështirë të aktivitetit shoqëror dhe politik në qarkun e Dibrës, të arsimimit dhe kualifikimit në Universitetin e Tiranës, dhe më tej si mësimdhënë, për t’u vendosur përfundimisht në Tiranë pa shkëputur asnjëherë lidhjet me vëndlindjen. Nga viti 1995 e deri më sot, vazhdon të ushtrojë profesionin e Avokatit të dëgjuar dhe respektuar në Shqipëri. Autor i botimit “*Mbi të Drejtën*” ai ka treguar se është një studiues dhe mik i shtrenjtë për librin, duke rritur cilësinë e tij profesionale përmes mbrojtjes së qindra çështjeve për vepra penale e civile deri në gjykatat Ndrërkombëtare në Hagë dhe Strasburg. Një rrugëtimin sfidant përmes shumë vështirësive për të arritur majat, ku përveç seriozitetit, drejtësisë dhe ashpërsisë së profesionit ai ka gjetur rrugën e refletimit të dashurisë njerëzore, larg urrejtjes, i mbështetur në optimizmin karakteristik të njerëzve të fortë, që jeta u ka mësuar të bëhen pjesë e të mirës dhe të distancohen nga ligësia, hipokrizia, duke formuar gradualisht një anë të tjerë të karakterit dhe personalitetit të tij, shpirtin human dhe paqësor”,-dha ndër të tjera Prof. Sulejman Abazi NESHA . Kjo, sepsë këtë anë të karakterit të tij Baftjari e shfaqti në punë, por e shfaqti edhe në familje, si një prind shëmbullor, shok e bashkëshort i mirë, mik i madh i njerëzve të afërt dhe kolegëve me një status të qëndrueshëm intelektual në standardet evropiane. Më tej Prof. Sulejman Abazi NESHA evidentoi mendimet dhe vlerësimet për avokatin Rusi, të këtij dibrani me botë të madhe, që rrokin një dimension të gjerë, dhe këtë e kupton kur je afër dhe bashkëbisedon me të.

MISHËRUES DHE PËRÇUES I VLERAVE MË TË MIRA NJERËZORE DHE INTELEKTUALE

Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet dhe partnerët e tij ndërkombëtarë ka të drejtë në këtë vlerësim për Njeriu patriot që e do shumë atdheun e tij Dibrën dhe Shqipërinë, që shfaqet me tabanin popullor, duke reflektuar fisnikërinë e origjinës prindërore, të njeriut modern dhe të civilizuar, juristin dhe avokatit e vendosur për të mbrojtur dhe për të dhënë drejtësi njerëzve të shantazhuar nga struktura konjukturale të drejtësisë.

Drejtësia në thellësi të shpirtit të tij njerëzor dhe human reflekton siguri, paqe dhe mbështetje, kundër komplekseve dhe paragjykimeve të jetës tonë të traumatizuar nga pasojat e kohës. Është kjo drejtësi e thellë brenda shpirtit të Avokatit, që kërkon në vijimësi zgjimin dhe rizgjimin e energjive pozitive për të përcjellë në opinion një mesazh shprese dhe rilindje të vërtetë morale e shpirtërore.

Po, po, të gjithë e ndjejmë se kemi shumë nevojë për këtë. Brenda një portreti të thjeshtë në pamje por shumë vital në vullnetin e tij të imponimit, komunikimit, të njohjes dhe të sjelljes, të vendimmarrjes mbi drejtësinë, shpaloset figura humane e paqësore e Dr. Baftjar Rusit.

Luftëtari kundër së keqes që po vazhdon të dhunojë dhe trishtojë jetën tonë, kundër padijes dhe korrupsionit, kundër pangopësisë dhe politikës mecece kur është fjala për drejtësinë e munguar, ky realiteti i dhimbshëm është objekt i qëndrimit të palëkundur të Avokatit të Nderuar, kundër klaneve, ndërhyrjeve, presioneve, anatamimeve për shkak të konfliktit të interesave, për ta bërë atë pjesë të drejtësisë së munguar dhe të padrejtësisë. Nuk ia kanë dalë.

Shokët, miqtë dhe kolegët e tij tregojnë: Nëse do të jesh në bisedë me Baftjarin, do të kuptosh menjëherë se në mendimet e tij dallon vlerësimi për jetën e njeriut të dominuar përherë nga barbaria, kaosi, dhuna, por dhe mirësia dhe dashuria. Gjithmonë kundër së keqes do të gjendjen hapësira për t'i dhënë formë shpresës.

Kur flet me të, – vijoi Prof. Dr. Sulejman Abazi NESHA , të krijohen imazhe të qarta mbi atë që ai mendon për traditat, realitetin e sotëm dhe

pasojat e një ndryshimi të vonuar. Ai të jep përshtypjen e një interlekutori të pandalshëm midis vlerave të jetës në një pafundësi ngjarjesh si një vajtje – ardhje që të mban afër dhe të lidhur me realitetin që përjetojmë.

Ai mbetet si gjithmonë fisnik dhe i freskët në mendime, siç mund ta keni njohur në ditën e parë të miqësisë me të. Ai qëndron stoik në vitalitetin e dibranit, njeriut me vlera të larta morale të integruar në jetën moderne, të një njeriu që shpreh pa droje pozicionin e tij të pandarë nga historia jonë e përbashkët e një tranzicioni social – psikologjik ende të pambyllur.

Ky është personaliteti i njeriut që duam, që aq shumë e dëshirojmë në majat e drejtimit të piramidës së shtetit dhe të shoqërisë. Larg kompleksitetit të jetës, Avokati ynë i Nderuar shpalos ndjenjat e larta të humanizmit dhe të mirësisë njerëzore, në përballje me sfidat e jetës, duke mos harruar kurrë se i mjafton të ndihet qetë në vetëdijen e tij kur përfshihet me kurajo në realizimin e gjërave të vogla, por me dashuri të madhe. Kjo është tipikja e personalitetit të Shenjtësisë së saj Nënë Terezës Shqiptare. Këtë ka marrë përsipër të bëjë krenaria e Dibërës, miku dhe shoku ynë i mrekullueshëm, Dr. Baftjar Rusi. Ai ka marrë shumë lëvdata dhe dekorime gjatë jetës dhe karrierës së tij, nga institucione dhe organizata e organizma kombatarë dhe ndërkombëtarë, por titujt “Misionar i Paqes Boterore”, “Ambasador Nderi”, si dhe Medalja e Artë “Urdheri i Misionarit të Paqes Mahatma Gandhi” e vndosin në hierarkinë e personaliteteve më me vlerë të kombit shqiptar. Personalitete të njohura të avokatisë si Baftjar Rusi kanë si lajmotiv dhënien sa më shumë lumturi të tjerëve. Ai, ka qenë gjithmonë dhe është një prijës i së mirës shoqërore, i së mirës së përbashkët, një talent në fushën e jurisprudencës, që e kalon stekën e kohës. Baftjar Rusi është modeli i njeriut fisnik, autoritar, të çiltër, të dashur, bashkëveprues dhe të gjindshëm në çdo vështirësi. Si mishërues i urtësisë dhe mençurisë dibrane ai kudo dhe kurdohetë përçon vlerat më të spikatura njerzore dhe intelektuale.

SHUAIP METHASANI, VETERANI QË RREZATON MIRËSI DHE VLERA

- Dy libra – testament për brezat ku përshkruhen më së miri vendlindja, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë e traditat më të mira



Pothuajse në të gjitha veprimtaritë promovuese të librave të autorëve dibranë të dhjetë viteve të fundit, si edhe në ato të Federatës së paqes Univesrale ka spikatur me prezencën dhe performancën e tij edhe veterani Shuaip Methasani. Intelektuali që mishëron virtytet më të mira njerëzore: zgjuarsinë, mençurinë, fisnikërinë, dashurinë njerëzore, sinqeritetin, drejtësinë, solidaritetin, moralin e lartë dhe shpirtin human si fundamente kyçe të shoqërisë sonë. Dhe të gjitha këto virtyte ai i përçon më së miri edhe në dy librat e tij: “Sohodolli i Dibrës” dhe “Kujtime në vite”. Dy libra – testament për brezat ku përshkruhen më së miri vendlindja e tij, Sohodolli, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë, traditat më të mira të këtij fshati e të krejt Dibrës. Janë padyshim dhurata

më e çmuar për njerëzit e familjes, farefisin, të afërmit, shokët e miqtë e tij të shumtë në gjithë Shqipërinë dhe hapësirën mbarëshqiptare në botë. Njeriu i mirë dhe i veprave të mira Shuaip Methasani gjatë gjithë jetës së tij ka rrezatuar dhe përçuar mirësi, por dhe vlera në dobi të shoqërisë.

TAVOLINA E DIBRANËVE

Tek libri “Kujtime në vite”, një mestitull interesant (faqe 62) është “Tavolina e dibranëve”. Intelektuali që ka shërbyer me devotshmëri e përkushtim qytetar për afro dy dekada, pothujase në të gjitha krahinat e fshatrat e Dibrës, edhe këtu në metropolin shqiptar, ku është vendosur familjarisht prej shumë vitesh, punon pa rreshtur për të lartësuar emrin dhe dinjitetin e dibranëve. Nëse në Tiranë njihen nga shumëkush “Rruga e Dibrës”, “Lagja e dibranëve”, (e krijuar e shumëfishuar përgjatë një shekulli që nga eksodi i tyre i 1913, e sidomos pas viteve ‘90), apo dhe Xhamia “Dine Hoxha” në rrugën e Kavajës (e ndërtuar me kontributin financiar të filozofit popullor të mirënjohur si një nga këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog I), “Tavolina e dibranëve” në një lokal kafeneje në qendër të Kombinatit, është një tjetër vlerë e shtuar e këtij komuniteti, e ideuar dhe promovuar më së miri nga intelektuali i mirënjohur Shuaip Methasani. Është kjo, tavolina ku ai nuk mungon thuajse asnjë ditë për t’u takuar e kuvenduar me miqtë e tij, jo vetëm dibranë, por edhe tepelenas, vlonjatë, shkodranë, nga Tirana dhe nga e gjithë Shqipëria. “Duke përdorur edhe alegorinë dibrane në muhabete e sipër e me kundërshtime ndaj njëritjetrit, ato të tavolinave tjera dhe njerëzit e shërbimit në lokal çuditen me ne. Një ditë i kishin thënë asaj kamarieres 2-3 veta nga Jugu e Tirana: More, po ata dibranët që u zunë dje në muhabate, a prapë qenkan bashkë?! Nuk u merret vesh dibranëve, kur flasin përdorin shumë thumba...”. Dhe në të vërtetë vetë Shuaipi është përçuesi më i mirë i alegorisë dibrane, të përvetësuar në odat e kuvendet e Dibrës, por edhe nga kryevepra e Hazis Ndreut “Alegoria dibrane” si dhe nga “Kanuni” i shkrimtarit të shquar dibran Xhafer Martini. Libri ka qenë miku dhe bashkëudhëtari më i mirë i Shuaipit në tetë dekadat e jetës së tij, ndaj mos u çudisni nëse nga një vizitë rastësore në shtëpinë “Methasani” në një lagje të Kombinatit në Tiranë, do të gjeni një bibliotekë aq të pasur, konkurente në tituj e rubrika me ato të institucioneve. Ndërsa në bibliotekat tona, dy librat e tij duhet të zënë vend

nderi, pasi ua kushton prindërve (babait Sulejman dhe nënës Fie), motrave Hike e Servete që e kanë mbajtur në krah kur ishte i vogël, bashkëshortes Farie - një zonjë e nderuar e fisnike, fëmijëve të mrekullueshëm: Defrimit (moderator i shkëlqyer i dhjetra veprimtarive promovuese e argëtuese dhe ndër më të mirët e gazetarisë sportive në rang kombëtar), Artanit, Natashës, Nderimes e Lilianës që e kanë nderuar si me shkollimin dhe me punët ku kanë punuar e punojnë, dy nuseve të djemve, Lume e Naze, nipave e mbesave që e lumturojnë pafund, miqve dhe shokëve të tij të mrekullueshëm...Një përkushtim brilant për ata që përbëjnë embrionin e familjes nga buron atdhedashuria e tij e flaktë. Dhe në çdo faqe të tyre gjejmë aspekte nga historia e lavdishme e popullit tonë, por dhe ngjarje e detaje jetësore befasuese.

JETA DHE VEPRIMTARIA E NJË INTELEKTUALI SHUMËDIMENSIONAL

Ka qenë fare i vogël, 6-7 vjeç, por e ka të ngulitur në kujtesë pushtimin fashist të vendit më 1939 dhe reagimin e tij prej fëmije të inatosur nga ky pushtim i egër. “Ishte prill 1939. E mbaj mend mirë kur erdhën italianët me makina e mushka të mëdha me artileri; kaluan lagjen tonë dhe dolën në vreshtat nën varre të Skëndere, vendosën çadrat e ushtrisë...ndërsa ne afroheshim ashtu si fëmijët që duan të shikojnë çdo gjë...” . Më tej kujton thirrjen e tyre italisht atëhere: “ej pikoli, vjeni kua, vjeni kua...” ndërsa vetë Shuaipi e shokët e tij të fëmijërisë, Imeri, Pajaziti, Zaimi, Cena, Hakiu etj, u afroheshin italianëve, e ata nxirrnin mallin e njerëzve të tyre që kishin në familjet e veta....

Në vitin 1944 vijon mësimet në shkollën fillore te xhamia, me mësues Halil Shehun nga Vlesha e të tjerë që erdhën më vonë nga Vlora, Elbasani e Shkodra...Nxënësi i zellshëm Sh.Methasani më pas do të ngjiste shkallët e dijes e formimit arsimor e kulturor në të gjitha nivelet: 7-vjeçare, pedagogjike e deri të lartën. Që nga 1944 e deri në mbarimin e shkollës së lartë ka kaluar me shumë shokë e shoqe, në klasa paralele e auditore të ndryshme. “Kështu, e fillova me Osman Hysen Pajazitin, Xhemën, Alushin, Cenën, Ismetin e Selimin dhe e mbarova me Nikollë Brozin nga Mirdita, Omer Hashorvën nga Gjirokastra, me Mentor Muçën, Rustem Devën, Vera Haxhiun, Liljana Mitin, Shpresa Barbullushin, Nikoll Kolën,

Izet Durmishin, Hajdar Kastratin, Rustem Lleshin, Servet Pëlumbin, etj”, shkruan Shuaipi në librin e tij “Kujtime në vite” (faqe 53). Janë vërtetë kujtime mallëngjyese por edhe mbresëlënëse jo vetëm për autorin, por edhe për lexuesin. Të përshkruara mjeshtërisht si mbresa e kujtime nga jeta e puna e tij në zonën e Shupenzës e Gjoricës (1968-1971), në Zogje të Dibrës (1982-1984), në Kalanë e Dodës – ballkonin natyror të Dibrës e gjithë Shqipërisë ku punoi e jetoi për 12 vjet (1971-1982), në zonën e Çidhnës (1984-1989), në Sllovë, etj, formojnë profilin e këtij intelektuli që kudo shërbeu me devotshmëri e përkushtim qytetar.

Vetëm një intelektual i mirëfilltë si Sh.Methasani, duke e konsideruar mirënjohjen si shprehjen më të bukur të karakterit të njeriut, në moshën e tretë merr penën dhe shkruan me realizëm e objektivitet për shokët e miqtë e tij të shumtë. Kështu ai në dy faqe të librit të tij me kujtime (12-13) rendit emrat e qindra intelektualëve dibranë me të cilët ka patur fatin të punojë. Dhe po me atë dashuri të pakufishme shkruan për “Dibrën e margaritarëve”, Dibrën e 9 maleve, teqeve dhe oxhaqeve të përmendura.... Ndërkohë si kontribut real në gjeopolitikë ai jep përkufizime të qarta për “Dibrën e shtrirë në një hapësirë pa fund, si një vilajet i stërmadh, që nis nga Mati në njërin anë e nga Luma në tjetrën dhe duke pasur përbri e afër këtej Kukësin, Mirditën e Librazhdin, e matanë, Strugën e Ohrin dhe pas më larg Kërçovën, Tetovën etj, me një reliev të thyer, plot me male, kodra, ultësira, fusha e lugina...Ai përshkruan bukur e thjeshtë: Dibrën e Korabit gjigand e legjendar dhe disa male të tjera që i qëndrojnë krahinës si një kurorë e bukur mbi kokë, duke ia shtuar edhe më shumë madhësinë e krenarinë; Dibrën e Drinit të Zi që gjarpëron mijëra metra tejmbanë Veriut dhe pasi bashkohet me Drinin e Bardhë arrin në Shkodër tok me Bunën e derdhen në Adriatik; Dibrën e shtatë liqejeve margaritarë e piktoreskë të Lurës; Dibrën e shumë pasurive të mëdha natyrore, kromit, gipsit, sulfurit e llixhave ku kurohen me mijëra njerëz; Dibrën e traditave në bujqësi e blegtori, të frutikulturës, sixhadeve e qylymave të Kalasë së Dodës; Dibrën e sofrës, pushkës e penës, urtësisë dhe mençurisë; Dibrën e arsimit, kulturës, sportit, besës e flamurit; të fiseve e familjeve të mëdha e emrave që kanë shkruar e bërë histori, si: Gjergj Kastrioti, Iljaz Pasha, Elez Isufi, Nikollë Kaçorri, Vehbi Dibra(Agolli), Dine Hoxha etj; Dibrën e shumë heronjve, mësuesve e pedagogëve, inxhinierëve, mjekëve e

mjeshtrave të artit, kulturës dhe sportit, si: Haki Stërmilli, Haki Sharofi, Suljeman Pitarka, Drita e Esmë Agolli, Muharrem Xhediku, Hazi Ndreu, Shaban Sinani, Agron Tufa, Bujar Kapexhiu, Gëzim Erëbara, Femi e Tasim Oshafi, Avni Resuli, Zenulla Hatibi, Xhemil Simixhiu, Agim Krajka, Hiqmet e Nexhat Agolli, Adivie e Yllka Sharofi, Edip e Engjëll Tërshana, Sadik Botku, Liri Rasha, Arif Vladi, Arben Spahiu etj....Po ashtu e gjejmë Shuaipin përkrah të birit gazetar e moderator, Defrimit, tek promovon të mëdhenjtë e sportit, kampionët botëror Erzen Rrustemi, Ismail, Gjetan e Ferit Keta, Bari Mehmeti (Meçollari) apo dhe artistin shqiptaro-amerikan me famë botërore Xhevat Limani. Dhe si gjerdan në kurorën e lavdisë dibrane, ai nuk nguron të rendisë edhe miset shqiptare me origjinë dibrane Denisa Kola, Ilda Reka e Migena Ramadani.

Vetëm një studjues tejet i vëmendshëm e skurpuloz si Shuaip Mehtasani mundet të evidentojë kaq shumë emra të spikatur dibranësh në fusha të ndryshme, siç evidenton “odën e burrave”, “traditën e fisit”, objektet dalluese të vendlindjes së tij, “sohodollasit e Tiranës” apo “Familjet nga Sohodolli me banim në Tiranë”. Parë në tërësinë e individualitetit të tij krijues, Shuaip Methasani është një enciklopedi e gjallë për Dibrën e dibranët.

Për meritat, mençurinë dhe urtësinë e tij, në 90 vjetorin e ditëlindjes u nderua me “MIRËNJOHJE” nga kryetari i Bashkisë Tiranë.



HALIT BERISHA - INTELEKTUALI BASHKOHOR QË I PËRBALLOI ME DINJITET SFIDAT E JETËS

Në librin e tij “Kujtime në vite”, Shuaip Methasani i kushton një vëmendje të posaçme edhe punës me rininë, e në këtë kontekst evidenton edhe bashkëpunimin me Halit Berishën në zonën e Muhurrit.

Ishin vitet ’60-të të shekullit të kaluar, kur në kontekstin e zhvillimeve shoqërore të asaj kohe, rinia ishte promotore e ndryshimeve të vullshme. Ajo kohë kishte kënaqësitë e veta, por edhe vështirësi e sakrifica të mëdha.



Pikërisht në kontekstin e këtyre zhvillimeve formësohet edhe profili i Halit Berishës, djaloshtit simpatik sykaltër që do të spikaste mes ekipit të ish-Komiteteve të Rinisë e Bashkimeve Profesionale të rrethit Dibër për vizionin e tij bashkëkohor. Fëmijëri e vështirë Berishët e Muhurrit janë një familje e dëgjuar që në lashtësi për trimëri e mençuri, besë e humanizëm, të evidentuara veçanërisht këto cilësi tek gjeneralët e Skënderbeut, Nikollë e Dhimitër Berisha, por dhe në betejat e mëvonshme kundër pushtuesve osmanë e serbë nga gjyshi i tij, Liman Berisha.

I rritur jetim për babë, që në fëmijërinë e tij të hershme, Haliti do të trashëgonte pikërisht këto virtyte të të parëve të tij. Mes vështirësive të panumërta, i detyruar t’i vijë në ndihmë familjes që në moshë foshnjore, krahas vijimit me zell të mësimave në shkollën 7-vjeçare, do të përballonte punë nga më të rëndomtë në bujqësi e blegtari. Ndërkohë, si edhe bashkëmoshatarët e tij të famijes e të fisit, Haliti do t’iu kushtohej masivisht edhe veprimtarive kulturore e sportive. Bashkëkohësit kujtojnë vitet kur ai aktivizohej me grupet amatore kulturore të fshatit, por veçanërisht me ato

sportive. Vendlindja e tij, Muhurri, për vetë pozitën e favorshme gjeografike, me Drinin që i kalon mes për mes, fushën pjellore, por edhe masivin malor gjer majë Runjës hijerëndë e kreshnike, ishte përcaktuar nga funksionarët e atëhershëm të rrethit Dibër si epiqendra e këtyre veprimtarive në shkallë rrethi. Dhe pikërisht këtu, ata do të evidentonin Halit Berishën si të riun më të avancuar për kohën, në drejtim të angazhimit të rinisë në aktivitetet kulturore e artistike, si edhe në ekipet sportive të kohës, ato të futbollit, atletikës etj. Atje, në luginën e Drinit të Zi, mes shelgjeve e varrinjve ku ngrinin fushat e lojës, ku zhvilloheshin kampionatet e futbollit, të atletikës e të lojërave me dorë, Halit Berisha, ishte ndër më të mirët, falë aftësive e talentit, por edhe bukurisë së tij të rrallë fizike e shpirtërore.

NDIKIMI I USHTRISË NË FORMIMIN E TIJ SI KUADËR

Megjithëse jetim, me vëllain e vetëm më të vogël Likën e nënë Hanen, zemërmirë e fisnike, që rropatej për t'ua plotësuar sadopak kushtet e jetesës, kur sapo kishte dalë në jetën e tij aktive, Halitit do t'i duhej të kryente shërbimin e detyruar ushtarak, jo në ndonjë repart të afërt në vendlindje, por siç veprohej rëndom asokohe me të rinjtë pa përkrahje, e degdisin 400 kilometra larg shtëpisë, në Repartin 401 të kufirit në Sarandë. Por kufitarit dibran, që mbartte me vete një përvojë të pasur jetësore të fituar në vendlindje, do t'i vinte në ndihmë pikërisht kjo përvojë për të evidentuar aftësitë dhe inteligjencën e tij natyrore dhe atë të fituar në shkollë e në aktivitetet me rininë. Si të tillë, por edhe si djalë energjik e me karakter të fortë e caktojnë në sekretarinë sekrete të repartit. Imagjinojeni, një djali të rritur me vështirësi të shumta, por të formuar e kalitur përmes tyre i duhej të përshtatej me kushte e rrethana krejt të reja, ku i besoheshin planet sekrete tekniko-operative të përballimit të ndonjë agresioni të mundshëm grek, si ai i provokacioneve të gushtit '49. Por pikërisht shërbimi me devotshmëri e përkushtim në atë repart ushtarak, i shërbeu atij për të krijuar lidhje të reja miqësore dhe mbi të gjitha për t'u formuar si kuadër. Në këtë repart të largët, Halit Berisha do të përsoste talentin e tij edhe në një aspekt tjetër. Si askush tjetër, këtu do të perfeksiononte profesionin e daktilografistit, pikërisht në kohën kur makina e shkrimit ishte ndër mjetet më të perfeksionuara të asaj kohe, në raport me "artilerinë" e mjeteve të sotme shumë të sofistikuara, në funksion të komunikimit në botën dixhitale, që

asokohe as që mund të inagjinohej. Por Haliti, që as nuk i shikoheshin gishtat, për vetë shpejtësinë me të cilën përdorte makinën e shkrimit, do të ishte i preferuar nga nomenklatura e kohës. Madje, kjo do të ishte dhe një nga arsyet e këmbënguljes së komandës për ta mbajtur në punë si shef të sekretarisë sekrete të repartit edhe pas mbarimit të kohës së shërbimit të detyruar ushtarak. Por Halit Berisha, kurrësesi nuk mund të braktiste nënën dhe vëllain e vetëm që i kishte qindra kilometra larg repartit, ndaj dhe më 7 dhjetor 1962 u kthye përgjithmonë në vatrën e tij të ngrohtë familjare, tashmë si një kuadër i përgatitur për të marrë përgjegjësi e sfida të reja.

TRI DEKADA NË FUNKSIONE ME PËRGJEGJËSI

Nuk kishte kaluar as një muaj nga koha e mbarimit të shërbimit të detyruar ushtarak, kur Halit Berishën, në fillimin e janarit 1963 e emërojnë instruktor në ish - Komitetin e Rinisë të rrethit Dibër. Punoi plot katër vjet në këtë funksion, ku zhvilloi talentin e tij dhe u miqësua me njerëz të moshave e profesioneve të ndryshme nga i gjithë rrethi, gjer në Lurë, Kala të Dodës, Steblevë e Bulqizë. Plot katër vjet, sa koha që kalon një student në auditoret e një universiteti, i dhanë atij “diplomën” e “studentit” të odës dibrane e të kuvendeve të Dibrës, të konsideruar si universiteti më i mirë i kohës. Kalon moshën e rinisë dhe sërish Halit Berishën e mbajnë në një tjetër strukturë të organizatave shoqërore të asaj kohe, siç ishin Bashkimet Profesionale të Rrethit. Punoi plot dhjetë vite si llogaritar i Bashkimeve Profesionale të rrethit Dibër, kohë kur ai mbahet mend e vlerësohet nga shokët e miqtë e tij të shumtë, si Sinan Saraçi, Agim Kaba, Baftjar Shahini, Ismete Jashari etj, si një nga kuadrot e përgatitur, korrekt e mjaft i devotshëm në përkushtimin e tij qytetar. Megjithë vështirësitë e kohës, (pasi për 15 vite si instruktor rinie dhe në Bashkimet Profesionale i duhej të udhëtonte për çdo ditë nga katër orë më këmbë Muhurr-Peshkopi dhe anasjelltas), ai kurrë nuk u gjuhëzua, përkundrazi ngjiti me meritë shkallët e karrierës. Një tjetër funksion i përgjegjshëm që ka kryer Halit Berisha për 11 vitet në vijim (1975-1986) ka qenë ai i Kryetarit të Degës së Planit në Minierën e Mermerit Muhurr. Ishte një dekadë përballjeje deri në Komisionin e Planit të Shtetit e në instanca të larta të Ministrisë së Industrisë e të rrethit Dibër, që pretendonin e kërkonin të realizoheshin plane të fryra në një

minierë ku kushtet e punës ishin tejet të rënda. Por për çdo vit, planet e kësaj miniere Muhurri, histori dhe personalitete 353 që mbanin firmën e Halit Berishës qenë reale dhe konkruuese me të gjitha ndërmarrjet simotra. Këtë e dëshmojnë më së miri në vlerësimet e tyre për Halitin, ish-drejtorët në vite të kësaj miniere, Besim Sadiku, Rustan Loka e Hekuran Domi, duke përveçuar edhe humorin e këndshëm e mendjemprehtësinë e tij për të kapërcyer edhe situata të ndërlikuara. Me të njëjtën përgjegjësi e përkushtim punoi ky kuadër me përgatitje profesionale e moral të lartë edhe në Degën e Tregtisë Muhurr (1986-1992) dhe në ndërmarrjet tregtare e atë të grumbullimit Bulqizë (1993-1995), duke përballuar vështirësitë ekstreme të asaj periudhe, kur mungonin gjërat më elementare, deri edhe ushqime të paketës bazë. Por edhe në këto rrethana ai diti të përshtatet dhe të krijojë figurën e intelektualit të respektuar nga kolektivi dhe komuniteti ku shërbeu. Për 25 vite, Halit Berisha jetoi familjarisht në Tiranë, në gjirin e familjes së tij të mrekullueshme, me bashkëshorten Naxhien, djalin Bujarin, nusen e djalit Fiqirie (Kollaku), mbesën Amarilda e nipin Serxho, ndërkohë që përkujdesje maksimale ndaj tij tregojnë katër vajzat, Kimetja që e ka fare pranë shtëpisë së tij si dhe Kujtimja, Natasha e Lumja që prej shumë vitesh jetojnë e punojnë familjarisht në Bruksel. Ai i gëzohej gjithashtu progresit dhe dashurisë së nipërve Bledar e Arlind Rama, Oligert e Kallashnikov Hoxha dhe Paris Jovani, fëmijëve të tyre, Keidës, Alesias, Eltonit, Fitimit e Katerinës, të cilët me sjelljen e përkujdesjen ndaj tij i dhuronin lumturi të veçantë, në moshën e tij të tretë.

Punoi me ndershmëri e përkushtim të rrallë në Komitetin e Rinisë dhe Bashkimet Profesionale të rrethit Dibër; për tri dekada shef plani në Minierën e Mermerit; më pas në Degën e Tregtisë Muhurr, në ndërmarrjen e Grumbullimit e atë Tregtare të Bulqizës, deri sa doli në pension. Bashkohësit do ta kujtojnë si simbol të mirësisë, urtësisë e mençurisë dibrane. Ishte bashkshort, prind dhe gjysh shembullor..

Halit Berisha u nda nga jeta më 26 qershor 2023 për t'u përcjellë në banësën e fundit në varrezat Kodër e Kuqe, Paskuqan, të nesërmen më 27 qershor 2023, nga miëjra të afërm, shokë e miq të shumtë, nga e gjithë Shqipëria që i deshi dhe e dëshën aq shumë.

Parajsa qoftë vendbanimi i tij i përjetshëm!

BUJAR PATA, NJË VLERË E VËRTETË E QYTETARISË

- **IN MEMORIAM** - Intelektuali shumëdimensional, profesionisti politeknik, ndër drejtuesit më të aftë të Minierës së kromit Bulqizë
- Këshilli Bashkiak i Bashkisë Bulqizë, në vitin 2005 i dha inxhinierit Bujar Pata titullin “Qytetar Nderi”, për kontributin e tij në 40 vite si specialist dhe drejtues, që mbajti mbi vete përgjegjësi të mëdha për ecurinë e prodhimit të mineralit të kromit në minierën e Bulqizës



Më 10 Dhjetor 2016, familjarët, miqtë dhe të afërmit, përcollën me shumë dhimbje në banesën e fundit, inxhinierin Bujar Pata, një figurë të nderuar të Bulqizës dhe të Dibrës, me një kontribut të madh në zhvillimin e industrisë së kromit.

Ai lindi në Peladhi në vitin 1940. Shkollën fillore dhe unike i kreu në Zerqan me rezultate të shkëlqyera, ku dallohej për zgjuarsinë e tij. Shkollën e mesme e kreu në Politeknikumin “7 Nëntori”, ku përsëri mbaroi me rezultate të shkëlqyera, degën e minierave. Në Politeknikum e donin Bujarin pasi ishte i urtë, i sjellshëm dhe i dashur me shokët. Ai gjithkujt i bënte respektin që i takonte.

Filloi menjëherë punën si teknik miniere në Bulqizë, ku shpalosi çdo ditë aftësitë e tij në kryerjen e detyrave deri në vitin 1965, kur nisi studimet në UT, në Fakultetin e Minierave. Edhe këtu u shqua si student i përkushtuar për të arritur rezultate të shkëlqyera. Gjithashtu ai kishte marrëdhënie shumë të afërta me shokët studentë dhe me pedagogët që e vlerësonin si një ndër specialistët e rinj që do të jepte kontribut të

rëndësishëm në zbatimin e teknologjive të reja në nxjerrjen e mineraleve nga nëntoka.

Biri i një familje me tradita e emër të mirë, ku gjenden të kombinuara mençuria, bujaria, fisnikëria e zemërgjerësia, do t'i mishëronte e perfeksiononte ato gjatë gjithë karrierës së tij prej afro pesë dekadash.

I porsadiplomuar inxhinier minierash, ai fillon punën në vitin 1970 në Minierën e Kromit në Bulqizë, ku afirmoi veten si specialist rezultativ në personelin inxhinieroteknik të kësaj ndërmarrje, që në atë kohë ishte bërë miniera më e madhe në Shqipëri.

Rezultatet e suksesshme në punë shpejt sollën dhe vlerësime për guximin e rrallë, qëndrimin heroik në frontet më të vështira dhe në kujdesin e mirëmbajtjen e mekanikës së minierës. Autori i dhjetra projekteve për modernizimin e minierës më të madhe të kromit në vend, drejtuesi i talentuar, miku më i shtrenjtë i minatorëve, nderohej gjithnjë prej tyre.

Të tillë do ta portetizonte atë edhe ish bashkëpunëtori e bashkëqytetari i tij, Ing.Hamza Gurra, në librin “Bulqiza, një minierë me histori”. Në vitin 1973 Bujar Pata emërohet Kryeinxhinier në Minierën e Kromit në Bulqizë, ku drejtoi për shumë vite.

Krahas punës ai ushtroi edhe detyrën e mësuesit të lëndëve profesionale në Shkollën e Mesme të Minierave në Bulqizë. Gjithashtu ai ishte këshilluesi më i besuar në mbledhjet e personelit inxhiniero-teknik. Fjala e tij dëgjohej me vëmendje në frontet e prodhimit ku haseshin vështirësi të mëdha në zbatimin e rregullave të prodhimit të mineralit në frontet e thella të puseve dhe traverbanzheve të ndërtuara për hapjen e minierës në të gjithë masivin, tashmë të vërtetuar të kromit.

Ishte një profesionist politeknik dhe mjaft i thelluar në njohuritë për minierat. Dallohej për projektimin e fronteve të thellësive, në kushtet e infrastrukturës mizerabile të kohës dhe gjithnjë ia dilte të korrite suksese.

KARRIERA NË NGJITJE E NJË INTELEKTUALI SHUMËDIMENSIONAL

Bujar Pata, ky intelektual shumëdimensional do të kishte një karrierë gjithnjë në ngjitje, të admirueshme për kolegët e bashkëpunëtorët e tij të shumtë.

Në vitin 1981 emërohet Drejtor i Minierës të Kromit, Bulqizë, por ai

mbeti gjithnjë ashtu, i thjeshtë e i dashur me shokët dhe llogjik në trajtimin e problemeve deri në zgjidhjen e plotë të tyre. Në këto vite u rrit me shpejtësi mekanizimi e modernizimi i minierës duke zbatuar teknologji që i përgjigjeshin realizimit të planit të prodhimit e të kërkimit dhe futjes në funksion të fronteve të reja të nxjerrjes së kromit. Në këtë minierë u hapën rreth 18 km galeri, puse, furnele e rampa dhe u nxorrën rreth 20 milion ton krom, duke qenë një faktor i rëndësishëm për ekonominë e vendit tonë.

Në vitin 1984, Bujarin e emërojnë Sekretar të Parë të Komitetit të Partisë të Rajonit të Bulqizës. Edhe këtu ai ruajti po ato tipare të thjeshtësisë e të komunikimit me drejtues, minatorë e qytetarë me të cilët qante hallet e tyre të punës e të jetës. Pas një viti përsëri kthehet kryeinxhinier në minierë, ku shifrat e realizimit të planit të prodhimit kishin arritur në nivelin e një përgjegjësie të jashtëzakonshme.

Në vitin 1989 Bujari emërohet Sekretar i Komitetit të Partisë të rrethit Dibër. Në këtë kohë ai pati edhe probleme shëndetësore me zemrën që i kaloi me sukses.

Në mars 1991, në Kuvendin e parë pluralist, B.Pata zgjidhet deputet deri në marsin e vitit 1992. Aty ai dha kontributin e tij në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë. Pas vitit 1992 filloi punë përsëri në minierën e Bulqizës në repartin e cilësisë.

Nga viti 1998 deri 2001 kur doli në pension punoi specialist në Albkrom në Tiranë.

40 VITE KONTRIBUT SI SPECIALIST DHE DREJTUES I MINIERËS

Në vitin 2003 Bujar Pata ngre zërin e tij në shtyp për gjendjen e gjigantit të kromit të Bulqizës, ku paralajmëron vështirësitë e mëdha që sjell keqmenaxhimi i kësaj miniere. Larg klisheve e slloganeve përçarëse, edhe në këto vite ai iu përkushtua profesionit, duke bërë më të mirën e mundshme.

Bujari, një profesionist politeknik dhe mjaft i thelluar në njohuritë për minierat, mbajti mbi vete përgjegjësi të mëdha. Kështu vlerësohet kontributi i tij si specialist dhe drejtues për 40 vite. Gjithmonë ishte një burrë me shpirt të jashtëzakonshëm, simbol i nëpunësit të drejtë e të

përkushtuar, inxhinieri pasionant i minierave të kromit shqiptar, njeriu shumë i dashur për të gjithë minatorët dhe popullin e Bulqizës dhe një vlerë e vërtetë e qytetarisë.

Bujar Pata ishte mjaft dinamik, në lëvizje e kërkim të pasosur njohurish dhe vlerash. Ai ishte shumë i lidhur me punën dhe mjaft i shoqërueshëm; lexonte e shkruante, fliste bukur në kuvende, takime e festa. Në bibliotekën familjare i gjeje të gjitha librat shqip të kohës si dhe koleksionet me revistat përparimtare.

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Bulqizë, në vitin 2005 i dha inxhinierit Bujar Pata titullin “Qytetar Nderi” për kontributin e tij në 40 vite si specialist dhe drejtues, që mbajti mbi vete përgjegjësi të mëdha për ecurinë e prodhimit të mineralit të kromit në minierën e Bulqizës. Gjithë ky aktivitet i dendur e mjaft produktiv i një personaliteti me përmasa shumëdimensionale si Bujar Pata, na bën të hulumtojmë më shumë rreth jetës dhe produktit që ai lë pas, në të mirë të shoqërisë dhe të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të Bulqizës dhe krejt Dibrës.

Në realitetin e kohës që jetoi Bujar Pata përpiqej gjithnjë të ishte në harmoni me vetveten dhe ky ka qenë orientimi më i mirë i tij, orientim drejt lirisë së qënies dhe gjykimit të pandikuar. Pikërisht një orientim i tillë do ta çonte atë në kufijtë maksimalë të cilësimit si një individ i veçantë.

PROMOVUES I VLERAVE QYTETARE

Bujar Pata kultivoi dhe promovoi vlera qytetare, që në etapa dhe forma të ndryshme, në ecjen e njerëzve me kohën e për kohën, nëpërmjet kontributit të tyre modest dhe historik, kanë komunikuar dhe vazhdojnë të komunikojnë, mesazhe modeste e komplekse, dialogimin e së kaluarës, qartësinë e së tashmes dhe udhën e së ardhmes; ndjenja të shpallura këto, për të kuptuar vazhdimësinë e jetës, krenarisë, dhe përjetësisë..., vlera që sigurojnë identitetin e qytetarisë dhe inteligjencës dibrane.

...Lajmi i trishtë se një nga personalitetet më të shquara dibrane, Bujar Pata, u nda nga jeta, u prit me dhimbje e dëshpërim të thellë nga familja, bashkëshortja e fëmijët, nga të afërmit dhe miqtë e shumtë, jo vetëm në Bulqizë e Dibër, por në gjithë Shqipërinë, veçmas nga ata që kanë patur fatin ta njohin, ta kenë mik dhe koleg. Ata shprehën ngushëllimet dhe dhimbjen e tyre në rrjetet sociale e shtypin shqiptar.

Në një bisedë ngushëlluese telefonike që pata me djalin e tij, mikun e kolegun shembullor, gazetarin e talentuar, Ylli Pata, përpos kërshërisë sime për të ditur më shumë rreth babait të tij, ndjeva dhimbjen e thellë, respektin dhe një moment homazhi, malli, mungese, dhimbje, dashurie dhe admirimi, për njeriun që e pati pjesë të jetës së tij për 40 vjet, duke e vlerësuar edhe si një tribun promovues dhe përcjellës të vlerave njerëzore dhe qytetare. Me ndarjen e tij nga jeta, Bulqiza humbi një inxhinier të talentuar e qytetar shembullor, familja e shoqëria ndahen me të shtrenjtin e tyre. U prehtë në paqe shoku dhe mikun ynë i paharruar Bujar Pata. Dheu qoftë i lehtë për të !

BESIM NDREGJONI - EMBLEMA E DISIDENCËS SHQIPTARE



Vetëm tre vjet pas dekorimit nga Presidenti i Republikës me Urdhërin e lartë “MJESHTRI I MADH”, erdhi një tjetër titull nderi për aktivistin e të drejtave dhe lirive të njeriut, Besim Ndregjoni. Në kuadrin e 25-vjetorit të rënies së sistemit komunist në Shqipëri, Këshilli i Qarkut Tiranë nderoi misionarin e palodhur për dokumentimin dhe gjetjen e eshtrave të të ekzekutuarve nga regjimi komunist, Presidentin e Unionit Mbarëkombëtar të Integritimit të të Burgosurve Politikë të Shqipërisë, Besim Ndregjoni, me titullin e lartë “Nderi i Qarkut Tiranë”. Është gjithashtu ky titull vlerësim për kontributin e rëndësishëm të zotit Ndregjoni si aktivist i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht për integrimin dhe mbështetjen e shtresës së të përndjekurve politikë dhe për veprimtari të çmuar në evidentimin dhe demaskimin e krimeve të regjimit komunist.

Në ceremoninë e dhënies së këtij titulli ishin të pranishëm Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, ish-Presidenti Alfred Moisiu, deputetë, krerë të partive politike dhe ish-të përndjekur politikë të regjimit komunist nga Tirana, Dibra e Shkodra.

Ndregjoni është shembulli i qëndrestarit, shembulli i njeriut që na tregon se si duhet jetuar jeta. Ai ka të drejtë të krenohet për udhën që

ka përshkruar gjatë gjashtë dekadave. Si askush tjetër, ai ka ditur të lërë gjurmë të pa shlyera në udhën e jetës, gjurmë që duhet t'i ndjekin dhe pasardhësit e tij. Personaliteti i tij, kudo dhe në çdo rrethanë reflekton vlera, për të cilat është e etur shoqëria jonë. I rritur dhe edukuar në një mjedis atdhetarësh, në Lukanin e Katër Grykëve, rrëzë Runjës hijerëndë e kreshnike, ai u bë shembull frymëzimi për bashkëkohësit, si udhërrëfyes i progresit dhe dinjitetit njerëzor. Ai në gjithë jetën e tij njihet si një njeri mjaft serioz, shumë i dashur dhe me një humor, gjithmonë të shëndetshëm. Njeri i veçantë, energjik, në sjellje e qëndrime, me një mënyrë të foluri karakteristike, që të mbush mendjen për çdo gjë që mund të flasë. Një njeri tepër bujar, i thjeshtë si buka që ndante përnatë e përditë me miq nga më të ndryshmit në tryezën e vatrës së tij familjare. Është një ndihmëtar i pakursyer për të përcjellë nëpër shkolla dhe universitete të vendit, dhjetëra e dhjetëra djem dhe vajza të popullit, nga familje të burgosura e të persekutua të regjimit komunist. Pikërisht këto vlera të tij i evidentuan gjatë fjalëve përshëndetëse, kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë, Tasim Mema, kryebashkiaku i Peshkopisë, Ilir Kroso, Kreu i Shoqatës “Musine Kokalari”, z.Agim Musta si dhe Dr.Orhan Sakiqi.

MISIONARI VIZIONAR U KA PRIRË ZHVILLIMEVE TË RËNDËSISHME

Emblema e disidencës shqiptare, Besim Ndrejoni, falë intuitës, inteligjencës dhe largpamësisë së tij ka ecur vrullshëm në jetën politike shqiptare të këtyre 25 viteve pluralizëm, duke u prirë zhvillimeve të rëndësishme.

Ai i përket atij brezi të vuajtur të Shqipërisë së diktaturës së proletariatit, ku vlera e njeriut ishte e papërfillshme dhe ku konstitutohej nga Kushtetuta diktatura e pakicës mbi shumicën. Ndrejoni vjen nga një familje fisnike, e shquar në kontributet për shërbimet në drejtim të shoqërisë dhe kombit. Si familje fisnike u persekutua nga regjimi komunist; ai regjim i pushkatoi tre pjesëtarë të familjes, dy, të tjerë i mbyti në hetuesi. Babain e tij Imer Ndrejoni e dënoi me 17 vjet burg politik dhe persekutimi vazhdoi edhe jashtë familjes ku nga torturat i çmendi në hetuesi kunatin (1982). Gjatë Luftës së Dytë Botërore, babai i tij luftoi me armë në dorë së bashku me Abaz Kupin kundra fashizmit në prill të vitit 1939. Ai ishte një nacionalist,

antikomunist dhe humanist, i cili gjatë periudhës 1943-1945 shpëtoi një familje hebrejsh nga genocidi nazist. Me ardhjen e sistemit pluralist për kontributet e dhëna në shërbim të kombit, babai i tij është shpallur “Qytetar Nderi i Selishtës Dibër” (2003). Po ashtu, Presidenti i Republikës e ka dekoruar me “Medaljen e Artë të Shqiponjës” si luftëtar antifashist dhe për qëndresën ndaj regjimit komunist. Këshilli Bashkiak i Tiranës me rastin e 60-vjetorit të genocidit nazist mbi Hebrejtë, ka emërtuar një rrugë në Tiranë, Rruga “Imer Ndregjoni” me motivacionin për shpëtimin që u bëri hebrejve gjatë okupacionit nazist. Gjatë kohës së regjimi komunist, atij iu privuan të drejtat dhe liritë themelore, ndër to e drejta e arsimimit, e punësimit. Gjatë atij regjimi, u caktua në bazë të një vendimi të pushtetit diktatorial, të punonte në punë të rënda në hapje tunelesh, dhe në vende të tjera, që sot konsiderohen si relike të diktaturës së komunizmit në vend, me detyrimin që të mos lëvizte, pa urdhër të pushtetit qendror. Por megjithë kalvarin e mundimshëm, dashuria për lirinë të ky njeri ka qenë e para, e përhershme dhe e përhershme, i gatshëm për t’u flijuar dhe martirizuar edhe nën terrorin komunist.

MEMORIA HISTORIKE E KRIMEVE TË KOMUNIZMIT

Me përmbysjen e diktaturës komuniste, Besim Ndregjonin do ta shohim edhe një herë në vijën e parë të luftëtarit të lirisë. Gjatë viteve të pluralizmit, Besim Ndregjoni ka dhënë një kontribut të çmuar për dokumentimin, publikimin dhe memorien historike të krimeve të komunizmit. Mbrojtës i zjarrtë i kauzës së të përndjekurve politikë, duke qenë një oponent i vazhdueshëm ndaj pushtetit politik për integrimin dhe rehabilitimin e pasojave dhe traumave të kësaj pjese të shoqërisë shqiptare. Ndregjoni shfaqet edhe në shtypin e përditshëm si publicist, me artikuj të shumtë që pasqyrojnë kalvarin e mundimeve të një luftëtari të lirisë dhe nëpërmjet veprës së tij ne njohim kalvarin e vuajtjeve dhe mundimeve të shqiptarëve nën diktaturën komuniste. Dhe në këtë mënyrë, ai na shfaqet si shembulli i njeriut që ndjen detyrën ndaj atdheut dhe se si duhet ta bëjmë këtë detyrë, duke kapërcyer çdo vështirësi që na del përpara. Ai bën një paraqitje historike të fakteve të rënda të persekutimit komunist, botkuptimit dhe filozofisë së pakuptueshme që udhëhoqi Shqipërinë për katër dekada, duke nisur që prej viteve ’40 e deri në fillim të viteve ’90. Ndregjoni analizon

në mënyrë të drejtpërdrejtë diktaturën shqiptare si një nga më të ashprat dhe pa asnjë element të përbashkët me pushtetet komuniste në Evropën Juglindore, duke mbajtur konstant genocidin mbi kundërshtarët e saj – të Përndjekurit Politikë shqiptarë, që kaluan një kalvar vuajtjesh, traumash, përçmimesh, fyerjesh, degradimesh të pakrahasueshme në asnjë shoqëri të Evropës Juglindore. Në përditshmërinë e jetës zoti Besim Ndregjoni është një nga figurat më interesante, si përfaqësues i elitës intelektuale dibrane dhe mbarëshqiptare. Në miqësi me dijen, si simbol i mençurisë e diturisë, ai besoi dhe dëshmoi me vepra se njeriun në jetë e mban vetëm dija.

PJESËMARRËS DHE REFERUES NË DHJETRA KONFERENCA NDËRKOMBËTARE

Bashkëvuajtësit vlerësojnë aktin e z.Ndregjoni kur si ish Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Ish të Përndjekurve Politik të Shqipërisë, u larguat nga ky institucion në shenjë proteste ndaj Qeverisë për mos dhënien e dëmshpërblimit të ish të përndjekurve politikë. Ata evidentojnë bashkëpunimin e kreut të tyre me institucionin e Avokatit të Popullit të Danimarkës dhe Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe të Torturës për zbatimin e konventave ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Shqipëri. Por Besim Ndregjoni ka dhënë një aktivitet intensiv në organizma prestigjiozë ndërkombëtarë. Më 25 janar 2008 ka referuar në Senatin Francez Paris, "Familjet fisnike Shqiptare në mbrojtje të Hebrenjve". Tre ditë më pas ai referon në selinë e OKB-së në Neë York "Fisnikëria e familjeve shqiptare dhe humanizmi i tyre për shpëtimin e jetëve të hebrenjve gjatë luftës së dytë botërore".

Është pjesëtar dhe referues i delegacionit shqiptar në Konferencën ndërkombëtare organizuar në Berlin- Gjermani me temë: "Eksperiencia gjermane domosdoshmëri, në dokumentimin e krimeve të komunizmit".

Nën devizën "Dënimi i krimeve të komunizmit është drejtësi", themeluesi dhe drejtuesi i Unionit Mbarëkombëtar të Integritetit të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, insiston në kërkesën që mazhoranca aktuale të bëjë ndarjen nga e shkuara komuniste, të dënojë krimet e komunizmit. " Dënimi i krimeve të komunizmit është drejtësi dhe jo hakmarrje siç e përdor politika shqiptare, sepse vetëm

kështu mund t'i japim vendit një të ardhme të sigurve demokratike dhe europiane”,-shprehet zotiNdregjoni. Për këtë kalorës të fjalës së lirë, të përkushtuar maksimalisht në mbrojtje të lirive dhe të drejtave njerëzore, u organizua ceremonia e dhënies së titullit “Nderi i Qarkut të Tiranës, nga Këshilli i Qarkut të kryeqytetit, ndërkohë që qindra pjesëmarrësit nga institucionet qendrore e vendore ndoqën me interes të jashtëzakonshëm dhe dokumentarin “Misionari i palodhur në dokumentimin e krimeve të komunizmit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive civile të përndjekurve politike”, përgatitur nga gazetari i mirënjohur i RTSH, Defrim Methasani.

110 vjetori i lindjes – Akademi solemne në nder të themeluesit të
Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore

GANI STRAZIMIRI, KRYEARKITEKTI I TIRANËS SË VITEVE "50-60-TË"



- Si e vlerësojnë Gani Strazimirin, Aleksandër Mexhi, Neritan Ceka, Apollon Baçe, Saimir Shatku, Artan Shkreli
- Në saj të kontributit të tij të madh dhe në bashkëpunim me specialistë të shquar vendas e të huaj, u përcaktua zona muzeale e qytetit të Beratit, sipas vlerave të saj historike e ndërtimore, duke arritur kështu një përvojë konkrete, për të vazhduar më tej me zonifikimin e qendrave të tjera historiko-kulturore të Shqipërisë, si Gjirokastra apo të komplekseve muzeale të pazareve të Krujës dhe të Korçës

Themeluesi i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Mbrojtjes të Institucioneve të Kultit në Shqipëri, arkitekti Gani Strazimiri është përkujtuar të hënën më 10 mars 2025 me një akademi solemne në hollin e Teatrit të Operas dhe Baletit në Tiranë.

Vepra e arkitektit të mirënjohur, u vlerësua nga personalitete akademike, si ish-kryeministri i Shqipërisë, Prof. Aleksandër Meksi, Prof. dr. Neritan Ceka, akademik Apollon Baçe, Prof. dr. Pirro Thomo, arkitekt Artan Shkreli etj.

Organizatori i kësaj akademie, Prof.as.Dr.Saimir Shatku, njëherësh kryetar i Shoqatës Bashkësia Dibrane, në çelje të këtij eventi në praninë e qindra pjesëmarrësve të botës akademike, nga Tirana dhe Dibra e Madhe, ndër të tjera tha se: “Arkitekti i njohur dhe urbanisti Gani Strazimiri dhe vëllai i tij, Lutfi Strazimiri bëjnë pjesë në plejadën e atyre figurave dhe personaliteteve të Arkitekturës dhe urbanistikës që kontribuan në gjysmën e dytë të shek. XX, pas Luftës së Dytë Botërore dhe çlirimit të Shqipërisë në ndërtimin e një sërë veprash publike, në rregullimin e ndërtesave të dëmtuara nga luftat etj”.

Z. Shatku tha se mbiemrin Strazimiri e ka njohur në familjen e tij që kur ka qenë fëmijë nga gjyshja për lidhjet e tyre, ndërsa emrin e arkitektit të njohur Gani, e ka njohur kur ishte me studimet magjistrale në Universitetin e Studimeve në Torino, kur takoi znj. Erica Facci, bashkëshortja e Ganiut, në Maj të vitit 2008 në Torino dhe ajo i ka folur për Ganiun, studimet e tij në Moskë dhe në Torino dhe lidhjet e tij me miqtë, kolegët dhe personalitetet e kohës si Petrit Radovicka etj.

Firmën e Gani Strazimitit mbajnë edhe sot mjaft vepra publike të arkitekturës së tij të veçantë, si ndertimet tek Pallatet e Shallvareve, Hotel Adriatik në Durres, Parku Rinia i inaguruar në vitin 1959 etj. Po ashtu është i nohur kontributi i tij i mbrojtjes së monumenteve të Kultit.

Rolin e Prof. Gani Strazimitit në themelimin dhe konsolidimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Mbrojtjes të Institucioneve të Kultit në Shqipëri e evidenoj më së miri ish-kryeministri Meksi, student i Prof. Strazimitit në vitin e tretë më 1953.

“Ky Institut u projektua nga Prof. Strazimiri që në vitet 50-të, por inaugurimi i tij u bë në vitin 1965. Kjo falë personalitetit të Gani Strazimitit që nuk donte t’ia dinte për asnjë nga ndalimet e kohës. Ai merrej me gjurmimit e monumenteve në gjithë Shqipërinë”, -tha Prof.Meksi. Më tej ai foli për rolin e G. Strazimitit për implementimin e Kartës së Restaurimit pa zhurmë, ndonëse ajo ishte perëndimore. Duke e vlerëzuar arkitektin G. Strazimiri si një personalitet shmëdimensional, z. Meksi foli për rolin dhe

punën e tij konkrete në krijimin e seteve monumentale. “Prof. Ganiu ishte shumë rigoroz, një figurë, tribunë e historisë së kombit tonë. Ishte këmbëngulja e tij që u tejkaluan episodet e viteve 67 – 69 kur na akuzonin se kemi rënë pre e ideologjisë borgjeze e fetare”, tha Prof. Meksi.

Në të njetën linjë, edhe kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe Dr. Hekuran Duka e vlerësoi prof. Gani Strazimirin si një figurë e shquar që la gjurmë në historinë e arkitekturës shqiptare. “Me formimin e tij akademik ai la një trashëgimi të pasur arkitektonike. Shpëtoi nga shkatërrimi shumë objekte fetare e kulturore që rrezikoheshin nga shkatërrimi”,-tha ndër të tjera kryekomunari i Dibrës së Madhe.

Akademik Apollon Baçe, tha se që kur erdhi në krye të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore para 15 viteve iu referua përvojës së prof. Gani Strazimirin si themelues i këtij instituti. Ai vlerësoi guximin, finesën unikale me të cilën G.Strazimiri i kundërihej kryeministrit të shtë të asaj kohe Mehmet Shehu. Madje sipas tij, kur bota në shumë aspekte na njihte për keq, ishte vizioni bashkëkohor i prof. Gani Kryeziut që bëri që Insituti ynë i Trashëgimisë Kulturor të njihej e vlerësohej si model. Ky institut në fillim mori emrin e Gani Strazimit, por që pas disa vitesh iu hoq pa asnjë justifikim ky emër, sipas akademik Apollon Baçe. Ai tha se Ganiu si drejtor inspektonte vetë çdo objekt.

Vepra e kryearkitektit të Shqipërisë të viteve '60 u vlerësua dhe nga Prof. dr. Neritan Ceka. Ndër të tjera ai tha se është detyrë e shtetit që ata që themeluan esencën e tij të vlerësohen. “Për mua ka qenë fat që isha pjesë e institutit që krijoi dhe drejtoi Gani Strazimiri. Ai shkëlqente për njerzillëkum, për aftësitë e veçanta për të punuar me të rinjtë. Pavarësisht përpjekjeve aventureske për ta shpërbërë qëndron në themelet e këtij Instituti sakrifica me rrezik për ruajtjen e monumenteve të kulturës e të kultit. Emri i tij duhet ti vihet prapë institutit, heqja qe padrejtësi”, tha akademik Neritan Ceka.

Edhe drejtoresha aktuale e këtij Inatituti Joli Mitrojorgji, si ish nxënëse e largët e prof.Strazimit tha se në detyrën e saj që nga viti 2013 është frymëzuar nga vepra e Prof. G.Strazimirin. Sepse Ai ka ditur ti mbrojë dhe përçojë vlerat tona kontinentale, ndaj duhet të rikthehemi te mësimet e tij.

Një leksion më të zgjeruar për veprën monumentale të prof. Gani Strazimit mbajti edhe prof. dr. Pirro Toma. Ndërsa arkitekt Artan Shkreli,

i angazhuar për shkrimin e një monografie për Gani Strazimirin tha se mund ta përfundojë atë brenda vitit

Folësit në këtë akademi solemne u shprehën me mirënjohje për rolin e jashtëzakonshëm që ka luajtur Prof. Gani Strazimiri në fushën e historisë së arkitekturës shqiptare, veçanërisht në përcaktimin e zonave historike të arkitekturës popullore në vend dhe të shpalljes së Gjirokastrës e Beratit qytete-muze si dhe të komplekseve muzeale të pazareve të Krujës e Korçës.

SI E REFUZOI POSTIN E ZËVENDËS MINISTRIT TË NDËRTIMIT

Gazeta “Tema” e datës 27 Maj 2020, referuar studjuesit të mirënjohur Dashmor Kaloçi, ndër të tjera shkruan se si e refuzoi arkitekti Gani Strazimiri vendimin e Byrosë Politike për emërimin e tij në postin e zv/ministrit të Ndërtimit.

Në vitin 1950, pasi u diplomua me rezultate të larta, Gani Strazimir kthehet në atdhe ku emërohet si Kryeprojektues në Zyrën e Urbanistikës dhe Projektimit të Tiranës me drejtor, Sali Angonin, i diplomuar në Francë, në periudhën e Monarkisë së Zogut. Dy vjet më vonë, në 1952-in, Byroja Politike e Komitetit Qëndror të PPSH-së, vendosi që ai të emërohej në funksionin e zv/Ministrit të Ndërtimit, gjë e cila bëhet e ditur edhe nga dokumenti arkivor përkatës.

Vendimi shoqërohet me Relacionin përkatës se si Byroja Politike e Komitetit Qëndror të PPSH-së, në mbledhjen e saj të datës 18/IV/1952, rekomandon që shoku Gani Strazimiri të emërohet Nd/Ministër i Ministrisë së Ndërtimit. (Firmosur nga Kryetar i Degës së Kuadrit, Raqi Shamblli më 28. IV.1952)

Por me këtë emërim nuk ishte dakort vetë Gani Strazimiri, i cili gjeti mënyrat dhe e refuzoi atë detyrë që i ngarkuan, gjë e cila pasqyrohet edhe në një dokument tjetër (sekret) të Degës së Kuadrit mbi mosaprovimin e shokut Gani Strazimiri, për Ndihmës Ministër i Ndërtimit.

Pas refuzimit të postit të zv/ministrit të Ndërtimit, Gani Strazimiri vazhdoi punën e tij si Kryearkitekt i Zyrës së Projektimit të Tiranës, duke u marrë me planin rregullues të kryeqytetit. Por krahas asaj pune voluminoze, në vitet në vijim, ai shërbeu edhe si Shef i Katedrës së Arkitekturës në Fakultetin e Arkitekturës në Universitetin e Tiranës.

PËRPLASJA E STRAZIMIRIT ME RUSËT PËR VENDIN KU DO NDËRTOHEJ PALLATI I KULTURËD DHE ME KRYEMINISTRIN SHEHU PËR PRISHJEN E BEZISTANIT TË SHKODRËS

“Memorie. Al” ka publikuan historinë e panjohur të arkitekt Gani Strazimirit me origjinë nga rrethi i Dibrës, i cili në periudhën e Monarkisë së Zogut studjoi në Universitetin Politeknik të Torinos në degën e Arkitekturës, por i ndërperu studimet dhe u kthye në atdhe, për t’u angazhuar në Lëvizjen Antifashiste, fillimisht me njësit guerile të Tiranës dhe më pas në rrethin e Dibrës, ku shtëpia e tyre ishte një nga bazat më të mëdha të Luftës dhe babai i tij, Ismail Strazimiri, u vra nga gjermanët që bombarduan shtëpinë e tyre me artileri. Dërgimi i Ganiut për studime në Bashkimin Sovjetik menjëherë pas mbarimit të Luftës dhe diplomimi i tij në vitin 1950 në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Moskës, në degën e Arkitekturës dhe kthimi në Tiranë duke u emëruar si kryearkitekt i Zyrës së Urbanistikës, ku ai u muarr me planin rregullues të kryeqytetit, gjë të cilën ai e kishte filluar që në periudhën e studimeve në Moskë, ku kishte konsulencën e dy arkitektëve të njohur rus, Kratjuk dhe Polyakov, të cilët erdhën edhe vetë në Tiranë duke studjuar nga afër terrenin. Përplasja e Strazimirit më pas me specialistët rusë për vendin se ku do ndërtohej Pallati i madh i Kulturës, dhe tërheqja e tij më pas nga ajo punë, duke kaluar te Instituti i Monumenteve të Kulturës, të cilin ai e themeloi vetë dhe përplasja më pas me autoritetet partiake e shtetërore, deri në rangjet më të larta, si ajo me kryeministrin Mehmet Shehu, për prishjen e Bezistanit të Shkodrës, apo Kishës së Shën Mërisë, ku ai bëri denoncimet në Prokurori, duke i konsideruar ato si krime të rënda që duheshin ndëshkuar penalisht.

LUFTA E ASHPËR ME AUTORITETET PARTIAKE E SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE

Lidhur me punën e madhe që ka bërë arkitekt Gani Strazimiri gjatë gjithë asaj periudhe që ishte në drejtimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, veç të tjerash flasin me një konsideratë dhe veneracion të madh edhe ish-bashkëpunëtorët dhe vartësit e tij. Një ndër ata është dhe profesor Emin Riza, i cili mes të tjerash shprehet: “Nën drejtimin e Gani Strazimirit, bashkë me bashkëpunëtorët, hartuam tekstin e parë të Historisë të Artit të

Arkitekturës Shqiptare dhe kjo hyri si lëndë në Fakultetin e Arkitekturës. Ndërsa sipas, mikut dhe bashkëpunëtorit të tij, arkitektit, Koço Miho, idea e arkitekt Gani Strazimirit për përcaktimin e “vijave të verdha” për ndarjen e qyteteve nga zonat rurale, si dhe përcaktimi i zonave të banuara nga ato industrial, qenë një koncept madhor për kohën”. Gjithashtu në memorien e ish-vartësëve të tij në Institutin e Monumenteve, mbetën të paharruara përplasjet e përditëshme të drejtorit Strazimiri, me autoritetet partiake dhe shtetërore të asaj kohe, për mbrojtjen e monumenteve të kulturës. Gjë e cila u acarua së tepërmi pas vitit 1965, kur regjimi komunist filloi luftën kundër besimeve fetare dhe nisi aksionin e madh për prishjen dhe shkatërrimin e objekteve të kultit, ku pothuaj pjesa më e madhe e tyre ishin monumente kulture dhe thesare të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar. Vlen për t’u përmendur vandalizmi i regjimit komunist ndaj disa objekteve të rralla dhe unikale të trashëgimisë kulturore në Shqipëri, si: Kisha e Shën Mërisë, në Qyrsaq të Vaut të Dejës në Qarkun e Shkodrës, Bezistani (Pazari vjetër) në hyrje të qytetit të Shkodrës afër bregut të Bunës dhe liqenit, Hamami etj., të cilat u shkatërruan plotësisht. Kjo gjë e irritoi pa masë Gani Strazimirin dhe ai përdori të gjithë fuqitë e mundësitë e tij, duke denoncuar në Prokurori dhe duke hedhur në gjyq autoritetet shtetërore që kishin kryer atë “vepër kriminale” siç e cilësonte ai, por megjithë përpjekjet e tij të jashtëzakonëshme, shumë monumente të pakthyeshëm u shkatërruan plotësisht.

THEMELUES I SHKENCËS SË RESTAURIMIT NË SHQIPËRI

Prof. Gani Strazimiri u vlerësua si një nga figurat më të shquara të arkitekturës dhe si themelues i shkencës së restaurimit në Shqipëri në të gjitha disiplinat e saj, i cili dha kontribut të madh në ruajtjen e vlerave arkitekturore të traditës shqiptare.

Prof. Gani Starizimiri si themelues i Institutit të Monumenteve të Kulturës, u vlerësua për mbrojtjen me vendosmëri, kurajë intelektuale e qytetare të çdo monumenti kulture në vendin tonë si dhe për formimin e një brez të shquar restauruesish, që vazhdoi rrugën e shtruar prej tij.

I lindur në Maqellarë, të Dibrës, Gani Strazimiri shfaqti që në fëmijëri, prirje për artin dhe veprimtarinë ndërtimore. Kjo prirje bëri që të vazhdonte studimet për arkitekturë në Universitetin e Torinos, që i ndërpreu për të

kontribuar për çlirimin e Atdheut, në Luftën Antifashiste. Ndërkohë më pas ai përfundoi studimet në Bashkimin Sovjetik dhe filloi punë si arkitekt e projektues i objekteve shoqërore dhe ato të banimit, për të kaluar më pas, përfundimisht, në fushën e studimeve të ndërtimeve arkitekturore, ku u shqua për përkushtimin dhe talentin e tij. Profesor Stazimiri ishte i bindur në rëndësinë e krijimit të specialistëve të përgatitur për fusha me rëndësi kombëtare, në veçanti si ajo e monumenteve të kulturës në Shqipëri. Në saj të kontributit të tij të madh dhe në bashkëpunim me specialistë të shquar vendas e të huaj, u përcaktua zona muzeale e qytetit të Beratit, sipas vlerave të saj historike e ndërtimore, duke arritur kështu një përvojë konkrete, për të vazhduar më tej me zonifikimin e qendrave të tjera historiko-kulturore të Shqipërisë, si Gjirokastra apo të komplekseve muzeale të pazareve të Krujës dhe të Korçës.

“MOTORI” I PËRGATITJES PROFESIONALE TË ARKITEKTËVE TË MIRËNJOHUR

60 vite më pare (në vitin 1965), profesor Stazimiri bëhet themeluesi dhe drejtori i parë i Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe ‘motori’ i përgatitjes profesionale të shumë specialistëve të shquar, si Aleksandër Meksi, Emin Riza, Pirro Thomo, Apollon Baçe, Buron Kaceli, Valter Shtylla, Gjerak Karaiskaj e shumë të tjerë, të cilët nga ajo kohë e më vonë, do të bënin emër dhe jo vetëm në fushën e tyre. Evidentimi dhe më pas ruajtja e restaurimi i vlerave monumentale dhe arkitekturore të vendit u bënë objekti parësor i punës së Institutit të Monumenteve të Kulturës të drejtuar nga Gani Strazimiri.

Nëse para pesë vitesh Presidentii Republikës dekoroi arkitektin e shquar Gani Strazimiri (pas vdekjes) me Titullin e lartë “ Kalorës i Urdhërit të Skëndebeut”, dje ishte Shoqata Bashkësia Dibrane që i dha atij Titullin “Fisnikëria e Bashkësisë Dibrane në Tiranë” për kontributin e shquar dhe përkushtimin në projektimin e një sërë veprash publike

Në këtë akademi silemne merrnin pjesë dhe përfaqësues të familjeve të mëdhs të komunitetit dibran në Tiranë, kryetari i të urtve Tofik Jegeni, Prof. Bujar Kapexhiu-Nderi Kombit, Ing. i Rugës së Arbërit Faruk Kaba, Ing. Dr. Orhan Sakiqi, Kryetari i Shoqatës Tirana Prof. Ruzhdi Keçi si dhe dhjetra persoaliete tjera akademike.

RAMAZAN SULEJMANI, PROFILI I INTELEKTUALIT SHUMËDIMENSIONAL

- Një nga intelektualët e njohur dibranë, që shërbeu për shumë vite me devotshmëri e përkushtim maksimal në drejtimin e ndërmarrjeve e institucioneve kryesore në Peshkopi, Bulqizë dhe Tiranë, është padyshim edhe Ramazan Sulejmani. Profili itij është ai i intelektualit shumëdimensional, i skalituar në sa e sa projekte, jo vetëm në Bulqizë ku kaloi pjesën më të madhe të jetës, por edhe në metropolin shqiptar, në Tiranë

Ramazan Sulejmani lindi në Shumbat të Dibrës më 08.08.1950. Shkollën fillore e mbaroi në fshatin e lindjes. Më pas vazhdoi Shkollën e mesme për Gjeologji-miniera në Prrenjas. Studimet e larta i kreu pranë Universitetit të Tiranës në degën Ekonomi-financë. U punësua në Ndërmarrjen Gjeologjike Bulqizë, ku punoi për një kohë të gjatë si kryenormist në sektorë të gjeologjisë në Peshkopi dhe më vonë si shef finance në të njejtën ndërmarrje në Bulqizë. Për 20 vite punoi dhe jetoi në Bulqizë duke kryer detyra të rëndësishme si drejtor i ndërmarrjes së Furnizimit të Punëtorëve, drejtor i Bankës Bulqizë, si këshilltar aktiv në këshillin e rajonit të Bulqizës dhe aktivist në lëvizjen kulturore, politike dhe intelektuale të Bulqizës. Kontributi i tij që mjaft i çmuar veçanërisht në vitet e demokracisë, kur Ramazani ishte një intelektual me shumë reputacion dhe integritet, i lidhur me njerëzit dhe mjaft karizmatik, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e proceseve demokratike në qytetin e Bulqizës. Në vitin 1997 transferohet në Tiranë ku intensifikon punën për kualifikimin profesional pasuniversitar për financë duke u licensuar



si kontabilist i miratuar. Ai ishte një intelektual i formuar dhe vizionar, debatues për probleme shkencore ekonomiko-financiare, duke dhënë kontribut për shumë vite në drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, (VIP-at), si specialist dhe shef departamenti, duke kontribuar drejtpërdrejt në përsosjen e sistemit të tatimeve dhe duke mbajtur një qëndrim shembullor si punonjës i shtetit. Ai ishte një njohës shumë i mirë i ligjit dhe i të drejtës, i punës në administratë dhe kishte një performancë të shkëlqyer në sjelljen politike dhe administrative. Në tre mandate radhazi është zgjedhur këshilltar në njësinë Bashkiake nr.11,Tiranë, si përfaqësues i Partisë Demokratike, duke dhënë një shembull mjaft të mirë në komunikimin institucional dhe politik dhe duke ndihmuar profesionalisht në sektorin e menaxhimit të financave publike të Njësisë Bashkiake, në Laprakë. Një vit pasi doli në pension, u nda nga jeta pas një sëmundje të pashërueshme me gjithë përkushtimin e familjes dhe të institucioneve shëndetësore. Ramazani ishte organikisht njeri i kulturës, i ekonomisë dhe politikës. I rritur në klimën e varfërisë së përgjithshme të fshatit të tij Shumbat i Dibrës, te Ramazani do të ngjizej një nga vetitë më të çmuara të shoqërisë njerëzore: humanizmi dhe afiniteti social. Shpesh herë e dëgjonim shqetësimin e tij për vuajtjen e të tjerëve, athua ai kishte përgjegjësi për të tjerët më shumë se gjithkush. Ishte njeri i familjarizuar me botën e shpirtit dhe intelektualit. Me shpirt civilizues. Dukepatur një gatim të tillë, ai ishte ndër të rrallët që ndihmonte kaq shumë rrethin e tij familjar. Ramazani i kishte dhënë vetes lirinë të punonte me zell e frymëzim për familjen dhe fëmijët e tij. Të përzgjidhte gjatë jetës miqtë dhe shokët më të mirë. Ata që kishin të njëjtin grup gjaku me të, të këndonte dhe të kuvendonte me to për qejf të vet, të dëfrente pa bujë; tolerant në mënyrën se si hynte në lidhje me jetën, si kënaqej me ato që e rrethonin, si pasionohej pas muzikës, valles, shakave dhe humorit të këndshëm. Ishte modest dhe nuk kërkonte vëmendje, sepse kishte lindur me shenjën për t'u bërë dhurata të tjerëve dhe ashtu shkoi, duke mos i pasur borxh njeriu, por duke e lënë pengun tek të gjithë ata që e deshën dhe e nderuan gjatë jetës. Kur dikush vdes, lëvdatat nuk kursehen, por ky shkrim për Ramazan Sulejmanin nuk është lëvdim, as vajtim, është kërkimi i asaj që la pas, përtej kujtimeve.



**“VETËM UNË DHE AI KEMI FORCËN TË BËJMË QIELL E TOKË
BASHKË”**

SILVANA SULEJMANI, e bija që e deshi aq shumë dhe i qëndroi afër gjithmonë, më 05.12.2017, nga Londra shkruan: “Dhimbja më shtriu dorën... se di pse ja zgjata si për ta ndihmuar; ajo më tërhoqi pas vetes! Si një viktimë e denjë u dergja rrugës së saj, si mjegull ja mbaj mend fytyrën. Më përqafoi nxirja e qiellit dhe nuk munda të ikja, po ashtu me kokën këputur prej trishtimit, lotoja në kraharohin e saj. Qaja, qaja e me atë pak forcë doja të shkëputesha. I ziu qiell më kish zgjatur duart për të mos m’i lënë kollaj. Kërkova ngultaz të dija një të vërtetë, që ishte ti ai që më përqafoje prej lart. E dija, e dija fort mirë që veç ti kishe forcën të ma mbaje shpirtin peng. Ndër duar veç gjakut që gëlonte në vena, gurgullonte një shpresë e ethshme, me vete thoja: do të më shohë mua e do të zgjohet. Vetëm unë edhe ai kishim aq fuqi ndërmjet njëri tjetrit! Tani vetëm unë dhe ai kemi forcën të bëjmë qiell e tokë bashkë sot. Sa gërma më mbetën pathënë, sa ditëlindje e sa fjalë kisha ruajtur për ty në sundukun e thesarëve që veç ty të përkasin. Më ke lënë një dekoratë jete, atë të krenarisë së bijës shpirtlumtur. Më ke lënë veten tek unë! Më ke lënë gjithësinë. Ndërsa unë të kam dhënë me vete shpirtin tim, ai nuk vdes kurrë. Do të ishte ditë e dielë, kafën prapë bashkë do t’a konsumonim, do të visheshim të dy njësoj si përherë e ti me sytë e qeshur do të përsërisje edhe njëherë refrenin tonë: “ti je goca babit!”. Shoku im ti, prap në kafe do më gjesh të dielën, do të porosis dy si gjithmonë, një për vete një për ty, do të bëjmë foton tonë të

zakonshme e do të diskutojmë për pasione e gjëra që na gëzojnë! Do të debatojmë e në fund do të mbajmë edhe inate, e ti si përherë do më vish prap me 1000 copëza lumturie që të shkëlqenin në sy; do më vish atëherë kur më së shumti do të të dua e si gjithmonë do t'i gëzohesh vendimeve të mia! Do të doja të më kishe thënë njëherë jo, të më kishe kundërshtuar për kapriço e për teka të kota, do të doja njëherë të vetme të guxoje të vije veten në vend të parë, por në gufimin e rrahjeve të zemrës fryhej veç dëshira për të më bërë të lumtur... Është një libër aty, ti e preke me krenarinë e pashoq të zemrës plot të babait të lumtur. Qershorit tim, i dhe dimension tjetër, qershori im nuk është më njësoj, qershori im u bë i yti! Ditëlindjet e mia nuk do të jenë më të njëjtat, ti nuk do të vish si çdo herë për të më zgjuar e uruar i pari, ti nuk do garosh me mamin për të më dhënë bekimet, ti nuk do të vish më tek unë, sepse tashmë ti je me mua në çdo hap që bëj, ti je e hëna ime, zgjimi, hapat, të shtunat, të qeshurat, ti me aureolën tënde ecën me mua! E ndjej se si qesh fytyra jote bashkë me qiellin. Asnjëherë nuk do të shoh me sytë lart duke lotuar; m'a ke lënë zemrën plot dhe të vetmin thesar që e kam kyçur me premtimet, është se do të jem e lumtur, sepse e di, e di fort mirë që lumturia ime është gjithë jeta jote! Shihemi në ëndërr, vetëm aty takohen shpirtrat e lënë peng! Përgjithmonë e vogla jote...". Me rastin e 1 vjetorit të vdekjes Silvana, e bija do të shkruaj ne faqen e saj në fb: "Sikur njëmijë vargje t'i shkruaj, e di që nuk do të mundesha të them atë që vërtetë Ti përfaqëson për mua, atë lidhje të fortë të pamposhtur midis nesh, atë aleancë të përjetëshme tonën që jeton edhe kështu... Ti me ëngjëjt në qiell, unë këtu duke të të pasur kudo me vete. Do të doja shumë që të vizitoja për një çast parajsën në një përqaftim të më thoje se gjithçka do të shkojë mirë. Mungon!"

“SA SHUMË NA MUNGON !

Bashkëfshatari, shoku i tij i afërt HAJRI MANDRI shkruan në kujtim të Ramazan Sulejmanit: “Sa shumë na mungon ! Ti ike, ike shpejt sikur i mbarove të gjitha punët, të gjitha përkushtimet, të gjitha kënaqësitë me miqtë njerëzit dhe shokët... dhe ike... Ike duke lënë prapa imazhin e gjallë dhe të paharrueshëm, kujtime të mrekullueshme, respektin dhe dashurinë e pakufijshme me familjen, miqtë dhe shokët. Edhe unë jam me fat që ruaj në mendje dhe në zemër zgjatimin e jetës tënde drejt përjetësisë, se është

fat të njiheshe nga afër dhe të rrije me Ty, pranë Teje dhe të mrekulloheshe nga fjala, mendimi, qeshja, humanizmi, mençuria, shkathhtësia, shakaja, kënga, vjersha, rrëfimet, fjalimet, argumentimet... Të rrije me ty e kishim kohën të fituar dhjetëfish nga inteligjenca që ndaje dhe humaniteti që dhuroje. I freskët ende dhe i gjallë në kujtesën e shokëve mbetesh, ashtu i gjallë dhe impulsiv, me sytë e shkruar plot çiltërsi që rrezatonin mesazhe shprese dhe optimizmi, me një shpirt të demokratizuar dhe konfident. Me këdo ndaje qëndrime dhe vlera si kuadër drejtues si intelektual me inteligjenca të shumëfisha dhe energji pozitive. Ti, ike, ike shpejt fizikisht por jeton në kujtesën e të gjithë atyre që patën fatin të të njohin nga afër. Njeriu vdes vetëm kur harrohet. Ti jeton, jeton midis nesh po ashtu i dashur, i qeshur, kryelartë e babaxhan dhe unë ndjej se ende jemi bashkë duke shëtitur në Bulqizë, Laprakë apo Stamboll. Ike... pa lamtumirë duke lënë prapa kujtimet e paharruara. I paqtë dhe i paharruar qoftë shoku ynë, Ramazan Sulejmani”.

NJË INTELEKTUAL I FORMUAR NGA TË GJITHA FUSHAT

Ramazani duke qenë një intelektual i formuar nga të gjitha fushat: politike, administrative, ekonomike, sociale, kulturore ngrihej mbi përditshmërinë banale të jetës dhe shikonte larg si vizionar. Ndaj familja, bashkëshortja Nazife që punoi një jetë si infermiere e përkushtuar, djemtë Arturi (simbol i intelektualit shembullor e korrekt në një institucion të rëndësishëm ligjzbatues) dhe Flori (jurist i shquar-ndër drejtorët më të suksesshëm të AMP), vajza Silvana që e donte pafund, shokët, miqtë dhe të afërmit do ta kujtojnë kurdoherë me respekt dhe mirënjohje të thellë. Le të jenë këto shënime një homazh për jetën dhe veprën e tij.

PROF. SHPËTIM CAMI “KOHERENT ME ATO ÇKA THOTË E BËN”



- Si Kryetar i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë i ka dhënë asaj dimensionin mbarëkombëtar, duke promovuar vlerat më të mira historike, njerëzore dhe intelektuale dibrane.

Pasi ke lexuar librin “KOHERENCË” të autorit Shpëtim Cami – botim i “M&B”, nuk ka se si të mos i bashkohesh vlerësimit të Prof. asoc. Dr. Zamira Çavos, pasi me të vërtetë në të gjen shpirtin dhe veprën e një njeriu koherent me ato çka thotë e bën.

I kompozuar në formën e një triptiku (*me tre kapituj: Vlera dhe personalitete; Opinione dhe analiza; Politika dhe qeverisja si përgjegjësi*) libri “Koherencë” përçon tek lexuesi mesazhet e një intelektualit me vitalitet e shpirt krijues. Autori e bën këtë në 38 shkrimet që i përgjigjen titullit të librit, si profile, reportazhe, analiza e refleksione. Ai ka meritën që t’i paraqesë personazhet dhe ngjarjet në mënyrë sugjестive, me thjeshtësi dhe në mënyrë të perceptueshme në komentet dhe në arsyetimet e veta.

Në tërësinë e lëndës ndjehet dora e një publicisti të përgatitur, që shkruan me ndjenjë e me stil, cilësi këto që e bëjnë interesant këtë libër për lexuesin. Në këtë pikëpamje libri ka vlera të njëmendta dhe është i rëndësishëm fakti që është botuar bash në kohën e duhur.

Duke evidentuar dhe përçar tek lexuesi vlera të veçanta, me qartësi mendimi dhe me stil të mprehtë, autori shkruan për personalitete të cilat, edhe pse nuk jetojnë, do të ishin në unison me të, në shqetësimin e tij për të ardhmen e kombit, për Shqipërinë. Shembulli më sinjifikativ për këtë është *profili i Prof. Nuri Abdiut, si emblemë e fisnikërisë, urtësisë dhe mençurisë dibrane. Madje, autori ia dedidon pikërisht këtij dishepulli të dijës edhe zgjedhjen e tij në dilemat midis fushës akademike dhe asaj politiko-administrative.*

Ndonëse me përvojë jo të pakët në këtë të fundit (si ish – Përgjegjës i Sektorit të Statistikës dhe Informacionit në Drejtorinë Arsimore Kurbin; ish - Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Transportit Rrugor, anëtar i Këshillit të Bashkisë Tirnë, Kryetar i Njësisë Bashkiake Nr.1, Tiranë, etj), referuar prof. Abdiut, autori shkruan se Ai, pa u menduar gjatë i ka rekomanduar që të angazhohet në fushën akademike. Rezultati i kësaj përzgjedhjeje është përvoja mbi 15-vjeçare e Shpëtim Camit në sistemin e arsimit të lartë, si pedagog dhe drejtues në disa universitete jopublike prestigjioze të Tiranës dhe në Universitetin Ndërkombëtar Strugë, Maqedoni e Veriut. *Aktualisht ushtron detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit Universitar të Biznesit, që është një nga universitetet më me emër e ndër më të preferuarit nga maturantët e studentët, jo vetëm në Tiranë, por nga të gjitha rrethet.*

U ndala jo pa qëllim, pak në CV-në e këtij autori, për të evidentuar implementimin e kësaj përvoje gati mbi 40-vjeçare në fushën e arsimit, politikës, administratës, shoqërisë civile, biznesit dhe në fushën e botimeve, si edhe në këtë liber.

Kështu, në kapitullin e parë “*Vlera dhe personalitete*”, autori shkruan me frymëzim, por edhe me plotë emocione dhe krenari të ligjshme për “*Gjoricën, fshatin midis ujrave*”, si recensë të librit të bashkëautorëve Qemal osmani e Shaqir Skarra.

Me mjeshtri të rrallë artistike autori sjell edhe jehonën e këngës dibrane në Kurbin, nëpërmjet zërit brilant të artistes së mirënjohur Liri Rasha, dekoruar nga Presidenti i Republikës me titujt “Mjeshër i Madh” dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”. Për këtë ai i referohet kohës kur kjo artiste më 1994, me bashkëshortin e saj Pashk Jushi erdhën të jetonin pranë të afërmeve të tij në qytetin e Laçit. “*Pavarësisht se në Laç*

mungonte tradita e këngës si në Dibër, Liria kontribuonte, jo vetëm me zërin, por edhe me përvojën e saj artistike. Ajo ishte pjesë e koncerteve me orkestrën e Pallatit të Kulturës Laç dhe Krujë, të cilat u shfaqën jo vetëm në rrethin e Krujës e të Kurbinit, por edhe në Danimarkë e Belgjikë”, -shkruan autori Cami. Më tej ai i bën të ditur lexuesit se në Laç u rrit edhe e bija e Liri Rashës, Ingridi, trashëgimtarja e zërit kumbues të nënës së saj dhe që prej vitesh ka bërë emër si një zë i veçantë dhe interpretuese dinjtoze e këngës qytetare dibrane e asaj shqiptare në tërësi. Në morinë e vlerësimeve autori i librit shkruan për shkollën e fshatit Viçisht ku u skalitën dashuria për letërsinë dhe shkëncat e natyrës. Po ashtu në reportazhet “Një udhëtim buzë Korabit” e “Një ditë e veçantë me vlera të shumëfishta” (Nga fjala në “Ditën e librit”, zhvilluar nga Lidhja e Intelektualëve Dibranë në Shkollën “Hasan Leka, Shumbat) autori përcjell mesazhin se ka edhe vlera të mira ky vend, kjo krahinë, që duhen njohur, që duhen ndjekur e promovuar.

Ndërsa kur është fjala për Bulqizën “*pasuria me tre emra*”, Sh.Cami, përveçse përshkrimi brilant të pozitës gjeografike, fokusohet edhe në vendbanime të herëshme me gjetjet arkeologjike në Krajë të Zerqanit apo në Shupenzë, si edhe në fushën e Gjoricës, luginën e Fushë Bulqizës dhe të Vajkalit, që kanë hyrë në histori që nga koha e Skënderbeut. Pjesë e këtij libri racional, emocional, dokumentar, arkivor është edhe artikulli “*Sfida që duhen përballuar*”(Mbi kontributin dhe suksesin e Shoqatës Gryka e Vogël Dibër), si dhe intervista dhënë gazetës “Rruga e Arbërit” (“*Faktor të bën nevoja e përbashkët*”) kur Z.Cami ishte nënkryetar i Njësisë bashkiake Nr.1, Tiranë.

Ndërsa në kapitullin e dytë “**Opinione dhe analiza**” autori shpalos një shpirt të madh, gati parajsor, pothuajse në të gjitha shkrimet, si në analizën e librit me vlera globale të gjeneral Gëzim Ostrenit “*Dëshmia e Gjeneralit*”, ashtu edhe në këndvështrimin mediatik mbi luftën e UÇK-së në Maqedoninë e Veriut, për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut si faktor shtetformues, etj.

Testin e saktë të profesionalizmit të tij, Sh.Cami e kalon suksesshëm edhe në pjesën e portretizimit. Këtë ai e jep, jo vetëm në profilet e personazheve të spikatur (si në profillin e prof. Nuri Abdiut), por edhe kur shkruan për të njohur e të panjohur shumë për publikun, si për “*Vlerat qytetare*

të *Leko Makos*” ashtu edhe tek *“Heroi i shtangës”*, kushtuar peshëngritësit Aleksandër Kondo.

Në kapitullin e tretë *“Politika dhe qeverisja si përgjegjësi”* Sh. Cami është i drejtpërdrejtë me lexuesin e tij dhe konformizmi për të është i papranueshëm. Reflektim i këtij qëndrimi janë shkrimet *“Tirana, një model përtej të majtës e të djathtës”*, *“Të ndjesh përgjegjësinë e përfaqësimit”*, *“Fokusi i punës së ndërlidhësve me komunitetin”* etj.

Sh.Cami vjen kështu në tregun e librit shqiptar me një përmbledhje publicistike, sa modeste aq edhe mbresëlënëse. Thjesht dhe bukur, me gjuhë të pasur dhe me një ndjesi njerëzore, ai rrëfen, përshkruan, tregon fakte, ngjarje, jetë heronjsh dhe kontribute njerëzore. Me një gjuhë letrare dhe rrëfim të admirueshëm ato të emocionojnë për detajet e stilin që ai ka zgjedhur dhe që e bën origjinal.

Referuar fakteve që na sjell autori dhe libri i tij me reportazhe, portrete, analiza etj, vetë kultura në këtë libër shumë të detajuar dhe mjaft përfshirës është reflektim nga qasja, tradita, avancimi në njohjen e gjerë të veprave të marra në konsideratë, po ashtu dhe të personaliteve që autori i ridimensionon me thjeshtësinë e bukurinë e fjalës shqipe.

Profilin krijues të këtij autori e evidentojnë më së miri Prof. asoc. dr.Zamira Çavo dhe prof. asoc. dr. Bajram Yzeiraj, vlerësimet e të cilëve janë vënë që në hyrje të librit. Kështu nëse sipas Znj.Çavo: *“në këtë libër gjen komunikim njerëzor si dhe vlerësime për individë që kanë kontribuar në shoqëri heshtazi, pa pritur lëvdatat publike, por me besimin që një vepër e mirë nuk harrohet dot kollaj”*, për Z.Yzeiraj: *“botimi sjell një pjesë të jetës e veprimtarisë së autorit në kohë të ndryshme dhe njëherësh pasqyron vlerat e mjedisit familjar, shoqëror e shtetëror ku ai ka zhvilluar veprimtarinë e tij; si dhe problematikën e kohës në fushën politike të qeverisjes, të shoqëruar me përkushtimin e tij si intelektual, për ndryshim e zhvillim”*.

MUSA RIÇKU, PORTRETI I NJERIUT FISNIK



Fisnikëria e Musait është në një kuotë aq të lartë, sa si rrallëkush, arrin të bëjë bashkë krerët e politikës dibrane Rrallë ndodh që një njeri të përjetojë tri gëzime në një ditë, siç i përjetoj Musa Riçku në 60-vjetorin e ditëlindjes së tij, kur në një nga sallat kryesore të Hotel Tirana, u mbledhën qindra familjarë, të afërm e miq të shumtë.

Një ditëlindje që është ngulitur thellë, jo vetëm në memorien e Musait, bashkëshortes, Hasijes, djemve e të afërmëve të tyre, por të të gjithë dibranëve e miqve të tij përtej Dibrës, gjer në Kosovë, Vlorë e Devoll...

Një ditë vërtetë mbresëlënëse. Mbresa nga dokumentari kushtuar jetës dhe veprës së Musait, përgatitur me fantazi e profesionalizëm nga gazetari i talentuar, Defrim Methasani., vlerësime dhe fjalë zemre për Musain në promovimin e librit "MUSAI – Portret i njeriut fisnik" me autor Shaqir Skarrën, dhe si "qershia mbi tortë", titulli "QYTETAR NDERI I DIBRËS" akorduar nga këshilli bashkiak i rrethit verilindor. Fisnikëria e Musait është në një kuotë aq të lartë sa si rrallëkush arrin të bëjë bashkë krerët e politikës dibrane: deputetët e të gjitha partive, si dhe pothuajse të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak të Dibrës, pa dallime partiake.

Dhe në këtë ditë të shënuar për njeriun fisnik, që përveçse në Dibër

e Tiranë ka shërbyer me devotshmëri edhe në Bulqizë, s'kishte si të mungonin edhe miqtë e tij bulqizakë.

Shkrimtari i mirënjohur Agron Tufa, jo pa qëllim u shpreh se: “duke folur për dajë Musain, në mendje më ulet natyrshëm një krahasim me personazhet e suksesshëm të romancierit amerikan Theodore Dreiser.... Personazhet e Drajzerit e nisin karrierën e tyre nga hiri, për të mbërritur majat e suksesit në shoqërinë amerikane të fillimit të shekullit XX. Edhe Musai e nisi ngjitjen e tij nga pika më e ulët...Por sukseksi i dajë Musës është radikalisht i ndryshëm, sepse ai është i bazuar në themelet e etikës njerëzore, gjë tepër e rrallë kjo për parallinj të tanë“.

Dhe vërtetë: Mjafton të lexosh ditarët e Musait ndër vite për t'u bindur në thelbin e argumentit moral të këtij suksesit...

Një tjetër shkrimtar i suksesshëm dibran, Lutfi Hanku do të shprehej se: “Musa Riçku e çliroi shpirtin, duke e tjerë zgjuarsinë me fjalët e botës së dijes që mblodhi nga gjuha e mësuar e shkollës, në odat e kullave dibrane dhe nga valët e fjalës së Drinit, duke i shijuar këto fjalë nga shpirti i lirisë... Fryma e botës së vlerave të Musait nuk e shijon jetën përtej dëshirave të tij, sepse nuk është formuar si intelektual pa dritërimën e bindjes. Ndryshe nuk do t'i jepte emër jetës e të dritërohej në 36 shkronja nëpër libra”.

FAMILJAR I MIRË, MIK I VËRTETË, SHOK I PAPËRTUAR.....

Janë të shumtë personalitetet e botës së letrave, akademikë e profesorë që kanë dhënë vlerësime pozitive për Musa Riçkun. Prof.Dr.Edlira Haxhiymeri – Kryetare e Shoqatës “Lidhja Intelektuale Dibrane”, duke u ndalur në dimensionin njerëzor të Musa Riçkut, e vlerëson atë si familjar të mirë, mik të vërtetë, shok të papërtuar, qytetar të ndërgjegjësuar dhe si dibranin me zemër të madhe. “Është fat, themi ne shpesh, të kesh një familje të mirë. Por është zotësi”. Ndaj, Znj.Haxhiymeri beson se Musai ia ka dalë, me ndihmën e bashkëshortes, të ngrejë një familje që reflekton të gjitha vlerat e tij.

Në të njejtën linjë, edhe Dr.Hajri Mandri shprehet se formacioni shpirtëror i Musait është përmirësuar dhe zhvilluar nën ndikimin e nxitësve dhe stimujve socialë, i cili, duke pasur një përthithje inteligjente dhe mishërim të vetive më të mira, zhvillon përgjigje të vlefshme ndaj indikatorëve socialë, si reagim estetik që i shkaktojnë ndjenjën e kënaqësisë

e të përmbushjes morale. Madje, për Dr.Mandrin “Ajo që të lë mbresë të thellë në jetën, personalitetin dhe veprimtarinë e Musa Riçkut është vargu i gjatë i sponsorizimeve në fushën humane, dhuratë pa menduar këmbimin e tyre, kohëzgjatja në dekada e këtij inspirimi, sjellja ndaj vlerave dhe qasja ndaj njerëzve që përpiqen t’i përhapin ato”.

Këto anë të veçanta të karakterit të këtij dibrani të shquar, vepra e të cilit ka rrezatim mbarëkombëtar, i evidentuan më së miri në këtë aktivitet mbresëlënës, jo vetëm deputetët Sherefedin Shehu e Ulsi Manja, por dhe kreu i Komunës së Dibrës së Madhe, z.Rushdi Lata, vlonjati Vullnet Sina – President i “Big Market” si dhe dhjetra të tjerë që folën fjalë zemre për Musa Riçkun. Dhe vërtetë, siç përshkruhet në librin që u promovua në ditëlindjen e tij të 60-të: “Musai është përfaqësues i denjë i Limjanit, intelektual e punëtor i palodhur, familjar e bashkëshort i mirë.

Ai vazhdimisht ka pasur si qëllim evidentimin e vlerave humane e njerëzore të limjanasve dhe dibranëve. Musai është një gjysh i kujdesshëm, që nuk harron t’u përçojë nipave e mbesave dashurinë për vendin dhe origjinën. Ata janë tashmë frymëzimi dhe optimizmi i tij për të punuar edhe më shumë....”.

MISIONARI QË MBAN GJALLË VLERAT E MËDHA TË ARTIT DHE KULTURËS POPULLORE DIBRANE

Si nënkryetar i Shoqatës “Lidhja e Intelektualëve Dibranë” Musai do të mbante ndër vite peshën kryesore, si një ndër kontribuesit kryesorë. Disa nga veprimtaritë e Shoqatës, ku kontributi financiar i Musait është i konsiderueshëm janë: Sesionit Shkencor për Rrugën e Arbërit (2007), “Dibra në sytë e të huajve” (2008), “Përkuajtimi i 100-vjetorit të Kongresit të Dibrës” (2009), “Kontributi i Dibrës në pavarësimin e Shqipërisë” (2012), si dhe mjaftë veprimtari të tjera që Shoqata ka organizuar gjatë këtyre 10 viteve të ekzistencës së saj.

Musa Riçku, edhe për shkak të një trashëgime familjare, ka pasur një vëmendje të shtuar ndaj objekteve të kultit. Që nga viti 1996 vazhdimisht ka ndihmuar në rikonstruksionin e xhamive të ndryshme në Dibër, por edhe me iniciativën e tij për të ndërtuar një xhami për komunitetin mysliman në Laprakë. Janë me qindra veprimtaritë e sponsorizuara prej tij, që nga botimi i librave të autorëve dibranë, e deri tek ato me karakter humanitar

në ndihmë të të varfërve. Musai ka qenë gjithmonë mbështetje edhe për vëllezërit boksierë nga Bulqiza, Ismail e Gjetan Keta, të cilët na kanë nderuar në arenën ndërkombëtare, duke ngritur lart emrin e Bulqizës, të Dibrës dhe Shqipërisë.

Edhe në aktivitetin e organizuar më 19 shkurt 2016, ku Gjetan Keta u shpall nënkampion i botës, “Big Market Ken“ ishte një nga sponsorët, duke ndihmuar kështu një veprimtari sportive, e cila u transmetua drejtpërdrejtë në mbi 100 shtete të botës.

Nga libri “MUSAI – Portret i njeriut fisnik”, ndër të tjera mësojmë se ai është një nga misionarët e vetëm të Dibrës, që me kontributin e tij financiar ka bërë të mundur të mbajë gjallë vlerat e mëdha të artit dhe kulturës popullore dibrane. Madje, “Oda Dibrane”, një ndër veprimtaritë mbarëkombëtare që zhvillohet çdo vit në Dibër, prej 25 vitesh ka patur si sponsor kryesor edhe Musa Riçkun.

Për të gjitha këto, ky njeri që rrezaton mirësi në çdo aspekt të jetës së tij e meriton plotësisht titullin “Qytetar Nderi” i Dibrës dhe mirënjohjen e gjithë dibranëve.

U rritën me lavdinë e kombit, tani kombi lartësohet me lavdinë e tyre

DINASTIA E VËLLEZËRVE KETA NGA BULQIZA, KAMPIONË BOTE NË KIKBOKS

- Tek vëllezërit Ismail, Gjetan e Ferit Keta, karriera përmban ndershmëri e realizëm pa asnjë manipulim e përgënjeshtim, siç mund të arrijnë sukses disa njerëz të famshëm. Duke u fokusuar tek familja, gjyshi, fshati, vështirësitë ekstreme, rrëfimet e tyre gjenerojnë mesazhe paqendjellës që çlirojnë energji dhe dritë shprese tek fuqia e suksesit të njeriut, thyerja e tabuve dhe afirmimi i të jashtëzakonshmes.



Është rast i rrallë, ndoshta unikal në historinë e sportit, që nga e njëjta familje të dalin tre kamionë botërorë. Ata janë Ismail, Gjetan dhe Ferit Keta, tre vëllezër kampionë bote në sportin e kikboksit. U rritën me lavdinë e kombit, tani kombi lartësohet me lavdinë e tyre. Të tre vëllezërit e dinastisë Keta nga Bulqiza, me një histori të interesante edukimi dhe rritjeje.

Karshi fshatit Kocaj, vendlindjes së tyre, vendi i luftërave legjendare të Skënderbeut, do të ishte modeli mendor udhëheqës në koshiencën e

kampionëve botërorë. Në galeritë e kromit, në shpat të malit do të shfaqej imazhi epiko-heroik i minatorëve, karvani i të cilëve ngjitej në kolonat e puseve për të zbritur në nëntokë me kilometra, në kërkim për të nxjerrë nga barku i malit kromin e florinjët, duke të ngjarë si heronj legendash. Ky mjedis që bashkon legendën me të vërtetën do të farkëtojë tek dinastia sportive këta virtyte të mëdha. Gjithkush ndjehet krenarë tek i sheh ata t'i demonstrojnë këto virtyte në arenën e ndeshjeve, por edhe në intervista brilante nëpër televizione të vendit e botës dhe në takime me presidentë, kryeministra e kryebashkiakë të Mynihut, Tiranës, Dibrës e Bulqizës. Të thjeshtë gjer në madhësi, mbresëlënës për qindra mijëra shikues e teleshikues, falë bukurisë fizike e shpirtërore por dhe aftësive komunikuese me publikun. Tek vëllezërit Ismail, Gjetan e Ferit Keta, karriera përmban ndershmëri e realizëm pa asnjë manipulim e përgënjeshtim, siç mund të arrijnë sukses disa njerëz të famshëm. Duke u fokusuar tek familja, gjyshi, fshati, vështirësitë ekstreme, rrëfimet e tyre gjenerojnë mesazhe paqe ndjellës që çlirojnë energji dhe dritë shprese tek fuqia e suksesit të njeriut, thyerja e tabuve dhe afirmimi i të jashtëzakonshmes. Po. Ata janë me të vërtetë të jashtëzakonshëm, të rrallë, kampionë bote, sportistë me famë botërore. Intervistat, apo qoftë dhe rrëfime rastësore të tyre janë një gjendje-premise që emetojnë emocione estetike pozitive në kuadrin e të madhërisë dhe bukurisë morale të qëndrimeve dhe vlerave që ndan protagonistin me audiencën... Kjo për faktin, se në shumë ndeshje, përballë rivalëve shumë të fortë nga vende të ndryshme të botës ata e kanë bërë Mynihun të flasë shqip.

ISMAILI, “PEDAGOGU” I VËLLEZËRVE

Njeriu, në jetë, arrin atë që beson më shumë. Kështu ka ndodhur me Ismail Ketën, tre herë kampion bote në kikboks: më 2011, 2012 dhe 2013. Ai tani është pedagog, mjeshtër, për studentët e tij. Përgjërimi ndaj prindërve, paraardhësve të tij është akses i edukatës dhe ndërveprim i individit në mjedisin familjar, plot dashuri, mirënjohje dhe rivlerësim identitar. Ai është një mit, një legendë e kohës sonë moderne që na frymëzon me shqiptarizëm, pikërisht tani kur kemi nevojë më shumë për të qenë vetvetja.

Hapja dhe njohja me botën e qytetëruar, përshkallëzoi në mënyrë të

shpejtë ngritjen drejt objektivit final të sportistit. Tek Ismaili, karriera përmbante ndershmëri e realizëm pa asnjë manipulim e përgënjeshttrim siç mund të arrijnë sukses disa njerëz të famshëm.

Ismaili, Bulqiza dhe Kombi – një trekëndësh mbi të cilin vërtiteshin mesazhe të fuqishme kombëtare, morale dhe estetike.

Kushdo ka simpati për njerëzit e shquar. Kjo ka qenë motoja njerëzore në shekuj. Rasti i vëllezërve Keta, kampionë bote na dëshmon se madhështia që i përket akteve të mbështetjes tek vetvetja zakonisht shndërrohen në idol.

Njeriun e shpjegon historia e tij. Muza e historisë që ndikuese në projektimin psikomoral të personalitetit të tij. Përgjigjen e jetës nuk e gjeti në libra, e zhvilloi vetë. Ismaili rrëfen histori vetjake, mbresa, mesazhe, emocione... Gjëja më e rëndësishme në botën e vlerave të njeriut është shpirti aktiv. Ismaili u rrit dhe u edukua në një mjedis me nxitës mjedisorë ekstrem. Klima dimërore e ashpër e Bulqizës, me akujt dhe acarin që zgjat me muaj, me murlanin dhe suferinën që ngrenë tornado pështjelluese përgjatë fushës, ku qëndrojnë të pa shkukur nga toka, vetëm Gurët e Skënderbeut, kërkojnë të përgatitesh që fëmijë për një mbijetese sakrale. Tek Ismaili, fuqia fizike shkon në harmoni me fuqinë morale. Ata janë ene komunikuese që furnizojnë njëra-tjetrën. Krenaria kombëtare ishte stimuli nxitës.

EDUKIMI FAMILJAR DHE SHPIRTI HUMAN

“Përveç edukimit familjar, sportet e boksit ndikuan shumë në formimin tim.. Në këtë lartësi jam falë mbështetjes së familjes dhe të gjithë shqiptarëve, të cilëve u jam mirënjohës dhe do t’ua shpërblej në edukimin e fëmijëve të tyre”,-shprehet kamioni Ismail Keta. Sipas tij, kjo është arsyeja e hapjes edhe në Shqipëri të “shkollës” së kikboksit. Dhe gjikund ka me vete si pjesë të qenies së tij portretin e Heroit tonë kombëtar, Skënderbeut. “Dua të jem shembull për fëmijët e mi, t’i edukojë me ndjenjën e krenarisë kombëtare. Ku ka më mirë se shembulli i Heroit tonë kombëtar?!

Falë kësaj krenarie e obligimit për Heroin organizoi eventin duel në themel (rikthim, sepse edhe Skënderbeu u rikthye fillimisht në Dibër.....). Më tej duke u ndalur tek përgjegjësia për pasardhësit, Ismaili pohon se si më i madhi i fëmijëve ka detyrë të jetë shembull për ta....Por edhe

mësuesi e trajneri i tyre.. “Çdo gjë rodhi mirë dhe vëllezërit, Gjetani e Feriti më ndoqën me suksesin e tyre. Me Gjetanin, paksa “kokëfortë” më është dashur shumë punë si në ring edhe gjatë stërvitjes e mësimit. Pas 20 vitesh edhe ai tani është në pikën më të lartë.

Për Ismailin, të bësh mirë është detyrë njerëzore, ndaj për këtë ai nuk don të heshtë. “Falë reputacionit të miqtë e mi jam në hapat e para për të krijuar një institucion bamirësie, ku natyrisht vendlindja ime Bulqiza dhe tërë Shqipëria janë fokusi im. Ngaqë kam parë dhe shoh fëmijë e prindër duke vuajtur jam i gatshëm të bëj të pamundurën në ndihmë të tyre”,- shprehet Ismaili. Ndërkohë ai pohon se janë të gatshëm të aderojnë në këtë institucion bamirësie, institucione e emra të spikatur të një shoqërie të gjerë, sidomos mjekë, akademikë etj., të cilët kanë prekur nga afër bujarinë e shqiptarëve por edhe dhimbjen e një realiteti tronditës në një vend kaq të bukur si Shqipëria me resurse të shumta natyrore e njerëzore.

Vite më parë, falë bashkëpunimit me Fondacionit “Project Cure” arriti të sigurojë 400 pajisje për spitalin e Kavajës në shumën 400 mijë Euro. Duheshin 23 mijë Euro për transportin e tyre..Kishin mbetur për 12 mijë euro dhe ato i dhuroi vetë Ismaili.


Ai është mjeshtër i qeverisjes së fuqive të tij fizike. Këmbëngulja mund gjithçka thonë të urtët. Demokracia, çlirimi i lirive politike dhe shpirtërore, krijoj shanse të reja edhe për perspektivën konkurruese të Ismailit, Gjetanit e Feritit. Hapja dhe njohja me botën e qytetëruar përshkallëzoi në mënyrë të shpejtë ngritjen e tyre drejt objektivit final të sportistit. Këta kampionë të mëdhenj e duan Shqipërinë dhe e nderojnë flamurin më të bukur në botë. Faleminderit vëllezërit Keta, që na bëni të ndjehemi krenarë!

VELO CFARKU, KRYEREDAKTORI MË JETËGJATË QË I DHA JETË “USHTIMËS SË MALEVE”

- “Ushtima e maleve” që Velo Cfarku e drejtoi me kompetencë e profesionalizëm të lartë, për afro dy dekada ka përcjellë mbi 9 milionë kopje, ku kanë marrë pjesë me shkrime rreth 25 mijë anëtarë, bashkëpunëtorë e korrespondentë të saj, midis tyre intelektualë e kuadro të rangjeve të ndryshme, shkrimtarë artistë e sportistë që shkruan dhe u afirmuan falë saj

Më 30 gusht 2020 ndërroi jetë Velo Cfarku, një nga përfaqësuesit dinjitozë të elitës dibrane në metropolin shqiptar. Kjo ikje e tij për në botën e përtejme vetëm katër muaj pasi kishte festuar 85 vjetorin e ditëlindjes që e papritur, jo vetëm për familjen, por edhe për miqtë e shokët e tij të shumtë.

Në 85-vjetorin e ditëlindjes, gazetarin dhe mësuesin e shquar Velo Cfarku, e uruan për zemërsisht, jo vetëm familja e tij e mrekullueshme, por gjithë elita intelektuale dibrane, pjesë dinjitoze e së cilës ai ishte dhe mbetet, si dhe miqtë dhe shokët e tij të shumtë në Tiranë, Peshkopi, Elbasan dhe sidomos në fshatrat e Gollobordës. Në memorien dhe vlerësimin e tyre, ai është gazetari dhe mësuesi shembullor, që bëri aq shumë për Gollobordën dhe Dibrën. Velo Cfarku u lind më 5 maj 1935 në Gjinovec të Gollobordës. Mësimet e para i mori në fshatlandje (1946-1949) me mësues z.Sefedin Shabani. Të mesmem në shkollën Pedagogjike “Ndrec Ndue Gjoka” (1951-1955) dhe për plotësim në Shkollën Pedagogjike “8 Nëntori” Peshkopi (1957).



Ka kryer Institutin Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani” në Tiranë për matematikë-fizikë (1963-1964). Ka punuar si mësues në fshatin e lindjes (1955-1956) dhe në shkollën 7-vjeçare “10 Dëshmorët e Trebishtit” (1956-1963), drejtor i shkollës 7-8 vjeçare “Spiro Velko të Klenjës dhe njëkohësisht drejtor zone në lokalitetin e Klenjës.

Mbas kryerjes së Shkollës së lartë të Partisë (1970-1972) ka qenë instruktor në aparat në sektorin e edukimit.

Nga muaji gusht 1973 ka drejtuar gazetën “Ushtima e maleve” si kryeredaktor i saj për 17 vite, gazetë kjo që ka qenë tribuna e vetme mediatike e Qarkut të Dibrës përgjatë regjimit, që për afro 23 vjet meradhë ka promovuar ngjarjet, personazhet dhe problemet më të spikatura të trevës dibrane në të gjitha fushat. Kjo gazetë ka promovuar një armatë të tërë shkrimtarësh, të cilët kanë lënë dhe po lënë gjurmë të mëdha në historinë e medias shqiptare. “Ushtima e maleve” që Velo Cfarku e drejtoi me kompetencë e profesionalizëm të lartë, për afro dy dekada ka përcjellë mbi 9 milionë kopje, ku kanë marrë pjesë me shkrime rreth 25 mijë anëtarë, bashkëpunëtorë e korrespondentë të saj, midis tyre intelektualë e kuadro të rangjeve të ndryshme, shkrimtarë artistë e sportistë që shkruan dhe u afirmuan falë saj. Në vitet 1981-1982, Velo Cfarku ka kryer kursin e lartë të Filozofisë dhe ka punuar në vijim 3 vjet instruktor për arsim-kulturën në rrethin e Dibrës, për t’u rikthyer sërish në prill 1985 kryeredaktor i “Ushtimës së Maleve”. Është dekoruar me Distinktivin “Mësues i dalluar”, me Medaljen “Naim Frashëri” më 1961 për rezultate të mira në mësim dhe me Urdhërin “Naim Frashëri” të Klasit II më 1986, për punë të mirë në drejtimin e gazetës “Ushtima e Maleve”. Më 15 Prill 2014 është shpallur “Qytetar Nderi” i komunës Trebisht.

Velo Cfarku ka botuar librat “Golloborda në optikën e kohës”, “Një jetë mes dibranëve”, “Të parën kemi Dibrën”, “Intelektuali emblemantik i Gollobordës” (monografi gjithëpërfshirëse e figurës së tij si vlerësim dhe produkt i Unionit të Shkrimtarëve të Tiranës) dhe “Mozaik episodesh e ngjarjesh, rrjedhës së Drinit të Zi”. Për këtë të fundit, studiuesi, shkrimtari e publicisti veteran Faik Xhani, ndër të tjera shprehet: “Impresionues, i veçantë dhe polivlerash është kontributi i Velo Cfarkut, si gazetar profesionist, si kryeredaktor i gazetës “Ushtima e Maleve”, si studiues e kritik letrar, por edhe si shkrimtar”. Madje sipas studiuesit e shkrimtarit

Xhani, librat e botuar me autorësinë e tij, e vendosin plotësisht dhe denjësisht Velo Cfarkun në fronin e shkrimtarëve dibranë dhe shqiptarë. I japin atij, me meritë “Shengenin” e shkrimtarit për të lëvizur kudo e për të zënë vend nderi në bibliotekat e lexuesve dhe kodikët e bibliografitë e Bibliotekës Kombëtare.

Profesorë, akademikë, dhe publicistë të njohur e kanë vlerësuar Velo Cfarkun si një personalitet i kulturës në verilindje, me një biografi të begatë letrare. Kështu, Prof.dr.Shaban Sinani, akademik, kujton kohën kur ka nisur të shkruajsinxhënës përtëpërjavshmen “Ushtima e Maleve” qysh në vitin 1974 (kur kryeredaktor i saj ishte Velo Cfarku) dhe kur ka botuar aty rregullisht dhjetra shkrime. Madje një vit ka marrë dhe një çmim të dytë për një fejtון, si dhe një honorar modest, që siç pohon vetë “e ktheva menjëherë në libra...” Ndërsa Xhelil Gjoni, politikan dhe publicist, nisur dhe nga titulli i librit “Partizani i vogël Velo”, e konsideron Cfarkun partizan të të emancipimit të shoqërisë dibrane, kolegun dhe shokun e sinqertë, si publicist dhe propagandist.

Për poetin Qazim Shehu “Velo Cfarku është një shembull i gazetarisë investiguese që e merr lëndën nga jeta, nga kontaktet me njerëzit. Gazetaria e tij është një gazetari që vlerëson njerëzit e thjeshtë, vlerat e tyre, jo bujën e çastit të vipave, siç ndodh sot me gazetarinë shqiptare...” Si një personalitet të njohur të kulturës në verilindje, me një biografi të begatë letrare që ka shkruar një barrë me libra, jo si qëllim më vete, por me misionin e ndriçimit e kulturimit të brezave, e vlerëson Velo Cfarkun edhe poeti Ilir Balili. “Materialin fizik, Cfarku na e jep me anë të vëzhgimit, reportazhit, personazhit, skicës, reflektimit mbi ngjarje e figura, qofshin historike, qofshin të përditshmërisë, duke i veshur ato me një petk të mirëfilltë letrar”, shprehet shkrimtari Hyqmet Hasko.

Unë personalisht i mbetem mirënjohës Velo Cfarkut, jo vetëm për ndikimin që ka patur në formimin tim si gazetar gjatë kohës që drejtonte “Ushtimën e Maleve” (kur me mbështetjen e tij u afirmova dhe botova qindra reportazhe, skica e fejtone), por edhe për vlerësimin që bëri në promovimin e librit tim “Memoria historike e Kombit”, ku në praninë e elitës krijuese të kryeqytetit në sallën e madhe të Akademisë e Shkencave në Tiranë, ai e vlerësoi librin tim si një vlerë të shtuar në letërsinë tonë dokumentare dhe në historinë e lavdishme të Shqipërisë.

DEFRIM METHASANI, IKONË E GAZETARISË SPORTIVE, DOKUMENTARIT TELEVIZIV DHE MODERIMIT TE EVENTEVE

- Ka disa maja në profesionin e tij të gazetarit e moderatorit dhe këto i ka me meritë



- Defrim Methasani, ndër vite ka marrë tituj e çmime që ia kanë rritur prestigjin si gazetar e intelektual, si “Mjeshtër i Madh” nga Presidenti Republikës, “Qytetar Nderi” i bashkive Dibër e Përmet, “Personazhi i vitit”, Rubik, “Kronika e Vitit” RTSH 2007, “Ambasador për Paqen” nga FPU etj, etj, por gjithsesi Çmimi Special me të cilin e vlerësoi Komiteti Olimpik i Kosovës që ndër më surprizuesit

Në 33 vite si gazetar në RTSH, si drejtues i dhjetra emisioneve e realizues i qindra dokumentarëve televizivë, Defrim Methasani ka shënuar dhjetra kulme profesionale. I vlerësuar, jo vetëm nga institucione qendrore e lokale shtetërore e mediatike shëqiptare dhe OJF vendase e ndërkombëtare, si ikonë e gazetarisë sportive, por edhe si Mjeshtër i Moderimit të eveneteve shtetërore e sportive të rëndësishme, më së fundi ai do të provonte edhe marrjen e çmimit special nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Po. Në ceremoninë që ky Komitet realizoi me 25 shkurt ne Prishtinë në prani të 500 personaliteteve të sportit për të shpallur fituesit e vitit 2024 në sport, një çmim special pati edhe për gazetarin e RTSH (Radiotelevizionit Publik Shqiptar) Defrim Methasani, për kontributin që ai ka dhënë në promovimin e sportit në Kosovë dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit mes gazetarëve në Shqipëri dhe Kosovë. Çmimi i është dorëzuar nga Presidenti i KOK Ismet Krasniqi.

Përpara se të jepej çmimi, është transmetuar një material filmik që tregonte kontributin e tij në mbi tre dekada në RTSH. Organizatorët janë ndalur kryesisht në veprimtarinë e tij intensive në promovimin që i ka bërë sportit kosovar përmes kronikave dhe reportazheve të shumta, duke evidentuar arritjet më të mëdha që kanë afirmuar Kosovën në arenën ndërkombëtare.

E ka bërë këtë më së miri si Kryetar i Unionit Shqiptar të Gazetarëve Sportivë, si ish-kryetar i këshillit të Paqes për Tiranën dhe po i jep dritë shkëlqimtare këtij misioni edhe tani si Kryetar i Federatës së Paqes Universale, Shqipëri.

Pas marrjes së çmimit në fjalën përshëndetëse, Methasani ka pohuar se kënaqësia e një çmimi të tillë vlen vetëm për momentin, pasi përgjegjësia për të vazhduar këtë rrugëtim në shërbim të sportit në Kosovë, vijon edhe në të ardhmen.

Defrim Methasani, ndër vite ka marrë tituj e çmime që ia kanë rritur prestigjin si gazetar e intelektual, si “Mjeshtër i Madh” nga Presidenti Republikës, “Qytetar Nderi” i bashkive Dibër e Përmet, “Personazhi i vitit”, Rubik, “Kronika e Vitit” RTSH 2007, “Ambasador për Paqen” nga FPU etj, etj, por gjithsesi Çmimi Special me të cilin e vlerësoi Komiteti Olimpik i Kosovës që ndër më surprizuesit.

Në këtë event mbresëlënës, u vlerësuan edhe xhudistët Distria Krasniqi dhe Akil Gjakova të cilët u shpallën Mbreti dhe Mbretresha e sportit, si fitues të medaljeve olimpike në lojrat olimpike "Paris 2024".

DETYRA E GAZETARIT IA KA SHTUAR PASIONIN PËR JETËN, PËR TË BUKURËN, PËR TË VËRTETËN

Pa asnjë mëdyshje, Defrim Methasani është një nga modelet më të mirë në gazetarinë e sotme, dhe si dibrani i mençur e human, ai njihet

e vlerësohet tashmë si krenari dibrane në metropolin shqiptar. Ndaj dhe me të drejtë gazetari e shkrimtari i njohur Namik Selmani, në librin e tij *"Jehona e urtësisë dibrane"* (fq. 100) shkruan se: *"Detyra e gazetarit ia ka shtuar Defrim Methasanit pasionin për jetën, për të bukurën, për të vërtetën, për të ardhmen"*.

Po. Çdo gjë te Dëfrim Methasani është art. Një art që të emocionon dhe të mëson. Është së pari arti i komunikimit, që e bën atë të admirohet nga shokë e miq të shumtë dhe t'ju dhurojë atyre lumturi të paparë.

E kemi parë atë si të ftuar special të televizioneve kryesore publikë shqiptarë, kur ai me të drejtë e ka konsaideruar, jo emission, por mision promovimin e vleravë tona më të mira kombëtare.

E ka bërë këtë mjeshtërisht në realizimin me fantazi e talent të rrallë të qindra dokumentarëve kushtar yjeve të sportit shqiptar, jo vetëm nga kryeqyteti, por nga të gjitha rrethet e vendit.

Po e bën më së miri edhe aktualisht me ciklin e famshëm: "Rrëfim kampionësh" në RTSH dhe si kryeredaktor i emisioneve sportive në Radio Tirana.

Në memorien e shqiptarëve janë ngulitur thellë ciklet e emisioneve më të bukura në vite që ka realizuar Defrim Methasani si: *"Mëngjes sportiv"*; *"Sporti i një qyteti"*; *"Rubrika sportive"*; *"Aty ku ka sport"*; *"Kam lindur kuqezi"*; *"Rrëfim kampionësh"*, etj, etj.

Ka disa maja në profesionin e tij dhe këto i ka me meritë. Me futbollistin e njohur Kristiano Ronaldo, është takuar 3 herë dhe një herë ka biseduar me të. Ka takuar shumë kampionë, mes tyre vëllezërit Keta, që janë djem fantastikë. Ka takuar Beckenbauer e shumë figura të sportit botëror.

Dhe jo vetëm kaq, por ai ka shkëlqyer edhe në emisionet sportive në RTSH kushtur ndeshjeve të kombëtares sonë në futboll, si: Shqipëri - Greqi 2004; Serbi - Shqipëri - Beograd 2014 dhe të Europianit, Gjermani "Euro 2024". Të gjithë jemi mahninur me artin e tij të komunikimit, duke e konsideruar veten shërbëtor i njerëzve të sportit. Kurrë nuk ka thënë "jo" për çdo event. Sepse më shumë se gazetar, ka dashur të jetë dhe është njeri.

Ndaj dhe si askush tjetër ai, ka miq e shokë të shumtë, jo vetëm brenda teritorit të Shqipërisë si shtet, por në gjithë hapësirën mbarëshqiptare në botë.

MJESHTËR I MODERIMIT TË EVENTEVE TË RËNDËSISHME

Si mjeshtër i moderimit, ndër më të mirët në rang kombëtar, Defrim Methasani është shfaqur dinjitetshëm dhe ka lënë mbresa tek bashkëatdhëtarët tanë, si në moderimet e disa ndeshjeve të kamionëve botërorë Ismail, Gjetan e Ferit Keta në kikboks, Apo, vetëm para disa muajsh (13 Tetor 2024) kur moderoi festën më të madhe të realizuar ndonjëherë nga Shoqata Mbarëshqiptare Social kulturore “Bijtë e Shqipes”, kushtuar komunitetit shqiptaro-amerikan, përrurimin e Qendrës Komunitare dhe Shkollës Shqipe “Gjuha Jonë” në Filadelfia.

Talentin e rrallë dhe shpirtin e tij krijues Defrimi e ka demonstruar në moderimin e dhjetra takimeve me tematika të larmishme të organizuara në selinë e Federatës së Paqes Universale Shqipëri, ku kanë marrë pjesë personalitete të politikës, letrave, kulturës e Sporteve nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi e Maqedonia, ndër të cilët ish - presidentët Moisiu, Topi e Sejdiu, kryeparlamentarë, kryeministra e ministra.

Me të njetin talent ka moderuar D.Methasani edhe koncertet recitale të artistëve shqiptarë, si të Shoqërisë kulturore Artistike “Dibra e Madhe” me president Z. Miçe Duka, Ilir Shaqiri, Aurela Gaçe, Liri Rasha, Vera Laçi, Shaban Mëziu etj, si dhe dhjetra promovime librash të autorëve shqiptarë të njohur.

Dhe jo vetëm kaq. Defrim Methasani është dhe një familjar shembullor. Gjithkush do ta admironte atë për përkujdesjen ndaj prindërve të tij, babait Shuaiipit - emblemë dhe mishërues e përçuesi më i mirë i urtësisë e mençurisë dibrane, nënë Faries me inteligjencë natyrore e fisnikëri të rrallë dhe tri vajzave model: Lunës, Blertës e Rinës që në përditshmërinë e tyre shembëlajnë virtytet e babait.

Ndaj me të drejtë, siç shkruan Prof. dr. Fatmir Terziu në prestigjiozen e krijuar dhe drejtuar prej tij, fjalaelirë.com: *“Defrim Methasani, nuk është e vështirë të kuptohet thjesht e menjëherë që ka dhënë një kontribut të çmuar në promovimin e sportit shqiptar, prej shumë vitesh, por përtej këtij promovimi është zëri, timbri, elokuenca, oratoria, dashuria për ata që e ndjekin dhe e rrethojnë, atë ta bëjnë më shumë se një dashuri njerëzore. E kështu është udha e tij. Kështu është përditësia, të cilën e kupton jo thjesht në një rrëkëllimë kafeje me të dashurit e tij, por dhe në një memorje të fiksuar herët në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë”*.

XHELAL MARKU - GAZETARI ME KARRIERË TË SHKËLQYER AKADEMIKE DHE PROFESIONALE



- Si pinjoll i një familje e fisi emërndritur nga Kraj Reçi i Dibrës, Ai, jo vetëm do ta ruante por edhe do ta pasuronte këtë emër, në të gjitha etapat e jetës së tij, si nxënës e student i shkëlqyer në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, nga fillorja e 8-vjeçarja në vendlindje, gjimnazi në Peshkopi e deri me studimet e larta në Universitetin e Tiranës, fakulteti Histori – Filologji, dega Gjuhë – Letërsi Shqipe, ku dhe është diplomuar me titullin: “Mësues i gjuhës dhe i letërsisë për shkollat e mesme”

Në 373 faqe të monografisë me titull “*Xhelal Marku, gazetari akademik me penë e kamera*”, lexuesi njihet me profilin e një intelektualit me karrierë të shkëlqyer akademike dhe profesionale.

Krahas etapave të shkollimit, autori i këtij libri, Fran Lleshi, e vlerëson Xhelal Markun, si pionierin e parë të gazetarisë televizive për Mirditën, Pukën dhe Matin në RTSH, i cili sillte për publikun emocionalitet, përmes punës së tij krijuese, me shumë art e shije artistike, përmes së cilës shpaloseshin arritjet, transformimet, mendimet kreative e shkencore, bota e pasur shpirtërore me epikën dhe poetikën e larmishme të asaj kohe.

Redaktori i librit, publicisti dhe shkrimtari i mirënjohur Albert Zholi,

në parathënien e librit, ndër të tjera i kushton vëmendje historisë së vendlindjes së Xhelal Markut, krahinës së Reçit të Dibrës, një krahinë e njohur për tradita të shquara atdhetare, për trimëri e bujari, për besë e qëndresë të pamposhtur përballë pushtuesve, tradhtarëve dhe armiqve të vendit ndër shekuj.

Pjesë interesante e librit janë përshkrimi brilant i momenteve që kanë mbetur në kujtesën e gazetarit Xh.Marku. Po ashtu edhe shkrimet e kreut të IV “Promovim vlerash nga krijimtaria e gazetarit Xhelal Marku”.

VLERËSIME TË DISA PERSONALITETEVE AKADEMIKE E TË LETRAVE

Vlerat e këtij libri konsistojnë veçanërisht në kreun e V-të “Opinione për gazetarin Xhelal Marku”. Kështu nëse Zef N. Brozit, ish deputet dhe ish-kryetar i Gjykatës së Lartë, nënvizon faktin që “Personaliteti dhe veprimtaria profesionale e Xhelal Markut, është vlerësuar para viteve 1990 e deri më sot, me disa tituj, çmime, dekorata e çertifikata nga institucione shtetërore qëndrore e lokale dhe nga shoqata të ndryshme”, ish-kryetari i Bashkisë Rrëshen, Gjon Deda shprehet se: “...gazetari Xhelal Marku, mbrojtësi elegant i burimeve të informacionit, në punën e tij rezulton një temperament i qëndrueshëm, kompetent, etik dhe vizionar gjatë gjithë karrierës së tij, si në shërbim të mësimdhënies në shkollën e mesme Rrëshen, në shërbim të gazetarisë dhe reporterit në RTSH, ashtu edhe si specialist i turzimit në Ministrinë e Turzimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ku mbylli karrierën e vetë”.

Kësisoj e plotësojnë profilin akademik e profesional të Xhelal Markut me opinionet e tyre edhe shkrimtari e kulturologu Ndue Dedaj, ish-shefi i Arsimit e Kulturës Mirditë Pjetër Doda, shkrimtari dhe poeti Gjovalin Ndoja, gazetari i RTSH Defrim Methasani – Mjeshtër i Madh, Aleksandër Ndoja – kryeredaktor i revistës “Mirdita”, si dhe disa personalitete tjera të publicistikës dhe letrave.

Kjo për faktin se, me një karrierë të shkëlqyer profesionale dhe akademike, si mësues, gazetar, studiues e publicist, Xhelal Marku, padyshim që është një ndër zërat e spikatur të elitës dibrane në metropolin shqiptar. Si pinjoll i një familje e fisi emërndritur nga Kraj Reçi i Dibrës, Ai, jo vetëm do ta ruante por edhe do ta pasuronte këtë emër, në të gjitha etapat

e jetës së tij, si nxënës e student i shkëlqyer në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, nga fillorja e 8-vjeçarja në vendlindje, gjimnazi në Peshkopi e deri me studimet e larta në Universitetin e Tiranës, fakulteti Histori – Filologji, dega Gjuhë – Letërsi Shqipe, ku dhe është diplomuar me titullin: “Mësues i gjuhës dhe i letërsisë për shkollat e mesme”.

PERSONALITETI I TIJ, KUDO DHE NË ÇDO RRETHANË REFLEKTONTE VLERA

Në Dibër, e veçanërisht në Mirditë e Tiranë, ku kaloi pjesë të konsiderueshme të jetës Xhelal Marku njihet si një nga korifejtë e vërtetë të publicistikës, kulturës dhe arsimit kombëtar. Personaliteti i tij, kudo dhe në çdo rrethanë reflektonte vlera, për të cilat ishte e etur shoqëria jonë. Bashkëkohësit e mbajnë mend që në vitet 1973-1974 kur si mësues i Letërsisë në Gjimnazin “Bardhok Biba” të qytetit të Rrëshenit, që një njeri me nivel të lartë në të gjitha dijet, një filozof dhe psikolog, mësues dhe edukator shembullor, që gjithkujt i duhet në ditë të vështira.

Më pas, në harkun kohor të më shumë se dy dekadave (1974-1998) Xhelal Marku do të bënte emër si një nga gazetarët më të mirë të Radiotelevizionit Shqiptar për rrethet e zonës verilindore: Mirditë, Pukë, Lezhë, Mat, Kurbin e Krujë. Autoritete dhe njerëz të thjeshtë të këtyre rretheve si dhe drejtuesit e institucionit do ta vlerësonin atë si personalitetin që kudo dhe në çdo rrethanë reflektonte vlera. Si i tillë do të merrte vlerësimet maksimale dhe të titullohej “*Gazetar i Kategorisë së Parë*” e më pas, në vitin 1988, të dekorohet me urdhërin: “*Naim Frashëri*”, për pasqyrim dinjitoz e me profesionalizëm të veprimtarive në rrethet përkatëse.

Pikërisht, mbështetur në këtë CV kaq të pasur, para dy viteve ai mori titullin “AKADEMIK”, akorduar nga Bordi i Akademisë Shqiptaro-amerikane të Shkencave dhe Artit, Nju Jurk. Në ceremoninë mbresëlënëse që u organizua me këtë rast në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave në Tiranë, personalitete të publicistikës, artit, kulturës e shkencës, intelektualë më në zë, jo vetëm të Dibrës e Mirditës, por nga i gjithë vendi e vlerësuan Xhelal Markun si një dishepull të dijes dhe simbol të filozofisë dibrane. Vlerësime të tilla ka marrë Ai edhe kur është vlerësuar me titullin “**Qytetar Nderi**” nga vendlindja e tij, ish Komuna Reç e Dibrës, si dhe me çertifikatën “**Mirënjohje**” nga Bashkia Peshkopi, ndërsa në vitin

2017, ka marrë titullin e lartë “**NDERI I QARKUT DIBËR**”, ku përfshihen katër bashki, një titull rajonal ky, me të cilin, për herë të parë vlerësohet një gazetar i Medias Shqiptare.

ZË I SPIKATUR NË HISTORIKUN E RTSH

Xhelal Marku ka hyrë me dinjtet edhe në analet e historisë së Radiotelevizionit Publik Shqiptar, duke u *përfshirë më 2012 në vëllimin e dytë të historikut të këtij institucioni të rëndësishëm mediatik kombëtar të vendit, si një nga 16 figurat më të përzgjedhura të tij.*

Kjo ngjitje në shkallaren e karrierës së tij, padyshim që vjen pas evidentimit të vlerave si publicist, e veçanërisht të kohës kur punoi si ish - korrespondent i RTSH-së për Mirditën. Ndaj dhe Bashkia Rrëshen dhe Pallati i Kulturës i këtij qyteti, në vitin 2008, organizuan veprimtarinë: “*Mirdita përgjatë tre dekadave në fokusin e gazetarit - Xhelal Marku*”, ku ai u nderua me çertifikatën “*Mirënjohje*” nga Bashkia Rrëshen. Profesionalizmin e lartë si publicist ai e ka shfaqur edhe si bashkëpunëtor i rregullt e korrekt i medias së shkruar, duke sjellë për lexuesit shkrime problematike e me interes për publikun, si: reportazhe, komente e analiza politike, ku përmendim, komentin politik: “*Etika dhe morali...*”, si dhe reportazhin “*Shënime për Reçin*” etj, që u vlerësua me çmim të parë në konkursin “*Krijimtaria dibrane 2007*”, si dhe mjaft portrete e skica për figura të njohura të krahinave të Mirditës e të Dibrës.

Krijimtaria publicistike, mjaftë produktive e cilësore e Xhelal Markut ka qenë e evidente edhe në vitet 1998 - 2010, kur ai ka punuar në mediat private të kryeqytetit, si në Televizionin Kombëtar “*Arbëria*”, në “*Koha Televizion*”, etj, ku dhe ka fituar një përvojë të re në fushën e gazetarisë, të regjisë e të kameras. Gjatë kësaj periudhe ai është vlerësuar edhe për tre dokumentarët për pyjet, realizuar sipas një projekti të Bankës Botërore, si dhe dokumentarët: “*Mespërmes bjeshkëve të Tropojës*” dhe “*Shënime për Reçin*”.

Xhelal Marku punoi për tri vite (2010-2013) edhe si specialist i lartë në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun, në Agjensinë Kombëtare të Turizmit (AKT), pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS), sot Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit (MTM). Edhe në këtë institucion ai u dallua për përkushtimin maksimal,

profesionalizmin e lartë dhe vizionin bashkohor. Madje, si rezultat i një pune të përkushtuar studimore, arriti të përgatisë dhe botojë librin e parë kombëtar për Turizmin, me titull: “*TURIZMI SHQIPTAR*”, që u promovua me shumë sukses në kuadrin e veprimtarive kushtuar 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, një libër i plotë, gjithpërfshirës dhe me informacionet më të reja e të kompletuara për turistët vendas e të huaj.

Ndër projektet e tjera të punës së tij krijuese, janë edhe përgatitja për botim e një libri me përmbledhje nga krijimtaria e tij publicistike në vite, përgatitja për botim e një libri të ri me portrete, skica e monografi kushtuar figurave më të njohura të Mirditës e të Dibrës, si dhe libri “*Reportazhe dhe intervista*”. Talentin, zgjuasinë dhe fisnikërinë e tij, Xhelal Marku i ka shfaqur edhe në jetën shoqërore. Në takime promovuese, në raste dasmash e gëzimesh të tjera familjare, jo vetëm në Dibër e Mirditë, por edhe këtu në metropolin shqiptar ai do të merrte rolin e drejtuesit e të organizuesit të talentuar. Gjithnjë në koherencë me realitetin objektiv, Ai do të evidentohej si njeriu që i zinte vend fjala dhe i kishte dukë puna.

Në një vështrim kompleks të personalitetit të tij, (ngaqë e kam njohur nga afër) do të veçoja, tri konstatime përcaktuese për dimensionin njerëzor e shoqëror të Xhelal Markut.

Konstatimi i parë lidhet me vetëdijen e tij kombëtare.

Konstatimi i dytë është se ai ishte dhe mbeti idealist në raport me të vërtetën. Parë nga një vështrim analitik, Ai asnjëherë nuk bënte dhe nuk bën lëshime në të vërtetën dhe kurrësesi nuk lejonte dhe nuk lejoi devijimin nga e vërteta.

Konstatimi i tretë, ka të bëjë me faktin e pakundërshtueshëm se Xhelal Marku, ashtu si edhe dhjetra bashkëkohës të kohës së monizmit, në vitet e mëvonshme u shdrrua në pikë referimi për bashkëbiseduesit në takime të ngushta e publike. Si rrjedhojë e cilësive të veta të shquara profesionale, humane dhe sociale, Xhelal Marku është bërë si një lloj magneti që ka krijuar një rreth gjigand miqsh dhe një popullaritet mahnitës. Marrëdhëniet me njerëzit ai i ka dhe i konsideron të shenjta dhe pikërisht këtu qëndron edhe madhështia në këtë intelektual, simbol i një familje me tradita e emër të mirë, ku gjenden të kombinuara: mençuria, bujaria, fisnikëria e zemërgjerësia, që Ai do t’i mishëronte e perfeksiononte ato gjatë gjithë karrierës së tij prej afro pesë dekadash.

HALIL RAMA

II

PERSONALITETE DIBRANE TË ARSIMIT
DHE KULTURËS

“Universiteti” ku studjoi elita e Dibrës

LUTFI HANKU – PROFILI I MËSUESIT DHE SHKRIMTARIT DISIDENT QË SFIDOI DIKTATURËN

- Nga ky “universitet” nisën rrugëtimin e tyre drejt majave të shkencës, jurisprudencës, kulturës e publicistikës: prof.dr. Shaban Sinani, prof.dr. Myqerem Tafaj, prof. dr. Fehmi Abdiu, prof.dr. Shefqet Hoxha, prof.dr. Arian Kadiu, shkrimtari Lutfi Hanku, gjeneral Kudusi Lama, gazetarët Kamber Farruku e Defrim Methasani, etj

Në shtator 1948, në qytetin verilindor të Peshkopisë u hap e para shkollë pedagogjike, e cila për vetë “produktin” e saj (qindra personalitete, deri ministra, gjuhëtarë e profesorë, poetë e shkrimtarë, artistë, diplomatë e gazetarë), me të drejtë njihet si “Universiteti i Dibrës”. Një bilanc mbresëlënës për faktin se ajo nxori rreth 2200 kuadro, djem e vajza, që çuan dritën e kulturën në gjithë krahinat e fshatrat e zonës verilindore të Shqipërisë.

Historikun e kësaj shkolle ma ka rrëfyer më së miri njëri nga mësuesit e parë të saj, shkrimtari Lutfi Hanku – një nga korifenjtë e vërtetë të kulturës dhe arsimit kombëtar në Dibër, “Qytetar Nderi” i dy bashkive të Dibrës dhe Bulqizës. Në memorien e tij ishte ngulitur shtatori i vitit 1948, kur u hap shkolla pedagogjike e Dibrës, që e gjeti këtë rreth me afro 90% të popullsisë analfabete, vetëm me 14 mësues me arsim të mesëm pedagogjik. Shkolla pedagogjike Peshkopi u hap në shtator të 1948; u mbyll në vitin 1967, pas 19 vitesh, u rihap në vitin 1972 e kështu me radhë, u mbyll më 1976-ën, u rihap më 1984-ën, u mbyll përsëri më 1990-ën, u rihap më 1998-ën, një klasë e atashuar pranë



shkollës bujqësore dhe u mbyll përfundimisht në vitin 2008. Në analet e historisë së saj ka arritje, por dhe fakte e ngjarje tronditëse.....

KOHA KUR VUANIN URINË E “KOMUNIZMIT TË LUFTËS

Në memorien e Prof. Lutfi Hankut ruhej e freskët vjeshta e vitit 1945, kur në Peshkopi u ndez drita e diturisë. U çel Shkolla Unike në shtëpinë e Rushdi Shehut. Skllavëria e analfabetizmit u trondit. Në vitin e dytë shkollor erdhën nga Normalja e Elbasanit tre nxënës: Zejnel Sula, Lutfi Hanku, Adem Sollaku dhe nga Shkolla Teknike e Tiranës, Mois Cami. Kontigjenti i ardhur në Unike qe rezultat i kërkesës këmbëngulëse të intelektualit demokrat, Edip Tërshana, për të hapur pas dy vitesh Shkollën Pedagogjike. Shkolla me konvikt kaloi në Dobrovë në shtëpinë e Abdulla Mehmetit. Uniken e vazhduan dibranët: Avni Agolli, Adem Sollaku, Emin Jashari, Halit Doçi, Ismail Hoxha, Ilir Ramizi, Ismail Erebara, Jashar Kaci, Lutfi Hanku, Mois Cami, Mefat Shehu, Nehat Tërshana, Rushdi Ndreu, Selaudin Trepça, Fehmi Ndreu, Vera Nura, Zejnel Sula, Zyber Ndreu. Drejtonte shkollën Edip Tërshana që jepte lëndët shkencore, ndërsa lëndët humanitare i jepte mësuesi Hysni Alimerko nga Vlora. Në dritë-hijet e asaj kohe L. Hanku veçonte vërtetësinë, sakrificat e mbijetesës për të fituar dije që të varrosej errësira e padijes me atë mentalitet, dëshirë e botë të asaj moshe. Ulej konviktori i mërdhifur nga të ftohtit pranë fenerit ose dritës së mekur të qiririt, duke nxjerrë sytë mbi dispencat e shkruara me ciklostil. Pa zjarr. Këmbët akull dhe të enjtura, të lagura në opinga të grisura. “Në kohën e lirë ne vraponim tek ndërtesat, që po ngriheshin për zyra në bulevardin e qytetit. Prisnim të kapim ndonjë thes bosh çimentoje. I bënim fletore për shënime dhe për detyra mësimore. Ky refren me zor kapërcehej edhe pse shkollarët në netët e ditët e uritura mbanin shpirtin me 250 gram bukë misri në 24 orë. Ne vuanim urinë e “komunizmit të luftës”, -rrëfente Prof. Lutfiu, i cili në botën e nxënësit kishte mbledhur copëza të jetës si më tipike të asaj kohe. Edip Tërshana dhe Hysni Alimerko kishin mbetur të zgjuar si personalitete me plagë dhembjeje në vetësinë e Lutfiut e të disa shokëve të tij. Diktatura nuk e la drejtorin Tërshana të ndezë i pari dritën e ëndrrës më të bukur të patriotizmit: – Hapjen e Shkollës së Mesme Pedagogjike! Edhe pas shtatë dekadash krismat e “sharrësit” që derdhi plumba mbi jetën e mësuesit demokrat, zhurmonin në lëngatën e asaj nate të trishtuar të

qytetit të Peshkopisë e të Lutfiut...E vranë burrin e diturisë që formoi të parën Parti Demokratike në Shqipëri!

KUR QYTETI NDRYDHEJ NËN KËRCËNIMIN E TERRORIT TË KUQ

Ambienti i sajuar për shkollën Pedagogjike ishte një shtëpi me oborr të ngushtë me dhoma studimi e fjetje si kotec. Mesnatat mbyteshin në terror. Sharrësit korrnin jetë njerëzish. Ndërsa mëngjeset e ngrira zgjonin Peshkopinë me këngët e konviktorëve, nën presionin e zërit të çjerrë të sekretarit të Partisë, Nuri Prrenjasit, një refren i detyruar. Por tek ura e qytetit mekeshin zërat e trembur të rreshtit. Në mes të sheshit të pazarit vazhdonte trekëmbëshi i vdekjeve me litar për kundërshtarët e komunizmit. Kënga shuhej nën mërmërima zërash. Qyteti ndrydhej nën kërcënimin e terrorit të kuq. Edhe mes klithmës së terrorit, unikasit u bënë promotorë të zhvillimit arsimor e kulturor të qytetit. Ata derdhnin vullnetet rinore përmes kulturës, artit e sportit si: Ismail Hoxha, Zejnel Sula, Vera Nura, Ismail Erëbara, Moisi Cami, Lutfi Hanku, Nuri Abdiu, Shemsi Manjani, Skënder Sharku. Nehat Tërshana, Mefat Shehu etj. Lutfiu i përmendte me nostalgji prindërit e shokëve të shkollës, si: Nëna e Selaudin Trepçës, Netën e Vera Nurës, nënën e Halit Doçit që vinte mes dimrit nga Lura, nënën e Skënder Sharkut dhe të Selaudin Trepçës, etj.

KALVARI I MËSUESIT E SHKRIMTARIT DISIDENT. MBËSHTETJA QË I DHA ISH MINISTRI I ARSIMIT BEDRI SPAHIU

Viti i dytë solli mësues indiferentë, të ftohtë me drejtorin, autoritarë e fashistë në karakter, si Pandi Cicin. Lutfiu nuk u bindej urdhrave të mbrapshta të filozofisë të tij të spiunit. Ai nuk harronte profesor Sinjarin me “profecitë” e tij. Por nuk harronte, sa qe gjallë, as “lugatin” N. Prrenjasin, sekretarin e partisë në shkollë. Sepse kishte mbledhur rreth vetes nxënës, “aristokratë” me rolin e hetuesve që raportonin çdo “mëkat” të shokëve. Pedagogjikasi Hanku nuk i përballoi trysnitë amorale të shpifjeve të “shokëve” të tij. Një ditë atë e larguan nga shkolla. Por më vonë ishte Ministri i Arsimit, Bedri Spahiu, që i dha të drejtën e vazhdimit

të pedagogjikes në Shkodër. Ngrohtësia shoqërore, takti pedagogjik, veçanërisht i drejtorit Shaban Arra, e mësueses së gjuhës shqipe e letërsisë, Arsinoi Bino, korrektesa dhe respektimi i nxënësit si individ i lirë e me personalitet, ndërgjegjësimi i vetëgjyqësimit, nxitën premiset e dhuntive të përgjumura e melankolike të nxënësit dibran Lutfi Hankut, ashtu si dhe të kuksianit Havzi Nela, shokut të tij të ngushtë.

Më 1952 mbaroi pedagogjiken dhe u emërua mësues në Fushë Bulqizë dhe në 7-vjeçare nate drejtor i shkollës së qytetit Bulqizë. Pas një muaji transferohet në shkollën 7-vjeçare të Kastriotit. Në Konferencën Kombëtare të Arsimit u cilësua “Mësues i dalluar”. Më 28 Nëntor 1953 krijoi familje me të bijën e “armikut të popullit”, Zenel Shehu. Pas një viti shkon në 7-vjeçaren e Zerqanit dhe më 1954 Inspektor i Arsimit. Më 1960 Lutfi Hanku mbaroi Universitetin Shtetëror të Tiranës, duke plotësuar kështu ambiciet arsimore, dëshirat e pasionet e të riut për dije dhe me përkujdesjen e heshtur të pakursyer të Rrahman Hankut të paharruar – ish-Ministër i Ndërtimit.

PEDAGOGJIKJA QË U SHNDRRUA NË “UNIVERSITET TË DIBRËS”

Porta e hapur e dashurisë së parë, – shkolla pedagogjike e priti dhe nxënësin e fillimit të saj më 1948, tani mësues. Aty gjeti Zenelin, Moisin, Ismailin dhe Shemsion, të cilët mbaruan studimet e larta më parë.

– Mirëseerdhe Lutfi Hanku! – uroi Ismaili.

– Ikëm prej këtu nxënës dhe u kthjem mësues, -tha Zeneli, drejtor. Këta mësues, e të tjerë pas tyre pasuruan me vlera shkencore dhe rritën emrin e pedagogjikes, sa e quajtën “Universiteti i Dibrës”. Mësuesi e shkrimtari brilant nuk i ndante nga vetja, shokun e universitetit, Osmanin merakli në përgatitje, Shemsion, Munirin, Oruçin, Tahirin, Semiun etj. Kujtonte gjallërinë e Ismailit që hynte në Këshillin Pedagogjik me xhakëtën e bërë bardhë me pluhur shkumësi, lëvizjet nga pasioni para tabelës së zezë që e mbushte me ekuacione, mes qetësisë e vëmendjes së nxënësve. Fol, shkruaj dhe fshij, i futur në magjinë e numrave me plus minuse deri sa t’ua regjistronte në mëndje nxënësve. Ndodhte kur në fanatizmin e ligjit të numrave “ikte” harmonia shkencore, atëherë nervoziteti “hante” mësuesin Ismail, por ai nuk “dorëzohej”, derisa t’u pjesëtonte shpirtin human e t’ua

ndante secilit mësues të ardhshëm. Atëherë nxënësit e ndjenin se rriteshin dhe dilnin nga klasa të fituar e të kalitur me vullnet si mësues.

Në albumin e kujtesës së mësuesit Hanku gjelbëronte emri i Nevrezit. Atë nuk mund ta fshihte mjegulla e harresës, as ta treste mermeri i bardhë. Ajo rrezatonte në jetësinë shkollore të nxënësve dhe kolegëve.

SI SHPËTOI MËSUESI NGA NJË “INCIDENT POLITIK”

Kujtonte sa qe gjallë mësues Luti edhe një datë: mëngjesin e gushtit 1967 kur hipi shkallëve të ngushta të Degës së Punëve të Brendshme, i shoqëruar nga polici. E kishte thirrur kryetari, Zija Kambo për një “incident politik”.

Një “Dacibao” (Fletë – rrufe) fajësonte policinë pse nuk vriste qentë rrugaçë që prishnin qetësinë e qytetit. Ajo mbante firmën e mësuesit L. Hanku.

– “Ti ke fyer policinë e popullit! Policia nuk vret qen, por armiq e diversantë”,-bërtiti me ton të ashpër kryetari, sa hyri mësuesi në zyrën e tij.

– “Nuk e paskam ditur që policia nuk vraka qen”,u përgjigj mësuesi me indiferencë.

– “Ti ke nxjerrë mllefin për pushkatimin e vjehrrit tënd.”

– “Mos më paragjykoni shoku kryetar.”

Si u qetësua pakëz, duke zhbiruar fytyrën e mësuesit, vazhdoi:

– “Ti vjen nga një familje shumë e mirë. Por e ke mbyllur rrugën e avenirit. A kishe pak femra që të krijoje familje?!”

Mësuesi u kthjellua dhe e kuptoi hallin e tij.

– “Faleminderit shoku kryetar! Me atë grua më lidhi fati. Ajo sot lindi vajzë....

Heshtja e kryetarit ishte e lexueshme. Por prapë e ngacmoi mësuesin:

– “Përse nuk të mbajti Universiteti?!”

– “Paragjykimi....Biografia... Telefoni...”

...Mësuesi u kthye nga materniteti. Ndjeu të qarën e vajzës së sapolindur. Një jetë tjetër i gëzoi shpirtin për herë të parë, më 20 Gusht 1967, Kozeta, pas 15-vitësh martesë me Hazbie Shehun!

MËSUESI QË “NXINTE” PUNËN E PARTISË NXORI PROFESORËT, MINISTRAT E ARTISTËT E ARDHSHËM

Në vitet ’60-të u shtua gramatura e bukës së konviktorëve. Disa filluan të gjuanin mbi njëri-tjetrin me saçme buke. Ky veprim ra në vesh të Komitetit të Partisë. Sekretari i Parë mblodhi konviktorët. Ngriti të flasë ish konviktorin e vitit 1948 për vështirësitë e asaj kohe, Lutfi Hankun. Ai u kujtoi: “konviktori hante 250 gram bukë misri në ditë. Mbetej gjithnjë i uritur. Me drita feneri mësonim, të palarë e pa zjarr, e të tjera!?!...”

Mbledhja mbaroi në heshtje. Duke dalë sekretari i foli ish konviktorit Hanku:

- Ti e nxive fare punën e Partisë!
- Unë nuk i thashë të gjitha,- u përgjigj i ndrojtur mësuesi.
- Pas pak ditësh mësuesi u ndodh përballë me sekretarin e parë.
- “Shoku sekretar!” – guxoi mësuesi.
- Ç’deshe? u përgjigj i vrejtur e mospërfillës.
- “Konviktorët nuk luajnë më me bukë”.
- Heu, vërtetë?!,-u përgjigj i çuditur sekretari i parë.

Por sekretari nuk e harroi se mësuesi L.H e kishte nxirë punën e Partisë. E hoqi ca vite nga shkolla pedagogjike. I ndërgjegjësuar për misionin fisnik të mësuesit, Lutfiu, veç njohurive të programuara shkencore, mundohej që nxënësit të dilnin sa më të kompletuar e të pjekur, dhe me kulturë artistike.

Mësuesi që dikur u përjashtua nga “Pedagogjika” pse “nxinte” punën e Partisë nxori profesorët, ministrat e artistët ardhshëm. I ndërgjegjësuar për misionin fisnik të mësuesit, Lutfiu, veç njohurive të programuara shkencore, mundohej që nxënësit të dilnin sa më të kompletuar e të pjekur, dhe me kulturë artistike. Dramat e vëna në skenë me nxënësit aktorë nga mësuesi regjisor, si “Përmbysja”, “Cuca e Maleve”, “Përmbytja e Madhe”, “Duke gdhirë viti ’45”, “Shtëpia në bulevard”, disa numra estrade dhe ansamblet në shkollën pedagogjike e bujqësore e rritën emrin dhe vlerat në konkurrimet me shkollat e mesme të Republikës si në Elbasan, Shkodër, Rrëshen, Berat, Bulqizë e Peshkopi dhe pothuajse në gjithë zonat e Dibrës gjatë pushimeve të verës, duke sjellë çmime kombëtare, medalje e dëshmi të sukseseve artistike. Profesor Lutfiu i mbante në mendje pedagogjikasit, bujqësorët e gjimnazistët, ish-nxënësit e tij: Kudusi Lama, Myqerem Tafaj, Fehmi Abdiu, Nexhmi Dumani, Qani Përtafi, Shaban Sinani, Agim

Basha, Zymbyle Zeneli, Arian Kadiu, Lumturie Rexha, Enver Hysa, Lirie Rexha, Natasha Shehu, Përparim Sinani, Fiqiri Novaku, Alie Zhulali, Sali Onuzi, Alleta Martini, Kamber Farruku, Faik Xhani, Reshat Kola, Gëzim Shatku, Vangjel Petri, Latif Okshtuni, Fiqiri Duriçi, Hysen Uka, Baftjar Gazidede, Ramazan Ilnica, Bujar Pata, Bujar Shehu, Agim Shehu, Musa Riçku, Lavdrim Shehu, Syrja Stafa, Kujtim Leka, Shpresa Agolli, Defrim Methasani, Hasije Deva, Nexhmije Cani e shumë të tjerë, emra të spikatur të elitës intelektuale dibrane e kombëtare.

LUTFI HANKU, AUTOR I 41 VEPRAVE LETRARE

Lutfi Hanku, u nda nga jeta më 15 prill 2022 në moshën-89 vjeçare. Ai ishte dhe mbeti deri në fund të jetës praktikant, besimtar i devotshëm dhe përhapës i besimit të paqtë bektashian. Në veprat e tij letrare e publicistike (40 të tilla), bektashizmi, zë një vend të rëndësishëm. Me ndarjen e tij nga jeta, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ka ngushëlluar familjarë, të afërt e miq të Lutfi Hankut. Ndër të tjera, në mesazhin e tij thuhet: *“Me rastin e ndarjes nga kjo jetë, të vëllait tonë, myhibit Lutfi Hanku, shpreh dhimbjen dhe ngushëlloj familjarë e të afër, besimtarët, për ndarjen nga jeta të bektashiut dhe intelektualit të njohur, i cili si myhib e intelektual, dha shumë për besimin tonë. Në librat e tij, një vend të rëndësishëm zenë dhe ngjarjet bektashiane, roli i këtij besimi të paqtë dhe i personaliteteteve të tij. Lamtumirë vëllai ynë!”*. Lutfi Hanku lindi në Zerqan të Dibrës më 4.4.1933 nga një familje e mesme, patriotike me besim bektashian. Ai u rrit jetim. Mësimet e para i mbaroi në vendlindje. U aktivizua si pionier në luftën kundër pushtuesit italo-gjerman. Pas çlirimit të atdheut, vazhdoi studimet në Normale të Elbasanit dhe Uniken në Peshkopi. Më 1948-1952 ndoqi shkollën pedagogjike në Peshkopi dhe e mbaroi në Shkodër. Punoi me përkushtim si mësues në shkollën 7-vjeçare të qytetit të Bulqizës, Kastriotit, Zerqanit dhe inspektor arsimi. Më 1956-1960 mbaroi Universitetin Shtetëror të Tiranës, fakultetin Histori-Filologji. Nga viti 1960-1992, mësues i gjuhës shqipe në shkollat e mesme të qytetit të Peshkopisë. Ka drejtuar rrethet letrare të shkollave, bibliotekat dhe aktivitetet shkencore kulturore artistike. Është vlerësuar në konkurrimet kombëtare për drama, ansamble artistike dhe estrada me medalje nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës. Që në vitet '60 ka botuar në

shtypin monist përshkrime, skica letrare, tregime, monografi të shkurtra historiko-letrare në përmbledhje me shumë autorë dhe në gazeta e revista të sistemit monist dhe pluralist. Në TVSH janë shfaqur tre telefilma për heronjtë e Dibrës. Më 1974 botoi “Nëpër gjurmët e heroit” dhe më 1980 ribotoi “Nazmi Rushiti”. Në vitin 2000 “Kaçaku”, më 2003 “Drita e shpirtit”. Më 2006 romanin “Erdhi Caushi”, më 2009 “Marsi i vrarë” (vepër historiko-letrare). Më 1975, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Dekoruar dy herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, vlerësuar tri herë me dëshminë “Mirënjohja e kombit”, vlerësuar nga Bulqiza “Qytetar Nderi”. Ka drejtuar për disa vite kohë gazetën “Dibra”.

MUHARREM XHEDIKU, KOMPOZITORI I 'TANGOS SHQIPTARE'. JETOI DY DASHURI TË VETME, MUZIKËN DHE SLLAVEN JELICA



- Kompozitorit Muharrem Xhediku, pas luftës, iu besua krijimi i Filharmonisë shqiptare dhe është drejtori i parë i saj. Bashkë me Dhora Leka, Papariston, Jakovën, Avrazin, lanë gjurmë të pashlyera në muzikën shqiptare. Është autor i dhjetëra këngëve të njohura që kanë zënë vend në repertorin e brezave të shumtë.

Kaloi një jetë të dhimbshme, me mund e sakrificë, por la një pasuri të vyer në muzikën shqiptare që është e do të mbetet pronë e brezave... Kompozitori Muharrem Xhediku, ose siç njihet “Kompozitori i Tangos Shqiptare” kaloi në jetën e tij të trazuar vetëm dy dashuri, atë për muzikën dhe sllaven e bukur Jelica... Babai i Muharremit, Hajredini, u vra nga serbët në vitin 1919. Muharremi mbeti jetim në moshën 2-vjeçare. Në këto kushte, e ëma u detyrua që së bashku me katër fëmijët e saj, në vitin 1922 të emigronte nga Dibra në Tiranë, por pa asnjë bazë ekonomike, pa strehim e punë....

RINIA E ARTISTIT

Muharremi, shkollën fillore e mbaroi pranë strehës vorfnore në Tiranë. Përveç bukës së përditshme, aty arriti të siguronte mundësi që i hapnin rrugë për t'u njohur me botën muzikore dhe që në fillim u vu re talenti i tij. Në kryeqytetin e atyre viteve, familja e tij bëri një jetë të mundimshme dhe si pasojë Muharremi u rrit në varfëri... Në vitin 1933, Muharremi arriti të siguronte një punë në një ndërmarrje italiane, por edhe aty pati shkurtime dhe ai u shkrua i pari në listat e atyre që duhet të linin punën. Mllef i Muharremit për gjendjen e tij të mjerë ekonomike po rritej gjithmonë e më tepër. Pjekuria e moshës dhe ndërgjegjësimi i tij bën që ai të kalonte në kampin tjetër, ku rreshtoheshin të pakënaqurit ndaj regjimit monarkist. Ai kritikonte dhe stigmatizonte regjimin e kohës që e kish pllakosur vendin në varfëri ndaj ky ishte shkaku që regjimi e burgosi atë disa herë. Herën e fundit arriti të dalë nga burgu duke e thyer atë. Në vitin 1937, ai u shpall nga mbretëria si element i rrezikshëm dhe u burgos.

ARRATISJA NGA BURGU

Edhe në burg ai i binte çiftelisë dhe këndonte këngët e bukura dibrane dhe të Veriut. Një gardian nga Mati i pëlqente shumë këngët e tij. Në heshtje dhe fshehtësi njëherë i afrohet dhe i thotë: “Mor djalë, ti paske zanat fort të bukur, e qitke lek nëpër dasma, prandaj sillu mirë, dil prej burgu dhe merru me muzikë.”

Po kështu edhe shumë gardianë të tjerë gjatë turnit të tyre afroheshin pranë dritares së qelisë së Muharremit dhe dëgjonin muzikë popullore.

Por fati nuk kishte vendosur ta përkëdhelte akoma Muharremin, prandaj në bazë të akt akuzës ai do të dënohej me 20 vjet burg, prandaj rruga e vetme e shpëtimit ishte arratisja nga burgu dhe largimi për në Itali, për të ndjekur ëndrrën e tij të bukur, shkollimin për muzikë.

Një natë para se të dilte në gjyq, një shok i dërgoi një pako me ushqime. Brenda pakos ishte futur një ibrik me kos ndërsa në fund një sharrë hekuri dhe një kastravec në mesin e të cilit fshihej lima e hekurit. Shoku e porositi: “Kujdes, se kosi është i hollë, por merr nga fundi! Edhe kastravec i është pak i vjetër, por ti haji zemrën! Po nuk e konsumove ushqimin sonte, nesër nuk do të sjellim më gjë”. Muharremi e kuptoi në çast se porosia e tij kishte ardhur.

Muharremi kërkoi të shkonte në banjë nga mesi i natës dhe atje u mbyll brenda, derisa arriti që të sharrojë hekurat e dritareve të banjës dhe të arratiset... Xhandarët dhanë lajmin se Muharremi ishte mbytur dhe dërguan lajmin në shtëpi. Milicët kishin hapur lajmin se kafshët ia kishin copëtuar kufomën dhe nëna Sudja e vajtoi djalin për së gjalli pa kufomë.

NË KOLEGJIN E JEZUITËVE SHKODËR

Muharremi arriti të shpëtojë dhe të mbijetojë pas rënies në lumë. Ai arriti të vishet si fshatar, por vendosi të mos kthehej më në shtëpi, por të udhëtonte drejt Shkodrës. Udhëtimi zgjati 5 ditë, rrugë e pa rrugë. Kudo që kaloi, ai hasi në bujarinë e njerëzve, të fshatarëve lezhjanë dhe të shkodranëve. Pasi punoi për një farë kohe si karrocier për shpërndarjen e qymyrit nëpër shtëpitë e qytetit të Shkodrës, me emrin Martin Mirashi dhe me dokumente të rreme të një shoku, futet në kolegjin jezuit të Shkodrës. Mundësia që arriti të futej në këtë kolegji ishte se fare rastësisht ai shpëton jetën e nipit të drejtorit të kolegjit, i cili ra nga një pemë. Por emri Martin Muharremi iu fiksua si një emër i dytë, si një emër i dashur. Edhe sot, një nga nipat e Muharremit jo rastësisht mban emrin Martin, që është një nga amanetet e tij.

STUDIMET NË ITALI

Pas tre vjetësh, kolegjin e mbaroi shkëlqyeshëm dhe u diplomua si prift. Drejtori i këtij kolegji, që e kishte shumë për zemër Muharremin (Martinin) e ndihmoi të shkonte për studime teologjike në Itali, bursë nëpërmjet Vatikanit. Ishte ende i ri kur emigroi në Itali, ku u gjend nën përkujdesjen e një prifti i cili e bëri bir në shpirt. Edhe në kolegjin e lartë të jezuitëve të qytetit të Laningos u dallua për zell në mësim dhe zgjuarsia. Por në vitin e fundit të kolegjit, ai shpalo të vërtetën e fesë së tij dhe të bindjeve të tij që tani nuk ishin as myslimane dhe as katolike, por ateiste. Kjo dëshmi e hapur i solli mjaft pasoja të rënda pasi provoi përsëri privimin nga liria, por këtë herë duke vuajtur burgimin në Vatikan. Me ndihmën e Luçias, vajza e një pedagogu të jashtëm të tij, por që nuk jepte lëndë fetare, por shkencore, arriti të arratiset nga ky burg duke u veshur si murgeshë.

NË KONSERVATORIN E BOLONJËS

Pas arratisjes nga burgu në Itali filloi jetën e vështirë të emigrantit ekonomik. Pa punë, pa përkrahje, i vetmuar dhe pa shpresë shkon në Siçili dhe fillon punë si kamerier. Punoj tre muaj dhe mori vlerësimin e pronarit të lokalit. Pronari i lokalit kishte një mik në Bolonja, i cili menaxhonte një lokal ku luhej muzikë dhe kërkonte një kitarist që të dinte gjuhë të huaja. Muharremi, me emrin italian Mario, shkon në Bolonja dhe konkuron për këtë vend pune. Fitoi jo vetëm punën si kamerier, por edhe si kryekamerier. Fati filloi t'i rezervonte vetëm surpriza të bukura Muharremit. Dukej sikur dimri i ftohtë, gri e plot acar po largohej nga jeta e tij dhe po vinte pranvera e bukur shumëngjyrëshe, e ngrohtë dhe gjithë blerim. Ajo që i jepte më zemër dhe e mbushte me shpresa pa fund Muharremin, ishte se pronari i lokalit administronte një konservator muzike. Muharremi (Mario) iu lut pronarit që të studionte për muzikë në këtë konservator jashtë orarit të punës dhe në fund t'iu nënshtrohej provimeve. Fati i hapi këtë herë plotësisht krahët për të. Edhe pse duhet të punonte, arriti të vazhdojë studimet në konservatorin e Bolonjës, duke shpalosur talentin. Muharremi pak nga pak filloi të zhytej në botën e mrekullueshme dhe plot emocion të muzikës, të gjigantëve të kësaj bote të magjishme që me veprat e tyre tronditën skenat mbarëbotërore dhe u bënë frymëzim për shumë ngjarje jetësore... Nuk e pati të vështirë t'i mbaronte studimet e konservatorit me rezultate të larta. U diplomua në konservatorin e famshëm të Bolonjës dhe sigurisht që tani ndihej më krenar.

KTHIMI NË SHQIPËRI

Pas pushtimit italian të vendit, Muharremi vendosi të kthehej në Shqipëri. Ishte shpallur amnisti për të dënuarit e regjimit të Zogut.

Ai vendosi të kthehej në atdhe dhe të jepte kontributin e tij, tashmë si një intelektual profesionalisht i formuar... Pronarët e fundit italianë, të cilët e donin shumë, i kishin premtuar edhe një trashëgimi të vogël. Ata organizuan një mbrëmje përcjellëse për Muharremin apo Marion, ashtu sikurse e njihnin në ato mjedise. Pas darkës, pak metra larg lokalit dy persona e godasin dhe e mbërthejnë për t'i rrëmbyer paratë dhe dokumentet e trashëgimisë. E raportojnë se është shqiptar dhe se fshihet

me emër të rremë. Të nesërmen, gazetat botojnë në kronikën e zezë për një shqiptar që kishte mashtruar dhe ishte fshehur nën një emër italian. Kështu, Muharremi humbi edhe paratë, edhe atë trashëgimi të vogël të premtuar me akt noterial. Ëndrra e bukur për të u ndërpre përsëri në mes dhe tani duhet të luftonte me fatin, ta fillonte përsëri çdo gjë nga e para. I dërrmuar dhe i demoralizuar për çfarë i ndodhi, mori rrugën për t'u kthyer në Shqipëri përmes portit të Barit. Futet në një vapor mallrash që kishte ngarkuar qymyr dhe u nis për në atdheun e tij aq të dashur, që i mungonte prej kohësh. Me të arritur në Durrës, i pangrënë, i veshur keq dhe i lodhur, niset në këmbë drejt Tiranës, drejt “shtëpisë”, barakës së vjetër ku e priste nënë Sudja. Ajo e dinte të vdekur, por thellë në zemër besonte se djali ishte gjallë... Nënë Sudja kishte shtatë vjet që qëndronte krejt sy e veshë se një ditë apo natë do ta dëgjonte zërin e djalit të saj. Dhe mrekullia ndodhi. Ishte Muharremi që thërriste: “Nënë, hape derën, jam Muharremi.” Nënë Suden nuk e linte qeni të dëgjonte, por zërin e djalit të saj arriti ta dallonte. E pabesueshme, por e vërtetë!!! Mblodhi veten. Kishte shtatë vjet që e priste këtë çast. Kishte shtatë vjet që nuk besonte se djali kishte vdekur. Iu hodh në qafë...

NË KAMPIN E PËRQËNDRIMIT TË PRISHTINËS

Pas 25 ditë dhe net udhëtimi, rrugë e pa rrugë nëpër male, arriti në Prishtinë tek Ivan Tomasheviçi, për të cilin kishte patur një rekomandim nga Alush Zari, me të cilin kishte patur lidhje që në Tiranë. Ivani e pranoi në shtëpi, i ofroi strehim dhe e ndihmoi të punonte si përkthyes në Dhomën e Tregtisë. Më vonë, Muharremi arrin të futet si nëpunës, protokollist-arkivist në zyrat e pushtetit fashist në Prishtinë. Ai njëjtte disa gjuhë të huaja dhe kjo e ndihmonte në punën e tij. Megjithatë, ai ishte kurdoherë në vëzhgim.

Në vitin 1943, një spiun kishte dorëzuar një listë për burgosjen e 92 shokëve kosovarë në Federalin e Ferizajt. Muharremi njoftoi shokët dhe ata arritën që të shpëtonin. Ai ndiqej në çdo hap që hidhte dhe nga shkonte. Këtë e ndjente edhe vetë, prandaj, pasi e gjurmoi, vendosi që spiunin Alush Agai ta qëllonte për ta vrasë, por nuk arriti ta vrasë. Pas këtij atentati, shtatë karabinierë e rrethuan, e kapën dhe në tetor 1943 e burgosën në kampin e Prishtinës. Kampi i internimit në Prishtinë nuk ishte kamp, por

burg dhe kaluar burgut. Ai ishte i rrethuar me tela me gjemba. Qëndroi në këtë kamp internimi deri në qershor të vitit 1944, kohë kur arriti të arratisej nëpërmjet kanalit të ujërave të zeza të kampit, që kishte dalje në qytet. Udhëtoi një muaj rresht nëpër malet dhe fshatrat e Kosovës, deri sa mbërriti në fshatrat e Dibrës

DASHURIA ME JELICËN

Jelica. Një emër, një dashuri, një ëndërr, një këngë, një shpresë, një gëzim, një hidhërim, një vuajtje... Një femër jo si të gjitha femrat, një vajzë e veçantë që ia ngriti peshë zemrën që në momentin që e pa për herë të parë. Pikërisht, atëherë kur shpresat ishin ndërprerë, u shfaq ajo, Jelica, vajza malazeze. Ajo ishte e bija e kryegardianit të burgut. Ajo hynte e dilte në kamp për të takuar të atin. Ishte vetëm 16 vjeçe dhe babai e kishte dritë të syrit. Një ditë u takuan rastësisht në oborrin e kampit Jelica, malazezja 16- vjeçare, e bija e komandantit të kampit dhe Muharremi, i burgosuri shqiptar, që nuk pajtohej me asnjë regjim e padrejtësi. Muharremi, ky muzikant i lindur që prodhonte dashuri me sy, zemër, buzë, me këngë dhe me kitarën që së ndante asnjëherë, e tërhoqi si një magnet vajzën që dukej sikur kishte dalë nga bota e personazheve të një përralle të bukur... Vajza malazeze kishte zgjedhur për shok jete djaloshin shqiptar, muzikantin e shkolluar në konservatorin italian. Ajo ishte një bukuri mesdhetare, ku Zoti, skulptori i vetëm i natyrës dhe i gjithësisë e kishte gdhendur plot dashuri. Përsosmëria e saj dukej tek balli i gjerë, sytë e shkruar, trupi plot forma të rrumbullakëta, me një simetri të habitshme. Por jo më larg saj qëndronte Muharremi, që mbi të gjitha të bënte për vete me fjalët e ngrohta, që i dilnin nga goja si një simfoni e ëmbël. Kështu ndodhi edhe me Jelicën. Sapo e pa Muharremin, i rrahu fort zemra, kraharori sa nuk i doli nga vendi, truri iu turbullua nga dashuria. Çdo ditë nuk mund të kalonte pa u takuar, pa u parë. Muharremi, për këtë vajzë të bukur që më vonë do të bëhej gruaja e tij, kompozoi këngën e famshme "Jelica".

KOMPOZITORI, PARTIZAN

Për bashkimin e tyre mendoi vajza e bukur malazeze. Ajo përgatiti një plan të shkëlqyer arratisjeje që do ta kishte zili edhe një oficer i përgatitur

i shërbimeve sekrete. Dy të rinjtë arritën të arratisen nga kampi me ndihmën e Alush Zeqirit, që u tregoi dhe i ndihmoi të kalonin nëpërmjet kanalit të ujërave të zeza të kampit, i cili kishte dalje në qytet. Një kalvar i papërshtetshëm vuajtjesh edhe rruga përgjatë këtij kanali të ngushtë e të qelbur, por nuk kishte gjë që i ndalte dy të rinjtë e dashuruar. Muharremi së bashku me Jelicën (tashmë gruan e tij) inkuadrohen në Brigadën e 18-të, ku shërbeu në sektorin e propagandës dhe dha një ndihmesë të jashtëzakonshme në korin partizan. Muharrem Xhediku njehsohet me ata kompozitorë partizanë që krijuan këngë, himne dhe balada për Luftën Nacionalçlirimtare siç ishin Dhora Leka, Paparisto, Jakova, Avrazi, etj. Ndërsa bashkëshortja e tij, Jelica, dha një kontribut të madh si infermiere për mjekimin e të plagosurve të Brigadës. Muharremi mban Medaljen e Çlirimit për pjesëmarrje me armë në dorë në rreshtat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

NDARJA ME JELICËN

Me kalimin e viteve, jeta e vështirë që kishte kaluar që në fëmijëri dhe rini, të ftohtët që kishte marrë në internim, maleve duke luftuar, burgjeve duke mbijetuar bënë që të shfaqej sëmundja e tuberkulozit, që do ta mundonte pjesën tjetër të mbetur të jetës. Ndoshta ishte ky shkaku që martesë e tij me Jelicën, që mbeti dashuria e tij e vetme e vërtetë, të merrte fund. Ndarjen me Jelicën e përjetoi në mënyrë dramatike. Por shkaku i vërtetë i ndarjes me Jelicën nuk ishte sëmundja e Muharremit. Jelica ishte një grua e rrallë, e dashuruar marrëzisht me Muharremin, i shërbente si një fëmie; e puthte, e lante, e ndërronte, i rrinte mbi kokë, e shihte në dritë të syrit.

Por cili ishte shkaku i vërtetë i ndarjes me Jelicën, me këtë dashuri që i ngjasonte rrezes së diellit pas shtrëngatës?! Shkaku i ndarjes, ishin thashethemet. Opinioni i keq i kohës për gratë me kombësi të huaj, presioni që bëhej nga partia-shtet e asaj kohe dhe ish-Sigurimi famëkeq i Shtetit, që i shikonin femrat e huaja si agjente, si kundërshtarë të regjimit komunist nuk e kurseu as Jelicën bukuroshe.

Në sanatoriumin e shtetit në Tiranë ku shërbente Jelica dhe ku kurohej të shumtën e kohës Muharremi, punonte edhe Dr. Kalvari, një mjek serb, të cilin e akuzuan për marrëdhënie me Jelicën, gjë që nuk ishte kurrë e

vërtetë, pasi Jelica dashuronte marrëzisht Muharremin. Edhe familjarët e rrethi i ngushtë i miqve të Muharremit e mbrojtën me forcë e vërtetësi figurën e nuses së huaj, por opinionin dhe mjedisi i mykur patriarkal ishte tepër mbytës. Fjalët e liga e bënë punën e tyre. Ato ranë si bomba mbi trurin dhe zemrën e Muharremit të sëmure, i cili thellë në ndërgjegje ishte i bindur për pafajësinë e gruas së tij. Tashmë fuqitë, të prangosura prej avancimit të sëmurdjes, po e linin dhe ai nuk mund ta përballonte dot presionin dashakeqës, kështu që pranoi të ndahej nga dashuria e vetme dhe e vërtetë e jetës së tij.

TRASHËGIMIA

Megjithëse vdiq në moshë të re, Muharrem Xhediku do të mbetet një nga baballarët e kultivimit të muzikës së lehtë shqiptare. Pas çlirimit, atij iu besua krijimi i filarmonisë shqiptare. Punoi si drejtues në korin e ushtrisë dhe është drejtori i parë i filarmonisë shqiptare, megjithëse është e papranueshme mospërmendja e këtij fakti. Ai ka shërbyer edhe si pedagog në shkollën e parë të muzikës në Tiranë. Në të njëjtën kohë iu kushtua kompozimeve të këngëve të muzikës së lehtë dhe përpunimit të këngëve burimore, duke u bërë një ndër kompozitorët më të adhuruar të kohës... E veçanta e kompozimit të tij ishte se ai i shkruante vetë tekstet dhe i kompozonte mbi bazën e tabanit tonë kombëtar. Këngët si “Falmi sytë e shkru”, “Engjëllushes”, “Matura”, “Jelica”, etj. kanë mbetur edhe sot në kujtesën e asaj gjenerate si këngët me motivet më të bukura plot pasion të dashurisë.

...Krahas muzikës së lehtë, ai kompozoi edhe këngë popullore si: “Cuca e Radomirës”, “Hajde shpirt se erdh pranvera”, “Te kroni”, etj.. Mrekullohesh kur dëgjon nga Eranda Libohova këngën “Cuca e Radomirës”.

Xhediku është kompozitori i parë që solli me profesionalizëm ritmet e muzikës së lehtë, sidomos të tangos në Shqipëri. Ai shkroi dhe kompozoi në të gjitha gjinitë e muzikës, jo vetëm këngë, por edhe romanca, pjesë për koncerte, suita orkestrale, opereta, muzikë vallëzimi, etj. Tangot e tij këndohen dhe kërcëhen edhe sot.

Kur dëgjon “Artistin e Popullit” Ramiz Kovaçi të këndojë “Bareshë e malit”, shoqëruar në piano nga Margarita Kristidhi, të duket sikur je pranë burimeve të malit dhe mes cicërimave të zogjve. Një mrekulli muzikore

që të jep natyrë dhe dashuri hyjnore. Karakteristika të veçanta ka edhe kënga “Kur më zbret bregut”, kënduar nga Pranvera Baçe, këngëtare e grupit artistik të Korçës. Sjell humor por shoqërohet nga ndjenja “Kënga e pleshtit”, interpretuar nga artisti Hysen Pellingu. Kënga “Matura” ose “Unë për ty nuk do të shkruaj”, në ato vite himn i tangos shqiptare, interpretohet nga një zë dinjitoz i muzikës shqiptare, Anita Take. Mjaft interesant është gjithashtu interpretimi i Gaqo dhe Luiza Çakos në këngën “E dua jetën”. Dueti Anita Take dhe Xhavit Xhepa është një kombinim i mahnitshëm zërash tek kënga “Te burimi”. Muzika si në këngë, ashtu edhe orkestrale, p.sh. tek kënga “Në parkun e qytetit”, kënduar nga Anita Take, është shumë ngacmuese, ngazëlluese, duke provokuar lëvizje të pashmangshme. Zëri i Pjetër Gjergjit tek kënga “Lisi plak” (Shkruamë të vërtetën) tingëllon si kënga e një bilbili mali. Dhe më tej, dueti Pjetër dhe Florinda Gjergji tek kënga popullore e Xhedikut “N’at” livadh” duket sikur me të vërtetë vallëzon nëpër livadhet dhe lëndinat e bukura dhe të pafundme shqiptare... Duetet Pjetër Gjergji dhe Anita Take vazhdojnë me këngët “Ndarja nuk na ndan” dhe “Të pres”, këngë karakteristike të tangos shqiptare, vepra të papërsëritura të Xhedikut. Hysen Pellingu shpërthen fuqishëm me lirizmin e tij karakteristik tek kënga “Cuca e Radomirës”, një mrekulli e këngës popullore dibrane.

XHEKDIUK NË ‘100 KËNGËT E SHEKULLIT’

Midis dhjetëra kompozitorëve të talentuar, midis dhjetëra këngëve të mrekullueshme, me riorkestrimin e kompozitorit të mirënjohur Edmond Zhulali dhe nën interpretimin e Aleksandër Gjokës, në konkurimin ‘100 këngët e shekullit’ u paraqit edhe kënga “Falmi sytë e shkruar”, e cila befasoi për muzikalitetin e saj dhe tekstin e saj të ndjerë për dashurinë. Edhe sot e gjithë ditën kënga pëlqehet e këndohet nga të rinjtë dhe nga publiku muzikëdashës, gjë që flet për muzikalitetin e krijimeve të Xhedikut dhe të aftësisë së tij krijuese.

DISA KËNGË TË AUTORIT

- “Falmi sytë e shkru”
- “Vashës sime” (Vajzë engjëlllore),

- “Matura” (Unë për ty nuk do të shkruaj)
- “Jelica”
- “Pranvera e re”
- “Fshatarja deputete”
- “Do ta gris çarçafin”
- “Kur dielli bie”
- “Komisarja dëshmore”
- “Erë pranvere”
- “Këngë për hidrocentralin”
- “Vashës trimëreshë”
- “Do të ngremë së bashku digën”
- “Kënga e të mërguarit” (kurbetit)
- “Do të korr arat me kombajnë”
- “Afërdita traktoriste”
- “Syrin ma ke si filxhan”
- “Bukuroshja shamikuqe”
- “E para ndër shoqe”
- “Lumi i Matit, ujë dhe dritë”
- “Shkëlqen Tirana”
- “Zall Dardhës trime”
- “Tek burimi”
- “Tek kroni”
- “Pllumb i shkruar”
- “Hajde shpirt se erdh pranvera”
- “Hallet e bilbilit”
- “Cuca e Radomirës”
- “Maturantes”
- “Lisi plak”(Shkruam të vërtetën)
- “Vendit tim”
- “Trëndafili dhe zogu”
- “Kanga e pleshtit” (humoristike)
- “N’at’ livadh”
- “Në parkun e qytetit”
- “E dua jetën”
- “Të pres”

- “Ndarja nuk na ndan”
- “Bareshë e malit”, etj, etj.

VLERËSIME TË ARTISTËVE PËR KOMPOZITORIN

Avni Mula (“Artisti i Popullit”):“Sa herë dëgjoj tingujt muzikorë të kitarës, sa herë shoh kitarë, më del përpara sysh figura e ndritur e kolegut dhe shokut tim të nderuar, kompozitorit të talentuar Muharrem Xhediku”.

Çesk Zadeja (“Artisti i Popullit”):“Shpesh këngët e bukura, të kompozuara me frymëzim dhe ndjenjë të hollë poetike, që kanë transmetuar idealet e larta të popullit dhe punën e gjallë, traditat luftarake e atdhetare të tij, populli i ka bërë të vetat, duke shkruar autorësinë e tij dhe duke i shndërruar në këngë popullore. Kjo ka ndodhur edhe me krijimet e kompozitorit Muharrem Xhediku dhe ky është një fat dhe nder për të”

Edmond Zhulali (Kompozitor): Kur dëgjoj realizimet muzikore të viteve ‘50-‘70, ndryshimi në mes këngës shqiptare dhe asaj botërore ka qenë i vogël dhe kjo falë disa muzikantëve si M.Xhediku që sillnin një kulturë perëndimore. Këngët e dashura të M.Xhedikut do të vinin duke u harruar dhe zëvendësuar me këngët e “jetës së re”, me një krijimtari të sforcuar të autocensuruar nga vetë artistët.


Anita Take (Këngëtare): “Ai ishte një muzikant i talentuar si instrumentist, si kompozitor edhe si drejtues. Unë kam kënduar disa këngë të M.Xhedikut si “Te burimi”, “Vajzë ëngjëllore”, etj. Pavlina Nikaj ka kënduar gjithashtu shumë këngë të Xhedikut. Muharrem Xhediku ishte një muzikant i mrekullueshëm.

Miço Kallamata (shkrimtar): “Muharrem Xhediku ishte një partizan dhe kuadër shembullor në luftë. Ai kryente me përpikmëri të gjitha detyrat e ngarkuara, duke luftuar me pushkë, penë dhe kitarë. Por ai mbetet një kompozitor i talentuar që u dhuroi brezave këngë të pa vdekshme”

Arben Duka(Poet): “Xhediku ka lënë gjurmë në historinë e këngës shqiptare. Këngët e tij i kanë rezistuar dhe do i rezistojnë kohës, pasi ato kanë shpirtin e gjerë të një artisti të rrallë, që kishte dijen e kulturën dhe talentin për të prodhuar perla të muzikës sonë”

(Nga libri “Muharrem Xhediu, kompozitori i tangos shqiptare”, me bashkëautor Sakip Camin)

“NDERI I KOMBIT” HAZIS NDRU – EZOPI I DIBRËS



- Nga partizan në festivalin rinor në Moskë më 1957, arti i “Ezopit të Dibrës”! Si u krijua kënga e Hajredin Pashës

E kanë quajtur ”Ezopi i Dibrës”, “Burri i Odës Dibrane”, “magu”, i cili me preken e tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo shqiptari. Ndoshta si për askënd tjetër, për ish-partizanin e Brigadës së Parë Sulmuese dhe të parin drejtues vendor në Zall Dardhën ku ka lindur, koreografin e valltarin që me talentin e rrallë të të kërcyerit ka mahnitur jo vetëm publikun shqiptar, por edhe atë rus në Festivalin e gjashtë Botëror të Rinisë e Studentëve në Moskë më 1957, për artistin, poetin, studiuesin dhe shkrimtarin e mirënjohur Hazi Ndreu – Nderi i Kombit, janë shkruar, botuar dhe promovuar bujshëm katër monografi. Dhe jo nga autorë të rastësishëm, por nga personalitete të mirënjohura të letrave, si: Prof.Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, Prof.dr.Ramazan Bogdani – “Mjeshtër Madh” – shkrimtar dhe studiues i etnomuzikologjisë dhe etnokoreografisë, Xhezair Abazi – shkrimtar dhe kritik i mirënjohur letrar dhe nga prozatori e poeti Xhafer Martini – ish-Kryetar i Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Dibrës.

I vlerësuar, gjithashtu, nga personalitetet kryesore të letrave e artit:

Dritëro Agolli, Kol Jakova, Drago Siliqi, Moikom Zeqo, Bujar Kapexhiu, Ramazan Bogdani, Skënder Sallaku, Reshat Arbana, Luftar Paja, Agron Xhangolli, etj, si ikonë e artit e kulturës kombëtare, ky artist, studiues e shkrimtar me rrezatim mbarëkombëtar, këtë 1 shkurt do të festonte 97-vjetorin e ditëlindjes.

Shtatëmbëdhjetë vjet më parë, (në 80-vjetorin e ditëlindjes) u realizua një spektakël madhështor në përkujtim të “Artistit të Merituar” Hazis Ndreu. Skenarist, regjisor dhe prezantues, prof. Bujar Kapexhiu – “Nderi i Kombit”, i cili pas disa vitesh do ta përjetësonte atë në veprën e tij monumentale “Burri i Odës Dibrane”. Një spektakël për një artist dhe njeri të madh, ku interpretuan artistë dhe njerëz të mëdhenj të botës së artit, kulturës e shkencës.

Për të arritur deri te ky spektakël-shoë, Kapexhiut iu deshën muaj të tërë parapërgatitje... Dhjetëra takime me studiuesit e Institutit të Folklorit, prof.dr. Ramazan Bogdani, Agron Xhagollin, Skënder Sallakun, Skënder Calën, Inajet Shehun etj. Të gjitha takimet të monitoruara besnikërisht nga djali i madh artist i Hazizit, Avni Ndreu – “Mjeshtër i Madh” (drejtues dhe koreograf i Ansambllit Artistik që mban emrin e babait të tij), sipas të cilit: “Baba interesohej për të gjithë, të njohur e të panjohur, që ishin në hall apo që kishin ndonjë problem me zyrtarët. Interesohej për ata që hynin në burg, që i pushonin nga puna, për ata që s’kishin Triskë Fronti, për të futur dikë në shkollë, për vizitë të ndonjë mjek i zoti... Ishte me një fjalë, derë e hapur për popullin, njoft e panjof... e dinin që Hazizi të mbaron punë se është i njohur dhe e duan të gjithë... deri në Tiranë... te qeveria”.

Po, i tillë ishte Hazis Ndreu ‘magu’, i cili me prekjen e tij magjike ngre peshë zemrën e çdo dibrani, pasi arti i tij i flet atij për gjërat më të vyera të pajës më të vyer shpirtërore, siç shprehet për të shkrimtari i mirënjohur Agron Tufa.

PAK NGA AUTOBIOGRAFIA PËR “DOSJEN E KUADRIT”

Referuar autobiografisë së shkruar më 1974 për “Dosjen e Kuadrit”, Xhezair Abazi, në librin “Ezopi i Dibrës” ndër të tjera na njeh me faktin se pasi kishte qenë dy muaj xhandar, në shtator 1944 Hazis Ndreu radhitet si partizan në Brigadën e Parë Sulmuese. Në kreun e I (Jeta) të këtij libri

ndër më të kërkuarit nga lexuesit, Xh.Abazi i mirënjohur për kontributin madhor në fushën e kritikës dhe të studimeve letrare dhe që për 30 vjet (1979-2009) punoi në Lidhjen Shkrimtarëve, redaktor në “Drita”, shef i sektorit të kritikës dhe botues në SHBL, shkruan se : “ ... Për vetë faktin që xhanadar ndejti vetëm 2 muaj dhe, në shtator rradhitet në Brigadën e Parë Sulmuese, mendoj se Hazizi po lëvizte jo thjeshtë për të siguruar jetesën e familjes. Një djalosh, që e kishte filluar ‘jetesën’ që 7 vjeç, tanimë duhet të zgjidhte rrjedhën e së ardhmes ». (fq.27). Dhe në të vërtetë kjo do të ishte zgjedhja më e mirë e djaloshit që «nga mosha 7-16 vjeç u rrit duke punuar në dyret e botës, nëpër male, stërka, në borë e shi, duke fjetur në rrogoz, duke e zgjuar me këmbë dhe duke ngrënë çfarë u tepronte të zotëve », që sipas Xh.Abazit, do të thotë t’ia kalosh Oliver Tuistit.

Ish- partizani që mori pjesë në luftën heroike për çlirimin e Tiranës, (luftë ku ranë dëshmorë 3-4 djem nga Dardha) ndonëse vetëm 16 vjeç do të merrte pjesë në rrugëtimin e gjatë të kësaj brigade deri në janar të ’46-ës kur e kaluan në Brigadën e Mbrojtjes së Popullit, dhe kur filloi të marrë rrogë si ushtarak efektiv. ”Pesë vite të jetës së tij (16-21 vjeç) rrjedhin si partizan dhe ushtarak efektiv. Kanë qenë vitet kur i është lidhur ashti i trupit, por edhe ashti i shpirtit. Një fëmijë që e ka filluar 7 vjeç ‘shërbimin civil’ për ta vazhduar me pesë vite shërbim ushtarak. Për dy vite të tjera (1970-51) punon përsëri ushtarak, por këto në organet e Sigurimit të shtetit”, -shkruan Xh.Abazi në librin “Ezopi i Dibrës”, (fq.32). Më pas për dy vite (1972-54) Hazis Ndreu qe kryetar lokaliteti në Zall Dardhë, për të vijuar si Sekretar Komiteti në Shumbat kur Dibra u bë Qark dhe Shumbati rreth, dhe po në vjeshtën e atij viti (1974) e transferojnë shef të Fuqisë Punëtore të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Dibër.

HAZIS NDREUT I BURONTE MAGJI ARTISTIKE TËRË QËNIA E TIJ

Hazis Ndreu, fëmija i dytë i Halim Ndreut dhe Vaskë Barës, që kishte lindur në Zall Dardhë më 1 shkurt 1928, do të bënte emër e karrierë në fushën e artit e kulturës. Kështu në harkun kohor të tri dekadave (1977-1987 ai kryen më së miri funksione të rëndësishme si: Përgjegjës i Shtëpisë së Kulturës Peshkopi; Drejtor i Estradës dhe Shtëpisë së Kulturës Peshkopi; Inspektor i Kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit Dibër, si aktor,

orkestrant e koreograf në Estradën Profesioniste etj. Ndërkohë gjatë këtyre viteve merr pjesë në Festivalin e Rinisë Rinisë Botërore në Moskë, ku midis 103 grupeve konkurruese fiton çmimin e tretë si valltar (1977), fiton çmimin e parë në Festivalin Kombëtar të Fjalës Artistike, me kryetar Jurie Kujtim Spahivoglin (1964) kur shkruan poemën “Dibrës time”; merr pjesë në turneun tre mujor të Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve në Kinë (1967); merr çmimin e dytë në konkursin kombëtar për poemën satirike “Ma kadalë, or Kapidan” (1969).

Dhjetë vite më vonë më 1979 i jepet titulli “Artist i Merituar”; Më 1982 merr çmim të dytë për poezi satirike nga revista “Hosteni” dhe po atë vit, me Ansambllin “Kukësi i Ri” shkon në një turne një mujor në Kosovë, ku repertori i tij pati një pritje dhe jehonë të jashtëzakonshme.

Në vitet ’80-të Hazis Ndreu ka qenë pjesë e turneut të Ansambllit Shtetëror të Këngëve e Valleve në Turqi...

Kompozitori i mirënjohur Edmond Zhulali, jo më kot është shprehur se “Po të kishte kryer konservatorin, Hazis Ndreu do të ishte një ndër baritonët më të mëdhenj në Europë”....dhe po sipas E.Zhulalit “Në don të prekësh Dibrën në një pikë, lexo Hazis Ndreun”.

Autorit të librit “Ezopi i Dibrës” do ti mjaftonte kjo karrierë e shkëlqyer artistike për të konkluduar se Hazis Ndreut i buronte magji artistike tërë qenia e tij.

KËNGËT E HAZIS NDREUT, KËNGË TË KRENARISË KOMBËTARE

Është i njohur tashmë, jo vetëm në metropolin shqiptar, por edhe në Stamboll, Ulqin, Shkup, Kërçovë, Strugë, Prishtinë, etj, Ansambli Artistik “Hazis Ndreu” - “Nderi i Kombit”, i cili, pesëmbëdhjetë vite pas “pagëzimit me këtë emër” ka fituar dhjetëra çmime të para e trofe në festivale kombëtare e ndërkombëtare. Presidenti i këtij Ansambli Muharrem Gjoka – “Mjeshtër i Madh” dhe “Qytetar Nderi” i Qarkut Dibër shprehet se: “Vlerat dhe përmasat këtij ansambli, madhështia e tij, konsistojnë edhe në emrin që mban: ‘Hazis Ndreu’ – ‘Nderi i Kombit’, titull me të cilin u dekorua para katër vitesh (Dekret Nr. 11708, datë 17.09.2020) me motivacionin: ”Për veprimtarinë e shumanshme në lartësimin e kulturës kombëtare, etnografisë, folklorit e muzikës popullore shqiptare, veçanërisht asaj

dibrane. Si autor e interpretues virtuoz i këngëve e valleve folklorike dhe si studiues, hulumtues e krijues letrar i shquar”.

Për zotin Gjoka, mjafton qoftë edhe ky motivacion për ta konsideruar Hazis Ndreun ikonë të artit e kulturës kombëtare. Kjo, sipas tij edhe për faktin se Ai ka qenë i afirmuar si këngëtar popullor në nivel kombëtar. Ka marrë pjesë në Festivalin e këngës, muzikës dhe valles në Tiranë më 25-27 nëntor të vitit 1979, ku vlerësohet me çmimin e lartë “Rapsod popullor”. Pas kësaj, merr pjesë rregullisht në të gjitha festivalet folklorike të Gjirokastrës dhe në Festivalin e këngës popullore të Beratit, në vitin 1997.

KËNGA E HAJAJREDIN PASHËS, SI KRIJIM, PËRPUNIM DHE INTERPRETIM I HAZIS NDREUT ËSHTË BËRË HIT KOMBËTAR

Liri Rasha, një tjetër zë brilant dhe interpretese e talentuar e këngës popullore e qytetare vlerëson se: “Këngët e Hazis Ndreut janë të veçanta në shumë segmente krijuese dhe interpretese. Për dallim nga rapsodët e tjerë që kanë krijuar e kënduar dhjetëra e qindra këngë, albumi i këngëve të tij duket modest, por origjinaliteti i këngës së tij është tej mase i veçantë, qoftë me zërin burror, të lindur apo të trashëguar, qoftë me përzgjedhjen e këngëve, meqë ai ka kënduar vetëm këngë historike dhe këngë trimërie, qoftë me melodinë dhe kompozimin e shquar artistik, qoftë me mënyrën arkaike të kënduarit, qoftë me forcën e brendshme shpirtërore, mobilizuese, që iu ka dhënë këngëve”. Ndërkohë, Muharrem Gjoka vijon: “Të gjitha këngët e Hazis Ndreut janë antologjike, të gjitha këngët e tij janë këngë të krenarisë kombëtare, këngë që kurrë nuk harrohen, kurrë nuk vjetërohen”. Kjo sipas tij për faktin se sapo ta dëgjosh këngën e Hajredin Pashës, pavarësisht se kush e këndon dhe pavarësisht sa mundohet ta këndojë mirë e më mirë, nuk ka si të mos kujtohet origjinali, të cilit askush deri sot nuk i është afruar. Kjo këngë, si krijim, përpunim dhe interpretim i të madhit Hazis Ndreu është bërë sot hit kombëtar. Në këtë këngë ai ka bërë bashkë zërat kushtimtarë si uraganë të ndezur flakë të Lumës e Dibrës, zërin mobilizues të masave të revoltuara shqiptare kundër mbretit të Turqisë, ka intonuar zërin më të fuqishëm të mundshëm të kushtimit të furisë kryengritëse, të ndeshjeve për jetë a vdekje, zërin e ngadhënjimit çlirimtar.

Kjo këngë epike-heroike, përveç forcës mobilizuese, ka edhe një

melododi mahnitëse që të rrëmben si një forcë magnetike, duke të mbërthyer në botën e heroikes dhe tragjikes, duke të sjellë në kujtesë dhembjen bashkë me krenarinë. Këngëtari kushtrimtar Hazis Ndreu, i ka kënduar edhe kryetrimin të Lumës e të Shqipërisë, luftëtarit të përkushtuar Elez Isufi, i cili “në malet e Lurës dhe të Korabit, fushën e mbushi me shapka të serbit”, ashtu siç i ka kënduar edhe heroizmit të Isuf Murrës e të trimave të tjerë dibranë.

Po ashtu Hazis Ndreu ka punuar me zell në fushën e historisë, ku ka dhënë kontribut të vyer në mbledhjen e të dhënave gojore e dokumentare për ngjarje të rëndësishme të luftërave popullore e figurative atdhetare me të cilat ka referuar në sesione shkencore e simpoziume brenda dhe jashtë vendit.

TË MËDHENJTË E LETRAVE, ARTIT E KULTURËS PËR HAZIS NDREUN

Veprimtaria krijuese e Hazis Ndreut është vlerësuar nga personalitete të shquara të letrave, të artit e kulturës.

Nëse për Dritëro Agollin, “Si Hazis Ndreu, mjeshtër i humorit dibran, sot e kësaj dite, si ai nuk gjen më, i papërsëritshëm, i papërtuar, modest dhe shpirtmirë”, për Moikom Zeqon, Hazisi është unik. Duke veçuar dy aspekte të figurës multidimensionale, që përbëjnë këtë njeri krijues unik, Zeqo ka vlerësuar veçanërisht studimin e tij për Skënderbeun, përmes toponimeve dhe gjurmimeve në zonën e Dibrës, që nuk ka qenë vetëm një shkencë e terrenit. “Për Skënderbeun ka disa studime të tipit gojëdhënor, por studimi i Hazis Ndreut është diçka e re dhe serioze, që më ka bërë shumë përshtypje. Janë studime që lidhen me veriun dhe jugun e vendit, ndaj të gjithë studiuesit duhet të marrin për bazë këtë libër dhe këtë studim të Hazis Ndreut”, është shprehur Moikom Zeqo. Ndërkohë Zeqo ka vlerësuar edhe përmbledhjen me tregime alegorike dibrane të H.Ndreut, që sjell rrëfime të popujve. “Libri Tregime alegorike dibrane nxjerr në pah mençurinë e popullit tonë përmes karakterit linear të rrëfimit. Shkruesi i librit ka dimensione të veçanta dhe trashëgimia e tij është më shumë se ai fizikisht”, ka vlerësuar Moikom Zeqo.

Hazis Ndreu ishte i veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të të

rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian.

Kolë Jakova vlerëson se “Hazis Ndreu asht ngritë mbi rapsodët aktualë të Veriut. Ai e ka nda çiftelinë dhe shkruan në frymën e Fishtës. Madje në disa konceptime epike Ai ma shumë pi ujë në Eposin e Kreshnikëve”. Po në këtë linjë e vlerëson edhe Drago Siliqi, sipas të cilit: “...Ky Hazizi i Dibrës asht me kryet tek Eposi i Kreshnikëve dhe Lahuta e Fishtës”.

Po. Tek Hazis Ndreu, – shkruan Bujar Kapexhiu, arti gërshetohet në mënyrën më brilante. Ka shkelur në të gjitha gjinitë e tij dhe ka lënë gjurmë. Jeta e pasur artistike e ka veshur me pavdekësi këngëtarin, poetin, aktorin, rapsodin, historianin dhe etnografin Hazis Ndreu.

Teksa dëgjon emrin e tij nuk ka se si të mos të kujtohen rapsoditë e bukura të zonës së veriut, që vijnë në sfond sapo ndriçohet skena. Por jo vetëm kënga, edhe vallet e mrekullueshme, poezitë dhe studimet për Skënderbeun do të mbeten gjithmonë në mendjen e shqiptarëve.

Hazisi, si kërcimtar, në shumë festivale kombëtare e ndërkombëtare, qe fitues i shumë çmimeve, sidomos në vallen dyshe dibrane me kërcimtarin e mirënjohur Besim Zekthi. Vlerat e tij si koreograf e valltar i evidenton më së miri prof.dr. Ramazan Bogdani në librin e tij ”Hazis Ndreu, Korabi i valles dyshe dibrane”. Studiuesi Agron Xhagolli, veç të tjerash, flet për Odën Dibrane si institucion dhe për burrin e saj, Hazis Ndreu. Ai ishte dhe mbetet një universitet që ua kalon shumë universiteteve me emër, për nga forca e riprodhimit të ngjarjeve, interpretimit, për nga mençuria dhe ironia e hollë, aspak fyese për mikun, por shumë favorizuese edhe për t’u formuar në të.... Këtë e pohon artistikisht edhe “Artisti i Popullit” Resha Arbana, njëherësh edhe “Nderi i Kombit”. Artisti i Popullit, Skënder Sallaku, ka pohuar meritën e padiskutueshme të Hazis Ndreut, i cili duke eksploruar në rrënojat e lashtësisë, si një historian i mirëfilltë, e futi Historinë e Dibrës në shina të sigurta për të ecur me dinjitet në fushën e madhe të Historisë sonë Kombëtare.

Shkrimtari Xhafer Martini, në librin e tij ”Hazis Ndreu – Prsonaliteti, krijimtaria”, ndër të tjera shkruan se: ”Te Hazizi vepronte si tek rrallë njerëz, teoria e kompensimit: Zoti i kishte mohuar ato që ua kishte dhënë të gjithëve, por nuk e kishte nxjerrë nga sytë: për të do të kujdesej si për të rrallët, do ta pajiste me talent dhe dhunti për shumë fusha. Një fjalë e urtë

thotë: ‘Kur të do Zoti, nuk ke nevojë për të tjerët’. Megjithatë, Hazizin e kanë dashur edhe të tjerët. Kjo është meritë e tij”.

Krijimtaria e Hazis Ndreut është vlerësuar nga kompozitori i mirënjohur Edmond Zhulali, nga Artisti i Popullit Luftar Paja, nga Behar Mera, Skënder Cala, Llesh Nikolla si dhe nga këngëtarët Arif Vladi, Lirie Rasha, Qerim Sula, Vera Laçi, Saje Poleshi...

Me botimet e tij: “Ushtima e Maleve” – libër me poezi (1961; ”Valet e Drinit te Zi” – poema dhe vjersha (1966); ”Këngë e vargje” – libër poetik (1970); ”Nje trim i Skenderbeut ne Diber” – poeme rapsodike (1972: ”Tregime alegorike dibrane” (1983 ; ”Elez Isufi – trajtresa, dokumente” – (1996; ”Kastriotet dhe skenderbeu ne trojet arbnore” (1999 ; ”Dibra ne udhen e historise – tradite, kanun, lufte histori” (2003) etj, Hazis Ndreu ka hyrë me dinjitet në fondin e artë të letërsisë shqipe.

Pikërisht për këtë kontribut madhor dhe si ikonë e artit e kulturës kombëtare duhet ta vlerësojnë Hazis Ndreun edhe autoritetet vendore të Dibrës e Kamzës, duke emëruar institucione kulturore e rrugë kryesore me emrin e tij.


Le ta kujtojmë, nderojmë e respektojmë si të tillë në 97-vjetorin e ditëlindjes së tij Hazis Ndreun, si simbolin e Odës Dibrane, gati-gati si një institucion lëvizës ndërshekullor i traditës, të cilin, shumëformësia e qasjes, ribërja letrare e evenimenteve historike, aftësia vrojtuese, kultura e begatë e shkathtësia përpunuese e lëndës së trevës së vendlindjes, me gjithë gamën përjetuese, e bëjnë të kapërcejë nga Dibra në vizionin e botës shqiptare në përgjithësi.

SKËNDER CALA, I MAGJEPSUR NGA “MAGJIA E DIBRËS”

- Si shpëtoi artisti, pas tre incidenteve që i kurdisën ish agjentët e Sigurimit të Shtetit
- Kur i doli e drejta e studimit dhe po vinte për në Tiranë, u betua se do ta rrallonte rrugën për në Dibër, sepse dega që kishte zgjedhur kërkonte punë, prova e studim. Por Dibra, sado të mundoheshë për t’iu larguar, ajo t’i ngulte kthetrat e të tërhiqte rreth vetes si magjistare. Dibra ishte si një dashuri klandestine, që vjedhurazi të pushtonte mendjen e zemrën dhe dalëngadalë të mbërthente plotësisht duke të bërë për vete

Qyteti i Peshkopisë, nga dibranët, por dhe nga të ardhurit e shumë prej rretheve të ndryshme të vendit njihet si qyteti i blirëve. Ai njihet për atë bulevardin me blirët e famshëm anash, nga ku dekada të tëra gjithë qyteti merrte frymë e jetë nga një copë udhë e asfaltuar, ku nga njëri krah në tjetrin ishin rreshtuar politika, ideologjia, burgu e dajaku, ekonomia e financat, bankat, institucionet kulturore, teatri, estrada, kinemaja, teatri i kukullave e gjimnazi...

Sot, pas më shumë se TRI dekada, njëri nga intelektualët e njohur dibranë, që ka lënë gjurmë në themelimin dhe konsolidimin e institucioneve kulturore, artisti i mirënjohur Skënder Cala, shpreh dhimbjen për bulevardin e qytetit të Peshkopisë, tashmë të lodhur që po plaket çdo ditë e më shumë...Ky rrënim ka nisur pikërisht atëhere kur dinjiteti i njeriut shtypej e poshtërohej nga qëndrimi prej bajraktarësh i pushtetarëve, që të veshur me pushtet nuk ndaleshin para



asgjëje, në emër të ligjit partiak e ideologjisë proletare. Regjisori, këngëtari dhe aktori i roleve në disa filma e teatro e ka provuar vetë trysninë e atij pushteti makabër. Pikërisht në sallën, fare pranë “Bulevardit të blirëve”, për të cilin sot ndjen dhimbje, para tre dekadash ju bë “gjqyqi në kolektiv”, sepse sigurimsat kishin sinjalizuar lart se “Skënder Cala, shikon çdo natë në televizor stacione të huaja, duke iu kundërvënë hapur vendimit të Komitetit të Partisë së rrethit për zhdukjen e antenave televizive”. Nomenklatura e asaj kohe ishte shqetësuar dhe po i bënte gjyqin në kolektiv, për të përcaktuar se çdo të bëhej me këtë njeri të pabindur që shkante kundër rrymës?!

E mbrojtjen artistin e qindra roleve të spikatura, Artisti i Merituar Haziz Ndreu, ish drejtori Adil Shehu dhe kolegu Abdyl Sturçe, mbrojtje kjo që i detyroi të dërguarit e nomenklaturës të largoheshin me bisht ndër shalë..... Kështu kishte ndodhur me Skënder Calën edhe pas debatit të tij me ish ministrin e Energjetikës Farudin Hoxha, si i deleguar në një mbledhje të Këshillit të Rrethit Dibër, kur me kurajo civile e intelektuale kishte denoncuar projektet e apartamenteve të atëherëshme, nga ngushtësia e të cilëve, qytetarët ishin të detyruar të zhvisheshin që në sallon e të kërcenin si kinezët, direkt e në krevat. Këtyre “incidenteve”, si dhe atij të korrikut '65 kur e përjashtuan për një vit nga Instituti i Arteve sepse kishte mbrojtur shokët që një të shtunë ishin larguar nga aksioni në fermën e Sukthit dhe kishin shkuar në Tiranë të laheshin e të bëheshin gati për të hënë, ai u shpëtoi falë zgjuarsisë prej dibrani të sprovuar. Ato vite ishte stërholluar lufta e klasave dhe veçanërisht shtrirja e veprimtarisë së Sigurimit të Shtetit në çdo qelizë të shoqërisë shqiptare kishte krijuar një gjendje terrori në gjithë vendin.... Këtë terror e ka përjetuar me ankth edhe S.Cala, që si artist ka interpretuar mjeshtërisht role në flimat”Guximtarët”(me partner “Artistin e Popullit” Sandër Prosi), “Kërcënimi” përkrah Rajmonda Bulkut e Stavri Shkurtit, apo dhe tek “Çeta e Vogël” ku pati rastin të ketë partnerë aktorët e mëdhenj Ndreka Luca e Marie Logoreci. Por bashkëkohësit e mbajnë mend Skënderin edhe tek filmi “Skënderbeu”, kur në moshë krejt të njomë gjendet mes dhjetra fëmijëve, grave e pleqve, i veshur me lecka si malësor i vogël, në atë mori flakësh, britmash e ulërimash prej tmerrit të turqve....

NË RRUGËN DREJT ARTIT, MES DY DASHURIVE TË MËDHA

Skënder Cala e nisi rrugën drejt artit, mes dy dashurive të mëdha, Korabit hijerëndë dhe Drinit plak që e kishte zbutur e burrrëuar, e kishte bërë më të urtë, më të mençur, siç janë Dibra dhe dibranët. Ai kujton vitet kur turrej me tersëllimë nëpër zabelet e Përroit të Madh, kur kalonte dushqe, kërcunj, lisa, kanale, prita e porene arash dhe ndjente mbi shpinë grahmën tërbuese të egërsirave. Ashtu si Qatip Cala, i cili si i lidhur me historitë e fisit, atë që dinte e hodhi në librin e tij “Në kërkim të një fisi”, edhe Skënderi kërkon që njerëzve e ngjarjeve t’u vendosë emër, që të mos mbeten anonime si mjaftë gjëra të papërsëritshme në historikun e fiseve... Për herë të parë, kur sapo kishte mbaruar klasën e tretë, fillojë të dëgjojë jaren shkodrane, ta mësojë e këndojë atë. Këngët: “Për mue paska qenë kismet”, “Pra në kjoftë kjo e vërtetë”, “Kalaja e Shkodrës”, “Dalin vajzat prej mejtepi” u futën në repertorin e tij me tekst e muzikë origjinale, që në fëmijërinë e tij, kur s’i shkonte ndërmend se do të bëhej këngëtar...Fare i ri, 15 vjeç ai do të shërbente si mësues në shkollat fillore të Reçit e Dardhës, nga ku mësoi me zell filozofinë dibrane. Kur futej nëpër zabele, këngët e bilbilave, trumcakëve e laureshave e çonin peshë shpirtërisht dhe ndjente sikur rritej orë e çast, bashkë me ritmin e tonalitetin dhe tingujt fantastikë të atyre mjeshtërve, që Zoti i kishte krijuar për të hijeshuar natyrën e për të zbutur egërsinë e jetës....E tërhiqnin veshjet e krahinës së tij që janë me larmi formash e kolorit ngjyrash, ku dhe puna artistike që është përdorur nënave, motrave, nuseve e vajzave tona, të cilat kanë derdhur në këto veshje artin e papërsëritshëm të popullit. Po ashtu mahnitej nga veshja e burrave prej koporaneve dhe tirqve të zezë, brezit të mesit me një pafundësi ngjyrash, ku e zeza, e kuqja dhe e bardha bien më në sy... nga çorapet e leshit të burrave, të thjeshtë ose me midiskame, me kolor ngjyrash dhe figurash të ndryshme me yje, lule, rrathë, trekëndësha, me vlera të veçanta artistike....

Me përshkrimin e veshjeve që përdornin malësorët e Dardhës, Skënder Cala të krijon përshtypjen se “malësori pa kësulë, tirq e koporane, pa çorape leshi e opinga me norta nuk mund të ketë ato vlera burrërore që

jemi mësuar të shohim në qënienëe të tij. Këto elementë sikur e kompletojnë atë, i japin vlera më burrërore, e bëjnë më të pranueshëm në sfondin e legjendave të maleve, bëmave dhe ngjarjeve të historisë....

Duke argumentuar institucionin e shenjtë të burrave në kryet e vendit, z Cala konkludon se “dibranët janë një specie e vecantë, sepse sido që të vijë puna, nuk e prishin shtëpinë e tyre. Të mençurit, ata që e stërhollonin fjalën, duke e përpunuar në laboratorin e inteligjencës dibrane, dinin që t’i vendosnin gjërat në vendin e tyre; vlerësonin dhe burrat që kishin me vete peshoren, metrin, dhe kunjin e mprehur në të dyja anët...”

Në këtë kontekst e rendit ai përkujdesjen e e Hazis Ndreut, porosinë e tij për kujdesin që duhej të tregonte për zërin, që ta ruante atë se e kishte pasuri që ia kishin dhuruar nëna e baba. “Mësoi këngët e Dibrës se janë flori, kanë melodi të bukur dhe tekste përrallore..Kështu i dukej Hazisi edhe muzikant, edhe poet, edhe i ditur.”

Rrugës duke shkuar për në Vilë ku ishte mësues, filloji të thurë ëndrra në mendjen e tij prej të riu. E shihte vetën nëpër skena, duke kënduar si Hozelito i vogël te filmi “Dëgjoni këngën time...” Hazisi ia kishte futur keq fitilat si Sheherezadja, që çuditi mbretin e Persisë në “Një mijë e një netë”. Ideja e Hazisit për të përvetësuar folklorin e popullit e tërhoqi shumë. Ai e dinte se dernjani sa bie prej djepi e gjer kur bëhet gati për të shkuar n’atë botë kërcen.... Ëndërronte si muzikantët më të mëdhenj të botës, si Bah, Bethoven, Verdi, Puçini, Moxarti të cilët ishin ulur këmbëkryq në shpirtin e popullit dhe kishin marrë prej tij nektarin e këngës popullore...

GJIMNAZISTI I SHKËLQYER I GJIMNAZIT TË KUADROVE TË ARSIMIT

Më pas do të ishte gjimnazi i kuadrove të arsimit në Tiranë, shkolla që e përgatiti S.Calën si mësues me njohuri e dije shkencore dhe nga ana tjetër nxori në pah dhuntinë e talentin e tij për t’u marrë veçanërisht me futbollin dhe rrethet artistike, sidomos me këngën...Me repertorin e tij muzikor u muar vetë drejtori Riza Hajro, që kishte mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik, që e njihnte muzikën ruse mjaftë mirë, këndonte me pasion dhe kishte dëshirë të interpretonte bukur.. Në një konkurs final me shkollat e kryeqytetit, Skënderi ka kënduar dy këngë “Azerbajxhani ynë”(e kënduar nga këngëtari Reshit Bejbutov) dhe “Kënga e dashurisë së parë”. Krahas

këngëve ruse repertorit të tij iu shtuan edhe këngë italiane sidomos ato napolitane. Për të ishin mjaftë të dashur këngëtarët italianë si: Domenico Modunjo, Klaudo Vila, Pepino di Kapri, Luçiano Tajoli. Por ato që e mahnisnin dhe e linin pa gjumë gjithë natën ishin këngëtarët operistikë Mario Delmanok, Henriko Karuzo dhe më vonë Luçiano Pavaroti e Plaçido Domingo. Ndërkohë filloi të magjepsej pas zërave të bukur të Llukë Kaçajt, Mentor Xhemalit, Avni Mulës, Ramiz Kovaçit, Stavri Rafaelit, Kristaq Antoniut dhe Gaqo Çakos. Gjithsesi, adoloshenca e tij, si dhe e qindra e mijëra bashkëmoshatarëve, u shtyp nga trysnia e halleve.

Më vonë, kur u burrrëua dhe mori rrugën e vërtetë të artit, duke u bërë artist i skenës si këngëtar, aktor e regjisor e ka takuar si mik të paharruar Riza Hajron, i cili për erudicionin kulturor e artistik që zotëronte, u bë drejtor i Teatrit Kombëtar dhe më vonë drejtor i Teatrit të Operas dhe Baletit...

Ditën që mbaroi gjimnazin dhe mori në dorë dëftesën e pjekurisë, ndjeu sikur një ngërç i madh i pushtoi gjithë trupin dhe ju duk vehtja si i paralizuar. Sepse ëndërronte Tiranën ndërkohë që do t'i duhej të endej nëpër malësitë e Dibrës, duke ndërruar shkollë një herë në gjashtë muaj apo një vit, për një copë bukë.. Por gjithsesi ato vite i shërbyen për të mësuar gjuhën e veçantë të dibranëve me shifra e kode, që gosite me pambuk, por therte gjer në palcë, mjeti artistik i të cilëve ishte humori që përdornin, që në esencë kishte një dramacitet e tragjizëm të thellë, që digjte e përvëlonte si zjarr.

SUKSESI I PARË SI PROFESIONIST ME SHFAQJEN “TË FALA NGA KORABI”

Duke shfletuar jetën e tij në udhën e vështirë të artit Skënderi kujton kohën kur, nga Sorica e largët ku shërbente si mësues shkon në Peshkopi si këngëtar në Estradën e qytetit, kujton repertorin e tij të parë muzikor që përbëhej nga këngët “Shkurta e Hoklit”, duetin “Kufitarët” me Muharrem Zajmin dhe këngën e “Hatixhes”. Djali i ri nga Lugejt e Zall Dardhës vokalin e kishte të pastër dhe arrinte në nota tenori, pavarësisht se ishte bariton..Të gjithëve u bëhej qejfi, por veçanërisht Hazis Ndreut që e kishte prezantuar si këngëtar dhe Tonin Rrotës, i cili si kompozitor shpresonte që me të të bënte punë të mira..Dhe këto “punë të mira” u dukën fare qartë në

turrneun më të gjatë e të suksesshëm të Estradës Profesionte të Peshkopisë, në Tiranë dhe në gjithë Shqipërinë, në maji 1961, me shfaqjen “Të fala nga Korabi”.

Në Institutin e Arteve shkoi i burrëruar, ndoshta më i pjekur se shumica e studentëve të kursit të tij..Asgjë s’i mungonte që t’i përkushtohej shkollës dhe profesionit të bukur, por të vështirë të aktorit. Fati i madh për të ishte që këtë kurs e drejtonin udhëheqësi artistik Kujtim Spahivogli dhe pedagogët Naim Frashëri, Pjetër Gjoka, Mihallaq Luarasi dhe Prokop Mima...

Kur i doli e drejta e studimit dhe po vinte për në Tiranë, u betua se do ta rrallonte rrugën për në Dibër, sepse dega që kishte zgjedhur kërkonte punë, prova e studim. Por Dibra, sado të mundoheshe për t’iu larguar, ajo t’i ngulte kthetrat e të tërhiqte rreth vetes si magjistare. Dibra ishte si një dashuri klandestine, që vjedhurazi të pushtonte mendjen e zemrën dhe dalëngadalë të mbërthente plotësisht duke të bërë për vete.

LIRI RASHA, PASAPORTA ARTISTIKE E DIBRËS

- Pesëdhjetë vjet të jetës së saj artistike, artistja e merituar Liri Rasha i ka finalizuar me koncertin recital “Kënga ime” në sallën e madhe të Pallatit të Kulturës “Dedë Ndue Lazri”, Lezhë. Artistja famoze që me zërin brilant e performacën e shkëlqyer artistike ka ngritur peshë zemrat e artdashësve në skenat e mëdha të Parisit, Berlinit, Brukselit, Zyrihut, Stambollit e Nju Jorkut, jo rastësisht zgjodhi Lezhën në këtë jubile të jetës së saj artistike.

Sepse këtu jeton një komunitet i madh artdashës, lezhjan, dibran, mirditor, shkodran etj., që e duan dhe e respektojnë Liri Rashën si pasaportën artistike të Dibrës. Dhe jo vetëm ata, por edhe i madhi këngës shqiptare Ilir Shaqiri – Nderi i Kombit dhe humoristi i mirënjohur Behar Mera – Mjeshtër i madh e partneri i tij Genc Lleshi, si edhe e bija këngëtare Ingrid Jushi, ia rritën madhështinë me interpretimet e tyre mjeshtërore, si të ftuar të saj në këtë koncert recital. Kësisoj, vetë protagonistja Liri Rasha s’kishte pse të “zhgënjehej”, kur mbi 700 artdashës nga Lezha, Dibra, Tirana e Prishtina ndoqën me interesim të veçantë koncertin e saj recital me titullin sinjifikativ “Kënga ime” në sallën moderne të këtij pallati kulture, ndër më të mirët në rang vendi, që pas investimit të kryer për rikonstruksionin e tij, është shndërruar, jo vetëm në një objekt madhor të trashëgimisë kulturore, në një shkollë edukimi e kulture, por edhe në një aksesori për turizmin dhe një brand që do të mbështesë artin, artistët dhe kulturën e lashtë të këtij qyteti.



Me koncertin recital “Kënga ime”, mbretëresha e këngës popullore dhe qytetare dibrane prezantoi biografinë e saj krijuese, jo vetëm si këngëtare

e shumëtalentuar, por edhe si kantautore, me repertorin e saj mjaftë të pasur. Në pesë dekada të jetës së saj, ajo ka formuar profilin e një artisteje profesionale, duke interpretuar fillimisht në moshën rinore me ansamblin “Kuvendi” të Zall Dardhës (në moshën 13-vjeçare), më pas në Peshkopi e deri në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës (1978), për të vijuar për 40 vjet edhe në skena të mëdha botërore, e ftuar nga diaspora shqiptare.



Kështu, Liri Rasha, e njohur si “mbretëresha” e këngës popullore e qytetare dibrane, fill pas një performace të shkëlqyer të grupit të valltarëve të Ansamblit Artistik “Hazis Ndreu” – Nderi i Kombit (që ka fituar disa çmime të para, trofe e tituj nderi në dhjetëra festivale kombëtare e ndërkombëtare), prezantohet si e tillë nga mjeshtri i moderimit Defrim Methasani – Mjeshtër i Madh dhe ngjitet në skenë mes duartrokitjeve të ardashësve të shumtë dibranë (qytetarë të Lezhës) e lezhjanë, të cilët do t’i entuziazmojë me zërin e saj brilant. Kënga e saj e parë në këtë recital është pikërisht kolazhi i përzgjedhura në “100 këngët e shekullit” (programi i mirënjohur i Pandi Laços në Tv Klan), me “Oj fusha e Korabit”, për të vijuar me “Vijnë pamporrat” të të madhit Hazis Ndreu. Me zërin e saj unik Liri Rasha interpretoi në këtë koncert recital edhe këngët: “Liqenet e Lurës”, “Amaneti”, “Nдалu shkja me m’shkel në prag”; “Na çeli prapë thana”, “Cucë dibrane”, etj., duke dëshmuar sërish se me emrin e saj është e lidhur kënga lirike e njëres nga trevat më të pasura artistike të kulturës popullore dhe folkut shqiptar. Kjo për faktin se në rrugëtimin e saj skenik, ajo asnjëherë nuk ka deformuar këngën e bukur popullore.

Kësisoj, nëse të “7 liqenet e Lurës” duket sikur sjell, jo vetëm freskinë dhe bukurinë e tyre të rrallë natyrore, por edhe jehonën e qëndresës së

lurjanëve ndaj okupatorëve të huaj, me interpretimin e vargjeve: “Ky liqeni luleve nën malet me borë, dëshmorëve të Lurës ju qëndron kurorë...”; tek “Amaneti” identifikohet si “zëri i lavdisë shekullore shqiptare”, duke përcjellë mesazhin e bashkimit. Kështu zëri i saj kumbon fuqishëm në refrenin “Ju që vini nëpër breza, vit për vit e mot për mot/ Ju bekoftë Nënë Tereza, Ju bekoftë i madhi Zot...”. Të gjitha këngët e kënduara prej saj janë bërë hite dhe kanë udhëtuar e udhëtojnë me kujtesën e njerëzve, që e duan këngëtarën e shquar dhe impresionohen nga magjia e shpirtit të saj të bukur artistik, që dallohet jo vetëm në interpretimin e lirikave dibrane, por duke u shfaqur në këtë skenë edhe si orteku i këngës epike me vargjet e këngës “Ndal shkja me m’shkel në prag/ Ti je serb e unë jam arb”.

VLERËSIMI NGA ILIR SHAQIRI

Ndërsa ka udhëtuar qindra kilometra që nga Prishtina për të respektuar ftesën e Liri Rashës që të përshëndeste në koncertin recital të saj, “Nderi i Kombit”, Ilir Shaqiri, para se të niste këngën, është shprehur se Liri Rashës i buron magji artistike tërë qenia e saj. “Liri Rasha është një zë brilant dhe interpretese e talentuar e këngës popullore e qytetare. Këngët e saj janë të veçanta në shumë segmente krijuese dhe interpretese. Ajo i përket plejadës së artistëve të mëdhenj të vendlindjes së saj Zall Dardhës, si Muharrem Xhediku e Hazis Ndreu – ‘Nderi i Kombit’, me të cilët ndjehet krenare, sepse kanë bërë historinë e këngës popullore shqiptare.

Ajo dallohet për originalitetin e këngës së saj që është tej mase i veçantë, qoftë me zërin brilant, të lindur apo të trashëguar (por edhe të kultivuar), qoftë me përzgjedhjen e këngëve, qoftë me forcën e brendshme shpirtërore, mobilizuese, që iu ka dhënë këngëve”, shprehet i madhi Ilir Shaqiri. Ndaj dhe me të drejtë në këtë event Liri Rasha shpallet “Krenaria e Ansambli Artistik ‘Hazis Ndreu’- Nderi i Kombit” nga Presidenti i këtij ansambli Muharrem Gjoka – Mjeshtër i Madh dhe “Qytetar Nderi” i Qarkut Dibër. “Udhëtimi drejt këngës së këngëtares së mirënjohur dibrane Lirie Rasha është një udhëtim drejt një magjie, surprizimi dhe mrekullimi, që sa më shumë të shtyresh në morinë e tingujve dhe trajtave të saj, aq më shumë ndihesh i pushtuar nga magjia e një arti muzikor elitar. Me emrin e këngëtares së shquar dibrane Lirie Rasha është e lidhur kënga lirike e njëjës nga trevat më të pasura artistike të kulturës popullore dhe folkut

shqiptar. Fuqia e mesazhit të saj, tonaliteti i spikatur lirik, ëmbëlsia dhe finesa e një zëri unik, magjia e një interpretimi të thjeshtë dhe komunikues gjer në detajet më të imëta, e bëjnë atë një këngëtare të preferuar jo vetëm në trevat e Dibrës dhe të veriut, por në gjithë Shqipërinë, në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në gjithë hapësirat etnike shqiptare, si dhe në diasporën e vjetër dhe të re”, – shprehet Muharrem Gjoka, i cili nuk e fsheh krenarinë si nip i familjes Rasha të Zall Dardhës.

KONCERTI RECITAL “KËNGA IME”

Edhe në këtë koncert recital ajo erdhi si përvetësuese dhe interpretuese e denjë e këngës popullore e qytetare dibrane, që padyshim është faktori bazë i formimit të saj artistik. Ndaj dhe ministri i Drejtësisë Ulsi Manja, në përshëndetjen e tij në këtë koncert, nuk nguron ta cilësojë Liri Rashën si pasaportën artistike të Dibrës. “Liri Rasha, ‘Artiste e Merituar’ dhe ‘Mjeshtre e Madhe’, e ngriti peshë pallatin e kulturës në Lezhë! Si artiste, Liri Rasha është pasaporta artistike e Dibrës në trojet shqiptare dhe kudo ku shqiptarët flasin gjuhën tonë të bukur shqipe anembanë botës! Liria, sonte zgjodhi Lezhën si simbol i bashkimit të shqiptarëve, për të festuar mes miqve të saj të shumtë nga Shqipëria, Kosova dhe diaspora, në 50 – vjetorin e ngjitjes së saj në skenë”,-tha ndër të tjera Ministri Manja, ndërsa i shprehu një mirënjohje të veçantë kryebashkiakut të Lezhës Pjerin Ndreu, i cili e ka bërë Lezhën nyje të rëndësishme të kulturës dhe artit mbarëshqiptar.

Ndërsa vetë Pjerini falënderoi elitën e artisteve që shkeli natën e 30 prillit 2024 në skenën e bukur moderne lezhjanë dhe publikun aq të ngrohtë që mirëpriti recitalin e të madhes Liri Rasha. Në këtë event të veçantë kulturor, të ideuar dhe moderuar mjeshtërisht nga ikona e skenës dhe ekranit Defrim Methasani, artisti shqiptar me famë botërore Ilir Shaqiri, i ftuar, nga mikja e tij Liri Rasha, e flakëroi sallën moderne të pallatit të kulturës ” Dedë Ndue Lazri” të Lezhës, kur zëri i tij vetëtimë ushtoi me vargjet e këngës: “Poçari – Sërish vjen pranvera”.

Kjo këngë, vargjet e saj mbresëlënëse të interpretuara aq mjeshtërisht nga një zë kumbues si i Ilir Shaqirit ndez në zemrat e çdo shqiptari ndjenjën e madhe të shqiptarizms. Kështu ndodhi edhe me Liri Rashën, e dekoruar jo vetëm me titullin “Mjeshtër i Madh”, por edhe “Kalorës i

Urdhrit të Skënderbeut”, teksa interpretoi këngën e bashkimit, vargjet e së cilës: “O shqiptar kudo ku jeni/ Njëri tjetrin mos urreni / Mos e lini mollën t’thahet/, mos e lini gurin t’çahet.../ se ma shumë vlen shqiptaria”, janë jo vetëm mesazh, por edhe sintezë e qëndresës shumëshekullore të shqiptarëve në luftërat legjendare ndaj pushtuesve serbë. Të kombinuara aq bukur, nënë e bijë, Liri Rasha e Ingrid Jushi mirëpritën nga spektatori në këtë koncert , jo vetëm në potpuritë dibrane, por edhe kur zëri i tyre tingëllon ëmbëlsisht në vargjet e këngëve qytetare “Nga sevdaja jote moj Xhemile”, “Ç’ është më e bukura në këtë botë/, ftyra e gocës hënë e plotë...” etj., etj..

Ndërsa më të larmishëm e bëjnë këtë spektakël madhështor edhe humoristët e mirënjohur Behar Mera – Mjeshtër i Madh dhe Genc Lleshi, me interpretimin mjeshtëror të grimcave humoristike “Alo policia e shtetit...një ore e gjys që gruaja s’ka ardh n’shpej.... S’ kam hallin e grus por vdiqa për bukë...”; “N’ klas t’pestë tuj pi cigare” etj. Zëri brilant i Liri Rashës që ka ngritur peshë plaketë e shumë vendeve të botës, kudo ku ka emigrantë shqiptarë, në të katër anët e globit, kumboi fuqishëm edhe në këtë skenë të Pallatit të Kulturës Lezhë. Një këngëtare e veçantë e traditës së këngës popullore dibrane e asaj qytetare, si edhe vetë emri që mbart, edhe në këtë natë të 30 prillit 2024 qe impresionuese për publikun me këngët e saj, e lirë, e ëmbël, duke ruajtur me fanatizëm traditën, por duke hedhur dhe sytë drejt së resë në këngën e mirëfilltë popullore shqiptare. Gëzimi i saj më i madh, vajza e saj, Ingrid Jushi shfaqet në këtë koncert si një këngëtare e afirmuar me po atë dinamizëm, elegancë dhe përkushtim në rrugën e nënës, duke lënë hapur shtigjet e fluturimit brenda familjes në këtë profesion kaq të brishtë, por edhe të bukur dhe magjik. Ndaj dhe me të drejtë në këtë event Liri Rasha shpallet “Krenaria e Ansambilit Artistik ‘Hazis Ndreu’- Nderi i Kombit” nga Presidenti i këtij ansambli Muharrem Gjoka – Mjeshtër i Madh dhe “Qytetar Nderi i Qarkut Dibër”. Ndërsa Elmaz Lala, ish- Shef i Seksionit të Arsimit e Kulturës Dibër, që si qindra të tjerë përfaqësues të elitës dibrane (Nderi i Kombit Bujar Kapexhiu, prefekti i Dibrës Nexhbedin Shehu, Prof. asoc. dr. Shpëtim Cami, Prof. asoc. Dr. Nazmi Koçi, Prof. dr. Sali Kurti – Mjeshtër i Madh dhe “Qytetar Nderi” i Matit, Avni H.Ndreu-Mjeshtër i Madh, Musa Riçku, Hasie Riçku (Deva), Latif Miha, Irfan Zebi, Demir Rusi, Baftjar Çera, Mimoza Reçi

(Shehu), Mimoza Truka, Xharie Lala etj.) do të shprehej se “Liri Rasha është unike në vokalin e saj, me atë zërin e ëmbël, melodioz, me timbër të jashtëzakonshëm, me koloritin më të qartë të këngës dibrane dhe me finesën në interpretim duke ndërtuar kështu një personalitet artistik të paarritshëm. Pa diskutim që ajo është maja artistike e Dibrës dhe krenari kombëtare që me zërin e saj brilant ka tronditur edhe skenat botërore.

Liri Rasha është vlerësuar me çmime, medalje, mirënjohje e tituj të lartë, si Artiste e Merituar, Mjeshtre e Madhe, Qytetare Nderi e Peshkopisë dhe Nderi i Qarkut të Dibrës. Nuk di çfarë arritjesh duhet të ketë tjetër një artist që të meritojë trajtimin me “pension të posaçëm” nga shteti i vet?! Do ishte në nderin e Kryeministrit Rama dhe Qeverisë ta vlerësonin trajtimin e saj se jam i sigurt që edhe me referendum lokal në Dibër dhe në shkallë vendi po të shtrohej, nuk besoj se do ish dikush kundër. Për gjithë kënaqësitë artistike që i ke dhënë këtij vendi për 50 vjet, paç jetën e gjatë, Liri Rasha!”

BIOGRAFIA KRIJUESE

Liri Rasha – Jushi është një këngëtare e mirënjohur, e lindur në një familje me tradita dhe talent muzikor. Shkollën fillore e ka kryer në fshatin e saj, Lashkizë, ndërsa të mesmen në Peshkopi. Ka mbaruar specializimin për kanto dhe shkollën pedagogjike. Talenti i saj është zbuluar krejt rastësisht, kur ishte vetëm 13 vjeç, të cilën e “hetoj” mësuesi i saj i matematikës një ditë teksa ajo këndonte në shtëpinë e saj. Më pas u shfaq si dritë shkëlqimtare në skenën e Shtëpisë së Kulturës “Haki Stërmilli” Peshkopi dhe si profesioniste me Estradën Profesioniste të këtij qyteti, ku vijoi për afro dy dekada, që nga viti 1973. Në Festivalin e Gjirokastrës të vitit 1978 ka kënduar këngën “Oj syzeza vetullhollë”. Pas disa vitesh karrierë në skenë, rreth viteve të ’80, ka edituar një album me titull “Këngë të zgjedhura nga Liri Rasha”, dhe një album tjetër në vitin 2001, me titull “Nusja me të bardha”.


Ajo, në vitin 1988 ka marrë titullin “Artiste e Merituar” dhe në vitin 2013 dekorohet me titullin “Mjeshtër i Madh” nga ish Presidenti Bamir Topi: (ndërsa është dekoruar nga ishPresidenti i Republikës Ilir Meta dhe me titullin “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”) Lirija njihet edhe për talentin e saj krijues, ndaj dhjetëra këngë të saja, tekstin e kanë të shkruar nga vetë

ajo, siç kemi: “Nusja me të bardha”, “Oj zogo”, “Oj syzeza vetullhollë”, “Cucë dibrane”, etj. Ka marrë pjesë me disa kolazhe në “Këngët e Shekullit”. Ajo ka dy fëmijë: një vajzë e një djalë. Vajza e saj, Ingrid Jushi, ka talent për të kënduar këngën popullore dhe bashkë me të Lirien kanë punuar disa kolazhe. Ajo me familje aktualisht jeton dhe vepron në Tiranë, ku mban koncerte e manifestime të ndryshme familjare. Më datë 20 Mars 2018, Liri Rasha & Blerina Braka publikojnë videoklipin “Le Te Tundet Vendi”. Më datë 24 Prill 2023, Liri Rasha publikon videoklipin “Nдалu Shkja Me M’shkel Ne Prag”. Muzika dhe orkestrimi i këngës janë shkruar nga Naim Gjoshi.

Videoklipi u prodhuan nga kompania “Domi Production”. Më datë 28 prill 2023, Liri Rasha & Hysni Hoxha publikojnë videoklipin “Labinot, Si Ti S’ka Tjetër”. Muzika e këngës është kompozuar nga vetë Hysni Hoxha, ndërsa orkestrimin e përgatiti Luan Dagistani. Videoklipi u prodhuan nga kompania “Domi Production”. Më datë 7 qershor 2023, Liri Rasha publikon videoklipin “Shqiptari Ja Sot Ja Kurrë”. Muzika dhe orkestrimi i këngës janë shkruar nga Naim Gjoshi. Videoklipi u prodhuan nga kompania ‘Domi Production’. Më datë 1 Tetor 2023, Liri Rasha publikon videoklipin “Cuc Dibrane”.

Kënga u orkestrua nga Alfred Qemalja. Videoklipi u prodhuan nga kompania ‘Domi Production’. Më datë 7 shkurt 2024, Liri Rasha publikon videoklipin “Loti I Vetmisë”. Muzika dhe teksti i këngës janë punuar nga vetë Liri Rasha, teksa për arranzhimin u kujdes Alfred Qemalja. Videoklipi u prodhuan nga kompania ‘Domi Production’. 50-vjetorin e jetës së saj artistike Liri Rasha e finalizoi në Lezhë me koncertin recital “Kënga ime”, që u ndoq me interesim të veçantë nga më shumë se 700 artdashës dibranë, lezhjanë, mirditorë e shkodranë.

PËR POETIN E KËNGËS, NAIM PLAKU



Katër dekada pas ndarjes nga jeta të autorit të poemës së famshme “Bagëti e Bujqësi”, lindi një tjetër poet i talentuar, me të njejtin emër. Jo në Frashër të Përmetit, por në Sllatinë të Dibrës.

“Data shënonte 14 nëntor 1940. I jati, Shemsiu ishte në punë e vonë, kur u kthye, e mori vesh se ishte shtuar me një djalë....Emri Naim ishte emër i librave. Nxënësit e shkollave, ato që kishin pak klasë, e njihnin këtë emër. Ishte Naim Frashëri i Rilindjes sonë Kombëtare. Nxënësit e mësonion nëpër shkolla e të rriturit e kishin lexuar. Edhe në shkollën e Slllovës kishin mësuar e recituar poezitë e tij. Shemsiu pothuaj i kishte lexuar të gjitha poezitë e tij të botuara. Djalit që lindi këtë natë nëntori, ia lanë emrin naim. ‘E gëzoftë! – u dëguan urimet nëpër kullën që ishte mësuar të priste e të përcillte miq të shumtë, të ftuar e rrugëtarë të ndryshëm...”.

E nisëm me këtë perifraksim të autorit të librit “Dritëhijet e një poeti”, të shkrimtarit të njohur Shaqir Skarra, për të bërë një analogji të dy Naimëve, poetë, që ngjasojnë shumë në jetët dhe veprat e tyre.

Nëse rilindasi i shquar rridhte nga dega e Dakollarëve ose e Dulellarëve e Familjes së shquar Frashëri, edhe Naim Plaku, ishte pinjoll i një fisi emërndritur në Sllatinë, nipi i “gjeneralit me shajak” Elez Isufi. Nëse Naim

Frashëri u shqua për lirikën e tij patriotike me temë aktuale (vjershat “Gjuha shqipe”, “Korçës” 1887, etj.), u këndoi me pasion të rrallë mallit dhe bukurive të atdheut (“Bagëti e bujqësia”) dhe bëri thirrje të fuqishme për çlirimin e tij (krijime të ndryshme, “Dëshira e vërtetë e shqiptarëve”), në shekullin që lamë pas, vepra e Naim Plakut, është një testament fjale.

Dhe siç shprehet autori në monografinë “Dritëhijet e një poeti”, Naim Plaku, që e konsideronte poezinë si një “zanë mali, por kryeneçe”, me mjeshtri të rrallë e ledhatoji, e përkëdheli dhe pastaj u dashura pas saj. U dashurua me poezinë që në fëmijërinë e tij, kur qau për “dhinë pikaloshë që ia hëngri ujku” dhe për “mushkën, që ia hodhi ngarkesën të gjithën në tokë, ngaqë nuk e kishte ngarkuar mirë”. Janë këto detaje nga fëmijëria e një nxënësi që shkëlqente në të gjitha lëndët, në gjuhë e lexim, në aritmetikë e gjeometri, në histori e gjeografi, në kimi e biologji...Ngaqë mbante sy e vesh te shpjegimi, si rrallë nxënës, por edhe ngaqë tek kulloste bagëtinë apo dhe kur shkonte për dru në mal, me vehte kishte edhe trajstën me libra. I tillë do të ishte ai edhe në fidanishten e mësuesisë, siç njihej Shkolla e mesme Pedagogjike e Peshkopisë, për përfundimin e së cilës, babait të tij, Shemsi Plakut, iu desh të shesë pothuaj të gjithë bagëtitë. Por edhe në Universitet, tek do të përballej e triumfonte me pedagogun e sintaksës që “dhjetën” e konsideronte pronë të veten. Ishte pikërisht N.Plaku, ndër studentët e paktë që me zotësinë e talentin e tij të rrallë e theu këtë tabu të pedagogut zemërngurtë, ashtu siç sfidoi në vitet e dekadat e jetës së tij të gjithë nihilistët e mediokrit që i shërbyen me zell sistemit të diktaturës.

Këto e të tjera detaje jetësore për këtë poet të këngës, e bëjnë më të dashur për lexuesin këtë vepër dinjitoze të publicistit, studjuesit dhe analistit tashmë të njohur, Shaqir Skarra. Me mjeshtri të rrallë ai ka ditur të “shfrytëzojë” arkivën e pasur që la si trashëgimi, poeti i këngës, Naim Plaku. Nuk është rastësi që nga kritika letrare, emri i Naim Plakut si poet kënge, radhitet përkrah Gjokë Becit e Lefter Çipës. Këtë, përveçse autorit të monografisë “Dritëhijet e një poeti”, e pohojnë edhe emra të spikatur të letrave shqipe, që e kanë studjuar hollësisht veprën e Naim Plakut. Kjo edhe për faktin se tekstet e Naim Plakut janë lënda e parë e standardit më të lartë për këngëtarët e mirënjohur Arif Vladi, Shkurte Fejza, Haxhi Maqellara, Skënder Cala, Liri Rasha, Qerim Sula, Ilir Shaqiri, Selami Kolonja, Caje Poleshi, Sherif Dervishi, Vera Laçi, Dritan Jashari etj. Mjafton të kujtojmë

se si janë ngritur peshë zemrat e mijëra artdashësve, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në skenat më presitigjioze të botës, kur kanë përjetuar zërin e tyre melodioz në interpretimin e teksteve të këngëve të N.Plakut: “O prite Azem Galicën”, “Një gërshet u la me gjak”, “Na knojnë pushkët nëpër kulla”, “O i madhi Skënderbe”, “Përcolla ylberin”, “Mine mori Mine”, “Tinguj krenarie”, “Fluturo shqipe ka kalaja”, etj.

“Naimi u bë gjuhëtar, punoi shumë për të, mblodhi fjalë të rralla jo vetëm të krahinës, por edhe jashtë saj...Naimi truppakët, çapitej nga Fushë Alia në Shumbat, nga Cereni në Sllovë e nga Sllova në Gollobordë...Ai çliroi shpirtin, duke tjerre zgjuarsinë me fjalët e botës së dijes që mblodhi jo vetëm nga gjuha e mësuar e shkollës, por edhe në odat e kullat dibrane dhe nga valët e fjalës së Drinit e oshëtima e Korabit, duke i shikuar këto nga shpirti i lirisë...Pas mësimit, gjatë udhëtimeve do të nxirrte bllokun e do të shkruante toponime e mikrotoponime. Për to pyeste qoftë dhe një çoban që ishte me bagëti...Gjeti ninullat e bukura të djepit e shprehjet frazeologjike, të përdorura aq bukur në këto anë. Përpara se ta hidhte në bllok, këngë qoftë apo shprehje gjuhësore, kërkonte burimin. Kështu ai ra në gjurmë të ciklit të këngëve të Korabit, mblodhi këngën e Ymer Agë Ulqinit, “Motra me nantë vllazën”, “Balada e Rexhës” e dhjetra të tjera...I mori këto këngë nga goja e popullit, ua hoqi pluhurin dhe i bëri pronë të të gjithëve për të mbetur visare të folklorit shqiptar”. Mjaftojnë qoftë edhe këto perifrazime të shkëputa nga faqe të ndryshme të veprës së Sh.Skarrës “Dritëhijet e një poeti”, për të konkluduar në punën e mirëfilltë studimore e shkencore që ai ka bërë për të na e sjellë në mënyrë sa më origjinale madhështinë e profilit krijues e njerëzor të Naim Plakut.

Poeti që përjetoi skajshmërisht përndjekje, ishte vërtetë një poet i përmasave të spikatura. Në monografinë e botuar nga Shtëpia Botuese e mirënjohur tashmë M&B, evidentohen qartazi variacionet poetike në formë mozaiku brenda konstruktit poetik të poezive të tij që shkrihen në kodet nëntekstuale, të shartesave të kumteve dhe përcjelljeve të folkut. Kjo edhe për faktin se në poezinë e tij, Naim Plaku i ngre një kult botës dibrane, nderit, dinjitetit, virtytit, arketipit social, etik dhe filozofik të dibranit që motivohet nga zgjuarsia, maturaia, etj. Këto, më së miri i gjejmë në veprat poetike të N.Plakut “Fllad e frullizë”, “Kreshtat e Korabit” dhe “Trëndafila mbi mermer”. Por vitet e fundit botimet e tij po lexohen e po pëlqehen nga

publiku, sidomos “Krojet e zanave” e “Folklor nga viset e Dibrës”.

Qoftë edhe me një vështrim sporadik të veprës “Dritëhijet e një poeti”, lexuesi do të mrekullohej me “rrëfimet nga ditari”, të cilat autori Sh.Skarra ka patur fatin t’i ketë në dorë dhe prej tyre të përveçojë nektarin e veprës shumëdimensionale të Naim Plakut. Dhe jo vetëm kaq, por shkrimtari e studjuesi Skarra, sjell risi në “Raportet e Naimit me veprën”, duke i parë ato në një kontekst të gjerë, në fushën e gjuhësisë e letërsisë, por edhe duke na e paraqitur Naim Plakun si një figurë të shquar të folkloristikës tonë, si skenarist dhe libretist.

Dhe në vlerësimin e veprës së N.Plakut, autori i monografisë “Dritëhijet e një poeti”, nuk ndalet vetëm tek mendimi i tij analitik, mjaftë i vlefshëm, por sjell referenca të çmuara nga bashkëkohës të mirënjohur. Kështu, Prof. Dr.Shaban Sinani, përveç shumë punëve të bukura në krijimtari, veçon atë çfarë Naim Plaku i ka kushtuar traditës gojore të popullit të Dibrës, traditës etnozakonore dibrane, studimeve me karakter historiografik dhe etnologjik, krijimtarinë letrare në përgjithësi, sidomos poezinë e tij. Ndërsa Ali Ahmeti, sjell në kujtesë këngët e mrekullueshme që këndonin Arif Vladi, Liri Rasha, Qerim Sula dhe të tjerë këngëtarë, që atij dhe shokëve të tij, kur luftonin për të drejtat e popullit shqiptar, u jepnin zemër dhe i hidhte në flakën e betejave. Por, lideri i mirënjohur historik i shqiptarëve të Maqedonisë pohon se në atë kohë nuk e dinte që tekstet e tyre aq të fuqishme i kishte bërë Naim Plaku.

Dhe nëse për Shkurte Fejzën, poezia e N.Plakut ka shpirt dhe i jep motiv kompozitorit, që të kompozojë, por edhe këngëtarin e frymëzon për të kënduar me shpirt, për Dr.Fejzulla Gjabri, që është edhe redaktori i librit, “Në vëllimet e Naimit ka frymëzim vendlindor, dibran dhe gjithëshqiptar. Aty është lashtësia, aty burojnë mesazhet, aty ngrenë krye hulumtimet....”.

QERIM SULA, ZËRI I LAVDISË SHEKULLORE, IKONË E KËNGËS DIBRANE

- Sa më shumë largohen vitet e ikjes në botën e përtejme, aq më madhështore na vjen në memorie jeta dhe vepra e artistit me përmasa mbarëkombëtare, Qerim Sula.



Për këtë do të mjaftonte vetëm kënga kushtrimore “Na k’ndojnë pushkët nëpër kulla”, që grupe artistike, ansamble e këngëtarë të njohur, jo vetëm dibranë, por edhe kosovarë, çamë etj., e kanë bërë lajtmotivin e koncerteve të tyre. Dhe jo vetëm në koncerte, por edhe në dasma e promovime librash. Është kjo këngë epike, që megjithëse huazohet, askush s’e këndon si Qerim Sula, që e ka veshur atë me pavdekësi.

Nuk është rastësi që mjeshtri i moderimit të veprimtarive kulturore artistike, si dhe i dhjetëra e dhjetëra dasmave, miku i tij (dhe i yni) i ngushtë, Defrim Methasani, ta ketë pjesë të skenarit, improvizimin e odës dibrane, ku rreth sofrës së mbuluar me flamurin kombëtar fton të ulen burrat për të performuar qarkullimin e kutive të duhanit dhe ngrehjen e hutave,

ndërsa në sfond shfaqet gjiganti Qerim Sula me këngën “Na k’ndojnë pushkët nëpër kulla”. Madje është kjo këngë, si i gjithë repertori i tij që na e la si testament në dy albume, që i ka motivuar studiuesit e folklorit dhe gazetarët e kulturës të gazetarëve e televizioneve të ndryshme, për ta pagëzuar Qerimin Sulën si: “Zëri i lavdisë shekullore dibrane”, “Mjeshtri i Madh i këngës dibrane” dhe “ikonë e këngës dibrane”. Qerim Sula lindi, u rrit dhe u burrërua me këngën që përcillte jehonën e luftërave të dibranëve për liri e pavarësi kombëtare.

Ndërkohë s’i ndahej punës në profesionin e tij të nderuar të shoferit, fillimisht në ishkooperativën Bujqësore Zall Dardhë e Ndërmarrjen Elektrike Peshkopi dhe pasi mori patentën e klasit të dytë e të parë, në Parkun Automobilistik të Mallrave Peshkopi deri në vitin 1983. Më pas, deri në vitin 1991, ai do të ishte pjesë aktive e trupës të estradës profesioniste të Peshkopisë, duke e nderuar atë me interpretimin mjeshtëror të këngës popullore e qytetare dibrane në të gjitha shfaqjet e saj, brenda e jashtë rrethit të Dibrës.

KUSH ISHTE QERIM SULA

Qerim Sula lindi në 12 prill 1951 në Zall-Dardhë të Dibrës, në këtë krahinë që njihet si djep i artit dhe kulturës. Këtu mori formimin bazë, duke kryer shkëlqyer 8- vjeçaren, për ta vazhduar të mesmen në shkollën mekanike të Peshkopisë. Kushëriri i tij nga nëna, Muharrem Gjoka, Mjeshtër i Madh dhe Presidenti i Ansambilit Artistik “Hazis Ndreu” – “Nderi i Kombit”, tregon se që në moshën 12 vjeç, Qerim Sula ka performuar suksesshëm me këngën folklorike dibrane në skenën e Shtëpisë së Kulturës Zall-Dardhë për të vijuar ndër vite dhe në skena të tjera, në Peshkopi e rrethe të ndryshme të vendit. “Në gjurmët e artistëve më në zë të Dardhës, Muharrem Xhediku e Hazis Ndreu, Qerim Sula, si askush tjetër, me talent të rrallë arriti të përvetësojë dhe interpretojë mjeshtërisht folklorin dibrane e atë mbarëkombëtar, mbështetur në rrënjët popullore e kombëtare. Madje, përvetësimi dhe interpretimi me ndjenjë i këngës epike dibrane do të ishte faktori bazë i formimit të tij artistik”, pohon Muharrem Gjoka.

Edhe pse kishte mbaruar shkollën mekanike, Ai ishte i dashuruar dhe i përkushtuar për këngën, ndaj që në moshë të re u aktivizua me grupet amatore të Zall Dardhës, ndërsa në vitin 1967 me ansamblin “Dibra”. Një

vit më pas, më 1968 bën prezantimin e parë në Festivalin e Parë Folklorik të Gjirokastrës me këngën e Hazis Ndreut, “Kënga e Lam Dacit”, ku u vlerësua me çmim të parë për interpretimin e tij.

Ka marrë pjesë në të gjitha Festalet Folklorike deri në vitin 2000. Kështu ai do të evidentohej si këngëtar me talent të rrallë, talent që do ta shfaqte, jo vetëm në skenën e Shtëpisë së Kulturës “Haki Stërmilli” dhe të Estradës Profesioniste Peshkopi, por veçanërisht në skenën e Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, si edhe në finalen e tij përpara udhëheqësve partiakë e shtetërorë të kohës në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Ai është aktivizuar në mjaft trupa e ansamble, si dhe ka qenë pjesëtar i Estradës Profesioniste të Peshkopisë. Ka kënduar në shumë skena të vendit por edhe jashtë shtetit, si në Gjermani, Austri, Turqi, Belgjikë, etj. Ka punuar me shumë artistë, por mund të veçojmë Liri Rashën, me të cilën ka qenë në Estradën profesioniste të Peshkopisë, me Arif Vladin një artist i kompletuar, Vera Laçi një këngëtare shumë me vlerë, me Sherif Dervishin, me të madhin Haziz Ndreu, i cili ishte profesori i tyre.

Në vitin 1981 ishte në Kosovë me ansamblin “Kuksi i ri”. Në repertorin e tij ka një numër të madh këngësh epike, duke qenë nga këngëtarët më të suksesshëm të trevës së Veriut, i vlerësuar me mjaft çmime e diploma të ndryshme, në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare. Ka realizuar dy albume me këngët më voluminoze dibrane, mjaftë të preferuara nga artdashësit, jo vetëm në Dibër e Tiranë, por kudo në hapësirën mbarëshqiptare në botë. Qerim Sula ishte dhe një bashkëshort e prind shembullor. Nga martesë me Razijen, një vajzë shembullore e familjes emërndritur Kaca nga fshati Tartaj i Zall Dardhës, krijuan një familje solide që nderohej e respektohej jo vetëm në Dardhë e Peshkopi, por edhe në Tiranë, ku jetuan familjarisht dy dekadat e fundit.

PËRBALLJA ME SËMUNDJEN! AI E DONTE DHE E DASHURONTE JETËN...

Artisti i madh dibran Qerim Sula, në vitin 2017 preket nga një sëmundje e rëndë. Në këto kushte, më 4 shkurt 2017, pasi kishte kaluar atak kardiak shtrohet në pavijonin e kardiologjisë të Spitalit “Nënë Tereza” në Tiranë. Dhjetë ditë pas shtrimit, do të operohej nga kardiokirurgu Edvin Prifti, por pa sukses. Po përballonte kështu me stërmundim sëmundjen dhe vetëm pas

disa ditë ekzaminimesh (duke nxjerrë edhe ujë), në Sanatoriumin e Saukut, herën e fundit, këtu mjekët konstatuan se vuante nga mosfunksionimi i rregullt i valvulës së zemrës. Më 9 mars 2017, shtrohet në spitalin gjerman në Tiranë. Pas disa ditësh pëson vdekje klinike e në këto kushte i nënshtrohet sërish operacionit që zgjati 8 orë. Këtu, duhet përmendur përkujdesja shembullore dhe profesionalizmi i spikatur i kardiokirurgut të talentuar Selman Dumani. Megjithë përkujdesjen shembullore të bashkëshortes së tij, Razies, të djalit, Aleksit, e vajzës, Greta, si dhe të kushërinjve Muharrem e Lazam Gjoka (ky i fundit mjek në profesion) e të miqve të ngushtë Latif Miha e Defrim Methasani, jo në një e dy ditë, një e dy jave, por plot tre vjet, artisti i përmasave mbarëkombëtare Qerim Sula, nuk mundi t’u shpëtojë thonjve të vdekjes. Në këtë rast, mirënjohja si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, i takon Latif Mihës, i cili me punë, vizion, ndershmëri e përkushtim të rrallë, ndërsa ka arritur të jetë ndër sipërmarrësit më të suksesshëm na rang vendi, ka shfaqur me tërë fuqinë e mendjes, të zemrës e të shpirtit dimensionin e tij të rrallë human e njerëzor. Sikur ta kishte vëlla, dhe jo shok, mik e komshi, Latifi e ndoqi hap pas hapi artistin shumëdimensional Qerim Sula në të gjitha etapat e sëmundjes, duke i qëndruar pranë në ekzaminime e spitale e deri në organizimin e ceremonisë së lamtumirës.

NJË LAMTUMIRË JO E ZAKONTË

Qerim Sula mbylli sytë pas një beteje me një sëmundje të rëndë, sprovë që nuk e kaloi dot, më 31 maj 2020, pikërisht kur sëmundja globale Covid – 19 do të pamundësonte ardhjen nga Amerika të djalit dhe vajzës së tij në ceremoninë e lamtumirës. Dhe më e rëndë situata, kur edhe bashkëshortja Razia, vëllai Fasliu e motra e tij, Milita, ishin prekur dhe po vuanin në gjendje tejet të rënduar nga Covid -19.

“Mëngjes shumë i trishtë ky i 31 majit. Kemi humbur një aset të kulturës dibrane dhe shqiptare, një vlerë të artit dhe ortekun e këngës. Qerim Sula nuk e fitoi dot betejën me jetën, por do të mbetet në jetë të jetëve. Iku pa i mbushur 70 vjeç, duke lënë pas emrin dhe veprën e madhe. U prehsh në paqe Mjeshtër i Madh!”, do të shkruante atë ditë Defrim Methasani në faqen e tij në “Facebook”. Dhe jo vetëm Defrimi, por edhe personalitete të politikës, artit e kulturës dhe të botës akademike do të shprehnin

ngushëllime për këtë humbje të madhe, duke e konsideruar në zi artin dhe kulturën tonë kombëtare.

Njëri prej tyre, Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka ngushëlluar me këtë rast familjarët, miqtë dhe komunitetin artistik duke thënë se këngët epike të Qerim Sulës kanë lënë gjurmë të pashlyera dhe frymëzim për brezat. “Na paska lënë këngëtari i njohur dibran, “Mjeshtri i Madh” Qerim Sula. Ai, përmes këngëve epike, transmetoi vlera atdhetare dhe kombëtare, të cilat mbeten gjurmë të pashlyera dhe frymëzim për brezat. Ngushëllime familjes, miqve dhe komunitetit artistik”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Po. Ishte shuar një zë burror që vinte si një jehonë drithëruese duke shkundur e mbajtur gjallë shpirtin e pamposhtur me piskamën e fortë të maleve të Dibrës për liri. Por amanetin s’e tret dheu.

Ai u kishte shprehur njerëzve të familjes dhe miqve të tij më të ngushtë dëshirën për ta varrosur në vendlindjen e tij, në Zall Dardhë. Ndaj kushërinjtë Muharrem e Lazam Gjoka, Latif Miha e Defrim Methasani dhe nusja e djalit, Vera, do ta përmbushnin besnikërisht këtë amanet, kur edhe në kushtet e izolimit total prej kolerës covid-19, do të udhëtonin me arkivolin e tij nga Tirana për në Zall Dardhë, ku edhe ato kushte do të organizonin një ceremoni mortore dinjitoze të artistit të madh dibran, këngëtar i këngëve epike në vend, zëri dhe kontributi i të cilit në muzikë do të mbahen mend ndër breza. Zëri dhe kënga e tij do ta mbajnë gjallë të madhin Qerim Sula. Kënga e veshi atë me pavdekësi. Dhe jo vetëm kënga e tij.

Artistët më në zë të Dibrës, Arif Vladi e Shaban Mziu, do t’i thurnin këngë mikut të tyre, artistit që ish-Presidenti Bamir Topi do ta vlerësonte me titullin “Mjeshtër i Madh”, ndërsa ish-Presidenti Meta, me dekret nr.11715, date 17.09.2020, do ta dekoronte Qerim Sulën me titullin “KALORËS I URDHËRIT TË SKENDERBEUT” me motivacionin: “Për kontributin e shquar në artin e kulturën popullore shqiptare, si dhe talentin mjeshtëror në interpretimin e këngëve të përpunuara, atyre folklorike, veçanërisht motiveve të trevës së Dibrës”. Me këngën e tij, Qerim Sula u ka lënë gjurmë folklorike brezave. Ai ka përcjellë dhe përcjell nëpërmjet këngës imazhe trimërore që ndikojnë për edukimin atdhetar të brezave në vijimësi.

MUHARREM GJOKA, PROMOVUES I VLERAVE ETNOKULTURORE DHE ATYRE TË LANÇ

Muharrem Mehdi Gjoka është ndoshta nga të rrallët që për vlerat e tij unikale si mishërues dhe përçues i mençurisë dhe urtësisë dibrane, është vlerësuar me titujt “Mjeshtër i Madh” nga Presidenti i Republikës, “Qyetar Nderi i Qarkut Dibër” nga Këshilli i këtij qarku dhe “Ambasador për paqe” nga Federate e paqes Univesrale, Shqipëri.



Emëruesi i përbashkët i motivacioneve të kërtyre titujve të lartë nderi përbledhtasi është: mbajtja gjallë e vlerave etnokulturore, kontributi i tij i çmuar në mbështetjen dhe promovimin e vlerave të LANÇ, dhe si ish-drejtues në fushën e ndërtimeve dhe infrastrukturës rrugore në gjithë vendin.

Muharremi lindi në vitet e luftës, në Zall-Dardhë, Dibër më 16 qershor të vitit 1943. Kaloji një fëmijëri të vështirë, por kjo e bëri më të fortë dhe të vetëdijshëm për të çarë rrugët e jetës. Që në vitet e rinisë së tij u inkuadrua në kantierët e ndërtimit të rrugëve, flimisht në Kurbnesh dhe më pas në Skuraj, duke afirmuar cilësi të jashtzakonshme, të njeriut punëtor, korrekt, kreativ, por edhe drejtues i aftë.

Vitet e shërbimit ushtarak e largojnë prej këtu dhe mbrojtja e atdheut e kërkon në Bilishtin e largët, në kufirin me Greqinë. Prej aty, ai shërben syshqiponjë edhe në Poçarin e largët në Leskovik, duke lënë gjurmët e mira të një patrioti të guximshëm dhe të një ushtari e djali të mirë.

Sërish pas shërbimit ushtarak në kantieret e ndërtimit, nga njëri fshat në tjetrin, si në Spaç, Shupal, Repe, Arrëz, Miliska, Fierzë, Gropa, Haprripe etj, Muharrem Gjoka stamponte çdo ditë me punën dhe sjelljen e tij, emrin

e mirë, duke krijuar një personalitet të padiskutueshëm. Veçanërisht aftësitë e tij organizuese dhe drejtuese spikatën në vitet 1965- 1955 në ndërtimin në një kohë rekord të rrugës Qafë Bari – Fierzë dhe në vitin 1972 për asfaltimin e rrugës nacionale Peshkopi-Bulqizë. Më pas, cilësitë e tij dhe vullti i punës e afirmojnë edhe në Vaun e Dejes, madje aty kreu edhe studimet e shkollës së mesme në teknikumin e ndërtimit, duke rritur më shumë nivelin e tij jo vetëm profesional, por edhe intelektual. Tashmë shkollimi i jep mundësinë që të zgjidhet në detyra të rëndësishme, duke qënë edhe drejtuesi i transportit. Jo rastësisht ai mori përsipër mjaft punë të mira në asfaltimin e rrugëve të Pukës, Shkodrës, Kukësit, Bulqizës, Rrëshenit, etj. Viti 1979, solli një shpërblim të gjithë këtij angazhimi dhe pune titanike, duke u pozicionuar në qytetin e Laçit, ku zgjedh edhe të banojë me familjen e tij të re dhe aty vijon të jetojë e kontribuoj për shumë vite. Këtu kryen edhe shkollën ekonomike, çka i mundësoi ngjitje në shkallët e karrierës deri shef i transportit të ndërmarrjes së asfaltimit, që mbulonte gjithë Veriun e Shqipërisë. Pas viteve 90, kantieri ku ai punonte, rruga-ura u privatizua, konkretisht në vitin 1994, por Muharremi vijoi të ishte sërish aty, si drejtues kantieri deri në vitin 2002.

MUHARREMI ZË VEND TË MERITUAR NË SHOQËRI DHE KOMUNITET

Në vitin 2004, ai del në pension, por kjo shkëputje, asnjëherë së ndali atë në vrullin e përjetshëm të angazhimeve dhe punëve të mira në dobi të familjes, vendlindjes dhe Shqipërisë.

Muharrem Gjoka, mbetet në ajkën e njerëzve të mirë dhe burrave të ndershëm e të përkushtuar, që përmes punës fjalës, sjelljes, por mbi të gjitha veprave të mëdha në shërbim të komunitetit, kanë një vend të merituar në shoqëri dhe komunitet. Prej më shumë se dhjetë vitesh Muharrem Gjoka kryen funksionin e presidentit të grupit artistik “Hazis Ndreu” – “Nderi i Kombit”, i cili ka konkurruar dhe fituar çmime të para në festivale ndërkombëtare si në Ulqin, Tetovë e Prishtinë. Po ashtu, që nga Kuvendi i shtatë i OBVLP është zgjedhur nënkryetar i kësaj organizate, funksion të cilin e kryen me përkushtim të rrallë. Aktiviteti i tij i mësipërm është vlerësuar me certifikatë nderi nga shoqata kombëtare e miqësisë dhe bashkëpunimit Shqipëri-Itali; me mirënjohje nga qendra për kulturë

në Ulqin; me çertifikatë “Mirënjohje” nga ansambli artistik “Kuvendi” Zall Dardhë, ndërkohë që mban edhe Titullin “Ambasador i paqes” nga Federata e Paqes Universale.



DITËLINDJA JUBILARE MBRESËLËNËSE E MJESHTRIT TË MADH MUHARREM GJOKA – PRESIDENT I ANSAMBLIT ARTISTIK “HAZIS NDREU”- “NDERI I KOMBIT

Defrim Methasani, ndër moderatorët më të mirë në rang kombëtar të eventeve - ikonë e gazetarisë sportive dhe dokumentarit televiziv, të shtunën e 17 qershorit 2023, bëri një "përjashtim" nga përditshmëria e tij, duke bashkuar dy ngjarje në një event: 80 vjetorin e ditëlindjes të mikut tonë të ngushtë Muharrem Gjoka - Mjeshtër i Madh, Qytetar Nderi i Qarkut Dibër dhe Nënkryetar i OBVL, si dhe takimin përmbyllës të sezonit "Nga njëra ndeshje në tjetrën" me komentatorët sportive të rretheve. Ndërsa këta të fundit, sëbashku me kolegen e talentuar Erga Kruja (Kënga) i vlerësoi me Medalje e mirënjohje, për "Burrin e Dibrës" Muharrem Gjoka (siç e kemi pagëzua prej vitesh, si mishëruars dhe përçues i urtësisë e mençurisë dibrane), në praninë e tre djemve të tij të mrekullueshëm: Lutfiut, Edit e Gentit, bëri surprizën e radhës, duke i dhuruar simbolin e Mjeshtrit dhe tortën me foton më të mirë të tij. Me këtë rast, në emër të Kryesisë së OBVL (Org.Bashkuar të Veteranëve të LANÇ) i dorëzova Z.Muharrem Gjoka Çertifikatën për dhënien e titullit "NDERI I FEDERATËS SHQIPTARE

TË VETERANËVE TË LANÇ" (Në 80-vjetorin e ditëlindjes së tij) me motivacionin: "Drejtues me aftësi e përkushtim të rrallë i OBVL, për kontributin në konsolidimin e strukturave të saj, mishërues dhe përçues i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale".

Zall – Dardha, Dibrës dhe madje gjithë Shqipërisë i ka dhënë kulturën dhe artin, duke e furnizuar me artistë, këngë e valle. Të shumtë janë artistët nga Zall Dardha të njohur jo vetëm brenda vendit, por edhe ndërkombëtarisht. Muharrem Gjoka është njëri prej tyre, i cili vjen në 80 vjetorin e ditëlindjes (këtë 16 qershor) me bukuri të rrallë fizike e shpirtërore, (si edhe në moshën e tij rinore), i përmbushur në të gjitha aspektet e jetës si askush tjetër; me memorien e freskinë e mendimit e të veprimit, me një familje shembullore dhe me miq e shokë të shumtë nga e gjithë Shqipëria, Kosova e hapësira mbarëshqiptare në botë.

Ai ka kontributin e tij të spikatur në krijimin dhe drejtimin artistik të Ansambllit 'Hazis Ndreu' – "Nderi i Kombit", si president i këtij ansambli prej më se një dekade. Duke evidentuar dhe vlerësuar talentet krijuese e interpretuese si dhe veprimtarinë e shumanshme organizative, ai i ka shërbyer lartësimit të folklorit, etnografisë, valleve dhe kulturës popullore shqiptare dhe veçanërisht, asaj dibrane.

Të nderosh artin dhe njerëzit, që e krijojnë atë, që kontribuojnë kaq shumë, është jo vetëm një detyrë, por edhe një kënaqësi e veçantë. Folklorin, këngën dhe vallen, Dibra i ka në genet e saj, siç ka patriotizmin dhe besnikërinë ndaj Atdheut. Ndaj dhe Muharrem Gjoka nuk rresht për t'i promovuar këto vlera.

Urime të përzemërta mori Z.Gjoka edhe nga miqtë e tij komentatorë në emisionin e Radio Tirana "Nga njëra ndeshje në tjetrën", Rrok Preçi, Moisi Dalipi, Bashkim Tufa, Martin Dedaj, nga kampioni i volejbollit dhe drejtues i strukturave të larta të Sportit Leonard Tase, ish-këshilltar i Presidentit të RSH Ilir Meta, nga Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Universale të Paqes, Shqipëri Z Gani Rroshi, etj...

Familja e madhe e emisionit "Nga njëra ndeshje në tjetrën" në këtë takim mbresëlënës me rastin e përfundimit të sezonit futbollistik, dhe veçanërisht Muharrem Gjoka e djemtë e tij, përjetuan emocione që do t'ju mbeten gjatë në memorie...

Jo rastësisht Defrim Methasani kishte përzgjedhur lokalit "ERDEN", pak kilometra nga ku nis rruga e vjetër Elbasan-Tiranë, por sepse këtu

DIBRA DHE DIBRANËT NË PANTEONIN E VLERAVE

gjithshka është mrekulli, jo vetëm gatimet "bio" e shërbimi mjaftë i kulturuar, por edhe sepse ky lokal rrëzë një kodre me ullinj ngjan si ballkon i Elbasanit, me bukuri magjepëse. Ndaj, këtu, familja e madhe e emisionit "Nga njëra ndeshje në tjetrën" në këtë takim mbresëlënës me rastin e përfundimit të sezonit futbollistik, dhe veçanërisht Muharrem Gjoka e djemtë e tij, përjetuan emocione që do t'ju mbeten gjatë në memorie...



LAHIM KOLA, MUZIKANTI I TALENTUAR NGA SOPOTI

- **Si shpëtoi artisti nga akuzat si “i molepsur nga psikologjia mikroborgjeze dhe zbutës i luftës së klasave”!**

Një nga personalitetet e muzikës shqiptare është padyshim edhe Lahim Kola. Ai ka lindur në mars të vitit 1938, në familjen Kola në Sopot. Fëmijëria e tij përkon me vitet e vështira, të Luftës Nacionalçlirimtare. Nga viti 1945 deri në vitin 1949 ka kryer shkollën fillore në Sopot, me vështirësi e mungesa të mëdha deri te librat e fletoret. Falë mësuesve të përkushtuar, si dhe vullnetit e këmbënguljes, e mbaroj me rezultate shumë të mira shkollën fillore. Por kushtet e vështira ekonomike e familjare nuk e lejuan të vazhdojë shkollën shtatë vjeçare në Zerqan.



NGA FIZARMONIÇIST AMATOR TE ESTRADA PROFESIONSTE E PESHKOPIË

Si dhjetra bashkëmoshatarë, Lahimi u detyrua të rritej para kohe dhe t’u përkushtoj punëve, për t’i ardhur në ndihmë sado pak familjes së tij të madhe. Provoi të gjitha punët, duke filluar që nga ruajtja e bagëtive e më pas me të gjitha proceset e punëve bujqësore.

Gjatë kësaj kohe filloi të kremtohej festa e 3 gushtit në Livadhet e Zerqanit. Kaloi një fëmijëri të vështirë, duke mos pasur asnjë lloj argëtimi, sepse atëherë nuk bëhej fjalë për radio apo energji elektrike, madje nuk kishte vajguri për ndriçim. “Jemi ndriçuar me pishë për disa vite. Ne fëmijët mezi e prisnim ditën e kësaj feste, si i vetmi argëtim për ne. Bukurinë, kësaj feste, përveç të tjerave ia shtonin ardhjet e grupeve artistike nga Tirana e

Shkodra. Orkestrat e këngëtarët e mrekullueshëm na jepnin kënaqësi të veçantë. Por mua, në mënyrë të veçantë, më pëlqente fizarmonika. Dhe nuk më hiqej nga mendja për shumë kohë...”, rrëfen Lahimi. Për të, kjo qe shkëndia e parë dhe që më vonë, me ndihmën e Zotit dhe të Familjes u bë e mundur që të blenin një fizarmonikë të vogël. Me këtë fizarmonikë të vogël shkoi për të kryer shërbimin ushtarak 40 mujor. Aty ka hyrë në orkestrën e repartit të kufirit Peshkopi, nga viti 1957 deri më 1960.

Duke kujtuar ato kohë fatlume, mjeshtri i ardhshëm i muzikës shprehet se falë kushteve që iu krijuan, pasionit dhe vullnetit, ndihmës që i dha fizarmonicisti tjetër i repartit, si dhe ndihmës teorike nga shoku dhe miku i tij, Ahmet Balliu, (në atë kohë fizarmonicist në shtëpinë e kulturës), arriti të ecte mjaft mirë në përvehtësimin e instrumentit të lakmueshëm. Që në ushtri krijuan grup artistik dhe orkestra e repartit përballonte një pjesë të mbrëmjeve që bëheshin në qytetin e Peshkopisë.

Në Estradën Profesioniste të sapo krijuar të Peshkopisë kishte ardhur në detyrën e drejtuesit të muzikës kompozitori i mirënjohur shkodran Tonin Rrota. Pasi e dëgjoi Lahimin në disa mbrëmje, e thirri për të biseduar dhe i vuri përpara ca partitura me pjesë muzikore, ndërkohë i dha një fizarmonikë dhe po e dëgjonte me vëmendje. Pasi u bind në talentin e djaloshit nga Sopot, i premtoi që pas mbarimit të shërbimit ushtarak ta merrte si bashkëpunëtor në orkestrën e Estradës Profesioniste të Peshkopisë.

Për Lahim Kolën, kjo ishte e paimagjinueshme, por ja që ndonjëherë edhe ëndrrat bëhen realitet. Kështu, më 2 dhjetor 1960, sapo u lirua nga ushtria, u paraqit sipas porosisë. Tonini thirri dhe drejtoreshën Vera Muça dhe përsëri i dha fizarmonikën që ta dëgjonte edhe drejtoresha. “Ndërkohë që unë i bija fizarmonikës ata diçka bisedonin bashkë. Në fund më thanë: me 16 dhjetor do vish të fillosh punë këtu si fizarmonicist profesionist në orkestrën e estradës”, vazhdon rrëfimin Lahimi.

Pas fillimit të punës në Estradën Profesioniste, vazhdoi me korespondencë shkollën shtatëvjeçare, si dhe shkollën pedagogjike, ku u diplomua në vitin 1966. Natyrisht që shkollimi e ndihmoi që të ecë me kurajo edhe në fushën profesionale si muzikant.

Falë punës profesionale që bënte kompozitori Tonin Rrota me sektorin e muzikës dhe studimit individual, Lahim Kola arriti që, jo vetëm të

perfeksionohej në fizarmonikë, duke luajtur dhe pjesë solo me të në skenë, si “Vallja e shpatave” e një kopozitori rus, “Fantazi për fizarmonikë”, nga Agim Krajka, vals in “ Indiferenti”, pjesë koncerti etj, por nën shembullin dhe kujdesin e tij, filloi edhe të krijojë këngë me motive dibrane. Si të tilla vlen të përmenden: “Eja cucë dibrane”, duetet “Aksioni na bashkoi” dhe “Si dy lule ndër agime”, të kënduara me shumë sukses nga Flora Toska e Abdyl Sturçe, të cilat janë vlerësuar me çmime të para nga juritë përkatëse. Po kështu Lahimi krijoi “Këngë malesh”, e vlerësuar me çmim të dytë në Festivalin e Radio Kukësit. Në memorien e bashkëkohësve të tij ruhen të freskëta gjithashtu krijimet mahnitëse: “Aksionistja e malit”, kënduar nga Melita Shehu, “Këngë e punë kudo”, “Dibranja e re”, “Kombanjeri” etj. Këto dhe mjaftë të tjera janë të regjistruara dhe të transmetuara dikur nga Radio Tirana, por si shumë nga këngët e asaj kohe, ca nga tematika e ca nga aparaturat e vjetëruara, nuk transmetohen më.

NË VITIN 1971 MERR DREJTIMIN E ORKESTRËS SË ESTRADËS PROFESIONISTE

Me largimin e kompozitorit të ndjerë Tonin Rrota nga Peshkopia, në vitin 1971, Lahim Kola u ngarkua me drejtimin e sektorit të muzikës dhe orkestrës së Estradës Profesioniste. Në fillim, ai tregon se e pati mjaftë të vështirë, sepse duhej siguruar repertori i këngëve për çdo premierë, duhej të punonte me këngëtarët, të orkestronte pjesët muzikore dhe t’i përgatiste me orkestrën etj. Të gjitha këto deri në atë kohë i bente kompozitori Tonin Rrota. Kjo gjë, sipas tij, i kufizoi kohën për studimin e mëtejshëm në fizarmonikë, që ishte pasioni i tij. Por gjithsesi ishte i detyruar. Ishte përgjegjësi e madhe për të sepse niveli artistik duhej të vinte gjithmonë në ngritje. Gjatë viteve që ka qenë në drejtim të orkestrës ka dalë dhe dy herë jashtë shtetit me Ansamblin “Dibra”, në Turqi dhe Maqedoni. “Si Estradë Profesioniste kishim plan shtetëror. Duheshin realizuar katër premiera në vit: 160 shfaqje në qytet dhe në fshatrat e rrethit. Për çdo vit bënim një ose dy turne me shfaqje në qytetet e vendit”,-thotë Lahimi. Veçanërisht ai kujton turnetë e viteve 1961, 1963, si dhe më vonë kur kanë dhënë shfaqje në çdo qytet të Shqipërisë, në çdo fshat të Dibrës, si dhe në veprat e qendrat industriale. Ai vlerëson punën e palodhur dhe krijimtarinë e regjisorit Tefë Krroqi si dhe këngët e bukura të Tonin Rrotës dhe ato dibrane të

trajtuara me mjeshtri nga këngëtarët dhe orkestra, të cilët kishin sukses të jashtzakonshëm kudo që shkonin.

SI I SHPËTOI NDËSHKIMIT PËR ZBUTJE TË LUFTËS SË KLASAVE

Megjithëse populli i donte e respektonte, edhe artistët si Lahim Kola, gjatë viteve të diktaturës kishin problemet e tyre. Ai kujton disa drejtues partiakë, që jo vetëm nuk merrnin vesh nga arti, por nuk ishin as dashamirës të punonjësve të artit. Kështu artistët si Lahimi, veçanërisht orkestrantët që luanin dhe muzikë të huaj, ishin në shënjestrën e tyre, që të mos ndikoheshin nga ideologjia mikroborgjeze dhe shfaqjet e huaja. “Pas shkarkimit të disa kolegëve më të vjetër, në vitin 1976, si duket, në vitin 1980 më erdhi radha edhe mua. Neve na ngarkonin që të drejtonim grupet artistike nëpër shkolla e qendra pune, si dhe nëpër mbrëmjet që organizoheshin në Turizëm dhe na jepej një farë shpërblimi në bazë të ligjit dhe të rregullave.

Në funksion të këtyre aktiviteteve aktivizonim ndonjë person të talentuar edhe pse mund të kishte ndonjë hije në biografi. Mjaftuan këto pretekste që një drejtues partiak të më kundërvihet deri në atë shkallë, sa që pas debateve të forta me të, në zyrën e tij i propozoi Byrosë së Partisë që të vendoste shkarkimin tim, si i molepsur nga psikologjia mikroborgjeze dhe zbutës i luftës së klasave. Pas kësaj mase priteshin edhe masa të tjera deri në largim nga qyteti, siç kishte ndodhur dhe me të tjerë. Por shqyr Zotit kishte dhe njerëz të mirë mbi atë. Pikërisht njëri prej tyre pasi më dëgjoi me vëmendje, më tha: “Shko pa merak dhe puno ashtu siç ke punuar gjithmonë”. E falenderova dhe u çlirova nga një ankth i jashtëzakonshëm”, - rrëfen Lahimi për atë kohë të trishtë. Dhe nuk nguron të falenderojë personin që e shpëtoi nga ajo isinuatë, ish Sekretarin e Parë të Komitetit të PPSH të rrethit Dibër, Jovan Bardhi që për të mbetet njeri i respektuar.

LAHIM KOLA, NDËR DHJETË ARTISTËT E PARË TË ESTRADËS PROFESIONISTE TË PESHKOPIË

Lahim Kola pati fatin që të bënte pjesë në dhjetëshen e parë të artistëve të Dibrës dhe të punonte e të përfitonte nga dy drejtuesit artistikë. Puna

e tij është vlerësuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor në vitet 1979 dhe 1989 me Medaljet “Naim Frashëri”, të Klasit të Tretë dhe të Dytë, me motivacionin: “PËR PUNË ME PASION E PËR INTERPRETIM ME NIVEL IDEOARTISTIK SI INSTRUMENTIST DHE PËR NDIHMËN E DHËNË NË MBARËVAJTJEN E FORMACIONIT TË ORKESTRËS në Shtëpinë e Kulturës në Peshkopi”. Në vitin 1993, u bë reformë në Shtëpinë e Kulturës ku Lahimi punoi për 33 vite, mori për ca kohë asistencë dhe pastaj doli në pension. Që nga viti 1998, Lahim Kola bashkë me familjen janë vendosur me banim në Tiranë.

Mbretëresha e skenës dhe ekranit Margarita Xhepa, Prof. Dr. Ethem Ruka dhe aktori i mirënjohur Timo Flloko – Mjeshtër i Madh, vlerësojnë rezultatet e larta të “Sarinës”

“SARINA 2002”, LIDER NË ARSIMIN JOPUBLIK SHQIPTAR

- Shkolla Jopublike “Sarina 2002”, u krijua dhe u rrit cilësisht falë kontributit të Presidentit të saj, Liman Hoxha - njeri i veçantë, energjik, në sjellje e qëndrime, personaliteti i të cilit kudo dhe në çdo rrethanë reflekton mirësi dhe vlera



Në një takim miqsh në pragun e ndrrimit të viteve, moderatori i mirënjohur i eventeve festive (lokale, kombëtare e ndërkombëtare), Defrim Methasani – Mjeshtër i Madh, më prezantoi me Liman Hoxhën.

-Është themeluesi dhe Presidenti i Shkollës Jopublike “Sarina 2002” që ndodhet në Fushë Keshar, Autostrada Tiranë - Durrës, kilometri i parë përballë “Vodafone”, ndër më të suksesshmet në rang kombëtar, - më thotë Defrimi, duke shtuar se këtu janë shkolluar deri në mbarimin e gjimnazit

tri vajzat e tij të mrekullueshme.

Kureshtja më nxiti ta vizitoja këtë shkollë në një nga ditët e para të këtij viti. Dhe vërtet u befasova. Jo vetëm me pamjen e jashmte por dhe me mjediset e këtij kompleksi arsimor modern, të standardeve më të përparuara arsimore, me klasa moderne, laboratorë, palestra e terrene të reja sportive.

NË 23 VJET NUMRI I NËNËSVE U 15 FISHUA

Para 23 vitesh,”(shtator 2002) pasi provoi dhe ja doli suksesshëm në bizensin e vogël, Liman Hoxha guxoi të hapë këtu shkollën jopublike “Sarina 2002” , në fillim me 53 nxënës dhe për 10 vjet u dhjefishua, ndërsa aktualisht atë e frekuentojnë rreth 800 nxënës nga arsimi parashkollor deri ne gjimnaz.

Ka të drejtë të krenohet, presidenti i saj, Limani, djaloshi i ardhur nga fshati Bllicë-Dibër, bir i një familjeje arsimadëshëse, sepse rezultatet e shkëlqyera me të cilat u diplomua si ekonomist në Universitetin Bujqesor, fakulteti Ekonomik Tiranë dhe përvojën e mëpasme disavjeçare në sektorë jetikë, po i implememton suksesshëm, duke e shndrruar shkollën “Sarina 2002” lider në arsimin jopublik shqiptar. Për këtë flasin vetë rezultatet

Në këto 23 vite kjo shkollë ka 15 fishuar numrin e nxësëve dhe ka arritur rezultate të shkëlqyera, si fituese olimpjadash në lëndë të ndryshme dhe duke qenë fituese edhe në aktivitete artistike sportive. Aktualisht kjo shkollë ka 300 nxënës në ciklin e ulët, 270 nxënës në ciklin e ulët të mesëm dhe 230 nxnës në gjimnaz.

“Nxënësit tanë që mbarojnë gjimnazin janë fitues në degët më të kërkuara të universiteteve tona, si në mjekësi, inxhinieri kompjuterike dhe Ndërtimi, Shkencat Shoqërore dhe Ekonomike, etj. Gjithashtu janë dhjetra nxënës që kanë mbaruar gjimnazin në shkollën tonë që studjojnë në universitete të njohura jashtë vendit, si në Gjermani, Angli, itali, Kanada, Amerikë, etj,” - pohon Presidenti Hoxha. Për të qenë sa më bindës na njuh me emrat e maturantëve të dallaruar të viteve 2018-2022, të pasqyruar në tabelat mbresëlënëse edhe në ëbsit-in e shkollës. Dhe nuk janë pak, por 100 emra që me rezultatet e shkëlqyera në univeristetet ku studjojnë ja rrisin prestigjin shkollës “Sarina 2002” , ku kanë kryer shkollimin bazë.

Një tjetër tabelë e vendosur edhe në këndin mahintës në hyrje të

shkollës ka emrat dhe fotot e maturantëve të shkëlqyer ndër vite. Kësisoj, presidenti Hoxha dhe stafi pedagogjik synojnë që edhe për vitin 2025 nxënësit e kësaj shkolle të fitojnë degët më të mira brenda dhe jashtë vendit tonë.

Në ceremoninë festive të 20-vjetorit të kësaj shkolle, nxënësit dhe mësuesit i përshëneti Prof. dr. Ethem Ruka, ish - Ministër i Arsimit, aktualisht rektor i Universitetit "LUARASI". Ai shprehu mirënjohje dhe vlerësim maksimal për stafin aktual dhe të gjithë ish - mësuesit, për kontributin dhe kujdesin që tregojnë për çdo nxënës dhe rezultatet e larta të "Sarinës". Në takimin festiv ishin të pranishëm edhe Zëvendës. Ministri i Arsimit dhe Sportit Z. Endrit Hoxha, deputeti i Kuvendit Popullor Z. Denis Delia, përfaqësues të ZVA Tiranë, Drejtorisë Rajonale, përfaqësues të universiteteve etj...

STAF TË KUALIFIKUAR MËSUESISH

Rezultatet inkurajuese të Shkollës 12-vjeçare jopublike "Sarina 2002" me eksperiencë 23 - vjeçare, "Lider në edukim dhe mësimdhënie", me kushte shumë të mira mësimdhënie dhe studimi dhe me programe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, parasëgjithash i dedikohen një stafi të kualifikuar mësuesish.

44 mësues të lëndeve të ndryshme (nga cikli i ulët deri në gjimnaz) shërbëjnë këtu si modele të profesionalizmit, ndershmërisë dhe përkushtimit ndaj nxënësve.

Presdienti i Shkollës Liman Hoxha, pohon se përzgjedhja e stafit pedagogjik është bërë gjithnjë me konkurse të rregullta sipas standardeve të njohura ndërkombëtare dhe rregulloreve të miratuara nga Ministria e Arsimit.

Limani, që në përditshmërinë e jetës është një nga figurat më interesante, si përfaqësues dinjitoz i elitës intelektuale dibrane në metropolin shqiptar, flet për mësues që reflektojnë personalitetin e tyre si edukator shembullorë për 800 nxënësit e prindërit e tyre sidhe për shembujt pozitiv të mësimdhënies. Duke aplikuar metodologji të përparuara mësimdhënieje, shkolla "Sarina 2002" është bërë më e dashura për nxënësit e saj dhe për prindërit e tyre, me të cilët mbahen kontaktet e rregullta takimi e konsultimi.

Gjithkush do të mrekullohej me realizimin nga nxënësit e kësaj shkolle të projekteve të tilla si “Traditat dhe Metropoli/ Bashkëjetesë në diversitet”, etj.



Reflektim i dijeve në lëndën e gjeografisë janë punimet e bazuara në njohjen e trashëgimisë sonë të pasur kulturore, materiale dhe shpirtërore, të mishëruara më së miri në traditat tona, si dasma shqiptare veriore dhe jugore, vallet, veshjet, punimet artizanale si dhe gastronomia, të realizuara aq bukur dhe mjeshtërisht nga nxënësit e talentuar të klasave të XI-A, B, C, D, nën udhëheqjen e mësueses së gjeografisë Zyri Zavalani.

Të mësuarit e bazuar në projekte është një metodë mësimore përmes të cilës në këtë shkollë nxënësit identifikojnë problematika dhe zgjidhje efikase të tyre.

Me anë të të mësuarit të bazuar në projekte, nxënësit fitojnë njohuri dhe shkathtësi të ndryshme, të cilat pastaj ndihmojnë në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional. Ky lloj i të mësuarit në këtë shkollë është më ndryshe se të mësuarit tradicional, për shkak se të mësuarit këtu bëhet përmes angazhimit aktiv dhe aktiviteteve të cilat kërkojnë bashkëpunim dhe janë shumë më argëtuese.

Ka ardhur në këtë formë një orë mësimi në lëndën e anglishtes për klasat e treta nën kujdesin e mësueses Besiana Hala.

Në këtë shkollë mësojmë se janë realizuar projekte për tema të ndryshme gjatë zhvillimit të njohurive të thella të përmbajtjeve që diskutohen, evidentohet shkathtësia e punës në grup, komunikim, mendim kritik, kreativitet, menaxhim të kohës, zgjidhje të problemeve, shkathtësi

hulumtuese, shkathtësi prezantuese, rritje të përgjegjësisë qytetare dhe veprimtari personal.

Drejtori Koldashi thotë se pika kryesore e të mësuarit me bazë projektsh është se mësimi duhet të jetë një përpjekje bashkëpunuese mes mësuesve dhe nxënësve dhe ku nxënësit duhet të marrin një rol aktiv në mësimin e tyre. Në këtë mënyrë, kur nxënësit mësojnë njëri-tjetrin gjatë punës në grup, ata janë një skuadër, që sfidojnë dështimet, ata gjithashtu marrin pjesë në mënyrë bashkëpunuese në krijimin e një harte konceptuale, si një pazëll, ku secili plotëson pjesën e tij. Kjo shton një dimension të rëndësishëm tek të menduarit kritik dhe të nxënësit. Kur projekti është i integruar, secili nxënës mund të gjejë diçka që i pëlqen dhe të gjithë mund të hyjnë në të, ata mund të gjejnë caq shumë aspekte të ndryshme dhe të mësojnë se si të lidhin një temë me veten dhe kjo është çelësi për të mësuar.

Këtë e kanë treguar nxënësit e klasave XI-C dhe XI-D nën kujdesin dhe udhëheqjen e mësueses Brunilda Reçi në një orë mësimi bazuar në projekte.

Kësisoj, çdo vit që kalon, nxënësit ngjitin nga një shkallë, e çdo shkallë shoqërohet nga arritje e kënaqësi. Shkolla “Sarina 2002” kujdeset fort mbi vlerësimin e pasurisë shpirtërore të nxënësve, që gjithmonë mbetet e paçmueshme.

SPORTI NË FUNKSION TË EDUKIMIT

Këndet dhe mjediset sportive moderne të Shkollës “Sarina 2002” që ndodhet në Autostradën Tiranë - Durrës, kilometri i parë përballë “Vodafone” do të ishin të pavlerë, nëse në to nuk do të zhvilloheshin veprimtari të larmishtme sportive. Kështu në këtë shkollë është mbyllur kampionati i futbollit për moshat 15-18 vjeç teksa në fund luajtën si finaliste klasa IX-A me IX-B duke i bërë një mbyllje fantastike kampionatit me një ndeshje super nga te dyja skuadrat.

Me moton “Sporti përmirëson jetën”, mësojmë se në këtë shkollë ka përfunduar kampionati i volejbollit për vajza. Presidenti Liman Hoxha, i cili në rininë e tij është dalluar për pjesëmarrje aktive në sportin e mundjes në Dibër, thotë i ngazëllyer se: “Ashtu sikurse pritej, vajzat na dhuruan një finale të fortë, por në fund ato që festuan ishin vajzat e klasës së XII-A. Përballja rezultoi me shumë rivalitet midis klasave XI-D me XII-A, duke

sjellë emocione dhe krijoi një atmosferë të ndezur gjatë të gjithë ndeshjes”. Dhë për këtë ai falenderon mesuesen e edukimit fizik Lubjana Koltraka për punën e palodhur si dhe të gjithë nxënësit e gjimnazit “Sarina 2002” për angazhimin.

EDUKIMI NËPËMJET VEPRIMTARIVE KULTURORE ARTISTIKE MARGARITA XHEPA DHE TIMO FLLOKO

Krahas realizimit me sukses të programit mësimor edukativ në të gjitha ciklet, Shkolla jopublike “Sarina 2002” zhvillon veprimtari të larmishme kulturore artistike. Më evidebnte këto veçanërisht në ditë të festave kombëtare, por edhe në Ditë të veçanta Ndërkombëtare si “Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara”, “Dita e Tokës”, “Dita e Mjedisit” etj.

Ndërkohë zhvillohen edhe aktivitete të ndryshme mësimore, kulturore – artistike (të organizuara në klube lëndësh).

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Poezisë 21.03.2024 mesues dhe nxës të shkollës “SARINA 2002” patën kënaqësinë të kishin mes tyre mbretëreshën e skenës dhe ekranit, aktoren e madhe Margarita Xhepa – “Nderi i Kombit”. Me përrshëndetjen e zjarrtë në vlerësim të kësaj shkolle, ndër më të mirat në rang kombëtar, si dhe me interpretimi8n mjeshtërot të disa poezive ajo eelektrizoi sallën ku u zhviullua eventi.

Nxënësit nën përkushtimin dhe kujdesin e mesueses së letërsisë Elenika Kavaja, dhuruan një atmosferë të mbushur plot dashuri dhe pozitivitet nëpërmjet recitimit të poezive me tematikë të ndryshme, të cilat u vlerësuan me çmime nga e madhja Margarita Xhepa. Aktorja përcolli emocione pozitive tek të rinjtë e shkollës sonë duke theksuar vlerën e poezisë edhe nën interpretimin e saj brilant.

Në kuadër të veprimtarive të organizuara për 80 - vjetorin e çlirimit të Atdheut dhe Ditën e Pavarësisë se Shqipërisë perfundoi puna për ekspoziten me punime të nxënësve të shkollës, punime që kishin në qender patriotizmin, atdhedashurine dhe ndjenjen e krenarisë për Atdheun. Mësuesi Azem Teta i konsideron këto një shkëlqim të merituar të nxënësve të shkollës “Sarina 2002”, të cilët nëpërmjet mësimit dhe veprimtarive bënë të mundur këto vlerësime në prag të dy festave të mëdha aq të dashura për to.

Gjithashtu mësojmë se i një rëndësie të veçantë ka qenë aktiviteti me temë: “Të kujtojmë te kaluarën me një sy nga e ardhmja. Holokausti duhet kujtuar që të mos përsëritet më”, organizuar nga klasat e XI-ta të kësaj shkolle nën kujdesin e mësueses së historisë Eriola Muça.

I veçantë dhe mbresëlënës ishte Tetori që në traditën tonë të re është tashmë dhe Muaji i Letërsisë, sepse lidhet me jetët e disa prej shkrimtarëve më të mëdhenj të letrave shqipe. Kjo është ajo çka arti dhe letërsia ka si qëllim të arrijë: t’i bëjë nxënësit të hyjnë edhe në mendjet e atyre njerëzve që nuk do të kishin kurrë rastin t’i takonin.

Në kuadër të “Tetori Muaji i Artit dhe Letërsisë”, Shkolla “Sarina 2002” pati nderin dhe kënaqësinë të kishte të ftuar një nga aktorët më të mëdhenj të kinematografisë shqiptare, Mjeshttrin e Madh Timo Flloko.

Aktori i njohur, në një bashkebisedim të gjatë me nxënës të kësaj shkolle foli për jetën e tij, vendlindjen, pasionin për poezinë, filmin, aktrimin, letërsinë dhe percolli te nxënësit mesazhin se: “Dija kurrë nuk është e tepruar, sepse pasuria mendore dhe madhështia shpirtërore e bëjnë njeriun të lumtur.” Nisur nga ky vlerësim i ikonës së skenës dhe kinematografisë shqiptare Timo Flloko, Presidenti Liman Hoxha premtonte se kjo traditë do të vazhdojë e do të pasurohet ndër breza në shkollën “Sarina 2002”. Mesazhi i tij starton rrugëtimin e saj në përgatitjen e brezave me dije dhe shkencë.

Moto e Shkollës “Sarina 2002” ka qenë dhe mbetet edukimi me një kulturë studimi sistematik dhe llogaridhënie e nxitje për zhvillimin e aftësive. Këtu çdo nxënës gjen motivim në ambiente komode për studim, në laboratore e kabinete ku alternohet teoria me praktikën. Shkolla ka hapësira çlodhëse të bollshme e të gjelbëruara

OSMAN MIHA DHE ARSIMI PROFESIONAL NË BULQIZË

Bulqiza ndër vite, si një kantier i madh punëtorësh, me mbi dhjetë mijë minatorë, nuk mund të kuptohej pa shkollën e mesme të arsimit profesional, të degës gjeologji-miniera. Shkolla e Mesme e Minerave të Bulqizës, përgjatë viteve 80', fitoi një përvojë dhe arritje mjaft të lartë në harmonizimin teoriko-praktik të lëndëve dhe moduleve profesionale. Prapa kësaj veprimtarie mësimdhënëse dhe mësimnxënëse, natyrisht ishte një intelektual i aftë, inxhinieri Osman Miha. Osmani, me një



përkushtim dhe njohje të thellë të shkencave gjeologjike dhe minerare, shfrytëzim dhe ndërtim miniera, që në rininë e tij, e shfaqti ambicien për të studiuar dhe për t'iu kushtuar studimeve të thelluara teorike dhe praktike në hartimin e kurrikulave, programeve dhe teksteve të shkollës së mesme profesionale të minerave. Si ekspert i aftë dhe i talentuar, Osmani u arsimua në Shkollën e Mesme Gjeologjike dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Fakultetin Gjeologji-Miniera, duke pasuruar njohuritë teorike me përvojën e tij praktike në Minierën e Bulqizës, ku nis karrierën si teknik miniere, teknik Markshedër, përgjegjës Sektori dhe kryeinxhinier në ndërmarrjen e Ndërtimit të Minerave. I kompletuar kështu me një përvojë teorike dhe praktike, Osmani emërohet më 1975, drejtor i Shkollës së Mesme të Bashkuar Bulqizë. Në këtë shkollë përmblihdeshin disa degë: Miniera, Gjeologji, Shpim, Elektrike, Mekanike, Bujqësore dhe Përgjithshme.

Kjo që një zgjidhje mjaft e volitshme për kohën dhe për kushtet e Bulqizës, ku kontigjenti që vazhdonte shkollën, pas mbarimit të saj sistemohet në punë duke rritur efektivitetin në prodhim dhe duke ofruar

interes kualifikues dhe leverdi në pagesë të të rinjëve, me rritjen në kategori. Madje kjo ishte një zgjidhje dhe për ata të rinj që punonin në Minierë, Gjeologji apo Ndërtim-Miniera dhe në moshë të kaluar, ndiqnin studimet me kohë të shkurtuar. Kuptohet që një rol të rëndësishëm këtu ka luajtur me aftësitë e tij, drejtori i shkollës Osman Miha. Ai me intuitën e tij kishte një vizion mjaft modern për arsimin ku ndërthureshin përputhja e diplomës me vendet e punës, përshtatja e moduleve për sektorë konkretë të ekonomisë dhe të prodhimit, lidhja e teorisë me praktikën, ku njohuritë gjenin zbatim konkret në punën e gjallë të sektorëve minerarë, nxjerrës dhe përpunues, kërkime e ndërtime. Kjo është për Osmanin një meritë intelektuale duke vërtetuar vizionin e tij mbi filozofinë arsimore dhe edukimin, si intelektual dhe drejtues. Si mësimdhënës i kësaj shkolle, Osmani filloi të shkruante tekste shkollore në module profesionale me cilësi shkencore dhe pedagogjike si teksti Makina Miniere (1978), Transport Miniere (1979), Makina Transport-1 (1981) dhe Makina Transport-2 (1982). Këto tekste me miratim të Ministrisë së Arsimit u liçensuan si tekste kombëtare për degën gjeologji-miniera për shkollën e mesme me profil gjeologji-miniera në gjithë vendin. Inxhinier Osman Miha u aktivizua në grupe ekspertësh, pranë Ministrisë të Minierave dhe Energjetikës dhe pranë Ministrisë së Arsimit për recensimin e teksteve: Art Miniere 1-A; Art miniere 1-B; Art Miniere-3; Teknika e Sigurimit në Miniera, si dhe në planprogramet e arsimit profesional.

PERFORMANCA E SHKËLQYER E NJË PERSONALITETI ME INTEGRITET TË LARTË MORAL

Po kështu kontributi i tij shkencor pati ndikim edhe në grupin studimor të pagave të punonjësve të Minierës Bulqizë, gjatë vitit 1999-2000. Në gjithë veprimtarinë e tij si drejtues në ndërmarrje ekonomike dhe si drejtues i arsimit, Osmani realizoi një performancë të shkëlqyer si një personalitet me integritet të lartë moral, profesional e shkencor. Ai dinte të motivonte dhe të nxisë stafet drejtuese për rezultate të larta dhe realizim objektivash. Me korrektësi dhe përkushtim, ai ishte shembull në punë duke objektivizuar kërkesa të larta ndaj vetes dhe të tjerëve. Inxhinier, mësues dhe edukator i brezit të ri, Osmani do të formatonte një familje dinjitoze në shoqëri, duke u nderuar dhe respektuar nga gjithë komuniteti

i Bulqizës dhe më gjerë. Ai harmonizonte idetë e reja dhe progresive me traditën e vyer të dibranit të Katër–Grykëve, zonë që shquhej për urtësi, bujari dhe fisnikëri njerëzore. Motivet e fuqishme kombëtare dhe vlerat kulturore qytetare, përbënin principet bazë, nga motivohej dhe prirej në punë e në jetë, Osman Miha. Sot atë e takojmë në veprimtaritë kulturore dhe letrare që zhvillojnë intelektualët dibranë në kryeqytet, duke u ndjerë i respektuar midis kolegëve ku ka qenë shef i zonës “D”, punonjësve të administratës që e kanë patur dikur si kryeinxhinier, apo zyrtarët kolegë që e kanë patur kryespecialistin e pagave dhe normave gjatë vitit 1999- 2000. Ai vazhdon të punojë në firmën e ndërtimit “Andi Konstruksion” Sh.p.k që e drejton vëllai i tij, inxhinieri i talentuar Latif Miha, një biznesmen i suksesshëm dhe korrekt. Begraundi i Osman Mihës shtrihet edhe në fushën e studimeve etnografike, si njohës dhe hulumtues në fushën e folklorit dhe etnografisë si dhe njohës i mirë i përkthimit në gjuhët angleze dhe ruse. Në këtë fushë dosja krijuese e tij është premtuese për libra të ardhshëm. Më 1975 u dekorua nga Kuvendi Popullor me motivacion: “për punë të shquar në miniera dhe gjeologji”. Për moshën dhe jetën e tij edhe tani, për Osmanin, puna është kuptimi, gëzimi dhe krenaria e jetës. Kështu ai vazhdon ta jetojë jetën me familjen e tij të mrekullueshme plot dashuri, humanizëm dhe dinjitet.

QYTETAR NDERI I BULQIZËS

Në vlerësim të kontributit të tij, Këshilli bashkiak i Bulqizës e ka vlerësuar, Osman Mihën, me titullin e lartë “Qytetar Nderi”. Ndaj nuk qe rastësi që ditën e premte, më datë 14 korrik 2019, shumë të njohur dhe familjarë të Osmanit, miq e shokë, kolegë e ish nxënës të tij e lanë vapën dhe zagushinë e madhe të Tiranës dhe udhëtuan drejt Bulqizës.



Si gjithmonë, në të tilla evenimente të rëndësishme dibrane, gazetari i talentuar i televizionit shqiptar Defrim Methasani do të fillonte të moderonte këtë aktivitet. Në fillim shfaqet një dokumentar i shkurtër, por

mjaft i pasur nga jeta dhe veprimtaria e gjatë e Osmanit si në fushën e inxhinierisë minerare, ashtu edhe në atë të mësimdhënies, përgatitur nga Defrim Methasani. Të pranishmit u përqendruan sy e veshë në skenë, ku po shfaqej dokumentari. Jo që nuk e njihnin Osmanin, por mënyra se si i kishte gërshetuar ngjarjet Defrimi, vlente për t'u parë vërtet me mjaft kërshëri dhe interes.



Pas dokumentarit radha do të ishte për kryetarin e Bashkisë zotin Milaim Damzi, i cili foli shkurt për Osmanin. “Janë të pakta fjalët sot në këtë eveniment vërtet mjaft të rëndësishëm, e nisi përshëndetjen e tij zoti Damzi. – Të flasësh për ish mësuesin tim, për njeriun e familjarin model, për intelektualin gjithëplanësh Osman Miha nuk është nevoja të mendohesh gjatë, se fjalët burojnë nga ndjenja e shpirtit dhe zemrës, pasi me punën, sjelljen dhe virtytet e tij, Osman Miha ua imponoi respektin të gjithëve në qytetin e Bulqizës. E prita me shumë dëshirë kërkesën e ardhur nga një grup intelektualësh për dekorimin e Osmanit. Emra të tillë si Osman Miha vetëm nder dhe krenari i japin qytetit tonë.

Folën pastaj Emin Gjapi, ish nëndrejtor shkolle e shok me Osmanin, Hamdi Haka, ish mësues në shkollën e Bulqizës, Agim Totraku, Muharrem Gjoka, Faik Bruçi, Bujar Karoshi, Latif Miha, i cili përshëndeti të pranishmit edhe në emër të familjes.

Në fund, qershia mbi tortë, – siç u shpreh Defrimi, kryetari i Bashkisë Milaim Damzi i dorëzoi titullin e lartë “Qytetar Nderi i Bulqizës” Osman Mihës me motivacionin “Për punë të shquar në minierë dhe gjeologji dhe kontribut të çmuar në arsimin profesional në Bulqizë”.

SKËNDER MURRJA – 40 VJET MËSUES DHE DREJTOR SHEMBULLOR I DISA SHKOLLAVE

- **Karriera e shkëlqyer profesionale dhe intelektuale e mësuesit dhe drejtuesit të talentuar.**
- **Skënder e Nadire Murrja, jo vetëm mësues por edhe bashkshortë e prindër shembullorë, e mbyllën karrierën si mësues, për të mbetur në kujtesën e mijëra nxënësve si përcues të dritës së diturisë, modele frymëzimi për komunitetet ku shërbyen, kërkues dhe të ngritur profesionalisht, ekselentë në fushën e mësimdhënies e të edukimit në përgjithësi**

Në dyzet vjet mësues i lëndës matematikë-fizike dhe drejtor i disa shkollave 8-vjeçare e të mesme, madje dhe drejtor i Drejtorisë Arsimore Bulqzë, Skënder Murrja ka krijuar profilin e një intelektualit me karrierë të shkëlqyer profesionale dhe njerëzore. Gjithkush do të impresionohet nga karriera e tij, nga arritjet inkurajuese në procesin e mësimdhënies e të drejtimit të shkollave me kompetencë e profesionalizëm. Ndaj dhe nuk është e lehtë të shkruash për madhështinë dhe shenjtërinë e këtij mësuesi e drejtuesi shembullor, pasi



duhet t'i qasësh një punë sa të rëndësishme, po aq komplekse në karrirën e tij 40-vjeçare. Kjo edhe për faktin se sapo ishte diplomuar me rezultate të shkëlqyera në Institutin Pedagogjik, dega Matematikë – Fizikë, Shkodër ku studjoi për periudhën Shtator 1966 – Korrik 1968, djaloshit nga Hoteshi i Luznisë të rrethit Dibër, do t'i duhej ta ushtronte profesionin e shumëëndërruar të mësuesit, jo në vendloindjen e tij, por mbi 100 km larg

shtëpisë, në shkollën 8-vjeçare Derjan, Mat. Por, ndonëse në këto kushte, ai që në vitin e parë të punës do të dallohej për rritjen e nivelit metodik dhe shkencor të orëve të mësimit në lëndët matematikë dhe fizikë. Dhe jo vetëm kaq. Mësuesi Skënder Murrja, gjatëdy viteve (01.09.1968 – 15.08.1970) që punoi si mësues i matematikës dhe fizikës në shkollën 8-vjeçare Derjan, Mat realizoi me efikasitet punën e diferencuar me grupet e nxënësve në orën e mësimit dhe jashtë saj dhe ndërkohë ishte një veprimtar i dalluar shoqëror në fshat.

MIRËNJOHJA SI SHPREHJA MË E BUKUR E KARAKTERIT TË NJERIUT

Mirënjohja si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, e ka karakterizuar gjatë gjithë karrierës së tij mësuesin Skënder Murrja. Edhe tani në vitet e pensionit ai vlerëson ndërhyrjen imponuese të ish-shefit të Seksionit të Arsimit Dibrë, Shemsi Manjani, deri në strukturat përkatëse të Ministrisë së Arsimit për t’i transferuar atë dhe disa dibranë të tjerë, nga rrethi i Matit në atë të Dibrës. Kështu Skënder Murrja, vitin e ri shkollor 1970-1971 do ta fillonte si mësues i lëndës së matematikës në shkollën 8-vjeçare “Nexhat Agolli”, Muhurr, vetëm dy orë larg shtëpisë së tij të lindjes. Këtu ai do të spikaste me talentin e tij të rrallë të mësimdhënies me shpirt krijues. Unë kam patur fatin ta kisha mësues atë vit në klasën e pestë, pikërisht në atë moshë kur fitoheshin shprehitë bazë të kësaj lënde kryesore. Si edhe bashkmoshatarët e mi të asaj kohe, Shefqet Mikli, Shefqet Xhani, Flutura Kurti. Haki Xhani, Liman Berisha, Marie Balliu, Ibrahim Doda, Aqif Mikli, Femi Balla, Shefqet Tanushi, Maliq Lleshi, Basri Zhuzhi (si edhe gjithë brezat e rinj që ai mësoi dhe edukoi ndër vite), ndihemi krenarë për të, sepse në gjithë jetën tonë (si nxënës, studentë, mësues, etj.) nuk kemi njohur një mësimdhënës kaq të talentuar si ai, një intelektual kaq të formuar si ai, një njeri si ai, me një vullnet dhe një sistematikë shembullore në studime dhe lexime librash të ndryshëm, jo vetëm të shkencave ekzakte, por edhe të atyre artistikë.

Vetëm tre muaj pasi kishte filluar punën si mësues në Muhurr, (19.11.1970 – 23.11.1972) do të detyrohej të kryete shërbimin e detyruar ushtarak në Korçë, për t’ u rikthyes po në shkollën shkollën 8-vjeçare “Nexhat Agolli”, me energji të reja e dije bashkohore. Kështu në harkun

kohor të tri viteve (04.12.1972 – 29.08.1975) shtoi dhe sistemoi bazën materiale dhe didaktike për lëndët matematikë e fizikë në shkollë dhe ndërkohë u bë shembull për shkollat e rajonit në realizimin e punës së thelluar me nxënësit cilësorë. Në këto vite Skënder Murrja do të ishte shembull i përkryer i bashkëpunimit të ngushtë me prindërit e nxënësve për realizimin e detyrave në shkollë.

KOHA KUR DREJTONTE SHKOLLËN 8-VJEÇARE KATUND I RI, LUZNI

Viti i ri shkollor 1975-1976 do të ishte surprizë për mësuesin Skënder Murrja, pasi për herë të parë që nga mosha e fëmijërisë kthehej në shkollën e vendlindjes. Tashmë më i vlerësuar nga strukturat drejtuese të arsimit në rrethin e Dibrës, do të emërohej drejtor i shkollës 8-vjeçare Katundi i Ri. Falë përvojës si mësues shembullor në Derjan e Muhurr, Skënderi do të ndikonte në krijimin e kushteve të përshtatshme për punën e mësuesve dhe nxënësve në shkollë. Kësisoj, do të rritej niveli i punës kualifikuese në bazë shkolle si dhe të gjitha format e tjera të kualifikimit. Në rolin drejtues, Ai do të ndihmonte dhe kontrollonte njëherazi me nivel të gjithë punën e mësuesve, veçanërisht në orët e mësimit. Këtu Skënder Murrja që kuadër mjaftë serioz, por njëherësh edhe shumë i dashur dhe me një humor gjithmonë të shëndetshëm. Ishte i veçantë, energjik, në sjellje e qëndrime dhe këto dotë ndikonin në arritjen e rezultateve të mira, si në procesin mësimor-edukativ dhe në krijimin e një klime bashkëpunimi efektiv me prindërit e strukturat vendore të pushtetit të asaj kohe. Megjithë kushtet e vështira ekonomike, pasojë e sistemit të ekonomisë së përqëndruar në ish-kooperativën bujqësore, kolektivi mësues-nxënës i kësaj shkolle do të ndikonte dukshëm në elementë të tillë, si në përmirësimin e kulturës së jetesës dhe emancipimin tërësor të shoqërisë së asaj kohe. Dhe jo vetëm si mësues e drejtor shkolle, por Skënder Murrja do të shquhej edhe si nga veprimtarët më të mirë shoqëror. Gjatë atyre vite ai kreu më së miri detyrën e Sekretarit të Komitetit të Rinisë të Luznisë si dhe të anëtarit të Plenumit të Rinisë të rrethit Dibrë.

MËSUES NË FUSHË ÇIDHËN DHE DREJTOR NË LUNARË, SELISHTË

Ndonëse vlerësohej për potencialin intelektual dhe si mësues e drejtues kompetent, edhe Skënder Murrja do të provonte dhe përballonte me dinjitet luftën e bërrylave dhe koniukturat e injorantëve që drejtonin organizatat bazë të Partisë e strukturat e pushtetit. Ish-drejtori i Shkollës 8-vjeçare Katund i Ri, pikërisht kur e kishte bërë këtë shkollë shembull të përvojës së përparuar në gjithë rrethin e Dibërës, do të transferohejmësues në shkollën e mesme të bashkuar Fushë-Çidhën. Por edhe këtu, në harkun kohor të katër viteve (17.08.1977 – 21.08.1981) Ai do të ishte ndër më të mirët e kolektivit pedagogjik të kësaj shkolle, ku për herë të parë, falë shembullit të tij konkret do të realizohej me sukses konkursi mësimor në lëndët matematikë e fizikë për rritjen e qëndrueshmërisë së njohurive të nxënësve, ndëkohë do të aplikoheshin konkluzionet e punëve me shkrim dhe roli i tyre për efektivitetin e formimit të nxënësve. Në këtoi vite do të evidentoheshin kujdesi i shtuar i mësuesit Skënder Murrja në gjithë veprimtarinë e punës me nxënësit e mbrëmjes për një formim sa më të plotë të tyre. Dhe pikërisht, në vlerësim të aplikimit të metodave të avancuara në procesin mësimor si dhe të vizionit të tij për një sistem arsimor bashkohor, Skënder Murrja do të emërohej drejtor i shkollës së mesme bujqësore Lunarë, Selishtë, ku për shtatë vite të drejtimit të saj (22.08.1981 – 30.08.1988)do ta bënte atë shkollë, model në rang kombëtar. Me ideimin e Seksionit të Arsimit, do të vinin në këtë shkollë për të marrë përvojë, mësues e drejtorë të disa shkollave të rrethit përta i përket ndërtimit të kabineteve mësimorë për cdo lëndë e grup lëndësh, veçanërisht për lëndët bujqësore; përhapjen e eksperiencës së përparuar të lidhjes së teorisë me praktikën në lëndët bujqësore nëpërmjet seminarit me drejtuesit e shkollave të rrethit Dibër; realizimin e treguesëve të planit ekonomik-financiar të bazës prodhuese të shkollës në kushtet e terrenit dhe të klimës, si dhe për promovimin e vlerave më të mira folklorike të zonës nëpërmjet grupit artistik të shkollës.

Dhe megjithë këto arritje, sërish do të viktimizohej nga lufta e bërrylave dhe koniukturat e kuadrove mediokër vendas, për ta kaluar mësues në shkollën 8-vjeçare Selishtë (31.08.1988 – 20.08.1990), ku edhe këtu, pa u demoralizuar ai dallohet për nivelin e lartë profesional të mësimdhënies.

22 VJET NË BULQIZË-EMRI I MIRË QË LA SKËNDER MURRJA SI MËSUES E DREJTUES NË SEKTORIN E ARSIMIT

Përkushtim dhe vetëm përkushtim, durim dhe vetëm durim, dashuri dhe pasion për profesionin e bukur të mësuesit... Vetëm kështoj Skënder Murrja eci suksesshëm në këtë mision fisnik edhe gjatë 22 viteve të fundit të karrierës së tij si mësues e drejtor në shkollë të qytetit të Bulqizës. Pasi kishte shërbyer me përkushtim e devotshmëri në disa shkollë të rrethit të Dibrës, pas '90-tës kur nis edhe ndryshimi i sistemit politik e për rrjedhojë edhe i atij arsimor në vendin tonë, Skënder Murrja transferohet në shkollat e Bulqizës. Edhe këtu ai shpalos rrugëtimin shumëvjeçar të punës së tij edukativo-arsimore, përvojën jetësore të mbushtur me mbresa dhe emocione. Kështu, nga viti 1990 deri më 1993, kur shërbeu si mësues dhe zëvendës drejtor në shkollën 9-vjeçare "Shefqet Tançi" Bulqizë. Ai do t'ju dhuronte nxënësve dhe kolegëve, por edhe prindërve dashuri e ngrohtësi, buzëqeshje e çiltërsi, kënaqësi e drejtësi, mësim e dituri, shkathtësi e lumturi. Me moton: para se të jemi mësues të mirë e të dalluar, duhet të jemi edukatorë të mirë, të luajmë rolin e prindit, psikologut, pedagogut, po pse jo nganjëherë edhe të artistit, Skënder Murrja ia doli të fitojë respektin maksimal të komunitetit. Sepse me punën, përkushtimin e profesionalizmin e spikatur ndikoi në ngritjen e nivelit të mësimdhënies veçanërisht në lëndën e fizikës nëpërmjet shtimit të bazës materiale – didaktike për realizimin e eksperimenteve për çdo orë mësimi. Po ashtu edhe në rritjen e nivelit të testimit të nxënësve në përputhje me objektivat lëndore dhe përcaktimin e detyrave konkrete në punën me nxënësit. Do të ishte Skënder Murrja që do të fuste në këtë shkollë koncepte më të avancuara nga programet e kolegjeve në punën me nxënësit cilësorë për të përballuar me sukses konkurset në bazë shkollë, rrethi dhe kombëtare.

Me të njëjtin përkushtim e profesionalizëm do të shërbente S.Murrja edhe si drejtor në shkollën 9-vjeçare "Xhevdet Doda" Bulqizë (13.09.1999 – 08.06.2003).

Strukturat drejtuese të arsimit në qarkun e Dibrës dhe rrethin e Bulqizës do ta përgjithësonin këtë shkollë si qendër të rëndësishme për shkollat e tjera të rrethit Bulqizë për edukimin e të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve. Po ashtu ato do të evidentonin rolin e drejtorit S.Murrja në rritjen e aktiviteteve mësimore dhe artistike në funksion të edukimit dhe

mësimit; për veprimtaritë cilësore kualifikuese për të ngritur nivelin e mësimdhënies në një standard të ri në luftë me praktikatat e prapambetura si dhe për standartizimin e bibliotekës së shkollës, rritjen e numrit të librave si bazë e rëndësishme për lexuesit nxënës e mesues, për përmirësimin e punës në shkollë.

Pikërisht mbi bazën e këtyre arritjeve ai do të ngjiste shkallarën e karrierës së tij deri Drejtor i Drejtorisë Arsimore të Rrethit Bulqizë (09.06.2003 – 30.04.2004) dhe Inspektor i Matematikës dhe Fizikës në Zyren Arsimore Bulqizë (01.05.2004 – 16.09.2004). Në këto funksione drejtuese ai do të dallohej për takime efektive me të gjithë mësuesit në të tetë zonat e rrethit për të tërhequr mendimin e tyre për pyetjen: Çfarë mendoni ju se duhet bërë më mirë në shkollë, arsim dhe mbi këtë bazë në përcaktimin real të objektivave mësimorë e edukativ në shkollë rrethi, për të ngritur përmbajtjen e punës në nivel të ri, për t’ju përgjigjur si duhet kërkesave në rritje në arsim.

Nga strukturat përkatëse drejtuese në qarku e Dibrës e Bashkinë e Bulqizës S.Murrja do të vlerësohej për rritjen e nivelit në formë e përmbajtje, të punës së komisioneve kualifikuese në bazë shkolle e rrethi, për t’ju dhënë zgjidhje problemeve të përmbajtjes së punës me nxënësin. Si ekspert shembullor ai do të ndikonte edhe në ngritjen e nivelit të veprimtarive me nxënësit cilësorë për t’ju përgjigjur me sukses kërkesave në arsimin e mesëm dhe të lartë. Ndërkohë do të realizonte studimin e mirëfilltë të punës me kuadrin për t’ju përgjigjur në kohë e me cilësi kërkesave të punës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

SKËNDER MURRJA “QYTETAR NDERI” I BASHKISË BULQIZË

Gjatë karrierës së tij 42 vjeçare si mësues dhe drejtues në disa shkolla e institucione arsimore, Skënder Murrja ka marrë vlerësime maksimale, deri edhe nga Ministria e Arsimit. Kështu, më 16.04.1984 ai është vlerësuar nga Ministrja e Arsimit Tefta Cami me Distinktivin “Mësues i Dalluar”, me motivacionin: “Përpërgatitjetë mirë ideologjike, shkencore e pedagogjike, për punët ndërgjegjeshme dhe për arritjet e larta në procesin mësimor-edukativ. Më 01.04.2002. ka marrë Certifikatën: “Shkolla pilot në Edukimin e të Drejtave të njeriut, një eksperiencë e re pune” nga Drejtore ekzekutive e QSHDNJ Kozara Kati dhe Drejtore e IS: Erlehta Mato.

Skënder Murrja është vlerësuar edhe me Certifikatën “Për kontributin e dhënë në lëvizjen sindikale në arsim” (më 26.04.2016.) nga Kryetari i FSASH Xhaferr Dobrushu. Për 11 vite (2008-2019) ka qenë Kryetar i FSASH (Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës) për bashkinë Bulqizë.

Pikërisht për këtë kontributin madhor në edukimin e brezave, Këshilli i bashkisë Bulqizë, me Vendimin Nr.40, datë 05.06.2024, i ka dhënë Skënder Murrës Titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Bulqizë, me motivacionin:

“Për kontributin si mësues dhe drejtues me kompetencë dhe profesionalizëm i disa institucioneve arsimore në Bulqizë, ku është dalluar për nivelin e lartë të mësimdhënies, marrëdhënie shembullore me komunitetin dhe për vlerat e tij të spikatura intelektuale dhe njerëzore”



DRITAN JASHARI - “KJO ËSHTË DIBRA MAJA-MAJA”

- **Dritan Jashari “princi” i “Odës Dibrane”- Shembull i përkryer i një artisti që di të shpalosë pastër vlerat dhe traditat e një kombi**

Në edicionet e fundit të Festivalit Mbarëkombëtar “ODA DIBRANE”, ka spikatur edhe spikati zëri brilant i artistit të mirënjohur Dritan Jashari, në interpretimin e këngës “Fluturo shqipe mbi Korab”. Vargjet e saj: “*Sillu shqipe nga Kalaja/ Kjo është Dibra maja – maja/ Dibra pushkën e ka zanat/ Për shqipëri e për bajrak...*” janë vargje plot jehonë atdhedashurie, që zor se mund t’u shkojnë më shumë se viseve të Dibrës.



Më mirë se kushdo tjetër e përcjell jehonën e Nëntë Maleve kreshnike e hijerëndë të Dibrës këngëtari virtuoz Dritan Jashari në disa albume, koncerte e festivale. Degjon këngët e tij dhe ndjen sikur lugina të thella zbresin në zemër të dheut, por edhe në fushore të hapura e gjalluese. Korabi, mali më i lartë i kombit përjetësohet në vargjet lapidare “Fluturo shqipe mbi Korab”, jehona e të cilave përhapet alpeve, ngjitë qiellit përpjetë. Kënga epike e interpretuar mjeshtërisht nga Tan Jashari, pikërisht edhe këtu në “Odën Dibrane” që bashkon në një festë të vërtetë artistike popullore, artistë dhe studjues nga të gjitha trevat shqiptare, për momentin të çon mbi ato lartësi që duken si kreshnikë viganë, ngjeshë sup më sup, si dibranët ndër shekuj përballë armiqve të shumtë. Në repertorin e këtij këngëtari gjejmë legjendat, baladat e mitet, meloditë e këngët e pashtershme që u bëjnë jehonë shkëmbinjve borëbardhë dhe ujëvarave jetëdhënëse të kullotave alpine.

Me një finesë që i shkon vetëm elegancës së një artisti të mirënjohur,

Dritan Jashari pëlqehet nga publiku në interpretimin e këngëve “Për Mahmut Dac Kalisin”, “Cuca vesh fustan jeshile”, dy këngë të punuara në Shkup: “Deri në mëngjes” dhe “Rruga e kurbetit”, e shumë këngë të tjera.

Në këngët e tij ndjehet gurgullima e burimeve, një simfoni tingujsh të përcjella nga instrumenta muzikorë orgjinalë të artistëve dibranë. Ky artist virtuoz ka magjepsur spektatorët e shumtë edhe nga interpretimi i këngës për Iljaz Qokun “Lum për djemtë që rriti Dibra”. Po ashtu dhe me klipin e këngës “Cen Elezi, shkamb i Korabit”.



“FLUTURO SHQIPE MBI KORAB”

Kulmin e vet artisti dibran e ka shënuar me “Fluturo shqipe mbi Korab”, këngë kjo që sjell dijamante të vërteta nga folklori i zonës së Dibrës. Kjo këngë e interpretuar me vyeritë nga Tan Jashari ka ngritur peshë zemrat e mijëra spektatorëve në koncertet-recital të tij në Peshkopi, Tiranë, Dibër të Madhe, Athinë, Selanik, Austri, Itali etj. Padyshim që sukcesi është meritë e vetë artistit që përpos zërit melodioz është dhe studjues skurpuloz i traditës popullore dibrane e të krejt Veriut.

Shpirti i artistik, midis epikës dhe lirikës popullore derdhet fare qartë në interpretimin e këngës “Për Zall Dardhën” të autorit Hajri Mandri: “Bijt e mëndjes, bijt e Dijes/ Kan dal nga Zall Dardh e Dibrës....”, si dhe në këngët e para të publikuara në albumin e parë “N’daç me naze”. Repertori i pasur dhe i larmishëm i Tan Jasharit dëshmon se ai i përmbahet me fanatizëm ruajtjes së orgjinalitetit të kulturës së tyre. Mjafton qoftë dhe vetëm albumi

i fundit i titulluar “Oda Dibrane” për të kontastuar interpretimin brilant me finesë e elegancë nga Tan Jashari, ku si më të spikaturat janë këngët: “Krah për krah Dibra e Kosova”, “Lum për djemtë që rriti Dibra”, Gurët e Sokakut”, “Këngën shqipe këndoj më mall”, “Rruga e Kurbetit” etj.

Nga repertori i Dritan Jasharit veçojmë gjithashtu këngën: “Dil në fushë të Torviollit/ ku ndrin shpatë e Kastriotit/ Vjen një za sa tundet dheu, këtu i ka trojet Skënderbeu.....”, që i shkon për shtat folklorit të kësaj zone. Po në këtë linjë ai evidenton edhe këngën aq të njohur por disi e lënë mënjanë për vite të tëra për Mahmut Dac Kalisin.

Në albumet e Tan Jasharit gjejmë interpretime autentike që sjellin dëshmi të tjera të orgjinalitetit të kësaj trashëgimie shpirtërore të pashtershme, si tek: “Dil n’konak t’Lidhjes së Prizrenit/ Iljaz Dibra n’krye të vendit/ Bëjnë kuvend si e do vatani/ Sheh Bulqiza e Sheh Zerqani...”.Të interpretuara mjësthtërisht këto vargje janë përcjellur me kureshtje dhe mirëpitur tek adhuruesit e folkut. Po ashtu edhe vargjet: “Hej Dibër t’bën drit oda/ Hije t’ka pushka e sofa/ O bashkon zemrat prej çdo ane/ O mirë se vini në Odën Dibrane...”

Gjejmë gjithashtu në repertorin e Tan Jasharit edhe këngë që kanë sjellur intonim lirik popullor me motive lirike dhe pos këngëve të cilat janë shumë të dëguara dhe të adhuruara një vlerësim i është dhënë edhe për interpretimin e tyre mjëstëror. Dritan jashari, me përvojën e tij, si gjithnjë impulsiv, sjell dëshmi prej një këngëtari që këndon me zotësi dhe bukuri këngët paksa më të vështira për interpretim, këngë me motive kombëtare si ajo e titulluar “Krah per krah Dibra e Kosova”.

Me përgjegjësi profesionale mund të them se ky artist është atraktiv pasi sjell pjesë të fshehura të thesarit nga folklori ynë i vjetër dhe i pasur, imponuar kjo nga dasitë me kufinj të dhunshëm dhe të pamerituar.

“KRAH PËR KRAH DIBRA E KOSOVA”

Dritan Jashari ka edhe një veçori tjetër, pasi në repertorin e tij gjejmë një larmi të gjerë gjeografike. Pa këto këngë nuk imagjinohet dot folklori dibran dhe i Veriut në tërësi, si frymëzim nga letërsia popullore. Ndaj dhe Tan Jashari ka kënduar me përkushtim nga zemra, shpirti dhe zëri këngën “Krah per krah Dibra e Kosova..” që simbolizon unifikimin kombëtar në ide si fuqi primare për të mirën e vet kombit.

Duke patur një pozicion të tillë gjeografik që përkufizohet me Kosovën dhe lidhje të afërta kulturore që ka, të gjakut dhe shpirtit, dibranët kanë kënduar edhe këngë me motive bashkimi dhe jo ndarjeje, siç ishte deri më 1999, kur Kosova u çlirua. Falë pasionit dhe talentit dhe mbi të gjitha përkushtimit maksimal D.Jashari ka një repertor për paraqitje dinjitoze në të gjitha trevat shqipfolëse, brenda e jashtë vendit, duke synuar përfaqësim sa më të plotë të vlerave të kulturës sonë popullore.



Në këtë repertor artisti sjell përveç kumtit të luftës, edhe momentet solemne të dasmave, apo ngjarjeve të tjera të gëzueshme të njeriut, përfshi edhe përkujtimin e një të vrari në luftë apo një vdekjeje e ngjashme tragjike. Këto këngë, me karakteristikat e tyre jo vetëm me tone burrërore por edhe me specifika të një treve të gjerë me shqiptarë dëshmuar etnicitetin dhe zanafillën apo burimin e tyre original prej kombit që i përkasin, pa elemente ndërhyrëse sllave në këndim. Në repertorin e tij ka një numër të madh këngësh epike, duke qenë nga këngëtarët më të suksesshëm të trevës së Veriut, i vlerësuar me mjaft çmime e diploma të ndryshme, në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare. Në gjerdanin e artë të këtyre çmimve ndrit “Mirënjohja për këngën dibrane” nga Festivali “Oda Dibrane”.

Dritan Jashari demonstroi vlera. Ai është shembull i përkryer i një artisti që di të shpalosë pastër vlerat dhe traditat e një kombi.

HALIL RAMA

III

NË USHTRINË SHQIPTARE DHE FATË
RSH

DALI NDREU, STRATEGU QË DREJTOI LUFTËN PËR ÇLIRIMIN E TIRANËS

- Në krye të Korparmatës së I-rë, gjeneral - major Dali Ndreu, drejtoi mjeshtërisht veprimet e njësiteve luftarake të shumta për çlirimin e Tiranës, njëherazi ato për çlirimin e Lezhës dhe të Shkodrës etj, deri në çlirimin e plotë të të gjithë Shqipërisë

Historiografia e sistemit monist për tri dekada (1960-1990) shtrembëroi të vërtetat e një prej epopeve më të lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, siç ka qenë beteja për çlirimin e Tiranës. Nën diktatin e nomenklaturës së kohës që synonte zhbërjen e familjeve të mëdha, siç qe ajo e patriotit Elez Isuf Ndreu e Sllovës së Dibrës, u fshi qëllimisht nga historiku i asaj lufte heroike emri i gjeneral – major Dali Ndreut, si drejtues i saj.



Në jubileun e 75-vjetorit të çlirimit të Tiranës, qe prof.dr.Paskal Milo ai që pohoi të vërtetën e pamohueshme të drejtimit të betejës legjendare për çlirimin e kryeqytetit shqiptar prej pushtuesit nazifashist nga general-major Dali Ndreu. Pas shtrembërimeve të qëllimshme nga historiografia komuniste, ky është ndoshta rasti më konkret ku hidhet dritë për një akt kaq madhor. Gjatë një interviste televizive, historiani Milo ndër të tjera tha se: *“Urdhëri për realizuar betejën për çlirimin e Tiranës, u dha në fundit e tetorit të vitit 1944 nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, për t’u zbatuar nga Korparmata e I-rë me komandant Dali Ndreun, ku në përbërjen e saj ishin disa brigada. Lufta për çlirimin e Tiranës ishte pa dyshim një luftë shumë strategjike, se atëherë kur çlirohet qyteti i një vendi është simbol i çlirimit të gjithë vendit”.*

Këtë të vërtetë historike e argumenton më së miri historiani i mirënjohur, Milo, i cili e vlerëson luftën për çlirimin e Tiranës si betejën më të madhe të luftës Nacionalçlirimtare, që kurorëzoi atë fitore, që 12 ditë më pas do t'i vinte vulën çlirimit përfundimtar të Shqipërisë. Dita kur trupat gjermane tërhiqeshin drejt Tiranës dhe u zunë në pritë nga forcat partizane, duke ndezur një betejë gjaku e zjarri për 24 orë rresht, përfundoi me bilancin tragjik të humbjes së jetëve të 2000 ushtarëve gjermanë dhe të afërsisht 300 partizanëve.

Në çdo përvjetor të çlirimit të Tiranës nga okupatori nazifashist shqiptarët kujtojnë me nderim e respekt të veçantë ata që ideuan, drejtuan dhe realizuan fitoren e asaj beteje legjendare, heronjtë dhe dëshmorët e saj. Dhe padyshim edhe strategun e kësaj lufte, komandantin legjendar Dali Ndreu.

DALI NDREU, FIGURA NUMËR DY E LUFTËS PARTIZANE

Për vëtë postet drejtuese, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare deri zëvendëskomanadant i Shtabit të Përgjithshëm, general- major Dali Ndreu, njihet si numri dy i ushtrisë partizane. Kjo edhe për faktin se ka drejtuar me guxim, trimëri e largpamësi disa beteja duke trimfuar ndaj pushtuesit nazifashist të vendit.

Ai ka lindur në Sllovë të Dibrës më 10 mars 1912, në mesin e familjes së madhe të patriotëve Elez Isufi e Sufë Xhelili, të njohur si prijësit legjendarë të luftës 9-vjeçare (1913-1921) të dibranëve kundër shovinistëve serbë.

I biri i Isufit dhe Xhevrijes, i lindur, rritur dhe edukuar në këtë mjedis atdhetarësh do të krijonte një karrierë të shkëlqyer intelektuale e akademike.

Më 1931, pasi kreu studimet në Shkollën Ushtarake të Plotësimit si oficer artilerie u gradua nëntoger. Fillimisht shërbeu në degën e rekrutimit në Përmet, më pas në artilierinë e divizionit “Kosova” deri më 1933.

Pasi kishte rënë në kontakt me lëvizjen komuniste të asaj kohe, u anëtarësua në Grupin e Tiranës të themeluar dhe drejtuar nga arsimtari Hasan Reçi, ku merrnin pjesë shumë oficerë. Ai është në radhën e atyre përparimtarëve të asaj kohe që u dënuan si organizatorë dhe përkrahës të Kryengritjes së Fierit më 1935. Pikërisht atëhere u shkarkua

si oficer.

Pinjulli i familjes së ndritur të Elez Isufit, i zellshëm për të rritur nivelin arsimor, pas daljes nga burgu, vijoi studimet për Shkenca Ekonomike në Firence.

Në vitet 1940-1941 inkuadrohet në radhët e formacioneve partizane. Ai dha kontribut të veçantë në ngritjen e strukturave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, pasi kishte aftësi të spikatura drejtuese dhe organizuese. Siç shkruan dr.Vangjel Kasapi:“Në prill të 1942-shit, para Konferencës historike të Pezës, në Sllovë të Dibrës formohet njësi luftarak, që u rrit në çetë me komandant Dali Ndreun. Kudo në aksione shquhet për trimëri, sidomos për aftësi drejtuese ushtarake. Falë origjinës së familjes, për kontribute të spikatura atdhetare-luftarake, dije profesionale, trimëri, drejtësi, gjakftohtësi dhe komunikim të mirë me njerëzit, prej nga gëzonte ndikim të ndjeshëm në popull, në mbledhjen për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-së, Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar e zgjedh Daliun anëtar dhe zëvendëskomandant të këtij institucioni strategjik ushtarak.

Pas major Spiro Moisiut (komandant), Dali Ndreu vinte figura numër dy ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të Luftës dhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kjo u vlerësua si një ngjitje e madhe e dibranit 31-vjeçar. Gjatë përzgjedhjes u vlerësuan aftësitë e shumanshme ushtarake, karakteri i paepur, maturia dhe pjekuria për gjykimin e situatave, në përpunimin dhe marrjen e vendimeve”.

Për meritat e tij, bazuar edhe te kontributi historik i familjes, me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare caktohet zëvendëskomandant i Shtabit, pra figura numër dy e luftës partizane. Por njëherësh shquhet si një komandant i zoti me aftësi dhe reputacion.

Brigada e III-të Sulmuese ishte formacioni ushtarak që ai drejtoi në fillimet e Luftës Nacionalçlirimtare.

Pas 24 Majit 1944 drejtoi Divizionin e I-rë Sulmues. Me vendimin nr.11, të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, propozuar me shkresën nr.226, datë 16.8.1944, Dali Ndreu gradohet nga “kolonel” në “gjenral-major”.

Nga 18 gusht 1944, drejtoi Korparmatën e I-rë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, i pari dhe më i madhi i formacioneve

ushtarake deri atëherë.

Në krye të Korparmatës I-rë, ai drejtoi mjeshtërisht veprimet e njësiteve luftarake të shumta për çlirimin e Tiranës, njëherazi ato për çlirimin e Lezhës dhe të Shkodrës etj, deri në çlirimin e plotë të të gjithë Shqipërisë.

Si udhëheqës i lartë ushtarak, një nga personalitetet e Luftës e të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ai zgjodhi e mbajti një qëndrim shumë të arsyeshëm në marrëveshjet me aleatët ushtarakë të Koalicioni Antifashist Botëror. Anëtari dhe zëvendës i Shtatmadhorisë, komandanti strategjik dhe gjeneral, Dali Ndreu mund të konsiderohet në historiografinë ushtarake të LANÇ-it e të UNÇSh-së, autori i parë i përgjithësimit shkencor dhe i botimit në shtypin ushtarak (gazeta “Luftëtari”, 1945-‘47, sidomos i tri operacioneve më të mëdha operative-strategjike: thyerja e mësymjeve të përgjithshme naziste të dimrit (1943-44) e të verës (1944) dhe të operacionit mësymës për çlirimin e kryeqytetit – Tiranës, kur autorë të tjerë, gjeneralë e studiues nuk ishin shfaqur në mënyrë kaq sintetizuese në opinion publik, ndonëse më vonë ata i zgjeruan e i thelluan ato operacione madhështore të historisë moderne ushtarake të popullit dhe ushtrisë shqiptare.

Por kuçedra që menjëherë pas çlirimit filloj të hajë bijtë e vetë, do t’i vërsulej pabesisht dhe egërsisht edhe drejtuesit të luftës partizane Dali Ndreu. Strategu që kishte shërbyer në formacionet e Dibrës dhe të Tiranës, ish- anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NAÇL dhe numri dy i saj; ish komandant i Brigadës së Parë, komandant i Divizionit të Parë dhe komandant i Korpusit të Parë deri në çlirimin e vendit dhe pas çlirimit Komandant i Prapavijës në Ushtri, ish- deputeti i parë i Dibrës në legjislaturën e vitit 1945, ndërsa në administratën shtetërore të pasçlirimit zëvendësministër – njëri nga tre gjeneralët e asaj kohe (përveç E.Hoxhës dhe Spiro Moikut), pikërisht Ai, që në korrik të vitit 1945, ishte dekoruar me medaljen më të lartë të asaj kohe, “Ylli Partizan” të Klasit I-rë, dhjetë vjet më vonë, në vitin 1956 arrestohet në bahçen e tij në Sllovë, për t’u dënua dhe pushkatuar pas një procesi të montuar politik më 25 dhjetor 1956, sëbashku me Liri Gegën, bashkëshorten e tij.

GENOCIDI I PASHSEMBULLT – LIRI GEGËN E PUSHKATUAN SHTATZËNË DHE IA DOGJËN ESHTRAT ME ACID

Kanë kaluar 68 vite që nga dita më e kobshme e jetës së saj, por Lavdie Merlika-Ndreu, vajza e vetme e Dali Ndreut e Liri Gegës, që aktualisht jeton në Laprakë, e ka të ngulitur në memorie ndarjen tragjike me prindërit e saj: çastin e arrestimit, lajmin për vdekjen e tyre dhe pushkatimin e nënës shtatzënë. E rritur me brengën dhe dhimbjen e tyre, kujton se ka qenë vetëm tetë vjeçe atëherë, por i mban mend me detaje rrethanat e tragjedisë dyfishë.

“Sa kishim shkuar te xhaxhai në Sllovë, kur erdhën dhe i arrestuan papritur. Thanë se i kapën në kufi duke u arratisur. Pas tre muajsh mbërriti lajmi se i dënuan me vdekje si armiq të popullit”, kujton ajo.

Ndërsa në dokumentet e Sigurimit rezulton se prindërit e saj, dy nga personazhet e njohura të lidërshiptit komunist, janë pushkatuar në të njëjtën ditë, me akuzën për tradhti ndaj atdheut dhe tentativë arratisjeje për të kaluar kufirin për në Maqedoni, Lavdia thotë se ky është një mashtrim i paskrupullt. “Ata janë arrestuar në oborrin e shtëpisë së xhaxhait, në Sllovë të Peshkopisë. A mund t’i thuash kufi shtetëror portës së gjyshit ku kishim shkuar për të qëndruar disa ditë?! Marrëzi, marrëzi pa fund... Atë skenë e kam parë nga afër. Atëherë isha tetë vjeçe. Arsyja që kishim shkuar në vendlindjen e prindërve në Sllovë lidhej me shëndetin e vëllait, Sokolit. Ai ishte dy vjeç dhe vuante nga një sëmundje kronike. Ishte kuruar për të disatën herë në spitalin e Tiranës. Mjekët më në fund kishin rekomanduar të frekuentonte klimë malore. Pas konsultës me ta, prindërit vendosën të shkonim në Sllovë. Aty kemi mbërritur një natë para se t’i arrestonin”, kujton Lavdia me sytë e përlotur. Sot ajo është bërë gjyshe dhe kujton gjithë genocidin që kaloi familja e saj dhe gjithë fisi emërndritur Ndreu i Sllovës.

Me prindërit është ndarë kur ishte tetë vjeçe. Asokohe jetonin në katin e dytë të një shtëpie private te Rruga e Kavajës. Dali Ndreu e Liri Gega kishin ardhur aty fill pas luftës. “Babai, me sa mbaj mend, ishte drejtor i ndërmarrjes së ndërtimit, po shpesh i flisnin gjeneral. Mamaja punonte mësuese në shkollën pedagogjike te Rruga e Elbasanit. Unë vazhdoja shkollën te ‘Hasan Vogli’. Si fëmijë, kuptohet nuk kisha si t’i dija peripecitë

që kishin kaluar prindërit deri atëherë. Ajo që ndieja ishte rrallimi i vizitave të miqve dhe shokëve të tyre, të cilët dikur hynin e dilnin shpesh”,-kujton Lavdia. Por gjithsesi, nga memoria e saj nuk shqitet momenti i arrestimit të prindërve. “Teksa rrija e shtangur para gruas së xhaxhait, dëgjova zërin e mamasë që i thoshte: Amanet djalin, Sokolin! Sakaq, u hodh babai qortueshëm: Amanet Lavdijen, se ajo do t’i mbajë mend të gjitha! Kaq ishte gjithçka. Ku ta dija se ai do të ishte komunikimi i fundit me ta. Tek u ndamë, i ndoqa me sy derisa i futën forcërisht në makinë. Deri në fund mamaja nuk i shkëputi sytë nga unë...”.

Rrëfim vërtetë tronditës i vajsës së një prej gjeneralëve më të shquar të LANÇ-it. Dali Ndreu dhe bashkëshortja e tij Liri Gega u eliminua nga diktatori E.Hoxha me skenarin ogurzi të tradhtisë ndaj atdheut. Diktatori shihte ëndërra me skenarë të sajuar për rrëzimin e tij nga fronti, ndaj dhe nuk nguroi të shpallë armiq e të eliminojë një nga një ish – gjeneralët që organizuan dhe udhëhoqën Luftën e lavdishme nacionalçlirimtare. Vetëm një mendje e çmendur mund të shpallte “agjent të Beogradit” dhe me këtë akuzë absurde të ekzekutonte një gjeneral të shquar si Dali Ndreu, pinjoll i një fisi të madh dhe të njohur për tradita patriotike. Dhe për më tej të arrinte deri na aktin makabër të ekzekutimit të nënës shtatzënë (me fëmijë në bark) Liri Gega dhe të djegies së eshtrave të saj me acid...

DALI NDRU, NGA “ARMIK I DIKTATURËS” SOT “NDERI I KOMBIT”

Më 15 gusht 2007, në Qendrën Kulturore të Ushtrisë Tiranë (ish-SHQUP), u organizua ceremonia e dekorimit të Gjeneral Dali Isuf Ndreu, me Urdhërin e lartë “Nderi i Kombit” (pas vdekjes), akorduar nga ish-Presidenti i Republikës, SHT Z. Alfred Moisiu, me dekret Nr 5403, datë 17.07.2007. Ceremonia u organizua nga Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ-it. Në këtë ceremoni ku morën pjesë personalitete të larta politike të asaj kohe, deputetë e oficerë madhorë, miq dhe të afërm të familjes Ndreu, mbi jetën dhe aktivitetin e gjeneral Dali Ndreut, foli Heroi i Popullit, gjeneral-lejtënant Rrahman Parllaku. Mbi të gjitha, Parllaku evidentoi rolin determinant të gjeneral-major Dali Ndreut në luftën për çlirimin e Tiranës.

“Drejtimi i Operacionit iu ngarkua komandës së Korparmatës së Parë

me komandant gjeneral Dali Ndreun, e cila krijoi një grup operativ për drejtimin e luftimeve në kryeqytet. Për zhvillimin me sukses të operacionit, Komanda e Përgjithshme i dha në vartësi Korparmatës së Parë, përveç tri brigadave: I, IV dhe III, edhe brigadat e XV dhe XXIII.” -tha ndër të tjera gjeneral Parllaku në atë ceremoni mbresëlënëse, ku me propozimin e tij, Dali Ndreu, i dënuar dhe ekzekutuar tragjikisht nga diktatura komuniste, tashmë do të shpallej “Nderi i kombit”. Dhe duke rrëfyer të vërtetat e LANÇ-it Parllaku vijoi: “Kush e ka drejtuar këtë luftë?! Mos vallë “jashtëtokësorët”, pasi nuk ka asnjë emër komandanti nga Korparmata, grupi i drejtimit direkt të luftës në qytet dhe të asnjë komandanti të 11 brigadave!!!! Për mua nuk përbën ndonjë çudi, por ndonjë i ri ose persona që e dinë se njësitë e repartet në luftë komandohen, duan të dinë se kush ka qenë në krye të këtyre reparteve. Prandaj nuk përmenden emrat e gjeneral Dali Ndreut – komandant i Korparmatës I-rë, që drejtoi operacionin për çlirimin e Tiranës, Mehmet Shehut –komandant i divizionit dhe drejtues i shtabit të këtij operacioni, si dhe emrat e drejtuesve të tri brigadave që vepruan direkt dhe drejtuan me mençuri, largpamësi, guxim e heroizëm luftimet e kryeqytetit, si: Muhamet Prodani, Arif Hasko, Nexhip Vinçani, Pëllumb Dishnica, Qazim Kondi e Bajram Sinojmeri. Të tillë kanë qenë edhe drejtuesit e 8 brigadave të tjera, po edhe emrat e tyre nuk përmenden.”

Do të duhej kjo dëshmi e legjendarit në kufirin e dy kohëve, Rr.Parllaku (i cili fatmirësisht jetoi një shekull dhe la të shkruar të vërtetat e pamohueshme të LANÇ-it), për të hedhur dritë mbi të vërtetën e organizimit e të drejtimit të betejës për çlirimin e Tiranës dhe për vlerësimin e komandantit të kësaj beteje Dali Ndreu, duke i dhënë atij dekoratën e lartë “Nderi i Kombit”. Dali Ndreu ishte një yll që shkëlqeu në vargun e personaliteteve ushtarake shqiptare, por që, për fat të keq, u fik shpejt, atëherë kur mund të ndriçonte më tepër.

NDERIMI PËR ISH-KOMANDANTIN E FRONTIT VERILINDOR ISMAIL SHULKU

- **BAJRAM MANE:** “Ismail Shulku qëndron në majën e piramidës së elitës ushtarake shqiptare”



“Ismail Shulku - Simboli i ushtrisë dhe krenarisë”, ishte titulli i dokumentarit që u promovua në një nga sallat më luksoze të FSHF në Stadiumin "Air Albania" Tirana. Dhjetra ushtarakë të niveleve të larta të kohës kur kolonel Shulku shërbeu si komandant i njësive kryesore ushtarake, mes të cilëve ish-zëvendësministri i Mbrojtjes Bajram Mane, gjeneralët Perlat Sula, Xhemal Gjunkshi e Piro Ahmetaj ndoqën me interes të veçantë dhe vlerësuan dokumentarin e përgatitur me profesionalizëm e nivel të lartë ideor dhe artistik, nga mjeshtri i gazetarisë sportive Defrim Methasani dhe operatori Agron Hoti.

Pikërisht në këtë sallë të FSHF, numri dy i së cilës është djali i komandantit “Mjeshtri i Madh” Ilir Shulku, u ndje fuqishëm jehona e asaj ceremonie mbresëlënëse që vetëm para pak ditësh u organizua në qytetin e Peshkopisë, ku Kolonel Ismail Shulku – ish-komandant i Frontin Veri-

Lindor dhe zëvendës i Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, si dhe nënkryetari i OBVL-së Muharrem Gjoka, u vlerësuan për kontributin e tyre mbi 50 vjeçar, me titullin “Nderi i Qarkut Dibër”.

Sërish, këtu, në zemrën e metropolit shqiptar, për të nderuar komandantin kishin ardhur kryetarja e Këshillit të Qarkut Dibër, Valentina Haliti Doda, prefekti i Dibrës Nexhbedin Shehu, si dhe disa personalitete tjera dibrane.

Gjithkush pushtohet nga emocione të forta, kur komandant Ismailit, i jepet dekorata “Nderi i Qarkut Dibër”, nga numri një i Këshillit të Qarkut dhe Prefekti i Dibrës, me motivacionin: “Për kontribute të shquara në reformimin dhe konsolidimin e strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut”.

Pikërisht këto kontribute vlerësohen maksimalisht nga të intervistuarit në dokumentarin “Ismail Shulku - Simboli i ushtrisë dhe krenarisë”. Skenaristi dhe realizuesi i këtij dokumentari mjaftë kompetitiv nuk ka “përtuar” ta shoqërojë komandantin në qytetet e Gramshit e Burrelit, ku ndjen nostalgji dhe njëherësh krenari për kohën kur shërbeu para pesë dekadash. Pikërisht këtu ka, ikona e gazetarisë sportive dhe e dokumentarit televiziv, Methasani ka ditur të përveçojë mesazhet frymëzuese të bashkëkohësve të tij.

Në Gramsh ku ka qenë komandant brigade, në vitin 1974, pasi kishte kryer shkëlqyer studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, e cila përgatiste shtatmadhorë dhe drejtues të lartë të ushtrisë, e mirëpresin nënprefektja Luljeta Dollani, si dhe bashkëkohësit Skënder Lena e Enver Qose. Ndonëse kanë kaluar 47 vite nga koha kur ishin bashkë në këtë njësi të rëndësishme të ushtrisë shqiptare, ata shprehin mirënjohje, respekt e nderim të veçantë për Ismail Shulkun që sipas tyre ishte jo vetëm komandanti shembullor i brigadës së Gramshit, por dhe një mik i rrallë për gramshiotët....

Si i tillë kujtohet ai edhe në Burrel, nga kryetari i Bashkisë së Matit Agron Malaj, nënkryetari i Këshillit të Qarkut Dibër Halit Palamani, kryetari i Komitetit të Veteranëve të Matit Sefer Duka dhe nga ish ushtaraku Besim Gjika. Skenaristi i dekomunetarit D.Methasani, me mjeshtri të rrallë ka ditur të përveçojë nga intervistat e opinionet e tyre mesazhe atdhetarizmi, miqësie e bashkëpunimi të frytshëm. Se i tillë ishte komandant Ismaili,

mishërues dhe përçues i vlerave më të mira intelektuale e njerëzore.

Këto vlera, në këtë dokumentar evidentohen qartë edhe nga Gjeneral major Perlat Sula, nga gjeneral major Xhemal Gjunksi, nga ish-ushtaraku Egerem Osmani dhe sidomos nga Bajram Mane, ish zv.minister i Mbrojtjes. Ish numri dy i ushtrisë shqiptare, ndër të tjera shprehet se “Ismail Shulku qëndron në majën e piramidës së elitës ushtarake shqiptare”.

Më pas, Ilir Shulku – “Mjeshtër i Madh”, Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të futbollit shpreh krenarinë për babain e tij, pasi kudo nëpër qytetet e Shqipërisë, sapo mësojnë se është djali i Ismail Shulkut i bëjnë nderim dhe respekt të veçantë.

Krenarë për “Nderin e Qarkut Dibër” Ismail Shulku, shprehen edhe e bija Rikela Shulku, nusja e djalit Irida Meksi Shulku, mbesat Grejs e Prishila Hysa, si dhe nipërit Dejev e Endi Shulku. Ata kanë se përse të krenohen me babain, vjehrrin e gjyshin e tyre Ismail Shulku, këtë emër të madh të Ushtrisë e inteligjencës shqiptare.

Ismail Shulku lindi në Peshkopi më 10 shkurt 1943. Në qytetin e Peshkopisë kreu arsimin 7-vjeçar, si dhe shkollën e mesme. Në vitin 1961, nisi studimet në Shkollën e Bashkuar, për t’i përfunduar ato me rezultate shumë të mira. Me përfundimin e shkollës e caktuan komandues po në shkollë ku qëndroi dy vite edhe si komandues, edhe pedagog. Aty mësoi më shumë për t’u orientuar në jetë në detyrat ushtarake. Pas kësaj eksperience të mirë, emërohet komandant kompanie në brigadën e Peshkopisë, ku pas një viti bëhet shef i shtabit të batalionit dhe shumë shpejt edhe komandant batalioni, për punë të organizuar dhe për marrëdhënie shumë të mira me kuadrot dhe ushtarët.

Në vitin 1974, shkoi për studime në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, e cila përgatiste shtatmadhorë dhe drejtues të lartë të ushtrisë. Ismaili mbrojtji diplomën shumë mirë dhe në shtator filloi punën si komandant i Brigadës së Gramshit. Kur mbushi 5 vjet në detyrë, u transferua në detyrën e shefit të Shtabit të Koorpusit të Burrelit. Deri në mars 1983, kreu dhe detyrën e komandantit të Koorpusit, por ato u suprimuan dhe mori detyrën e komandantit të Divizionit të Burrelit që shtrihej në katër rrethe në Librazhd, në Peshkopi, në Burrel dhe një pjesë në Tiranë.

Ky divizion kishte një detyrë të vështirë pasi mbronte drejtimin Dibër e Madhe, Kaptina e Martaneshit dhe Tiranë. Në vitin 1985, Këshilli i

Mbrojtjes e pa të arsyeshme që ushtria të ndahej në tre Fronte. Për çdo front u caktua nga një komandant, ku Ismail Shulku, mbulonte Frontin Veri-Lindor dhe ishte zëvendës i Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Kështu që filloi punë në Shtabin e Përgjithshëm, duke drejtuar Frontin Veri-Lindor që ishte më i vështirë, pasi mbulonte vijën kufitare prej 474 km nga Qafë Thana deri në Velipojë të Shkodrës dhe kishte në drejtim 6 divizione.

Siç shprehet prof.dr.Bernard Zotaj – Kryetar i Shoqatës së historianëve ushtarakë: Ngjarjet e vitit 1997 Ismail Shulku i përjetoi si gjithë ushtarakët e tjerë të vendit, duke u dëshpëruar, pasi shikoi me sy si po shkërmoqej e gjithë puna, munda, djersa dhe sakrificat e panumërta të një brezi të tërë ushtarakësh, të përkushtuar për mbrojtjen e vendit. Në këto ngjarje të rënda dhe tronditëse për Ismail Shulkun ishin humbja e Flamurëve Luftarak të njëjësive. Dhe të humbësh flamurin luftarak për një njësi dhe ushtarak është disfata më e madhe që mund të ndodhë në betejë, por jo brenda reparteve dhe të sulmuar nga njerëz të shumtë, ku oficerët nuk mundën të vrisnin popullin e vet. Deri këtu kishte arritur politika, i kishte tradhtuar.

Pas ngjarjeve të vitit 1997, rikthehet në MM, në detyrën e drejtorit të Drejtorisë së Personel-Arsimit. Kjo ishte një ndërmarrje e fuqishme për të gjithë, pasi që nga MM dhe deri në repartin më të vogël çdo gjë ishte prishur dhe dëmtuar rëndë. Me përkushtim dhe ndjenjë përgjegjësie u ringritën njësitë dhe repartet, u plotësuan vendet bosh me kuadro të përkushtuar dhe profesional që e donin ushtrinë dhe ishin të përkushtuar ndaj saj. Ngjarjet që erdhën më pas, sidomos gjendja në Kosovë dhe përkeqësimi i situatës në kufirin veri-lindor të vendit treguan se ushtria ishte ringritur dhe se i përballoi me nder dhe sakrifica të mëdha sfidat e kohës. Në vitin 2003 Ismail Shulku, pas mbushi moshën për pension doli në lirim”.

Ismail Shulku është autor i mjaft shkrimeve e kumtesave në shtypin ushtarak, si dhe i disa metodikave që kanë shërbyer për zhvillimin e disa stërvitjeve të Shtabit e Komando-Shtabi me shumë njësi të Forcave të Armatosura. Ai ka drejtuar e udhëhequr disa stërvitje të mëdha me trupa, me njësi taktike dhe operative, me pjesëmarrjen e të gjitha llojeve të armëve e shërbimeve. Deri në fund të karrierës ushtarake mbajti me dinjitet gradën e Kolonelit. Në të gjithë veprimtarinë e tij për merita pune e shërbimi është vlerësuar me urdhra e medalje të ndryshme nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, nga Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.

MANUSHAQE SHEHU, E VETMJA GRUA SHQIPTARE ME GRADËN MADHORE “GJENERALMAJOR”

Pesë vjet pasi mori gradën “Gjeneral brigade”, Manushaqe Shehu ngjitet në majën e hierarkisë ushtarake shqiptare. Me Dekretin Nr.1313, datë 17.06.2021, të Presidentit të Republikës, ajo bëhet e para grua shqiptare me gradën madhore “Gjeneral major”.

Afro pesë vjet më parë (16 nëntor 2016), Manushaqe Shehu hyri në histori si e para femër që do të shërbente si gjenerale në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Gradimi i gjeneral brigade Manushaqe Shehut u bë në një ceremoni të veçantë në mjediset e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Numri dy i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë (nga data 16 janar 2018 e në gusht 2024) kreu me shumë sukses detyrën e Zëvendëshefit të SHP të FA) është e para ushtarake shqiptare me një karriere të shkëlqyer në të gjitha nivelet e Ushtrisë Shqiptare.

Veçanërisht gratë dhe vajzat oficere krenohen me profilin e ish-shefes së tyre, doktore e shkencave, gjeneral major dhe juriste.

Si njohëse në mënyrë perfekte e dy gjuhëve të huaja (anglisht dhe italisht), dr. Manushaqe Shehu ka përfunduar kursin e CIMIC në Qendrën P&P, Ankara, Turqi (mars–prill 2013), Kursin Gender Perspective in Peacekeeping Operations në Zagreb, Kroaci (qershor 2014); studimet për CIMIC&CIMI Oberamengau, Gjermani (shtator – tetor 2015); Kursin “Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore” në Qendrën P&P, Ankara, Turqi (maj 2016); Kursin e Lidërshiptit Strategjik, Budva, Mal i Zi (shtator 2016); Kursin e Sigurisë në “Qendra Marshall”, Garmish, Gjermani (korrik–shtator 2017) si dhe kursin “Building Integrity” në Mbretërinë e Bashkuar



(tetor 2017). Në muajin gusht 2018, në mbrojtje të temës “Leadershipi dhe ndikimi i tij në menaxhimin e mjedisit të sigurisë. Rasti i Ballkanit e më gjerë”, fiton gradën shkencore “Doktor”. Ajo ka botuar një sërë artikujsh shkencorë dhe joshkencorë brenda e jashtë vendit, në revista ushtarake, në shtypin ushtarak e civil. Po ashtu ka marrë pjesë në disa aktivitete ushtarake ndërkombëtare në vendet anëtare të NATO-s dhe ato partnere të saj.

Dhe jo vetëm kaq, si intelektuale bashkëkohore, demokracinë e konsideronte sfidë ndaj sistemit që u shemb; sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimit të saj ishte vetëm konkurrenca në vlera. Ajo besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme. E qetë, e pjekur, shumë e kulturuar, nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyeshe dhe autoritare në ndëshkimin e saj individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit. Kuptohet, ajo ishte dhe është individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e saj mund t’i shërbenin dhe i shërbejnë shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dukshëm si drejtuese në disa nivele të Ushtrisë Shqiptare, deri në majën e piramidës së saj, si zëvendësshefe e SHP të FA të RSH-së.

Gjeneral major Manushaqe Shehu është titulluar oficerë në vitin 1984 dhe në karrierën e saj të gjatë prej 40 vjetësh në uniformë ka shërbyer në disa detyra dhe funksione

KUSH ËSHTË MANUSHAQE SHEHU

U lind në Peshkopi më 5 nëntor të vitit 1965. Pas përfundimit të studimeve në Akademinë e Lartë të Oficerëve në Tiranë në vitin 1984 – 1988, emërohet Shefe e Logjistikës në Brigadën 3900, Peshkopi. Gjatë viteve 1989–1994, përfundon Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës. Në vitin 1991 merr gradën Kapiten i Parë. Nga viti 1989 – 1996, kryen disa detyra të ndryshme në Logjistikë si itendente batalioni, shefe e shërbimeve të ndryshme logjistike për ushqimin, veshmbathjen, karburantin e kazermimin në brigadë, deri shefe e Logjistikës e Divizionit 1100, Shkodër. Në vitin 1996 emërohet Specialiste e Kontrollit Financiar dhe Rezervave të Paprekshme në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë detyrë e mban deri në mars të vitit 2000. Gjatë viteve 2000 – 2002 punon në ekipin

amerikan të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si përkthyes, njëkohësisht kryen studime pasuniversitare (Kursin Themelor të Oficerit në SHPFA dhe Kursin e Funksioneve) në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2003 merr gradën Major dhe emërohet Shefe e Shërbimit të Ushqimit në FA, detyrë që e mban deri në vitin 2004. Gjatë kësaj periudhe, ka qenë nismëtare e disa projekteve të ristrukturimit të FA dhe anëtare e Bordit të Kompanisë Amerikane SAIC “për ndryshimin e strukturave të FA”, si dhe anëtare e bordeve drejtuese të ndryshimit të disa rregulloreve të ndryshme për Logjistikën në FA. Drejtuese e Bordit të Ndryshimit të Normave të Ushqimit dhe Veshmbathjes e Kazermimit në FA. Në vitet 2004–2005 përfundon ADAMS P&P (shkollë logjistike) në Tur, Francë dhe Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm “Spiro Moisiu”, Tiranë. Në vitin 2006 merr gradën Nënkolonel dhe emërohet Shefe e Furnizimit të FA dhe në vitin 2007, Shefe e Protokollit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Më 8 tetor 2007 emërohet Ndhimëse e Presidentit të Republikës për Çështjet Ushtarake dhe Integrimin Euroatlantik. Gjatë kësaj periudhe përfundon studimet në Kolegjin e Lartë Rajonal të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, Tiranë.

Në vitin 2010 përfundon Master Shkencor të Nivelit të Dytë (MND) në fushën e Sigurisë Kombëtare dhe merr gradën “Kolonel”.

Më 4 shkurt 2011 emërohet Këshilltare Ushtarake e Presidentit të Republikës.

Me 1 shtator 2012 emërohet Drejtoreshë e Bashkëpunimit Civil – Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes.

PJESËMARRËSE NË STËRVITJE TË PËRBASHKËTA ME VENDE ANËTARE TË NATO-S,

Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu ka qenë pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s, aktiviste dhe drejtuese e nismave në ndihmë të grave ushtarake e civile të FA dhe të rajonit. Gjatë karrierës së saj, ka qenë nismëtare e një sërë projektesh të përbashkëta civilo-ushtarake kombëtare dhe ndërkombëtare, ku një vend të veçantë zënë projektet për barazinë gjinore, për të cilat ka marrë mirënjohje dhe falënderime nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave

të njeriut, por edhe nga shoqëria civile e strukturat e tjera të kontrollit civil në Forcat e Armatosura.

Më 1 nëntor 2016 emërohet Komandante e Akademisë së Nënoficerëve.

Më 14 nëntor 2016 gradohet “Gjeneral Brigade”, e para ushtarake femër në historinë e Republikës së Shqipërisë që merr këtë gradë.

Më 1 dhjetor 2016 emërohet në detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Gjeneral major Manushaqe Shehu është e martuar dhe ka dy fëmijë, një vajzë e një djalë.

AUTORE E VEPRËS “LIDERSHIPI NË MJEDISIN E SIGURISË”

Në 111 vjetorin e Forcave tona të Armatosura, Dr. Manushaqe Shehu, e para gjeneralmajore shqiptare dhe zëvendësshëf i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSHerdhi me kurorëzimin e studimit të saj disaveçar për lidërshpin në mjedisin e sigurisë.

Ashtu si në parathënie edhe në fjalën e tij përshëndetëse gjatë promovimit në Akademinë e Shkencave të RSH, ish-Presidenti i Republikës Alfred Moisiu vlerësoi monografinë e gjeneralmajore Shehut, jo vetëm si një kontribut, por edhe si një rast të veçantë të trajtimit të problemit të drejtimit ushtarak. Kjo sipas tij për faktin se gjenerale Manushaqe Shehu, ka përshkruar me hollësi, jo si diçka të pamundur, lidërshpin në menaxhimin e sigurisë në kodin etik dhe të rëndësisë së tij.

Qoftë dhe nga një vështrim i përgjithshëm i kësaj monografie, gjithkush do të konkludonte se autorja Shehu sjell një punim të plotë që analizon një informacion të gjerë duke arritur në përfundime me vlera njohëse, bazuar në historinë botërore dhe shqiptare, ku njihen plot shembuj liderësh të suksesshëm.

E kompozuar në pesë kapituj: “Lidërshipi dhe menaxhimi i sigurisë”; “Kodi etik dhe rëndësia e tij”; “konsensusi, kryefjala e liderit në pakt me sigurinë”; “roli udhëheqës politik në fushën e sigurisë”, dhe “Ballkani, ndryshimet euroatlantike dhe roli i Shqipërisë”, monografia e gjeneralmajor M.Shehut hedh dritë në përmbushjen sa më mirë të misionit dhe të rolit të forcave të armatosura shqiptare në të gjithë historinë 111 vjeçare të shtetit, për të kontribuar në sigurinë kombëtare të vendit. Në të reflektohet më së miri përvoja e saj në krye të korpusit të oficerëve të lartë si numri dy i

Forcave tona të Aramatosura.

Që në hyrje të studimit të saj skrupuloz ajo argumenton se të drejtosh do të thotë të kesh vizion të qartë për sa i përket synimeve dhe arritjeve dhe se udhëheqja është para së gjithash një përkushtim sublim për t'i shërbyer me përgjegjësi interesave kombëtare.

Në këtë optikë, nisur nga koncepti i përgjithshëm për figurën e liderit ajo shkruan se: "...është pikërisht lidershpi i nivelit strategjik, që kapërcen vështirësitë, duke orkestruar ngjarjet e brendëshme, në bashkërendim me ndikimin personal të organizatës në mjedisin e jashtëm, me qëllim arritjen e vizionit të organizatës" (fq.22). Me tej ajo argumenton më së miri se si dinamikat e proceseve të buxhetimit të shtetit ndikojnë fuqimisht në vendimmarrjen në nivel strategjik.

Përsa i përket rëndësisë së Kodit Etik, autorja e kësaj monografie shumëvlerëshe e konsideron atë një "armë të fuqishme" në duart e drejtuesit, i cili duhet ta përdorë në funksion të krijimit të një mjedisi të këndshëm dhe një klime të favorshme komandimi. (fq.57).

Më së miri, këto koncepte i sqaruan në kumtimet e tyre Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj dhe Prof. asoc. Dr. Zaho Golemi.

SELMAN RAMA – SKËNDEBEGASI NGA MUHURRI QË U BË OFICER MARINE



Në vëllimin e tretë të librit “Skënderbegasit ndër vite”, të autorit dibran Kujtim Boriçi, mes shumë personaliteteve që u formuan si ushtarakë të disiplinave të ndryshme spikat edhe emri i Selman Hidër Ramës nga Muhurri.

...Më 15 gusht 1958, pas 7 orë udhëtimi me një “zis” makinë ushtarake, së bashku me tre shokë të tjerë, Sabri Jella, Fais Kurti e Ahmet Loka mbërriti në oborrin e shkollës “Skënderbej”. Për Selman Ramën, si edhe për bashkëmoshatarët e tij skënderbegas, ditët e para qenë të vështira, pasi nuk ishte larguar asnjëherë nga familja dhe vendlindja e tij, Muhurri i Dibrës. Por skënderbegasit dibranë të viteve të tjera u qëndruan afër për t’ua hequr sado pak mërzinë. Pas ndarjes në klasa, u njoh me djem të shkëlqyer që vinin nga rrethe të tjera të vendit.

“U njohëm me njëri-tjetrin dhe ndihma për përvetësimin e mësimëve ishte e pakursyer, sidomos nga shokët Adem Çobani, Sabri Jella, Fiqiret Doda, Asim Pregja, Daniel Reveli etj. E pata të vështirë fillimisht me gjuhët e huaja, pasi ne nuk kishim bërë gjuhë të huaj në shkollën 7-vjeçare, por me ndihmën e pa kursyer të mësueses së gjuhës ruse Florika Papajani, dhe

të gjuhës angleze Nina Agolli, arritëm që të ishim pothuajse në të njëjtin nivel me të tjerët”, - shkruan në ditarin e tij ish-skënderbegasi i viteve 1958-62, Selman Rama, ndërsa i falenderon nga zemra mësueset Florika e Nina, pasi njohuritë e marra në gjuhët e huaja i kanë shërbyer më vonë edhe në punën e tij, gjatë jetës ushtarake e asaj civile.

Por në ditarin e tij gjejmë edhe emrat e kuadrove ushtarake të atyre viteve, si Drago Isufi e Muhamet Ormani që i dhanë një ndihmesë të madhe për t’u ambientuar me jetën ushtarake. Ndërkohë, (po sipas ditarit të tij), e paharruar do të mbetet për brezat e skënderbegasve e gjithë trupa pedagogjike e shkollës, e drejtuar nga drejtori Stavri Angjeli.

KUSH ISHTE SELMAN HIDËR RAMA?

Ka lindur në Muhurr, Dibër më 01.09.1944.

Shkollën fillore dhe atë 7 - vjeçare i mbaroi në fshatin e lindjes, me rezultate të mira. Me mbarimin e shkollës 7 - vjeçare pati fatin, t’i dalë e drejta e studimit për në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” në Tiranë, studime të cilat i mbaroi në vitin 1962 dhe po atë vit filloi shkollën e lartë të marinës në Vlorë, ku u diplomua në vitin 1965. Gjatë viteve në Shkollën Ushtarake “Skëndebej” dhe atyre studentore në Shkollën e Lartë të Marinës, Vlorë, Selmani manifestoi inteligjencë e pjekuri, aq sa fitoi dashurinë e respektin e pedagogëve dhe të shokëve studentë.

Në Flotën Luftarako-Detare punoi për 36 vjet (deri sa doli në pension) në detyra të ndryshme, si shef organi deri në vitin 1968 dhe nga 1968 -1978, shef i armëve të nënujshme në Bazën Ushtarako-Detare, Durrës.

Kuadri i përgatitur me dije e njohuri të larta profesionale, në vitet 1978 -1980 do të shërbente edhe si pedagog i armëve të nënujshme në Shkollën e Lartë të Marinës, Vlorë (1980 – 2001), edhe si specialist i armëve të nënujshme në distriktin detar Durrës. Selman Rama shërbeu me devotshmëri e përkushtim në të gjitha këto funksione, duke e mbajtur me nder emrin e skënderbegasit dhe të familjes së tij nga fshati i bukur Muhurr, që shtrihet në luginën e Drinit të Zi, në hapësirën mes dy maleve më të lartë të vendit, Korabit e Runjës hijerëndë e kreshnike. Si i tillë, Selman Rama bën pjesë në plejadën e ushtarakëve shqiptarë që u shkolluan në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” dhe në Shkollën e Lartë të Marinës, Vlorë dhe që kontribuan për forcimin dhe modernizimin e

ushtrisë shqiptare.

Për katër dekada karrierë si nxënës, student e oficer marine ai ka shpalosur vizionin e ushtarakut bashkëkohor dhe dimensionin njerëzor, të trashëguar nga Familja dhe të perfeksionuar gjatë punës e jetës ushtarake...

GASHTË VJET PAS PËRCJELLJES

Në mbrëmjen e datës 3 korrik 2018 njoftova me hidhërim të thellë, të gjithë miqtë që frekuentonjë faqen time të facebookut si dhe në postën time elektronike, për vdekjen e vëllait tim të dashur e të shtrenjtë, Selmanit. Sot, pas dy vitesh hidhërimi që ka pllakosur zemrën time, ju shpreh mirënjohje të pakufishme atyre qindra të afërmëve, miqve e shokëve, që në kulmin e zhegut të 4 korrikut 2018, përcollën me dinjitet për në banesën e fundit trupin e pajetë të vëllait tim.

Mirënjohje dhe respekt për më shumë se 2000 miqtë e mi në Facebook, që me sms-të ngushëlluese ma lehtësuan peshën e dhimbjes për humbjen e njeriut më të dashur në jetën time.....

Mirënjohje dhe respekt të veçantë për ish-gjeneralin 100-vjeçar Rrahman Parllaku, që si Hero i Popullit e Nderi i Kombit na u gjend pranë ditën e përcjelljes së tij për në botën e përtejme, duke na dhënë forcë e kurajo për të përballuar këtë dhimbje të madhe.

Mirënjohje e respekt për shokët e tij të ngushtë: Polo Guga, Abdulla Elezi, Astrit Muha, Bejdush Çuadari, Asim Prexha, Isa Tare (e dhjetëra të tjerë - të më falin që s'po mundem t'ua përmend emrat), që aq shumë e deshën dhe i donte...

Mirënjohje dhe respekt të pakufishëm për bashkëshorten shembullore të të ndjerit, kunatën e madhe, simotrën time të dashur Nafien, që i shërbeu si askush tjetër me përkushtim e dashuri të pakufishme vëlla Selmanit, deri në momentin e fundit të jetës së tij.

Falenderim të përzemërt për Adelinën, bashkëshorten e nipit tim, Arianit, që i shërbeu jo si nuse e djalit, por si të ishte vajza e tij, dhe falë dhe zotërimit në mënyrë perfekte të profesionit të infermieres, tregoi përkujdesjen maksimale për t'ia zgjatur jetën Selmanit...

Vëlla i dashur e i paharruar!

Qenë me qindra, bashkëkombas si dhe shtetas të huaj në ceremoninë e lamtumirës tënde, si dhe ata që na kanë bërë vizita ngushëllimi në Familje.

Të paharruara do të mbeten përshtypjet e qindra shokëve tuaj, ish-oficerë marine, duke ju konsideruar Ju si mikun e shokun, mishërues të dimensioneve të mëdha njerëzore e intelektuale, një shembull frymëzimi për ta në çdo aspekt.

Vëlla i dashur e i paharruar!

Unë, motra jonë e shtrenjtë Bajdja, vëlla Selimi si dhe Nafia, Ari, Nila, Senardi e Blerta dhe më i vogli, nipi Keisan, ndjehemi krenarë për Ty që na e rrite emrin dhe lavdinë e Familjes sonë. Unë që të kisha jo vetëm vëlla, por edhe prind, shok e mësues ndjehem më krenar se kurrë me Ty....

Thonë se koha shëron plagët, por unë nuk e besoj dot këtë, sepse kjo plagë që na krijon mungesa jote është e rëndë.

Pikëllimi dhe malli për ty vëlla do të na mbetet për jetë. Por Ti fli i qetë, se amanetin tënd do ta ruaj si më të shtrenjtin e jetës time: për simotrën Nafie, motrën tonë të vetme Bajden, mbesat e shtrenjta Nilën e Brunën, dy nipat shembullorë Arin e Nardin, si dhe për Adin, Blertën, Paolën, Kiarën, Gledisin e Keisanin do të tregoj përkudesje maksimale.

Të qoftë i lehtë dheu i kësaj toke vëlla!

Parajsa qoftë banesa jote e përjetshme!

HAMDI DODA, GJENERALI NGA MUHURRI QË KA PËRFAQËSUAR SHQIPËRINË NË NATO



Pas një karrieretë shkëlqyer në Forcat e Armatosura të RSH, Hamdi Doda, me dekretin e Presidentit Nr.87, datë28.02.2025 ka marë grandën madhore Gjeneral Brigade. Ai është ndër të vetmit ushtarakë me origjinë nga Muhurri, që ka përfaqësuar Shqipërinë në NATO dhe që ka takuar Sekretarin Amerikan të Shtetit, John Kerry dhe Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes Donald Rumsfeld, si përfaqësues i FA, pjesëmarrës në Misionin “Liria e Irakut”. Karriera e tij në strukturat e Forcave tona të armatosura

njuh ngjitje, nga Komandant i Kompanisë së Ndërlidhjes në Brigadën e Këmborisë, Muhurr, shëf ndërlidhje në Batalionin e Tankeve në Dovolën dhe Batalionin e Parë të Brigadës së Këmborisë Bulqizë, Komandant i Kompanisë së Radios në Batalionin e Ndërlidhjes të Divizionit të 8^{të} të Këmborisë në Tiranë, Drejtor i Drejtorisë së Ndërlidhjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Rrapi i Treshit (ish Brigada e Ndërlidhjes), dhe deri detyrë Komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura detyrë të cilën e ushtron edhe sot.

FËMIJËRIA, SHKOLLIMI DHE FAMILJA

Ai ka lindur më 5 Maj 1970 në fshatin Vajmëdhej të Rrethit të Dibrës. Ka kryer shkollën fillore në fshatin e lindjes dhe atë 8 vjeçare (1980-1984) e të mesme të Përgjithshme në Shkollën “Nexhat Agolli” në Muhurr (1984-1988). Nga viti 1988-1992, ka studiuar dhe është diplomuar në Akademinë Ushtarake të Forcave të Armatosura, në Specialitetin Ndërlidhje, në Tiranë. Nga fëmijëria mban mend dhe kujton me respekt të veçantë mësuesit e tij, nga klasa e parë deri në klasën e tetë si dhe shokët e shoqet e klasës, sakrificat e tyre, përkushtimin, vështirësitë, gjithashtu dhe aktivitetet sportive (spartakiada) që bëheshin në ato kohë. Kujton me nostalgji momentet kur zhvilloheshin ndeshjet e futbollit midis shkollave të mesme ku mbronte, si shqiponjë portën e ekipit të shkollës. Edhe pse i vogël në moshë u zgjodh dhe u aktivizua si “gardian i portës” për ekipin e kooperativës së Muhurrit. Kështu ai ruan respekt të veçantë për mësuesit e klasës së parë, Bilal Rina dhe Sinan Tanushi (nga klasa e parë deri në klasën e katërt). Të njëjtin respekt ruan edhe për mësuesit e shkollës 8 vjeçare, në veçanti për mësuesen kujdestare Hike Iskurti (Hoxha) dhe për mësuesit e shkollës së mesme, si Sadik Selishta, Fadil Bushi, Shahin Lazri, Lavdrim Shehu dhe Fehmi Mikli, por edhe për Drejtorët e shkollës së mesme Gafurr Zoto dhe Baftjar Gazidede/ Shehu.

Në shkollë u njoh dhe me Nadiren, një nxënëse e shkëlqyer, e cila më pas erdhi në Universitet dhe sot është nëna e dy fëmijëve të tyre, Enriku dhe Lusjela. Enriku ka përfunduar studimet e larta, bahçelor për shkencë ekonomike “Economic Sciences” në “Universitetin Libre du Bruxelles” në

Bruksel në gjuhën frënge, kurse vajza Lusjela, ka perfunduar studimet e larta në Universitetin “Epoka”, dega Informatikë Ekonomike “Business Informatics” në Tiranë, si dhe ka përfunduar me rezultate të larta studimet master ne fushën e sigurise kibernetike “Digital Forensic and Information Security” në Mbretërinë e Bashkuar pranë Universitetit “East London University”.

Gjeneral Brigade Hamdi Doda është i biri i Dine Dodës, një burrë i nderuar, me ndikim në komunitet dhe i vlerësuar publikisht në zonën e Muhurrit dhe më gjerë në gjithë Dibrën.

GJENERALI ME KARRIERË TË SHKËLQYER NË FA

Hamdi Doda, në vitin 1992 merr titullin “Oficer Aktiv” me gradën “Nëntoger” dhe emërohet Komandant i Kompanisë së Ndërlidhjes në Brigadën e Këmborisë, Muhurr. Nga viti 1993 deri në vitin 1995 ka punuar shef ndërlidhje në Batalionin e Tankeve në Dovolani dhe Batalionin e Parë të Brigadës së Këmborisë Bulqizë, Dibër. Nga Nëntori i vitit 1995 deri në Qershor të vitit 1997 ka studiuar në Turqi, ku është diplomuar për Gjuhën Turke, në Institutin Ushtarak të Gjuhës Turke në Stamboll, si edhe kursin bazë të Oficerit për Ndërlidhje, në Shkollën Ushtarake për Ndërlidhjen dhe Elektronikën në Ankara, Turqi. Në përfundim të studimeve në Turqi, për rreth një vit, ka ushtruar detyrën e komandantit të Kompanisë së Radios në Batalionin e Ndërlidhjes të Divizionit të 8-të të Këmborisë në Tiranë. Gjatë kësaj periudhe kujton me nostalgji profesionale Çertifikimin e grupit të Fundit të Radio-telegrafistëve në rang Force të Armatosur. Nga marsi i vitit 1998 deri në tetor të vitit 2008 ka ushtruar detyra të ndryshme në Regjimentin Komanda Zall-Herr, fillimisht si komandant toge dhe Specialist për Planizimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit deri në Shef Ndërlidhje Regjimenti.

DITËLINDJA E 29-TË, GJATË LUFTËS SË KOSOVËS

Në mars të vitit 1999, së bashku me trupat komando dislokohet në Perollaj për të mbrojtur dhe siguruar me përkushtim kufirin midis Kosovës dhe Shqipërisë, vija kufitare nga Morina - Kukës, Qafë Prush dhe deri në Qafë Morinë - Tropojë. E paharruar për të është ditëlindjen e 29-të (në Maj të vitit 1999) që i takoi ta festonte në një nga pozicionet e Artilerisë

Tokësore, të ndërtuar nga regjimi komunist. Nuk i harron ato momente lufte kur së bashku me kolegët festonin në një ambient të përshtatur për “Bar - kafe”, si edhe dhuratën e bërë nga shokët: një kapele dhe një peshk (dekorativ).

MISIONI NË IRAK (MOSUL)

Në periudhën Tetor 2004 - Prill 2005, Hamdi Doda përzgjidhet dhe merr pjesë në kontingjentin e katërt të Misionit “Liria e Irakut” (“Iraqi Freedom Mission”). Së bashku me 70 veta personel të Regjimentit Komando kryejnë me sukses misionin fisnik dhe kthehen në Atdhe. Ajo që është për t’u nënvizuar është mirënjohja e madhe dhe vlerësimet shumë pozitive të dhëna nga forcat aleate, paqeruajtësit shqiptarë, lidhur me aftësitë dhe profesionalizmin e demonstruar gjatë zbatimit të detyrave, si dhe takimi me Sekretarin Amerikan të Shtetit, John Kerry i cili në Janar 2005, vizitoi Bazën e Mosulit, ku krahas forcave Amerikane ishin të dislokuar edhe Forcat Shqiptare. Në mënyrë speciale bëri një takim me drejtuesit e trupave Amerikane ku morën pjesë edhe oficerët e kontingjentit shqiptar (kjo e kërkuar nga ana e tij). Në takim vlerësoi me nota maksimale kontributin e vendit tonë si dhe shkallën e lartë të profesionalizmit të treguar nga gjithë kontingjenti. Ish presidenti i SHBA, Xhorxh W. Bush, në dhjetor 2008, ka shprehur mirënjohje dhe vlerësim për kontributin e dhënë nga FA të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të misionit gati pesëvjeçar në operacionin e koalicionit, “Liria e Irakut”, duke theksuar: “Tashmë që forcat ushtarake shqiptare përfundojnë shërbimin e tyre të gjatë në Irak, kam dëshirë të shpreh mirënjohjen e thellë të Shteteve të Bashkuara për qeverinë dhe popullin e Shqipërisë, për trupat që kanë kontribuar për forcën ndërkombëtare në Irak nga prilli i 2003 deri në dhjetor të 2008. Populli i Shqipërisë duhet të jetë krenar për pjesëmarrjen e suksesshme për të ndihmuar Irakun që të sigurojë lirinë e vet. Ne presim me gëzim të shërbejmë së bashku me kontingjentet e ardhshme shqiptare në mbrojtje të lirisë. Eksperienca jonë e përbashkët në Irak, tregon shembullin më të mirë sesi partneriteti midis vendeve tona është thelluar në vitet e fundit”, duke shprehur optimizmin se lidhjet e Shqipërisë do të forcohen ndërkohë që Shqipëria zë vendin e saj si anëtare e NATO, duke rritur bashkëpunimin me qeverinë amerikane.

TAKIMI ME SEKRETARIN AMERIKAN TË MBROJTJES

Në muajin shtator të vitit 2006 Hamdi Doda përzgjidhet si përfaqësues i FA të Shqipërisë, pjesëmarrëse në misione, për t'u takuar me Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes Donald Rumsfeld. Ky ishte një takim i veçantë dhe i paharruar edhe për vajzën Lusjela “vetëm 6 vjeçe”, e cila përzgjidhet për t'i dhuruar tufë/buçetën me lule të freskëta Zotit Rumsfeld. Për këtë takim media e asaj kohe shkruan me germa të mëdha “Dibranja e vogël që thyen Protokollin”, i shtërngon dorën Sekretarit Amerikan të Mbrojtjes. Gjatë periuridhës që shërbeu në Njësinë Elitare të Forcave të Armatosura “Trupat Komando”, Hamdiu drejtoi grupin e punës për hartimin e projektit për modernizimin e rrjeteve kompjuterike në këtë njësi, projekt i cili i u finalizua me sukses. Në mars të vitit 2007 nisët me studime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, fillimisht në Institutin e Gjuhës Angleze në Bazën Ajrore “Lack Land Air Force Base, në Teksas (mars-korrik 2007). Bazuar në rezultatet e shkëlqyera vlerësohet me “Certificate of Achievements”. Po në të njëjtën periudhë, arrin të mbrojë me çertifikatë edhe gjuhën angleze.

Në Gusht të vitit 2007 deri në Janar të vitit 2008 ndjek studimet në Koopusin e Trupave Amerikane të Ndërlidhjes, Baza Ford Gordon, Augusta, Georgia SHBA. Në përfundim të studimeve renditet si studenti më i mirë ndërkombëtar, ku vlerësohet me Çertifikatë Nderi. Pas kthimit nga studimet në Amerikë, për një periudhë të shkurtër emërohet specialist për Sistemet Statike në Komandën e Forcës së Bashkuar, në Plepa Durrës. Në tetor të vitit 2008 emërohet Shef i Degës së Ndërlidhjes në Komandën e Forcave Detare, Plepa, Durrës, detyrë të cilën e kryen me sukses deri në korrik 2012, ku krahas detyrës funksionale drejton edhe grupin e punës për hartimin e studimit për mirëmbajtjen e Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare. Në dhjetor të vitit 2009 fiton të drejtën për herë të dytë, për të ndjekur Kursin për Menaxhimin e Burimeve të Mbrojtjes, në një nga Institutet më të njohura në Amerikë, Instituti i Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes, “Defence Resource Management Institute”, Monterey, Kaliforni.

NATO- BRUKSEL, 2012-2015

Në korrik të vitit 2012, Hamdi Doda përzgjidhet për të punuar për një periudhë tre vjeçare si Oficer Shtabi për Ndërlidhjen në Përfaqësinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë në NATO. Gjatë kësaj periudhe

përfaqëson denjësisht Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Bordin e Konsultim-KomandimKontrollit të NATO-s. Pas përfundimit me sukses të detyrës në NATO, nga korriku i vitit 2015 deri në Shtator të vitit 2018 emërohet Oficer Shtabi për Planizimin, Standardizimin dhe Implementimin e Objektivave të Kapaciteteve në Drejtorinë e Ndërlidhjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Gjatë kësaj periudhe, krahas detyrës funksionale si ekspert i fushës, merr pjesë në grupe pune për hartimin e kërkesave operacionale për modernizimin e sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit në nivel Force të Armatosur, gjithashtu përfaqëson Drejtorinë e Ndërlidhjes në takimet Bilaterale me NATO-n, lidhur me implementimin e Objektivave të Kapaciteteve.

NË MISIONIN E NATO-S NË KOSOVË (KFOR)

Në vitin 2018 Hamdi Doda ka marrë pjesë në misionin e NATO-s - KFOR në Kosovë. Në përfundim të misionit është dekoruar me medalje nga Komandanti i KFOR, gjeneral major Salvatore Cuoci për kontribut të shquar në mision. Në shtator të vitit 2018 emërohet Drejtor i Drejtorisë së Ndërlidhjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (niveli më i lartë i detyrës/përfaqësimit për një oficer Ndërlidhje). Gjatë kësaj periudhe, krahas pjesëmarrjes në grupe pune dhe borde për standardizimin dhe modernizimin në nivel Force të Armatosur përzgjidhet si anëtar i grupit të punës në nivel kombëtar, ngritur me Urdhër të Kryeministrit për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike. Në Prill të vitit 2019 emërohet Komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit të Rrapi i Treshit (ish Brigada e Ndërlidhjes) detyrë të cilën e ushtron edhe sot.

NË SHTATOR TË VITIT 2019 PROMOVOHET ME GRADËN “KOLONEL”

Në shtator 2019 Hamdi Doda është promovuar me gradën “Kolonel”. Ai, krahas studimeve dhe kualifikimeve brenda vendit ka kryer studime afatgjatë dhe afatshkurtër jashtë vendit, ku mund të përmendim, kursin Bazë të Oficerit të Ndërlidhjes në Ankara, Turqi, Kursin e Kapitenit të Karrierës dhe Kursin e Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në Shtetet e

Bashkuara te Amerikës, si dhe Program Studimin për Sigurinë Kibernetike “George C Marshall” në Oberamergau Gjermani.

Gjeneralbrigade Doda në vitin 2011 përfundoi Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë së Mbrojtjes së FA ku fitoi Gradën Shkencore “Master Shkencor në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes”.

Në vitin 2017 përfundoi Kursin e Lartë të Oficerit pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, dhe në vitin 2023 përfundoi Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Ai ka marrë pjesë dhe kontribuar, në konferenca, seminare, workshope dhe grupe pune, veçanërisht në fushën e Ndërlidhjes dhe Sigurisë Kibernetike, si brenda dhe jashte vendit. Përgjatë karrierës 33-vjeçare në FARSH, për shërbimet e kryera, Gjeneralbrigade Doda është nderuar me një numër medaljesh karriere, shërbimesh të veçanta në MM dhe SHP. Gradat i ka fituar një e nga një, ashtu si e detyron rregullorja gradave në ushtri.

Ka përfaqësuar vendin tonë në konferenca, takime dhe seminare ndërkombëtare në fushën e Ndërlidhjes dhe Sigurisë Kibernetike. Në vitet 2010-2011 ka mbrojtur provimet pasuniversitare në Inxhinieri Elektronike si dhe ka mbrojtur gjuhën angleze pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Tiranë. Ka shërbyer si përkthyes në gjuhën turke për grupin e eksperteve turq të atashuar në Regjimentin Komando në Zall-Herr, Tiranë. Për pjesëmarrjen në misione ndërkombëtare është dekoruar me medalje e tituj nderi si, “Medaljen e Shërbimit Ushtarak”. Gjeneral Doda ka trajtuar kryesisht tema/çështje për Ndërlidhjen, Sigurinë Kibernetike dhe Masat për Sigurinë e Sistemeve të Komunikimit e Informacionit në FA.

Me kualifikimet në SHBA, Turqi, Gjermani e Austri dhe eksperiencat e vyera e karrierën e tij të shkëlqyer, gjeneral Hamdi Doda radhitet me ushtarakët më të zotë të Forcave tona të armatosura.

Kolonel Hamdi Doda, aktualisht me detyrë Komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes merr gadën madhore Gjeneral Brigade, me dekretin e Presidentit të Republikës SH.T.Z Bajram Begaj nr. 87, datë.28.02.2025.

PORTRETI NË BRONX I DËSHMORIT KLODIAN TANUSHI

- Me aktin e tij heroik, Klodian Tanushi nderoi jo vetëm familjen, por gjithë Shqipërinë, duke i treguar botës se ç'është shqiptaria



Për 726 nxënësit dhe mësuesit e shkollës 9-vjeçare Qesarakë dita e fillimit të vitit të ri shkollor (11 shtator 2023) do të mbetet në kujtëse si dita e inaugurimit të bustit të dëshmorit Klodian Tanushi, emrin e të cilit mban shkolla e tyre.

Një ditë krejt e veçantë kjo, kur para se të futeshin në klasat e tyre, ata, si dhe dhjetëra personalitete që ju bashkuan këtij eventit do të shpërthenin në duatrokitje të fuqishme në çastin kur shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave tona të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji dhe babai i dëshmorit, ish-ushtaraku shembullor Basri Tanushi do të zbulonin bustin në Bronx të Klodian Tanushit, vepër kjo mjaftë e arrirë artistikisht e

skulptorit Ardian Pepa. Kështu, vogëlushët e kësaj shkolle, si dhe mësuesit e tyre, çdo mëngjes do të përshëndetën me heroin shqiptar të Letonisë.

Nëse në kampin e NATO-s në Letoni është vendosur një memorial për Klodian Tanushin dhe Zarife Hasanajn, të cilët humbën jetën pas shpërthimit në bazën e NATO-s në Letoni, vendosja e emrit të Klodianit shkollës së re në zonën ku jeton familja e tij, ishte një vendim historik i Këshillit Bashkiak të kryeqytetit.

Nëse lapidari perkujtimor i djalit flokëverdhe dibran, majorit të NATO-s, Klodian Tanushi, atje në Letoninë e largët, është një simbol i miqësisë mes popujve, që bën krenar jo vetëm familjen e Klodianit, babë Basriun, bashkshorten Semiha, djemtë Serxho e Klesoi dhe vajzën Darla, por çdo shqiptar, përjetësimi në portetin në bronx në oborrin e shkollës që mban emrin e tij është vepër e shkëlqyer në nderim dhe vlerësim të veprës heroike të Klodian Tanushit. Ndaj, dhe drejtori i shkollës, Lulzim Lika, në fjalën e tij përshëndetëse dje u shprehu një falenderim special gjithë shokëve e miqve të Klodit dhe në mënyrë të veçantë familjarëve të dëshmorit Klodian Tanushi. Pasi ju uroj mirëseardhjen nxënësve, ai e konsideroi këtë një ditë të shënuar për faktin se përruronin bustin e dëshmorit, emrin e të cilit mban kjo shkollë. “Ne jemi krenarë që shkolla jonë do të mbajë dhe në të njejtën kohë do të përjetësojë emrin e Klodit”, tha ndër të tjera drejtori Lika.

KONTRIBUTI NË MISIONET NDËRKOMBËTARE TË PAQES

Nuk ishte detyra e parë e major Klodianit në misione ndërkombëtare paqeruajtëse. Kontributi i tij në këtë fushë është i shquar dhe i shtrirë në kohë. Pjesëmarrja e tij në misione ndërkombëtare është, si më poshtë: Më 16 shtator 2012 deri më 6 mars 2013, ka marrë pjesë në misionin “Althea” në Bosnje-Hercegovinë, me detyrë komandant kontingjenti. Më 19 qershor 2017 deri më 15 dhjetor 2017, ka marrë pjesë në misionin e NATO-s në Letoni, me detyrë komandant kontingjenti. Klodian Tanushi – Heroi i Paqes 283. Më 20 dhjetor 2018 deri më 10 maj 2019, ka marrë pjesë në misionin e NATO-s në Letoni, me detyrë komandant kontingjenti dhe përfaqësues i lartë ushtarak.

Më 6 maj 2019, gjatë një operacioni çmimi, ndodhi një incident i rëndë, ku mbetet e vdekur në vend nëntetarja Zarife Hasani dhe u plagos major

Klodian Tanushi dhe nëntetar Julian Kapaj, nga shpërthimi i një mine. Pas katër ditësh, më 10 maj 2019, ndërroi jetë edhe major Klodian Tanushi, duke mos u bërë ballë plagëve të marra, me gjithë kujdesin e veçantë të mjekëve. Më 15 maj 2019, trupi i tij i pajetë u kthye në atdhe. Më 16 maj, u bë varrimi i dëshmorit Klodian Tanushi te Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut. Kur Klodiani kreu aktiv sublim të rënies në krye të detyrës ushtarake, ishte më pak se 39 vjeç, sepse ai kishte lindur më 31.10.1980. Major Klodiani u largua si burrat prej njerëzve të tij të dashur, prej miqve dhe shoqërisë, prej Forcave të Armatosura, kur ishte në më të mirën ditë, në më të mirën moshë, pikërisht atëherë kur ai mund t'u jepte akoma më shumë kontribute familjes së tij të nderuar, shoqërisë dhe Forcave të Armatosura.

MODEL QYTETARIE, USHTARAK SHEMBULLOR, FAMILJAR I PËRKRYER

Busti në boronx dhe dhjetra materialet filmike, arkivore e dokumentare dëshmojnë se Klodiani ishte model qytetarie, ushtarak shembullor, familjar i përkryer. Ndaj, dhjetëra janë vlerësimet e nderimet institucionale, që i janë bërë major Klodian Tanushit, për së gjalli dhe pas vdekjes”. Kjo, sipas tij, për faktin se Major Klodian Tanushi, pas rënies heroike në krye të detyrës, me vendimin nr.786, datë 13.5.2019, të Komisionit të Posaçëm Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, u shpall “Dëshmor i Atdheut”. Me urdhrin nr.706, datë 31.5.2019, të ministrit të Mbrojtjes, i jepet “Medalja e Nderit”, ndërsa me urdhrin nr. 554, datë 11.5.2019 të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i jepet medalja “Luftëtari”. Më 10 maj 2021, Presidenti i Republikës, zoti Ilir Meta, me një ceremoni të posaçme solemne, dekoroi me “Dekorata e Artë e Shqiponjës” dëshmorin major Klodian Tanushi (pas vdekjes).

Kreu i shtetit vlerësoi kështu aktin sublim të major Tanushi, i cili lartësoi Shqipërinë dhe Forcat tona të Armatosura, si një anëtare e denjë e NATO-s, për t'u shndërruar, nëpërmjet profesionalizmit të tij të lartë dhe trimërisë së rrallë të dëshmuar, në një shembull të përhershëm frymëzimi për çdo shqiptar. Gjatë karrierës së tij ushtarake qe vlerësuar: Me medaljen e “Karrierës” nga Komandanti i Forcës; medaljen e “Shërbimit” nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm; medalje “Shërbimi në Mision jashtë vendi”;

medaljen “Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare” nga ministri i Mbrojtjes; medaljen e “Mbështetjes” nga komandanti i Komandës Mbështetëse. Me vendimin nr. 09, datë 23.12.2019, të Këshillit të Qarkut Dibër, Klodian Tanushi është shpallur “Qytetar Nderi i Qarkut Dibër”.

Këtyre vlerësimeve të rëndësishme iu shtohet dhe një vlerësim tjetër me shumë vlerë. Një vit më parë, një vlerësim e nderim të lartë i bëri djaloshit trim dibran, major Klodian Tanushit, edhe Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Dibrës, me kryetar z. Sokol Sava. Ky këshill, me vota unanime, me vendimin nr. 60, datë 10.4.2020, vendosi që rruga nga kryqëzimi i fundit i bulevardit me rrugën e Pollozhanit, deri tek ish-Shkolla Bujqësore (Karburanti) të emërtohet rruga “Klodian Tanushi”. Kësisoj, major Klodian Tanushi, “Dëshmor i Atdheut”, do të jetë përditë e për çdo kohë në mesin e banorëve të këtij qyteti, në kujtesën dhe shpirtin e tyre.

Major Klodian Tanushi shpalosi trimëri, guxim, përkushtim e profesionalizëm në kryerjen e detyrave ushtarake, që i ishin ngarkuar, si dhe dha kontributin e tij të vyer në mbrojtje të vlerave të paqes dhe sigurisë, kudo në botë. Ai përfaqësoi e vlerat më të larta të ushtarakut shqiptar, jashtë vendit të tij, në kuadër të NATO-s, bëri sakrificën sublime, duke dhënë jetën e tij të re në krye të detyrës në Letoni, si komandant i Forcave Paqeruajtëse Shqiptare. Më parë, për gati njëzet vjet, major Klodiani kishte dhënë kontributin e tij të çmuar edhe për forcimin e modernizmin e Forcave tona të Armatosura, duke komanduar në nivele të ndryshme me shumë profesionalizëm dhe përkushtim atdhetar. Major Klodian Tanushi ishte një djalë i ri, që gdhendi emrin e tij me shkronja të arta në historinë e Shqipërisë, është dëshmor i ri nga ushtarakët shqiptarë, që ra në krye të detyrës në mbrojtje të paqes dhe sigurisë në botë. Ishte një djalë i ri, me dashuri të madhe për jetën, për profesionin dhe për paqen, kudo në botë.

KARRIERA NË FORCAT E ARMATOSURA E MAJOR KLODIAN TANUSHIT

Major Klodian Tanushi lindi më 31 tetor 1980, në qytetin e Peshkopisë të Rrethit të Dibrës dhe është fëmija i parë i familjes Tanushi. Ai vjen nga një familje atdhetare, e besës dhe e punës. Të parët e saj ishin luftëtarë, deri në gjeneralë, përkrah Heroit tonë Kombëtar “Gjergj Kastriotit Skënderbeut”. Origjina e Klodianit vjen nga fshati Fushë-Muhurr i rrethit të Dibrës. Ky

fshat, sa i lashtë, aq dhe i bukur, shtrihet buzë Drinit të Zi, i cili i jep atij jo vetëm një pamje mahnitëse, por e bën dhe shumë të përshtatshëm e tërheqës për pushues të shumtë nga fshati dhe qyteti. Arsimin 8-vjeçarë e bëri në shkollën “Demir Gashi”, po në qytetin e Peshkopisë. Në vitin 1999, mbaroi shkollën e mesme në profilin “motorist-xhenerik”, pranë shkollës së mesme “Nazmi Rushiti”. I martuar me tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë, përkatësisht 15, 12 dhe 3 vjeç. Nga viti 2000 deri në vitin 2003, ndoqi studimet pranë Akademisë Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë. Pas përfundimit të studimeve është titulluar oficer aktiv i Forcave të Armatosura, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, nr. 9628, datë 18 shtator 2003 dhe mori gradën e Nëntogerit. Gjatë karrierës së tij ushtarake ka kryer detyra në funksione të ndryshme si: Komandant toge, komandant kompanie, shef Seksioni, specialist Operacionesh, komandant Kontingjenti në misionet ndërkombëtare dhe përfaqësues i lartë i ushtrisë sonë në bazën e NATO-s në Letoni.

KLODIAN TANUSHI I TREGOI BOTËS Ç’ËSHTË SHQIPTARIA

Nxënësit e kësaj shkolle do t’i frymëzojë në vijimësi ky bust i derdhur bukur në bronx i Heroit të Paqes Klodian Tanushi edhe për faktin se ai i tregoi botës se ç’është shqiptaria.

Një vit më parë (22 tetor 2022) në përrurimin e kësaj shkolle, së cilës ju vendos emri “Klodian Tanushi, në nder të “heroit të paqes”, majorit që humbi jetën në krye të detyrës në Letoni, Kryeministri Rama që ishte i pranishëm në përrurimin e saj në Qesarakë, me kushte dhe hapësira moderne, ndër të tjera vlerësoi aktin e heroit të paqes që sakrifkoi jetën për atdheun, duke mbetur shembull frymëzimi për të rinjtë.

Ndërsa kryebashkiaku Erion Veliaj, duke kujtuar figurën e Major Klodian Tanushit, tha se heronjtë e sotëm janë ata që nderojnë kombin edhe pas vdekjes.

“Sot, është një ditë e trishtë sepse kujtojmë shokun tonë, djalin tuaj që nuk është më, por një gjë është e sigurt: ky emër, kjo shkollë do të jetë këtu në jetë të jetëve. Sepse, Klodiani na la një reputacion të jashtëzakonshëm, prandaj duhet të jeni krenarë. Sot kemi nevojë më shumë se kurdo për frymëzim”, tha ndër të tjera kryebashkiaku Veliaj.

Më 11 shtator 2023, në ditën e inaugurimi të bustit të tij, jeta dhe vepra

heroike e Klodian Tanushit u vlerësuan nga deputetët Xhemal Qefalia e Lavdrim Krashi, ndërsa ishin të pranishëm edhe deputetët Bardhyl Kollçaku, Petrit Doda e Denis Deliu, si dhe nënkryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, Armand Gjini. Mbresëlënëse qe për nxënësit e mësuesit edhe përshëndetja e Basri Tanushit, babait të dëshmorit.

“Pas vendosjes së emrit, ne si familje, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, në mjediset e saj ngritëm muzeun që rrezaton njohuri për këdo që e viziton pasi mëson se kush ishte Klodi. Kjo jo vetëm me shkrime, por edhe me dokumenta, fotografi e vendime për dekorimin e tij nga institucione të rëndësishme të vendit e ato ndërkombëtare”, tha ndër të tjera babai i dëshmorit. Ndërkohë, Bastri Tanushi vlerësoi si ngjarje të rëndësishme përrurimin e bustit të djalit të tij në oborrin e kësaj shkolle, për të cilin dha ndihmesë financiare sipërmarrësi Xhetan Ndrejoni.

Jeta e Klodianit, Zarifes dhe shumë të tjerëve që shërbyen dhe ranë heroikisht në misionet paqeruajtëse, flet për dinjitetin e gjakut që nuk bëhet ujë, për shembullin e krijuar që nga marrja e qumështit dhe këshillave të para të nënës e babait në djep, deri në përfshirjen në këtë familje të madhe të Forcave të Armatosura, e cila është e përkushtuar për të mbrojtur bashkësinë e madhe të njerëzve të këtij vendi dhe të Aleancës. Ata na tregojnë se paqja ka një çmim. Ndaj dhe përjerësimi i emrit të tyre në institucione të tilla arsimore ka rëndësi të veçantë sepse i shërben edukimit atdhetar të brezave.

Kjo për faktin se me aktin e tij heroik, Klodian Tanushi nderoi jo vetëm familjen, por gjithë Shqipërinë, duke i treguar botës se çështë shqiptaria. Pikërisht për këtë, duhet konsideruar si e drejtë legjitime kërkesa e babait të tij, bërë publike në këtë event mbresëlënëse, që trupa pedagogjike e kësaj shkolle të angazhohet maksimalisht në procesin edukativ, mësimor e shkencor, për të bërë të mundur që kjo shkollë të renditet ndër shkollat më të mira të kryeqytetit.

IV

NË ELITËN MJEKËSORE SHQIPTARE

Libri i ish - Ministres së Arsimit dhe Kulturës, monografi për
bashkëshortin e saj

DR. MEHDI CANI, MISIONAR I MJEKËSISË SHQIPTARE



- Përfaqësues të elitës mjekësore shqiptare, si: prof. Dr. Petrit Bara, prof. Nikolla Shurbani, Prof. dr. Gojart Cerga, Prof. Mynir Karagjozi, Prof. dr. Ahmet Kamberi, Prof. dr. Anesti Boçka, prof. dr. Ali Kuqo, Prof. Koleç Daja, Prof. Flamur Topi dhe Prof. Zamir Ndroqi e vlerësojnë Dr. Mehdi Canin si përfaqësuesin e përkryer të figurës së mjekut të vërtetë...
- Mori pjesë në kongrese e simpoziume ndërkombëtare si në Austri, Kroaci, Hungari, Itali, etj., ku referoi e dha eksperiencën e tij. Bëri shumë studime dhe publikoi mbi 100 punime shkencore brenda e jashtë vendit, ku trajtoi kryesisht temën mbi neuroinfeksionet. Është autor i librit të sëmundjeve infektive që përdoret edhe sot në Fakultetin e Mjekësisë dhe atë të Infermierisë.

Në një nga anketat e përvitshme që botonte një e përditshme shqiptare në dhjetor 2006, (kur sapo kishte ndërruar jetë), Dr. Mehdi Cani do të vlerësohej ndër 100 mjekët e famshëm të shekullit, që *“kanë shpëtuar jetë njerëzish dhe janë kthyer në heronj pa titull, që kanë themeluar e kanë promovuar pavijone e spitale anembanë vendit, për vite, dekada e deri një shekull”*.

I njohur si neuroinfeksionist dhe klinikist i shquar i vendit, si dhe si humanist që u ka shërbyer falas pacientëve të fshatit dhe krahinës së tij të Dibrës si dhe njerëzve në nevojë të Shqipërisë, Ai është dekoruar me disa urdhra dhe medalje si mjek i shquar. Me Dekretin nr.7336, datë 13.11.1989 Presidiumi i Kuvendit Popullor i jep titullin ***“Punonjës i shquar i shkencës dhe i teknikës”*** me motivacionin *“Për kontributin e dhënë në ngritjen e shërbimit të neuroinfeksionit në vend, për përcaktimin e kritereve të drejta shkencore në mjekimin e meningiteve e për ndihmesën e dhënë në kualifikimin e përgatitjen pasuniversitare të kuadrit në këtë shërbim”*. Ndërsa me Dekretin Nr.6872, datë 27.3.1984 të Kuvendit Popullor i është dhënë Urdhëri ***“Për shërbim të mirë popullit”***. Ndërkohë është vlerësuar me titujt *“Qytetar Nderi”* i Komunës të Zerqanit, *“Qytetar Nderi”* i rrethit të Bulqizës” dhe *“Qytetar Nderi”* i Qarkut të Dibrës.

Më të plotë, profilin e tij njerëzor, intelektual dhe profesional e gjejmë në librin *“Doktor Mehdi Cani, misionar i mjekësisë shqiptare”*, shkruar dhe botuar nga bashkëshortja e tij Tefta Cami (Cani) – ish ministre e Arsimit dhe kulturës.

DOKTORI ME DY DITËLINDJE

Në pasaportën e tij e kishte të shënuar ditëlindjen më 4 shkurt 1936, në fshatin Zerqan të rrethit të Dibrës. Por nëna e tij Mite, thoshte se Mehdiu ka lindur me 7 mars të vitit 1936. Këto dy data Mehdi Cani që do të bëhej misionar i mjekësisë shqiptare, i përdorte shpesh, për t’iu shmangur urimeve dhe dhuratave, apo organizimit të ceremonive të posaçme familjare.

Ndërsa ka rrëfyer këtë të vërtetë në librin e saj, bashkëshortja e tij Tefta Cami (Cani) shkruan: *“Sa herë ishte 4 shkurti, ne i uronim ditëlindjen. Ai na thoshte: ‘Jo, e kam me 7 mars’. Kur vinte 7 marsi, e uronim përsëri. Por ai na përgjigjej: ‘Jo!’. Unë e kisha me 4 shkurt. Ne i përdorëm të dyja datat, për t’ia uruar e festuar edhe pa dëshirën e tij...”*

FËMIJËRIA

Për të shkruar këtë *in memoriam* nuk e pata të vështirë sepse më mjaftoi libri me 462 faqe, i shkruar me aq dashuri nga bashkëshortja e dr. Mehdiut, Tefta, e cila, përveç kujtimeve të saj të shkruara thjeshtë, e bukur, me një gjuhë të pasur e gramatikë perfekte, në 240 faqe (për t'u marrë si shembull si rrëfime me mjeshtri të rrallë artistike), ka përfshirë edhe vlerësime e kujtime të profesorëve e kolegëve, kujtime të të afërmëve dhe shokëve të tij, si dhe dokumente e foto.

Kështu, që në faqen 16 të librit mësojmë se Dr. Mehdi Cani ka lindur dhe është rritur në një familje të nderuar. I ati i tij, Mahmuti, kishte punuar si berber për t'i shtuar të ardhurat e familjes. Mahmuti, ashtu si dhe i ati, Asllani, i përkiste sektit fetar bektashian dhe ishte i njohur si myhib. Nëna e tij, Mite Sinan Vorfi ishte rritur jetime te xhaxhai i saj, Asllan Vorfi. Ajo ishte bija dhe trashëgimtarja e vetme e Sinan Vorfit.

Prindërit e Mehdiut kujtohen nga të afërmit e bashkëfshatarët si njerëz të ndershëm, të drejtë e punëtorë, si bujarë e patriotë, si njerëz që u dhuronin të tjerëve dashuri e mirësi, që ishin të përkushtuar dhe sakrifikonin për të tjerët. Ndonëse të varfër, ata e lindën, e rritën dhe e edukuan djalin e tyre të vetëm të asaj familje me një përkujdesje të veçantë. Ajo familje qe shumë e pasur me vlera humane e fisnikërie, që i trashëgoi e i pasuroi, si dhe i rrezatoi në të gjithë krahinën dhe vendin, djali i tyre, Mehdiu. Ai, shkollën 7-vjeçare e ka mbaruar në fshatin Zerqan me rezultate shumë të mira. Ashtu si të gjithë shokët e tij të shkollës, edhe Mehdiut i është dashur që, në vend të lodrave të moshës së tij të fëmijërisë, pas mësimit të merrej me punët e bujqësisë e blegtorisë.

Natyra e bukur e fshatit të lindjes i kishte formuar ndjenjat e shijet e së bukurës e të harmonisë së ngjyrave, të melodive e të qetësisë, të idileve përrallore.

Mehdi Canin, i cili pas mbarimit të 7 - vjeçares punoi si llogaritar në minierën e Bulqizës, ku merrej kryesisht me shpërndarjen e pagave të punëtorëve, do ta ndihmonte fati, duke e takuar me "*Mësuesin e Popullit*" Selim Alliu, i cili i çeli rrugën e diturisë për të vazhduar studimet në Shkollën e Mesme Mjekësore Tiranë. Me ato mundësi të pakta që kishin, prindërit e nisën Mehdiun për në Tiranë me një valixhe të vogël prej druri, por ai ua shpërbleu duke e mbaruar shkollën me rezultate të shkëlqyera.

Ai e kujtonte dhe e vlerësonte me nderim e mirënjohje drejtorin e parë të asaj shkolle, kardiologun e shquar, prof. Nikolla Shurbanin, i cili u krijoi që ditën e parë një ambient të ngrohtë e miqësor. Po ashtu respektonte dhe nderonte shokë e miq të shkollës së mesme, veçanërisht ata të konviktit, me të cilët kishte fjetur në një dhomë, si Kristo Pandovskin, Naum Priftin, Dhimitër Xhuvanin, Tahir Cenkon, Xhuvi Pashkon, si dhe shokët e tjerë të klasës si Shpëtim Gjebren, Dhimo Roshin, Kanan Jakupin, Petro Shekën, Rexhep Klosin e dhjetra të tjerë.

PËRJASHTIMI NGA LISTA E ATYRE QË DO TË SHKONIN PËR STUDIME NË BASHKIMIN SOVJETIK

Mehdi Cani e mbaron shkollën e mesme mjekësore me rezultate shumë të mira, duke plotësuar dëshirën e tij e të familjes. Gjatë viteve të shkollimit ai tërheq vëmendjen e personelit mësimor për inteligjencën e zellin e madh në mësim, për aftësinë, pasionin e talentin e shprehur në fushën e mjekësisë. Prandaj e kishin propozuar e miratuar që ai të vazhdonte studimet e larta jashtë shtetit, në Bashkimin Sovjetik. Ai dhe familja e mirëpresin këtë vendim dhe e përgatitën për ta nisur jashtë shtetit. Mehdiu shkon në Durrës dhe futet në anije, meqë udhëtimi do të bëhej me anije. Pasi u sistemua, vjen një person dhe e nxjerr nga anija, duke i thënë: *“Ti nuk do shkosh me studime në BS, sepse nuk ke garanci”*. Në fakt nuk ishte mungesa e garancisë politike, sepse ai vinte nga një shtresë e varfër. Por siç tregonte, *në anije hyri një tjetër, që kishte lidhje me një funksionar të lartë të asaj kohe. Të nesërmen shkoi të ankohej në aparatën e KQ, por e priti personi për të cilin po ankohej. Mehdiu nuk e njihte. Kujtoi se ishte Enver Hoxha personi të cilit po i ankohej se në vendin e tij ishte nisur për studime në BS një person tjetër. Por sapo përmendi emrin e tij, e kapën për krahu dhe e pa vehten, sa hap e mbyll sytë jashtë selisë së KQ.*

U ngushëllua me fjalët e prof. Nikolla Shurbani: *“Mos u dëshpëro, biri im. S’kam ç’të bëj! Unë të kam propozuar që ti të studjoje në BS, sepse je një xhevahir dhe do të jesh e ardhmja e mjekësisë shqiptare. Ti do të vazhdosh studimet e larta këtu në Shqipëri dhe jam i bindur që ti do të studjosh mirë dhe do të bëhesh një mjek i shquar...”*.

Dhe nuk qe gabuar në profecinë e tij prof. Shurbani, ndonëse e konsideroi të padrejtë këtë veprim, *(pasi sipas tij, po qe se vazhdon, do*

të çënojë cilësinë e mjekësisë shqiptare, sepse do të përgatiten mjekë të paaftë). Mehdi Cani, do të kryente me rezultate të shkëlqyera studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë (1953-1958) duke u futur në Bllokun e Artë të niversitetit të Tiranës. (Emri i tij është shënuar në Librin e Nderit të Fakultetit të Mjekësisë). Gjatë periudhës së studimeve ka punuar në Klinikën Universitare të Tiranës.

Po ashtu, dr. Mehdi Cani ka mbrojtur disertacionin dhe ka fituar gradën shkencore “Doktor i Shkencave” në vitin 1985 me temë “Mbi meningjitet për periudhën 1976-1985 në Shqipëri.

KARRIERA E SHKËLQYER PROFESIONALE

Me një karriere 48 vjeçare si mjek dhe drejtues i disa institucioneve, ku ju shërbyer me përkushtim, profesionalizëm e humanizëm të pashoq qindra mijëra pacientëve nga e gjithë Shqipëria, Dr. Mehdi Cani, do të konsiderohej me të drejtë *Misionar i Mjekësisë Shqiptare*.

Ka filluar punën si mjek dhe Drejtor i Spitalit të Bulqizës, menjëherë pas mbarimit të studimeve, në vitin 1958, për të vijuar për gjashtë vite (1960-1976) si Shef i Klinikës së Infektivit dhe Drejtor i spitalit "Stefan Luarasi" Peshkopi.

Në një artikull të gazetës “Bashkimi” të datës 15 korrik 1960, me titull “Mjeku i Malësisë”, me autor Fane Boshnjaku, ndër të tjera shkruhet se si ka mbaruar Mehdi Cani si mjek dhe si po shërben me një gatishmëri e përkushtim të madh...

Në harkun kohor të 11 viteve 1965-1976, mjeku i nderuar Mehdi Cani do të ishte Shef i Seksionit të Shëndetësisë pranë Komitetit Ekzekutiv të rrethit Dibër, ku kreu me dinjitet edhe disa detyra shoqërore të ndërlikuara për kohën.

Gjatë drejtimit të shërbimit shëndetësor të rrethit të Dibrës nga Dr. Mehdi Cani, ky shërbim shënoi zhvillim e transformime të mëdha. U hapën specialitete e shërbime të reja, u shtua me ritme të shpejta personeli shëndetësor, sidomos numri i mjekëve. U bënë ndërtime të tilla si spitali i Peshkopisë, spitali i Bulqizës, hoteli i Llixhave dhe filloi ndërtimi i kompleksit modern balnear që kemi sot, u hapën spitale e maternitete në të gjithë rrethin.

Dr. Mehdi Cani, figurë e shquar e mjekësisë kombëtare, i ngjiti shkallët

e karrierës me shpejtësi. Në vitin 1976 u transferua në Tiranë, ku punoi në Klinikën Universitare të sëmundjeve infektive. Për një periudhë 10 vjeçare, gjatë viteve 1982-1992, ai ishte drejtor i spitalit infektiv të Tiranës, ku mjekoheshin të gjithë rastet e rënda që grumbulloheshin nga e gjithë Republika për trajtim të specializuar në spitalin qendror. Kësisoj u rendit me elitën e mjekësisë shqiptare. Për 30 vjet me radhë ishte pedagog i Fakultetit të Mjekësisë dhe më pas edhe atij të Infermierisë. Ishte specializuar më parë (1967) për sëmundjet infektive, bëri dhe një specializim të dytë në neurologji. Specialist i klasit të parë, Ai u bë një autoritet i padiskutueshëm shkencor. *Kur konsulta e spitalit kalonte për të parë të sëmurët rëndë, kishte raste që ata që referonin të shpreheshin: “Këtë rast e ka parë Mehdi Cani” dhe të gjithë profesorët me emër do të shpreheshin: “Le të vazhdojë mjekimin që ka thënë doktori, nuk ka nevojë për konsultë”.*

Rasti më sinjifikativ është ai i Hilë Zefit, ish-Drejtor i Pallatit të Kulturës Lezhë që e nxorën nga neurologjia si të pashërueshëm. E mori Dr.Mehdiu në pavionin e Infektivit, e mbajti 6 muaj në spital duke e kuruar e ushqyer vetë dhe shpëtoi...

Në vitin 1985 mbrojti Disertacionin me temë: “Mbi meningitet për periudhën 1976-1985 në Shqipëri” me të cilin mori titullin “Doktor i Shkencave Mjekësore” dhe më pas titujt e tjerë akademikë që vijnë. Tirana është një test për mjekët që vijnë nga rrethet. Askush më mirë e më shpejt se ai nuk e përballoi me sukses këtë test. *Mori pjesë në kongrese e simpoziume ndërkombëtare si në Austri, Kroaci, Hungari, Itali, etj., ku referoi e dha eksperiencën e tij. Bëri shumë studime dhe publikoi mbi 100 punime shkencore brenda e jashtë vendit, ku trajtoi kryesisht temën mbi neuroinfeksionet. Është autor i librit të sëmundjeve infektive që përdoret edhe sot në Fakultetin e Mjekësisë dhe atë të Infermierisë.*

Ai ishte një profesionist i zoti. Nga askush dhe asnjëherë nuk është vënë në diskutim një fakt i tillë edhe pse ka pasur rastin të punojë me figurat më të shquara të mjekësisë shqiptare të atij sektori si: Nikolla Dushniku, Kristo Pano, Elmaz Altari e shumë të tjerë.

VLERËSIMET NGA PERSONALITETE TË ELITËS MJEKËSORE SHQIPTARE

Për vetë vlerësimet e personaliteteve të elitës mjekësore shqiptare, karrierën e tij të shkëlqyer profesionale dhe akademike, si dhe për profilin e tij të lartë njerëzor e intelektual, Dr. Mehdi Cani padyshim që ishte dhe mbetet dinjitetshëm në pramidën e kësaj elite.

Të sinkronizuara në kapitullin e dytë të librit të Tefta Camit “*Doktor Mehdi Cani, misionar i mjekësisë shqiptare*”, kujtimet e profesorëve dhe kolegëve të punës e plotësojnë më së miri profilin e këtij dishepulli të dijes e kulturës në këtë fushë të rëndësishme.

Nëse Prof. dr. Gojart Cerga, e vlerëson Dr. Mehdiun si përfaqësuesin e përkryer të figurës së mjekut të vërtetë, prof. Dr. Petrit Bara evidenton kujdesin e veçantë që Ai tregonte për të sëmurët, jo vetëm duke i dërguar nëpër konsulta, por duke i shoqëruar personalisht dhe duke marrë pjesë vetë nëpër konsulta për zgjidhjen e problemeve të tyre shëndetësore.

Skënder Çiço, ish - pedagog dhe zëvendës dekan i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, ndër të tjera shkruan se Dr. Mehdiu, në mjediset shoqërore ka qenë i sjellshëm, i drejtë, i dashur dhe komunikues me shokët e tij dhe me pedagogët.

“I kalitur me cilësitë më të mira si studjues dhe virtytet më të larta si njeri, dr. Mehdiu mbeti i tillë gjithë jetës, veçanërisht gjatë periudhës pesëdhjetëvjeçare, e karakterizuar nga tranzicione të çfarëllojshme, me të mirat dhe të këqijat e tyre”, shkruan Prof. Mynir Karagozi.

Si një nga përfaqësuesit më të denjë të elitës mjekësore shqiptare e vlerësojnë Dr. Mehdi Canin edhe dhjetra profesorë, pedagogë e mjekë që e kanë njohur nga afër, si: Prof. dr. Ahmet Kamberi, Prof. dr. Anesti Boçka, prof. dr. Ali Kuqo, Prof. Kolec Daja, Prof. Flamur Topi, Prof. Zamir Ndroqi e disa doktorë të tjerë me tituj e grada shkencore.

Po ashtu, Haxhi Dede Reshat Bardhi – ish Kryegjyshi Botëror i bektashinjve ndër të tjera shkruan në parathënien e librit se *gjithmonë ka besuar që Dr. Mehdiu, i ka parë shkencën dhe fenë si dy rreze të së njëjtës dritë...*”.

BASHKËSHORT DHE PRIND SHEMBULLOR

Ish - ministrja e Arsimit Tefta Cami (Cani), në librin me kujtime përshkruan të detajuara njohjet e takimet me bashkëshortin e saj të ardhshëm Dr. Mehdi Canin (që në fillim ishin të rastësishme).



“Më la mbresa përshëndetja për herë të parë me të (në një nga ditët e para të shtatorit 1958). Më tërhoqi pamja e trupi i gjatë mbi 1.80 m, fytyra e tërhequr e pak e zbehtë, që i jepnin një paraqitje fisnike e të fisme. Kishte veshur një kostum shik e me ngjyrë ulliri të errët dhe të prerë dopiopet, sipas modës së atyre viteve. Flokët i kishte me ngjyrë gështenjë dhe kaçurrel. Në atë çast të shkurtër sytë e tij shprehën sa ëmbëlsi, aq qenë edhe depërtues tek unë. Portreti dhe fizionomia e tij shprehnin mirësi e humanizëm, që e rrezatoi gjatë gjithë jetës së tij”, shkruan Znj. Cami në librin e saj “Doktor Mehdi Cani, misionar i mjekësisë shqiptare” (fq.27).

Kjo vajzë e re dibrane, me bukuri të rrallë fizike e shpirtërore (ashtu si edhe sot në moshën mbi 80-vjeçare), do të dashurohej kësisoj e do të krijonin një familje solide me doktor Mehdi Canin, që edhe ai, përveçse shkollimit në të gjitha nivelet me rezultate të shkëlqyera, kishte kryer si i thonë edhe të ashtuquajturin “Universiteti i Dibrës”, nga ku kish përvetësuar urtësinë dhe mençurinë e spikatur dibrane. Dhe kështu, në 240 faqe të librit të saj, Tefta Cami (Cami) jep detaje të nderimit e respektit që dr. Mehdiu kishte për familjen e saj me një prejardhje atdhetare e sidomos për të vëllanë Mois Camin, ish - deputet dhe një nga personalitetet e arsimit në Dibër;

periudhën katër vjeçare të letrave e lajmëthirrjeve (Kur Tefta ishte studente në Tiranë ndërsa dr. Mehdiu mjek e drejtor në Bulqizë e Peshkopi).., për Vitin e Ri 1962 që e festuan bashkë (hëngrën darkë me Mehdiun e Enver Vorfin në restorant “Vollga”); për çastin kur dr. Mehdiu e emëruan drejtor të spitalit të Peshkopisë dhe Shef të Seksionit të Shëndetësië..., për kohën kur Tefta pasi mbaroi studimet në USHT u emërua mësuese në shkollën 12 – vjeçare Demir Gashi Peshkopi – periudhë kjo e artë për të dhe Mehdiun sepse derisa u martuan dilnin lirisht bashkë, megjithëse nuk kishin bërë asnjë ceremoni familjare.

MARTESA E BASHKËSHORTËVE TEFTA E MEHDI CANI, DITËN E SHËN VALENTINIT

Ndoshta qe rastësi që Tefta e Mehdi Cami të kurorëzoheshin në martesë ditën e Shën Valentinit. Ja si e përshkruan Tefta këtë ditë të shënuar në jetën e tyre: *“Nuk mund ta shpjegoj se si për koinçidencë, apo qe e përzgjedhur, që ditën e martesës e kemi ditën e Shën Valentinit. Ne ishim të përgatitur që një ditë do të shkoja te shtëpia e re e saporregulluar. Mehdiu vinte çdo natë te shtëpia e Moisit dhe qëndronte deri vonë. Atë natë edhe unë me Mehdiun hëngrëm darkë te shtëpia e Moisit me nënën, Moisin e Semihanë, Fehmien, Majlindën e Agronin. Qe një darkë e pasur, e bukur dhe plot humor. Pas darke, kur Mehdiu u ngrit për të dalë si zakonisht, Moisi e ndali dhe i tha me të qeshur: ‘Meqë është dita e të dashuruarve, merre Teftën sonte me vete dhe shkoni në shtëpinë tuaj...’.” (fq.64).*

Aq u tha dhe ashtu u bë atë natë dimri të vitit 1964 kur bënte ftohtë e jashtë binte një vesë shi e përzier me dëborë. Në vend të pajës Tefta Cami mori shkollën dhe valigjen që e kishte pothuajse gati dhe dolën nga shtëpia e vëlla Moisit pasi u përqafulan me të gjithë të dashurit e saj. Jeta e mëvonshme bashkëshortore i mësoi më shumë se si të gatujnë e si të ushqehen, duke praktikuar një të ushqyer sa më të balancuar.

Gjithësesi, pas disa ditësh shkuan në Zerqan se nënat e Mehdiut (nënë Mitja dhe nënë Zoja) donin t’u bënin dasëm. *“E vendosëm dhe shkuam në fshat. Na rrethuan njerëz të thjeshtë dhe na shprehnin dashuri e respekt. Vesha një fustan prej taftaje me ngjyrë vishnje të çelët. Bëra pak tualet dhe vura një shall krahëve, sepse fustani qe dekolte dhe bënte ftohtë. Zbrita në katin e parë ku filluan të vijnë të ftuarit dhe qëndruam për pak kohë...”.* E

kësisoj, Tefta Cami e përshkruan ditën e dasmës së saj e të Mehdi Canit, me nënat që shprehnin gëzim sepse po martonin djalin e vetëm...Në dasmë ishin edhe dy familjet e tjera të Caneve, si Zeneli, xhaxhai i Mehdiut me të dy djemtë, Rifatin e Dilaverin; ishin edhe dy djemtë e Hysen Canit, Isaja me të shoqen, Piren, dhe Samiu me Ismeten, të sapomartuar, si dhe nëna e tyre, Hajria...Një dasëm, vertetë me rreth të ngushtë familjar e miqësor, kur dreka e darka u shtruan në dy dhomat e katit të parë të shtëpisë, me sofa të mëdha që paloseshin më dysh ku mund të hanin 15-20 vetë, që do të mbahej mend gjatë.

Tefta e Mehdi Cani patën mundësi ta njihnim më mirë njëri - tjetrin, të njihnin karakteret e tiparet, të njihnin interesat, si dhe dëshirat e aspiratat.

“Ashtu si ai, edhe unë pata mundësi të njihja vlerat e virtytet më të mira të tij, të cilat do t’i shpaloste akoma më tepër gjatë viteve që jetuam bashkë, siç qenë dashuria e kujdesi për familjen, dashuria e pasioni i madh për profesionin e dijet shkencore, dashuria e respekti për njerëzit dhe qëndrimi humanist ndaj njerëzve në nevojë pa dallim klasor e shoqëror, interesat e mëdha për jetën, ndjenjat e sakrificës e të përkushtimit për gjërat më të vlefshme familjare, krahinore e komëbatre. Unë qeshë e predispozuar që ato virtyte të mira të tij t’ia mbështesja e të ndikoja për t’i zhvilluar e afirmuar më tej”, - shkruan ndër të tjera Znj. Tefta Cami (Cani) në kujtimet e saj.

Pikërisht me këto virtyte, ata lindën, rritën dhe mirëedukuan tri vajzat e tyre: Ildën, Almën dhe Brikenën, sot të mirëformuara si intelektuale me vlera, të afta në profesionet e tyre, bashkëshorte e familjare shembullore, të vlerësuara e të respektuara nga shoqëria.

DR. ALMA CANI TRASHËGOI DENJËSISHT PROFESIONIN E BABAIT

Alma, një nga tri vajzat e Tefta e Mehdi Canit është aktulisht drejtore e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Terza”, Tiranë. Gjatë 34 viteve të karrierës së saj si mjeke ka ndjekur dhe ka ecur besnikërisht në gjurmët e babait të saj Dr. Mehdiut dhe po ashtu ka trashëguar dhe demonstruar virtytet e tij.

Që prej një viti kur Prof. Asc. Dr Alma Cani u emërua në drejtimin e QSUNT, ndryshimet në institucionin më të rëndësishëm spitalor të vendit janë të dukshme. Këtë e shprehin pacientët e shumë që marrin shërbimet

e duhura dhe jo vetëm. Me një përvojë të gjatë si mjekje prej 34 vitesh dhe me 6 specializime të ndryshme në Gjermani, Kanada, Egjipt, Turqi, e një sërë trajnimesh e seminaresh, konferencash dhe kongresesh në vende të ndryshme të botës, si Stamboll Turqi, Essen Gjermani, Ontario Kanada, Berlin Gjermani, në Mansoura, Kajro Egjipt, në Vjenë Austri, Barcelonë Spanjë etj, ajo qëndron dinjitetshëm me elitën mjekësore shqiptare (Në vitet 2013-2016 ka qenë anëtare e Komisionit Epror Mjekësor për Sëmundjet e Traktit Respirator)..Dhe mbi të gjitha me profilin e saj të admiruar njerëzor, profesional dhe intelektual, ajo pa dyshim që ishte zgjedhja më e mirë për të drejtuar QSUNT.

Ashtu si babai i saj dr. Mehiu kur drejtonte institucione të rëndësishme shëndetësore lokale e kombëtare, edhe Prof. Dr. Alma Cani, në drejtinin e QSUT, në vend të bujës, protagonizmit personal e autoritarizmit, ajo i qaset përmbushjes së misionit të përbashkët shtetëror dhe jo si privilegj vetiak pushtetor. Kolegët, të cilët i konsideron si asetin më të çmuar në përmbushjen e misionit e vlerësojnë Prof. asc.dr. Alma Canin si Njeri, mjek, shkencëtare dhe intelektuale shembullore. Si e tillë ajo është nga vlerat e rralla që prodhon shoqëria dhe familja shqiptare për të cilat ka nevojë më shumë se kurrë. Pikërisht si e tillë ajo ka marrë vlerësime dhe dekorime që të impresionojnë dhe që konsistojnë në: *diplomimin me medalje të artë (Shkolla e mesme e përgjithshme "P.N.Luarasi", Tiranë 1982-1986); Nga Bashkia e Tiranës vendoset poster Heronjtë e Tiranës (Prill 2020 - Bluzat e bardha në vijën e parë të luftës kundër Covid19; Nga Bashkia e Bulqizës i jepet titulli "QYTETARE NDERI" me motivacionin: "Për veprimtari të shquar në fushën e mjekësisë, veçanërisht në drejtimin e terapisë intensive e reanimacionit në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi" (Covid2) dhe për kontribut të çmuar profesional në përballimin e situatës të pandemisë të shkaktuar nga covid -19".(Vendim nr. 5 i Këshillit Bashkiak Bulqizë, 08-09-2020); Në nëntor 2023 nga Federata Universale e Paqes vlerësohet si Ambasadore të Paqes me motivacionin: "Federata e Paqes Universale njeh si Ambasadorë për Paqen ata individë për hir të të tjerëve dhe që i përkushtohen praktikave që promovojnë më shumë vlera universale, jetë të shëndetshme familjare, ndërftare, bashkëpunimi, harmonie ndërkombëtare, rinovimi i Kombeve të Bashkuara, i medias publike të përgjegjshme, dhe krijimi i një kulture paqeje.*

PROF. DR. PETRIT BARA-PERSONALITET I SHQUAR I MJEKËSISË SHQIPTARE ME INTEGRITET TË LARTË PROFESIONAL



“Vlerat njerëzore çmohen nga njerëzit e mençur”. Kjo sentencë, bashkudhëtare e historisë së njerëzimit, gjeti mishërim të plotë edhe më 13 shtator 2019 në Konferencën Shkencore “110 Vjet Kongresi i Dibrës – Ngjarje Historike për Kombin Shqiptar”, që u mbajt nga Shoqata Bashkësia Dibrane në Tiranë, në sallën e Konferencave të Akademisë së Shkencave. Në këtë event të rëndësishëm Prof. dr. Petrit Bara u dekorua me titullin Mjeshtër i Madh nga Presidenti i Republikës.

“Në vlerësim të kontributit të shquar në fushën e mjekësisë dhe në atë të jetës akademike e universitare. I dalluar për nivelin e lartë profesional, përkushtimin dhe cilësitë njerëzore. Hartues i suksesshëm i një sërë tekstesh universitare dhe traktatesh në fushën e mjekësisë”, është motivacioni i dekoratës që mban prof. Petrit Bara.

Ky dekorim u bë në një ceremoni mbresëlënëse me praninë e dhjetëra akademikëve e profesorëve të njohur, të cilët nderuan kolegun e tyre, Petrit Bara, profesorin e mirënjohur që demonstroi një model të ri sjelljeje dhe përkushtimi ndaj bashkëqytetarëve.

PAK NGA CV E TIJ

Petr̄it Bara u lind mē 11.01.1952 nē Peshkopi. Pērvēç diplomimit si mjek nē Universitetin e Tiranēs, mē 1977, me rezultate tē shkēlqyera, kreu specializimet jashtē shtetit pēr terapi intensive koronare dhe ekokardiografi nē Turqi (Ankara), Trafik Hastanesi, 6 muaj (korrik – dhjetor 1992); emergjenca kardiovaskulare, terapi intensive, ekzaminime joinvazive (Holter, Ekokardiografi, Provē ushtrimore) nē – Itali (Bari), Policlinico di Bari (Pērgjegjēs – Prof. Ritzon), 3 muaj (korrik – tetor 2001) dhe sērish – Itali (Romē), Ospedale Sandro Pertini, shtator 2004.



Si njohēs i tri gjuhēve tē huaja (anglisht, gjermanisht dhe rusisht), prof. dr. Petrit Bara do tē udhēheqē ndēr vite titujt e projekteve: Hipertensioni arterial dhe komplikacionet e tij – mē 1998, si dhe infarkti akut i miokardit dhe rehabilitimi i tij mē 2001. Ai njihet nē rrethet akademike e shkencore si botues i disa teksteve me vlera tē pallogaritshme shkencore, si: “Trajtimi farmakologjik i urgjencave kardiovaskulare”, “Sēmundjet e brendshme”, “Trajtimi i urgjencave hipertensive” (monografi), Statistika – tekst pēr shkollat e larta tē infermierisē, Shēndeti Publik – Manual pēr shkollat e larta tē Infermierisē, “Sēmundjet e brendshme”, “Fakulteti i Infermierisē dhe Fiziologjia patologjike.

Po ashtu, prof. dr. Petrit Bara, si një nga personalitetet mē nē zē tē kardiologjisē, njihet si kryeredaktor i revistēs “Infermiera dhe mjekēsia bashkēkohore” dhe si pedagog pranē Fakultetit tē Shkencave tē Mjekēsisë nē Universitetin Shtetēror tē Tetovēs, qē nga viti 2003 pēr lēndēn e fizio-patologjisē.

Nē këtë profil punoi me devotshmēri e pērkushtim si mjek kardiolog, shef i pavijonit tē kardiologjisē nē Qendrēn Spitalore Universitare “Nënë Tereza” tē Tiranēs, si pedagog, themelues dhe dekan pēr një dekadē i Fakultetit tē Infermierisē. Personaliteti dhe karakteri i tij nē asnjē rast nuk

devijoi, por u shpalos dinjitoz për më shumë se tri dekada në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të shkencave mjekësore. Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrrës së dëshiruar në vite.

Në këtë përditshmëri mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësues i elitës intelektuale shqiptare. Ndaj, edhe pas titujve “Qytetar Nderi” i Dibrës, Bulqizës e Tetovës, që i kanë dhënë atij bashkitë e qyteteve respektive, dekorimi nga Presidenti i Republikës, me titullin “Mjeshtër i Madh”, është vlerësim i meritave dhe kontributit të intelektualit, demokratit dhe kuadrit shembullor Petrit Bara. Ai, para së gjithash, vlerësohet për kontributin e çmuar dhe fisnik në progresin e diturive shkencore në lëmin e mjekësisë.

PERSONALITET I SHQUAR ME INTEGRITET TË LARTË

Prof. dr. Petrit Bara është një personalitet i shquar me integritet të lartë profesional në fushën e mjekësisë si për arritjet e tij akademike, të cilat i dëshmon në volume të tëra shkrimore, si tekste akademike të publikuara brenda dhe jashtë Shqipërisë, ashtu edhe për përvojën prej katër dekadash si mjek kardiolog dhe drejtues i përkushtuar, i cili reflekton një intuitë të rrallë intelektuale gjatë aplikimit të njohurive shkencore në situata praktike të shërbimit mjekësor kardiologjik.

Prof. dr. Petrit Bara, që ka shërbyer prej dekadash me përkushtim të veçantë dhe humanizëm të thellë, përbën një shëmbëlltysë të konstruktivizmit në fushën e dijes. Ai di të ndërtojë ide dhe zhvillime të reja në reformat e ndërmarra si në përmirësimin e cilësisë së shërbimit mjekësor, ashtu dhe në formimin profesional të gjeneratës së re të mjekëve dhe specialistëve që nesër do të jenë promotorë të arritjeve cilësore të fushës së mjekësisë.

Reformat që prof. Bara ka realizuar si dekan i Fakultetit të Mjekësisë të UT dhe si zëvendesdekan i Universitetit “LUARASI” kanë në qendër kërkimin shkencor, zhvillimin kurrikular, metodologjinë e mësimdhënies, cilësinë e menaxhimit të shërbimeve përmes një sistemi inovativ. Gjithashtu, vetëqeverisja në liri akademike dhe autonomi financiare, rekrutim i personelit me procedura transparente konkurrimi, konceptimi i ri mbi funksionimin e UM si qendër universitare teoriko-praktike, ku zgjidhjet vijnë si qasje konstruktive në bazë situatë, motivim të studentëve

dhe pedagogëve dhe lidhjeve ndëruniversitare me institucione homologe perëndimore, kanë qenë prioritetete të platformës së tij.

Dr. Petrit Bara është vizionar dhe kreativ. Këtë ai e tregoi më së miri në krijimin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, të cilin e krijoi, e reformoi dhe si dekan i tij për një dekadë e bëri një fakultet me impakt publik kombëtar dhe ndërkombëtar, nga ku diplomohen me një performancë të admirueshme qindra specialistë të shërbimit mjekësor. Studentë të shkëlqyer që dalin nga ky fakultet performojnë jo vetëm brenda vendit, por edhe në vende të zhvilluara perëndimore.

Prej disa vitesh Prof. Petrit Bara është zëvendës rektor dhe dekan i Fakultetit të Infermierisë në Universitetin prestigjioz “LUARASI”. Është fat për këtë universitet që të ketë një dejtues dinjitoz si prof. dr. Petrit Bara, një mjek dhe pedagog i përmasave ndërkombëtare, pasi aftësitë e tij drejtuese të provuara në një përvojë të gjatë, garantojnë cilësi dhe zhvillim.



PROF.ASC. ISLAM DAUTI, INTELEKTUALI I SHQUAR ME PËRMASA MBARËKOMBETARE

- Me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë, Këshilli Bashkiak i qytetit të Bulqizës e nderoi me titullin ”Nderi i Qytetit”

Dr. Islam Dauti është padyshim një nga figurat më emblematike të trevës së Bulqizës, me përmasa dhe kontribute mbarëkombëtare. I njohur si kirurg plastike i specializuar për operacionet plastike të barkut dhe të gjirit, Dr. Dauti ka një përvojë shumëvjeçare në fushën e ndërhyrjeve kirurgjikale trupore.

Gjithashtu është i specializuar në ndërhyrjet kirurgjikale pas djegieve.



FËMIJËRIA

Ka lindur më 17.02.1942 në fshatin Vajkal të rrethit Bulqizë. Shkollën fillore e filloi në vitet '50, kur ekzistonte vetëm një shkollë fillore në të gjithë fshatin, e cila e ushtronte aktivitetin në verë, nga muaji Mars deri në Nëntor. Kjo për arsye të kushteve atmosferike dhe vetë shtrirjes së fshatit në një territor të gjerë, por edhe për faktin se nxënësit ishin të një moshe të vogël, nga 7-11 vjeç.

Pasi mbaroi klasën e IV me rezultate të mira, ambicja e tij, qoftë edhe për atë moshë, ishte që të vazhdonte më lart.

Në vendlindjen e tij nuk kishte variant për të vazhduar 7 vjeçaren, apo siç i thonin atëhere uniken, pasi e vetmja shkollë në atë zonë ishte në Zerqan, pra duheshin 2-3 orë me këmbë për të shkuar atje. Një pjesë e vogël e moshatarëve të tij që kishin të afërm në atë zonë filluan shkollën

në Zerqan. “Unë isha me fat mbasi xhaxhai im Hajdari, që kishte dalë nga lufta oficer dhe ishte caktuar me punë në Tiranë më ndihmoi për të vazhduar ëndrrën e shkollimit. Ndërsa shumë nga moshatarët e mi, me gjithë se dallonin qysh në femijëri për zgjuarsi, zell e intuitë për të mësuar, nuk e patën mundësinë dhe mbeten vetëm me arsimin fillor apo unik”, rrëfen Dr. Islami.

NË TIRANË, NË SHKOLLËN 7 VJEÇARE

Xhaxhai, Hajdari banonte me bashkëshorten e tij Kadifen në lagjen Ali Demi, në një dhomë të vetme të një shtëpie përdhese tiranase të asaj kohe. Duke qenë në këto kushte shtëpie, por edhe ato ekonomike, pasi në atë kohë paslufte funksiononte sistemi i triskëtimit, si 400gr. bukë misri etj., xhaxhai e futi në gjirin e familjes së tij dhe e trajtoi si fëmijën e vet.

Shkolla ishte shumë afër shtëpisë dhe quhej Shkolla 7 vjeçare “Ali Demi”. Islami, klasën e IV e mbaroi në Bulqizë në muajin Nëntor dhe erdhi në Tiranë në muajin Dhjetor, ku ndërkohë shkolla këtu kishte filluar qysh në muajin Shtator. U paraqit në Drejtorinë e Shkollës me xhaxhain e tij, ku i pritën shumë ngrohtë. Do të fillosh si degjues sivjet, i thanë. Të këtij mendimi ishin Islami dhe xhaxhai, duke qenë të ndërgjegjshëm, pasi kishin kaluar 3 muaj që nga fillimi i shkollës dhe kështu u vendos. Nga ana tjetër, për vogëlushin nga Vajkali ishte hera e pare që dilte nga fshati në një qytet si Tirana. Fillimi ishte mjaft i vështirë, nuk njihnte njeri e i dukej vetja i huaj dhe i humbur. Mësuesja e klasës së V-të, një grua relativisht e moshuar, me një zë të ëmbël dhe zemrën e një nënë të vërtetë, qysh ditën e parë e mbajti afër dhe i gjëndesh në çdo moment. Ajo filloi t’i vërë detyra suplementare për mesimet që kishin kaluar, duke bërë edhe punë jashtë orëve të mësimet. Këtë detyrë ajo e bënte me shumë zell pa asnjë shpërblim dhe detyrim, kështu që, me këmbënguljen e kësaj zonje (zysh Dallëndyshja), Islami mundi të arrij në përparim shokët e klasës dhe të kualifikohet bashkë me të tjerët. Në klasën e VI-të ishte më i qetë pasi ishte më i ambientuar; kishte krijuar shoqëri të reja dhe nuk kishte vështirësi. Viti mësimor kaloi mirë dhe rezultatet e këtij viti ishin shumë më të mira nga ato të klasës së V-të.

Në verën e këtij viti xhaxhai i tij, Hajdari, transferohet në Tropojë. Ndërkohë që Islami ishte në Bulqizë te prindërit, vjen dhe xhaxhai në fshat

me pushime të lejes së zakonshme dhe më pas do të shkonte në Tropojë. Në këto rrethana Islami vendosi që të mos shkonte në Tropojë pasi në qytezën e Bulqizës ishte hapur një shkollë nate 7 vjeçare për punëtorët e minierës ku sapo kishin filluar punimet për ndërtimin dhe shfrytëzimin e saj dhe mendoi ta përfundojë aty klasën e VII-të.

JETA NË BULQIZË

Kushtet ekonomike në fshat ishin të vështira. Filloi të kërkonte për një punë ditën dhe të vazhdonte shkollën natën. Në Bulqizë veç ndërmarrjes së kromit ishte hapur edhe ndërmarrja e furnizimit të punëtorëve (NFP), ku drejtor i saj ishte Hamit Koçi, një bashkëfshatar i tij, të cilit iu drejtua për ndihmë që ta sistemonte në ndonjë punë. “I ndjeri Hamit më vështroi nga koka e deri te këmbët dhe me pyeti: ”Po çfarë mund të bësh ti”?, Çfarë të mendoni Ju, u përgjigja. ”Po Jashari (im atë) e di për këtë”?. Po i thashë. Ai tundi kokën. Pas një heshtje, më tha që të vish të më takosh nesër. U largova me pesimizëm dhe për këtë e bisedova në shtëpi edhe me prindërit, që në fakt deri në këtë moment nuk dinin gjë për çfarë kisha bërë dhe natyrisht që nuk ma miratuan. Megjithatë unë të nesërmen shkova tek drejtor Hamiti, aty në zyrë gjeta edhe një burrë të moshuar që e thërrisnin xha Rrema. Mbasi u përshëndetëm, drejtori i thotë xha Rremës se ky është djali i Jashar Dautit dhe ka dëshirë të punojë si kamarier tek klubi jot. Po qenka shumë i vogël more drejtor, thotë xha Rrema. Nuk ka gjale se ka 6 klasë shkollë, ia priti drejtori”, -shprehet Dr.Dauti në kujtimet e tij.

PUNA SI KAMARIER ME XHA RREMËN

Xha Rrema (Muharrem Bala), asokohe ishte një burrë rreth të 60-tave po nga fshati Vajkal. Nuk kishte asnjë klasë shkollë, por kishte një zgjuarsiri natyrale dhe intuitë të jashtëzakonshme. Kishte hapur klubin siç i thonin atëhere, ku me vonë u quajt ”Kino-klubi”. Xha Rrema ishte banakier, ndërsa Islami kamarier, por më tepër shërbente si ndihmësi i tij për plotësimin e dokumentacionit dhe problemet e tjera si, inventarizimi i mallit, derdhja e lekëve në llogari, e të tjera shërbime të kësaj natyre dhe natyrisht me pastrimin, sistemimin e sallës, larjen e filxhaneve, gotave etj. Xha Rrema bënte kafën turke, servirte raki, konjak, fernet, uzo e vodka nga banaku me

parapagim e vetshërbim. Ai vinte në punë që në orën 6 të mëngjezit dhe largohej në orën 10-11 të darkës e bashkë me të edhe Islami.

Nga një herë, sidomos dimrit që ishte akulli e bora Islami i thoshte:

- Xha Rrema e mbyllim tani se nuk vjen njeri?!

-Jo me dajën – i thoshte ai – s’kemi si e mbyllim se tani është nxhira më e madhe se vijnë sulfetikët. Në fakt në atë kohë punonin disa inxhinierë sovjetikë edhe me turne dhe ktheheshin nga turni i dytë. Futeshin në lokal që ishte i vetmi i hapur në atë orë dhe pinin vodka me gota uji e natyrisht xha Rrema ua kishte zbutur pak. Kështu vazhdoi ky vit, ndërsa shkollën e “harroi”. Vajti disa herë dhe në fakt xha Rrema nuk e pengonte, por Islami, sa futej në klasë pas pak e zinte gjumi dhe lëre më për të mësuar. Më vonë pas një farë kohe drejtor Hamiti u transferua në Rubik dhe drejtor vjen Vaso Shqevi, i cili pa mbushur muajin në detyrë e mbyll klubin dhe Islamin, që të mos quhej ”pushim nga puna”, e transferon në ekonominë ndihmëse të NFP-së në Homesh. Natyrisht që nuk shkoi, dhe kur xhaxha Hajdari vjen nga Tropoja me pushimet e verës në fshat e mori me vete për të përfunduar klasën e VII-të në Tropojë.

VAZHDIMI I SHKOLLËS NË TROPOJË

Jetonin në shtëpinë e një fshatari që quhej Syl Mehmeti. Shkolla ishte 5 minuta larg nga shtëpia. Tropoja e vjetër deri në atë kohë kishte qenë qendër administrative e krahinës dhe aktualisht administrata ishte transferuar në Kolgecaj (Bajram Curri i sotëm). Në Tropoje kishin mbetur shumë pak zyra si, gjendja civile etj., por Reparti Ushtarak i kufirit e kishte qendrën aty, efektiv i të cilit ishte edhe xhaxha Hajdari.

Islami vazhdoi rregullisht shkollën duke e përfunduar atë me rezultate shumë të mira.

NGA TROPOJA NË TIRANË, PËR MJEKËSI USHTARAKE

Me të përfunduar 7-vjeçaren në Tropojë, Islami bëri kërkesë për të vazhduar shkollën e mesme, ku dëshira e tij ishte të bëhej mjek, gjë të cilën ia ushqente dhe xhaxhai. “Kërkesa për shkollë bëhej duke kërkuar 3 degë. Unë shkruajta në kërkesë mjekësi, mjekësi, mjekësi. Në mesin e muajit Gusht vjen një fletë-thirrje për t’u paraqitur në Degën Ushtarake me datë

dhe orë të caktuar. U çuditëm pasi unë isha nën moshë për t'u mobilizuar ushtar dhe mendja më shkonte mbase mund të më kenë ngatërruar me vëllezërit e mi më të mëdhenj. Megjithatë në ditën dhe orën e caktuar, i shoqëruar nga xhaxhai dhe korrieri i repartit shkuam në Kolgecaj në Degën Ushtarake ku na priti një nga oficerët e degës. Pasi u prezantuam, më komunikoi se më ka dalë bursa për mjekësi ushtarake. Unë menjëherë ia ktheva se nuk kam bërë kërkesë për shkollë ushtarake, por për mjekësi. Mos u mërzit se për mjekësi po të çojmë edhe ne, por për llogari të ushtrisë pëgjigjet ai, prandaj firmos këtu duke më vënë përpara një formular dhe kur të lajmërojmë do të paraqitesh këtu”,-kujton Islami me nostalgji.

Në fundin e Gushtit i vjen përsëri lajmërimi për t'u paraqitur në Degën Ushtarake dhe do të nisej për Tiranë. Përsëri së bashku me xhaxhain u paraqitën në ditën e caktuar. Nga Tropoja ishte caktuar edhe një tjetër po në këtë degë, të cilin nuk kishin mundur ta lajmeronin pasi ai ishte për verim në bjeshkë. U kishin zënë hotel dhe I porositen që të ktheheshin të nesërmen. Shoku tjetër, që e kishte emrin Nuredin Malaj erdhi mbas dite, kështu që e shtynë udhëtimin për në Tiranë ditën tjetër. Të nesërmen, të shoqëruar nga një kapter i degës u nisën me një makinë kamion tip Ziz, e përshtatur si autobus, me disa stola druri dhe e mbuluar me tendë mushama. Mbërrijnë në Shkodër rreth drekës dhe pastaj me autobuz të rregullt u nisën për në Tiranë. Mbas shumë peripecish e gjetën adresën, që ishte Shkolla e Bashkuar ku përgatiteshin kursantët për oficerë.

FILLIMET NË SHKOLLËN E MESME

Kapteri që i shoqëronte nga Dega Ushtarake e B.Currit u paraqit në postobllokun e shkollës, ku para tyre u paraqit një kapter mesoburrë, i shëndoshë, më shumë i gjerë se i gjatë. Pasi pa dokumentat që i dha shoqëruesi, i mori të dy, Islamit dhe Nuredinit dhe ata e ndoqën nga pas. Shkojnë në magazinë ku i furnizoi me materialet e fjetjes, si çarçafë, batanie e jastekë dhe pastaj u tregoi kapanonin ku gjetën edhe 10-15 shokë të tjerë të moshës së tyre. U caktoi krevatin, që natyrisht ishte tip marinari lart e poshtë. Nuredinit që ishte një djalë i hollë dhe i gjatë, Islami i vinte deri nën sqetull. Ai u ngjit lart dhe Islami poshtë. “Ishim shumë të mërzitur dhe mendja na rrinte tek ata që na e punuan, pasi mendonim se nuk ishim në vendin e duhur, por më vonë e kuptuam se destinacioni ynë ishte mjekësia.

Filloi shkolla. Në mëngjes, në komandën e një kujdestari, shkoni në rresht nga Shkolla e Bashkuar në teknikumin mjekësor, që ishte aty ku sot është "Medreseja". Pra hanim e flinim në Shkollën e Bashkuar dhe mësonim në shkollë civile bashkë me nxënësit e tjerë. Jeta në shkollën ushtarake na vinte përballë disa detyrave të rregullores ushtarake që për ne ishin të rënda dhe jo shumë të tolerueshme. Shpesh ne bënim shkelje të rregullores së brendshme e për këtë dënoheshim edhe me burg ditor, konform rregullores së disiplinës që ishte në atë kohë. Kjo periudhë zgjati vetëm dy vjet, mbasi komanda e shkollës e kuptoi që nuk mundnim që në një moshë 15-16 vjeçare të zbatonim rregullat e një shkolle që përgatiste oficerë të moshës 20 vjeçare. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes kaluam në konviktin e nxënësve të teknikumit mjekësor", rrëfen Dr.Dauti.

JETA NE KONVIKT

Këtë ndryshim e mësuam ditën e parë të vitit të tretë, kur u kthyen nga pushimet e verës. Duhet të hiqnin uniformën dhe të kalonin civila. Kjo nga një anë i gëzoi por edhe i hidhëroi, pasi nuk ishin përgatitur për uniformë civile. Nuk kishin asnjë rrobë civile, kështu që bluzat verore që kishin, i adaptuan duke u futur llastik dhe i sajuan në një farë mënyre deri sa erdhën ndihmat në konvikt dhe i furnizuan me këmisha, xhaketa e pantallona civile, ndërsa këpucët i kishin ato të ushtrisë. Ushqimi në konvikt ishte shumë më i pakët si në sasi dhe cilësi nga ai që hanin në ushtri, por shpejt u ambjentuan. Dr.Islami kujton se duke qenë se vinte në këtë shkollë nga B.Curri, u njoh përveç Dr.Nuredinit që erdhën së bashku, me shokë të tjerë tropojanë si Dr.Dine Abazi, Dr.Shaban Malaj, Dr.Sali Berisha, Dr.Hazir Malaj e shumë të tjerë. Jeta rridhte natyrshëm. Kjo kohë mjaft e bukur e kësaj periudhe të bukur të moshës së fundmi mbaroi. Përfundoi shkollën e mesme ku u titullua Ndihmësmjek. Rezultatet e përfundimit ishin shumë të mira, se edhe kërkesa ishte mjaft e lartë. Para se të mbaronin provimet e diplomës u kërkuar që të plotësonim kërkesën për të vazhduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë. "I plotësuam të gjitha kërkesat, të cilat u dërgoheshin rrethëve përkatëse për shqyrtim dhe miratim, ndërkohë ne kaluam në pushimet verore. Unë shkova në fshatin tim të lindjes pranë prindërve, mbasi dhe më kishin fejuar me një vajzë nga fshati, nga një familje e mirënjohur në fshat.

Më 15 Gusht 1959 postieri më sjell një shkresë të firmosur nga shefi i seksionit të arsimit ku shprehej se më ishte aprovuar e drejta e studimit për në fakultetin e mjekësisë. Gëzimi im ishte i pallogaritshëm, por nuk zgjati shumë kohë se pas 10 ditësh vjen një tjetër shkresë nga Ministria e Mbrojtjes ku kërkonte që me datë 25 Gusht të paraqitesha në Drejtorinë e Kuadrit të MM. Ky lajm na çoroditi shumë. Interesoheshim në seksionin e arsimit por ata nuk kishin dijeni për këtë problem.

U paraqita në Ministrinë e Mbrojtjes së bashku me 9 të tjerë, të cilët kishin të njëjtin lajmërim. Aty na priti shefi i shëndetësisë të ushtrisë Gjeneral Ibrahim Dervishi, i cili na komunikoi kalimin në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes, ashtu siç kishim qenë qysh në fillim. Nga ana jonë u kundërshtua pasi kërkonim që të vazhdonim studimet meqenëse na ishte dhënë e drejta e studimit nga Ministria e Arsimit. Përgjigja ishte se për këtë vit nuk qe e mundur, mbasi janë repartet bosh nga ata që kishin ardhur në fakultet. Ne nuk e lamë me kaq, prandaj i bëmë një kërkesë Ministrisë së Mbrojtjes të asaj kohe Gjeneral Beqir Balluku. Shpresa jonë ishte se në radhët tona kishim edhe shokë të cilët lidheshin me strukturat e larta të asaj kohe si ministra, anëtarë byroje etj. (veç meje). Për t'i dhënë përgjigje kërkesës tonë ishte ngarkuar drejtori i drejtorisë së kuadrit Gjeneral Et'hem Gjinushi, i cili komunikoi përgjigjen e kërkesës sonë, natyrisht negative dhe na urdhëroi që të paraqiteshim në Spitalin Ushtarak për të pritur emërimet. Drejtorja e spitalit ishte urdhëruar për të marrë masa duke na sistemuar në një dhomë për fjetje dhe për të ngrënë në mensën e spitalit. Pas një muaji qëndrimi aty, një ditë na vjen shefi i shëndetësisë Gjeneral Ibrahim Dervishi bashkë me një instruktor të kuadrit, ku na komunikuan urdhërin e MM për titullim oficer me gradë Nëntoger dhe emërimin tim në Brigadën e 8-të Korçë, në batalionin e parë të këmbëtorisë Bilisht. Brënda 5 ditësh duhet të paraqiteshim në detyrë. Urdhërohej prapavija e spitalit për të na pajisur me uniformën përkatëse dhe të shkonim në detyrë”, -rrëfen Dr.Dauti.

PERIUDHA NË REPART

Në Korçë nuk kishte shkuar asnjë herë. Sapo mbërriti pyeti shokun e tij nga Erseka por që u emërua në Tiranë, se çfarë hotelesh kishte Korça, ku ai midis të tjerëve i tha: Hotel “Borova”. Dhe në çast Islami i bën një

telegram hotelit që t'i rezervonte një vend për atë ditë që kishte vendosur të nisej. Arriti në Korçë rreth darkës. Mori një taksi ku i kerkoj ta më çonte te Hotel "Borova". Pasi u sistemua në hotel, të nesërmen duhet të shkonte të paraqitej në brigadë. Ja si e kujton Islami atë ditë: "Sapo dal nga hoteli para meje ishte një ushtar i cili ecte me shpejtësi. Mendova se ai duhet të shkojë në repart dhe ju vura pas dhe pasi e pyeta ai më dërgoi në parkun e makinave dhe më orientoi për të shkuar në Brigadë. Paraqitem në postobllok ku i jap shkresën që tregonte pozicionin tim. Më thanë të presë në një dhomë pasi tani vjen dhe komandanti. Pas pak minutash dëgjoj një zë të kumbueshëm duke raportuar -"shoku kolonel ... etj". Vështroj nga dritarja një burrë të pashëm veshur me një uniformë të rregullt ushtarake. Ky është komandanti i brigadës kolonel Xhafer Peçi me thotë një nga ushtarët. Pasi mbaroi ceremonia e mëngjesit, oficeri i rojes më dërgoi tek shefi i kuadrit të brigadës i cili kishte dosjen time përpara, e cila kishte ardhur para meje. Po të prisnim më tha ai dhe më rikomunikoi emërimin në batalionin e I-rë Bilisht apo siç emërtohej Rep.Usht.Nr.5777".

NË BILISHT

Të nesërmen u paraqit në këtë komandë ku si fillim e sistemuan në shtëpinë e beqarëve në një dhomë të madhe ku banonin 4 oficera dhe ai. Në repart e kompletuan edhe me pajime vetjake si çantë shpine, kundragaz, pistoletë etj. Batalioni i Bilishtit ishte artmitralier me gjysëm kompletim efektiv aktiv dhe pjesa tjetër plotësohej me rezervistë këmbësorie, mitraljere dhe një bateri mortaje. Kishte një infermeri ku shërbente veç Islamit dhe një infermier ushtar. Kjo njësi ishte në mbështetje edhe të forcave të kufirit të kësaj zone që mbulonte mbrojtja e batalionit në të gjithë Devollin. Bilishti në atë kohë kishte një spital të vogël me një mjek. Kur Dr.Vexhi Subashi (mjeku i vetëm) dilte për vizita, Dr.Dauti e shoqëronte dhe shpesh here ai ia linte vizitat atij, pasi vetë ai vizitonte edhe në shtëpi privatisht pasi atëherë lejohej.

ALARMI I PARË NË BILISHT

"Isha shumë i ri vetëm 19 vjeç. Shokët e mi akoma nuk ishin mobilizuar ushtarë, të cilet u mobilizuan pas 1-2 vjetësh, ndërkohë unë isha graduar

nëntoger dhe e njihja shumë pak ushtrinë.

Nuk e mbaj mend mirë rreth një javë apo 10 ditë që kisha filluar punë, një natë rreth mengjesit troket në derë korrieri që lajmëron "Alarm"! Menjëherë në dhomë filloi zhurma ku secili kërkonte të vishej sa më shpejt dhe të pajisej me kompletin e nevojshëm. Edhe unë e kisha përgatitur çantën e shpinës sipas kërkesave i ndihmuar edhe nga shokët e dhomës. U vesha shpejt, mora pajimet dhe me vrap shkua në repart, i cili ishte shumë afër nga dhoma jonë. Në fushën e repartit ishin rreshtuar forcat ushtarake me armatimet përkatëse. Mushkat u ngarkuan me artileri dhe arkat e municioneve. Kudo mbizotëronte heshtja dhe serioziteti. Shtabi në krye të batalionit dhe pastaj kompanitë e baterite me rradhë. Në mes qëndronte shefi i shtabit i cili i paraqiti forcën komandantit të batalionit major Zarif Poloska, i cili pasi mori përshtetjen urdhëroi që oficerat të futeshin në klasë.

Zumë vendet në sallën e mbledhjeve, pas pak minutash futet komandanti me një seriozitet jo të zakonshëm për mua. Hapi një hartë mbi tavolinë dhe mbasi mbështeti dy duart në dy cepat e hartës me gishtat e hapur në formë kthettrash dhe tha: -"shokë oficera, gjendja është reale. Monarkofashistët grekë me regjimentin aq e kaq kanë sulmuar në drejtim të vendit tonë...". në sallë ra heshtja e plotë, dëgjohej me vëmendje çdo fjalë e komandantit dhe të gjithë me kokë ulur mbanim shënime. Une nuk dija se çfarë të bëja, nuk e kisha fare idenë se ç'po bëhej, vetëm me naivitet mendoja "po mirë mua pritën këta grekët që të sulmonin".

Dukesh gjithçka reale. Komandanti vazhdonte të jepte detyra. Kompania e parë do të vendoset këtu, e me rradhë baterite e së fundmi dëgjoj, vendmjekimi i batalionit të vendoset në Poloskë, me qëllim që të tërhiqen të plagosurit etj.etj. Pasi u dha urdhër për të zënë pozicionet e caktuara, shkoj te ushtari infermier dhe i them po tani që erdha unë e gjetën këta grekët. Mos u merzit më thotë shoku nentoger, një herë e bën këtë punë komandanti i batalionit, një herë tjetër vijnë nga brigada e nga ministria, kjo është lojë më thotë ushtari. Atëherë u qetësova pak. I them se ku është vendmjekimi i batalionit dhe ai më thotë mos u bej merak se ta tregoj unë. Në organiken tonë kishm dy kuaj, të cilët i ngarkua me materjalet e shëndetësisë, e kështu zumë pozicionet që na ishin caktuar, duke hapur vendmjekimin e batalionit ku qendruam deri të nesërmen

në drekë e pastaj u dha urdhëri për t'u kthyer në repart. Gradualisht u ambjentova me këtë regjim, por mendjen e kisha të vazhdoja fakultetin. Çdo vit bëja kërkesë e më në fund pas 4 vjetësh në Bilisht u riaprovua e drejta e studimit në fakultetin e mjekësisë, por kjo periudhë me gjeti të martuar dhe me një fëmijë”, -rrëfen Dr, Islam Dauti.

FAKULTETI

Shkëputja prej një periudhe 4 vjeçare, shtuar këtu edhe problemet familjare, ia vështirësuan procesin mësimor në fakultet. Ju desh të gjente shtëpi për të sistemuar familjen, mbasi nuk kishte të drejtë strehimi, sepse ishte student dhe jo i transferuar me punë në Tiranë. Këtë gjendje e vështirësonte mospasja e pashaportizimit në Tiranë dhe si i tillë nuk ishte i regjistruar në asnjë nga listat që furnizohej popullata me ushqimet bazë, si buka, mielli, gjalpi, mishi e vaji dhe të gjitha ushqimet e shportës. Etapa e parë ishte strehimi, të cilin ia zgjidhi një bashkëfshatar me banim në Tiranë, ku ai kishte 2 dhoma nga të cilat njerën ja liroi Islamit. Kishte një sipërfaqe 12m katror, banjo e përbashkët jashtë, po ashtu e ndihmonin edhe për bukën që merrnin mbi normë duke i llogaritur edhe Familjen Dauti. Ekonomikisht ishte shumë e vështirë të përballej vetëm me bursën që jepte shteti. “Familja ime dhe ajo e sime shoqeje na ndihmonin me sa mundeshin, por edhe ata nuk ishin në gjendje të mirë me të ardhurat e kooperativës bujqësore. Gjatë vitit të parë në fakultet më lindi dhe fëmija e dytë dhe i treti në vitin e IV. Kështu që vështirësitë shtoheshin, por me vullnet dhe me rini s’ka gjë që nuk kalohet dhe kështu përfundova studimet me rezultate të mira”, - shprehet Dr.Dauti. Pas përfundimit të studimeve në fakultetin e mjekësisë, fillimisht u caktua në Institutin e Kërkimeve Mjekësore Ushtarake (IKMU), sot Spitali Ushtarak, në repartin e kirurgjisë, specialitet të cilin e dëshironte shumë. Në këtë specialitet mjekët kirurgë Dr.Ismail Feta, Dr.Spiro Dede e Dr.Maksut Dërrasa që drejtonin këtë repart ishin shumë dashamirës me Islamin dhe me gjithë specializantët e tjerë.

E transferuan në Korpusin e Shkodrës dhe prej aty në Kukës, me detyrë Shef i Shëndetësisë së Brigadës 24K (Rep.Usht. Nr.6600), me vend dislokim në Kolsh.

Puna në Kukës fillon me vështirësitë e zakonshme si për çdo fillim.

Komanda e brigadës ishte mësuar me paraardhësin e tij që mjeku të rrinte vetëm në repart ku kthehej thjeshtë në një administrator. Dr. Islami, tashmë, për një periudhë të shkurtër, kishte marrë nga Spitali Ushtarak në Tiranë nocione të nevojshme për kirurgjinë, ku nën drejtimin e mjekëve kirurgë kishte kryer edhe disa operacione të kategorive të lehta. Në spitalin civil të Kukësit kishte vetëm një kirurg, me një volum mjaft të madh operacionesh. Pra, ndihej nevoja për një ndihmës të tij. Kështu që ai, fillimisht jashtë orarit të punës dhe ndonjëherë edhe në kohë pune shkonte e punonte atje bashkë me kirurgun e rrethit Dr. Reshit Zusi, i cili e mirëpriste. Me kalimin e kohës, me propozim të tij, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit i kërkon komandës së repartit që të mos e pengonte për të qenë në spital në rast operacionesh. Kjo u bë me kalimin e kohës për të një "trampolinë" për t'u lidhur më shumë me punën në spitalin civil, po ashtu për të kërkuar kompletimin e specializimit që kishte lënë në mes. Për këtë i duhej që të kryente edhe një periudhë tjetër specializimi pranë Spitalit Qëndror Ushtarak (SQU), të cilin e kreu me sukses duke marrë dëshminë si "kirurg i përgjithshëm". Tashmë u zyrtarizua vijimi i punës në këtë spital dhe formalisht figuronte në repart.

Çdo vit bënte kërkesë për transferim për në SQU por refuzohej nga MM me arsyen se nuk kishin zëvendësues.

Në vitin 1974, me riorganizimin e ushtrisë, u krijua Korpusi i ri në Pukë, ku përfshinte në vartësi edhe brigaden ku ai bënte pjesë. Me qenë se vendi i Shefit të Shëndetësisë së Korpusit ishte bosh, u muar vendim nga Komiteti i Partisë së Korpusit dhe e emëruan në këtë pozicion, ndërkohë që ai kishte kërkuar të transferohej në SQU. Në atë kohë këto vendime e urdhëra nuk diskutoheshin, por zbatoheshin. Kështu bëri edhe Dr. Islam Dauti, filloi punë në korpus që përfshinte Pukën, Tropojën, Krumën, Kukësin, e në thellësi Rrëshenin. Për mua ishte një punë shumë e padëshiruar, por nuk kisha rrugë tjetër. Korpusi i Pukës ishte njësi e vijës së parë që mbronte gjithë vijën kufitare nga Shkodra e deri në Korab të Dibrës. Prandaj edhe gatishmëria e asaj kohe ishte gjithmonë e lartë, e në këtë kontekst bëheshin shumë stërvitje gatishmërie, me shtabe dhe me trupa. Mendoja se më ishte bërë një padrejtësi shumë e madhe, por për fat kjo u zgjidh shpejt dhe së fundmi më erdhi transferimi i shumëpritur në SQU Tiranë", kujton Dr. Dauti.

PUNA NË INSTITUTIN E KËRKIMEVE MJEKËSORE USHTARAKE (IKMU) SPITALI QËNDROR USHTARAK

Vitet e punës në Kukës i kishin dhënë një eksperiencë mjaft të madhe praktike. Kukësi një qytet në veri të vendit, me një industri minerare të zhvilluar në atë kohë, por edhe me një uzinë për shkrirjen e bakrit, uzinën mekanike e disa punishte të tjera që bëheshin shkas të aksidenteve të herë pas hershme. Kështu që u binte që të përballeshin me forma të ndryshme traumash, që nga ato të kokës, gjoksit, barkut apo të ekstremiteteve. Pajisjet diagnostike ishin mjaft të cinguara. Duhej të vendosej shumë shpejt diagnoza dhe të merreshin masa për ndërhyrje për shpëtimin e jetës. Këto raste nuk ishin aq shumë të rralla, por në një farë mënyre të detyronin që të vrisje mendjen, të shfletoje libra e literaturë të kohës për t’ju përgjigjur situatave.

Në Spitalin Ushtarak kishte kolegë që ishin emëruar qysh në fillim, duke marrë specialitete të veçanta. Një pjesë e mirë e tyre kishin marrë bursa specializimi në Kinë apo në vende të ndryshme perendimore, pra ai ishte me mungesa në këtë drejtim, por kishte një epërsi tjetër, atë të përvojës praktike në shumë degë të kirurgjisë. Megjithatë i duhej një punë shumë e madhe për të rikuperuar kohën 10 vjeçare të shkëputjes nga institucioni qëndror mjeksor, për këtë nuk i mungonte vullneti për të mësuar. Në specialitetin që e caktuan, atë të kirurgjisë plastike dhe të djegjes nuk e kishte menduar dhe pëlqyer, por Islami nuk kishte lluksin që të zgjidhte. Ju fut punës në drejtim të kësaj dege dhe krahas saj për likuidimin e provimeve pas universitare dhe përgatitjes për të mbrojtur në komision të specialitetit që kishte marrë, si dhe nga ana tjetër për të vazhduar punën me temën e mbrojtjes së doktoratës për Doktor të Shkencave Mjekësore. Me familje në Tiranë u sistemua shpejt, e në këtë drejtim, siç pohon ai vetë, e ndoqi fati. Kështu që kjo ishte një avantazh. Mbas një viti pune praktike dhe teorike arriti të marrë çertifikatën e specialistit në kirurgjinë plastike dhe të djegjeve me rezultate të shkëlqyera.

Puna për mbrojtjen e temës për gradën shkencore ”Doktor” vazhdonte, dhe në vitin 1987 mbrojti dhe përfitoi gradën shkencore ”Doktor i Shkencave Mjekësore”.

Puna e mjekut dhe e të gjithë personelit që punon me të djegurit është shumë e rëndë krahasuar me specialitetet e tjera të kirurgjisë.

Në spitalin ushtarak funksiononte një repart i veçantë për djegjet e destinuar për ushtarakët. “Për vetë karakterin e punës në kohë paqe të tyre nuk kishim pacientë ushtarakë por kryesisht civilë, që paraqiteshin me djegje të rënda dhe shumë të rënda nga të gjitha rrethet e Shqipërisë. Rastet e rënda apo shumë të rënda shpesh përfundonin me vdekje, gjë e cila linte mbresë shumë të keqe te personeli dhe veçanërisht për mjekun ishte një traum. Pra, për ne veç lodhjes së madhe fizike që kërkonte shërbimi i këtij të semuri me ditë, javë e ndonjëhere edhe me muaj, përfundimi, i sëmurit nuk shpëtonte. Kjo të vriste shumë, por kjo që puna ime dhe duhej përballuar me të mirat dhe të këqijat e saj. Por nuk ishin të gjitha rastet fatkeqe, shumica, falë punës të këtij ekipi që të sëmurët të shëroheshin plotësisht dhe të shkonin pranë familjes ku merrnin përgëzimet e familjarëve”, -kujton Dr.Dauti.

Gjatë jetës së tij, me punë në këtë specialitet ka kaluar me qindra apo mijëra raste që i kujton edhe pas shumë vitesh me respekt.

Tregon Dr.Islami dhe një rast që i ka ndodhur kohët e fundit: “Po ecja rrugës dhe para meje një grua relativisht e moshuar u drejtua drejt meje duke hapur krahët, kthej kokën pas dhe nuk pashë njeri, ndërkaq ajo u afrua dhe më pushtoi me të dy krahët dhe pastaj po më puthte duart. Për një moment u ndjeva keq, por shpejt ajo ma shuajti kureshtjen. Nuk më njeh më tha, jam Liza nga Fushë-Arrësi, kam qenë e djegur në mes e poshtë. Isha vajzë e re në ato vite dhe më keni shpëtuar jetën, të jam shumë mirënjohës. Të them të drejtën u ndjeva shumë i emocionuar dhe I kënaqur që kam bërë mirë në këtë botë sa kam mundur”.

Në vitet 1989-1990 u ndërtua ndërtesa e re në Qendrën Spitalore Universitare ”Nëne Tereza”. Kështu që, me një vendim të përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të Shëndetësisë, u suprimua reparti i djegjes në Spitalin Ushtarak dhe u bashkua me atë civil, kështu që i gjithë efektivi mjek e infermier kaluan në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë.

Puna në këtë institucion të ri ishte më e organizuar. Staf i mjek kirurg dhe reanimator ishte më i madh, baza materiale shëndetësore më e grupuar, investimi për kushtet që kërkonte kjo sëmundje që i konsiderueshëm për kohën që kalonte vëndi ynë. Vazhdimësia e tij ishte po e njëjtë. Kishte gradën shkencore në fushën e mjekësisë ”Doktor shkencash”, po ashtu një CV shkencore mjaft të pasur, me publikime në periodikun shkencor mjekësor

si dhe në revistat tona e të huaja. Ambicja e tij për të zhvilluar dijet edhe më shumë në klinikën e djegies të QSU-së gjeti ambient të përshtatshëm duke fituar aftësi profesionale që të kryente të gjitha operacionet nga me të vështirat e kirurgjisë plastike dhe asaj estetike.

Dr. Islam Dauti është autor dhe bashkautor në monografi të profilit për tekste mësimore të kirurgjisë. Ka marrë pjesë në kongrese e konferenca shkencore si brenda dhe jashtë shtetit. Është anëtar i klubit mesdhetar të djegjes me qendër në Itali, anëtar i shoqatës të kirurgjisë plastike të Ballkanit dhe të Europës. Si rezultat i një pune intensive praktike dhe pedagogjike si pedagog i jashtëm, arriti që të plotësojë kushtet dhe kështu fitoi titullin "Profesor i Asociuar" në vitin 1999. Edhe pas kësaj nuk e ndërpreu asnjëherë aktivitetin shkencor për thellimin e dijeve shkencore për aftësimin profesional.

Mbas daljes në pension u punësua me kohë të plotë në pozicionin e zv.Dekanit të Fakultetit Mjekësor dhe Shefi i Departamentit të Infermierisë, si dhe Pedagog i lëndës së kirurgjisë në universitetin jo publik Medikom. Me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë, Këshilli Bashkiak i qytetit të Bulqizës e nderoi me titullin "Nderi i Qytetit" me motivacion: - "Për kontribut të vlerësuar shkencor e profesional, të nivelit të lartë në fushën e mjekësisë, si dhe përkushtim të madh në punë në shërbim të jetës njerëzore, ku u bë i njohur si kirurg i kirurgjisë plastike dhe djegieve me tituj e grada shkencore, që ia kanë rritur emërin trevës së Bulqizës ku ai lindi". Ceremonia e dorëzimit të këtij titulli u zhvillua në kinemanë e qytetit ku e nderuan shumë bashkëqytetarë e personalitete të qytetit, deputetë të zonës, familjarë dhe miq e shokë. Ishte një ceremoni mbresëlënëse, ku u përshëndet nga shumë qytetarë të Bulqizës. Pikërisht për këto vlerësime Dr. Islam Dauti i shpreh mirënjohjen familjes së tij, popullit dhe institucioneve të Bulqizës dhe ndjehet shumë krenar që është bir i kësaj treve.

Ndaj dhe është i gatshëm qësa të ketë fuqi, të jetë kurdoherë në shërbim të këtij populli të mrekullueshëm.

PROF. ASOC. DR. ALI TONUZI, MË I VLERËSUARI NGA PACIENTËT DHE ELITA MJEKËSORE

- **Vlerësimi për dibranin e mirë dhe të zotin, Prof.asc.dr.Ali Tonuzin për çfarë ka dhënë në profesionin e tij si mjek dhe si profesor është i merituari dhe të tilla vlerësime nuk duhet të mungojnë për profesionistët**

Pas tri dekadash pa ndërprerje në gazetari, me sytë mbërthyer nga ekrani i kompjuterit, konstatova dëmtimin e perdes së syrit, një patologji kjo problematike që konsiston në zvogëlimin e imazhit të gjërave të largëta dhe të larta. Në këtë gjendje, si çdokush tjetër i prekur nga kjo patologji, iu drejtova mjekut okulist. Dhe ai që bëri



mrekullinë, duke më rikthyer dritën e syrit qe Prof.asoc.dr.Ali Tonuzi – Kirurg Vitreoretinal në Departamentin e Okulistikës të Spitalit Francez në QSUT (Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”). Për t’i shprehur mirënjohjen si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, hodha disa rreshta për profilin e tij në ëebisitn e një portali të njohur, pa e ditur që pas atij statusi do të vërshonin mijëra falenderime për të. Janë këto vlerësimet më objektive nga “foltorja” më e besueshme, jo vetëm e pacientëve të operuar prej tij, por edhe e përfaqësuesve të elitës mjeksore. Njëri prej tyre, Dr.Nexhat Kala,- otorinologu i njohur, ish-nëndrejtor i QSUT dhe deputet i Kuvendit të Shqipërisë, këtë “dyndje” mirënjohjeje të pacientëve e shpjegon me nivelin e lartë profesional të okulistit të talentuar Ali Tonuzi, shpirtin human dhe reputacionin që ai e ka fituar me punën e përkushtimin

qytetar, me sjelljen dhe shërbimin shembullor, pa i diferencuar në asnjë rast pacientët.

**PROF. ZHUGLI: LIBRI I DR. ALI TONUZI “LASERI
NË OFTALMOLOGJI”, VEPËR ME VLERA SHKENCORE**

Prof.asc.dr.Ali Tonuzi, nga Brezhdani i Dibrës, në mesin e moshës së tij ka arritur një karrierë të shkëlqyer akademike dhe profesionale. Jo vetëm si një okulist famoz (ndër të vetmit në rang vendi e rajoni që kryen operacione të shkallës së lartë), por prej dy deqash edhe si një ndër pedagogët më të mirë në Departamentin ORL-Okulistikë të Fakultetit të Mjeksisë në Universitetin e Mjeksisë Tiranë. Ai është përfshirë intensivisht në botën akademike pasi fitoi titullin “Doktor i Shkencave Mjekësore” (Maj 2002) dhe Prof. Asc në Tetor 2012. Produkt i punës së thelluar studimore shkencore është edhe libri i tij “Lasери në Oftalmologji” për të cilin prof.Sulejman Zhugli pohon se është teksti i parë që botohet në fushën e Oftalmologjisë në vendin tonë, llojet dhe përdorimet e shumta të tij në këtë fushë. Libri është shkruar thjeshtë, i ilustruar me shumë figura, duke e bërë tekstin shumë të kuptueshëm për të gjithë gjeneratën e oftalmologjistëve dhe më gjerë. “Ky libër është konceptuar të shërbejë si një bashkudhëtar i fuqishëm për oftalmologjistët klinikë dhe siguron një ilustrim të mirë të koncepteve bazë të terapisë së laserit për shoqërimi okulare të ndryshme të lidhur me kapakët, kornën, kristalinin dhe retinën”,-shprehet ndër të tjera prof. Zhugli në paraathënieën e këtij libri.

Padyshim që kjo karrierë e shkëlqyer profesionale dhe akademike e prof.asoc.dr.Ali Tonuzit ka patur si bazë studimet universitare me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin e Mjeksisë, Tiranë, dega Mjeksi e Përgjithshme (1986-1991), për të vijuar me “Diplomë Kualifikimi”, Specializim në Departamentin e Okulistikës, Tiranë (1992-1996) dhe në vitin 1997, ndoqi dhe përfundoi Shkollën Pasuniversitare (SHPU). Për të arritur në këtë stad kualitativ dhe akademik, prof.as.dr. Ali Tonuzi ka kryer disa trajnime dhe kualifikime, si: Kirurgji Okulare (Syrit) në Malaga – Spanjë; Specializim në Okulistikë (ORBIS) në Varna – Bullgari; për Kirurgjinë e Kataraktit pranë Universitetit Charles – Pragë, Republika Çeke; Program trainimi në Phacoemulsification, në Aravind Eye Hospital Coimbatore – Shteti, Tamilnadu, INDIA si dhe Felloëship në Menaxhimin Medikal &

Kirurgjikal në Semundjet e retines dhe Vitrosit, në Aravind Eye Hospitals & Postgraduate Institute of Ophthalmology. India.

Si njohës perfekt i anglishtes e frëngjishtes në të lexuar, shkruar e folur, Prof.asc.dr. Ali Tonuzi, njëherësh ndër anëtarët më aktiv të Shoqatës së kirurgëve vitreoretinal të Indisë dhe Shoqatave Shkencore të Okulistëve të Shqipërisë e asaj të Kosovës, është pjesëmarrës dhe referues dinjtoz në disa kongrese e konferenca Shkencore, kombëtare, rajonale e ndërkombëtare, si në Bern e San Galen – Zvicër, Romë – Itali, , Prague – Czech Republik, Morfild – Londër, Dubrovnik- Kroaci, Sarajevë – Bosnje Hercegovinë, Kerala – Shteti Tamilnadu India, Ljubljana – Slloveni, Thessaloniki – Greqi , Helsinki – Finland , në Prishtinë, Stugë. Etj.

Prof.asc.dr.Ali Tonuzi është autor i dhjetra artikujve dhe botimeve shkencore në revista e buletine shkencore të vendit e ato ndërkombëtare.

AKTIVITETI PROFESIONAL

Aktiviteti profesional i Prof.asc.dr.Ali Tonuzit konsiston në zbulimin për të parën herë të të sëmurëve me retinitis nekrotizant nga CMV dhe të sëmurëve me endoftalmit endogen nga HIV. Po ashtu, në trajtimin e endoftalmitit me vitrektomi dhe injeksione intravitreale; përdorimin e triamcinolonit në edemën makulare diabetike; përdorimin e avastines në edemën makulare cystoide; trajtimin bashkohor të degeneracionit makular senile të njome me Anti-VEGEF, Lucentesis dhe TPP, PDT; përdorimin e laserit në edemën makulare diabetike (Fokal laser); përrdorimin e laserit për fotokoagulacionin panretinal ne retinopatit diabetike proliferative si dhe trajtimin e okluzioneve venoze retinale me laser.

Specialistët e fushës i njohin prof,asc,dr.Ali Tonuzit meritën e trajtimit për herë të parë të të sëmurëve me dislokim të lensit në trupin vitroz me vitrektomi anteriore dhe fiksion skleral në dhomen e pasme; aplikimin e Barage laser për degeneracionet dhe çarjet retinale periferike për parandalimin e shkolitjes retinale, përdorimin për herë të parë të Ganciklovirit intravitreal dhe cor vitrectomi në endoftalmitin nga HIV-i dhe CMV; trajtimin kirurgjikal në sindromë Marfan dhe riaftesim të plote të të semurit me anë të fiksimit të inplantit në sklere dhe vitrektomi anteriore si dhe të Trans plana vitrektomi në hemoragjitë masive vitreale dhe rrethim me buckel në shkolitjet retinale dhe injeksion i vajit të silikonit.

Me këto ndërhyrje kirurgjikale të sukseshme ai është bërë nga kirurgët vitreoretinal më të njohur e preferuar nga pacientët, jo vetëm vendas por edhe nga shtetet e rajonit.

KIRURGU VITREORETINAL QË KRYEN NDËRHYRJETMË TË NDËRLIKUARA N Ë SY

Prof, asc. Dr. Ali Tonuzi – oftalmolog, kirurg i vitrorretinës, që e ushtron profesionin prej afro tri dekadash, si dhe një nga pedagogët e mirënjohur të Univeritetit të Mjeksisë (udhëheqës shkencor i temave të disa doktorantëve) është ndër të rrallët që ka realizuar me sukses mijëra operacione të ndërlikuara.

Ai bën të ditur se prej vitesh Sherbimi i Okulistikës ofron me sukses një gamë të gjërë të ndërhyrjeve kirurgjikale në sy me teknika bashkëkohore dhe se prej vitit 2019 e në vazhdim është siguruar nga spitali e gjithë paketa e kataraktës që vazhdon të aplikohet me sukses në këtë shërbim. Ndërkohë, Qendra Shqiptare e Syve, drejtuar nga Prof.asc.dr.Ali Tonuzi, është ndër më profesionale, ku përveçse vizitave të përgjithshme okulistike janë kryer dhe kryhen me sukses ndërhyrje të ndërlikuara, si kirurgji strabizmi; pterigium; kirurgji katarakte; kirurgji glaukome; lazer për retinën; kirurgji vitreoretinale; trajtim i syrit të verbër të dhimbshëm; proteza okulare; plastikë e syrit si dhe hapje e kanalit të lotit endoskopike (pa qepje).

Dr.Tonuzi gjatë karrierës së tij profesionale dhe akademike ka marrë disa vlerësime nga institucione e agjenci të specializuara, për nivelin e lartë profesional, përkushtimin dhe cilësitë njerëzore dhe si hartues i suksesshëm i një sërë leksionesh universitare në fushën e mjekësisë.

Përkushtimi, profesionalizmi dhe talenti i Dr.Ali Tonuzit është vlerësuar edhe nga shoqata Shqipëri-Itali. Kjo shoqatë i akordoi atij para disa ditësh një Mirënjohje në vlerësim të kontributit të shquar në fushën e mjekësisë dhe në atë të jetës akademike e universitare.

Dr.Tonuzi, 54 vjeç, ka tashmë më se çerek shekulli në shëndetësi. Në duart e tij kanë kaluar me dhjetra e dhjetra mijëra pacientë të cilët i kanë besuar dritën e syve këtij mjeku okulist të talentuar, ku prej shërbimit të marrë kanë qenë mjaft të kënaqur.

Për tri dekada këtu në Shërbimin e Okulistikës të Spitalit Francez në QSUT ai ka dhënë provat e një mjeku mjaft të aftë dhe ambicioz në

profesion.

Në kohët që jetojmë kemi nevojë për njerëz të mirë të mençur, vizionarë që të nderojnë jo vetëm një punë ku marrin një rrogë mujore, po shumë më tepër. Kohët që po jetojmë na bëjnë që ta kthejmë dhe më shumë syrin nga mjeku, nga humanizmi i tij. Për ta bërë më saktë portretin e tij do të citoja fjalët e një pacienteje. *“Sa hyn dhe shikon Dr. Aliun, të rregullohen vetë sytë e s’ke më nevojë për syze.”* Në këtë përditshmëri ai mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësues i elitës intelektuale shqiptare. Kjo sepse ka qenë njësh me pacientin, i shkruirë në nevojën e tij duke iu gjendur sa herë i lypte nevoja. Vlerësimi për dibranin e mirë dhe të zotin, Prof. asc.dr.Ali Tonuzin për çfarë ka dhënë në profesionin e tij si mjek dhe si profesor është i merituari dhe të tilla vlerësime nuk duhet të mungojnë për profesionistët.



PROF. DR. NAZMI KOÇI - STOMATOLOGJIA NË SHQIPËRI NGA LASHTËSIA DERI NË DITËT TONA



- Vështrimi analitik historik i shërbimit stomatologjik, vepër me vlera shkencore e Prof. as. Nazmi Koçit
- Akademik, prof. dr. SHABAN SINANI: “Besoj se duke shkruar këtë libër Nazmi koçi, profesor, mjek, njeri i shërbimit, ia ka arritur të realizojë atë që latinët e shprehnin me një idiomë të mirënjohur: *Corona opus finis* – t’i vësh veprës kurorë”

“Një libër diturie, një libër shërbimi, një libër përvojë, një libër në shërbim universitar”. Qoftë dhe vetëm nga ky vlerësim i akademik prof. dr. Shaban Sinanit, gjithkush do të bëhej kureshtar për të lexuar dy vëllimet e veprës voluminoze (në dy libra) të Prof. as. Nazmi Koçit “Stomatologjia në Shqipëri nga lashtësia deri në ditët tona”(vështrim historik). Sepse siç shkruan akademiku i mirënjohur Sinani në parathënien e vëllimit të parë të kësaj vepre: “Stomatologjia në Shqipëri (nga lashtësia deri në ditët tona) është strukturuar sipas një mënyre bashkëkohore, duke ndërthtur metodologjikisht parimin e periudhizimit (kronologjisë) dhe parimin tematologjik. Thënë më shkurt, sistematik e tematik njëherësh, shenjë tjetër paralajmëruese se në vijim do të kemi rastin të takohemi me njeriun

e dijës dhe jo thejsh të kujtimeve profesionale, të cilat, sado të bukura të jenë, kanë për shoqërim atë pyetyjen djallëzore të thënies së të vërtetës”.

. Këtë rast e patën qindra profesionistë dhe jo të profilit të Dr.Koçit në promovimin e veprës së tij, organizuar nga Akademia e Shkencëve të RSH, ku personalitete të fushës si prof.dr. Fejzi Keraj, prof. as. Erda Qorri, Prof. dr. Pavli Kongo, rektor i Albania University, Brunilda Koçi (redaktore shkencore), etj, vlerësuan veç të tjerash pasionin, vizionin dhe kapacitetin intelektual e dimensionin njerëzor të dr.Nazmi Koçit për realizimin e këtij misioni tepër të rëndësishëm kombëtar, në fushën e dentistrisë.

Është vërtetë një vepër studimore shkencore, ku si askush tjetër Prof. as. Nazmi Koçi sjell për lexuesin një historik të shkurtër të stomatologjisë në botë (Lindja dhe zhvillimi i stomatologjisë si shkencë që nga periudha parahistorike deri tek themelimi i universiteteve dhe futja e teksteve dentare.) Në mënyrë kronologjike, por me argumente shkencore, në vëllimin e parë të kësaj vepre autori na njeh me stomatologjinë shqiptare nga lashtësia deri te shpallja e pavarësisë (1912) dhe në vijim sipas etapave kohore: 1912-1944; 1944-1948; 1948-1993, ku sjell fakte e shembuj referuar mendimeve të specialistit para një shekulli si dhe për organizimin e shërbimit stomatologjik ndër vite.

Prof. as. Erda Qorri, në analizën e saj të hollësishme (në emër të Komisionit të Mjeksisë të Akademisë së Shkencave), ndër të tjera tha se rëndësia e kësaj vepre konsiston në faktin se për herë të parë lexuesit i bëhet e ditur nga nga ky libër, se dentisti i parë shqiptar është shkodrani Hasan Kaduku, i cili ushtronte këtë profesion që nga viti 1896, ndërsa dentistja e parë ka qenë Theodita Naçi në Tiranë. Po ashtu, – vijoi Prof. as. Erda Qorri, i bëhet e ditur lexuesit se një Federatë e parë shqiptare e dentistëve daton që në vitin 1931, me kryetar elbasanlliu Qemal Bobrati, dhe kjo 19 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, ose 31 vjet më vonë se themelimi i vetë Federatës Botërore dentare.

“Zakonisht thuhet se niveli i zhvillimit të shoqërisë përcaktohet prej kujdesit shëndetësor apo kulturës së shëndetit oral, dhe për këtë, të dhënat e sjella nga autori i kësaj vepre na bëjnë të shohim realitetin e asaj periudhe, për të cilën raporte e botime artikujsh të dentistëve, paraqesin ekspertiza dhe thirrje për shtimin e vëmendjes në këtë aspekt, duke sjellë kështu fakte reale të situatës, ashtu siç ajo ka qenë”, vlerëson prof.Erda Qorri.

Ky produkt studimor shkencor i një rëndësie të veçantë, i vjen lexuesit dhe veçanërisht personelit të klinikave të shumta dentare në Tiranë e rrethe si dhe pedagogëve e studentëve të fakulteteve përkatëse, nëpërmjet një bibliografie mjaftë të pasur dhe konkretisht: 39 tituj bibliografikë të autorëve të mirënjohur botërorë dhe vendas si dhe ligje e vendime që i përkasin fushës, për pjesën e parë; 29 që i përkasin pjesës së dytë të veprës; 34 për pjesën e tretë dhe 391 në pjesën e katërt. Po ashtu, në listën e gjatë të figurave gjejmë jo vetëm babain e dentistrisë Perre Fauchard por edhe poltronin dentar kinez dhe dhjetra klinika dentare të njohura të vendit e botës.

STRUKTURA KOMPOZICIONALE DHE RËNDËSIA E VEPRËS

Pothujse me të njetën strukturë kompozicionale është edhe vëllimi i dytë i kësaj vepre me gjashtë kapituj: Disa veçori të shërbimit stomatologjik shqiptar; Arsimi i lartë mjeksor stomatologjik në Shqipëri; Literatura mjeksore stomatologjike; arkitektët e stomatologjisë shqiptare; Institucionet menaxhuese të Shërbimit Stomatologjik në Shqipëri dhe Stomatologjia sot dhe e ardhmja e saj.

Ndaj dhe me të drejtë prof. dr. Fejzi Keraj e konsideron këtë një libër historik profesional e shkencor me shumë vlera dhe si i tillë duhet të jetë pjesë e programit të studimit për të gjitha fakultetet e stomatologjisë. Kjo sipas tij për faktin se “Vepra në dy vëllime e këtij autori e sjell të plotë portretin e stomatologjisë shqiptare deri në ditët tona; ajo përfaqëson një material studimor e bibliografik me vlera të rralla në literaturën mjeksore shqiptare”.

Vetë autori Prof. as. Dr. Nazmi Koçi pohon se në këtë libër rindertohet historia e fillimeve të stomatologjisë si shërbim me status ligjor, megjithëse kufijtë e periudhizimit janë marrë prej historiografisë politike-shtetërore, merr kuptim theksimi i faktit të kalimit prej subjektivitetit profesional në subjektivitetin ligjor, me marrjen e përgjegjësisë nga shteti dhe krijimin e disa kushteve që mundësojnë kalimin prej disiplinave në nëndisiplina.

Prof.Koçi thotë se botimi i Librit u zgjat në kohë për disa arsye.

“Mendimi për ta realizuar këtë punim u publikua në vitin 2018, por puna për realizimin e tij kishte filluar që në vitin 2003, ndërsa në pesë vitet e fundit kam punuar çdo ditë intensivisht, kam fjetur e jam zgjuar me këtë

problem. Pati diskutime për shtrirjen kohore të trajtimit, u bënë propozime që punimi të fillonte që nga viti 1944; Pati diskutime për titullin dhe u bënë disa propozime si: Historik, Vështrim historik, Zhvillimi i stomatologjisë etj. Unë e mbrojta në parim argumentin që historia e popullit tonë është shumë e lashtë e nuk fillon me 1944. Preferova të mos bëj një historik klasik për stomatologjinë në Shqipëri, por një portret sa më të plotë të saj”, pohon dr.Koçi. Kjo sipas tij për faktin se “Stomatologjia është e vjetër si shërbim sa vetë njerëzimi, por është e re si shkencë më vete. Ajo ka ecur nëpër shekuj e mijëvjeçarë sëbashku me shkencat tjera. Të dhënat për stomatologjinë duhen kërkuar në dokumentet e shkencave tjera si mjekësia e përgjithëshme, arkeologjia, historia, shkencat e natyrës, antropologjia, në epitafet e varreve, veprat e artistit, në folklor etj. Kjo më detyroi të deklaroj para kolegëve në një takim, kur ata u interesuan për ecurinë e punimit, se ‘Në malet e Afrikës ka diamante, por për t’i nxjerrë ata duhet të shembësh malin’. Po. Prof. as. Dr. Nazmi Koçi, me përvojën, përkushtimin dhe vendosmërinë arriti t’i zbulojë të fshehtat e këtij “mali” për sa i përket zhvillimit të stomatologjisë në shekuj, dekada e vite. Duke kërkuar grumbulloi një material prej dhjetra mijëra faqesh, me preferencë për të mos anashkaluar dokumente e fakte, duke ju dhënë kështu një shans dokumenteve në prag asgjësimi. Dhe këtë e bëri sipas parimit në punën e mjekut: “jepi një shans të jetoje”. Kësaj i sherbeu dhe fakti se kishte njohje të detajuar të mëparshme të problemeve të stomatologjisë dhe kësaj arriti të na japë një panoramë, portret të Stomatologjisë, në mos ezaurues, sa më përfaqësues e të plotë.

PAK RADHË PËR AUTORIN DHE VEPRËN E TIJ VOLUMINOZE NË DY VËLLIME ME 1040 FAQE

Prof. as.Nazmi Koçi kishte të gjithë staturën e duhur për këtë sipërmarrje të vështirë dhe delikate. Dr.Nazmi Koçi që ka lindur në Dibër më 17.04.1947, me një karrierë të shkëlqyer profesionale dhe akademike, kishte pasionin, vizionin dhe kapacitetin intelektual për realizimin e këtij misioni tepër të rëndësishëm kombëtar në fushën e dentistrisë.

Dr.Nazmiu, si ish – Shef i Shëndetësisë në Dibër, ish – drejtues i stomatologjisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe më vonë i asaj të kryeqytetit për disa vite, pedagog në disa shkolla të larta të profilit të stomatologjisë, autor tekstesh e studimesh shkencore, që ka realizuar më shumë se 140

publikime brenda e jashtë vendit, ekspert i arsimit të lartë në këtë fushë pranë Ministrisë së Arsimit dhe ASCAL, kishte njohjen dhe kompetencën për një spërmarrije të tillë voluminoze. Pra, dr. Nazmi Koçi kishte të gjithë kapacitetet njohëse për këtë shërbim si rrallëkush nga kolegët e profesionit tonë. Ai kishte kohë që kishte filluar të merrej me një punim të tillë dhe kishte botuar disa materiale mbi problemet e organizimit të shërbimit në fushën e stomatologjisë.

Ndaj dhe me të drejtë prof. as. Erda Qorri konkludon se Dr. Nazmi Koçi sjell një libër i cili do t'i shërbejë çdo stomatologu të njohë rrugëtimin e profesionit të zgjedhur. Madje kjo vepër përbën një aset që mund të përdoret nga pedagogët në auditoret e universiteteve për të prezantuar zanalillat e lashta që ka ky profesion në vendin tonë, ashtu sikurse në vendet tjera të botës, pjesë e së cilës kemi qenë dhe jemi edhe ne, si dhe dinamikën e zhvillimit deri në ditët tona.

Në tërësinë e saj, vepra e Prof. as. Nazmi Koçit “Stomatologjia në Shqipëri nga lashtësia deri në ditët tona” (vështrim historik), në dy vëllime me 1040 faqe, (e promovuar para disa ditësh nga Akademia e Shkencave të RSH) përbën një kontribut të çmuar, jo vetëm për dentistrinë shqiptare por edhe më gjerë. Kjo edhe për faktin se deri më sot mungonte një dokument i tillë në arkivat dhe bibliotekat shqiptare.

DR. AJET XHAFA, KIRURUGU UROLOG DUARARTË NGA BULQIZA, NË SPITALIN AMERIKAN TË PRISHTINËS

- Gjatë shkollimit dhe specializimit ka operuar bashkë me urologë shumë të njohur në Turqi dhe në botë. Dr. Ajeti ka një mori publikimesh në kongrese dhe revista të njohura ndërkombëtare. Gjatë gjithë punës së tij në Shqipëri dhe Kosovë, Dr. Ajet Xhafa ka spikatur për marrëdhëniet shumë të mira me pacientët dhe për performancë tejet të lartë. Ndërhyrjet e realizuara prej tij, në veçanti ndërhyrjet e reja si operacionet e mbyllura (pa prerje klasike) të gurëve në veshka (Nefrolitotomi Perkutane) kanë pasur një shkallë shumë të lartë suksesi në të gjithë rajonin e Ballkanit

Ekipit të shoqatës Atdhetare Kulturore Bulqiza, që me mbështetjeje e sipërmarrësit të suksesshëm Bukurosh Koçi, bëri një vizitë në Prizren, Krushe e Madhe e Gjakove të Kosovës, (22-25 tetor 2022), iu bashkua edhe DR. AJET XHAFA - Kirurg Urolog. në Spitalin Amerikan të Prishtinës (*Spitali Amerikan - American Hospital Kosova*). Në mbyllje të kësaj vizite, kryesia e kësaj shoqate e nderoi Dr.Ajetin



me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Kulturore Bulqiza” me motivacionin: *“Intelektual e veprimtar i shquar bulqizak, që ka arritur rezultate shumë të larta në formimin e tij profesional e shkencor në fushën e mjeksisë për mbrojtjen ne jetës së njerëzve dhe qytetar model që mban lart dashurinë e tij për vendlindjen”.*

Dy vjet më pas, pikërisht, mbrëmjen e 20 dhjetorit 2024, gjatë një

ceremonie festive në prag të festave të fundvitit, Drejtoria e Spitalit Amerikan të Prishtinës e shpalli Dr.Ajet Xhafen "MJEKU I VITIT 2024".

Për këtë vlerësim ai falenderon nga zemra drejtuesit e spitalit, mjekët, infermieret dhe të gjithë personelin e spitalit Amerikan në Prishtinë, që falë bashkëpunimit kanë arritur që të diagnostifikojnë dhe të shërojnë me mijëra pacientë prej vitesh. "Ky çmim nuk është vetëm një vlerësim për punën dhe përkushtimin tim, por është një motivim i madh për të vazhduar të shërbej me zemër dhe përkushtim ndaj pacientëve dhe komunitetit. Ky çmim shkon për te gjithë personelin spitalor që çdo ditë punojnë me pasion dhe përkushtim për të përmirësuar jetët e të tjerëve. Le të vazhdojmë së bashku në rrugën e kujdesit dhe humanizmit", shprrhet i entuazmuar Dr.Ajet Xhafa.

Për këtë vlerësim ai ka marë dhjetra urime nga kolegët e miqtë e veçanërisht nga bashkëpatriotët e tij në Bulqizë e Dibër.që e vlerësojnë si mishërues dhe përcues të vlerave më të mira njerëzore, intelktuale dhe profesionale....

PAK NGA CV-JA E DR.AJETIT

Dr. Ajet Xhafa nga Bulqiza, ka shkuar që në vitin 1996 ne İzmir të Turqisë dhe ka mbaruar liceun ushtarak `Maltepe Askeri. Në vitin 2000 ka vazhduar Fakultetin e Mjekësisë Gülhane "Guhane Askeri Tip Akademisi" në Ankara të Turqisë. Më pas ka vazhduar specializimin dhe ka marrë titullin "Specialist i Urologjisë" në vitin 2011 po në këtë spital.

Spitali ushtarak "Gulhane Askeri Tip Akademisi" ku është shkolluar Dr. Ajet Xhafa mbahet si një nga qendrat me numrin më të madh të operacioneve në Turqi dhe për menaxhimin e rasteve me teknologjinë më të fundit. Kjo i ka mundësuar që gjatë shkollimit dhe specializimit të operojë bashkë me urologë shumë të njohur në Turqi dhe në botë. Në saje të ndihmës së pandalur të profesorëve, ka arritur që të avancohet në nivele të larta në fushën e Endourologjisë, Uro-Onkologjisë, Andrologjisë, Kirurgjisë Urologjike Pediatrike etj.

Pas përfundimit me sukses të specializimit në vitin 2011, me gjithë mundësinë e vazhdimit të profesionit në Turqi, vendosi që të kthehet dhe të ushtrojë profesionin në Shqipëri.

Gjatë gjithë punës së tij në Shqipëri dhe Kosovë, Dr. Ajet Xhafa

ka spikatur për marrëdhëniet shumë të mira me pacientët dhe për performancë tejet të lartë. Ndërhyrjet e realizuara prej tij, në veçanti ndërhyrjet e reja si operacionet e mbyllura (pa prerje klasike) të gurëve në veshka (Nefrolitotomi Perkutane) kanë pasur një shkallë shumë të lartë suksesi në të gjithë rajonin e Ballkanit. Këto arritje janë prezantuar edhe në Kongresin e Endourologjisë Botërore në Cape – Toën të Afrikës së Jugut në vitin 2016.

Prezantimet e tij kanë qenë pjesë e serisë së rasteve të para të këtyre ndërhyrjeve të kryera në Tiranë dhe në Prishtinë. Dr. Ajet Xhafa ka kryer një numër të madh operacionesh tek të rriturit, si: zmadhimin e prostatës, ngushtimin e kanalit të urinës (uretra) dhe operacione të mbyllura e të hapura për gurët në kanal in urinar (ureter) dhe në veshkë. Ka trajtuar rastet e para të vendosjes së nefrostomisë në Kosovë dhe rastet e para të operacioneve nga mjekë shqiptarë me laparoskop për kistat e veshkës, gurët në ureter dhe heqjen e veshkës. Ka kryer shumë operacione të mbyllura për kancerin e vezikës, të veshkës dhe të prostatës. Pjesë e punës së tij, veçanërisht në Prishtinë, Kosovë, kanë qenë edhe ndërhyrjet e realizuara tek fëmijët me probleme të lindura si: hipospadias, testise të pa lëshuara, vezikoureteral Reflux (VUR), Ureterocele etj.

Dr. Ajet Xhafa është përfaqësues i rajonit në shoqatën e Urologëve të Evropës (EAU) për grupin e Urolitiazës (gurëve në rrugët urinare) dhe është pjesë e grupit të punës për vlerësimin metabolik dhe kërkimeve shkencore për sëmundjen e gurëve në veshka, (shih linkun: <http://uroëeb.org/section/eulis/ëorking-groups/>). Është anëtar i shumë shoqatave kombëtare dhe ndërkombëtare të urologjisë: shoqatës së Urologëve Evropianë (EAU) prej vitit 2007, shoqatës së Endourologjisë Botërore, shoqatës së Urologëve të Turqisë prej vitit 2006, shoqatës së Endourologjisë Turke dhe i shoqatës së Urologjisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës. Ai gjithashtu ka qenë pjesë e stafit organizues të disa kurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për urologjinë. Përgatitja, angazhimi dhe puna e tij e vazhdueshme janë tregues të pasionit të tij për profesionin dhe suksesit të tij në rritje.

Dr. Ajet Xhafa është i martuar dhe ka tre fëmijë.

Zotëron gjuhët e huaja), Anglisht (niveli i avancuar), · Turqisht (niveli i avancuar), Italisht (niveli i avancuar) dhe Frëngjisht (niveli mesatar).

PJESËMARRËS DHE REFERUES NË KONGRESE DHE REVISTA TË NJOHURA NDËRKOMBËTARE

Dr. Ajet Xhafa ka një mori publikimesh në kongrese dhe revista të njohura ndërkombëtare. Para disa ditësh (28 tetor – 1 nëntor 2024) Dr, Ajet Xhafa ishte i ftuar si panelist ne Kongresin e 33. kombetar te Urologjise Turke. Më me 31 Tetor ai foli në këtë Kongres të rëndësishëm për udhëzimet e reja në trajtimin e gurëve në sistemin urinar. “Në kongresin e 33-të të urologjise Turke pata fatin të marr pjesë në 3 kirurgji live dhe bashkë me dy akademikë të nderuar moderuam sesionin për gurë në veshka. Përveç organizimit të mirë dhe temave interesante pata mundësinë të takoj shumë miq nga studimet në Turqi dhe për këtë dua të falenderoj Shoqatën e Urologjisë Turke për ftesën dhe besimin e dhënë. Shpresojmë të shihemi së shpejti në kongrese të tjera për përditësim të njohurive në shërbim të pacientëve”, -shkruan Dr.Ajeti në faqen e tij në facebook.

Më parë, (11 maj 2024) përfundoi kongresi i 14-të i urologëve të Kosovës. Dr. Ajeti e vlerëson atë një kongres të organizuar mirë me tema interesante, diskutime, debate me kolegë shqiptarë dhe të huaj, disa prej tyre miq nga studimet në Turqi. Vetë Dr. Ajet Xhafa prezantoi eksperiencen 12-vjecare në Kosovë me operacionet për gurë në veshka siç është PNL si dhe ndërhyrjet me laparoskopji dhe lazer që kryejne prej vitesh në Spitalin amerikan në Prishtinë. Deri në kongresin e ardhshëm ai shpreson që të vazhdojnë ta përmisojmë veten në të mirë të pacientëve. Dhe jo vetëm kaq. Me vizionin e tij bashkëkohor ai herë pas here ju vjen në ndihmë pacientëve me video live ku ka treguar thjesht dhe bukur me gjun profesionale, sesi zgjidhen problemet e gurëve në veshka, prostatës etj. me metodat më të reja të teknologjise, e njejtë me çdo cep të globit. Në këto dalje live ai u ka mundësuar pacieëntëve të shumta nga Kosova e Shqipëria të mësojnë më nga afër rreth problemeve te traktit urinar si prostata, veshkat, fshikeza, problemeve seksuale ose inferilitetit, problemeve urologjike te femijeve ose çështjeve të tjera urologjike.

Për faktin se problemet urologjike janë të shpeshta tek të gjitha moshat, dr. Ajeti shprehet se se ka shumë rëndësi kujdesi i vazhdueshëm dhe vizitat tek urologu.

Ai ka kryer dhjetra operacione të ndërlikuara duke përdorur aparatatura moderne Laser Auriga XL 50 ëatt për trajtimin e gurëve në veshka

Këto ndërhyrje nuk kryhen më për herë të parë, por çdo ditë nga ekipi i urologjisë në Spitalin Amerikan në Kosovë.

KËNAQËSI E VEÇANTË KUR MERR VLERËSIMIN E PACIENTËVE

Padyshsim që dr. Ajeti ndjen kënaqësi të veçantë kur merr vlerësime ngë pacientët e shumtë. Janë të shumë pacientët që pasi janë operuar nga dr. Ajeti e falenderojnë atë për zemërsisht Dhe nuk janë një e dy, por qindra e qindra nga e gjithë Kosova e Shqipëria që e falenderojnë atë për zemërsisht për përkushtimin me të cilin u ka shërbyer duke i rijtyer në jetë, Në kabinetin e tij të punës na bën përshtypje një foto ku ai është me Halilin dhe Izerin, dy vëllezërit që i ka operuar për zmadhim të prostatës në vitin 2019 dhe 2022. Të dy, megjithëse s'kanë më probleme vazhdojnë kontrollet periodike çdo vit me analiza dhe çdo gjë në shëndetin e tyre duket shumë mirë.

“Çdo pacient që ka problem urologjik mund të sjellë edhe vëllain, sepse shërojmë edhe probleme të tilla vëllazërore”, na thotë dr. Ajeti.

Edhe Rustem Elezi thotë se ndihet mirënjohës me dr. Ajet Xhafa në Spitalin Amerikan – American Hospital Kosova. Pasi është kryer me sukses operacioni në veshkë të motrës së tij Liries, në Spitalin Amerikan ai fillimisht falenderon Zotin për gjithçka dhe të gjithë ata që kanë kontribuar që ky operacion të realizohet. Gjithsesi ai veçon në falenderimin e rij doktorin duarratë, kirurugun urolog Ajet Xhafa për këtë mirësi që i bëri motrës së tij.

E Falenderoj Dr. Ajet Xhafa. “Zoti ju shperblefte dhe ju begatofte Ju dhe familjen tuaj Dr. Ajeti”, shprehhet ai entuziast dhe me gëzim të paparë.

Ai pohon se këto ditë kanë patur raste shumë sfiduese në urologji dhe fatmirësisht janë zgjidhur të gjitha me metodat më të reja, falë aparaturave dhe mbështetjes që ofron spitali Amerikan në Prishtinë. Me entuziazëm ai tregon një ndërhyrje me shpim në veshkë. Se si kanë pastruar një veshkë plot me gurë të bllokuar prej vitesh. Në pamjet pas operacionit, veshka është pastruar komplet dhe pritët që të kthehet në funksionet e duhura për ti ikur dializes.

Në një rast tjetër të ndërlikuar tregon se si kanë kryer operacion me laparoskopji për gjendrën mbiveshkore dhe kanë hequr tumor të veshkës

me laparoskopji.

Po ashtu flet me pasion për një rast tjetër kur kanë bërë thyerjen e gurëve në veshka me lazer me një kamere fleksibile (RIRS) dhe kanë arritur të nxjerrin një sasi shumë të madhe gurësh pa prerje pa shpim.

“Vitet e fundit pothuajse asnjë rast urologjik i rimbursuar nga shteti nuk ka patur nevojë që të dërgohet jashtë Kosovës për trajtim më të avancuar dhe paratë e taksapaguesve kanë ngelur në Kosovë ku janë punësuar rreth 600 punëtorë në dy spitalet që operojnë sot. Spitali është bërë një nga pengesat kryesore për pacientet që vizitoheshin në privat dhe më herët shkonin për një analizë urine në Shkup për konfirmim të ndonjë diagnoze të thjeshtë”, – thotë dr. Ajeti.

Gjithkush do të ndjehej krenar ku mëson se këto operacione kryhen prej disa vitesh VETËM në spitalin Amerikan në Prishtinë nga një urolog shqiptar me mbështetjen e një ekipi shumë të madh ku përfshihen instrumentarët, anestezologët, kardiologët, endokrinologu, ekipa reanimatore e shumë infermierë dhe punonjës të spitalit, të cilët flasin çdo ditë shqip me këta paciente.

KRENAR QË LINDI DHE U RRIET NË NJË VEND TË VOGËL SI BULQIZA

Më 5-8 prill 2024 dr. Ajet Xhafa ishte drejtues dhe penalist në Kongresin më të madh të urologjisë që u zhvillua në Paris. Në këtë Kongres rreth 15 000 urologë nga e gjithë bota prezantuan me qindra punime shkencore. Profesorë me emër treguan për përvojat e tyre kirurgjikale të viteve të fundit. “Vetëm në panelin që drejtuam së bashku me dy kolegë të tjerë, kishte 18 punime nga Cape Toën, Vancouver, Singapor, Oklahoma dhe qytete të ndryshme europiane”, ka pohuar dr. Ajeti për rrjetet sociale. Dhe ndonëse merr pjesë dhe drejton e referon në evnete të tilla të ndërkomënate të një rëndësie të veçantë, ai nuk nguron të shpreh krenarinë për vendlindjen e tij. Është vërtetë frymëzues pohimi i tij publik se “... në këtë ditë të veçantë shpresoj që babai im të ndihet krenar, që edhe pse më rriti në një vend të vogël si Bulqiza, kjo nuk më pengoi të bëhem pjesë e barabartë e tryezës më të madhe urologjike në botë”.

Krenarinë për bashkqytetarin e tij nga Bulqiza e shpreh edhe kampioni i botës në kiks boks Ismail Keta. Para dy viteve (29 maj 2022), në ditën e

fundit të vizitës së tij me disa miq gjermanë në Kosovë, ai shprehej se si ‘qershia mbi tortë’, takoi kushëririn e tij, Dr. Ajet Xhafa i cili jeton prej vitesh në Prishtinë. “E kam quajtur ‘fatkeqësi’ që Dr. Ajeti u largua nga Bulqiza, pasi vendlindja ka nevojë për specialistë të tillë dhe pse mirekuptoja arsyen siç është kantandisja e spitalit të Bulqizës 30 vitet e fundit. Por gëzohem që ju shërben vëllezërve dhe motrave shqiptare në Kosovë. Faleminderit për mikpritjen që organizove për miqtë e mi gjermanë Ajet”, shkruan kampioni Keta.

Edhe vetë Dr. Ajeti nuk nguron ta shprehë krenarinë që është nga Bulqiza, një zonë me njerëz shumë punëtorë, që kanë kontribuar shumë në të ardhurat vjetore të Shqipërisë, që nga koha e komunizmit. “Kam dëshirë që të kontribuoj në ndihmë të pacientëve të rajonit të Dibrës dhe besoj se në të ardhmen, me hapjen edhe të tunelit të Murrizit të Rrugës së Arbërit, mund të vij për vizita pa pagesë në rast se kërkohet nga institucionet shtetërore për pacientët që kanë probleme urologjike. Kjo është edhe një nga porositë e lëna nga babai im Pëllumb Xhafa, mua dhe familjarëve të mij para se të ndërronte jetë. Çdokush që ka hedhur themelet e njeriut që është sot duhet të kontribuojë për vendlindjen dhe për njerëzit e asaj zone”, shprehet Dr. Ajet Xhafa. Kjo sipas tij për faktin se Dibra gjithmonë ka nxjerrë njerëz të shquar që kanë kontribuar shumë në mbarëvajtjen e vendit tonë dhe do vazhdojnë të jenë të tillë edhe për shumë vite. Kur na ndajnë vetëm pak ditë nga ndërrimi i viteve ai ka një “këshillë miqësore” për të gjithë dibranët që të mbajnë dhe të përkrahin njëri-tjetrin si dhe të ndihen mirë dhe të krenohen me sukseset e njerëzve që kanë origjinën nga ai vend i vogël, i ftohte por shumë i dashur.

HALIL RAMA

V

HISTORIA E DIBRËS NË LIBRA TË
AUTORËVE DIBRANË

BERISHËT E MUHURRIT, SI RAST UNIKAL NË HISTORINË SKËNDERBEGIANE

Romani i Naim Berishës “Të jetosh në paqe”, me bazë historike të vërtetë, është sa tërheqës dhe intrigues

Barleti, Franku, Sokoloski, Pall, Stort, Stojanovski dhe shumë të tjerë biografë dhe studiues vendas dhe të huaj të Skënderbeut, evidentojnë Berishët e Muhurrit të Dibrës, si një rast unikal në historinë skënderbegiane. Madje Marin Barleti të “*Histori e Skënderbeut*” – (faqe: 314, 315, ...) shkruan se “Ndër fisnikët më të mirë të atij vendi (në Dibrë) ka qenë familja e lashtë e Berishëve. Dy vëllezërit, gjeneralë të Skënderbeut dhe, njëherësh, kryetrima të rinisë dibrane, Dhimitri dhe Nikolla, ndihmën e të cilëve Skënderbeu e kishte të dendur dhe të shënuar, kur dëgjuan për fatkeqësinë e ushtrisë sonë dhe për përfundimin e rrethimit të Beratit, kur morën pastaj vesh për rebelimin dhe pabesinë e Moisiut, nuk u vonuan aspak, por vrapuan fluturimthi për tek roja dhe kryeporta e mbretërisë, të trembur se mos roja atje shpërndahej nga frika apo ngaqë s’kishte kush e frenonte dhe se mos vendi mbetej pa mbrojtës, sidomos kur vinin lajmet se Sebalia ndodhej, ende, në Epir. Dhe kështu Dhimitër dhe Nikollë Berisha me plot arsye, u kujdesuan, së pari, për të kërkuar ushtarë dhe, kështu, e rritën rojën, u dhanë zemër burrave me fjalë dhe me vepra, duke ua shtuar, me çdo mënyrë, dashurinë për Skënderbeun, si dhe duke shfaqur simpatinë e tyre për fatin e tij dhe urrejtjen për pabesinë e Moisiut ...”. Duke shkruar për këtë familje, (filloj: “Familja e Lashtë të Berishëve” sepse në gjithë librin voluminoz të tij për Skënderbeun, Barleti, çuditërisht, vetëm këtë familje,



në ndryshim nga gjithë të tjerat, e specifikon kështu: “të lashtë”) është e pamundur të mos përmendësh Kastriotët dhe Skënderbeun. Kjo sepse, këto dy familje, u ngjizën në të njëjtën trevë të origjinës, në Masrekat e Dibrës së Poshtme, për të cilën kanë shkruar jo pak historianë vendas dhe të huaj. Edhe nga burimet arkivore, edhe nga ato gojore vërtetohet se këto dy familje qenë jo vetëm bashkëkohës dhe bashkëfshatarë, por, njëkohësisht, dhe bashkëlufëtare. Qyshse Kastriotët u shfaqën për herë të parë në skenën politike të kohës, Berishët bëjnë krushqi me ta dhe që nga ajo kohë, familja e lashtë e Berishëve, do të mbetet në historinë skënderbegiane si njëra nga familjet bashkëlufëtare më besnike e kauzës së Kastriotëve.

MASREKAT DHE GARDHI, TREVA NË TË CILAT, EKSKLUZIVISHT, IDENTIFIKOHET MUHURRI

Të shkruash për Berishët, më së pari, do të thotë të shkruash për Masrekat, të Epërmet dhe të Poshtmet, si dhe për Gardhin e Poshtëm (të Dibrës së Poshtme), treva në të cilat, ekskluzivisht, identifikohet Muhurri, ky shtrat i rrallë shtrëngatë i origjinës së lashtë të Kastriotëve. Të shkruash për Berishët e kohës së Kastriotëve do të thotë të hedhësh një dritë të re mbi qytezën e lashtë ilirike të Hurdhë-Muhurrit dhe Mazrekave të Epërme vend ku u ngjizen dhe u formuan në shekuj Kastriotët, të cilët i dhanë kombit tonë të shqiponjave pavdekësinë. Të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të farkëtosh dhe një të vërtetë më shumë se Gardhi i Poshtëm, (vendlindja e dy gjeneralëve të Skënderbeut, Dhimitër dhe Nikollë Berisha), ishte ashtu siç pohon Gjon Muzaka, njeri prej dy katundeve që pati në zotërim Pal Kastrioti, gjyshi i Skënderbeut. Dhe, më në fund, të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të shkruash për një rast unikal në historinë skënderbegiane dhe jo vetëm. Do të thotë të shkruash për dy vëllezër, secili më i zoti se tjetri, që të dy gjeneralë të Skënderbeut, luftëtarë të ekselencës, njerëz të elitës sunduese skënderbegiane, nënkomandantë nga më të rreptët e Skënderbeut dhe, njëherësh, nga më të besuarit e tij, personazhe historike të veprës së madhërishtme të Skënderbeut shkruar nga Barleti, vepër e përkthyer në shumë gjuhë evropiane dhe që qarkullon prej më shumë se 500 vitesh në gjithë botën. Kur shkruhet dhe flitet për Berishët e kohës skënderbegiane, s’do mend që flitet e shkruhet për Berishët

e Muhurrit të Dibrës së Poshtme. Asnjë historian apo kronikan, asnjë burim arkival apo gojor nuk na bën të njohur ekzistencën e ndonjë fisi a familjeje tjetër “Berisha” në gjithë trevën autentike arbërishte të epokës së Kastriotëve. Në se ka sot familje Berishësh, gjithkund, në hapësirat etnike shqiptare, ato, dihet, kanë divergjuar përgjatë harkut kohor të këtyre pesë shekujve të fundit, pra, fill pas MOTIT TË MADH nga e vetmja pikë: Familja e Lashtë e Berishëve të Masrekave dhe Gardhit të Poshtëm, përndryshe, nga Muhurri i sotëm i Dibrës së Poshtme, pikërisht, aty ku e kanë gjenezën, aty kanë dhe trojet e tyre të vjetra e të pakontestueshme Kastriotët tanë të madhërisëm.

Referuar këtyre kolosëve të historisë sonë kombëtare, por dhe në të dhëna arkivore e gojore, poeti, romancieri, përkthyesi dhe, njëherësh, kantautori muhurrak Naim Berisha, autori i më shumë se 30 librave artistikë, (vetëm në këta 23 vitet e fundit), ka botuar së fundmi romanin e tij të gjashtë, të cilit i ka vënë titullin e bukur dhe kuptimplotë, “TË JETOSH NË PAQE”. Ndryshe nga pesë të parët, ky i fundit i përket zhanrit historik.

Në këtë libër, ai trajton temën e qëndresës së popullit të arbërit në kohën e Skënderbeut. Duke glorifikuar familjen e lashtë të Berishëve të Mazrekave në Gardh të Poshtëm, dmth, në Muhurrin e sotëm të Dibrës së Poshtme dhe të dy gjeneralëve të Skënderbeut, vëllezërve Dhimitër dhe Nikollë Berisha, djem të Gjergj Berishë Mazrekës dhe Majra Kastriotit) ai, në të njëjtën kohë, glorifikon gjithë qëndresën heroike të Arbërisë nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër tiranisë së pashembullt turke.

FRYMA POLEMIZUESE E AUTORIT DHE BESUESHMËRIA NË PËRSHKRIMIN E PERSONAZHEVE

Duke vazhduar me vlerat e romanit, nuk mund të mos nënvizoj frymën polemizuese të autorit me ata që u përpoqën të anashkalojnë qëllimisht Muhurrin dhe Berishët, edhe pas mbledhjes së dëshmive të pleqve të urtë muhurrakë Lam Mziu e Fali Rama. Ndërkohë që ka edhe të tjerë që ndonëse botuan libra rreth gjurmëve të kastriotëve në Sinë e Muhurr, megjithë kontributin studimor nuk arritën të orientohen nga figurat e kryetrimave Nikollë e Dhimitër Berisha, siç bëjnë H.Koltraka, S.Mziu e F.Daci. Romani historik i N.Berishës bëhet më i besueshëm kur iu referohet studjuesve të mirëfilltë të Historisë së Muhurrit, Hilmi Sadikut e Ilvi Shehut, apo edhe

Hysni Bruçit e Hysni Milloshit si promovues të vjershë së tij të parë dhe të studimit për Berishët e Muhurrit të botuar në revistën “10 korriku”.

Një figurë interesante është dhe ajo e Liman Berishës, për bëmat e të cilit në betejat kundra turqve e serbëve, deri në kryengritjet e viteve ‘20-21 unë kam shkruar që para 30 vitesh reportazhin “Muhurri në breg të Drinit”, botuar në gazetën “Ushtima e Maleve”, dhe ku ndoshta për herë të parë sjell referenca nga Barleti e Noli për gjeneralët trima të Skënderbeut, Dhimitër e Nikollë Berisha

Tërheqës janë edhe profilet e Xhemalit, Osmanit e hallë Miles, që Gjorgju, mjeshterisht i viziton, qoftë dhe vetem si inkurajues të krijimtarisë së tij. Po në këtë këndvështrim përfshihen në romanin historik “Të jetosh në paqe” dhe xhaxhallarë e autorit, Ramazani, Haliti e Lika sidhe kushurinjtë, Arbeni, Limani e Bardhyli, si pasardhës të denjë të Dhimitrit e Nikollës. Pikërisht edhe për hedhjen dritë rreth këtyre figurave e personaliteteve të shquara, ky roman i N.Berishës zë vend të veçantë në analet e historisë sonë kombëtare.

“TË JETOSH NË PAQE” NJË ROMAN I ZHANRIT HISTORIC

Duke u mbështetur në mendimet e konsulentëve dhe të recenzentëve, emrat e të cilëve janë të shkruar në faqen e parë të librit, kemi mbërritur në një akord se ky libër i veçantë i Naimit, më shumë se një libër monografik për familjen a fisin, është një roman i zhanrit historik, sepse i gjithë libri është nën ndikimin e parimit artistik dhe estetik të historisë.

Ky parim, siç dihet, e sheh historinë edhe si art, njëherësh, i përcakton asaj edhe qëllime të tjera, veç tregimit objektiv të ngjarjeve. Romani “Të jetosh në paqe” mendoj se e prek lexuesin dhe, në të njëjtën kohë, e kënaq atë përmes rrëfimit interesant dhe stilit konciz, të trajtave të larmishme të tregimeve impresionuese, të vrullshme e plot ngjyra.

Natyrisht, parimet dhe tiparet e mësipërme letraro-artistike bien disi në kundërshtim me karakterin e rreptë shkencor të historisë, por ato, në roman, kombinohen aq bukur dhe aq bindshëm ashtu siç shkrihet, në një të vetme, forma artistike me përmbajtjen e romanit.

Edhe fakti se në libër janë përdorur mjaft mjete stilistike, si digresionet, retrospektiva, harmonizimi i kujdesshëm i kësaj të fundit me realitetin e sotëm, ruajtja dhe sigurimi i vazhdimësisë së amaneteve, i kumtit të tejçuar

oral nëpër brezat pasardhës të Berishëve të vjetër, në të njëjtat troje (të Muhurrit) deri në ditët tona, kombinimi i të vërtetave historike që përcjell Barleti dhe të tjerë biografë të Skënderbeut me gojëdhënat që janë shumë të njohura në Muhurr edhe sot e kësaj dite për fisin e Berishëve dhe lidhjet e tij shumë të afërta dhe tejet besnike me Skënderbeun, gërshetimi i linjave themelore të ngjarjeve historike me detajet konkrete të luftës dhe të jetës së dy vëllezërve gjenerala, Dhimitër dhe Nikollë Berisha, ingranimi me këto linja, që mbajnë në këmbë librin, i tregimeve të Babës së Madh, i cili jetoi aq gjatë si për të treguar ..., “Rrnoj për me tregue” dhe që, çuditërisht, na kujton plakun Balë të De Radës tek “Këngët e Milosaos”, dhe, më në fund, rrëfimet në vetën e parë të Gjorgut, (që është vetë autori i librit) të cilat shfaqen, mjeshtërisht, në trajtën e kujtimeve, e të tjera, e bëjnë këtë libër që të anojë më shumë si një roman, sesa një libër, thjesht, jetëshkrimor.

Gjithëçfarë thamë më lart, mendojmë se justifikohet edhe me atë që pohon autori, se letërsia, për të, është e pandarë nga historia.

Ky roman historik, shprehim bindjen se i bën nder sa historiografisë skënderbegiane, aq dhe letërsisë artistike që evokon atë epokë të lavdishme.

“Të jetosh në paqe” që i dedikohet familjes së lashtë, të vjetër dhe të re të Berishëve të Muhurrit dhe jo vetëm, është një kontribut i ri si në thesarin e historiografisë skënderbegiane, ashtu dhe për letërsinë që i korrespondon asaj periode legjendare e të papërsëritshme.

Ky roman me bazë historike të vërtetë është sa tërheqës dhe intrigues, aq dhe me interes e domethënës. Si i tillë, ai lexohet me një frymë. Dhe ne besojmë se do lexohet kështu për shumë e shumë kohë, si brenda, edhe jashtë kufijve të atdheut dhe se do zërë vend të merituar në mjaft biblioteka personale të shqiptarëve.

Për shkrimtarin, poetin, përkthyesin, hajkistin, romancierin dhe kantautorin, bashkëfshatarin tonë të dashur muhurrak Naim Berisha, urojmë nga zemra veç të mira në jetë dhe suksese të mëtejshme në krijimtarinë e tij të bukur artistike.

“NGA ISHIN KASTRIOTËT” KU LINDI SKËNDERBEU?”

*Për librin “Origjina dibrane e Skënderbeut” të studjuesit Besnik S.Kebej
“Panorama” - Jan 17, 2022*

Gjon Muzaka që në shek ullin e 16-të ka lënë si testament: “Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe quhet Pal Kastrioti dhe nuk pati më shumë se dy fshatra në zotërim, të quajtura Sinë dhe Gardh i Poshtëm “ (Gardhi i Poshtëm ndodhet në Muhurr)

Në janar 1974, çështja e origjinës krahinore të Kastriotëve u bë objekt i një studimi të veçantë të profesor Kristo Frashërit, i cili për herë të parë trajton shkencërisht edhe çështjen e vendit ku lindi Skënderbeu. Në artikullin e tij me titull “Nga ishin Kastriotët? Ku lindi Skënderbeu?”, ai shtroi për diskutim dhe ballafaqim të gjitha burimet arkivore dhe letrare, të cilave u shtoi edhe të dhënat toponimike që mblodhi në terren.

Nga analiza e këtyre të dhënave, profesor Frashëri del në përfundimin se, me emrin Has, kronika raguziane e Lukarit dhe koleksioni boshnjak i Fermexhinit, nuk kanë pasur parasysh krahinën e sotme të Kukësit, pasi kjo krahinë, deri në fund të shek. XVI quhej Pashtrik. Ata, sipas Profesor Frashërit, kanë pasur parasysh një nga krahinat e rrethit të Dibrës, qendra e së cilës është Çidhna, e masakruar barbarisht nga Sulltan Mehmeti II më 1466, në gjirin e së cilës ndodhen fshatrat Kastriot, Sinë dhe Gardhi i Poshtëm, që lidhen historikisht me familjen e Skënderbeut.

Këtë tezë, Prof. Kristo Frashëri. e hodhi për herë të parë në gazetën “Mësuesi” të datës 4 shtator 1974, Sipas tij Kastriotët ishin një familje shqiptare nga Dibra e Poshtme. Emrin Kastriotët e morën nga fshati



Kastriot në krahinën e Çidhnës, që ndodhet pranë Drinit të Zi (Peshkopi) (K.Frashëri, Nga ishin Kastriotët, ku lindi Skënderbeu, Mësuesi, Tiranë 1974, Nr. 35-36).

Si argument kryesor Kristo Frashëri jep të dhënat e Gjon Muzakës. Midis të tjerave në kujtimet e tij ai thotë se: “Gjyshi i zotit Skënderbeu quhej Pal Kastrioti dhe ky nuk kishte në zotërim më tepër se dy fshatra të quajtura Sinja dhe Gardhi i Poshtëm”. Të dy këto fshatra, thotë Kristo Frashëri (Shkenca dhe Jeta, Tirane 1988, I, fq.28-31), ndodhen ballë për ballë fshatit Kastriot, në të cilin ndeshim edhe një toponim interesant që lidhet me emrin e Gjon Kastriotit, si: Kulla e Gjonit, Kopshti i Gjonit, Pusi i Gjonit, Ograja e Gjonit, etj.

Një tjetër ide në të cilin u mbështet Kristo Frashëri ishte edhe libri i humanistit Italian Rafael Volaterrano botuar në vitin 1506. (R.Volaterrano, Comentari). Në shënimet e tij autori cilëson Gjon Kastriotin me mbiemrin Dibra ose Dibrani.

Të tjerë autorë që janë shprehur në favor të kësaj teze kanë qenë edhe historianët Hazis Ndreu dhe Ali Hoxha në vitet 1970.

Hazis Ndreu mbështet idenë e Kristo Frashërit, duke na vënë në ndihmë toponiminë e Dibrës dhe veçanërisht atë të fshatrave Kastriot, Sinjë dhe Gardhi i Poshtëm (Gazeta “Mësuesi”, 14 Janar 1976). Ndërkaq, në favor të kësaj teze u shpreh edhe historiani tjetër Ali Hoxha i cili përpiket të argumentojë origjinën dibrane të Kastriotëve (A. Hoxha. Studime historike, 3, 1979, fq.229-236). Ndërsa argumentet e fundit rreth kësaj ideje së fundi u shpreh edhe Fatos Daci, i cili në gazetën Tema e (17-18 tetor 2005) u shpreh jo vetëm kundër dy tezave të tjera (Matit dhe Hasit), por me tone të ashpra u përpoq që të na bindte se “Skënderbeu lindi dhe luftoi në Dibër” ... Midis autorëve të tjerë Daci i referohet edhe argumenteve të Haki Stërmillit, shkrimtarit të shquar të shekullit XX.

Tetë vjet më vonë (1982), historianët e mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri, pasi vizituan muzeun e Kastriotëve në Sinë të Dibrës lanë këtë shënim në fletoren e përshtypjeve të vizitorëve të këtij muzeu: “Sinë, 12 shtator 1982. Vizituam muzeun e vogël të fshatit Sinë, vendi i origjinës së Kastriotëve dhe Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut. Përhëndesim nismën e banorëve të Sinës dhe atyre që e përkrahën ngritjen e këtij Muzeu. Urojmë që ai (muzeu) të pasurohet sa më shumë e më shpejt

dhe të kthehet në një objekt historik të vizitueshëm për edukimin e brezit të ri.

Urojmë që së shpejti në Sinë të ngrihet muzeu kombëtar kushtuar familjes së Kastriotëve e bijve e bijave që nxori kjo derë e shkëlqyer, veçanërisht heroin e pavdekshëm, Skënderbeun”. Kristo Frashëri, Hysen Lala, Stefanaq Pollo, Hazis Ndreu – Firmat (libri “Origjina dibrane e Skënderbeut”, faqe 218- botimet M&B). Pikërisht kjo referencë nga historianët e mirënjohur, prof. Stefanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri e bën më të besueshëm librin “Origjina dibrane e Skënderbeut” (Historia e ngritjes së Muzeut të Kastriotëve në Sinë) të autorit Besnik Selman Kebej, që është një studim vërtet shkencor. Kjo fletore që ruhet me fanatizëm nga arkitekti i këtij muzeu, Besnik S. Kebej, ish-drejtor i shkollës 8-vjeçare Sinë, përbën bazën e këtij studimi që botohet në kuadrin e 554-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu.

Tridhjetepesë vjet pas inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës (18 shtator 2020), një vizitë impresionuese këtu në vend origjinën e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, e kreut të shtetit shqiptar, Ilir Meta, do të shërbente për ripërtëritjen e traditës së kësaj zone. Një ditë historike kjo, pasi referuar pikërisht veprës madhore të prof. Kristo Frashërit, “Historia e Dibrës”, që qëndron hijerëndë përkrah busteve të Gjon, Pal e Gjergj Kastriotit në hyrje të Muzeut, Presidenti Meta, ashtu si edhe elita historike e kombit (prof. Paskal Milo, prof. Bernard Zoto, prof. Adem Bunguri etj.) që vizituan këtë muze para tre vitesh, do të “legjitimonte” këtë fshat si vend origjinë të Kastriotëve.

Por ai që i ka paraprirë kësaj ngjarrjeje madhore është pikërisht, mësuesi i apasionuar pas historisë Besnik S. Kebej, i cili pas një pune studimore 30 vjeçare na dhuron veprën e tij monumentale “Origjina dibrane e Skënderbeut – Historia e ngritjes së Muzeut të Kastriotëve në Sinë”, me 255 faqe, plot referenca, burime arkivore e bibliografike. Redaktori i librit, dr. Fejzulla Gjabri, ndër të tjera e vlerëson atë për një mënyrë ndryshe të trajtimit të origjinës së Kastriotëve. Kjo, sipas tij, për faktin se Besnik S.Kebej, “duke qenë punonjës për disa kohë në Muzeun e Skënderbeut në Sinë, ka fituar përvojën e trajtesave historike, duke përfituar edhe nga debatet e shumta rreth origjinës së Kastriotëve, të parëve të Skënderbeut. Në këtë libër është puna e tij më se 30-vjeçare, duke mbledhur e sistemuar të dhëna

për vendin e origjinës së Heroit’.

Bazuar në referenca të shumta nga studiues të njohur vendas e të huaj që janë marrë me këtë temë, autori i këtij libri trajton shkencërisht tema të tilla si “Kastriotët dhe Skënderbeu”, “Cilët janë dibranët”, “Kastriotët, trashëgimia dhe territoret”, “Kastriotët, etimologjia, flamuri dhe stema” etj. Ndërsa në kapitullin e 7-të, “Disa toponime që formojnë një territor unik”, ai jep të dhëna për disa fshatra sipas defterit turk, për të vijuar më pas në kapitullin e 8-të me “Pak arkeologji në trojet e Kastriotit”.

PAK HISTORI....

Muzeu i Kastriotëve në Sinë qe gati që më 28 nëntor 1979, por për arsye subjektive dhe pengesa të qëllimshme nga ndonjë autoritet vendor i rrethit Dibër, përrurimi i tij u bë pas gjashtë vitesh, më 2 nëntor 1985. Gjithsesi, edhe gjatë këtyre viteve vijoi intensivisht puna për pasurimin e tij. Që në gusht 1978 kur filloi punën drejtor në shkollën 8-vjeçare “Nimete Progonati” në Sinë, B. S. Kebej ra në kontakt me gojëdhëna e emra vendesh për Skënderbeun, njëlloj si në Muhurr. Më pas vijoi për disa kohë me toponiminë dhe intervistat me të moshuarit për Skënderbeun.

Ndërkohë, u ishte dhënë detyrë nxënësve që të vazhdonin me gjetje arkeologjike të rastit, Deri në vitin 1982 organizuan dy sesione shkencore për Skënderbeun, duke pasuruar materialet dhe shtuar njohuritë për Heroin. Gjithashtu, në librin e tij (fq.213) mësojmë se më 29 maj 1982, kooperativisti Isa Kadriu kishte sjellë në Drejtorinë e Shkollës një medaljon prej bronzi me portretin e Skënderbeut. Madje, ky objekt medaljon vuri në lëvizje deri autoritete shkencore të Akademisë së Shkencave në Tiranë.

Gjatë vizitës në Sinë në vjeshtën e vitit 1982, akademikëve të mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo dhe prof. Kristo Farshëri u tërhoqën vëmendjen tri objekte arkeologjike, të gjetura në Sinë të Poshtme: një unazë floriri me portretin e Skënderbeut, që kishte përfunduar në pronësi të Ahmet Zogut; një vulë e thatë me trup guri, pjesa me shkronja e së cilës kishte stemë metalike (kjo vulë është gjetur rreth viteve 1967-1968, kur është hapur kanali vaditës që del në anën e përtejme të Drinit), si dhe një pllakë metalike me stemë, e gjetur rreth vitit 1940, e cila, siç tregojnë, kur fërkohej, ndriçonte derisa të vriteshin sytë deri në verbim. Asokohe, studiuesi i zellshëm B. S. Kebej u ka folur profesorëve të nderuar Pollo e

Frashëri edhe varrin e Ballaban Pashës në Sinë të Epërme, me “kryqet në gur”, për Kllezin e Poshtëm (ku një përrua e ka zanafillën në Këllezin e Epër dhe ky përrua njihet me emërtimin “përroi i qytetit”), për Trojën e Mzeze, ku ka shumë toponime e mikrotoponime me objekt pazaret dhe dyqanet. Mbështetur mbi këtë toponimi mjaftë të pasur, studiuesi Kebej argumenton vendndodhjen e Gardhit të Poshtëm (Zhgjerdhi) në Muhurr.

Ai pohon se këtu ka gjurmë banimi, të cilat janë dëmtuar gjatë viteve të ishkooperativës bujqësore e më vonë u vendos edhe një repart ushtarak, që e dëmtuan edhe më shumë. Gjithsesi, studiuesi Kebej nuk i rreshti kërkimet. Pas intervistave me disa pleq mendjehollë nga Muhurri e Sina, u fokusua në tri legjenda:

“Kepi i Skënderbeut sepse ka pasur gjurmë kali”; “Tre gjurmë të kalit të Skënderbeut janë edhe sot në Hurdha të Mshela; “Skënderbeu në Sheh të Thatë ka pas ndërtuar një kala dhe që edhe sot njihet si Kalaja e Skënderbeut”. Me këto e shumë të dhëna të tjera burimore e arkivore u pasurua më tej Muzeu i Kastriotëve në Sinë, që u përrua zyrtarisht më 2 nëntor 1985. Ky muze i vogël, me një ndërtesë njëkatëshe, me gur të gdhendur nga mjeshtrit e Sinës dëshmon një fakt të madh historik për atë kohë dhe për brezat që do vijnë se origjina e Kastriotëve është Sina e Dibrës.

Jo më kot, historiani i njohur dibran, Haki Përnezha, në rolin e ciceronit, ndër të tjera do t'i bënte të njohur një vit më parë vizitorit më të rëndësishëm të këtij muzeu, Presidentit Meta, atë që ka lënë si testament Gjon Muzaka që në shekullin e 16-të: “Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe quhet Pal Kastrioti dhe nuk pati më shumë se dy fshatra në zotërim, të quajtura Sinë dhe Gardh i Poshtëm...” (Gardhi i Poshtëm ndodhet në Muhurr).

KONKLUZIONE

Studimin e tij të mirëfilltë për origjinën dibrane të Skënderbeut, Besnik S. Kebej e mbyll me konkluzionin se “Territori Muhurr Sinë është ai që plotëson dhe përputhet me dokumente, me pozicionin gjeostrategjik, me toponiminë, me arkeologjinë, se ky është pikërisht territori më minimal që përmend Gj. Muzaka për gjyshin e Skënderbeut”.

Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka sjellë dokumente dhe argumente se

gjyshi i Skënderbeut quhej Kostandin Mazrek Kastrioti dhe se ai ishte nga Mazreka e Epër në Muhurr. Në këto përfundime ai arrin edhe nga fakti se nëpër Muhurr kalonte rruga kalorësiakë me emrin Rruga Dibrane, ndërsa nëpër Sinë kalonte Rruga Plakë. Po ashtu edhe për faktin se në Muhurr ndodhet Qyteza e shekullit V-VI pas Krishtit, në Sinjë ndodhet Kllezi dhe mes Sinës e Muhurrit qyteti i Trojës, që ka varre të shumta, ka ujin, ka dyqanet dhe pazaret, ka vendet fetare me emërtimet Popteshja e Madhe dhe Popteshja e Vogël. Sipas tij, Kastriotët kanë lëvizur për jetë më të mirë nga Mazrekat në Sinë dhe nga Sina dolën në fshatin që formuan vetë në krahun e djathtë të Drinit të Zi, me emrin e tyre, Kastriot.

SKËNDERBEU KA LINDUR NË SINË TË DIBRËS

- Kjo e vërtetë historike pohohet më zë dhe figurë në serialin turk “Jetë luftëtarësh”, përgatitur nga Instituti i Studimeve Ushtarake të Turqisë – <https://youtu.be/TO6UxLfcXvQ>
- Historianët e mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri, pasi vizituan muzeun e Kastriotëve në Sinë të Dibrës lanë këtë shënim në fletoren e përshtypjeve të vizitorëve të këtij muzeu: “Sinë, 12 shtator 1982. Vizituam muzeun e vogël të fshatit Sinë, vendi i origjinës së Kastriotëve dhe Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut. Përsëherë nismën e banorëve të Sinës dhe atyre që e përkrahën ngritjen e këtij Muzeu. Urojmë që ai (muzeu) të pasurohet sa më shumë e më shpejt dhe të kthehet në një objekt historik të vizitueshëm, për edukimin e brezit të ri”

Për herë të parë autoritetet shkencore turke thyejnë heshtjen, lidhur me historinë e Skënderbeut dhe kryesisht me origjinën e vendlindjen e tij. Nëse deri sot historiografia civile apo ushtarake e Turqisë heshte për Skënderbeun dhe historinë e tij, tani foli publikisht. Foli qartë dhe pastër Instituti i Studimeve Ushtarake të Turqisë (Milli Savunma Universitesi-Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare) të Turqisë. *Saktësisht në këtë dokumentar në përkthimin nga gjuha turke në gjuhën angleze dhe nga gjuha turke në shqip thuhet:*

“Gjergj Kastrioti Skënderbeu u lind më 1405, në fshatin Sinë të Dibrës (Kjo shqiptohet qartë në dy fjalitë e para të dokumentarit në fjalë)”.

Duke e publikuar këtë të vërtetë në librin e tij voluminoz me 497 faqe “Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër”, me fakte, argumente shkencore,



referenca nga autorë vendas e të huaj, studiuesi Fatos Daci, shprehet entuziast për faktin se: *“Për herë të parë, Turqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës! Dhe kur vulos Turqia, ish superfuqia e kohës, nuk ka më fjalë. Shqip: Skënderbeu ishte dibran. Pra, ishte shqiptar!”*

Po në këtë libër (fq.59) studiuesi Daci sjell referenca nga Akademia e Shkencave të RSH, konkretisht nga Sesioni Shkencor rreth origjinës dhe prejardhjes së Kastriotëve mbajtur në Peshkopi më 2 Nëntor 1985 me rastin e 580-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Skënderbeut dhe inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës. Dhe nëse Prof. Sterfanaq Pollo ka deklaruar në fjalën e tij përmbyllëse të këtij sesioni shkencor se: *“...Tani mund të themi se origjina e Kastriotëve është Çidhna, është Sina”*, Fatos Daci argumenton, se *“Ky dokumentar i tanishëm, i serialit turk “Jetë luftëtarësh”, i dha publikisht të drejtë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të saj të Historisë për ngritjen në Sinë, në nëntor 1985, të Muzeut të vetëm të Kastriotëve”*.

Autori i librit mjaft voluminoz *“Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër”*, ka të drejtë të ndjehet mirë me këtë konkluzion të pritshëm të shkencës ushtarake turke, për faktin se me argumentet e tij, për gjatë 20 vjetëve, në katër libra që ka shkruar e botuar për Skënderbeun, në qindra artikuj që ka botuar në organe të ndryshme të shtypit ditor dhe atij periodik, në dhjetëra intervista televizive dhe në dhjetëra veprimtari publike që ka zhvilluar në institucionet publike të Tiranës, në Peshkopi a në Dibër të Madhe, ka thënë e shkruar, ka këmbëngulur vazhdimisht me zë të lartë se, për një mijë arsye, Skënderbeu është dibran dhe ka lindur në Dibër, në krahinën e Çidhnës.

Në librin e tij me një bibliografi mjaftë të pasur (87 libra, fjalorë, studime, botime në gazeta të ndryshme), në 59 tituj, Fatos Daci argumenton, se: Nga ishin Kastriotët dhe Skënderbeu, ditëlindjen e saktë të tij më 6 maj 1405, në Sinë të Dibrës, pamjen fizike të Skënderbeut etj. *Mjaftë interesantë e tërheqës janë artikujt: “Pse Skënderbeu braktisi Portën e Lartë dhe u kthye në Shqipëri”; “Skënderbeu nuk mund të tjetërsohet”; “Skënderbeu është realitet historik” etj.*

SKËNDERBEU NË SERIALIN TURK “JETË LUFTËTARËSH”

“Sipas dokumentarit në fjalë, Gjon Kastrioti ishte princ dhe e shtrinte pushtetin në tokat e Dibrës, Matit, Krujës dhe Mirditës. Gjon Kastrioti, babai i Gjergj Kastriotit u mund dhe pranoi pushtimin osman në vitin 1421, ndërsa në vitin 1423, i dha Sulltanit si garanci (peng), djalin e tij Gjergjin, i cili në Oborritin e Sulltanit u konvertua në mysliman. Pra, Skënderbeu nuk shkoi në Turqi, te Sulltani as në moshën 8 vjeç, siç është interpretuar herë të tjera e as në moshën 10 vjeç, por plot 18 vjeç.

Nga viti 1423, deri në vitin 1431, Skënderbeu qëndroi në Oborritin e Sulltanit, ku mori edukimin me anë të shkollimit, ndërsa në vitet 1431-1437, kreu studimet ushtarake dhe doli oficer. Në kryengritjet shqiptare të 1432 dhe 1436, Skënderbeu nuk mori pjesë. Për 6 vite tregoi aftësitë e tij ushtarake dhe mori besimin e Oborrit. Prandaj, më 1437, u emërua subash dhe filloi të merrte pjesë në luftërat osmane, si spahi, si dhe i ngjiti me shpejtësi shkallët e gradave, duke u bërë më 1443, sanxhakbej (gubernator) i Dibrës”, shkruan F.Daci në librin e tij (faqe 133). Po në këtë faqe të këtij libri autori pohon se dokumentari turk hedh dritë mbi një tjetër fakt të rëndësishëm. “Kemi thënë e kemi shkruar se, bazuar në Marin Barletin, Skënderbeu u kthye nga Nishi vetëm me dibranë, jo ‘me shqiptarë’, siç shpesh problemit i bihet shkurt e kithtazi, me keqdashje, sepse në betejën e Nishit, Skënderbeu mori pjesë me ushtrinë e tij të përbërë me dibranë dhe shkoi nga Dibra në Nish, sepse Sulltani kishte urdhëruar të gjithë guvernatorët që në Nish të shkonin për të luftuar me kryqtarët, me ushtritë që do të mblidhnin nga vendet e tyre. Pra, Skënderbeu do të mblidhte ushtrinë e tij në Dibër, me dibranë, ashtu si mblodhi, se në Dibër ishte guvernator” .

Këto fakte studiuesi F.Daci i argumenton me referenca të autorëve të shumtë vendas e të huaj të historisë së Skënderbeut. Më konkretisht, autori i referohet edhe *Barletit i cili e përshkruan qartë, se “Skënderbeu u kthye nga Nishi me 300 luftëtarë të një fisi, dhe jo të disa fiseve, dhe me ta ai u kthye drejt e në Dibër, ku të gjithë e njihnin, donin dhe e respektonin”*.

PAK NGA HISTORIA

Pas kthimit nga Nishi, Skënderbeu refuzoi Islamin dhe u betua se do të hakmerrej për familjen e tij dhe shqiptarët. Për t'u hakmarrë ndaj Skënderbeut dhe shqiptarëve, që ishin rebeluar, Sulltani, pas 6 muajsh, dërgoi 30 mijë ushtarë, nën komandën e Ali Pashës. Skënderbeu kishte 15 mijë luftëtarë, nga të cilët 5 mijë luftëtarë i la në fushëbetejë, ndërsa 10 mijë i fshehu në male. Në këtë betejë, turqit patën 20 mijë të vranë dhe luftëtarët e Skënderbeut 5 mijë të vranë. Skënderbeu dhe luftëtarët e tij shënuan një fitore të rëndësishme dhe historike. Sipas një dokumentari tjetër dhe dëshmimeve të historianëve të tjerë fushëbeteja e Torviollit ishte në një fushë të rrethuar me pyje, me një gjerësi prej 4 km. Luftimet filluan më 28 qershor 1444, dhe dinamika e luftimeve u zhvillua më 29 qershor 1444. Vetëm e dhëna interesante, edhe nga autorë të tjerë, se fushë-beteja e Torviollit kishte gjerësi prej 4 km., rrëzon të gjithë aludimet e mëparshme për vendin, ku u zhvillua kjo betejë historike. Të tilla përmasa nuk i plotëson fusha e Përrenjasit (ku, sipas Dilaver Radeshit mund të jetë zhvilluar beteja e Torviollit), aq më pak nuk u plotëson as Fushë-Bulqiza (ku në kohën e komunizmit, te Ura e Qytetit, qe vendosur lapidari i kushtuar betejës së Torviollit), sepse gjerësia tyre nuk arrin mbi 1 km, jo më 4 km.. Të tilla përmasa i plotëson vetëm fusha e Kastriotit (nga shkolla e Kastriotit deri te sifoni mbi Dri dhe nga përroi i Kuke deri te Kodrat e Zdojanit, përballë Muhurrit) dhe vetë Fushë-Alia (Nga sifoni mbi Dri, deri te ura e Topuze).

KONTRIBUTI I FATOS DACIT PËR NDRIÇIMIN E HISTORISË SË SKËNDERBEUT

Mbështetur në studime skrupuloze, në dokumente arkivore e të dhëna gojore, Fatos Daci është i pari dhe i vetmi që ka zhvilluar veprimtari publike për Kastriotët dhe Skënderbeun te Muzeu i Sinës, duke filluar nga 6 maj 2008, kur muzeu ishte kthyer në sallë bagëtish. Pastaj, aty, vit pas viti, ka zhvilluar veprimtari publike në formë spektakli, duke e mbajtur në vëmendje e duke sensibilizuar opinionin për mirëmbajtjen e tij, si dhe për ta vizituar...

Fatos Daci ka shkruar 4 libra (tre të botuar dhe një në proces botimi), si: “Skënderbeu i vërtetë”, “Kastriotët e Çidhnës”, “Çidhna e Kastriotëve” dhe “Të vërtetat për Skënderbeun”

Ai ka realizuar tre dokumentarë, si: “Dibranët festuan ditëlindjen e Skënderbeut”, “Dibra priti me madhështi birin e saj” dhe “Shëngjergji i Skënderbeut”.

Kontributi i këtij autori me mbi 60 libra të botuar konsiston, gjithashtu, në realizimin e tre sesioneve shkencore në Peshkopi për origjinën e Kastriotëve dhe vendlindjen e datëlindjen e Skënderbeut: më 6 maj 2008, më 6 maj 2010 dhe më 25 nëntor 2018.

Në harkun kohor të pesë viteve të fundi ai ka realizuar 5 spektakle në Sinë, më 6 maj, për ditëlindjen e Skënderbeut; Ka realizuar spektakël në Sinë, në kujtim të kthimit të Skënderbeut nga Nishi, më 3-10 nëntor 1443.

Si studiues dhe botues, F.Daci ka mbajtur dy kumtesa shkencore për Skënderbeun jashtë vendit, për origjinën dibrane dhe ditëlindjen e tij, një në SHBA dhe një në Pulia të Italisë, që të dyja gjatë vitit 2018.

Ai ka organizuar ceremoninë e dorëzimit prof.Kristo Frashëri të titullit “Qytetar Nderi” të komunës së Arrasit, te Muzeu Historik Kombëtar, më 25 maj 2008.

Që nga viti 2005, në vijimësi, ka marrë pjesë në debate dhe polemika me autorë të ndryshëm në shtypin e ditës lidhur me origjinën e tij dhe në mbrojtje të figurës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Dendësia e veprimtarive mjaftë produktive e cilësore të Fatos Dacit përfshin gjithashtu përrurimin e disa librave kushtuar Skënderbeut në Tiranë, Dibër të Madhe dhe Peshkopi.

RISJELLJA NË VËMENDJEN E OPINIONIT DIBRAN E SHQIPTAR I MUZEUT TË VETËM TË KASTRIOTËVE NË SINE TË DIBRËS!

Z.Fatos Daci, Mjeshtër i Madh, me shumë kontribute për historinë e Dibrës dhe të Kukësit, ishte ai që e risolli në vëmendje të publikut dhe të vizitorëve Muzeun unik e të Kastriotëve në Sinë. Që nga nëntori i vitit 1985, ku ky muze u inaugurua në mënyrë solemne, deri në vitin 2008, I ishte lënë harresës kolektive. Aty nuk bëhej asnjë vizitë, nuk zhvillohej asnjë veprimtari. Çelësi i Muzeut ishte në dorë të një personi që pretendonte se Muzeu ishte ndërtuar në tokën e tij, i cili e kishte kthyer në stallë bagëtish.

Në maj të vitit 2008, Fatos Daci, në vitin 2008, organizoi ditëlindjen e parë të Skënderbeut te ky muze me një aktivitet publik, qe ishte edhe vizita e parë e një komuniteti të madh. Atë ditë, për herë të parë u hap dera e Muzeut. Atë ditë e më pas, e ngriti problemin e gjendjes së mjeruar të tij te strukturat kryesore vendore dhe te komuna, të cilat u vunë në lëvizje. Kjo nismë gjeti përkrahjen e ndihmën e z.Sali Tërshalla Dr.Shkencave dhe kryetar i komunës së Arrasit dhe të z.Xhafer Seiti, atë kohë prefekt i Dibrës.

Që nga kohë z.Daci dhe Unioni i Krijuesve Dibranë, që drejton, ka festuar në vijimësi çdo 6 Maj ditëlindjen e Heroit, shoqëruar dhe me sesione shkencore në Peshkopi. Ftesës për të mbajtur kumtesa i janë përgjigjur Prof. Paskal Milo, Prof. Bernard Zotaj, Prof. Bardhosh Gaçe, Dr. Asllan Zemani, Azis Keta, Haki Pernezha, Enver Kaloshi, Ali Hoxha, Murat Koltraka etj. të cilët gjejmë rastin t'i falënderojmë publikisht, si dhe operatorët Neki Feta dhe Islam Shehu, që i kanë ndjekur të gjitha veprimtaritë, për t'i pasqyruar në televizionet, për të cilët ata punonin.

Më 25 nëntor 2018, në bashkëpunim dhe me “Çidhna e Kastriotët”, organizoi veprimtarinë më të bukur në shkallë vendi, në kuadër të Vitit të Skënderbeut, kur me një veprimtari brilante e shumë të arrirë organizoi “kthimin” e Heroit nga Nishi, më 10 nëntor 1443.

Që nga viti 2008, nisi vullnetarisht të bënte rikonstrukcionin e Muzeut të Kastriotëve në Sinë.

Në një rast, siguroi pllakat, dhuratë nga nderuari Astrit Kuçi, dhe me shpenzimet e tij i dërgoi nga Fushë-Preza, ku i mori, në Sinë. Për fatin e tij, pasi i shkarkoi te hyrja e rrugës së Muzeut me njerëzit që i pagoi vetë, aty u gjend administratori i firmës që kishte fituar tenderin nga bashkia, z.Faruku, dhe ia dorëzoi falas pllakat, ndërkohë që la edhe gjithë materialin figurativ të printuar, fatin e të cilit nuk e di as sot. Me këtë rast la falas për vizitorët edhe 200 copë të librit guidë për Skënderbeun, të titulluar “Kastriotët e Çidhnës së Dibrës, printuar i gjithi me ngjyra.

Sot, falë edhe interesimit të bashkisë së Dibrës, Muzeu është në gjendje shumë më të mirë, nga ç'ishte kur qe harruar, si deri në vitin 2008.

Çdo veprimtari e zhvilluar te Muzeu i Kastriotëve në Sinë dhe Peshkopi është reklamuar fuqishëm me video, fotografi të shumta dhe kronika në shtypin e ditës, në gazetën “Dibra” dhe në rrjetet sociale.

Megjithatë, duhet bërë dhe më shumë. Materiali figurativ ka dhe

gabime shkencore, të cilat Fatos Daci i ka vënë në dukje, por që nuk janë korrigjuar.

KONKLUZIONE

Autori Fatos Daci, me përvojë të gjatë në fushën e botimeve dhe studimeve, në librin e tij më të fundit *“Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër – Tuqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës”* ka përdorur të gjitha argumentet për të arritur në konkluzionet e tij. Në librin e zotit Daci gjen plot dokumente arkivore, pa ju heq e ju shtuar asgjë, siç bëjnë rëndom disa që abuzojnë me dokumentin. Raste të tillë sillen me shembuj konkret. Autori bën qartësisht analizën historike, deri dhe analizë gjuhësore, gramatikë historike etj. Në argumentet e tij, ai, mbështetet edhe te toponimet.

Kështu në artikullin *“Toponimia vërteton lidhjet e vetme të origjinës së Kastriotëve me Dibrën”* (fq.46), pasi bën përkufizimin e saktë të vendndodhjes së fshatit Kastriot, përshkruan me hollësi *toponime të këtij fshati*, si *“Kulla e Gjoni”*, *“Ograja e Gjonit”*, *“Kopshti i Gjonit”*, *“Pusi i Gjonit”*, *“Zabeli i Gjonit”*, *“Guri i shamates”*, *“Kodra e pareve”*, *“Guri i kazanave”* etj.

Më tej në faqen 47 të këtij libri, autori F.Daci shkruan se *“Toponime të tilla që lidhen me Kastriotët dhe Skënderbeun gjenden edhe në Muhurr e Selishtë”*, ku sipas tij, në Muhurr me rëndësi është toponimi *“Arat e Mazrekave”*, dhe vendndodhja e tij ndodhet pikërisht në ato kordinata që përshkruajnë historianët .

Referuar këtyre burimeve, autori Daci, shkruan, se *“Njoftimet arkivore, letrare, gojore dhe toponimike që kemi deri tani mbi familjen e Kastriotëve, pajtohen midis tyre dhe plotësojnë njëri-tjetrin, të paktën në vijat kryesore”*(fq.481). Dhe ajo çka është më e rëndësishmja, thyerja e heshtjes nga historiografia turke për të cilën autori F.Daci me të drejtë shkruan: *“Historiografia turke, pas një heshtjeje mbi 5 shekullore, më në fund foli dhe foli publikisht e me zë të lartë për Skënderbeun. Ishte Instituti i Studimeve Ushtarake të Turqisë, i cili i kushtoi një dokumentar Gjergj Kastriotiti, tek seriali ‘Jetë luftëtarësh’. Ky Institut studimesh, në fjalinë e parë pohon atë që kemi deklaruar në dhjetëra artikuj, katër libra e disa intervista televizive kushtuar Heroit tonë kombëtar, se Skënderbeu ka lindur në Sinë të Dibrës më 1405”*.(fq.64). Ndaj dhe Prof.dr.Hasan Çipuri shkruan në parathënie se: *“Për të sqaruar dhe argumentuar të vërtetën mbi origjinën dhe vendlindjen e*

Skënderbeut, autori (F.Daci) ka përmendur në libër mbi 28 studiues të huaj dhe mbi 40 historianë shqiptarë nga më të spikaturit, duke filluar që nga Marin Barleti e Gjon Muzaka, te Fan Noli, Naim Frashëri, Marin Serdari, Dhimitër Frengu, e deri tek Aleks Buda, Kristo Frashëri, Sabri Godo, Mustafa Kruja, Injac Zamput, Kasem Biçoku, Luan Malltezi, Shahin Leka, etj. Gjatë hulumtimit të burimeve të nevojshme, autori ka pasqyruar 110 referenca të shënuara sipas çështjeve të renditura në libër”.

Dyzetenëntë vjet më parë (janar 1974), çështja e origjinës krahinore të Kastriotëve u bë objekt i një studimi të veçantë të profesor Kristo Frashërit, i cili për herë të parë trajton shkencërisht edhe çështjen e vendit ku lindi Skënderbeu. Në artikullin e tij me titull “Nga ishin Kastriotët? Ku lindi Skënderbeu?”, ai shtroi për diskutim dhe ballafaqim të gjitha burimet arkivore dhe letrare, të cilave u shtoi edhe të dhënat toponimike që mbloodhi në terren. Nga analiza e këtyre të dhënave, profesor Frashëri del në përfundimin se, me emrin Has, kronika raguziane e Lukarit dhe koleksioni boshnjak i Fermenxhinit, nuk kanë pasur parasysh krahinën e sotme të Kukësit, pasi kjo krahinë, deri në fund të shek. XVI quhej Pashtrik. Ata, sipas Profesor Frashërit, kanë pasur parasysh një nga krahinat e rrethit të Dibrës, qendra e së cilës është Çidhna, e masakruar barbarisht nga Sulltan Mehmeti II më 1466, në gjirin e së cilës ndodhen fshatrat Kastriot, Sinë dhe Gardhi i Poshtëm, që lidhen historikisht me familjen e Skënderbeut.

Tetë vjet më vonë, *historianët e mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri, pasi vizituan muzeun e Kastriotëve në Sinë të Dibrës lanë këtë shënim në fletoren e përshtypjeve të vizitorëve të këtij muzeu: “Sinë, 12 shtator 1982. Vizituam muzeun e vogël të fshatit Sinë, vendi i origjinës së Kastriotëve dhe Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut. Përshëndesim nismën e banorëve të Sinës dhe atyre që e përkrahën ngritjen e këtij Muzeu. Urojmë që ai (muzeu) të pasurohet sa më shumë e më shpejt dhe të kthehet në një objekt historik të vizitueshëm, për edukimin e brezit të ri”.*

Pikërisht kjo referencë nga historianët e mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri e bën më të besueshëm librin “*Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër – Tuqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës*” të autorit Fatos Daci, një botim ky me vlera vërtet shkencore. Kjo edhe për faktin se nëse, sot, ekziston një korpus i madh botimesh mbi origjinën e Kastriotëve dhe vendlindjen e Skënderbeut, historia skënderbegiane do të

ishte e mangët pa këtë libër të autorit Fatos Daci, i cili përveç studimeve të shumta serioze e të mirëargumentuara, *sjell më së fundi për publikun faktin e pakontestueshëm: serialin e dokumentarit turk ku që në fillim deklarohet Sina e Dibrës si vendlindja e Heroit tonë kombëtar*. Po, është Fatos Daci, që ka sens në edukimin e gjeneratave dhe studimin e historisë kombëtare, ai që hedh dritë mbi historinë reale skënderbegiane, ndryshe nga shtrembërimet e historiografisë së derisotme. Sot, ai ndjehet krenar dhe është i nderuar për faktin se puna e tij studimore shumëvjeçare ka arritur në destinacionin e duhur, e çertifikuar tashmë edhe nga Instituti i Studimeve Ushtarake të Turqisë që deklaroi Sinën e Dibrës si vendlindje të Skënderbeut.

SAGË E LAVDISHME SFIDASH TË ATDHETARËVE SHATKU QË BËNË EMËR NË HISTORINË E TIRANËS


*Duke lexuar librin historiko-biografik të bashkëautorëve Dr.Saimir
Shatku dhe Qatip Mara*

Plejadës së burrave të shquar që bënë emër në historinë e kryeqytetit shqiptar të gjysmës së parë të shekullit të kaluar i përkasin edhe patriotët nga Dibra e Madhe: Izet Shatku-Dibra (ish prefekt i Tiranës 1927-1928), Faik Shtaku, ish Ministër i Drejtësisë në qeverinë e fundit mbretërore të kryesuar nga Koço Kotta, Shefki Shatku, ish komandant i Përgjithshëm i Xhandarmërisë Mbretërore nga tetori 1931, si dhe disa emra të shquar të këtij fisi emërndritur.

Pikërisht, për kontributin e këtyre burrave të shquar, bashkëautorët Dr.Saimir Shatku dhe Qatip Mara, pas një punë të mirëfilltë studimore dhe mbi burime arkivore shumë bindëse shkruan dhe botuan librin historiko-biografik “Atdhetarët Shatku”.

Procesi i hartimit, përgatitjes, sistemit dhe botimit të një libri, nuk është një punë e lehtë dhe aq më tepër e kuptueshme për këdo, por në këtë libër, katalizatori kryesor u bë rëndësia ndihmëse dhe historike e vlerave dhe figurave kombëtare, në krijimin, zhvillimin dhe konsolidimin e shtetit Shqiptar dhe institucioneve tona.

Konkretisht, libri është i ndarë në pesë kapituj, tema dhe nënkapituj, i paisur me një bibliografi të pasur botimesh të cilat fillojnë nga periodikët e kohës, antikuarët dhe revistat e viteve 1919-1944; Dokumente arkivor nga fondi i arkivit të shtetit me nr. 803, 804 dhe nga fondi jetëshkrimor



i disa personaliteteve në këtë botim, si dhe qindra e mijëra dokumente të tjera shteruese e bibliografike retrospektive të kohës, janë një burim i rëndësishëm për këtë libër.

BURIME TË FONDIT ARKIVOR E ATIJ FAMILJAR

I një rëndësie të veçantë është përdorimi gjithashtu si pjesë e studimit, materiale dhe dorëshkrimet e fondit të arkivit familjar si dhe ditaret e tyre.

Një kontribut të veçantë në lidhje me pasurimin e informacionit në botim, kanë dhe fondet e fotografive nga fonoteka Marubi, Shkodër, arkivi fotografik, Insituti Lucce, Romë, foto-studio Ristani, Tiranë, foto Dajti si dhe foto Sport.

Periudha e studimit mbi trungun genetik të familjes Shatku, fillon që me datimin e tyre në qytetin e Dibrës së madhe në vitin 1671, pra para 350 vitesh, si pjesë e sanxhakut të Manastirit e duke përfshirë rrugëtimin historik të rrjedhës së kohës, dhe depërtimin e tyre në Tiranë pas eksodit masiv të shtatorit të 1913.

Në libër përshkruhet me vlerësime dhe mirënjohje roli dhe kontributi i kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Zyber Hallulli, i cili sëbashku me familjet e tjera të pasura të Tiranës si, Bargjini, Kërçiku, Vorpsi, Karapici, Bakalli, Fagu, dolën dhe pritën kolonat e para të eksodit masiv të genocidit sllavo-serb të 1913.

Më pas, në libër, bëhet një detajim më i gjerë i fëmijërisë, arsimimit, edukimit kulturor e shoqëror, studimeve shkencor dhe deri në funksionet dhe detyrat politiko-juridike, të disa prej figurave më eminete të kësaj familje.

Pjesë e rëndësishme e librit, janë veprimtaritë dhe kompetencat që ato kanë ushtruar nga periudha e viteve 1916 deri më 1939, si guvernator rajoni në, Çall, Allasonjë, Manastir e Gramsh, prefekt i disa qyteteve, si Durrës, Berat, Elbasan, Tiranë, Deputet i Dibrës, Tiranës dhe Elbasanit, Ministër i Punëve Botore, i Ekonomisë Kombëtare, si dhe Drejtor i Përgjithshëm i Reformës Agrare dhe Zyrës së Emigracionit, Ministër i Arsmi Kombëtar dhe i Drejtësisë dhe Komandat i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, ndërsa periudha më me trysni e kohës, ishte ajo e dëbimit dhe urbanizimit të tyre, pas vitit 1947.

LIBËR QË PASURON LETËRSINË TONË DOKUMENTARE

Padyshim që botimi i këtij libri që pasuron dukshëm letërsinë tonë dokumentare është meritë e shtëpisë botuese “M&B me administraor z. Bujar Karoshi. Gjithsesi në promovimin që u bë këtij libri në sallën e madhe të Presidentit të Republikës në kuadrin e 100 vjetorit të Tiranës kryeqytet, autori Saimir Shatku vlerësoi rolin e redaktorit shkencor z. Remzi Zeqja, dhe redaktorin letrar znj. Lumturi Prizreni, recezentin e librit, z.Tofik Jegeni, si dhe z.Gazmend Baku për parathënien e librit dhe pasthënësin e tij z. Bujar Kapexhiu.

Falenderim dhe mirënjohje shkon gjithashtu për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivit, bibliotekën Kombëtare, Insitutin e Historisë, Insitutin e Monumenteve të kulturës, fonotekën Marubi, si dhe arkivin historik të insitutit Luce, Romë për fotografitë e tyre.

NGAZËLLIM DHE NGUTJE E BRENDSHME PËR TË HEDHUR DRITË MBI AKTIVITETIN PATRIOTIK TE PERSONALITETEVE TË TILLA

Duke lexuar këtë libër, përjetimet janë të shumta dhe historia e dyerve dhe fiseve më në zë, që e kanë mbartur atdheun si një peng dashurie të përjetshme, në udhëkryqe kohësh dhe epokash, duket se konvergjon në një pikë: në shpirtin e sakrificës, që i ka udhëhequr dhe motivuar në shekuj këto familje të mëdha fisnikësh, për të bërë shumë më tepër se detyra ndaj familjarëve, derës, fisit, farefisit dhe trevës së tyre. Duke u bërë modele të sjelljes atdhetare e dinjitozë të kohës që i lindi dhe i ushquu me pasionin e etshëm të Lirisë... Madje siç shkruan Gazmend Baku “Mjeshtër i Madh” në parathëminë “...kur merr në dorë një libër si ky, që autorët Dr. Saimir Shatku dhe Qatip Mara po i japin lexuesit, ndjen një ngazëllim të brendshëm dhe një ngutje të brendshme e të beftë, për të hedhur diçka në letër.

Impresioni i parë, kur kthen faqen e fundit të librit, është ballafaqimi me njohuritë tona, për kohën kur bëhet fjalë në këtë histori dhe përtej kësaj, fakti kokëfortë se sa të vërteta kanë mbetur në hije për dyert dhe familjet më fisnike të kombit, në një kohë të pakohë”.

Libri “Atdhetarët Shatku” i autorëve, Saimir Shatku dhe historianit

Qatip Mara, një libër i shkruar me përgjegjësi krijuese dhe realizëm, për një të njërën nga familjet më me kontribut në historinë e Dibrës së Madhe.

Libri paraqet një sagë të lavdishme përpjekjesh dhe sfidash atdhetare, të burrave më në zë të fisit Shatku, që në përballje me vetveten, për të tejkaluar unin e tyre dhe rrethin e interesave të ngushta, ngrihen në lartësinë e vizioneve kombëtare. Bëhen pjesë e udhës së vështirë, plot kthesa të rrezikshme dhe honesh, ku është vërtitur koha e shqiptarëve, në një nga periudhat më dramatike të historisë sonë, kur kërcënoheshim nga lakmia shovene, nga njëra anë, dhe nga dritëshkurtësia e orekseve të kolltukofagëve, nga ana tjetër.

Evidentimi i vlerave morale, njerëzore, diturore të pinjollëve të derës Shatku, Izet Shatkut, Faik Shatkut, Shefki Shatkut etj, nxjerrja në pah e qëndresës së tyre përballë lakmisë, dredhisë dhe korrupsionit administrativ, që edhe atëherë, si dhe sot, ka qenë më se i pranishëm në jetën politike dhe administrative shqiptare, jepet nga autorët me një kolorit të gjerë dhe të detajuar ngjyrash emocionale.

Ky libër është një ftesë për të reflektuar mbi ndalesat dhe vakumet historike. Për të parë përtej fasadave të servitura nga kohë dhe shoqëri të devijuara qëllimshëm në udhëkryqe epokash të trishta, siç ishte epoka ku ne kaluam në gjysmëshekullin absurd.

VEPËR SHKENCORE ME VLERA TË JASHTËZAKONSHME ETNOKULTURORE

*Rreth librit të Prof. Dr. Fatmir Terziut “Toponimia e Gollobordës:
Diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i origjinës”*

PARARENDJA E SHKRIMIT

E lexova me shumë vemendje dhe interes të veçantë librin studimor të veçantë të Prof. Dr. Fatmir Terziut **“Toponimia e Gollobordës: Diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i origjinës”**. Një analizë të mirëfilltë mjaft të detajuar i ka bërë këtij botimi Prof. Dr. Eshref Imeraj, i cili që në krye të pasthënies nxit lexuesin, kur shprehet: *“Lexohet me shumë kënaqësi. Kjo është një vepër me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore”*. Por unë do të veçoja vlerat studimore, duke e konsideruar këtë një vepër të rëndësishme shkencore.



TRE DALLESAT TIPOLOGJIKE

Së pari: Që në fillim, autori trajton bindshëm dhe me finesë marrëdhënien mes gurit dhe zjarrit...duke pëshkruar *“...prodhimin e produktit të lindur prej gurit dhe zjarrit me produktin që në fakt kishte përdorim të dyfishtë, shëndetësor dhe estetik, të katër faktorët janë të pranishëm: toka, riprodhimi primitiv, puna dhe paraja, kombinimet e ndryshme të të cilave përbëjnë historinë e këtij produkti, që u ngjiz si gëlqere, një nga elementët më të rrëndësishëm, pas vetë grurit, baltës, rërës dhe drurit në një proces të ngritjes estetike të një banese. Por që nga momenti i shkëljes së tyre nga toka, deri në formëzimin e fundit të gurit e produktit të fundit të vënies në shërbim të obligimit njerëzor, si produkt i tij pas zjarrit, gëlqerja,*

*vetvetiu sillen në mënyra gati se gjithmonë kundërshtojnë rrënjësisht lidhjen me zjarrin. Shtëpitë janë të tilla pas së gjithave, por kur zjarri dhe zjarrvënësi nuk kanë arsyen e dhimbjes, natyrisht kundërshtia shkon përtej dhimbjes në të gjitha rrëfenjat, këngët e rrjedhat. Në këtë kornizë të ardhur nga rrëfenjat guri i skalitur në duart e ustait e mbajti zjarrin në shpirt, në zemër e në tërë udhën e tij të ecjes jetike. Sakaq ustai forcoi dashurinë me gurin.”*Për analogji, sipas një legjende: kur **dibranët e Dibrës së Madhe u vendosën në Tiranë**, pas eksodit të 1913-tës, lyen muret e shtëpive dhe të avllive me gëlqere dhe **tiranasi u çuditën dhe kujtuan se po i lyenin me qumësht...** Jo, ajo ishte gëlqerja që Prof. Terziu e sjell me rëndësinë që ka si element i pazëvendësueshëm në ndërtimtarinë shqiptare ku gollobërdasit dhe dibranët kanë në histori unike si njerëzit që sikur kanë ndërtuar cepe më cep të Shqipërisë duke vënë „vulën“ e qëndresës kombëtare edhe pse gjithmonë nën sulm dhe drejt „detdhedhjes“ nga fqinjët e pangopur.

Së dyti: Gjatë vitit që punoja në ish-këshillin e rrethit Bulqizë për 7 vjet (1991-1997) kam shkelur pothuajse në shumicën e fshatrave të ish-komunave Ostren e Trebisht, ndërsa më parë, në ish - shtëpinë e oficerëve Bulqizë (1997-1991), edhe në disa fshtara të Steblevës, madje deri na Draganin majë maleve. Por veçanërisht, në gazetën “Bulqiza” që themelova dhe nxora rreth 90 nr të saj (1992-1996 në Bulqizë dhe 1015-2020 në Tiranë) kam botuar disa artikuj studimorë të autorëve të njohur nga Golloborda: Hilmi Sadikaj, Velo Cfarku, Agim Bekteshit, Besnik Rama etj, të cilët përveç pozitës gjeografike, pavarësisht dygjuhësisë argumentojnë se shumica e banorëve të kësaj zone janë shqiptarë autoktonas dhe kjo „dygjuhësi“ shpjegohet me tregun dhe etjen për punë të burrave të Gollobërdës historike.

Pa marrë parasysh vëshirësitë e ndërmarrjes së një studimi të tillë në një kohë kur parlamenti i Shqipërisë ka miratuar tashmë ligjin “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, në të cilin ka përcaktuar se minoritetet në Shqipëri janë nëntë, përfshirë dhe pakicën bullgare, të cilësuar si të tillë popullsinë e fshatrave të zonës së Gollobordës, Prof. Dr. Fatmir Terziu, nëpërmjet referencave të shumta, ku unë veçoj prof. Kristo Frashëri, prof. Eqerem Çabej, Marin Barleti, Hilmi Sadikaj, arkivat britanike (sidomos mendimtarët e shquar si bizantologu francez Alen Dykelie (Allain Ducellier), dhe historiani anglez Noel Malkolm, etj, është më bindës në

këtë kontekst. Kjo sepse argumenton bindshëm se si lëvizjet dhe pushtimet kanë sjellë ndryshime, jo vetëm në konstrukt, por dhe në ADN-në e popujve, krahinave e njërëzve veçmas në Ballkanin që duke qënë „shesh luftime“ shpesh ka përzjerë keqas gjuhëtdhe etnitë origjinale. Mjafton të perifrazojmë atë që shkruan në fq. 7: *“Se kush janë banorët e një zone të tillë në derivatin e origjinës dhe në diskursin e gjuhës, apo dhe të dygjuhësisë, gjithashtu dhe përsëri për mendimin tim, mund dhe s’mund të përcaktohet nga gjuha që flet dhe shkruan, ndërtimet dhe shenjat e lashta që e rrethojnë aty ku jeton dhe gurët e shkruar nëntokë e mbi tokë. Këta komponentë popullit të kësaj zone, nuk i mungojnë, kur vjen fjala e këngëve të mbetura që edhe në gjuhën e grave dygjuhëfolëse këndohet dhe faktohet se “Rosa rosit vo arbanoshka zemja...” (vesa veson në tokën arbërore...) por i mungon dëshmia e shkruar, i mungon madje mjaft arsyeja e gjuhëve të shumta mbi këta gurë, i mungon, ajo që të tjerët në shekuj e bënë sipas rrethanave të tyre për të nxjerrë në pah “orrigjinën” dhe mbi të gjitha dhe “dominimin” e dëshirave të hershme të shtrirjes masive territoriale”.*

Së treti: Këto teza autori i shtjellon duke sjellë fakte dhe argumenta në tre pjesët e para të kësaj vepre. Në pjesën e parë “Golloborda nga memorja”, nga artikulli “Emri, rrjedhat dhe gjuhët”, prof. Terziu ka si referencë “Defteri Osman” i vitit 1467, të cilin e solli në vëmendje për herë të parë në këtë drejtim historiani Hilmi Sadikaj (1999), duke theksuar se “kjo krahinë ka qenë e regjistruar me emrin “Dullgoberda ose Dollgoberda”. Pra, emri i kësaj krahine vjen nga bullgarishtja e vjetër dhe do të thotë në shqip “kodër (bordo) e gjatë (dollgo). Ky toponim gjendet i pranishëm pjesërisht në emërtime lokale vendesh, si në Trebisht (kodra përballë lagjes Kasaj të fshatit, që quhet “Borda” nga banorët vendas), në Steblevë (në formën Vetarno Bordo), në Rekë (Velebordo) dhe në Vollnisht (Ternino Nebordo) (fq.22). Gjithashtu autori, në pjesën e parë të kësaj vepre na njeh me traditat e shkëmbimit dhe mjeshtëritë, me njeshtrit duarartë të Gollobordës, me kostumet tradicionale të grave të kësaj krahine si dhe me ritet në dasmat, gëzimet dhe përcjelljet njerëzore.

STUDIMI ME BAZA SHKENCORE

Pjesa e dytë e librit si zanafilla e studimit na sjell në vëmendjen e lexuesit e sidomos të studjuesve *Vajtimet e Gollobordës*, ndërkohë që më

pas në artikullin “Trazim kulturash” nguron ta japë përgjigjen shpejt dhe përciptazi. Kjo sipas tij për faktin se, studimi duhet të kalojë së pari në të gjitha pikat ku ravijëzohen ritet familjare, lindja, dasma, lamtumira, mbyllja e rrethit të jetës njerëzore, të gjitha ato që bëhen momentet më të rëndësishme në tërësinë e një treve, ato që shënojnë tranzicionet e saj kulturore më të rëndësishme.

Interes paraqesin për lexuesin edhe ato çfarë shkruan autori për vllahët dhe “jevgjit” e Gollobordës. Mendoj se impresiuuese është pjesa e tretë dhe më e rëndësishme e veprës mbi “Toponimet si Qasje Etimologjike”. Bazuar në toponiminë si kërkim shkencor të emrave të vendeve, origjinës së tyre, kuptimeve, përdorimeve dhe tipifikimeve, prof. Terziu sjell fakte se si mjaft vende të krahinës së Gollobordës kanë marë emërtimet e tyre nga toponimet. Pa u zgjatur, për këtë mjafton të lexojmë artikujt e kësaj pjese të veprës me tituj mjaftë intrigues: “Vajtimi i kukuvajkave”; “Guri i lotit”; “Tre lisat”; “Dardha e bekuar”; “Zogu i jargavanit”; “Guri i Xhemos”; “Qershitë e Lamos”; “Raven” u ngjiz nga i Huaji”; “Radeç, toponimi që flet qartë”; “Kodra e Shutecit”; “Kраста’ emri që rrëfen”; “Arra budallaqë”; “Rebori”; “Smilen”; “Kallogjeri”; “Presllop”; “Dragalicë”; “Truku i Bellavodas”; “ etj. Ndërsa për Kështjellën e Trebishtit, ndër më të njohura e kësaj zone autori shkruan se: *“Një nga emrat më të lakuar prej kohësh, që ka ngjizur toponimin më befasues dhe më tipologjik të kësaj treve lidhet me toponimin ‘Gradishtë’, që do thotë qytezë. ‘Gradishtë’ quhet vendi në fshatin Trebisht Çelebi, për të cilin hamendësohet se kohë më herët e kanë cekur në shkrimet e tyre Dhimitër Frangu dhe Marin Barleti”*.

Vështrimin etnokulturor të autorit për zonën e Gollobordës e ndeshim në pjesën e 4-t të këtij libri “Ballkani përtej “njëjësit”. Këtu, veç të tjerash prof. Terziu na njeh me vallen pa ‘njëjës’ “Pajtushka”, me origjinën e këngës “72 ditë”, ku e gjithë kënga interpretohet kështu: *“Shtatëdhjetë e dy ditë/Ka një plagë në zemrën time/Nuk është plagë nga sëmundja/Tashmë është plagë dhe pikëllimi./Merre pushkën dhe më vrit mua/pastaj më thuaj se s’ të dua”*.

Në këtë vepër të rëndësishme shumë dimensionale (studimore, etnokulturore) autori argumenton edhe “Këngët si mesazh unik” si dhe Gollobordën si zonë shumëgjuhëshe.

Ndërkohë, duke u ndalur tek “Rregjistrimi i Tetorit 2020” lehtësisht

evidentojmë shqetësimin e autorit për kushtin bullgar në lidhje me marrjen e një date për negociatat nga Tirana që ka të bëjë plotësisht me të drejtat reale të pakicës kombëtare bullgare. Prof. Terziu, jo më kot sjell për lexuesin një artikull të plotë dhe të pandryshuar nga origjinali, thuajse jashtë procedurës së referencimit, të shkruar nga Prof. Dr. Spasse Tashev, me qëllim mosndërhyrjen në disa pika që mund të quhen të plotëkuptueshme në një situatë të tillë. Është fjala për problemin e mosgjetjes së „origjinës bullgare” për mjaft nga ata që aplikojnë për pasaportën e këtij shteti, në kushtet e sotme të komplikuar ekonomike, por që vetëm me këtë mundësi ata mund të lëvizin e të punësohen diku në vendet europiane. Dhe konkluzioni i autorit: *“Përgjigjja është mjaft kuptimplote, nëse nuk do të ishte kjo pasaportë, ata nuk do të kërkonin të ishin ndonjë lloj minoriteti”*. Siç shkrova në fillim, mjaft bindëse e bëjnë veprën e Terziut referencat nga arkivat britanike, të sintetsizuara në pjesën e 5-të *“Arkivat Britanike për Gollobordën”*.

TJETRI NË KËTË VEPËR TEJET DINJITOE

Kjo vepër tejet dinjitoze, me interes të veçantë për lexuesin, mbyllet me pjesën e 6-të *“Figurat dhe vlerat”*. Këtu autori na njeh me personalitete emërndritur në histori të kësaj zone. Ndërsa evidenton origjinën shqiptare të Qemal Ataturkut, Terziu shkruan për Kapitenin e Parë Qazim Kasa - Drejtuesi ushtarak i Prishtinës, për *“Piktorin e Popullit”* Nexhmedin Zajmin, sidhe piktorët tjerë si, Bajram Mata, Tahir Zeneli, Duro Ibrahim etj. *“... Lexoja kujtimet e Hasan Shahinajt, Dail Halilajt, Ibrahim Allës, Islam Ramës, Fatmir Selimit, Velo Cfarkut, Fidan Markut, Halil Hoxhës etj., dhe ndjehesha kryelartë, komentoja poezitë e dhjetra poetëve të Gollobordës dhe bëhesha letrar ndryshe, shikoja skulpturat e Hamza Halilit, Fitim Sulës, Bashkim Sadikut dhe përhumbesha në to, shikoja filmat dhe skenaret e Esat Musliut dhe s’kisha të ngopur, pastaj shkrimet e studimet e Hilmi Sadikut, Myqerem Tafaj, Ramazan Hoxhës, Besnik Ramës, Cfetan Maznikut, Kujtim Boriçit, Mehmet Hasanit, Kristaq Trajës..”*, shkruan autori (fq.145). Prof Terziu vlerëson gjithashtu veprën e Doktor Arif Hasanit - *“Qytetar Nderi i Dibrës”*, të këtij kirurgu duarartë që shpëtoi qindra jetë njerëzish.

KONKLUZIONI I KONKLuzionIT

Në pjesën e 7-të të librit janë konkluzionet e autorit. *“Të dhënat e mbledhura në punën në terren gjatë viteve dëshmojnë se njerëzit e kësaj treve shprehin lidhjen e tyre të origjinës në mënyra të ndryshme. Disa e sqarojnë me një fjali që përcaktohet sipas tyre me shprehjen “mije zborime bugarsko”, dhe disa të tjerë me një tjetër që bazohet tek “mije zborime nashincki, nashki”. E para shkon ndoshta më larg në vitet kur sundonte dhe dominonte kultura dhe gjuha bullgare në rajon, duke lënë kështu kuptimin e fjalisë së parë “ne flasim bullgarisht” dhe kuptimin e shprehjes së dytë “ne flasim gjuhën tonë, tonën”. Dhe kështu kur mbetet zgjidhja nga toponimet kjo e fundit flet më së miri në këtë pikë, po aq sa e para. Pra, hipoteza jonë se toponimet ndikuan në këtë bashkësi në mënyrë të ngjashme në përvojën e identitetit të tij të pakicës është vërtetuar e gabuar. Për të forcuar këtë përfundim, komuniteti i Gollobordës që nuk kanë të njëjtën fe si bullgarët dhe maqedonasit duhet të ekzaminohet”, -shkruan prof. Terziu.*

Ndërkohë ai sqaron lexuesin se puna kërkuese e këtij studimi është e një natyre skematike. Ai nuk pretendon se botimi është një përpjekje për të shterruar këtë temë, as nuk mendon „se kontrastet kulturore, sociale dhe historike të theksuara midis efektivitetit tjetër të madh kulturor të traditës Gollobordës janë të gjitha aq sa absolutja e dukurive kulturo-sociale është ekstremisht komplekse, dhe larmia e faktorëve që i përcaktojnë ato shkaktajnë që ato të ndryshojnë shumë gjatë zhvillimit të tyre, nganjëherë ndryshimet i bëjnë ato të duken plotësisht të kundërta. Sidoqoftë, në thelb kontrastet që kam theksuar ekzistojnë. Idetë e përshkruara në këtë punë dhe faktet mbi të cilat ato bazohen mund të mbështeten nga një dokumentim i plotë dhe sistematik në shënimet e mbajtura nga rrëfimet, por duke pasur parasysh natyrën e punës kam preferuar të shtoj disa elementë plotësues. Ata merren me një temë themelore të tyre, por mbajnë disa aspekte themelore të pikës së parë të Gollobordës dhe do t’u interesojnë lexuesve që kujdesen të hyjnë më thellë në këtë temë”. Parë në një këndvështrim të përgjithshëm, Prof. Dr. Fatmir Terziu trajton gjerësisht në këtë vepër madhore fenomenin shoqëror të transkulturimit dhe rëndësinë e tij në Gollobordë.

Të „ripërtypësh“ qetësisht tezat e guximshme që hedh Fatmir Terziu në librin e vet mbi Gollobordën, këtë krahinë me tradita historike në vetë ekzistencën kombëtare shqiptare, duhet që librin to lexosh dhe rilexosh,

sepse ka shumë kuptime mes rreshtave. Sikurse thamë më sipër pa marrë të mirëqënë faktin që Terziu i thotë gjitha në këtë vepër studimore në „tezat e një doktorature“ universitare, autori hap për diskutim akademik një çështje të mprehtë shqiptare: kush jemi dhe cila është pjesa jonë më ekzistenciale. Shqipëria duke qënë „kërthizë“ e gadishullit më të trazuar të kontinentit europian, natyrisht ka shumë për të thënë dhe sqaruar duke konfirmuar devizën se autoktonia shqiptare jo vetëm që nuk diskutohet, por studime të mëtejshme do të kristalizojnë të vërtetën e „turbulluar nga koha“. Studimi i Fatmir Terziut nga Londra është një sfidë e hapur ndaj vetë Akademisë Shqiptare, që në monotoninë e vet përgjumëse ende nuk është kthyer ende në „gardën kombëtare“ të mbrojtjes me „zjarr akademik“ dhe të vërtetave gjitëshqiptare që shpesh mbulohen nga mashtrime ulëritëse nga fqinjët tanë.

Autori meriton përgëzime jo vetëm për guximin hulumtues, por edhe për dritën që hedh mbi një krahinë të harruar dhe nënvleftësuar nga regjimet dhe admnsitratat qëndore shqiptare. Në fund të fundit Shqipëria është një dhe mbetet një unison ballkanik me vitalitet që po testohet sërish në kohë lirie.

FAKTE DHE NGJARJE HISTORIKE TË SHKRUARA ME DASHURI NJERËZORE NGA SAKIP CAMI

*Për librin “NGJARJE DHE FIGURA TË SHQUARA HISTORIKE TË
KOMUNITETIT TË BASHKISË SË BULQIZËS“ (1839 – 1939)*



Në harkun kohor të dy dekadave, poeti, publicisti dhe studjuesi i mirënjohur Sakip Cami, ka bërë një hop cilësor dhe produktiv, duke i dhuruar lexuesit më shumë se 15 libra të botuar, vëllime me poezi, monografi letrare, profile e studime.

Libri i tij “NGJARJE DHE FIGURA TË SHQUARA HISTORIKE TË KOMUNITETIT TË BASHKISË SË BULQIZËS“ (1839 – 1939), përbën një kontribut real, të konkretizuar në një vepër shkencore të një niveli shumë të lartë.

Ndonëse përmbledh studime historike të një shekulli luftrash e përpjekjesh madhore të shqiptarëve për liri e pavarësi kombëtare, ngjarjet dhe protagonistët vijnë me realizëm objektiv. Autori, pas një studimi skrupuloz dhe ballafaqimi të mirëfilltë shkencor të fakteve, sjell risi në historinë e Heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, duke hedhur dritë edhe mbi personalitetet dhe ngjarjet legjendare skënderbegiane. Parë nga ky këndvështrim ia vlen të evidentohen përpjekjet e autorit për të përveçuar legjendat dhe paragjykimet. Dhe këtë e bën mbështetur në fakte mbi

qëndresën e paepur të kryetrimave të një treve lavdiplote siç është Bulqiza, Zerqani, Gryka e Vogël e Gryka e Madhe, por edhe Golloborda. Kemi kësisoj një libër të një lloji të veçantë me lëndë e material shumë interesant dhe tepër argumentativ mbi vendluftimet e ushtrisë së Skënderbeut, si Vajkali, Valikardha, Gjorica etj, por edhe toponime që flasin shumë për rezistencën e popullsisë së kësaj zone ndaj pushtuesve osmanë turq.

Kështu, autori hedh dritë për “Luftimet e Skënderbeut në zonën e Bulqizës dhe të Gollobordës”, duke përshkruar me një gjuhë të pasur dhe argumentuese, gjurmët e sheshbetejave si: Gurët e Skënderbut, Betejën e Valikardhës, SOFRA E SKËNDERBEUT, VENDKOMANDA E LUFTËS, fortesën e Modriçit, Kalanë e Maçadit, ku është zhvilluar edhe beteja e Maçadit në qershor të vitit 1465 kundër forcave turke të komanduara nga Ballaban Pasha, etj.

Si mjeshtër i përshkrimit dhe profilit, S.Cami sjell me freskinë dhe origjinalitetin e duhur personazhe të njohur e të panjohur të një kohe të largët, si: ZAHARIA GROPA, NGA GRYKA E MADHE, PRINC I OHRIT DHE KONTI VLLADAN GJURICA, PRINCI I ÇERMENIKËS, - DY BASHKËLUFTËTARËT MË BESNIKË TË SKËNDERBEUT. Ndërsa në aspektin gjeografik dhe zakonor, gjejmë në këtë libër një diapazon më të gjerë, si tek: “ÇIDHËN E GRYKË E VOGËL, VËLLA ME SHKODËR”, “HEROIZMI MASIV DIBRAN NE LUFTEN KUNDER TURQVE TE KOMANDUAR NGA HAJREDIN PASHA, KORRIK 1844” (sipas variantit të vjetër të këngës kushtuar luftës kundër Hajredin Pashës) apo dhe te: “Mustafa SHEH ZERQANI, LIDERI KRYESOR I LUFTËTARËVE DIBRANË NË LUFTËN KUNDËR HAJREDIN PASHËS”.

Duke ecur në të njejtën linjë, autori sjell fakte dhe ngjarje historike, të shkruara me dashuri njerëzore, edhe në profilet e Lam Dacit, madhështia e të cilit del qoftë dhe nëpërmjet vargjeve: “Lum kjo kulla ç’ish ka mrena/ Ka Lam Dacin me shtatë zemra...”apo te figurat e patriotëve të shquar Sheh Fejzë Bulqiza, Dalip Karaj, Mehmet Duriçi - embleme e mençurisë dhe trimërisë dibrane, Salë Markja etj.

Nëpër tymin e zjarrin e luftimeve dhe përmes fakteve të personazheve - heronj të këtij libri, gjejmë gjithashtu bëmat dhe heroizmin e “Hoxhë Hasan Moglicës, këtij kleriku dhe luftëtari të shquar për lirinë dhe gjuhën shqipe, si dhe të Elez Koçit nga Ostreni...

Dashuria është ai motiv që ka rrokullisur njëra pas tjetrës këto figura interesante në faqe të tëra të këtij libri, duke i dhënë atij një dimension të veçantë.

Shumë emra, shumë vende dhe histori, shumë dashuri dhe mirënjohje sjell autori Cami brenda faqeve të këtij libri, duke personifikuar njerëz të mençur, trima, patriotë, luftëtarë e intelektualë të Dibrës martire. Ato vijnë e ulen pranë nesh përmes faqeve të këtij libri, të rrethuar me trimëri nga jehona e kohërave, të thjeshtë deri në madhështi.

Ndërsa te “KLUBI ATDHETAR «BASHKIMI» I DIBRËS SË MADHE DHE ROLI I TIJ PER PERHAPJEN E ARSIMIT SHQIP DHE PER PAVARESINE E VENDIT”, autori flet për patriotë me vlera të mëdha kombëtare për përhapjen e mësimit shqip ashtu si dhe për luftëtarë të shquar kundër pushtuesve turq, serbë dhe bullgarë.

Duke konsideruar monografitë e shkurtra letrare të përfshira në librin “NGJARJE DHE FIGURA TË SHQUARA HISTORIKE TË KOMUNITETIT TË BASHKISË SË BULQIZËS“ (1839 – 1939), mund të konkludojmë se S.Cami sjell për lexuesin dhe veçanërisht për studjuesit e historisë një përmbledhje të shkurtër të historisë së kombit shqiptar nga njëra prej trevave më me emër. Për vetë lëndën e pasur dhe larminë e figurave e personazheve, mund ta konsiderojmë këtë libër edhe si një prej enciklopedive prestigjioze në shërbim të studjuesve. Kjo për faktin se Sakip Cami sjell një seri faktesh historike, korrespondencash diplomatike dhe mendimet e tij rreth ngjarjeve e personazheve të kësaj treve. Dhe këto ai i sjell nëpërmjet shumë fakteve dhe dokumentave historike të kohrave dhe burimeve të ndryshme. Dhe nëse në libra të tjera të S.Camit gjejmë poezi brilante që ai ua kushton këtyre ngjarjeve e figurave historike, edhe në këto monografi, portrete e refleksione ai dëshmon se poezinë e ka në shpirt dhe e bart kudo me vete. Ai bart në krijimtarinë e tij diçka origjinale. Ashtu si Gjorica, vendlindja e tij në prehër të Maleve, përmes së cilës kalon Drini, edhe ai si krijues lëvron dy fusha të krijimtarisë artistike: poezinë, me të cilën ka krijuar tashmë profilin e tij të spikatur si dhe studimet historike, një dyzim i natyrshëm ky për një shkrimtar por edhe një bashkëjetesë jo e lehtë. Gjithsesi, edhe me këtë botim dinjitoz, ai është dhe mbetet poet pavarësisht se balanca e botimeve anon nga studimet, prej të cilave, edhe si ish-ushtarak i talentuar njihet tashmë si një zë i njohur i fushës.

HYSEN DERVISHI PËR “LUFTËTARIN E LIRISË” BRAHMAN DERVISHI

Atdhédashuria, si lajtmotiv, edhe në gjashtë librat e tij të mëparshëm


Rrahman Avdi Dervishi vjen në këtë libër i skalitur me vijat e një portreti që për disa studjues dibranë, nuk ishte i panjohur, por jo i studiuar sa duhet, ashtu siç e meritonte, sepse ai ishte mjaft ndikues në rrjedhën e ngjarjeve, në të cilat kishte qenë ose inicues, ose inspirues, ose të dyja bashkë

Në vitin të jubileut të lavdishëm të 80-vjetorit të çlirimit të atdhetut nga okupatori nazifashist, evidentimi i luftëtarëve të lirisë (të të gjitha kohërave), u konsiderua si shërbimi më i mirë që i bëhet historisë sonë kombëtare.

Në këtë kuadër, shkrimtari tashmë i mirënjohur Hysen Dervishi, është një nga kontributorët shembullorë, vepra e të cilit mund t'i shërbejë (dhe duhet të konsiderohet) nga Komisioni i rishkrimit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave.

Libri i 7-të, i këtij autori, me titullin sinjifikativ “LUFTËTARI I LIRISË” është një prurje interesante në fondin e letërsisë sonë dokumentare. Ndonëse në epiqendër të kësaj monografie është luftëtari dhe patrioti dibran Rrahman Avdi Dervishi, në tërësinë e saj gëlon historia e Dibrës, e shkruar përmes pushkës dhe mendjes së hollë, të cilat, siç shkruan autori në hyrje të librit, e veçojnë atë prej krahinave të tjera, si një zonë me tradita të veçanta.

Atdhédashuria, si lajtmotiv i Hysen Dervishit edhe në gjashtë librat e tij



të mëparshëm, (të botuar dhe promovuar bujshëm në harkun kohor të dy dekadave të fundit): “Krenaria”; “Dibra – zemra e kombit”, “Përmbledhje me poezi”, “Vjeshtë e përgjakur”, “Nostalgjia e vendlindjes” dhe në poemën homerike “Dibra – Zani i Shqipës”, tek “Luftëtari i lirisë”, vjen në përmasat biblike të kësaj vepre. Kjo për faktin se ajo e njeh lexuesin me “atdhetarë të shquar që u rritën dhe u kalitën me ndjenjat e patriotizmit përmes të famshmes ‘Oda e Dibrës’, e cila kaliti burra me nam e lavdi të madhe, si Elez Isufi, Suf Xhelili, Vehbi Dibra, Ismail Pasha, Seit Najdeni, Dine Hoxha, Llan Kaloshi, Mersim Dema, Sheh Mustafa, Sheh Sula, Iljas Pasha, Isuf Murrja, Cen Leka, Cen Daci, Mahmud Daci, Ramis Daci, Halil Daçi, Asllan Kaziu, Murat Kaloshi, Tush Lleshi, Sali Markja, Sal Demiri, Dan Cami, Shaban Cami, Hoxhë Buci, Avdi Dervishi, Lam Bruçi, Asllan Bushi, Shar Topalli, Bajram Hasa, Hoxhë Bodini, Shaban Xhaferri, Has Kalia, Ahmet Perhati, Jashar Lela, Llan Elezi, Mal Llani, Lik Abazi, Kurt Ag Kadiu, Zenel Vata, Kros Vata, Ahmet Koka, Ahmet Begu, Haxhi Lleshi, Dali Ndreu, Ahmet Cami, Nikollë Kaçorri, Selim Rusi, Shaqir Jegeni, Baftjar Doda, Aqif Lleshi, Esat Ndreu e shumë burra të tjerë, të cilët nën ndikimin e vazhdimësisë heroike të kryegjeneralit dibran, Elez Isufi, rrokën pushkët dhe iu prinë dibramëve në disa luftëra, kuvende, kryengritje, duke u bërë preludi i fitoreve të njëpasnjëshme për çlirimin dhe ruajtjen e kufijve të shenjtë”. (fq. 5-6).

MONOGRAFI QË I NGJAN NJË ESSEJE TË GJATË HISTORIKE

Ndonëse në tërësinë e saj kjo monografi i ngjan një esseje të gjatë për kuvendet e Dibrës, kongreset e saj, ngjarjet e rëndësishme historike të zhvilluara në zona të ndryshme, në fokusin e autorit është luftëtari e patrioti Rahman Avdi Dervishi nga Lukani i Katër Grykëve të Dibrës.

Referuar gjeografisë historike si disiplinë fundamentale shkencore, Hysen Dervishi e trajton këtë personalitet dibran të integruar me faktorët kompleks dhe ngjarjet historike që ndikuan në formin e tij atdhetar e patriotik. Sepse ai i përket fisit Dervishi të Lukanit që gjithnjë është shquar për trimëri, besë, urtësi e mençuri, i përket njërës prej familjeve të këtij fisi të trashëguar nga breza që e provuan veten në beteja të përgjakshme dhe nuk u dorëzuan, nuk u gjunjësuan. Në formimin e tij, pa dyshim që ka ndikuar i jati, Avdi Dervishi, i cili sëbashku me dy vëllezërit, Selmanin dhe

Hysenin, e dhanë jetën për kombin dhe atdheun e shtrenjtë që e deshën më shumë se gjithshka.

“Avdi Dervishi u vra në Petrinë të Ohrit, duke lënë pas tij kullën historike, prej së cilës u renditën brezat e tjerë të revolucioneve popullore, dhe gruan e tij Mihanen, bija e Nuzajve të Shlliut dhe mbesa e Kokës në Macukull, bashkë me tre djemtë e tij Mehmetin, Rrahmanin dhe Seitin”, shkruan autori në këtë libër. (fq.62). Dhe jo pa qëllim veçon djalin e dytë të Avdiut, Rrahman Dervishin, i cili lindi në vitin 1908 dhe ishte vetëm 5 vjeç kur i vdiq babai nga pesë plagë të marra në tetor 1913 në betejën e famshme të Petrinës. Rrahmani do të burrërohej para kohe i frymëzuar jo vetëm nga vepra heroike e babait, por edhe nga gratë trimëresha të Dervishajve që: “së bashku me fëmijët e vegjël në shalën e kalit, morën rrugën e sprovës së madhe për në Prizren, ku prodhimi ishte si askund tjetër”. (fq. 65)

Libri monografik “Luftëtari i lirisë” i autorit Hysen Dervishi është shprehje më e mirë e ndëveprimit të kauzave patriotike të Rrahman Dervishit, me të cilat lidhet jo vetëm një pjesë e madhe e veprimtarisë së tij atdhetare, por edhe fati i jetës me atë të atdheut. Nga ky libër mësojmë se si luftëtari e patrioti dibran Rrahman Avdi Dervishi mbindërtoi gjithë formimin e tij intelektual e patriotik. Mbështetur në kauzën e lirisë.

SINTEZË TË DHËNASH E DËSHMISH MBI NJË PERSONALITET TË VEÇANTË

Libri monografik “Luftëtari i lirisë” është një sintezë të dhënash e dëshmish mbi një personalitet sa të veçantë, aq edhe kompleks, sa origjinal aq edhe kreativ, për nga natyra dhe energjia vepruese në rrethana e kohë të ndryshme. Rrahman Avdi Dervishi vjen në këtë libër i skalitur me vijat e një portreti që për disa studjues dibranë, nuk ishte i panjohur, por jo i studiuar sa duhet, ashtu siç e meritonte, sepse ai ishte mjaft ndikues në rrjedhën e ngjarjeve, në të cilat kishte qenë ose inicues, ose inspirues, ose të dyja bashkë.

Këtu nuk mungojnë të gjitha “stacionet” jetësore nëpër të cilat kishte kaluar Rr.Dervishi, që nga lindja më 1908 në fshatin Lukan e në vijimësi kur: “...në vitin 1920, ndonëse shumë i ri, u përball me betejat e burrërisë shqiptare kundër fashizmit Italian, duke parë me sytë e vet heroizmin e

vlonjatëve, por edhe të burrave të Dibrës, si Lam Bruçi me shokët e vet, i cili u hodh i pari në llogoret e betejës dhe u plagos e lau me gjak ato telat me gjemba të heroit të Vlorës Selam Musai...”

Autori ka ndjekur hap pas hapi rrugëtimin e Rrahman Dervishit në kohë e hapësirë, duke filluar nga rinia e hershme e tij e deri në momentet e fundit të jetës (vdiq me 11.3.1981). Në këtë ecejake të gjatë, lexuesi arrin të shoh si në një shirit filmi zhvillimin dhe formimin e një personaliteti, i cili gjatë rrugëtimit jetësor do të bëhej protagonist i ngjarjeve historike. Kështu “Njësi i parë partizan i Dibrës, i formuar në shtëpinë e Rrahman Avdi Dervishit në Lukan, nën udhëheqjen personale të Haxhi Lleshit, luajti një rol tepër të rëndësishëm në zgjimin dhe mobilizimin e popullit në luftën partizane”. (fq. 111).

Gjithësesi, profili jetësor i Rrahman Dervishit do të dilte i paplotë nëse autori nuk do të evidentonte besnikërinë e tij ndaj idealeve antifashite dhe patriotike, duke u rreshtuar në Çetën e Dibrës dhe më vonë në batalionin partizan, si pjesëmarrës në shumë luftime, duke mbetur përgjithnjë një figurë luftarake historike, besnike e çeshtjes kombëtare, që nga janai 1941 deri në nëntor 1944, kur u çlirua Shqipëria.

Nga ky libër mësojmë për veprimtarinë e tij të shtrirë në një hark të gjerë kohor, me një shtrirje të gjërë territoriale dhe një rrjet bashkëpunëtorësh, si përgjigje ndaj sfidave të kohës që veproi. Autori Hysen Dervishi e prezanton si të tillë këtë personazh historik edhe në vitet e pas çlirimit, kur Rrahmanii iu besuan dhe kreu me devotshmëri detyra shtetërore dhe shoqërore. Ai evidenton kontributin e Rrahman Dervishit për atdheun, vendlindjen, shoqërinë dhe familjen, zgjuarsinë e tij natyrale dhe vizionin për të ardhmen. E veçanata e këtij libri monografik është se autori, krahas portretizimit sa më besnik të figurës së Rrahman Dervishit, ka sjellur edhe një vështrim panoramik të historisë së krahinës prej nga vjen ai, Lukani i katër Grykëve të Dibrës, duke ofruar të dhëna të vlefshme trugut të tij familjar. Si i tillë, ky libër monografik, përveç që plotëson një boshllëk në tërësinë e informacioneve tona, ai i shërben edhe qëllimit të rishkrimit me vërtetësi të historisë, (ri)vlerësimit të personaliteteve të saj, process ky që i shërben kompletimit dhe sistemimit të të dhënave arkivore dhe vendosjen e tyre në një rrafsh studimi të paanshëm.

PAK RADHË PËR AUTORIN HYSEN DERVISHI

Referuar vlerësimet të analistit dhe poetit të mirënjohur Dukagjin Hata, shkrimtari Hysen Dervishi, edhe me këtë libër, vjen si një nga kërkuesit më të pasionuar të psikologjisë dhe shpirtit dibran, duke iu drejtuar vetëdijes kolektive të një populli me rrënjë të ngulura thellë në histori, i cili e shkroi sagën e fiseve krenare e të panështruara ndaj të huajve, në lëvoren e pemës vigane të kujtesës sonë. Me shtatë librat e tij ai zë vend të dinjitetshëm në fondin e artë të letërsisë shqipe. Kjo për faktin se firmën e Hysen Dervishit mbajnë monografi e poezi, portrete e analiza ku lëvrijnë ngjarje e personazhe të historisë sonë kombëtare. Ai ngre në pedestalin që meritojnë, jo vetëm personalitetet dibrane me rrezatim mbarëkombëtar në histori, që nga Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu, origjinën dibrane të të cilit të mirëargumentuar nga shkrimtari Fatos Daci – Mjeshtër i Madh, më së fundi e deklaruan edhe autoritete zyrtare turke, Qemal Ataturku – strategu i madh i revolucionit xhonturk me origjinë nga Koxhaxhiku i Dibrës; Nikollë Kaçorri nga Krej Lura e Dibrës, filozof dhe politikan me prirje përparimtare – nënkryetar i qeverisë së Ismail Qemalit; Iljaz Pashë Dibra – Kryetar i Lidhjes shqiptare të Prizrenit, Dine Hoxha i Muhurrit të Dibrës, politikan dhe diplomat i shquar, këshilltar i Mbretit Zog dhe prijës e udhëheqës i kryengritjeve popullore kundra serbëve..., por edhe elitën krijuese dibrane me përfaqësues dinjitozë si Haki Stërmilli, Hazis Ndreu – Nderi i Kombit; Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, Ahmet Prençi, ndër poetët e prozatorët dibranë, krijimtaria e të cilit vlerësohet krahas më të mirëve personalitete të letrave shqipe, ashtu si edhe akademik Shaban Sinani, Xhafer Martini, Agron Tufa e dhjetra te tjerë, që në fushën e letrave, artit e kulturës u lënë trashëgim brezave krijimtari letrare kaq shumë të vlerësuar.

“TOPONIMIA E ÇIDHNËS”, NJË BOTIM ME VLERA TË RRALLA SHKENCORE

Vepra e Haki Përnezha e Rruzhdhi Bitrit ka një mënyrë të konceptuari e shtjelluari mjaft të rrallë, brilante


Botimet “M&B”, pas suksesit të padiskutueshëm në Panairin e Librit 2016, prezantuan më 25 Nëntor 2016, në sallën e Akademisë së Shkencave në Tiranë librin “Toponimia e Çidhnës” (me 110 ilustrime fotografike dhe me një fjalës të leksikut të rrallë), të bashkëautorëve Haki Përnezha e Rruzhdhi Bitri.

Për vlerat e rralla shkencore të këtij botimi folën: poeti dhe prozatori i mirënjohur Agron Tufa, Prof. Gjovalin Shkurtaj, Prof.Dr. Shaban Sinani, si dhe studjuesit Ali Hoxha, Besim Cengu e Mustafa Tola.

Përveç studimit të thelluar e skurpuloz, për besueshmërinë e këtij botimi flasin qoftë dhe 328 referencat e përdorura nga bashkautorët, ku spikasin ato të Prof.E.Çabej, Mjeshtrit të Madh, Hazis Ndreu, studiuesit Iljaz Kaca, apo dhe të Giussepe Valentini (E Drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare).

Në përpjekjet për të sjellë aromën e vendlindjes së tyre, H.Përnezha dhe Rr.Bitri hyjnë në analet e historisë së letrave me një botim të rrallë. Pa hyrë në një analizë të thellë të këtij botimi tejet dinjitoz, në këto pak radhë unë dua të shpreh vlerësimin për kontributin e tyre në kërkimet shkencore.

Një sipërmarrje të tillë të vështirë mund ta quajmë pa mëdyshje të suksesshme dhe merita për këtë u takon dy bashkautorëve, por edhe



redaktorit potencial, akademik Shaban Sinanit, si dhe botuesit M&B (Miranda e Bujar Karoshi).

Larmia e studimeve të paraqitura në këtë libër janë dhe një nga arsyet e suksesit të botimit, i cili është i një cilësie shumë të mirë, i denjë për të nderuar dy studiues të shquar, botuesin dhe redaktorin. Në këto studime, pa mëdyshje shquhen ato mbi fshtarat Sinë e Epër e Sinë e Poshtme, Çidhën e Poshtme, Grykë Nokë, Mustafe, Zall dhe Kodër Leshe, Fushë Alie, Laçes, Çelias, Blliçe, Rrenx, Kastriot, Brest i Epër e Brest i Poshtëm.

Natyrisht, lexuesi shqiptar, bazuar në këto studime merr një informacion relativisht të pasur për këtë trevë të njohur që nga lashtësia. Vepra e H.Përnehës e Rr.Bitrit ndërkaq ka një mënyrë të konceptuari e shtjelluari mjaft të rrallë, brilante. Meritë e padiskutueshme e këtyre autorëve, krahas njohurive që zotërojnë për vendlindjen e tyre, është padyshim shfletimi dhe studimi në origjinal i një bibliografie mjaft të pasur.

Më së miri e vlerëson librin e tyre redaktori Sh.Sinani, i cili evidenton 100 fotot ilustruese dhe një burim të fjalës së rrallë e në zhdukje, që së bashku me frazeologjinë që lidhet me to, është një provë burimore dhe shkencore e rëndësisë kulturore e historike të emërtimeve vendore.

“I shkruar pas një vëzhgimi kërkimor prej shumë vitesh, prej dy njerëzish që janë edhe vetë subjekt i kërkimit; me një vëmendje diturore të kthyer në qëllim prej dekadash më parë, “Toponimia e Çidhnës”, – thekson akademiku Sinani – është një regestum i emërtimeve të përveçme të kësaj krahine etnografike, një hipotekë e kësaj pasurie shpirtërore, e cila për fat tashmë ka zot, dhe ky zot është folësi shqiptar i atyre anëve, bartës brez pas brezi i saj, një bartës sa krijues aq dhe ruajtës, sa pragmatik, aq dhe sintagmatik, sa figurativ aq dhe përdorues”.

Sipas Prof.Sh.Sinanit “Në librin e këtyre dy autorëve janë ndërthurur meritat e mbledhësit, tejshkruesit dhe të studiuesit. Aty janë bashkë edhe filologu, edhe dialektologu, edhe antropologu e historiani. Libri i tyre është një arritje etnoghjësore, në të cilën fjala dhe bartësi i saj nuk ndahen”. Madje sipas akademikut të mirënjohur “Toponimia e Çidhnës” dëshmon mbi të gjitha se populli i këtyre anëve nuk ka jetuar si popull malesh, si barinj shtegtarë, sikurse shkruhet edhe sot në disa botime enciklopedike, por ka ditur të jetojë dhe madje ka jetuar mirë.”

FAISI BRUÇI I LUKANIT TË DIBRËS

Një monografi shumëvlerëshe e autorit Faik Bruçi, për historinë e fisit e të fshatit që pati dhjetra luftëtarë në luftën për çlirimin e Shkodrës



Në historinë e zhvillimeve epokale botërore dhe lokale, fiset e mëdha identifikohen me emrat e personaliteteve që ata kanë nxjerrë në kohëra e rrethana të ndryshme. Kështu ka ndodhur edhe me fisin Bruçi të Lukanit të Dibrës, për historinë e lavdishme të të cilit është shkruar dhe botuar një monografi interesante nga studiuesi dhe sipërmarrësi i mirënjohur Faik Bruçi. Nëse Muhurri, njëri nga Nandë Malet e Dibrës identifikohet me emrin e filozofit popullor Dine Hoxha, një nga këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog i I-rë, emër ky i përjetësuar në xhaminë e Rrugës së Kavajës në Tiranë, (financuar prej tij në vitin 1930), Lukani i Katër Grykëve të Dibrës, i njohur për prijësit e mendimtarët Hoxhë Buci e Lam Tahiri (Bruçi), në kohët e sotme moderne identifikohet edhe me një emër mjaft të njohur në metropolin shqiptar.

Ky është Faik Bruçi, ndër sipërmërrësit më të suksesshëm (pronar i “Capital Tirana Hotel” tek Pazari i ri i Tiranës, fare pranë selisë së Prokurorisë së Përgjithshme), promovues i vlerave atdhetare, historike dhe kombëtare. Në këtë kontekst, treguesi më i qartë është botimi me autorësinë e tij i librit “Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës”, (monografi) një botim special me 230 faqe.

Ky botim shkencor i Faik Bruçit dëshmon për arritjen e një niveli të lartë në artin e të shkruarit. Kjo për faktin se Faiku, ashtu si në çështje të sipërmarrjes, edhe në këtë libër dëshmon se din të përveçojë me inteligjencë, fakte dhe ngjarje, si pjesë substanciale e karakterit të personazheve, duke e bërë librin e tij me vlera njohëse, edukuese dhe estetike.

PAK NGA VËSHTRIMI GJEORAFIK E HISTORIK I LUKANIT ME HISTORI TË LAVDISHME

Në morinë e detajeve dhe fakteve interesante nga historia e vendlindjes së tij, F. Bruçi e bën ndalesën e parë tek vështrimi gjeografik e historik i Lukanit me histori të lavdishme.

Kështu, nëse përcakton saktë pozicionin gjeografik të fshatit në zemër të maleve që kufizohet: në veri me Lurën, në lindje me Muhurrin, në jug me Selishtën dhe Kacninë, në Perëndim me Qafë Murrën, (ndërsa ka si mburojë Runjën hijerëndë e kreshnike, 2048 metra mbi nivelin e detit), po aq bindës është edhe në vështrimin etimologjik për emërtimin e fshatit Lukan, që vjen nga fjala “lug” - luginë, dhe që në gjuhën dibrane shqiptohet “luk”. Pra, nga fjala “luk” erdhi emri i fshatit Lukan. Për këtë autori i kësaj monografie i referohet periudhës historike të shekullit XV. Por kjo sipas tij nuk do të thotë se Lukani nuk ka prejardhje më të herëshme, siç kanë shkruar dhe lënë dorëshkrime historianët Hysen Lala e Bajram Totraku.

Parë nga ky këndvështrim, Faik Bruçi argumenton se edhe në aspektin ushtarak Lukani është katundi më strategjik i Katër Grykëve - një nga Nandë Malet e Dibrës që luftoi dhe nuk u mposht në lufta me pushtuesit turq, serbë, austriakë etj (Mal në Dibër dhe bajrak në Mat).

Në këtë mori faktesh, meritë e autorit është përshkrimi në pak rreshta i prejardhjes së herëshme të fisit BRUÇI, nga Dardania-Kosova e sotme.

“Kjo prejardhje është treguar gojarisht brez pas brezi deri në ditët e sotme. Përmes faktesh bindëse për ekzistencën prej 250 vjetësh të fisit Bruçi

në Lukan të Katër Grykëve të Dibrës, Faik Bruçi ndër të tjera shkruan se: “Burime të herëshme gojore tregojnë se fisi Bruçi ka ardhur nga Kosova, është vendosur në Shkodër, nga Shkodra në Domgjon e Fan të Mirditës. Stacioni i parafundit ka qenë Fushë Lura”. (fq.14).

KUVENDI I KULLAVE

Mjaft bukur shkruan autori i kësaj monografie për institucionin e kuvendit të kullave. Në Lukan nuk ka shtëpi, por kulla. Çdo shtëpi është një kullë, është një kala trimërie që ka brenda saj burra të mençur dhe trima të vendosur.

Në këto kulla të bekuara nga Zoti dhe të uruara nga Dede Bruçi, Hoxhë Bushi, Hoxhë Buci e Dede Ndregjoni kanë lindur, janë rritur e burrëruar qindra e mijëra djem petrita. (Djemtë dhe vajzat e tyre gjenden sot në disa vende të Europës, Amerikës, Kanadasë e Australisë, si sipërmarrës, mjekë e artistë me emër). “Në muret e këtyre kullave u varën qindra armë miqsh e trimash, bujtës nga Katër Grykët, Muhurri, Luznia, Lura, Dibra e Madhe, Mati, Kruja etj. Nga krismat e pushkëve të këtyre kullave u bekuan qindra dasma dhe lindje djemsh. Njerëzit ndër vite u dhanë jetë kullave dhe kullat ndër vite mbrojtën njerëzit. Në kullat e Katër Grykëve bujtën Abdyl Frashëri, Iljaz Pashë Dibra dhe udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Këtu mori jetë jeta jonë, rruga jonë”, - shkruan F.Bruçi në monografinë “FISI BRUÇI I LUKANIT”.

Në këtë libër, faqe pas faqeje hidhet dritë mbi luftimet e trimave të Lukanit e të krejt Katër Grykëve në betejat kundër turqve e serbëve, ndërkohë që mjaftë bukur autori e përshkruan Lukanin si strehë të njerëzve të shpërngulur nga raprezaljet serbe.

Kësisoj karakteret humanë shfaqen si shëmbëlltyra të përzgjedhura nga dora e një studjuesi të zellshëm dhe me talent, duke të bërë për vete me stilin e të shkruarit.

Dhe ajo që e bën të veçantë librin “FISI BRUÇI I LUKANIT, në raport me disa botime tjera në formë monografie apo enciklopedie për fshatra tjerë të Dibrës, është fakti se ai rrok brenda tij një periudhë të gjatë, gati një shekullorë, duke derdhur dashuri dhe mirënjohje për personazhe dominantë të historisë sonë kombëtare.

Kështu ai sjell për lexuesin profilin e Bajram Bucit, i njohur ndryshe si

Hoxhë Buci, i cili si njeri i zgjuar, i arsimuar dhe atdhetar ishte i pranishëm në të gjitha ngjarjet e mëdha historike që kaloi vendi ynë në vitet 1860-1913, veçanërisht si përfaqësues i Lukanit në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 10 qershor 1878. “Veprimtaria e Hoxhë Bucit është shumë e gjerë. Për të kanë shkruar historianët Kristo Frashëri, Kristaq Prifti, Selami Pulaha, Stefanaq Pollo, Bajram Xhafa etj. Për veprimtarinë e tij, përveçse në Arkivin Qëndror të Shtetit Shqiptar ka të dhëna e dokumenta edhe në arkivat e Turqisë, Austrisë etj”,-nënvizon autori F.Bruçi në këtë monografi kushtuar fisit të tij emërndritur në historinë tonë kombëtare.

Një tjetër personazh interesant i këtij libri është Islam Tahiri (Bruçi), simbol i zgjuarsisë dhe trimërisë dibrane. Duke e profilizuar si një njeri bashkëkohor, autori shkruan se: “Lami njihet si njeri i kohës, i muhabetit, me zgjuarsia natyrale dhe i zoti. Jetoj në periudhën e sundimit otoman, kohën e pushtimit serb, Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, në periudhën e regjimit komunist, dhe kurdoherë diti të orientohej drejt dhe të mbijetonte”. Më tej autori i kësaj monografie shkruan për Tofik Xhafer Bruçin që ishte lezeti i odës së burrave, i odës dibrane por dhe arkitekti i unitetit të fshatit, si dhe për Bajram Totrakun që ia ngiti lart emrin Lukanit dhe Katër Grykëve të Dibrës.

LAVDI BURRAVE TË LUKANIT QË LUFTUAN PËR ÇLIRIMIN E SHKODRËS

Një shembull frymëzues atdhedashurie janë 14 burrat e Lukanit, nga të cilët katër të fisit Bruçi, që shkruan faqe heroizmi në luftën legjendare për çlirimin e Shkodrës.

Gjatë rrethimit që iu bë nga 28 tetori 1912 deri më 23 prill 1913, në kuadrin e Luftës së Parë Ballkanike, prej forcave aleate të Malit të Zi dhe Serbisë kundër forcave të Perandorisë Osmane, Shkodra qëndroi e pamposhtur, falë edhe mbështetjes prej forcave rezerviste dibrane.

Studiuesi F.Bruçi, referuar dokumentave arkivore shkruan në këtë monografi se në luftën për çlirimin e Shkodrës, ndër 17 batalionet rezerviste të rezistencës, njëri ishte Batalioni i Dibrës. “Udhëheqësit kryesorë të forcave vullnetare të Katër Grykëve kanë qenë Hoxhë Buci dhe Smajl Nika. Lufta zgjati 6 muaj. Në këto luftime dhanë jetën 114 dibranë, midis tyre edhe disa luftëtarë nga Lukani dhe Katër Grykët”, shkruan F.Bruçi në këtë

monografi (fq.38). Madje sipas tij, Smajl Nika prej Qafë Murre, shpëtoi përveç flamurit (bajrakut) të Katër Grykëve edhe bajrakun e Lurës dhe të Matit. Gjithashtu në respekt të kontributit të të parëve të fisit e fshatit të tij të lindjes, ai rendit emrat e disa burrave të Lukanit që luftuan për çlirimin e Shkodrës, si: Hoxhë Buci; Islam Tahir Bruçi, Shaban Ali Bruçi; Xhafer Can Bruçi, Shaban Xhafer Dervishi; Ali Lik Dervishi; Selman Dervishi; Mustafa Buci; Sali Totraku; Llan Koka; Ibrahim Ndregjoni, Destan Ndregjoni, Zeqir Ndreka etj. Pjesë e kësaj monografie shumëvlerëshe është edhe kontributi i Dine Hoxhës e Llan Destan Ndregjonit në mobilizimin e trimave të Lukanit përballë qëllimeve shoviniste të Serbisë, si dhe mbështetja që Katërgrykasit i dhanë qeverisë së Arrasit më 1920. Këtë monografi e bëjnë tërheqëse kapitujt “Njerëz të thjeshtë që ja kushtuan jetën Lukanit”, “Nderim dhe respekt për luftëtarët dhe veteranët e Luftës së Dytë Botërore”, “Fisi Bruçi, fis me tradita të shquara bujarie”, sidhe artikujt: “Lukani, fshat arsimdashës”; “Përkrahës të kulturës dhe qytetërimit”, “Intelektualët e rinj”, “Plejadë burrash që siguruan mbijetesën e fshatit”, dhe “Bijtë e Lukanit, biznesmenë të fuqishëm në shkallë vendi”.

Brenda faqeve të kësaj monografie gjen plot emra të spikatur të fisit Bruçi e të gjithë fshatit Lukan të Dibrës që qëndrojnë me dinjitet në panteonin e vlerave.

FAIK BRUÇI, “MJESHTËR I MADH” DHE “NDERI I QARKU DIBËR”

Autori i kësaj monografie, Faik Bruçi është dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë “Mjeshtër i Madh” me motivacionin “Në vlerësim të kontributit të çmuar në ndërtimin e veprave hidroteknike në mbarë vendin. I dalluar si humanist dhe kontribues në dobi të bashkësisë dibrane dhe promovues i vlerave atdhetare, historike dhe kombëtare.” (Dekret Nr.11272, datë 12.09.2019). Po ashtu, Këshilli i Qarkut Dibër, me vendim Nr.5, datë 13 mars 2018, e ka nderuar Faik Bruçin me titullin më të lartë “Nderi i Qarkut Dibër”, me motivacionin: “Në vlerësim të veprimtarisë së tij, për mbështetjen financiare, në ruajtjen dhe promovimin e vlerave për historinë, artin, sportin dhe kulturën dibrane”. Këto tituj të lartë nderi janë vlerësim i kontributit të tij të dukshëm si një nga sipërmarrësit shqiptarë më të suksesshëm. Për shumë vite ai ka themeluar dhe drejtuar


Kompaninë “Bruçi” shpk, Kompaninë “Jon 2002” si dhe ka qenë aksioner i rëndësishëm dhe i suksesshëm në “Bankën Popullore”, Kompaninë e Sigurimeve “Albsig”, Hidrocentralin e Gjançit, Korçë dhe njëkohësisht sot është pronar i vetëm i “Capital Tirana Hotel”. Biznesi dhe aktiviteti i tij çdo vit ka njohur vetëm ngritje dhe suksese. Për këtë, kompanisë që ai drejton dhe personalitetit të tij angazhues, me aftësi të mira menaxhuese, i janë akorduar tituj dhe simbole vlerësuese nga institucione brenda dhe jashtë vendit tonë.

“KOHA KUR PO SHKRIHESHIN AKUJT” NË LIBRIN E KAMBER FARUKUT

- **Krimet e komunizmit meritojnë një monument kujtuese që të mos na përsëritet kurrë më e kaluara e Tonton-Makutëve enverianë**
- **“Jemi një shoqëri në zgjim. Ta bëjmë përtëritjen nga pesha e diktaturës me guxim. Misioni për të demaskuar deri në fund, me fakte diktaturën u takon trimave, atyre që nuk kanë frikë nga varret dhe hijet e së kaluarës. Të shërojmë njerëzit e gjymtuar, të shërojmë plagët. Të gjallët meritojnë respekt. Na takon ne që e nisëm, ta çojmë deri në fund demokratizimin dhe dekomunistizimin e vendit”**

Nëse do t'i përmbahemi vlerësimit që Kamber Faruku i bën gazetarit dhe shkrimtarit sovjetik Ilia Ehremburg, duke evidentuar gjuhën, stilin dhe përmbajtjen e reportazhit të tij “Si e njoha unë Amerikën”, botuar në 1947, një lexues i vëmendshëm, në të njejtin vlerësim do të arrinte edhe për librin e tij “Kur po shkriheshin akujt”.

Por, nëse Ehremburgu lejohej ta krahasonte SHBA-në me një njeri me trup gjigand, por me kokë të vogël, dhe të botonte një reportazh aq të drejtpërdrejtë dhe realist, Kamber Faruku, ndër gazetarët më kurajozë të kohës, do të haste vështirësi të panumërta në ushtrimin e profesionit, i ndodhur nën tryshninë e pothuajse gjithë nomenklaturës komuniste, përfshirë edhe ish-sekretarët e parë të komitetit të PPSH-së së Dibrës. Por gjithsesi, i vënë në sprovën e së vërtetës ai, falë inteligjencës së spikatur dhe



penës së tij të mprehtë arriti t’iu bëjë ball me dinjitet sfidave të asaj kohe skëterrë.

Libri i tij “Kur po shkriheshin akujt” në pjesën e parë “Shënime dollapi”, përmbledh përjetime dhe asosacione të ngjarjeve më kryesore që rrodhën vrullshëm gjatë vitit 1990, si pararendëse të legjitimitit të pluralizmit politik në Shqipëri.

Në këto ditare, përveç analizave të mirëargumentuara të zhvillimeve aktuale, ai bën retrospektivë nga e kaluara e largët për të sjellë në vëmendjen e lexuesit ato kohë kur në vendin tonë kishte pllakosuar skamja e varfëria e tejskajshme. Kështu ai e josh lexuesin të mësojë për ngjarje të kohës së luftës kundër nazifashizmit, kur “Kishte raste që në të njejtën shtëpi rrinin në kate të ndryshme armiqtë e njëri-tjetrit”. Në të njejtën linjë i trajton edhe ngjarjet e mëvonshme autori, kur sjell një rast nga Prodan, kur “vogëlushët nuk donin që ne të shihnim mjerimin që i kishte pllakosur”, ndërsa xha Ibrahimit, vëllait të Aliut që kishte shoqëruar E.Hoxhën në Prodan më 1943, i dukeshin brekushet e zeza, që kur hapeshin ishin të shpuara vrima-vrima. Në fokus të gazetarit të mirënjohur janë zhvillimet kobndjellëse të kohës së kolektivizimit të bujqësisë, kur fshatarët, pasi dorëzuan “vullnetarisht” tokën, sistemi i detyroi të dilnin ciplak në shi e në borë. Por dhe ajo e tufëzimit të bagëtive që e la fshatarin edhe pa një lugë shëllirë. Ka edhe mjaftë raste ku autori sjell shembuj konkretë se si organizatat bazë të partisë ishin shndërruar në fole të sundimit, thashethemeve, misticizmit dhe “paragjyqeve” politike..

Në këtë libër gjejmë sarkazmën e thellë të autorit për fshatarët që do t’u kërciste luga në sahan, si në rastin, kur ai i detyruar do të shkruante e botonte kronikën “Drejt Prrenjasis” (me shënimin e tij në ditar) “me t’u dhimsë vetja!”. Dhe po me këtë kurajë K.Faruku evidenton në librin e tij edhe gazetarë, të cilët iu drejtuan natyrës së llustrës për të marrë rrogën, duke sjellë shembullin e reportazhit “Qumështi i tufëzave”, botuar në “Zëri i Popullit” më 28 qershor 1986, ku gjenden përshkrime si te përralla e Andersenit “rrobat e reja të mbretit”. K. Faruku konkludon dhe argumenton se me shkrime të tilla gazetaria jonë e zhvilloi publicistikën me gjini të reja si “Kur e zeza bëhet e bardhë”, “Lexo e ngopu” apo “Hi syve”. Këto përfundime të publicistit, diplomatit e politikanit Kamber Faruku janë në koherencë me realitetin e sotëm, kur edhe 30 vjet pas këtij tranzicioni të

tejzgjatur, ka kalemxhinj që iu bëjnë ilustra pushtetarëve më të korruptuar e më të inkriminuar të rajonit të Ballkanit. K.Faruku, pasi analizon shkaqet që çuan në kolaps të plotë ekonominë shqiptare, ndër të tjera konkludon edhe për faktin se mendja e njerëzve, prej varfërisë së tejskajshme, ishte bërë si eshkë dhe merrte flakë urrejtje.

PORTRETIZIMET, TESTI I SAKTË I PROFESIONALIZMIT TË GAZETARIT

Libri “Kur po shkriheshin akujt”, ka ngjarje e fakte interesante nga pothuajse të gjitha zonat e Dibrës: Muhurri, Luznia, Katër Grykët, Lura, Reçi e Dardha, Kalaja e Dodës, Çidhna e Kastrioti, Sllova e Shumbati, Shupenza e Golloborda, Bulqiza etj. Përshkrimet brilante të bukurive natyrore, si dhe portretizimi gjer në detaje i ish - zyrtarëve të nomenklaturës komuniste, sidomos i ish- sekretarëve të komitetit të PPSH të rrethit Dibër, e bëjnë mjaftë tërheqës këtë libër. Pjesa e portretizimit të një gazetari natyrisht është testi i saktë i profesionalizmit të tij. Këtë ai e jep në mjaft personazhe të spikatur, të njohur e të panjohur shumë për publikun e gjërë dibran e jodibran. Është gjë e bukur se optika e tyre përfshin personalitete të kohrave, moshave e profesioneve të ndryshme si: Dine Hoxha, Tafe Kaziu, Ali Lika, Murat Kaloshi, Halit e Haxhi Lleshi, Sali Berisha, Azem Hajdari, Anton Çeta, Safet Zhulali, Mirush Mati, Arif Mata, Adrian Skuka, Besa Mera, Rexhep Hoxha, Lavdrim Shehu, Astrit Kuka e dhjetra të tjerë që të mbeten në mendje me detajet që ai ka dhënë për jetën dhe veprën e tyre (qofshin këta personazhë negativë apo pozitivë).

I drejtëprdrejtë është K.Faruku edhe në pjesën e dytë të librit, kur nuk nguron që nëpërmjet portretizimit të fytyrave të disa ish - eksponentëve të PD-së (viti 1991) bën profetin për ardhmërinë e tyre politike. Ja çfarë shkruan autori Faruku për një rast takimi me lidershipin demokrat në vitin 1991: “-Prisni te kjo zyra, do ta njoftoj Doktorin,-na tha një sekretare. Kur u futëm te zyra, aty ulur në një kënd, qëndronte Aleksandër Meksi.... Pasi e mësoi se kemi ardhur nga Dibra dhe duam të takojmë Doktorin, shkëmbeu dy-tri fjalë me Mirushin (Mati) dhe heshti, sikur nuk kishim se çfarë të flisnim më. Me një kostum të thjeshtë ngjyrë hiri të errët dhe me jelek klasik me cepa, me një kapele me strehë të rrasur në kokën e tij tullace me flokë të rrallë anash, me mustaqet si furçe teli dhe fytyrën shumë të

zeshkët, me trupin e shkurtër dhe të mbushur e rondokop, nuk e di pse, Meksi më ngjante me kallajxhinjtë, të cilët vinin në anët tona nga Përmeti dhe thërrisnin: Kallaisim bakra! Bakra për të kallaisur!”. Portretizime të tilla “të kripura”, K.Faruku bën edhe për të ndjerin Gramoz Pashko në rastin kur e kishin thirrur në një mbledhje qeverie si zëvendëskryetar i komitetit ekzekutiv pluralist të rrethit, për të dhënë llogari se pse Dibra nuk pranonte të zbatohet ligji famëkeq 7501 i ndarjes së tokës për frymë!

KUR GAZETARI VESH MANTELIN E HISTORIANIT

Sa shumë emra, sa shumë vende dhe histori, sa shumë negativitet dhe pozitivitet, dashuri dhe mirënjohje për to, ka derdhur autori, gazetari i mirënjohur, Kamber Faruku, brenda faqeve të këtij libri. Në një topografi dhe gjeografi që nga Bulqiza, Okshtuni, Klenja, Gjorica, dhe pse jo, gjer në Lurë e Kala të Dodës, Tiranë, Prrenjas e Laç.... Të rrethuar me trimëri nga jehona e kohërave, por të thjeshtë, të thjeshtë deri në madhështi vijnë e ulen pranë nesh, me fakte, me ngjarje, me jetët e tyre përmes faqeve të këtij libri.

Autori K.Faruku që provoi të jetë një publicist i sukseshshëm dhe tejet kompetent si redaktor i gazetës lokale “Ushtima e maleve” për gati 15 vjet, me shkrime nëpër gazetatat e ndryshme të vendit, me këtë libër, ai pa frikë ka veshur edhe mantelin e historianit. Vetë libri, në pjesën më të madhe të tij të sugjeron, data, ngjarje, personazhe dhe histori që do të jenë burim referencash për të ardhmen. Leksiku i pasur, fjalët e shprehjet frazeologjike të rralla dibrane e bëjnë këtë libër edhe një pasuri gjuhësorë e mjaft tërheqës për lexuesin. Mjaftë interesante janë përshkrimet që K.Faruku u bën takimeve të tij elektorale të kohës kur ishte kandidat i Partisë Demokratike për deputet në zgjedhjet e para pluraliste të 31 Marsit 1991. Janë përshkrime brilante që ekzaminojnë saktë gjendjen e rëndë ku e kishte katandisur sistemi socialist fshatin shqiptar dhe ndikimin e politikës mashtruese në indoktrinimin e thellë të malësorëve të varfër.

ANALIZA TË MIRËFILLTA NË SENSIN DIPLOMATIK

Si diplomat (K.Faruku në vitin 1994 filloi punë në MPJ në Tiranë, si sekretar i parë i ambasadës shqiptare në Maqedoninë e Veriut - në atë

kohë FYROM, ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, dhe nga shtatori deri në dhjetor 1997, me largimin e ambasadorit, u caktua i ngarkuar me punë (a.i.), bën analiza dhe arrin në konkluzione të drejta, si për kohën pas çlirimit, kur përplaseshin superfuqitë SHBA dhe BS për hegjemoni e kur “Shqipëria mbeti si gomari mes dy atllarëve dhe hëngri aq shumë shkelma, sa vetëm më 14 dhjetor 1955, mundi të ulet në kuvendin e kombeve”, ashtu edhe për vitet e mëvonshme kur “zgjodhëm disa teza ‘të mira’ nga klasikët e M-L dhe pastaj bëmë një zhvillim krijues të marksizmit”, ekperimente bajate këto që e çuan Shqipërinë në buzë të greminës më 1990.

Dhe po në sensin diplomatik gjejmë në këtë libër analiza të mirëfillta për kohën kur “Shqipëria, si subjekt demokratik në Europë, duket se u prish punë forcave shoviniste në Ballkan”, ndërkohë që sipas tij, diplomacia shqiptare rrinte si një iriq i mbledhur në kundërshtimin e saj apokaliptik. Janë analiza të kohës kur “Sllobodan Millosheviçi është bërë një politikan i errët, një nacionalist histerik, që po luan me popullin e vet si buburreci me bajgën”...dhe kur “Jugosllavia i ngjan një laraske, që kakaris si e bardhë, por ngjyrën e ka të zezë”.

Pasi analizon edhe zhvillimet në botën arabe, kur në ringun e përbaljes kishte dalë diktatori Sadam Hyseini, diplomati dhe publicisti i mirënjohur K.Faruku arrin në përfundimin se “Një popull bie në mjerim, kur u beson verbërisht udhëheqësve, vetëm se ata e trazojnë në ndjenjat dhe emocionet nacionaliste”. (A nuk është ky përfudim në koherencë edhe me zhvillimet aktuale në vendin tonë, kur ekranet e televizioneve janë tejmbushur me kronika e debate për influenca të tilla?!)

DIMENSIONI INTELEKTUAL E NJERËZOR I K.FARUKUT

Ajo që jep më së miri dimensionin intelektual e njerëzor të K.Farukut është fjala e tij (që nuk u lejua ta mbante të plotë në një takim të datës 29.06.1991 në sallën e kinemasë Peshkopi, kur kishin ardhur të deleguar Azem Hajdari e Napolon Roshi. Publicisti e politikani kurajoz, këtu, midis të tjerash do të shprehej: “Jemi një shoqëri në zgjim. Ta bëjmë përtëritjen nga pesha e diktaturës me guxim. Misioni për të demaskuar deri në fund, me fakte diktaturën u takon trimave, atyre që nuk kanë frikë nga varret dhe hijet e së kaluarës. Të shërojmë njerëzit e gjymtuar, të shërojmë plagët. Krimet e komunizmit meritojnë një monument kujtese që të

mos na përsëritet kurrë më e kaluara e TontonMakutëve enverianë. Të gjallët meritojnë respekt. Na takon ne që e nisëm, ta çojmë deri në fund demokratizimin dhe dekomunistizimin e vendit. Siç thotë dijetari i shquar Visental: Liria nuk vjen nga qielli, për të luftohet çdo ditë”. E perifrazova këtë pjesë nga libri “Kur po shkriheshin akujt” për të sjellë në vëmendjen e lexuesit mesazhet aktuale që përcjell kjo vepër shumëdimensionale e Kamber Farukut për kohët që jetojmë. “Kur po shkriheshin akujt” është një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor që të bën ta marrësh diku një laps nga ato që shumë herë i kemi harruar përballë dehjes që na kanë bërë tastierat e kompjuterave dhe të celularëve dhe të shkruash diçka, mbase edhe shumë. Të shkruash për t’u bërë më tej një urë modeste e dobishme dhe e bukur mes kësaj vepre dhe publikut që e ndjek me shumë respekt, padurim dhe kureshtje çdo vepër që ai bën. Të bën që para se t’ia japësh mesazhin atyre që do e lexojnë këtë vepër të Kamber Farukut, të marrësh shumë për vete, bash si ata çirakët që kanë një kod të përbotshëm të marrjes së zanatit nga ustallarët.

BEQIR SINA, NJË BIOGRAFI NË DY KOHË

Më 7 Nëntor 2000, gjatë vizitës sime në Nju Jork, i ftuar nga Federata Panshqiptare “Vatra”, me bashkautor gazetarin dhe veprimtarin të saj shembullor Beqir Sina, do të shkruanim dhe botonim në të përditshmen më të madhe të diasporës shqiptare të asaj kohe “Bota Sot”, editorialin “Sot flet historia, Geroge E. Bush apo Al Gore?!”. Ishin zgjedhjet presidenciale amerikane të 7 nëntorit 2000, kur ne, pasi kishim vëzhguar fushatën e dy kandidatëve potencialë për kreun e Shtëpisë së Bardhë, edituam këtë ngjarje madhore historike në gazetën e përditshme që botohej njëherësh në Nju Jork dhe Zyrrih, në mbi 80 mijë kopje.



Në të vërtetë, Beqir Sina kishte vite që bashkëpunonte me këtë gazetë, si dhe me Radio “Kontakt” e “RD”, në Tiranë, ndërkohë që unë mbuloja politikën në këtë të fundit.

E solla në memorien time këtë ngjarje, pikërisht të enjten e 8 shtatorit 2022 kur Beqir Sina promovoi në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë librin e tij të parë “ROB – Një biografi për dy kohë”, në praninë e dhjetëra personaliteve të publicistikës, historisë dhe letërsisë, nga Tirana dhe diaspora shqiptare.

Nëse para 22 vitesh pata fatin të konstatoja, jo vetëm praninë, por dhe kontributin e tij në selinë e Federatës “Vatra” që asokohe drejtohej nga personaliteti i shquar Agim Karagjozi (e cila për B.Sinën ishte si shtëpi e dytë), tashmë ai i dhuroi lexuesit një libër, të cilin Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, dr. Dorian Koçi, e cilësoi si një kaleidoskop të kohës, duke theksuar se në të nuk gjejmë vetëm biografinë apo jetëshkrimin e autorit,

por edhe një udhëtim që na përket të gjithëve. Kjo edhe për faktin se ky libër është biografia e njeriut që jetoi 33 vjet në ferrin e Savrës si i internuar politik i regjimit të diktaturës komuniste, dhe po aq në lirinë e Amerikës. Ndaj dhe që në hyrje të librit Beqir Sina shkruan: “Gjysma e parë e jetës sime iku baltërave dhe moçaleve. Kur erdhi dita që vuajtjet e mia mbaruan, unë kisha moshën e Jezusit. Natyrisht, nuk isha i rëndësishëm si Krishti, por ashtu si ai, kërkova dinjitet, drejtësi dhe liri për veten e familjen, ndërkohë që barabajtë e diktaturës dhe profetët e rremë bënin kërdrinë në Shqipëri”. Ky është pothuajse lajtmotivi i këtij libri të kompozuar mjeshtrësisht në dy kapituj me nga përkatësisht gjashtë dhe shtatë pjesë.

Në pjesën e parë të kapitullit të parë “Familja ime e parë”, vetë titujt e artikujve janë sintezë e biografisë së një familjeje nacionaliste me traditë të lashtë dhe me kontribut madhor patriotik në ngjarje e fakte dominante të historisë sonë kombëtare, por njëherazi edhe e genocidit të pashembullt komunist ndaj burrave e grave të saj. Mjaftojnë për këtë qoftë edhe titujt: “Komunistët vrasin gjyshin”, “Kulla jonë në flakë”, “Internimi i parë”, “Arratisja e dy vëllezërve”, “Pas shtatë internimeve” etj. Ndërsa në pjesët 2, 3 dhe 4 autori rrëfen me gjuhë të pasur ngjarje dhe fakte interesante që konsistojnë në qenien e tij si bir i Dibrës dhe i Savrës’ Savra – një histori dhe familja e tij e dytë. Në këto rrëfime brilante është gjyshi i tij nga babai Beqir Sina (i vjetër) me autoritet në krahinë, që pasi kishte kryer Akademinë e Rendit në Itali, gjatë kohës së Mbretit Zog I kreu detyra të rëndësishme si ish-prefekt i Delvinës, prefekt i Lushnjës, komandant i Regjimentit të Fierit dhe në fund i Dibrës së Madhe. Por pikërisht si pasardhëse e tij, e gjithë familja në vitet e mëvonshme do të provonte barrën e rëndë të gjenocidit komunist. Ndaj dhe do të arratiseshin, fillimisht për në ish-Jugosllavi dy djemtë Feriti e Rushiti (të cilët atje i kapën dhe i pushkatuan) dhe më 1957 tre vëllezërit e tyre, Rasimi, Hashimi e Besimi që fatmirësisht mbërritën në SHBA ku ndërtuan jetën në vendin e demokracisë dhe lirisë së vërtetë. (Rasimi për dy dekada u bë zëri i diasporës shqiptare në SHBA si drejtues i një radioje për bashkatdhetarët, rrugëtim të cilin e përshkoi suksesshëm edhe i biri, Beqiri, autor i këtij libri).

Kalvari i djemve të kësaj familje përshkruhet me mjeshtri të rrallë në këtë libër nga autori Beqir Sina, në dhjetëra episode që pasi t’i kesh lexuar të mbeten në mendje, për të mos u shqitur nga memoria, ashtu si edhe

veprimtaria dhe publicistika mjaft produktive e cilësore e tij në tri dekadat e fundit të jetës në SHBA. Pikërisht për këtë produkt, autori i parathënies së librit, gazetari dhe studiuesi i mirënjohur Ilir Ikonomi e vlerëson atë si një autobiografi të pazakontë. Kjo, sipas tij, për faktin se: “Me seriozitetin dhe analizën e një gazetari vëzhgues, Beqir Sina tregon për jetën e tij në internim në Shqipëri dhe për lirinë e gjetur në Amerikë. Këto dy pjesë të librit përbëjnë një kontrast të thellë, që ai na e sjell me dinjitet dhe me rrëfime interesante”. Ikonomi vlerëson gjithashtu këtë tablo kontrasti midis robërisë dhe lirisë, e cila mban mesazhin se sa rëndësi ka që ne të luftojmë fort për ta ruajtur lirinë, edhe atëherë kur duket se ajo është e garantuar.

Nga ky libër mësojmë se si Beqir Sina që kishte lindur në internim në Savër të Lushnjës (nëna e tij Hanja, një grua me inteligjencë natyrore e fisnikëri të rrallë u internua pas arritjes së bashkëshortit, Rasimit më 1957 kur ishte shtatzënë me Beqirin barrë në bark) do ta njihte babain e tij për herë të parë në vitin 1991 kur ishte 33 vjeç. Mësojmë për kalvarin e tij gjatë 33 vjetëve të internimit, por edhe faktin se si gazetar, Beqiri ka takuar dhe fotografuar të gjithë presidentët amerikanë që nga viti 1992, ka fotografuar nga afër tre Papë, madje me njërin ka shtrënguar duart, ka takuar kongresmenë e senatorë, e ka treguar historinë e tij të vuajtjeve përpara shumë audiencave... Dhe nëse këto fakte i rendit në parathënie, gjatë promovimit të librit Z.Ikonomi kujtoi me emocion ngjarje të ndryshme që përcillen në libër, si dhe episode të ndryshme me autorin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ikonomi gjithashtu vlerësoi edhe veprimtarinë e gjerë të Beqir Sinës në Amerikë, miqësinë dhe bashkëpunimin e tij me personalitete të politikës amerikane.

Ndërsa moderatori i veprimtarisë promovuese, Dr.Dorian Koçi – drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, përveçse cilësimit të këtij libri si kaleidoskop të kohës, u ndal edhe në kontributin e autorit si një veprimtar i “Vatrës” dhe bashkëpunëtor i gazetës “Dielli”, por mbi të gjitha edhe për mbështetjen që u jep bashkëkombësve të tij.

Si një nga më të mirët sa i përket përshkrimit të së kaluarës komuniste e vlerësoi librin e Beqir Sinës “ROB – Një biografi për dy kohë” (Botim i “Tirana Times”), edhe studiuesi Albert Rakipi – Drejtor i Institutit për Studime Ndërkombëtare në Tiranë, duke e konsideruar njëkohësisht atë edhe si një homazh për të gjithë ata që u persekutuan gjatë diktaturës.

Vlerësim maksimal për këtë vepër dinjitoze, Beqir Sina mori edhe nga ambasadori Mal Berisha. Në fjalën e tij shprehu admirim për punën e shkëlqyer të Beqirit në këtë monografi, si dhe solli detaje nga njohja e tyre në SHBA. Berisha tha se edhe kjo monografi e shkruar artistikisht me detaje jetësore nga një njeri i letrave si Beqir Sina, e pasuron letërsinë tonë dokumentare dhe posaçërisht letërsinë e burgjeve.

Libri i Beqir Sinës u vlerësua edhe nga aktivisti dhe biznesmeni Ekrem Bardha, ish-i arratisur nga Shqipëria gjatë diktaturës komuniste. Ai tha se ngjarjet dhe faktet që Beqir Sina përshkruan në këtë libër dëshmojnë se komunizmi në Shqipëri ishte një diktaturë e rreptë, e paimagjinueshme dhe ne i dimë vuajtjet e të gjithëve, ndërkohë përcolli mesazhin se shumë pak njihen krimet e komunizmit, vuajtjet e shqiptarëve.. Ekrem Bardha, solli kujtimet e tij me babain e Beqirit, Rasim Sinën, para se të arratiseshin nga Shqipëria, si dhe jetën në SHBA si veprimtar shoqëror, si dhe persekutimin komunist të familjeve të tyre në Shqipëri.

Po në këtë linjë e vlerësoi librin e B.Sinës edhe bashkëvuajtësi i tij në vitet e internimit, Simon Miraka. Po ashtu, Ramazan Ndreu, bashkëvuajtës në kampin e Savrit, foli për familjen fisnike Sina, për jetën në persekutimin komunist dhe ma vonë në SHBA.

Si përfundim, për të konkluduar në vlerat shumëdimensionale të librit të Beqir Sinës “ROB – Një biografi për dy kohë”, do të mjaftonin qoftë dhe perifrazimet e disa personaliteteve të shquara, të vendosura jo pa qëllim nga redaktori Ilirjan Agolli, në kopertinën e fundit të tij.

Kështu, nëse Eliot Engel, ish-anëtar i Kongresit amerikan që e ka takuar autorin Beqir Sina në shumë prej aktiviteteve të tij si kongresist, në Uashington dhe në Nju Jork, e vlerëson si një gazetar të palodhur për të thënë të vërtetën dhe shpreh bindjen që rrëfimi i tij në këtë libër do të pritet me shumë interesim dhe se historia e jetës së tij do t'i shërbejë edukimit të brezave të ardhshëm, Leka II, Princi i Kurorës e konsideron librin “Një rrugëtim pasionant, rrëfyer mjeshtërisht nga i talentuari Beqir Sina, nga internimi në Shqipëri deri në zbulimin e lirisë së shumëpritur në SHBA. Një çelës për të përjetuar të kaluarën dhe për të kuptuar të tashmen!”.

Ndërsa Harry Bajraktari, aktivist dhe biznesmen, shprehet se është një libër që tregon të vërtetën, me fakte dhe hollësi interesante. “Gazetari Sina vuajti në internim dhe Amerika i hapi një të ardhme të bukur, atij dhe

familjes së tij. Është një libër që frymëzon. E falënderoj gazetarin Beqir Sina për sakrificën e tij dhe të familjes të tij. Me punën që ka bërë në vite si gazetar e ka pasuruar jetën e komunitetit shqiptar në SHBA”, shkruan Harry Bajraktari.

Për studiuesin Sami Repishti, “Ky libër ashtë një ngjarje me randësi për bashkësinë shqiptaro-amerikane dhe kontribut të çmueshëm për lexuesit shqiptarë kudo që jetojnë. Për lexuesit e huej, dedikimi pa kushte i shqiptarëve dhe veçanërisht i Diasporës në Amerikë mund të jetë një revelacion. Libri pa dyshim ashtë një konfirmim i dokumentuem i këtij dedikimi, një dhuratë për breznitë e ardhme”.

HALIL RAMA

VI

DIBRA DHE DIBRANËT NË
REPOPORTAZHET E MIA

Bulqiza në një film të Ylli Pepos

ATY KU BANORËT SHKELIN MBI NËNTOKËN MË TË PASUR NË EUROPË



- “Prof. dr. Gafur Muka, me modesti është shprehur në këtë film se nuk teprohet aspak kur thuhet se Bulqiza ishte një universitet i dytë për të gjithë kuadrot që punuan në minierë e gjeologji. “Në këtë universitet ishin të gjitha format e mësimdhënies: leksionet – përvoja e atyre që kishin shumë vite në minierë, seminarët – specifika e të dhënave që kërkonin zgjidhje, laboratorët – gjithë ambienti mbi – e nëntokë ku zhvillohej aktiviteti për kërkimin, zbulimin, hapjen dhe shfrytëzimin e mineralit të kromit dhe provimet – hartimi i projektprogrameve vjetore dhe mbrojtja e tyre para komisioneve teknike e shkencore. Kur largoheshe nga Bulqiza kishe vetëdijen e një profesionisti të certifikuar dhe krenarinë e përballimit të sfidave që nuk përsëdyteshin”, thotë prof. Muka, i cili, personalisht ndjehet me fat që u përfshi në “armatën” e atyre që e bënë Bulqizën.
- Në vijim të skenarit që përmban elementë të një eseje të gjatë letrare, në këtë film jepet Bulqiza ku banorët shkelin mbi nëntokën më të pasur në Evropë për kromin që bart. Brenda skenarit është poezia e Martin Cukallës: “Thua Bulqizë, ke

thënë krom”. Filmi evidenton kështu përmes pamjesh filmike, episodesh e intervistash një nga trevat e Dibrës me histori të veçantë. E njohur për luftërat e saj për liri e pavarësi të Shqipërisë. E njohur për thesaret e mineralit të kromit të fshehura në barkun e maleve...Më të larmishëm e bëjnë filmin edhe sinkronet e ing. Bukurosh Koçit, ing. Gjergj Xekës, specialisteve gjermanë etj., në gojën e të cilëve jepet gjithë dinamika e zhvillimit të minierës së Bulqizës dhe e gjithë kësaj treve lavdiplote.

Resurset e shumta mbi e nëntokësore të Bulqizës dhe historia e lavdishme e kësaj treve, vijnë artistikisht për publikun nëpërmjet një filmi dokumentar. Gazetarja e njohur e Radio Tiranës, Suzana Zyrakja, autore e qindra emisioneve radiofonike, por edhe e mjaft dokumentarëve televizive shkroi skenarin nën kujdesin, konsulencën e ndihmën e pakursyer të poetit të mirënjohur Martin Cukalla, ish-drejtor i minierës më të madhe të kromit në vend. Edhe titulli i filmit vjen nga një varg poetik i Martinit: “...E nderit është nëntoka e Bulqizës...”. Rrallë ndodh që një varg, i zgjedhur nga veprat poetike, të jetë titull filmi!

Por, ai nuk mungoi as në sheshet e xhirimit, kur me regjisorin e mirënjohur Ylli Pepo, nuk kanë ngurruar që së bashku të nisin realizimin e filmit.

Dhe ja, mëngjesin e një dite të zakonshme vjeshte janë gjendur në një nga sheshet e qytetit minatorë mes dhjetëra veteranëve, të ardhur nga të gjitha skajet, edhe nga përtej oqeanit. Është një takim brezash.

Kësisoj, Ylli Pepo, regjisor, gazetar, skenarist që ka realizuar suksesshëm një mori telereportazhezh e filmash dokumentarë, që ka xhiruar dhjetëra filma për personalitetet dhe ngjarjet historike të shqiptarëve, kësaj here është përqëndruar në një zonë të paeksploruar. Dhe jo pa qëllim e nis filmin me të rënë në galeritë e nëntokës së Bulqizës. Që në fillim teleshikuesve do t’ju duhet të fokusohen në një sallë, ku: ” ...si një mjegull e bardhë, nga errësira e galerive, vijnë edhe të rënë në apelin që hap takimin. Bujar Keta, Ismet Ymeri, Lavderim Lika, Mehmet Xhediku, Sadik Deda, Servet Islami, Lutfi Smeli, Skënder Leka, Sakip Muça, Axhem Xhepa, Myftar Begu, Luan Hoxha.

S’janë 5 as 10, por plot 300 emra! Në apel përgjigjet shpirti i tyre. Ata mbeten aty, në galeri, gjatë disa dekadave.

300 minatorë, punëtore e specialistë. Në mbi 7 dekada të krijimit dhe shfrytëzimit të Minierës së Bulqizës, dhanë jetën në krye të detyrës. Edhe pse llamba e karbitit iu shua në balle ata mbeten në gjirin e tokës si në legjendën shqiptare të murimit.

Ata u futën në gji të tokës për të nxjerrë thesaret e saj dhe mbeten aty si gurë themeli të forta për vazhdimësinë e minierës ndër vite”.

Martin Cukalla që ka përjetuar dhimbshëm çaste të trishta të rënies dhe të lamtumirës së disa prej tyre, si një nga drejtorët më të suksesshëm të kësaj miniere, kurrresi nuk mund ta niste ndryshe skenarin e këtij filmi, veçse me homazhin dhe nderimin e këtyre heronjve të nëntokës.

Ndërsa regjisori Pepo, si për ta kaluar sa më lehtë këtë moment të trishtë, përcjell nëpërmjet filmit muzikë, pamje nga Bulqiza...rrugët e saj.... Dhe si një nga ikonat e dokumentarit televiziv i jep filmit nuanca artistike ku përdoren mjeshtërisht dhe fotot me pamje nga natyra e Bulqizës... Një natyrë e virgjër që do të frymëzonte poetët, shkrimtarët, skenaristët e regjisorët më të famshëm të botë.

THUA BULQIZË, KE THËNË KROM...

Në vijim të skenarit që përmban elementë të një eseje të gjatë letrare, në këtë film jepet Bulqiza ku banorët shkelin mbi nëntokën më të pasur në Evropë për kromin që bart. Brenda skenarit është poezia e Martin Cukallës: “Thua Bulqizë, ke thënë krom”. Filmi evidenton kështu përmes pamjesh filmike, episodesh e intervistash një nga trevat e Dibrës me histori të veçantë. E njohur për luftërat e saj për liri e pavarësi të Shqipërisë. E njohur për thesaret e mineralit të kromit të fshehura në barkun e maleve.

Gjithkush që do ta ndjekë këtë film do të magjepset nga dy portat hyrje e dalje: Ura e qytetit me Harqe dhe Qafa e Buallit...me Bulqizën që ka fusha të mëdha për prodhime bujqësore e blegtorale. Janë vërtetë bukuri mahnitëse ato të fushës së Gjoricës, Boçevës, Shupenzës dhe Okshtunit. “Hambari i Dibrës në brigjet e Drinit të Zi” janë cilësuar ato.

Ndërkohë skenaristit Cukalla kurrresi nuk mund t’i “shpëtonin” dy burime hidrike të fuqishme të kësaj treve: Zalli i Okshtunit në Lindje dhe ai i Bulqizës në Perëndim. Rezerva të mëdha hidrike këto, prej kohësh të njohura e të shfrytëzuara, pamjet e të cilave shfaqen me tërë madhësinë e tyre në këtë film.

Detaje prekëse në këtë film nga natyra që i ka falur Bulqizës pasuri të mëdha natyrore. Një terren mjaft mbrojtës, rrethuar me male, gjelbëruar nga lloje drurësh si lisi, shkoza, panja, ahu. Male, liqene, miniera, pyje, pllaja e livadhe piktoreske, me shumëllojshmëri bimësh medicinale, si sherbela, dëllinja, qershia e egër etj. Burime natyrore, stane....Filmi paraqet një peizazh madhështor e të virgjër. E të mendosh për ata që i mbijetojnë dimrit të acartë, që ulet këmbëkryq me muaj në këtë zonë, kur erërat e forta dhe bora i kalojnë kufijtë e normales.

BULQIZA KA HISTORINË E SAJ SI PJSË TË LAVDISË SHQIPTARE

Për të realizuar sa më artistikisht filmin, regjisori dhe operatorët në një moment janë ngjitur lart, në majë të malit të Duriçit. Që këtu krahina e Bulqizës duket si në pëllëmbë të dorës. Poshtë këtij mali fshihet thesari i nëntokës, minerali i kromit!

Këtu spikat dukshëm kamera e mrekullueshme e Drejtorit të talentuar të figurës Xhemal Recit.

Po siç e përshkruan skenari, Bulqiza ka historinë e saj, si pjesë të lavdisë shqiptare. E kjo histori tepër madhërisht në këtë film kur paraqitet Ura me tri harqe që është një dëshmi ilirike. Banorët e Bulqizës ruajnë në memorien kolektive epopenë Skënderbejane. Ndaj dhe rrëqethesh nga ilustrimi me betejat në Vajkal të Bulqizes në vitin 1465, kur Heroi ynë Kombëtar, Skënderbeu përballi fitimtar dy beteja kundër pushtuesve osmanë. Pjesë vitale e filmi është dhe Memoriali “GURËT E SKËNDERBEUT”, vepër e skulptorit të ri Edmond Balja. Memorial ky ndanë anës së Fushës së Vajkalit, i realizuar me mbështetjen e disa sipërmarrësve, bij të Bulqizës që në film pasqyrohet nëpërmjet kronikës së asaj dite të inaugurimit.

Historia e minierës së kromit në Bulqizë, si një legjendë rrëfëhet nga veteranët, kronikanë të gjallë të kësaj historie të jetuar. Si në përralla thuhet se zbulimi i kromit në minierën e Bulqizës u bë rastësisht gjatë kohës së pushtimit italian.

Në fillim të vitit 1948 qeveria shqiptare vendosi të fillojë punimet për nxjerrjen e mineralit të kromit në Bulqizë. Më 18 Shkurt 1948 erdhën tetë punëtorë nga Rubiku me në krye Xhavit Hatibin dhe trembëdhjetë punëtorë nga zona e Bulqizës. Ajo ishte dita e parë e punës.

Imazhe frymëzuese filmike improvizuese kur në lartësinë mbi 1000 metra mbi nivelin e detit, në Ahishten e Madhe të malit të Duriçit jepet shpërthimi i parë i minave që thërrmonin shkëmbin e gurit me xixa që shënonte dhe fillimin e punës për nxjerrjen e mineralit të çmuar në Bulqizë. Bashkëkohësit tregojnë se gjatë këtij viti u prodhua 10500 ton mineral kromi. Drejtori i parë i minierës ishte Jorgji Traja, kryeinxhinieri i parë i saj ishte Dhori Pano.

Ndër vite prodhimi i kromit do zinte hapsira të reja e sektorë të rinj do hapeshin: Batra, Krasta; Thekna, Cerruja, Shkalla, Selishta..

Në kronikat e kohës përmenden emrat e minatorëve e specialistëve të parë, si: Osman Losha, Tosum Spahiu, Myrteza Duriçi, Gjergj Prenga, Sulejman Ruta, Hamit Duriçi, Liman Zogu, Adem Hasa, Gjin Kola e të tjerë. Janë këta heronjtë e parë që do të shtronin trasenë ku do të ecnin qindra e mijëra minatorë e specialistë të tjerë nder dekada.

Në film jepen imazhe të një shtegtimi nëpër nëntokë në mbi 100000 km pune minerare. Improvizime të realizuar mjaftë mirë artistikisht në film janë ato të atyre fillimeve të largëta si “pyetje në çdo rrëfim historie”, kur minerali nxirrej në sipërfaqe me karroca dore. Specialistët tregojnë se vetëm pas 10 viteve, aty nga 1958-ta u arrit shfrytëzimi i minierës me galeri nënkati. E pastaj me radhë shfrytëzimi i pusit 1...2...me tri nivele. Mjaft nga këto momente, si fletë ditari të kohës, na vinë nga kronikat filmike, që dikur shfaqeshin në kinematë dhe autokinematë e shumta që çonin filmin deri në skajet më të largëta të vendit. Dhe s’ka se si në këtë film të mos kujtohen me respekt drejtorët e atyre viteve: Sinan Xhemili, Ferit Alla, Sotir Dodona etj.; inxhinieret: Andrea Xega, Niko Lula, Zija Çeliku, Vilson Myftiu etj.; minatorët: Kamber Duriçi, Hasan Jashari, Sali Shehu, Zef Bib Lleshi, Pjeter Reci, Kole Arapi, Kadri Suli, Veli Kola, Servet Islami, Lutfi Smeli, Fais Kaci, Islam Spahiu etj.; mekaniket: Encio Xhimitiku, Fahrudin Shehu, Edip Kaloshi, Ilia Kocaqi, Skender Keta, Shefqet Duriçi etj.

QYTETI I MINATORËVE NË VERILINDJE TË VENDIT, MË I VARFËRI MBI NËNTOKËN E TIJ TË PASUR

Më të besueshëm e bëjnë filmin kronikat e kohës, nxjerrë nga arkivi i RTSH-së. Paraqiten në to zhvillimet të fundviteve 1960 dhe në fillim të viteve ’70, kur kjo minierë e ka renditur Shqipërinë në vendin e katërt

në botë për sasinë e nxjerrjes së mineralit të kromit me cilësi të lartë për shkrimje. Atëherë, deklarohet se miniera e kromit Bulqizë jepte 32-37 për qind të të ardhurave kombëtare në shkallë vendi. Megjithatë, Bulqiza, qyteti i minatorëve në verilindje të vendit mbetet e varfër mbi nëntokën e saj të pasur!

I ilustruar me kronikat e kohës me moton “Kromi çan bllokadën”, filmi sjell bindshëm në memorien e bashkëkohësve vitet 1980-1990, kur vetëm në zonën veriore janë hapur 8 puse vertikale dhe 8 dishenteri. Është koha kur në krye të kantierit që ndërtoi këto punime të mëdha ishte burri nga Fushë Bulqiza Nazmi Perkola, një drejtues i talentuar, i lidhur ngushtë me vendin e vet. Nazmiu filloi punën në minierë që në vitin e parë të jetës së saj dhe aty u rrit si specialist e kuadër. Në minierë punoi për 42 vjet rresht deri sa doli në pension në vitin 1990. Në këtë film ai prezantohet si kuadri i papërtuar, i lidhur ngushtë me njerëzit e ballit të galerive, në krye të sakrificave, i zoti të zgjidhte problemet e shumta e të vështira që shfaqte nëntoka. Nazmi Përkola gjithë jetën e vet në minierë mbeti porta ku trokiste minatori dhe fukaraja.

HARMONI UNIKALE NDËRMJET FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË FILMIT

Në atë mori planesh filmike të ndërlidhura, të shoqëruara me zë apo jo, të cilat krijojnë efektin e lëvizjes, në harmoni unikale ndërmjet formës dhe përmbajtjes, padyshim shkëlqen edhe montazhi i mjeshtrit të njohur Gjergji Pano, ku vend parësor zë përkushtimi i njerëzve që e bënë minierën e Bulqizës të shënonte vetëm rritje... Dhe jo vetëm në prodhimin e mineralit të çmuar të kromit, por edhe në krijimin e instancave ndihmëse.

Në 120 minuta (i ndarë në dy pjesë) momente kulmore të këtij filmi, shifra dhe fakte, shoqëruar me foto e dokumente arkivore që të mbërthejnë pas ekranit për të mësuar ecurinë e tyre ndër vite. Kështu mësojmë se më 1950 u krijua bërthama e parë gjeologjike dhe se deri në vitin 1952 në Bulqizë kishte vetëm baraka ku strehoheshin punëtorët. Por pas këtij viti u ndërtuan me radhë zyrat për ndërmarrjen e minierës së kromit, për ndërmarrjen gjeologjike, ndërmarrjen e furnizimit të punëtorëve.

Nën një regji perfekte, operatorët e këtij filmi janë fokusuar në momente të zgjerimit të qytetit të Bulqizës që ka ecur krahas me zgjerimin

e punimeve minerare. Gjithashtu filmi evokon vështirësi të mëdha, terrene të thepisura malesh, pa rrugë normale, nëpër të cilat minatorët me krahë transportonin sondat, motorët e pompat me pesha shumë të mëdha. Të thuash ndërgjegje e pastër punëtore, është kaq pak...i kalon tejskajshmërisht kufijtë e përkushtimit. Moment prekës, çasti kur kujtohen gjeologët e talentuar e të sakrificës së madhe: Koço Gushi, Sefedin Qorlaze, Todi Sema etj., që me punë të pakursyer e mendime përgjithësuese të mbështetura shkencërisht, i dhanë hov shtimit të pandërprerë të rezervave të këtij minerali të dobishëm dhe i hapën krahë shfrytëzimit në mënyrë të vazhdueshme e deri më sot.

Nëpërmjet sinkroneve ish drejtues të minierës së Bulqizës tregojnë se kulmi ishte kur në vitet 1984 – ’87 miniera arriti të realizojë afro 500 mijë ton krom çdo vit, derisa punimet minerare në ato vite arritën rekord mbi 40000 ml. Këto arritje do të shënonin bilancin optimal me mbi 15 milion ton krom që janë nxjerrë nga nëntoka e Bulqizës në afro 7 dekada kohë..

PROFILE DREJTUESISH QË FRYMËZOJNË

Pa profilizimin e atyre që i dhanë jetë minierës më të madhe të kromit në vend, filmi do të ishte i mangët. Por, skenaristi Cukalla dhe regjisori Pepo janë treguar tejet të vëmendshëm në evidentimin dhe promovimin e tyre, duke na i paraqitur ata me foto e çaste të sinkronizuara në frontet e punës. Kështu, periudha me ritëm rritje veçanërisht të lartë për minierën e Bulqizës lidhet me një emër të veçante për Bulqizën: Bujar Pata kryeinxhinieri dhe drejtori i palodhur e i pakursyer në përpjekjet e veta për të zgjidhur çështjet e vështira që kishte nxjerrja e kromit. Djalë i një familje modeste nga Peladhia, Bujar Pata u formua inxhinier miniere në Universitetin e Tiranës dhe iu përkushtua profesionit të vet duke e njësuar jetën e tij me atë të minierës.

Miniera dhe njerëzit e saj. Në film tregohen histori njerëzore, heroike, të heshtura, të thjeshta deri në madhësi...

Inxhinier Todo Manço në vitin 1955 transferohet ne Bulqizë si kryeinxhinier i minierës. Një ish partizan sypatrembur, i diplomuar në Poloni inxhinier miniere, sakrifkoi gjithë jetën në këtë minierë. Në këtë film ai evidentohet si miku i minatorëve dhe i gjithë qytetarëve, balli i luftës kundër vështirësive të motit e rreziqeve të nëntokës, që me personalitetin

dhe veprimtarinë e çmuar, u bë emblemë dhe frymëzim për të gjithë inxhinierët e minierave të vendit!. “Ai jetësoi punën e tij për kromin e markës shqiptare”, shprehen ndër kujtime ish punëtorët dhe koleget e tij të minierës. Ne respekt për këtë inxhinier – ikonë ndershmërie e përkushtimi ndaj punës, miniera mban emrin e tij: “MINIERA E KROMIT, TODO MANÇO-Bulqizë”!

Të mirat dhe fajet thuhet se i mban mend ndërgjegjja. Shpesh në jetë njerëzit harrojnë ato që thua, ato që ke bërë...por kurrë nuk harrojnë mënyrën se si i ke bërë të ndihen. Martin Cukalla edhe sot kur shkon në minierën e Bulqizës duket sikur dje është larguar prej saj. Në film jepen çaste se si ai rrethohet nga respekti e mirënjohja e njerëzve aty. Dhe kjo është lumturi. Në botë vijmë me asgjë, largohemi prej saj pa marrë asgjë dhe i lumtur është ai që ka lënë një kujtim në mendjen dhe në zemrën e dikujt. Martin Cukalla është një tjetër drejtues i aftë e i drejtë që kërkonte të vërtetën.

Njerëzit e respektojnë, se ai gjithnjë i ka dashur dhe respektuar. Një buzëqeshje apo shtrëngim dore me njeriun e thjeshtë asgjë nuk na kushton, por atij që ia jep e lumturon, pa varfëruar atë që e jep.

Hamza Gurra është një nga inxhinierët që jetën e tij e ka të lidhur me minierën. Mbi 50 vjet ka jetuar në qytetin e vogël të Bulqizës. Përvoja profesionale, gatishmëria dhe ndërgjegjja e tij në punë janë shembull i gjallë në kujtesën e njerëzve me të cilët ka punuar. Një shpirt i bukur artistik që, siç tregojnë shokët e tij, hynte galerive të minierës me arie të Bethovenit, Vivaldit në gojë. “Ti je artist” i thoshin shokët. “Artist je kur çdo punë e bën me pasion gjegjej ai”

Fatmir Beqiri kujtohet si inxhinieri i vlerësuar për aftësitë e tij organizative e teknike, njeri që nuk përtonte e që ishte thuajse çdo çast në galeri e pranë minatorëve dhe i ndëshkuar padrejtësisht nga goditjet që vinin nga lart. Kurrë nuk u thye ai njeri, përkundër u ngrit sërish e më i nderuar në krye të punëve e të sakrificave dhe meritoi respektin e kolegëve e të minatorëve në detyrat e ngarkuara si kryeinxhinier e drejtor i minierës veriore.

Artistikisht pasqyrohen në filmin “...E nderit është nëntoka e Bulqizës...”, edhe një brez i ri inxhinierësh që mbartën mbi shpatullat e tyre përgjegjësitë e mëdha të organizimit të punëve e të rritjes së pandërprerë të

nxjerrjes së kromit. Përmenden këtu Shefqet Kllogjeri e Jani Pasko, Vehbi Mustë e Fadil Cami, Gezim Dauti, Bukurosh Koçi e dhjetra të tjerë.

PROF. GAFUR MUKA: BULQIZA, NJË UNIVERSITET I DYTË PËR TË GJITHË KUADROT QË PUNUAN NË MINIERËN E GJEOLGJIS

Për ta sinkronizuar sa më mirë filmin, regjisori Pepo dhe konsulenti Cukalla, jo pa qëllim kanë zgjedhur opinionin e prof. dr. Gafur Mukës. Kjo për faktin se ai që e ka nisur karrierën në galeritë e Bulqizës për të arritur deri në instancat më të larta si ish-diplomat në Ambasadën e RSH në Bonn, Gjermani, Anëtar i Unionit Evropian të Konsulencës (ECU). E.C.U. – European Consultants Unit, pedagog në Fakultetin Gjeologji Miniera dhe në UET, Departamenti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, autor i 5 teksteve mësimore dhe i mbi 40 referateve, artikujve e projekteve brenda e jashtë vendit, si dhe autor i monografisë “Geo-Risk Maps for Management of Abandoned Mine Exploitations”, Publisher: LAP LAMBERT Academic Publishing, Berlin, 2018.

Prof. Muka, me modesti është shprehur në këtë film se nuk teprohet aspak kur thuhet se Bulqiza ishte një universitet i dytë për të gjithë kuadrot që punuan në minierë e gjeologji. “Në këtë universitet ishin të gjitha format e mësimdhënies: leksionet – përvoja e atyre që kishin shumë vite në minierë, seminarët – specifika e të dhënave që kërkonin zgjidhje, laboratorët – gjithë ambienti mbi – e nëntokë ku zhvillohej aktiviteti për kërkimin, zbulimin, hapjen dhe shfrytëzimin e mineralit të kromit dhe provimet – hartimi i projektprogrameve vjetore dhe mbrojtja e tyre para komisioneve teknike e shkencore. Kur largohesh nga Bulqiza kishe vetëdijen e një profesionisti të certifikuar dhe krenarinë e përballimit të sfidave që nuk përsëdyteshin”, thotë prof. Muka, i cili, personalisht ndjehet me fat që u përfshi në “armatën” e atyre që e bënë Bulqizën.

Më të larmishëm e bëjnë filmin edhe sinkronet e ing. Bukurosh Koçit, ing. Gjergj Xekës, specialistëve gjermanë etj., në gojën e të cilëve jepet gjithë dinamika e zhvillimit të minierës së Bulqizës dhe e gjithë kësaj treve lavdiplote.

Xhirimet e këtij dokumentari vijuan edhe në mjediset e shkollës së mesme profesionale Bulqizë ku u fol për ing. Osman Mihën, “Qytetar Nderi” i Bulqizës, ndër themeluesit dhe drejtuesit më jetëgjatë të kësaj

shkollë që ka luajtur rol kryesor në aftësimin profesional të minatorëve e specialistëve. Përpjekjet në këtë fushë nisën që në vitin 1952-1953 kur u hap shkolla e mbrëmjes për punëtorët e Bulqizës. Kohë kur sapo ishin vendosur këtu dhe familjet e para të minatorëve. Në vitin 1970 u hap shkolla e mesme profesionale e ditës me degën për teknikë miniere e më pas u zgjerua me degët gjeologji dhe shpim pusesh. Për veprimtarinë e gjatë të Osman Mihës, si në fushën e inxhinierisë, ashtu edhe në drejtimin e shkollës e mësimdhënie shembullore flasin me respekt, jo vetëm bashkohësit, por edhe më të rinjtë nga gjenerata e elitës bulqizake.

FAMILJA KOÇI, NJË NDËR ATO QË I KA DHËNË SHUMË MINIERËS

Për ta bërë sa më jetësor filmin, skenaristi Cukalla dhe regjisori Pepo kanë bërë pjesë të qenësishme të tij edhe Familjen Koçi të Bulqizës, një ndër familjet e këtij qyteti, apo të zonave përreth që i ka dhënë shumë minierës. Madje, po të bësh apel njerëzit e kësaj familjeje që kanë kontribuar me vite e dekada në miniere bëhen gati një brigadë e tërë.

Filmi tregon për Hasan Koçin që ishte njëri nga minatorët e prodhimit, i mirënjohur në gjithë minierën, për Qemalin dhe Dilaverin që shquheshin si minatorë të punimeve minerare. Po ashtu flitet për Hysenin që ishte gjithnjë i gatshëm të paraqitej ku të ishte nevoja: në prodhim apo punime minerare. Flitet edhe për Sabriun që ka qenë brigadier. Të gjithë kanë dalë në pension si punëtores miniere.

Ndërsa ISUF KOÇI, nuk harrohet kurrë. Në këtë film ai pasqyrohet me foto e pamje filmike si drejtori që drejtoi me zotësi dhe solli veç të mira për njerëzit si drejtues i bujqësisë dhe themelues i fermës në Fushë Bulqizë. Populli i Bulqizës e ka përjetësuar në memorien e tij Isufin. Edhe në këtë dokumentar, si edhe, në oda burrash, evente e takime, pohohet se djalë si Ai, nuk i vjen më Bulqizës. Po. Ai ishte dhe mbetet simboli i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale, mishërues dhe përçues i mençurisë dhe urtësisë dibrane. Këto virtyte e shoqëruan si kuadër dhe drejtues shembullor, qoftë në ish-kooperativën bujqësore dhe në Fermën e Fushë Bulqizës, të cilën e drejtoi me kompetencë e profesionalizëm deri në fundin e sistemit monist. Filmi dokumentar i regjisorit Pepo sjell shembuj që kur drejtonte Isuf Koçi, kooperativa dhe ferma patën nivelin më të lartë

të zhvillimit të të gjitha kohërave.

Në atë shtëpi karakteristike dibrane, Hajdar Koçi prezantohet si një tjetër pjesëtar i familjes së madhe Koçi. Një shtegtar i veprave të ekonomisë shqiptare që ka punuar në hidrocentralet e para, si në atë të Selitës, Ulzës etj. Më pas filloi punën në minierën e Bulqizës si mekanik i minierës, përmbi 30 vite, deri sa doli në pension.

Nga gjiri i kësaj familje tregohen në film dhe një skuadër djemsh e burrash të rinj në moshë, që punojnë në minierë apo në Fabrikën e Pasurimit të mineralit, si Hazizi, Ruzhdiu, Xhevahiri, Uka, Inxhinier BUKUROSH KOÇI, që është sot sipërmarrës i Fabrikës së Pasurimit të kromit në Bulqizë. Është vërtetë impresionuese intervista e tij në këtë film.

FABRIKA E PASURIMIT TË KROMIT, GJENERUESE E PRODHIMIT



Intervista me Bukurosh Koçin lidhur me ringjalljen e Fabrikës së Pasurimit të kromit, investimet e kryera, teknologjitë e avancuara që aplikohen, si dhe materialin që vetë fabrika prodhon zë vend të veçantë në filmin "...E nderit është nëntoka e Bulqizës...", të Ylli Pepos, Martin Cukallë e Suzana Zyrakës. Bukuroshi argumenton se nëse sasia e përgjithshme e mineralit të prodhuar në 75 vite i ka kapërcyer 15 milionë tonë, duke konsideruar vlerën e mineralit, me një çmim mesatar në vite prej 200 dollarë toni, rezulton një vlerë prej rreth 3 000 000 000 (3 miliardë) dollarë, këtu një rol dominant ka pasur dhe ka Fabrika e pasurimit si gjeneruese kryesore e prodhimit.

Por, ing. B. Koçi pohon se rënia e shpejtë e nivelit të prodhimit që filloi në vitin 1988, u thellua me ndërrimin e sistemeve. “Nuk po shtoheshin më rezervat e mineralit të kromit, punëtorët po iknin në emigracion, nivele të rinj prodhimi nuk po hapeshin. Zgjidhja u mendua tek dhënia me koncesion në investitorë të huaj, por prodhimi sërish nuk u ngrit, përkundër ra më poshtë. Pa punë mbeti edhe Fabrika e Bulqizës, e ndërtuar për pasurimin e kromeve të varfra. Fabrika e pasurimit të kromit e Bulqizës, e para e këtij lloji në vendin tonë, është vënë në punë në vitin 1973. Ajo përpunonte në koncentrate kromi pluhurat e mineralit të pasur dhe kromitet e varfra. Dhe ja, i mbeti vetëm emri! Mall pa zot siç thuhet në këto raste. Gati një skelet -fabrike nga grabitjet e hekurit e makinerive”, shprehet ing. B. Koçi në intervistën për këtë film.

Në shtator të vitit 2001 inxhinieri bulqizak Bukurosh Koçi u tregua iniciator, i guximshëm, vizionar dhe shpresëmirë. Në kuadër të privatizimit plotësoi dokumentacionin e duhur, bindës për perspektivën dhe e privatizoi këtë objekt që i dhimbte në zemër tek e shikonte karakterin. Se inxhinier Bukuroshi është rritur në mjedis familjar, ku miniera ishte jeta, kryebiseda e prindërve dhe të afërmve. Disa vite kishte punuar në këtë miniere, kështu që përvoja e punës e ndihmoi për ta ringjallur shpejt fabrikën. Brenda vitit e vuri në funksionim. Punësoi mbi 80 punëtorë. Prodhimi u rrit. Nisi dërgimi i mineralit të përpunuar për eksport. Ringjallja e fabrikës zbuti varfërinë, mundësoi një mirëqenie normale në mbi 80 familje të zonës. Kështu inxhinier Bukurosh Koçi, i aftë, me vizion për perspektivat e fabrikës është sot ndër më të suksesshmit në zonën e Bulqizës dhe madje edhe në rang kombëtar.

Në intervistën për filmin “...E nderit është nëntoka e Bulqizës...” ai flet për ringjalljen e fabrikës së pasurimit të kromit, investimet e kryera, teknologjitë e avancuara që aplikohen, si dhe materialin që vetë fabrika prodhon.

T’ia nisesh nga e para. Por duhet të dish kur është momenti për t’ia nisur e çka është më me rëndësi të mos ndalesh nga vështirësitë. Ky është stili i punës, i metabolizuar në shpirtin kërkues dhe novator të inxhinier Bukurosh Koçit. Në bashkëpunim me një kompani tjetër, fabrikës së pasurimit të kromit në Bulqizë iu bashkëngjiti e privatizuar një ish fabrikë e vjetër e pasurimit të kromit në Gjakovë. E lënë në mëshirë të fatit. Me

afro 1.5 milion Euro investime kjo fabrikë u riaktivizua. Në të përpunohen minerale të zonës kufitare, kryesisht të Hasit dhe Tropojës. Pajisjet janë të standardeve bashkëkohore, suedeze dhe kineze. Investimet vazhdojnë në këtë fabrike. Staf e punonjës të kualifikuar. Paga të kënaqshme. Uke Koçi, inxhinier prodhimi në këtë fabrikë dhe punëtorë kosovarë që punojnë aty pohojnë në këtë film se investimet në sektorin e minierave po rriten si rruga e vetme që sheh biznesi privat për shtimin e prodhimit edhe pse shteti ende nuk po e gjen veten në zbulimin e rezervave të mineraleve që i shërbejnë fuqizimit të kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë.

Një moment tjetër emocionues në këtë fil është industria e kromit në Kukës, pothuajse e shuar prej vitesh, e shfrytëzuar në mënyrë të jashtëligjshme dhe e degraduar nga makutëria, por që nga viti 2014 u gjallërua. Sërish sipërmarrësi, inxhinier Bukurosh Koçi, në bashkëpunim me investitorë seriozë të huaj i kthyen sytë nga kjo minierë. Është një investim shqiptaro-austriako-suedez. Në fabrikë është instaluar teknologjia më moderne, e cila përdor një metodë nga më të suksesshmet, që ka përparësi mbrojtjen e mjedisit. I gjithë uji i fabrikës shkon në qark të shkurtër. Nuk përdoret asnjë lloj kimikati dhe nuk ka rrjedhje.

“Nisi shfrytëzimi me kriter, me teknologji bashkëkohore për daljen në sipërfaqe të materialeve të fjetura. Miniera e kromit në Kalimash, sipas studimeve të kryera, ka rezerva industriale prej afro 1,23 milionë tonë krom! Investimet e kryera rezultojnë që kapaciteti përpunues i fabrikës është afro 40000 ton në vit mineral i pasuruar dhe koncentrat kromi. Në këtë fabrikë, ku faza e parë e investimit kap vlerën prej 3,5 milionë euro, janë punësuar deri tani mbi 150 punonjës”, pohom ing. Koçi.

NË FABRIKËN E PASURIMIT TË KROMIT PUNOHET DHE MENDOHET GJITHNJË PËR PERSPEKTIVËN

Në fabrikën e pasurimit të kromit në Bulqizë punohet dhe mendohet gjithnjë për perspektivën, përsosjen e standardeve. Investime të herëpashershme në reparte e pajisje. Në filmin “...E nderit është nëntoka e Bulqizës...” jepen çaste pune në laboratorë bashkëkohor fiziko-kimik, që përpunojnë gjithë monstat e lëndëve të para që futen në këtë fabrikë (lëndët e para që futen në këtë fabrikë, por dhe monstat e prodhimit përfundimtar të saj, koncentratit të kromit). Çdo ditë, kamionë me “ARIN

GRI” shkojnë drejt Portit të Durrësit. Vende të ndryshme të Evropës e më gjerë vlerësojnë kromin e Bulqizës. Pasuri shqiptare që ndërkohe i sjell buxhetit të shtetit të ardhura të konsiderueshme.

Ing. Bukurosh Koçi, të cilit në vitin 1980 i refuzohej e drejta e studimeve të larta për “njolla në biografi” sot është ndër sipërmarrësit më të suksesshëm. Autori i disa studimeve të kryera për pasurimin dhe parapasurimin e mineraleve të kromit në zonën e Bulqizës, Batrës, Krastës, Tërrnovës, Kukësit, Tropojës, Hasit etj., si dhe bashkëpunëtor në kryerjen e disa studimeve nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë; po ashtu autor dhe bashkautor i ndërtimit të disa Fabrikave e impianteve për pasurimin e mineralit të kromeve të varfra, si dhe i disa rikonstruksione Fabrikash Pasurimi, ka ngritur e konsoliduar një Shoqëri nga e cila janë përpunuar dhe vazhdojnë të ripërpunohen mbi 2.5 milionë ton? sterile dambe, duke prodhuar koncentrat kromi për eksport. Sot në këtë shoqëri që po mbush afro 23 vjet, punojnë rreth 100 punonjës të profesioneve teknologë, mekanikë, elektrike, manovratorë e shoferë. Ai shprehet për përfshirjen më të gjerë të shoqërisë, jo vetëm në përpunim por dhe prodhim të lëndës së parë, qoftë dhe për kromite të varfra, duke vërejtur se sasia e sterileve që mund të riciklohet po shkon drejt përfundimit, ndaj orientimit të ri të shoqërisë dhe drejt objekteve të reja të shfrytëzimit të kromit apo dhe kërkim-zbulimit të trupave të rinj minerare.

BULQIZA ME RESURSE TË SHUMTA TURISTIKE DHE NJERËZ TË FAMSHËM

Në filmin e regjisorit Pepo, Bulqiza nuk jepet vetëm si vendburimi kryesor i kromit, por edhe me atraksionet e shumta turistike. Sepse mjaftë njerëz guximtarë dhe me vizion duan të çojnë edhe në udhën e turizmit, sidomos tani me avantazhet e “Rrugës së Arbrit”, kur Bulqiza mund të konsiderohet si një lagje e Tiranës, duke ju afruar miqve dhe të huajve bukuritë natyrore, liqenet malorë të Dhoksit e Durrësit, nga më të bukurit e Shqipërisë, pyjet me klimën e tyre të shëndetshme, pishat përherë të gjelbra, duke dashur t’ju krijojnë kushte sa më të mira për të kaluar ditë të paharruara.

Me plane dhe vizion ambicioz mbresëlënës prezantohet në film edhe

një djalë i guximshëm i Bulqizës, që dëshiron të ngrejë një resort të bukur turistik buzë liqeneve.

Vend meritator ka në këtë film edhe Edmond Isaku, i mirënjohur në Bulqizë, pasi ka hapur hotelin “Bulqiza”, një ndër më luksozët dhe më të rehatshmit në vend.

Këtu është edhe stacioni televiziv “TV Bulqiza”, për të cilin Mondit tregon një kujdes të veçantë. “TV Bulqiza” transmeton programe të bukur njohëse dhe historike për bashkëqytetarët, duke ju rritur dijet dhe dashurinë për vendlindjen e tyre.

Njerëz të shquar me famë në të gjithë botën, ka nxjerrë Bulqiza. Të tillë janë vëllezërit Keta, këta kampionë botërorë në artet marciale, që realizuesit e këtij filmi i gjetën në Munih të Gjermanisë. Ata kanë hapur një shkollë të arteve marciale, ku njerëz të njohur e të rëndësishëm të jetës gjermane, vinë këtu rregullisht. Ata na tregojnë:

Vëllezërit kampionë Ismail, Gjetan e Ferit Keta nuk i harrojnë kurrë rrënjët, Bulqizën e dashur me prindërit dhe gjyshin e shtrenjtë.

Dhe ja në fund të filmit, përsëri takimi i brezave. Kujtime të njerëzve, që një pjesë të rëndësishme të jetës së tyre e lidhën me minierën. Këto kujtime, apo librat me kujtime shkruar modestisht, janë një testament shpirtëror që brezat e minatorëve i lenë njeri-tjetrit.

Kujtime të bukura, kujtime të dhimbshme e nderim për heronjtë që ndër vite dhanë jetën në minierë. Por, ajo që dhemb edhe më shumë është kur ndjehen të harruar në indiferencën e kaosit të realitetit shqiptar, të qeverive shqiptare njëra pas tjetrës. Këta minatorë fisnikërisht kërkojnë të drejtën e tyre themelore, hartimin sa më shpejt të Ligjit për “STATUSIN E MINATORIT”. E drejta e tyre gati bërtet!

Indiferenca dhe korrupsioni, sado të mëdha nuk do mundet ta mbytin zërin minator. Ky zë mbetet peng i tyre... Ndaj edhe ky film është dëshmi se minatorët nuk e humbin shpresën. Shpresa, një fjalë që gjendet me ta në mëngjes, ndofta vritet nga shurdhëria gjatë ditës, por fatmirësisht rilind me agimin. Edhe pse nëntokë, si në çdo gjë, drita e gjen rrugën.

Historia e Dinastisë “RUSI”, nga Dibra e Madhe, në SHBA, Turqi, Shkup, Tiranë e Durrës

“SHTËPIA E BARDHË” E SELIM RUSIT, KU U INICIU SAMITI I DIASPORËS



- Në Samitin e diasporës, biri i shquar i Dibrës, Selim Turhan Rusi, pati kurajon t’i kërkonte qeverisë shqiptare angazhimin konkret për Rrugën e Arbërit, duke shprehur njëherazi mbështetjen e gjithanshme të diasporës për këtë projekt jetik për Dibrën dhe viset shqiptare të Maqedonisë
- Njëherësh me optimizmin për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, Turhan Rusi shpreh keqardhjen legjitime për shtrembërimin në mjaftë raste të të vërtetave historike

Në Samitin e Diasporës që u mbajt në Tiranë më 18-20 nëntor 2016, bashkë me qindra bashkëatdhetarë ishte edhe Selim Turhan Rusi. Në të vërtetë, ky Samit u ideua pikërisht në “Shtëpinë e Bardhë” të biznesmenit Sel Rusi në Nju Jork, afro dy vite para se ai të mbahej. Pas takimeve që

kryeministri shqiptar, Edi Rama dhe lideri kosovar Hashim Thaçi patën me zyrtarë amerikanë, të Kombeve të Bashkuara dhe me bashkatdhetarët tanë, morën pjesë në një darkë private nga Sel Rusi, një nga biznesmenët më të njohur shqiptarë në Amerikë dhe aktivist i njohur në komunitet. Shtëpia e tij madhështore në Staten Island të Neë Yorkut, e cila njihet edhe si “Shtëpia e Bardhë” (e pagëzuar me këtë emër nga Znj.Hillary Clinton) pati mikpritës veç kryeministrit shqiptar, edhe ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Enver Hoxhaj, Musa Xhaferin zëvendëskryeministër i Republikës së Maqedonisë, Teuta Arifin, kryetaren e bashkisë së Tetovës, etj. Familja Rusi dhe aktivistët patën një bashkëbisedim të frytshëm me dy liderët shqiptarë, Edi Rama dhe Hashim Thaçi për zhvillimet politike dhe ekonomike në dy shtetet shqiptare, Shqipëri e Kosovë. Mysafirëve u uroi mirëseardhjen babai i vëllezërve Sel, Ilirjan dhe Benjamin Rusi, z. Turhan Rusi, i cili shprehu kënaqësinë për pjesëmarrjen e kryeministrit shqiptar Edi Rama dhe mysafirëve të tjerë në shtëpinë e familjes së tij. Media shqiptare e përcolli këtë pritje si një eveniment të veçantë edhe për faktin se për herë të parë u fol për mundësinë e mbajtjes të një Samiti të Diasporës në kryeqytetin shqiptar, me pjesëmarrjen e ajkës të inteligjencës dhe burrërisë shqiptare. Në atë Samit, biri i shquar i Dibrës, Selim Turhan Rusi, pati kurajon t’i kërkonte qeverisë shqiptare angazhimin konkret për Rrugën e Arbërit, duke shprehur njëherazi mbështetjen e gjithanshme të diasporës për këtë projekt jetik për Dibrën dhe viset shqiptare të Maqedonisë.

HISTORIA E TURHAN RUSIT, MIK I TRE KRYEMINISTRAVE SHQIPTARË

Turhan Rusi, në moshën 84 vjeçare, ishte me një memorie dhe rrjedhshmëri logjike kur na rrëfeu ngjarje, për t’u patur zili. Veç të tjerave, ai ruante dhe një arkiv me foto interesante, që flasin shumë për veprimtarinë patriotike të Familjes së shquar Rusi, jo vetëm në dy Dibrat, por në gjithë Shqipërinë dhe diasporën shqiptare në Amerikë e Turqi.

Pinjollit i kësaj familje emërndritur në historinë tonë kombëtare, ka një histori të dhimbshme në rininë e tij të herëshme. Megjithëse ka provuar kalvarin e vuajtjeve në burgjet serbe, ai kurrë nuk u mposht përpara torturave më mizore të eksponentëve të UDB-së për ta rekrutuar



Turhan Rusi me gjeneralin Clark

në gjirin e saj dhe për ta përdorur kundër Shqipërisë mëmë. Pushteti represiv serbo-maqedonas që i kishte konfiskuar pasurinë e trashëguar nga Familja në Dibër të Madhe, që i kishte burgosur vëllain, Qaniun, me akuzën absurde të organizatorit të një grupi për të ikur në Shqipëri, më 1964 do ta burgoste edhe atë vetë, duke e vënë përpara hetuesisë speciale, sipas nenit të famshëm 101 të Kodit Penal të ishFederatës Jugosllave, me akuzën e bashkëpunëtorit të Sigurimit Shqiptar. E liruan pasi nuk arritën ta rekrutonin si agjent të UDB-së...dhe pas këtij kalvari ai lë vendlindjen, për tu vendosur fillimisht në Romë, ku punoi për gjatë gjithë vitit 1969 si shofer i konteshës Atoliko, ndërsa që nga viti 1970 emigroi në SHBA, ku ndërtoi me mund, dije e përkushtim “perandorinë ekonomike”, në dobi jo vetëm të Familjes Rusi, por pothuasje të gjithë fafesisit e komuniteteve shqiptare në Nju Jork, Florida, Dibër të Madhe, Homesh e Peshkopi, në Shkup, Strugë, Durrës e Prishtinë. Mjafton për të “përligjur” këtë parajsë të kësaj familje, qoftë edhe fakti që sot ajo posedon 12 kompani të fuqishme biznesi në gjithë Amerikën, ku punojnë dhe mirëpaguhen 12.000 punëtorë nga të cilët 3000 shqiptarë. Brenda këtij bilanci mjaftë pozitiv është edhe kontributi i tij në ndihmë të vendlindjes e të Shqipërisë mëmë. Jo pa qëllim, evidentuam nga arkivi i tij i fotografive, tre më interesantet, ku Turhan Rusi pozon në krah të kryeministrave shqiptarë Fatos Nano, Sali Berisha dhe Edi Rama. I ka takuar në Nju Jork e Tiranë dhe i ka mirëpritur

në “Shtëpinë e Bardhë”, të tre liderët historikë shqiptarë, të së majtës dhe të djathtës, me qëllimin e vetëm për të marrë prej tyre premtimin për ndërtimin e Rrugës së Arbërit dhe për t’i kushtuar më shumë vëmendje Verilindjes e veçanërisht Dibrës së lënë në harresë. Ndjen keqardhje për mosmbajtjen e premtimit në kaq shumë vite, por edhe është optimist se kreu aktual i ekzekutivit shqiptar, Edi Rama, pas fitores plebishitare dhe mbështetjes që i dhanë dibranët në zgjedhjet e fundit, do ta ketë prioritet dhe do ta bëjë realitet ndërtimin e Rrugës së Arbërit, brenda 35 muajve, duke filluar nga shtatori i këtij viti.



Demir Rusi ,Turhan Rusi, Halil Rama.

KEQARDHJE PËR SHTREMBËRIMIN E TË VËRTETAVE HISTORIKE

Njëherësh me optimizmin për mundësinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit, Turhan Rusi shpreh keqardhjen legjitime për shtrembërimin në mjaftë raste të të vërtetave historike, nga shkruet të historisë në Tiranë, Dibër, Shkup e gjetkë... Ndërsa vlerëson dekorimin e disa personaliteve me rastin e 110 vjetorit të themelimit të klubit “Bashkimi Dibran” nga ish-Presidenti i RSH, Bujar Nishani, me Urdhërat “Nderi i Kombit”, “Mjeshtër i Madh” e “Për merita të Veçanta Civile”, ai me të drejtë shpreh indinjatën për mosvlerësimin e patriotit Riza Rusi, ish-kryetar i Klubit “Bashkimi Dibran”. Ky kolos i mendimit dhe veprimit progresist, njëherësh dhe njohës i mirë i historisë, ndalet në fakte konkrete kur është fjala për vlerësimin e të vërtetave historike. Pikërisht Turhan Rusi që para disa vitesh inicioi simpoziumin mbi Historinë e Dibrës, është zemërthyer për mosvlerësimin e kontributit të tij në këtë aspekt. Pas kundërvënieve ndaj nismës së tij, për çështjen e emërtimit të varreve të vjetra të Dibrës së Madhe, veprimtari i njohur dibran, në Amerikë, zoti Turhan Rusi, i cili tani në pension e ka ndarë jetën e tij mes Dibrës dhe SHBA, ofroi një ide për zgjidhjen e problemit, duke propozuar mbajtjen e një “Simpoziumi mbi historinë e Dibrës”, të cilin ai dhe familja e tij do ta mbështesnin tërësisht financiarisht. Por fatkeqësisht, bujaria dhe fisnikëria e tij, qëllimisht u anashkaluan nga autoritetet vendore, dhe sot është jo vetëm për të ardhur keq, por edhe për t’u lemerisur me faktin që ende në Dibër të Madhe ekziston një rrugë me emërtimin “Armata Jugosllave”, kur shumë mirë kësaj rruge mund t’i hiqej ai emërtim dhe t’i vihej emri Rruga “Selim Rusi”. Kjo edhe për faktin se ky atdhetar i flaktë njihet në histori si bashkëpunëtor i tribunit kosovar Haxhi Zeka dhe si organizatori dhe drejtuesi i të parës ushtrie jo të rregullt shqiptare kundër Turqisë më 1877. Po ashtu është i njohur kontributi i Selim Rusit, me arsim të lartë ushtarak, edhe në kuadrin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Janë gjithashtu evidente në historinë tonë kombëtare përpjekjet e patriotit Selim Rusi për autonominë e Shqipërisë, si adjutant i Abdyl Hamidit të II, si nismëtar i thirrjes të Kuvendit të Pejës e Kuvendit të Dibrës më 1899 dhe si president i Sanxha të Dibrës. Ndërkohë, autoritetet vendore të Dibrës së Madhe, si dhe ato të Peshkopisë e Bulqizës duhet të ridimensionojnë qëndrimin e tyre edhe përsa i përket

vlerësimit të kontributit të njohur të patriotit Dalip Rusi në kryengritjen kundërosmane të viteve 1833- 1845. Këtë rivlerësim, sipas pinjollit të denjë të tyre, shqiptaroamerikanit të mirënjohur Turhan Rusi, mund dhe duhet ta bëjnë historianë, studijues dhe shkrimtarë të njohur shqiptarë, të ndershëm e të pa përfolur më parë për tjetërsim apo manipulim të historisë – nga Dibra e Madhe, Peshkopia, Tirana, Prishtina, Tetova, Shkupi dhe diaspora dibrane.

PEMA GJENEALOGJIKE E FAMILJES RUSI

Një tjetër emër i spikatur i kësaj familje, publicisti dhe poeti Demir Rusi, pasi ka konstatuar deformime diletantësh, në librin e tij të botuar dhe promovuar para disa muajsh, “Ura e fjalës”, i ka kushtuar një poemë me vargje brilantë edhe pemës gjenealogjike të fisit të tij. Këtë, pasi që në vitin 1986 ka lexuar në lidhje me prejardhjen e fisit “RUSI” nga një kandidate shkencash, po e këtij fisi, që tani nuk rron, por që sipas tij ka pasardhës dhe mund të gjejnë dokumenta që dëshmojnë prejardhjen. Të parët e këtij fisi, kanë ardhur rreth 500 vite më parë nga Siçilia për në Leskovik të Korçës. Më vonë shumica prej tyre kanë lëvizur në drejtim të Shkodrës, dhe aty mendohet të kenë qëndruar rreth 100 – 150 vite. Më vonë të gjithë janë organizuar dhe janë kthyer në vendin e tyre të origjinës, kryesisht në Siçili por edhe në Kalabri, (dhe tani fisi RUSI është i shtrirë thuajse në gjithë Italinë e Jugut. Këtë e ka konstatuar vetë në vitet kur ishte emigrant, 1993 -2001). Vetëm tre vëllezër kanë marrë rrugën dhe kanë lëvizur në drejtim të Dibrës. Njëri nga këto është ndalur në Homesh, Dibër; tjetri ka zënë vend në Dibër të Madhe nga buron edhe pasardhësi, Turhani e djemtë e tij. I treti është kthyer në Leskovik. Po nga ky studim që posedonte zonja, e cila kish gjurmuar arkivat e disa vendeve ku ishte prezent mbiemri RUSI, bëhet e ditur se ata që sot janë me shumicë në Shkodër nuk janë autoktonë, por u ka mbetur ky mbiemër nga lagja me emrin “RUSI”, meqënëse këta ishin banuesit e parë të asaj mëhalle (lagjeje). Nga ky studim evidentohe edhe fakti se mbiemri RUSI është transformuar në shumë mbiemra të tjerë, ku pasardhësit trashëgonin emrin e babait si mbiemër, si në: TASHA, ZENELI, KURTI etj. Por Turhan Rusi shkon edhe më tej, në prejardhjen e mbiemrit Rusi, që nga osmanishtja përkthehet në “këshilltar”. Këtë pohim e gjejnë edhe në një evidencë arkivore, të

nënshkruar nga Lutfi Rusi, një nga personalitetet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të viteve 1880, i cili bashkë me vëllain, Njaziun sollën librat e parë në gjuhën shqipe në Dibër të Madhe. Po ashtu historia flet për rënien e Aqif e Riza Rusit në fushën e nderit, kundër serbëve, si dhe për kontributin në ar nga Dalip Rusi për mbajtjen e Kongresit të Lushnjës, më 1920. Por, poeti, publicisti dhe biznesmeni i mirënjohur, shpreh indinjatën edhe për përgojimin padrejtësisht të Familjes Rusi në SHBA, nga pseudohistorianë, me pretendimin absurd pse paska pritur kryeministrin aktual, Edi Rama. Kjo familje, ndër më të pasurat e Nju Jorkut, është padyshim pjesë vitale e krenarisë tonë kombëtare.

FAMILJA “RUSI” NË NJU JORK, NDERI I KOMBIT TONË

Kreu i kësaj familje aktualisht është Sal Turhan Rusi, një filantrop dhe milioner nga Neë York-u. Nga një emigrant nga Dibra e Madhe ai është kthyer në një nga ikonat e City-t. Ka mbushur mediat amerikane pas blerjes së “Shtëpisë së Bardhë”, të pagëzuar me këtë emër nga Znj. Hillary Clinton, pas një pritje nga të zotët e shtëpisë, nga ku startoi mbështetja për garën e saj presidenciale. Vila ndodhet në Staten Island, zonë elitare e Neë Yorkut. Turhan Rusi dhe djemtë e tij kanë emigruar për Amerikë pas një kalvari të gjatë vuajtjesh në Dibër, rreth vitit 1970. Është për t’u theksuar se kjo familje shquhet për ndjenja të larta atdhedashurie dhe humane. Në Dibër të Madhe, Turhan RUSI së bashku djemtë, përveçse në dhjetra projekte infrastrukturore në dobi të komunitetit, kanë lënë gjurmë sidomos për ndihmat e konsiderueshme humanitare në periudha krizash. Kështu, gjatë 97-tës kur Shqipëria përjetonte krizën e fajdeve dhe kur shteti ishte pothuajse inekzistent, ndërsa ish kryekomunari i Dibrës së Madhe, z.Xhafa nuk qe në gjendje t’iu përgjigjej kërkesave që vinin nga Peshkopia, Maqellara e Bulqiza, z.Turhan Rusi, nga llogaria e rastit, trefishoi ndihmat me medikamente për spitalet e këtyre rretheve. Të njejtën gatishmëri do të tregonte biznesmeni shqiptaro-amerikan edhe gjatë krizës kosovare, kur vuri tre dyqane në dispozicion të Drejtorisë së Çerdheve në Dibër të Madhe. Po kështu është i njohur kontributi i z.T.Rusi, i cili në bashkëpunim me drejtorin e llixhave, Z.Ollogu ndikoi në vënien e Llixhave në dispozicion të kosovarëve të dëbuar nga trojet e tyre nga pushtuesi serb, duke kontribuar me 65-70 mijë dollarë për çdo muaj. Evident është gjithashtu kontributi

i kësaj familje për ndërtimin e xhamisë në Budolec, për mbulimin e xhamisë në Kojnarë, për pastrimin e varrezave etj. Po ashtu Familja Rusi ka investuar për ndërtimin e një qendre shëndetësore, të specializuar për sëmundjet e grave, ku i gjithë populli dibran, por edhe vendet perreth u janë shumë mirënjohës, pasi të gjitha ekzaminimet bëhen falas. Qendra e diagnostikimit të kancerit të gjirit “Florina Marke – Rusi” në Dibër të Madhe, është e vetmja e këtij lloji në Maqedoni dhe në Ballkan që ofron të gjitha shërbimet falas dhe me një aparaturë të sofistikuar që familja Rusi e ka sjellë nga SHBA-të.

Por ndërsa ky kontribut është i pamohueshëm, tingëllon absurd fakti që në librin e Dr.M.Hysa “Kosova e Vogël në Dibër të Madhe” ai përmendet vetëm me inicialet T.R, intrigë kjo që shkaktoi dhe reagimin e Prof.Nuri Kolecit gjatë promovimit të këtij libri, i cili pohoi se pa mbështetjen e Familjes Rusi, nuk mund të kishte kurrësesi “Kosovë të Vogël” në Dibër të Madhe. Nga viti 2013 Sal Rusi është emëruar Konsull Nderi i Shqipërisë në Neë York. Ai ka një influencë të fuqishme në politikën amerikane. Në shtator të vitit të kaluar, në Gazetën “ILLIYRIA” (organ i diasporës në Neë York) do të publikohej lajmi se edhe znj.Clinton, kandidate për Presidente në zgjedhjet e fundit presidenciale në SHBA, kishte startuar fushatën e mbledhjes së ndihmave pikërisht nga kjo familje, miq të së cilës janë edhe personalitete të tjera të shquara amerikane, si ish kandidati demokrat për president Al Gore dhe gjenerali Clark, mbështetja e të cilit në garën për president ka startuar po nga kjo familje.

Dhjetë vjet më parë u mbajt një samit i madh në banesën Rusi në Dibër të Madhe, ku kryeministri i Shqipërisë Edi Rama u takua me Hashim Thaçin dhe Ali Ahmetin, për të kordinuar punët e lobit shqiptar. Si organizator i këtij lobi, kur ishte 84-vjeç Turhan Rusi e pati përqëndruar gjithë vëmendjen tek Rruga e Arbërit. Dhe ashtu si edhe në qindra projektet e mëparshme kishte besim të patundur se do t’ia dalë me sukses.

EKSODI MASIV, MIJËRA FAMILJE DIBRANE NË KËMBË DREJT TIRANËS



Njëqinddhjetë vjet më parë, mijëra familje të Dibrës së Madhe, për t'i shpëtuar gjenocidit të pashembullt dhe të dëbuar nga shovinistët serbë, pasi ecën për ditë e net të tëra në këmbë, u vendosën në kryeqytetin shqiptar, të mikëpritur bujarisht nga tiranasit.

Për shumicën e banorëve të kryeqytetit shqiptar janë të njohura: “Rruga e Dibrës”, “Mëhalla e dibranëve”, “Komuniteti dibran i Tiranës” (që për nga numri i banorëve është ndër të parët në rang metropoli)...Të parët e tyre, të dëbuar me dhunë nga shovinistët serbë erdhën para 110 viteve (1913) dhe gjetën strehë në Tiranë, të mirëpritur nga banorët e këtushëm autoktonë. Njëqind e dhjetë vjet më pas, pinjollët e tyre, të grupuar në Shoqatën “Bashkësia Dibranë” e përjetësuan këtë eksod në memorialin që u përrua me praninë e qindra dibranëve e tiranasve...dhe pse jo, edhe me të ardhur nga diaspora, nga Kosova e Ulqini...

Ndërsa përshëndeti i emocionuar në këtë eveniment historik të inaugurimit të Memorialit me titull “Në nderim të dibranëve të dëbuar, që u pritën zemër hapur nga tiranasit”, kreu i Shoqatës “Bashkësia Dibranë”, pjesë përbërëse e një prej komuniteteve më të vjetra tradicionale në Tiranë, prof. Bujar Kapexhiu-Nderi i Kombit, ndër të tjera bëri të ditur

se “Nderojmë sot të ardhurit para 110 vjetësh në Tiranë, nga gjenocidi i përsëritur serbo-sllav mbi trojet tona, si dhe mbi qytetarët e trevës së Dibrës, që do të përjetonin masakrat më të pashoqe ndonjëherë” . Kapexhiu vlerësoi punën e shkëlqyer për të realizuar këtë monument nga arkitekti i njohur Afrim Shatku, dibran 24 karat, që jeton ne Shkup si dhe nga skulptori, Ardian Pepa, pedagog në Universitetin e Arteve të Tiranës. Kreu i “Bashkësisë Dibrane” falënderoi dhe familjen e z. Abdurahim Buza, i cili dha dhe lejen e autorësisë për të përfaqësuar në Monumental temën e eksodit pasi në të njëjtën periudhë kohore 1913 është vit i tmerrit dhe i kasaphanës, jo vetëm për dibranët dhe kosovarët, por për të gjithë kombin shqiptar.

PËRJETËSIMI I EKSODIT MASIV TË VITIT 1913

“Memorial historik”, e ka vlerësua ministri i Drejtësisë Ulsi Manja këtë monument që përjetëson eksodin masiv të 1913. Duke përshëndetur pjesëmarrësit në këtë event mbresëlënës, ministri Manja tha se “Nuk duhet harruar kurrsesi fakti se, mbas konferencës së Londrës së 1913, trojet shqiptare por dhe në veçanti treva e Dibrës së Madhe, e njohur ndryshe si Shëhri i Dibrës, pësuan humbje në njerëz dhe pushtim të territorit të saj padrejtësisht”. Kjo sipas tij për fatin se Dibra nga një qendër e rëndësishme ekonomiko-sociale, politike dhe kulturore, si një Prefekturë, e humbi rëndësinë e saj të dikurshme. Gjithsesi, kreu i dikasterit të Drejtësisë vlerëson faktin që në Tiranë, qytetarët dhe paria e saj, me në krye kryetarin e Bashkisë së parë të Tiranës, bamirësin Zyber Hallulli dhe mjaft personalitete të kohës dolën dhe pritën të dëbuarit dibranë nga eksodi masiv i vitit 1913, pikërisht këtu nga ku nis “Rruga e Arbrit”. Pikërisht mu në këtë shtatore që u inaugurua të shtunën në sheshin para Fondacionit “Fundjave ndryshe”, ato u pritën me zemër, me fisnikëri dhe me ç’të mundnin nga rrethanat e vështira të kohës. “Nga një eksod masiv, prej popullsisë së Dibrës së Madhe, më 20 shtator të vitit 1913 do të shkëputen përmes gjenocidit, prej kësaj treve duke ecur ditë dhe natë në këmbë, të cilët ne i njohim me emërtimin si muhaxhirët dibran. Do të ishte kryetari i parë i Tiranës, Zyber Hallulli, i cili së bashku me parinë tiranase, do të dilte në Shkallën e Tujanit, me lot në sy, bukë, ujë dhe zemër të priste dibranët e sflitur nga gjenocidi sllav”, tha ndër të tjera ministri

Manja. Si një nga përfaqësuesit më në zë të komunitetit dibran në Tiranë, ministri më i suksesshëm i Drejtësisë i këtyre viteve vlerëson këtë forcë të veçantë, të mikpritjes që karakterizon zakonet dhe traditën tonë shqiptare, e në veçanti Tiranën tonë, e cila na pranoi, por dhe na vlerësoi.

Gjatë viteve 1920 deri në 1945 e në vazhdim, ka pasur disa drejtues të rëndësishëm dibran të institucioneve kushtetuese, si dhe në jetën legislative, ekzekutive dhe vendore apo lokale.

Ministri Manja bëri të ditur se nga komuniteti dibran kanë dalë disa kryetarë bashkie dhe prefektët, duke filluar nga prefekti i parë i saj më 1920 si: Qamil Pepa, dhe kryetari i parë i Bashkisë së Tiranës, Izet Shatku Dibra. “Dibranët e Tiranës, mbi 110 vjet në Tiranë, nuk e kanë harruar kurrë mikpritjen bujare dhe bamirëse të tiranasve, e cila shkon më tej duke shkëmbyer dhe lidhje familjare me njëri-tjetrin. Ashtu siç kemi në Kushtetutën tonë të Republikës së Shqipërisë, harmoninë dhe bashkëjetesën fetare, si pjesë e panteonit të vlerave universale dhe lirive themelore të njeriut, po kjo natyrshmëri karakterizon edhe sot kombin tonë”, vlerësoi ministri i Drejtësisë. Ai tha se nuk duhet harruar pritja madhështore që kryeqyteti ynë Tirana, bëri jo vetëm për dibranët e eksodit gjenocidial të 1913, por edhe për shqiptarët e Kosovës dhe komunitetin çam të 1945.

“Ne dibranët sot, jemi të nderuar me besim dhe dashuri, ndaj komunitetit tiranas i cili na hapi dyert, jo vetëm një herë por disa herë, jo vetëm për ne komunitetin dibran të Tiranës por edhe eksodit çam, toskë e më në fund edhe gegëve. E ndjejmë si një princip moral por dhe komunitar, ashtu siç t’i përulemi Perëndisë, t’i përulemi me respekt dhe emocion këtij komunitetit të nderuar, që nuk kurseu asgjë, nga kjo golgotë Shqiptare”, përfundoi fjalën e tij ministri Manja, i cili u duartrokit fuqishëm nga pjesëmarrësit.

NJË VËSHTRIM HISTORIK

Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës “Bashkësia Dibrane”, prof. Saimir Shatku, ndërsa ka falënderuar pjesëmarrësit në këtë event festiv, ka bërë një vështrim historik të ngjarjeve që çuan tek eksodi i dibranëve i vitit 1913. Ndër të tjera, ai evidentoi krijimin 115 vjet më parë të Shoqërisë Patriotike dhe Kombëtare “Bashkimi Dibran”, e dalë nga nevoja për liri dhe pavarësi kombëtare, me në krye disa personalitete të kohës si Said

Najdeni apo Hoxhë Vokrri, Hafiz Sherif Langu, Josif Bagleri, Ibrahim Jegeni, Jusuf Dibra Dohoshishti, e te tjerë. Z.Shatku vlerësoi gjithashtu kryengritjen e shtatorit 1913, si të parën kryengritje që i bashkoi shqiptarët kundër padrejtësisë që bëri Konferenca lajkatore e Londrës, me 22 mars të 1913 në dëm të viseve shqiptare.

Me 27 nëntor 1913, armatat serbe sulmuan trevën e Dibrës. Popullata e Dibrës kaloi në gjendje gatishmërie, duke përballuar një situatë të rëndë politike, ushtarake, ekonomike dhe humanitare e cila arriti kulmin në verën e 1913.

Referuar burimeve historike vendase dhe ë huaja, z. Shatku bëri të ditur se me 8 tetor 1913 janë kryer këto operacione:

-Ushtria serbe bombardoi, plaçkiti, dhe dogji qytetin administrativ të Dibrës së Madhe...

-U nis pararoja ushtarake drejt Pogradecit. Shqiptarët, me forcat e tyre, sulmuan dhe çliruan Dibrën e Poshtme, Peshkopinë, duke pasur 1200 luftëtarë shqiptarë.

Në Dibër të Madhe po përgatitej një kasaphane gjaku dhe gjenocid i pashembullt. Në këto kushte, plani dhe strategjia e luftës kundër ushtrive serbe, u përgatit nga disa patriotë dhe personalitete të kohës si: Shaqir beg Jegeni, Sefedin Pustina, Sedulla Strazimiri, Qamil Daci, Selim Rusi dhe komandant Shefki Shatku, ndërsa në krye, duke hyrë në Dibër me 22 shtator ishin Elez Isuf Ndreu, Dine Maqellara dhe Mersin Dema. Kryengritja ishte e suksesshme, pasi zgjoi kombin shqiptar nga identiteti për ruajtjen e trojeve kombëtare, dhe kjo lëvizje pati karakter ndërkrahinor dhe ndërshtetëror.

PRISHJA E DIBRËS SË MADHE

Me 22 nëntor 1913, koloneli Von Laffer, i cili ishte dhe kryetari i Komisionit Ndërkombëtar të Kufinjve lindor, nga Struga deri në Kukës raporton se: “Dibra, e cila pak para pushtimit ishte një qytet me rreth 45.000 mijë banorë, e që llogaritej qyteti i katërt mbas Shkodrës, Prizrenit, Janinës dhe Korçës, sot është krejt e pabanueshme (ajo sot është vetëm një lagje maqedonase). Shtëpitë nuk janë rrënuar por janë zhveshur nga të gjitha. Serbët përfituan shumë nga kjo kryengritje e shqiptarëve duke i deklaruar të gjithë shqiptarët pa përjashtim si kryengritës, dhe duke i

vrarë. Në rrethet e Dibrës, gati çdo katund është një vend i djegur dhe i shkatërruar. Në mesin e tyre gjinden disa katunde serbe që kanë mbirë si kërpudha e shumë të pasur. Banoret e tyre punojnë, pa pushim për mbledhjen e të korrurave të shqiptarëve të mbetura nëpër arra”. Kjo, tha z. Saimir Shatku ishte golgota Shqiptare.

DYERT E DIBRANËVE TË HAPURA, ASHTU SI I MIKPRITËN TIRANASIT

Prof. Ismail Varoshi, sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës “Tirana”, pasi u shpreh për marrëdhëniet e mira me Shoqatën “Bashkësia Dibrane”, ndër të tjera vlerësoi memorialin që përjetëson eksodin masiv të popullsisë së Dibrës së Madhe, e cila la trevën e saj nga okupacioni dhe gjenocidi sllavo-malazez, duke u strehuar nga bujaria dhe fisnikëria e parisë së Tiranës. “Do të ishin personalitetet si: Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Zyber Hallulli, dhe mjaft të tjerë si Mutesim Këlliçi, Efendi Ismail Ndroqi, Rauf Fico etj., që dolën për t’i pritur dhe strehuar dibranët. Në fillim ato u strehuan pranë Namazgjasë së Tiranës, e me pas u vendosën në lagjen apo Mëhallën e dibranëve, sot Njësia Administrative nr.3 e Tiranës”, tha z. Varoshi. Ai vlerësoi faktin që familjet dibrane u integruan me shoqërinë e kohës dhe dalloheshin për përkushtimin ndaj familjes së tyre dhe punës. Kjo gjë i bëri ata që të tejkalonin me shpejtësi vuajtjet e atij eksodi të tmerrshëm. “Dyert e shtëpive dibrane rrinin të hapura dhe ashtu si i mikpritën tiranasit ata iu përgjigjën atyre me të njëjtën monedhë bujarie. Madje shumë shpejt, filluan martesat ndërmjet tiranasve dhe dibranëve, saqë 80% e familjeve të hershme dibrane, pasardhësit e tyre, njërin prind e kanë dibran e tjetrin tiranas. Ne sot duhet të nderojmë tiranasit që mirëpritën dhe hapën dyert e bujarisë për vëllezërit dibranë. Dibranët janë mirënjohës dhe kjo është shprehur vazhdimisht edhe nga pasardhësit e familjeve të dëbuara. Mirënjohja pasuron shpirtërisht personin që është mirënjohës”, vlerëson avokat Varoshi. Pjesëmarrësit në këtë event mirëpritën gjithashtu fjalët përshëndetëse nga Presidenti i Fondacionit “Fundjave ndryshë”, Aber Hajdari, nga kryetari i Këshillit të Komunës së Dibrës së Madhe Fuat Spahiu, nga znj. Mirela Bogdani, kryetare e Shoqatës “Tirana Intellectum” dhe nga z. Faik Nika, kryetari i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve të Malit të Zi.

MEMORIALI YNË

E mirënjohura Suzana Varvarica Kuka, me të drejtë do ta quante “Memoriali Ynë” këtë vepër monumentale “Në nderim të dibranëve të dëbuar që u pritën me zemër të hapur nga tiranasit”, që është një shenjë historike dhe artistike.

“Historikisht ai do t’u kujtojë të gjithë brezave të familjeve dibrane se trojet e tyre të origjinës, të parët e tyre u detyruan me forcë, dhunë dhe gjenocid t’i lënë prej politikave të mbrapshta sllave-evropiane, në fillim të shek. XX. Si dhe të gjithë së bashku nuk duhet askurrë të harrojmë mikpritjen e dyerve dhe zemrave të hapura të familjeve autoktone dhe të nderuara të Tiranës së asaj kohe. Artistikisht ‘Memoriali ynë’ u ndërtua me këmbënguljen dhe iniciativën e përshëndetur të shoqatës ‘Bashkësia dibrane’, në Tiranë e drejtuar në zemër, mendje dhe respekt kah nderimi për çdo dibran të Tiranës. Memoriali Ynë mori formën e tij origjinale prej idesë së arkitektit Afrim Shatku, prej Shkupi dhe skulptorit Ardian Pepa, pedagog në Universitetit të Arteve në Tiranë, si dhe përpjekjeve të gjithanshme të zotërinjve Bujar Kapexhiu dhe Saimir Shatku, të cilët drejtojnë kryesinë e Shoqatës ‘Bashkësia Dibrane’, në Tiranë”, tha znj. Varvarica Kuka në fjalën saj përshëndetëse. Ajo vlerësoi zgjidhjen artistike të Memorialit të frymëzuar nga fakte historike tashmë të shkruara në Historinë e Shqipërisë dhe të Dibrës.

Duke u ndalur në detaje të veprës, ajo tha se imazhi i këtij memoriali është frymëzuar nga arkitektura dhe urbanistika e asaj kohe të qytetit të Dibrës së Madhe, gjë e cila është harmonizuar me modelimin e imazhit të pikturës me titull “Refugjatët” e piktorit të shquar Abdurrahim Buza. Kjo zgjidhje monumentale ka përmbushur situatën historike të ngjarjes e cila përkujtohet sot në 110 vjetorin e saj.

Kjo shenjë monumentale, sipas znj. Suzana Varvarica Kuka, në ditët e sotme ka përmbushur kujtimin e dibranëve, që u masakruan rrugës për në Shqipëri, prindërve dhe gjyshërve tanë që mbërritën të vinin në Tiranë, si dhe detyrës sonë për t’ua treguar brezave arsyet e banimit dhe jetës së dibranëve në gjirin e Tiranës.

Në këtë linjë e vlerësoi këtë memorial të sponsorizuar nga Firma EHV me drejtues z. Luan Leka dhe znj. Meliha Leka, edhe prof. Afërdita Tonuzi. Ajo u ndal veçanërisht në pasurinë shpirtërore e artistike të dibranëve, të


reflektuara këto në pastërtinë, bujarinë, vlerat e trashëgimisë kulturore, të traditës etj.

Po ashtu, Presidenti i Unionit të të Burgosurve dhe të Persekutuarve Politikë, Besim Ndrejoni-Mjeshtër i Madh, vlerësoi këtë memorial si përjetësim të një historie sa të trishtueshme aq dhe madhore njerëzore. Trishtimi, sipas tij, se si dibranët përziheshin nga trojet e tyre shekullore nga pushtuesi serb dhe njerëzore madhore, pritja, hapja e dyerve nga vëllezërit tiranas që i pritën dhe i bënë bashkëvëllezërit e tyre, vëllezër të jetës. “Doku shekullor i shqiptarëve ka qenë besa, besa në përkrahje të vëllait, mikut dhe prandaj ka ngelur në historinë botërore se shtëpia e shqiptarit është e mikut dhe Zotit”, tha z. Ndrejoni. Ndaj dhe ky memorial përcjell ndër breza historinë se si tiranasit e urtë e të mirë pritën dibranë e dëbuar nga sllavo-serbët para 110 vitesh.

Përrurimi këtij memoriali historik u shoqërua me një drekë festive në ambientet e Fondacionit “Fundjave Ndryshe”, ku përveçse fjalës përshëndetëse të kreut të të Urtëve të Shoqatës “Bashkësia Dibrane” Tefik Jegeni, pjesëmarrësit ndoqën me interes dhe duartrokitën fuqishëm interpretimin me mjeshtri artistike nga artisti i mirënjohur kosovar Enver Petrovski, nga këngëtarët e shumëtalentuara Liri Rasha e Shqipe Zani, si dhe nga valltarët e Ansambllit Artistik “Hazis Ndreu”, Nderi i Kombit.

FLUTURON SHQIPJA MBI KORAB

Kompozitori i mirënjohur Edmond Zhulali bashkon zërat dibranë, Kapexhiu, Methasani e Ismail Keta në këngën himn “Kjo është Dibra maja-maja”



Televizioni prestigjioz Neës 24 promovoi në fillimin pandemisë Covid -19 (2020) një kompozim në një mënyrë ndryshe të këngës “Fluturon Shqipja mbi Korab”, të kompozitorit të mirënjohur Edmond Zhulali – “Mjeshtër i Madh”. Vetë Zhulali pohoi se ideja për risjelljen e këngës në këtë formë, ishte e gazetarit të njohur Dëfrim Met’hasani, ndërsa të gjithë personalitetet që këndojnë janë nga Dibra.

Ikona e gazetarisë sportive, D.Methasani që ka bashkuar zërin me interpretuesin virtuoz të kësaj kënge, Dritan Jashari në sa e sa promovime, si dhe kur ka moderuar takime deri edhe me praninë e krerëve të shtetit, pasi e kishte “bluar” për muaj të tërë në mendjen e tij, ia propozoi këtë variant E. Zhulalit, dhe ai nuk nguroi të hedhë në notat e pentagramit një rikompozim të tillë.

Bashkëpunimi që i frytshëm. Kënga himn që ka ngritur peshë zemrat e artdashësve, jo vetëm në sallën e pallatit të Kongreseve në Tiranë, por edhe në dhjetra takime të diasporës në hapësirën mbarëshqiptare në botë, tashmë përcillet fuqishëm edhe në youtube, e risjellë në një mënyrë ndryshe me artistë dhe personalitete të Dibrës, në këtë kohë pandemie.

Dhe ja, zërit të Defrimit, të demonstruar në sa e sa transmetime ndeshjesh, në dokumentarë e spektakle televizive, i bashkohet ai i një tjetër ikone të artit skenik.

Bujar Kapexhiu – “Nderi i Kombit”, unik, i veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë artdashësve e të shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të intepretimit e të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian, këtë radhë, me një vitalitet të rrallë, prezanton edhe zërin e tij melodioz në këtë këngë kushtrimi.

Pas tij, një tjetër zë i njohur, ai i kampionit të botës në kikkoks, Ismail Keta, një rast i rrallë, ndoshta unikal në historinë e sportit. U rrit me lavdinë e kombit, tani kombi lartësohet me lavdinë e tij. Ai ka një histori interesante edukimi dhe rritjeje. Karshi fshatit Koçaj, vendlindja e tij, vendi i luftërave legjendare të Skënderbeut, do të ishte modeli mendor udhëheqës në koshiencën e kampionit të botës. Në galeritë e kromit, në shpat të malit do të shfaqej imazhi epiko-heroik i minatorëve, karvani i të cilëve ngjitej në kollonat e puseve për të zbritur në nëntokë me kilometra, në kërkim për të nxjerrë nga barku i malit kromin e florinjte, duke të ngjarë si heronj legjendash. Ky mjedis që bashkon legjendën me të vërtetën do të farkëtojë tek Ismail Keta vyrtyte të mëdha. Gjithkush është ndjerë krenarë tek e ka parë atë t’i demostrojë këto vyrtyte në arenën e ndeshjeve, por edhe në intervista brilante nëpër televizione të vendit e të botës dhe në takime me presidentë, kryeministra e kryebashkiakë të Mynihut, Tiranës, Dibrës e Bulqizës. Dhe ja, tani na shfaqet edhe si këngëtar, i thjeshtë gjer në madhësi, mbresëlënës për qindramijëra shikues e teleshikues, falë bukurisë fizike e shpirtërore por dhe aftësive komunikuese me publikun, njësoj si përballë rivalëve shumë të fortë nga vende të ndryshme të botës, kur e ka kanë bërë edhe Mynihun të flasë shqip.

Të tre të përzgjedhurit e kompozitorit famoz Zhulali: Methasani, Kapexhiu e Ismail Keta, në akordancë të plotë me këngëtarët profesionistë

Dritan Jashari, Altin Sulku, Lundrim Paçuku e Muharem Borova. Kësisoj, libohoviti Edmond Zhulali, të cilin e lidhin shumë gjëra me Dibrën, këtë rikompozim të këngës “Fluturon shqipja mbi Korab” (që siç pohon vetë është ndër më të dashurat e tij), e bëri me shumë passion.

“Audio e çdo interpreteshi është bërë në shtëpi me celular dhe editimi i zërit ishte shumë i vështirë, por më dha shumë kënaqësi. Teksa shikoja Bujar Kapexhiun të këndonte me shumë pasion, më dha një ndjesi shumë të bukur. Edhe Ismail Keta kishte një pasion të jashtëzakonshëm, që tregon se nuk është thjesht një sportist i kampion bote, por edhe një patriot i madh”, shprehet kompozitori Zhulali. Sipas tij, realizimi i klipit ishte pak i vështirë, pasi audiot janë regjistruar nga shtëpia e secilit artist me celular.

Teksti i këngës “Fluturon shqipja mbi Korab” është shkruar nga i paharruari Naim Plaku, të cilin kritika letrare, si poet të këngës, e radhit përkrah Gjokë Becit e Lefter Çipës. Kjo edhe për faktin se teksteve të Naim Plakut janë lënda e parë e standardit më të lartë për këngëtarët e mirënjohur Arif Vladi, Shkurte Fejza, Haxhi Maqellara, Skënder Cala, Liri Rasha, Qerim Sula, Ilir Shaqiri, Selami Kolonja, Caje Poleshi, Sherif Dervishi, Vera Laçi, Dritan Jashari etj. Mjafton të kujtojmë se si janë ngritur peshë zemrat e mijëra artdashësve, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në skenat më presitixhioze të botës, kur kanë përjetuar zërin e tyre melodioz në interpretimin e teksteve të këngëve të N.Plakut: “O prite Azem Galicën”, “Një gërshet u la me gjak”, “Na kjojnë pushkët nëpër kulla”, “O i madhi Skënderbe”, “Përcolla ylberin”, “Mine mori Mine”, “Tinguj krenarie”, “Fluturon shqipja mbi korab”, etj.

Refreni i kësaj të fundit: “*Sillu shqipe nga kalaja/Kjo është Dibra maja-maja/Dibra pushkën e ka znat/Për Shqipërie për bajrak...*” të ngjall emocione të forta e të bën për vehte në çdo çast.

Është një këngë që të ngjall shumë dashuri dhe krenari, me të cilën iniciatori Methasani, si dhe kompozitori i shquar Zhulali synojnë të promovojnë Dibrën, historinë dhe vlerat e saj. Ata, sidhe Kapexhiu – “Mjeshtër i Madh” dhe “Nderi i kombit”, skenarist, regjisor, aktor e prezantues, dhe Ismail Keta, karriera e të cilit përmban ndershmeri e realizëm pa asnjë manipulim e përgënjeshttrim, me këtë këngë përcjellin mesazhin e dashurisë për atdheun.

“*Fluturo shqipe mbi Korab*”, është një këngë që sjell diamante të vërteta

nga folklori i zonës së Dibrës. Kjo këngë e interpretuar më parë me vyeritë nga Dritan Jashari ka ngritur peshë zemrat e mijëra spektatorëve në koncertet recital të tij, në Peshkopi, Tiranë, Dibër të Madhe, Selanik, Austri, Gjermani, Belgjikë, Itali etj.

Gjatë prezantimit të klipit të ri të kësaj kënge nëpërmjet një interviste me gazetëren e njohur Ola Bruka të Tv Neës 24, Edmond Zhulali i dërgoi dhe një mesazh të fortë gjithë politikës shqiptare, teksa i kërkoi të kthejë vëmendjen nga artistët, pasi janë pikërisht këta të fundit që bëjnë krenar vendin dhe popullin.

Okelio - Diaspora shqiptare, festë në fshatin e martirizuar!

VIÇISHTI, ATY KU KA MË SHUMË HERONJ SE DËSHMORË



- **Viktimë e vendimit famëkeq të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të 1913-ës, qe edhe fshati Viçishti i Dibrës, gjysma e njerëzve të gjakut e fiseve të të cilit mbetën në Dibrën e Madhe, si edhe të disa zonave tjera kufitare që ju aneksuan ish-Jugosllavisë. Për afro një shekull, u ndanë për së gjalli njerëz e familje të një gjaku e fisi**

Dhe si të mos mjaftonte kjo tragjedi njerëzore, sërish sistemi i diktaturës do të ndiqte politika përçarëse edhe për banorët e këtij fshati me histori të lavdishme.

Një ndër rastet e shumta të këtij kalvari është edhe Hasan Cami, ish bashkëluftëtar i Heroit të dy luftimeve Botërore Ahmet Cami, që me krijimin prej tij të çetës antifashiste të Gollobordës. Edhe Hasani ishte ndër 19 burrat e këtij fisi që për veprimtari patriotike u burgosën nga fashistët italianë në burgun famëkeq të Tiranës në prill 1941 (mes të cilëve katër pushkatohen dhe tetë të tjerë bien dëshmorë), por çuditërisht, ky pinjoll

i këtij fisi emërndritur, pas çlirimit arrestohet dhe dënohet me akuzën absurde të sajuar nga ish sigurimi famëkeq i shtetit diktatorial “agjitacion e propagandë”, dënim ky që do t’ju kushtonte rëndë edhe pjestarëve të familjes së tij që u persekutuan për vite e dekada të kohës së monizmit.

EMIGRANTI NGA VICISHTI, SI FAKTOR PËRBASHKIMI



Tetëdhjetë vjet pas atij akti barbar, Klodian Cami, (stërnipi i patriotit Hasana Cami), President i Shoqatës “Shqiponja” (të emigrantëve shqiptarë) në Reggio Emilia të Italisë, identifikohet si faktor përbashkimi, jo vetëm i Camëve, por i gjashtë fiseve: Cami, Lika, Xheka, Tola, Suma, Markja e Izvira, duke iniciuar dhe organizuar një festë madhështore mbrëmjen e 17 gushtit 2024 në oborrin e shkollës “Fasli Cami” në Viçishtin e Epërm, një fshat ky me bukuri të rralla natyrore, në prehërin e maleve. Dhe jo vetëm kaq, por siç do të shprehej me fjalën e tij artistike moderatori i këtij event, Mjeshtri i Madh Defrim Methasani: “Të gjithë ndjejnë kënaqësi dhe krenari njëherësh që janë pjesë e kësaj feste madhështore në fshatin që ka më shumë heronj e dëshmorë se sa shtëpi, në fshatin që ka nxjerrë dhjetra personalitete me rrezatim mbarëkombëtar, si ministra, deputetë drejtues institucionesh kryesore qëndrore, apo dhe kampionë Europe e bote në sporte të ndryshme, si vëlla e motër Tefta e Mois Cami. shkrimtarët e njohur Sakip, Shpëtim e Agron Cami, drejtoresha e QSU Tiranë, Prof. dr. Alma Cami, kampioni i botës në boks Adriatik Cami etj.

Po. Është vërtetë kënaqësi për mjeshtrin e moderimit dhe ikonën e gazetarisë sportive e të dokumentarit televiziv Methasani, të jetë pjesë e kësaj feste dhe ta moderojë atë, një traditë që po zgjerohet nga viti në

vit me kthimin e mërgimtarëve në vendlindje, investimin dhe kujdesin e tyre për aktivitete të bukura si ky i sotmi. Këtë kënaqësi dhe krenari do ta shprehë edhe kryetarja e bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri. Në fjalën e saj përshëndetëse ajo e konsideron Viçishtin një fshat me tradita të hershme kombëtare, me dëshmorë dhe heronj të shumtë, për shkak të natyrës dhe ndjenjës së fortë kombëtare, por edhe me të përndjekur politikë dhe me personalitete në fushën e arsimit dhe shkencës, dhe kjo histori ja shton përgjegjësinë për të bërë më shumë për infrastrukturën e mjedisin e këtij fshati.

Qytetarja e parë e Bashkisë Bulqize, znj. Festime Mjeshtri tha se e mirëpriti menjëherë ftesën për t’ju bashkuar dhe për të kontribuar për ta rregulluar shkollën që mban emrin e dëshmorit “Fasli Cami”, për këtë ditë festive. Ajo është edhe ish – nxënëse e kësaj shkolle, kështu që përgjegjësia e saj qe e shumefishtë, siç pohuan edhe organizatorë tjerë të kësaj feste. Duke përgëzuar Klodian Camin për jetëzimin e mallit dhe dashurisë për familjen dhe mbi të gjitha për institucionalizimin e kësaj feste, ajo ftoi banoret e 63 fshatrave të bashkisë Bulqizë të marrin shembullin e Viçishtit dhe ta shikojnë bashkinë si partnere.

I pranishëm në këtë festë edhe depueti demokrat Xhelal Mziu, ndërsa prshëndeti qindra pjesëmarrësit e në veçanti bijtë emigrantë të këtij fshati, mirënjohje të veçantë shprehu për Klodian Camin. Ai tha se ishte i entuziazmuar që ndodhej mes banorëve të fshatit historik të Viçishtit, në juridikisonin e njësisë administrative Gjoricë. Mziu vlerësoi egon e jashtëzakonshme të Klodian Camit për të maksimalizuar dhe transmetuar tek bashkëmoshatarët e tij çdo vlerë të Shoqatës “Shqiponja” në Reggio Emilia që ai ka themeluar dhe drejton prej dy dekadash (Ai është edhe sponsor i ekipit të futbollit “Shqiponja” që këtë vit arriti në kategorinë C1.).

DY MESAZHET E ISH MINISTRES SË ARSIMIT TEFTA CAMI

Qindra pjesëmarrësit që kishin mbushur oborrin e shkollës “Fasli Cami” ndoqën me interesim të veçantë dhe duartrokitën ngrohtësisht znj. Tefta Cami, bijë e këtij fshati, ish ministrja më jetëgjatë e arsimit, e cila me vendimarrjen e saj si ministre, ka kontribuar që të ndëtohet kjo shkollë.

Pasi falenderoi organizatorët për ftesën për të marrë pjesë në festën e emigracionit në fshatin e saj të lindjes, Viçisht, dhe pjesëmarrësit e shumtë

në këtë festë, ndër të tjeta ajo tha se kudo ku ka punuar është përpjekur, që të nderojë familjen e saj me tri breza dëshmorë të atdheut, farefisnin me 14 dëshmorë gjatë Luftës të Dytë Botërore dhe bashkëfshatarët e saj. Ajo evidentoi gjithashtu ndihmën për bashkëfshatarët, duke u ndërtuar e hapur shkollën e mesme “Fasli Cami”, për ujësjellësin dhe me të drejta studimi. Znj. Tefta Cami përgëzoj inisiatorin organizatorin kryesor të këtij aktiviteti, Klodi Remzi Camin, që është pasardhës i Beqir Camit, i cili ka marrë pjesë gjatë Luftës të Parë Botërore me Shaban e Fet dhe Dan Camin dhe e kanë varë në mes të Sofies Beqirin, si luftëtarë e patriot shqiptarë, që ka luftuar kundër forcave pushtuese serbe e bullgare. Klodi është pasardhës i Hasan Beqir Camit, që ka qenë bashkëluftëtar i komandantit të tij Ahmet Feta Camit, si dhe bashkëvuajtës në burg si antifashist gjatë viteve 1941-1942.

“Camet kanë qenë gjithmonë të bashkuar, kur mëmëdheu ka qenë në rrezik nga pushtuesit e huaj në të gjitha luftrat, për të mbrojtur vatanin. Prandaj po jap këtë mesazh: Mos shikoni fe e ndarësira, se feja e shqiptarit është shqiptaria!

Me që është festa e emigracionit, mesazhi i dyte është: T’i japim fund emigracionit! Pasuria, e ardhmja e çdo shqiptari është këtu në Shqipëri, sepse Shqipëria ka pasuri pafund tokësore e nëntokësore, klimë e turizëm malor e detar. Shqipëria do të bëhet vetëm me punën e përkushtimin e shqiptarëve. Vetëm në Shqipëri shqiptarët ndihen të barabartë e me dinjitet për punën që bëjnë. Vetëm në Shqipëri do të ndihen krenarë”, tha ndër të tjera ish – ministrja e Arsimit Tefta Cami.

80 VJETORI I SHKOLLËS “FASLI CAMI”

Fjalë zemre për këtë djalë të Viçishtit thanë në përshëndetjet e tyre edhe znj. Lirie Teodori, Drejtore e Shkollës “Fasli Cami” dhe Prof. dr. Shpëtim Cami, kryetar i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, djalë i këtij fshati dhe ish – nxënës i kësaj shkolle. Prof. Cami vlerësoi angazhimin e kryebashkiakes Festime Mjeshtri në mbështetje të Festës së Diasporës së fshatit Viçisht, si dhe përgatitjet për 80 vjetorin e Shkollës ‘Fasli Cami’, me synim krijimin e një muzeu të shkollës në muajin tetor të këtij viti që përkon edhe me 80-vjetorin e clirimit të atdheut nga okupatori nazifashist..

Fasli Cami, emrin e të cilit mban kjo shkollë lindi në nëntor të vitit

1912 në fshatin Viçish të Dibrës. Shkollën fillore 6 vjeçare e kreu në Internatin e Kastriotit të Dibrës nga viti 1920 deri në vitin 1926. Më 1927 u pranua në Shkollën Mbretërore. Në vitin 1931 u transferua në gjimnazin e shtetit në Tiranë dhe vazhdoi studimet në këtë gjimnaz deri në fundin e vitit 1932, kohë kur e përjashtuan se kërkoi të drejtën si dhe shfaqti shenja rebelizmi ndaj padrejtësive. Në këtë kohë Fasliu ishte në një shkollë me Mehmet Shehun, i cili më vonë në kujtimet e tij do të shkruante se s'kishte takuar në jetën e tij djalë më trim se një dibran me emrin Fasli Cami. Me shumë përpjekje u ripranua për të vazhduar studimet në shkollën normale të Elbasanit. Në janar u emërua mësues, në vitin 1939 u transferua në Gjoricë, ku shërbeu me nder, përgjegjësi dhe ndërgjegje deri më 6 prill 1943, deri në momentin kur fashistët italianë e vranë në kodrat e Gjoricës. Mësues e nxënës të Shkollës së Viçishtit, në këtë 80 vjetor të krijimit të saj ndjehen më krenar se kurrë që ajo mban emrin e mësuesit dëshmir Fasli Cami.

Prof. dr. Shpëtim Cami, në fjalën e tij vlerësoi gjithashtu dakortësimin me kryebashkiaken Mjeshtri për ide që duhen mbeshetur në çdo fshat, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë.

Pjesëmarrësit i përshëndeti gjithashtu kryetari i degës së LID për Maqellarën, gazetari e shkrimtari Osman Gjili, kampioni i botës për dy kategori në boks Adriatik Cami etj. Mësuesi veteran Avni Mera, ish – drejtor për 8 vjet i kësaj shkolle shprehu kënaqësi të veçantë që ndodehje mes ish dhjetra nxënësve të tij, sot në profesione e funksione të ndryshme në Bulqizë, Peshkopi, Tiranë e diasporë.

Kënaqësi të veçantë që ndodheshin mes djemve e vajzave viçishtash shprehën edhe nënkryetari i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, z. Musa Riçku, kryetari i degës së PD, avokat Shaqir Manjani, njëherësh anëtar i këshillit të Bashkisë Bulqizë dhe nënkryetari i këshillit të kësaj bashkie Z. Munir Sinani.

Në fjalët e tyre, emërues i përbashkët është mirënjohja për Klodian Camin, iniciator dhe organizator i kësaj feste mbresëlënëse. Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin “krenari”. Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet...E pikërisht në këtë shtrat ka ecur dhe ecën Klodian Cami, i përshtatur mirë me kohën, bujar, fisnik, humanist i

pashoq, intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që ka çarë në jetë me mençuri e sakrificë.

FESTA E VIÇISHTIT, ME RREZATIM NBARËKOMBËTAR

Festa e Viçishtit rizgjoj nostalgjinë e bnorëve të tij, veçmas atyre që jetojnë e punojnë jashtë Shqipërisë. Klodian Cami është njëri prej atyre djemve që kthen kokën pas, duke krijuar mundësinë e gëzimit e bashkimit të njerëzve përmes organizimit të kësaj feste të paparë në fshatin e tij.

Impresione ngjalli kjo festë edhe tek miqtë e tij të ardhur nga SHBA, Italia, Gjermania, Greqia, Gostivari e Dibra e Madhe.

“Uroj që kjo festë të përhapet në gjithë Shqipërinë”, thotë Gentian Shero nga Kavaja, kryetar i Shoqatës “Nënë Tereza”, në Trento të Italisë, sponsor dhe president i shkollës “Artur Lleshi” dhe ekipit të futbollit “Iliria” të emigrantëve shqiptarë në këtë rajon të Italisë. Urimit të tij i bashkohet edhe Bujar Tabaku, nga Kavaja që jeton në Parma. Ai thotë se me shembullin e tij, me shqiptarizmin e spikatur në drejtimin e shoqatës “Shqiponja”, Kloian Cami është bërë shembull frymëzimi edhe për Forumi e Guas Shqiptare, me presidente znj. Marsida Mediu që është bërë zëri i diasporës në Itali. Gentiani dhe Bujari na flasin me përzemërsi edhe për ndihmësën që Klodiani ka dhënë për shkollën shqiptare “Skënderbeu” me drejtor Durim Lika nga Manza dhe mëues Zamira Shkurti nga Lushnja, Sabri Kulla nga Durrësi, shkollë kjo ku mësojnë 65 nxënës, fëmijë emigratësh shqiptarë. Mirënjohje dhe respekt të veçantë për Klodin shprehën edhe Ibrahim Kolari në emër të diasporës shqiptare në Nju Jork, Miçe Duka, Kryetar i Shoqatës Kulturore Artistike “Dibra e Madhe”, Ismaili nga Gostivari, anëtar i shoqatës “Shqiponja”, Resul Uzini nga Gostivari, si dhe bashkëshortët Sugare dhe Gjovalin Suzaj nga Tropoja, Urimit të tyre të përzemërt për Klodian Camin, djalë e shqiptarisë në Itali i bashkohet edhe kunata e tij, Alma Skuka që ka ardhur nga Franca për të bërë disa foto nga ky fshat perlë e natyrës, si dhe Drita Ahmet Cami (Garuli) që kishte ardhur nga Gjermania.

“Sa i bukur duket viçishti këtë mbrëmje të 17 gushtit 2024. Ky vend është i shenjtë për ne. Është kënaqësi e veçantë që bëhemi bashkë, në këtë bashkim vlerash...Sonte jemi shumë më shumë nga sa e mendonim, por

duhet të ishim shumë më shumë... Këtu tek kjo shkollë me histori 80 vjeçare nisi sot ky takim që do jetë i përvitshëm”, thotë ndër të tjera i emocionuar protagonist i kësaj feste, Klodian Cami. Dhe në morinë e miqve të shumtë, përveçon mjekun Bajram Xheka dhe mësuesin veteran Fehmi Lika, ish kryetar i fshatit Viçisht, që që dhanë ndihmesë në organizimin e këtij event.

Atmosferën e kësaj feste e nderoi këngëtarja famoze Elda Berisha me këngën “Kuç e zi”. Jehona e vargjeve të saj “Ose sot ose kurrë/ na bashkon një flamur/ kuç e zi është Shqipëria/ është Kosova, Çamëria” jehuan fuqishëm grykës së Drinit të Zi e matanë kufirit në trojet shqiptare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Po ashtu edhe vargjet e këngës “Po ku ka si ti moj Shqipëria ime”, interpretuar mjeshtërisht nga vogëlushja Keisiana Duriçi, si dhe Evelina Shabani, mbesë e këtij fshati me zërin e saj brilant në interpretimin e këngëve popullore dibrane. Gjallëri i dhanë festës edhe valltarët e vegjël të Qendrave Kulturore të Fëmijëve Bulqizë e Durrës, si dhe artistët e mëdhenj të humorit, Mjeshtri i Madh Behar Mera e Genci Lleshi, me interpretimin e disa grimcave humoristike gazmore.

Gëzim, këngë, valle, hare... në këtë natë festive në festën e Viçishtit, fshatit të martirizuar nga pushtues të shumtë dhe nga diktatura komuniste, festë që mbyllet me zërin kushtrimor të Dritan Jasharit në këngën kushtrim “Fluturon shqipja mbi Korab...”

DITA E MAQELLARËS....



Maqellara, njësi më e madhe administrative e Bashkisë Dibër dhe e qarkut me të njëjtin emër, për të dytin vit radhazi përjeton ditë-festën e saj. Nismëtarë dhe protagonistë të kësaj dite, dy kolegë gazetarë dhe shkrimtarë të njohur, Osman Xhili dhe Setki Jashari. Prej disa ditësh ata ftuan nëpërmjet rrjeteve sociale intelektualë të zonës, vendas e me banim në Tiranë, Peshkopi e Bulqizë, si dhe emigrantë të ardhur për pushime në vendlindjen e tyre. Dhe ja, jo një e dy, por qindra bij e bija të kësaj zone, që kishin ardhur deri edhe nga Brukseli, Zvicra, Gjakova e Dibra e Madhe e RMV, do të “pushtonin” mesditën e 11 gushtit resortin fantastik të Shaban Beçës në fshatit Potgorcë, buzë Drinit.

RINGJALLJA E TRADITËS

Nën moderimin mjeshtëror të Defrim Methasanit – i njohur në gjithë vendin si dhe në hapësirën mbarëshqiptare, si ikonë e gazetarisë sportive dhe dokumentarit televiziv, por dhe si organizator i talentuar i eventeve të tilla, festa do të niste me performimin e disa valleve nga valltarë të Ansambllit Artistik “Dine Doda” të Muhurrit, nën ritmet festive të daulleve.

Në këtë perlë të natyrës turistike, Defrimi do të improvizonte mjaft bukur skenën rrethore, nga ku burrat e ulur këmbëkryq do të interpretonin këngën epike “Kjo është Dibra maja-maja”. Më pas do të intervistonte dhjetëra personalitete dhe të përhapte siç di vetëm Ai jehonën e mbresave të tyre.

Dhe ja, i pari Leonard Tase. Emblema e volejbollit modern që solli risi në fushën e volejbollit në Shqipëri dhe që njihet jo vetëm për kontributet e tij në sportin e volejbollit si lojtar apo organizator dhe më pas si trajner, por edhe për mbështetjen që gëzon në Evropë dhe me gjerë nga BVA – CEV – FIVB dhe krerët më të lartë të volejbollit në botë (si Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Volejbollit FSHV për afro dy dekada dhe si ish-këshilltar për Sportin i Presidentit Meta), do ta vlerësonte këtë fshat të Maqellarës si perlë të natyrës shqiptare, që sipas tij nuk ka të dytë për nga bukuria e hijeshia. Pikërisht, nga këtu do të jehonte zëri i artistes së mirënjohur Liri Rasha, dekoruar nga Presidenti i Republikës me titujt “Mjeshtër i Madh” dhe “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”. Me mjeshtri të rrallë artistike, ajo interpretoi për pjesëmarrësit në këtë festë disa këngë qytetare dibrane e kështu zëri i saj brilant jehoi si asnjëherë tjetër brigjeve të Drinit të Zi.

Pikërisht, këtu ku pothuajse ishte shuar tradita e këngës, Liri Rasha kontribuoi, jo vetëm si një zë i veçantë dhe interpretuese dinjitoze e këngës qytetare dibrane e asaj shqiptare në tërësi, por edhe me fjalën e saj të ngrohtë përshëndetëse për njerëzit e mirë të Maqellarës, duke e rritur kështu ndjeshëm entuziazmin mes të pranishmëve në këtë festë mbresëlënëse. Por, Defrim Methasani – “Mjeshtër i Madh”, që vetëm para pak kohësh organizoi suksesshëm eventin “Maqellara fest” me ndeshje volejbollit mes ekipit të vajzave të ekranit dhe atij të vajzave të gjimnazit “Fiqiri Dine” të Maqellarës dhe shoë spektaktolar me djemtë e raftingut, edhe në këtë festë të radhës do t’i kushtonte vëmendjen e duhur ndeshjes

së futbollit mes ekipeve të nxënësve maqellaras, organizuar përsosmërisht nga trajneri Nexhat Agolli. Kësisoj, kjo ditë feste mund të konsiderohet edhe si ringjallje e traditës me veprimtari nga më të larmishmet. Madje, nga këtu do ta merrte frymëzimin edhe poeti Demir Rusi, për të premtuar promovimin e dhjetë librave të tij, pikërisht te ky resort i mrekullueshëm.

Kësaj atmosfere festive pa dyshim që do t'i gëzoheshin edhe intelektualit i shquar nga Dardha e Pukës, Luigj Marku (i ati i ish- futbollistit të “Korabit”, sulmuesit Taulant Marku), ndërkohë që atë do ta ndizte dukshëm me zërin e tij magjepsës, Kole Martin Aramadhi, si dhe Afrim Kurtaga, Ver Kulla, Urim Asllani e dhjetëra personalitete tjera të kësaj treve. Ndërsa regjisori, skenaristi dhe aktori Aqif Ademi, ky bir i shquar i Maqellarës me banim në Tiranë, jo pa qëllim kishte zgjedhur për të interpretuar vargjet e këngës së Haxhi Maqellarës, “Jam krenar që jam dibran”. Me të njëjtën performancë u shfaq dhe u duartrokkit fuqishëm nga pjesëmarrësit edhe kaskadori i famshëm nga Dibra e Madhe Di Jashari.

Pjesëmarrësit ndjenë emocione të fuqishme, kur nga mikrofonit i moderatorit Methasani jehuan opinionet mbresëlënëse të sekretares së përgjithshme të Prefekturës Dibër, Znj. Donika Hysenaj, si dhe intelektualit të mirënjohur maqellaras, me rrezatim mbarëkombëtar Demir Osmani (babai i moderatores së mirënjohur të spektakleve televizive Arbana Osmani).

Shtrëngim duarsh e takim mjaftë miqësor nga organizatorët Xhili e Jashari edhe me pjesëmarrësit e familjes të bijës së Maqellarës, ardhur nga Gjakova, Luiza Bajraktari Stanica si dhe me princeshën e Bim Bulkut, Manjola Liana Bulku, ardhur nga Belgjika. Fjalë zemre prej tyre për këtë festë madhështore me premtimin se do të jenë të pranishëm edhe vitin tjetër.

Dhe pa dyshim, oratorët shprehën mirënjohje për administratorin e Njësisë Administrative Maqellarë, djaloshin simpatik Florian Lazri, jo vetëm për mbështetjen në organizimin e kësaj feste, por edhe për drejtimin e njësisë me vizion dhe përkushtim maksimal.

SHQETËSIMI I LIGJSHËM PËR MASIVIZIMIN E FESTËS

Ndërsa kanë vlerësuar atmosferën e festës, organizatorët e saj, Osman Xhili e Setki Q. Jashari nuk kanë nguruar të shprehin shqetësimin e tyre

të ligjshëm për masivizimin e saj. Dhe kanë të drejtë edhe për faktin se 22 fshatrat e Njësisë Administrative Maqellarë (Bllata e Poshtme; Bllata e Sipërme; Burimi; Çernena; Dovolani; Erebara; Fusha e Vogël; Gradeci; Grezhdani; Herbeli; Katundi i Vogël; Kërçishti i Poshtëm; Kërçishti i Sipërm; Kllopçishti; Kovashica; Pesjaka; Pocesta; Podgorci; Popinari e Vojniku) kanë nxjerrë me qindra personalitete të njohura lokale e kombëtare, të cilët jo vetëm që nuk duhet t'i mungojnë, por edhe t'i kontribuojnë kësaj feste. Ashtu si Osman Xhili që ka shkruar me fantazi e profesionalizëm të lartë dhjetëra reportazhe, portrete intelektualësh e sipërmarrësish shembullorë si dhe artikuj problemorë për Maqellarën, dhe biri i devotshëm i kësaj zone Setki Jashari, autor i dy romaneve mjaft të arrirë artistikisht, edhe bashkëqytetarët maqellaras me banim në Tiranë, të të gjitha profesioneve e moshave, duhet t'i bashkohen misionit të tyre. Këtë e shpreh si domosdoshmëri edhe Ramazan Ilnica, babai i dy gazetarëve të talentuar, Elisabeta dhe Eduard Ilnica. Ndërsa drejtuesit e veteranëve të Rrethit Dibër, kryetari Alush Stojku dhe ndihmësit e tij shembullorë Besnik Lami e Ilmi Cani, të ngazëllyer nga atmosfera festive, domosdoshmërinë e masivizimit të festës e shtrojnë edhe në aspektin e ndikimit të saj në edukimin patriotik të brezave. Dhe kanë të drejtë, sepse përveç veprimtarive kulturore e sportive, festa duhet të ndikojë edhe në evidentimin dhe promovimin e vlerave të historisë, të patriotëve e luftëtarëve të kësaj treve për liri e pavarësi kombëtare, të ngjarjeve e personaliteteve të LANÇ, traditës, arsimit e kulturës, që në këtë zonë, si askund tjetër kanë shkëlqim të rrallë. Do të mjaftonte për këtë qoftë edhe sikur dikush nga historianët e zonës (që nuk janë të paktë) të zhvillonte një bisedë për profilin e personalitetit të shquar Iljaz Pashë Dibra (Qoku), i cili më 10 qershor 1878 kryesoi mbledhjen e parë të Lidhjes së Prizrenit dhe që njihet për kontributin e tij madhor për çështjen kombëtare shqiptare.

Gjithsesi, misioni i miqve e kolegëve të nderuar Osman Xhili e Setki Jashari duhet konsideruar i përmbushur edhe për këtë fillim të mbarë. Sepse Maqellara me më shumë se 14.000 banorë, që gjendet 22 kilometra larg kryeqendrës së Dibrës shqiptare, Peshkopisë dhe vetëm 5 kilometra larg Dibrës së Madhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me resurse të shumta natyrore e njerëzore (e konsideruar si hambari apo “Myzeqeja” e Dibrës) e meritonte një festë të tillë.

DIASPORA DIBRANE, FESTË NË DIBËR TË MADHE

- “Bashkim vlerash”, qe emëruesi i përbashkët i përshëndetjeve të kryekomunarit të Dibrës së Madhe, dr. Hekuran Duka dhe deputetëve të parlamentit shqiptar Xhelal Mziu i PD e Lavdrim Krashi i PS, në takimin e diasporës dibrane në vendlindjen e tyre



Pushtimet e gjata truke e serbo-bullgare, dhe veçanërisht vendimet antishqiptare të Kongresit të Berlinit (1878), të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-1913) dhe të Konferencës së Paqes në Paris (1919) që i ndanë dy Dibrat, duke i lënë për mëse një shekull që të kufizohen me vetveten, i detyruan dibranët e dy dibrave të emigrojnë anë e mbanë botës. Por kënga e artistit të madh Haxhi Maqellara “*Me ma falë m’u gjithë botën, jo me Dibrën nuk e ndrroj...*” është dëshmia më e qartë e dashurisë së pamatë që dibranët, të shpërndarë nëpër botë si zogjtë e shqipes, mendje e shpirt i kanë në vendlindjen e tyre. Dhe këtë po e dëshmojnë edhe me takimet festive që ata organizojnë çdo fund gushti në Dibër të Madhe, në koncertin e madh festiv “*Prej dibranëve, për dibranët*“, siç qe edhe ai i 23 gushtit të viti TB 2024. Po, më së miri këtë e dëshmoi Haxhi Maqellara, ky personalitet i spikatur i historisë së muzikës së pastër shqipe, në repertorin e të cilit gjen shprehje dashuria për vendlindjen, atmosfera e dasmës dibrane, përshkrimi i dashurisë rinore, mbi të gjitha malli i mërgimtarit.

Nëse Artisti i madh, Maqellara, mirëpritet e duartrokitet kudo për

zërin e tij melodioz krejt të veçantë kur interpreton këngën hit “Jam krenar që jam dibran”, me vargjet: “Në çdo cep të botës./ Unë kudo që shkoj,/ Emnin tand moj Dibra nan./Jo nuk e harroj/”, edhe më i vjetri këngëtar i kësaj treve, Sulejman Borova, i shoqëruar nga djali i tij, Muharremi, i ngrenë peshë zemrat e publikut artdashës dibran me refrenin e këngës së tyre “Dibra, zonj do jetë gjithmonë...”




VEÇ NJË DIBËR KA SHQIPËRIA...

Dibra e Madhe dhe Dibra e Vogël, apo Dibra e Epërme dhe e Poshtme kanë qenë dhe janë një. Vendi i trimërisë, i besëlidhjes, i dokeve, zakoneve dhe urtësisë, i Grykës së Radikës, i “Nandë Maleve” historike dhe i mençurisë, i fjalës dhe i pushkës, vendi ku dështoi çdo ekspeditë e ushtrive pushtuese dhe vendi që do të mbahet mend përgjithmonë në memorien e kombit shqiptar, për atë që i ka dhënë në çdo kohë dhe në çdo epokë kombit tonë, sepse gjithmonë kur ka pasur nevojë kombi ynë, dibranëve u kanë kënduar pushkët nëpër kulla. Dhe ja, sa bukur përçohet e transmetohet ndër breza historia e qëndresë nëpërmjet këngës “Veç një Dibër ka Shqipëria“, të interpretuar mjeshtërisht nga këngëtarët profesionistë Dritan Jashari e **Qanie Muça - Emini**. Zëri i tyre kushtrimor buçiti si asnjëherë në këtë qytet të qytetërimit të lashtë, në refrenin e kësaj kënge që do të ngrinte peshë zemrat e artdashësve të shumtë: “Veç një Dibër ka Shqipëria./Krenari o me Nandë Malet./Jo nuk ndahen kastriotët,/Dibër e Vogël e Dibër e Madhe...”

Këtë mesazh do ta përcillte më së miri Mjeshtri i madh Arif Vladi me interpretimin mjeshtëror të këngës së Suf Murre, kur kulmoi me refrenin *“Nam po len pushka e Luznisë/, kundra mbretit të Turqisë,/ me i zbardh faqen shqiptarisë...”*

Në funksion të edukimit patriotik të brezit të ri që edhe kënga *“Dibër ishe, Dibër mbete”* e interpretuar nga raspsodët dibranë Mislim Strkçani, Lulzim Lela e Bajram Klobuçishta. Po ashtu edhe këngët *“Amaneti i të parëve”*, *“Moj fusha e Korabit; “Jo nuk shuhet Dibra”*, *“Suf Xhelili ...”* etj.

Grupi Artistik i Shoqërisë Kulturore *“Dibra e Madhe”* me President të mirënjohurin Miçe Duka, shndërruar tashmë në një institucion interpretues dhe përçues të vlerave më të mira kulturore-artistike, me repertorin e tij mjaft të larmishëm, edhe në këtë koncert festiv luajti rol edukativ për publikun. Madje grupi i burrave, veshur me kostumet kombëtare të bukura e të larmishme të zonës së Dibrës, do të ngrinte peshë zemrat e artdashësve të shumtë kur këndoi me çifteli vargjet e këngës ***“Ja ke zbardh faqen vatanit”: “Ti moj Dibra e Kastriotit,/ djep pas djepi e mot pa motit/...në themel, besa e burrit/, n’ballin tand shqipja e flamurit...”*** Artdashit vlerësuan gjithashtu interpretimet dhe performancën e shkëlqyer artistike të këngëtarëve Klea Çutra, Medi Puci, Leda Ida, Valdrin Tollumi, Xiu (Evzi Kaja) dhe Adnanit nga Reka e Epërme, në interpretimin e këngëve *“Moj Fusha e Korabit; “Kur bjen fyelli e çiftelia, “Dasma e malësorit”*, *“Nga ke ardh ti vash a smë thue”* etj.



KAMPIONI BOTËROR GJETAN KETA VISHET ME KOSTUMIN KOMBËTAR

I pranishëm në këtë natë festive, kampioni i botës në kikboks dhe boks Gjetan Keta, do të provonte emocionet e dhuratës më të çmuar që do të merrte nga Presidenti i Shoqatës Kulturore “Dibra e Madhe” Miçe Duka. Teksa është ngjitur në skenë për të marrë një Mirënjohje të çastit, kampioni Keta është ndjerë i impresionuar, kur vetëm pas pak çastesh ai do të vishte xhamadanin e qëndisur bukur nga mjeshtrat e Dibrës së Madhe.

Njëzetë e katër fitore në 27 ndeshje në kikboks dhe boxing (20 me KO), e rendisin atë me më të mirët e botës në këto sporte. I rikthyer pas 6 vitesh mungesë “Tajsoni i bardhë”, kampioni shqiptarë – euroaziatik Mike Gjetan Keta, kurrësesi nuk do t’i zhgënjente mijëra tifozët që ndoqën ndeshjen e tij të radhës të shtunën e 27 korrikut 2024 në Tetovë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo për faktin se në arenën e ringut, Ai fitoi që në raundin e parë me knockout përballë kolumbianit Jose Miguel Torres.

Gjithsesi, ai do të shprehej se *“vlerësimi që më bëhet në këtë manifestim të shkëlqyer kulturor këtu në Dibër të Madhe më motivon për një tjetër fitore të ndeshjes së boksit që do të zhvilloi në fund të nëntorit në Londër”*.

FJALA ARTISTIKE MJESHTËRORE E MODERATORËVE METHASANI E PEJAZITI

Më të larmishëm e bënë këtë koncert me fjalën e tyre artistike, ikona e gazetarisë sportive dhe dokumentarit televiziv Defrim Methasani dhe gazetarja e mirëmjuhur dibrane Valbona Z. Pajaziti, me kontribut të veçantë publicistik në mediat e Shkupit, që si moderatorë të këtij spektakli madhëshor përcollën jehonën e natës së 23 gushtit 2024, që ishte e të gjithëve dhe veçanërisht e vëllezërve e motrave tona që janë në emigrim. Ndaj dhe urimi, gëzimi, të gjitha lutjet, të gjitha këngët, vallet e meloditë iu dedikoheshin vetëm atyre që mendjen dhe shpirtin e kanë këtu, në Dibërën e Madhe.

Ndaj dhe mesazhet që përcollën në fjalët e tyre përshëndetëse kryekomunari i Dibrës së Madhe Dr. Hekuran Duka si dhe dy deputetët dibranë në parlamentin shqiptar, Xhelal Mziu i PD e Lavdrim Krashi i PS, patëm si emërues të përbashkët këtë bashkim vlerash. Sepse Dibra e

Madhe po bëhet dhe më e Madhe nëpërmjet Rrugës së Arbërit. Kjo rrugë iliro-arbërore prej 75 km, rrugë (ndër)kombëtare e zhvillimit ekonomik e kulturor dhe bashkimit kombëtar të dibranëve e shqiptarëve ka shkurtuar aq shumë distancat kilometrike e politike, sa që të duket sikur Dibra me Tiranën janë vetëm një kafe larg... Këtë gëzim e shpreh edhe Baki Halili, një ndër mjekët më të mirë të Dibrës së Madhe, tashmë në pension, por që ka shërbyer edhe si drejtor i spitalit të këtij qyteti. Ndërsa mësuesi veteran Hysen Kosovrasti, njëherësh shkrimtar i njohur, i gëzohet faktit të ruajtjes së traditës dhe përcimit të vlerave tona shpirtërore nëpërmjet këngëve e valleve popullore.

Me emocione të veçanta e përcollën këtë natë feste madhështore edhe Hazis Hodaj, drejtor i festivalit “Hasi jehon”, koreografi i mirënjohur kosovar Dilaver Kryeziu, Sekretari i përgjithshëm i Shoqatës “Bashkësia dibrane” në Tiranë, Prof. dr. Saimir Shatku, si dhe gazetari e mederatori i mirënjohur i TV Klan Spartak Koka..

PAK FJALË PËR ORGANIZATORËT E SPEKTAKLIT

Ndonëse financuese e këtij spektakli ishte komuna e Dibrës së Madhe, organizimi i këtij koncerti me titullin sinjifikativ “*Prej dibranëve, për dibranët*”, ka një emër. Ai është Miçe Duka – Kryetar i Shoqatës Kulturore Artistike “Dibra e Madhe”. Kësisoj historia riciklohet. Atë që bënë burrat e shquar të Dibrës së Madhe me grupin e dikurshëm artistik famoz “Liman Kaba” po e ripërtërin Miçe Duka. Janë të rrallë burrat si Ai, që edhe në këto kohë të vështira kontribuojnë për ringjalljen e traditës. Po. Organizatori i gjithë kësaj ndodhie kulturore ishte Miçe Duka, personi, i cili punoi ditë e natë për të realizuar një shfaqje madhështore që do të mbahet mend gjatë. Vlerat e këtij personaliteti të Artit e Kulturës sonë kombëtare do t’i evidentonin, përveçse moderatorët Methasani e Pejaziti edhe Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe Hekuran Duka dhe deputetët e Parlamentit shqiptar Lavdrim Krashi e Xhelal Mziu, si dhe drejtuesit e festivaleve “Strugë Jeho” e ” Hasi Jehon:”.

Pjesëmarrja e dhjetra personaliteteve të diasporës, e Z.Muharrem Gjoka – Mjeshtër i Madh, Qytetar Nderi i Qarkut Dibër dhe President i Ansambllit Artistik “Hazis Ndreu” – Nderi i Kombit, regjia e përsosur nga Mjeshtri i Madh, Llesh Nikolla, i dhanë dimension tjetër kësaj ngjarje të

bukur dhe të madhe artistike, që në fakt i dedikohet diasporës dibrane në SHBA, Angli, Gjermani, Turqi, Itali, Kanada, Australi... Kënga, vallja, meloditë, këtë natë të madhe e të paharruar të 23 gushtit 2024 shkonin për emigrantët shqiptarë kudo në botë.

Artadashësit e shumtë, që kishin mbushur sheshin para pallatit të Kulturës të qytetit të Dibrës së Madhe shpërthejnë në duartrokitje të fuqishme kur në mesazhet e përfaqësuesve të pushtetit legjislativ e vendor të dy Dibrave, të këtej e andej kufirit, vlerësohet maratona kulturore-artistike “*Dibër ishe, Dibër mbete*” që do të mbyllet nga grupi i valltarëve të kësaj shoqërie kulturore, e njohur për dhjetëra trofe e çmime mbarëkombëtare e ndërkombëtare. Edhe në këtë manifestim të shkëlqyer artistik ata do të fitonin mirënjohjen e publikut për përkushtimin, shpirtin artistik dhe talentin që shpalosen në interpretimin e disa valleve me motive nga krahina të ndryshme të Shqipërisë.


LURA DHE PERSONALITET E LURËS NË NJË VEPËR ENCIKLOPEDIKE

- Prof. Dr. akademik Shaban Sinani: “Figura e Mark Ndreçë Vladit, me historinë e origjinës, të lidhjeve familjare, të vështirësive të rritjes e të formimit, të pjesëmarrjes në luftën çlirimtare si antifashist, të përgjegjësive që mori në një prej kohërave më të vështira – në vitet e mëkëmbjes së pushtetit që doli nga lufta dhe të mbrojtjes së tij prej ndërhyrjeve nga jashtë e nga brenda, ka qenë më se e mjaftueshme për një monografi”

Në harkun kohor të një dekade (2010-20200) gjer në frymën e fundit më 20 dhjetor 2020, i ndjeri Dine Kaca, i njohur në gjithë Dibrën e më gjerë për vlerat e tij njerëzore dhe intelektuale që mishëronte e përçonte kudo, do më kontaktonte që nga Italia dhe për çdo verë që kthehej për pushime në Tiranë, për të më njohur me angazhimin e tij për të shkruar dhe botuar një monografi për Mark Ndreçë Vladin e Lurës. E kishte obligim si mik i kësaj familje emërndritur për t’i dhuruar Lurës dhe lurjanëve një vepër enciklopedike, që ndonëse në epiqendër do të kishte Mark Ndreçë Vladin, në tërësinë e saj do të ishin Lura dhe personalitetet e kësaj treve me histori të lavdishme.

Aktualisht, unë dhe Lenin Vladi e familja e tij e madhe, ndjehemi disi të lehtësuar që këtë angazhim të Dine Kacës e ka përmbushur më së miri akademik Preng Vorfi, me përgatitjen dhe botimin e veprës “*Heroi i heshtur i kohës, Mark Ndreçë Vladi i Lurës*” që do të promovohet në Akademinë e Shkencave, të shtunën më 27 Maj 2023, ora 10.00.

Kjo monografi është e një rëndësie të veçantë edhe për faktin se ka ekspertizën e Prof.dr.akademik Shaban Sinanit – Sekretar Shkencor i



Akademisë së Shkencave të RSH, i cili në parathënie, ndër të tjera shkruan se: *“Libri i Preng Vorfit, kushtuar figurës së Mark Ndrec Vladit, është shkruar me një dashuri të shkëlqimtare për personalitetin të cilit i është dedikuar; për historinë e vendlindjes së tij, Lurës, një mrekulli natyrore e njerëzore, një rezervat virtutesh e visaresh; për trashëgiminë historike e kulturore që ka ndërlidhur Mirditë e Dibër, Mat e Lumë, me Lurën si krahinë “më vete e me të tjerë”. Figura e Mark Ndrecë Vladit, me historinë e origjinës, të lidhjeve familjare, të vështirësive të rritjes e të formimit, të pjesëmarrjes në luftën çlirimtare si antifashist, të përgjegjësive që mori në një prej kohërave më të vështira – në vitet e mëkëmbjes së pushtetit që doli nga lufta dhe të mbrojtjes së tij prej ndërhyrjeve nga jashtë e nga brenda, ka qenë më se e mjaftueshme për një monografi”.*

Parë nga ky këndvështrim, autori Preng Vorfi e ka përmbushur më së miri misionin e tij, duke na sjellë nëpërmjet referencash, faktesh e dokumentash arkivore tejet bindëse, jo vetëm profilin e personazhit të veprës së tij, por në tërësi Lurën dhe personalitetet e saj që zënë vend nderi në panteonin e vlerave. Kështu ai evidenton historinë e Lurës në dokumentat e kohës, gjurmët e lashta të jetës në Lurë, toponimet, gjetjen e 15 monedhave bizantine në Kepin e Xhitetit, në fshatin Arrëmallë, që tregon për zhvillim ekonomik të trevës; Historinë interesante të Lurës, sidomos gjatë periudhës së Skënderbeut, kur lurasit u përfshinë gjerësisht në luftë kundër pushtuesit ottoman; Lurën si krahinë e fundit të islamizuar në Shqipëri; qëndresën e paepur të lurjanëve ndaj pushtuesve turq, serbë e austrohungarezë dhe kontributin gjatë LANÇ.

PATRIOTË, LUFTËTARË E PERSONALITETE TË LURËS

Referuar të drejtës zakonore, autori sjell në vëmendjen e lexuesit Pesë Kararet e Lurës që nuk janë gjë tjetër veçse Pesë Ligje dhe disa akte nënligjore, që zbatoheshin nga 12 Pleq, 12 Çekiçë e 6 Dhetarë dhe që ishin: KARARET E BESËS, BARAZIA, RRAGJET, BIMËT E GJËJA E GJALLË, si dhe TROJET.

Preng Vorfi paraqet në këtë vepër me artin e tij të fjalës patriotë, luftëtarë e personalitete të Lurës si: Kol Bib Doçi; Dom Nikoll Kaçorri – nënkryetar i qeverisë së Vlorës, Ded Mardeda (Vladi); Gjetan Loka; Ibrahim Gjoçi; Hasan Ajazi; Hasan Kaci, Xhemile Gjogjegja e Gjok Doçi, Hero i Popullit;

Ndrecë Mark Vladin, mjekun e humanistin që fitoi zemrat e lurjanëve; Lenin Mark Vladin, ushtarakun që shërbeu me dinjitet për shtetin shqiptar; Ded Mark Vladin, oficerin që la mbresa në artilerinë bregdetare nga Saranda, Kepi i Rodonit, Lezhë e Shkodër, e dhjetra e dhejtra të tjerë që kanë bërë emër, jo vetëm në Lurë e Dibër, por në gjithë Shqipërinë.

PERSONALITETE TË HUAJA E TË VENDIT TONË PËR LURËN

Madhështinë e kësaj treve autori e paraqet edhe nëpërmjet personaliteteve të huaja e të vendit tonë për Lurën, si: Edit Durham, Franc Nopçe, Loro Mihaçeviç, Margaret Hacluck, koloneli britanik Maklin, Dom NIKOLL KAÇORRI, Dritëro Agolli, Ismail Kadare e të tjerë, të cilët na kanë lënë shumë burime e dokumente për Lurën..

Kështu, nëse misionarja angleze **Edith Durham**, shkruan në librin e saj “Brenge e Ballkanit” se: “...Lura mbetet model shumë i mirë i tolerancës fetare” dhe se sipas saj: “Lura, është Bajraku kryesor i grupit të tmerrshëm të Dibrës (Tigrave të Dibrës), siç e quajnë edhe bashkatdhetarët e tyre myslimanë”, patriarku i letrave shqipe **Dritëro Agolli**, duke vizituar Lurën, shkruan: “Kur arrita në Lurë, para meje shtrihej një botë tjetër, një botë e gjelbër në të errët, të gjelbra ishin livadhet dhe të gjelbra e të errëta ishin pyjet. Shkëmbinjte e bardhë dhe të kuqërremtë dukeshin si një mur i madh, për të mbrojtur këtë thesar. Dhe ky mur, në të vërtetë, fshihte thesare”.

Ndërsa shkrimtari ynë i madh **ISMAIL KADARE**, në shkrimin e tij “Një mbrëmje në Lurë”, në vitin 1967, shkruan: “Rruga kalon midis kodrave të buta, të gjelbra. Majë kodrave ngrihen kullat e gurta malësore; dritare të vogla, të ngushta, frëngji, sharapollë për të luftuar. Përderisa nuk mund të hynte bashkë me rrezet e diellit dhe plumbi, atëherë... ..Mbi ato frëngji ka shtirë ai që ndodhej përjashta, nga ato frëngji është mbrojtur ai që ndodhej brenda. Dhe, të dy, ndodheshin mbi të njëjtën tokë, mbi tokën amtare. Tani frëngjitë heshtin. Krismat gjakmarrëse po zhyten dalëngadalë në harresë. Ato nuk janë fshehur në katet e ulëta të ndërgjegjes, që të shpërthejnë një ditë përsëri, ato po shkulen njëherë e përgjithmonë nga psikika e malësorit tonë. Asnjë forcë nuk mund ta shkulë nga ndërgjegjja e malësorit gjakmarrjen. As ligji, as arti, as përpjekjet e intelektualëve të ndershëm. U desh një tërmet i tillë, si Lufta Nacionalçlirimtare, për të shkundur këtë etikë të tmerrshme”

MARKA NDREC VLADI, “QYTETAR NDERI” I LURËS

Autorit nuk i kanë shpëtuar paparendësit e personazhit kryesor të vepërës së tij, duke evidentuar: historinë me lavdi të Ndrecë Nikollë Vladit; Mara Ndue Vladin (Nëna e Marka Ndrec Vladit), e cila duke qenë bijë e një familjeje e fisi të dëgjuar në Lurë, e martuar me Ndrec Nikollë Vladin, një burrë trim e i zgjuar i fisit Vladi, një fisi nga më të vjetrit në Lurë, mbeti një zonjë fisnike, që përballoi të gjitha vështirësitë e asaj kohe...dhe për të mbrritur në fillim të gjysmës së dytë të shekullit XX, kur në Lurë shndrit një meteor, që do të rrezatojë ndër vite si Hero i Heshtur i ditëve tona. Ai është MARKA NDREC VLADI, i cili në Lurë bëri punë të mëdha për vendlindjen e për fshatin dhe për këtë, armiku e vrau në kulmin e rinisë. Ndaj nuk është rastësi që në vlerësim të kontributit të tij, Këshilli i Komunës Lurë, me VENDIM Nr. 94, datë 18.5.2015, i ka dhënë titullin “QYTETAR NDERI”, ZOTIT MARKA NDRECA (Vladi), pas vdekjes, me motivacionin: “Si trashëgimtar i denjë i një fisi me vlera patriotike e atdhetare, që u aktivizua me trimëri në LANÇ, për çlirimin e vendit tonë nga pushtimi nazifashist, ishte ndër organizatorët e parë të ngritjes 91 Heroi i heshtur i kohës – Marka Ndrec Vladi i Lurës së pushtetit të pas luftës në Lurë, pjesëmarrës direkt në rindërtimin e vendit të shkatërruar, përkrahu në ato ditë të vështira disa luras, që, nga regjimi politik i kohës, konsideroheshin me qëndrim të keq politik armiq, dhe mundësoi shpëtimin e disa jetëve të njerëzve në Lurë e jashtë saj, derisa dha edhe jetën e vet në moshën e rinisë, në krye të detyrës që i ishte caktuar”.

Siç theksova edhe në fillim të fjalës time, më vjen mirë që autori Preng Vorfi, për të na dhënë sa më të plotë figurën e Mark Ndrec Vladit, i është referuar edhe shënimeve të Dine Kacës, që shërbeu si kuadër I lartë, drejtues politiuk në Sllovë, Lurë, maqellarë, kryetar lokaliteti në Zall Dardhë e Përgjegjës Grupi I instruktorëve në Komitetin e Partisë Dibër.

RRUGËTIMI I GJATË I MARKA NDREC VLADIT NË DETYRA TË RËNDËSISHME

Dine Kaca, si kuadër e drejtues-politik, me emër e përvojë në Dibër, kishte dëshirë të madhe të shkruante një libër me shumë vlera për Dibrën, ku në qendër të kishte si objekt “veprimtarinë dhe historinë e Marka Ndrec

Vladit dhe të bashkëshortes së tij Dila”. Autori Preng Vorfi, materialet e Dine Kacës i ka trajtuar siç i ka në shënimet e tij, duke ruajtur autenticitetin e tyre nga origjinali. Dhe ja çfarë shkruhet ndër të tjera në shënimet e Dine Kacës:

Rrugëtimi i gjatë i Marka Ndrec Vladit në detyra të rëndësishme dhe kontributet që dha gjatë Luftës Nacionalçlirimtare deri në çlirimin e plotë të vendit dhe në vitet e para të periudhës së pasluftës, në kryerjen e reformave dhe të aksioneve për të zgjidhur emergjencat për Lurën, pjesëmarrja e tij aktive për ndërtimin e Shqipërisë së Re dhe periudha si oficer i Sigurimit të Shtetit, janë një dëshmi e gjallë e njeriut që e lidhi gjithë jetën e tij për t’i shërbyer deri në çastet e fundit të jetës Atdheut e shoqërisë shqiptare. Në karakterin e Marka Ndrecës lindën dhe u formuan, lulëzuan dhe u demonstruan virtyte e cilësi të rralla: dashuria e përkushtimi që Marku kishte për Atdheun, për t’i shërbyer atij edhe me sakrificë supreme. Te Marka Ndreca ishin çimentuar guximi dhe trimëria, mprehtësia dhe nuhatja, gjakftohtësia dhe shpejtësia e manovrimeve për zgjidhjen e situatave në kohë lufte e paqeje. Ai pati krijuar marrëdhënie të mira me të gjitha grupmoshat, që nga fëmijët e shkollave e deri te të moshuarit. Zotëronte informacione të hollësishme e të gjithanshme, realiste dhe, mbi këtë bazë, ai vepronte me kurajë, duke marrë vendime të drejta, të cilat i zbatonte në kohë në vendin e duhur. Karakteri e patriotizmi i Marka Ndrec Vladit kishte një bazament me themele të qëndrueshme. Ai as nuk shitej tek të tjerët dhe as nuk blihej, qëndronte njeriu më me besë, që e bën të fortë e më të besueshëm te njerëzit, i cili fitoi zemrat e tyre. Gjatë luftës bëri më shumë se partizani partizanëve. Në fillim të vitit 1942, në bashkëpunim dhe me ndihmën e Gjok Doçit, Marka Ndreca në shtëpinë e tij krijoi grupin apo njësitin e parë të rinjve antifashistë për Lurën. Kulla e Marka Ndrecës u bë shtëpia e parë ilegale në Lurë, kur Gjok Doçi vinte nga Shkodra e bënte propagandë kundër regjimit fashist. Marku dha një kontribut të madh në rrugën e Brigadave III – IV S në të gjitha veprimet e tyre për çlirimin e Lurës e të Mirditës, si ndër lidhës e informator, kreu shumë takime me krerë e kuadro të luftës në zonën Fan-Mirditë. Pas çlirimit, Marku iu besuan detyra me rëndësi, si: kryetar i Frontit për Lurën, anëtar i lokalitetit, drejtues i Partisë për Lurën dhe detyra të tjera në Komandën e vendit, në Lurë e Selishtë. Në kohën kur mori de juro e de fakto

detyrën e oficerit të Sigurimit të Shtetit, Marka Ndreca do të jetë njeri më i besuar për të ndihmuar shumë lurjanë që kishin hyrë në rrugën qorre. Ai arriti t'i bindë dhe ata të largohen nga rruga e gabuar ku ishin futur. Marka Ndreca, duke qenë një kuadër i aftë, diti të punojë me të gjitha shtresat e popullit, me individë të gënjyer, që nuk kishin kryer krime dhe i ktheu në rrugën e mbarë, por u bëri thirrje edhe krerëve që ishin bashkuar me armiqtë dhe vepronin bashkë me bandat kundër pushtetit popullor. Rasti më tipik për Marka Ndreca është puna e madhe e tij në Selishtë, në luftë kundër bandave, me radiolojën "LIQENI I VAJKANIT", ku u kapën dhe u shpartalluan 10 banda deri në fund, me likuidimin e bandës famëkeqe të Hamit Matjanit. Marka Ndreca, me aftësitë e tij, ndihmoi një burrë fisnik në Selitë të Mirditës, Preng Gjok Dedën, që e largoi nga bandat, të cilit iu fal jeta dhe u kthye në familje me tre djemta. Në misionin e ri dhe të fundit që Marka Ndreca iu dha në fundvitin 1953, duke hyrë viti 1954, nga Dega e Brendshme e Dibrës me Degën e PB të Mirditës, ai përfundoi tragjikisht në mbrëmjen e 1 janarit 1954, duke rënë në krye të detyrës, vetëm 500 m larg shtëpisë së tij. Kjo ishte një vrasje e pastër politike e tipit UDB, që ka lidhje për shkak të detyrës, për faktorë e motive politike dhe të aktivitetit të tij të gjithanshëm. Ceremonia mortore ishte madhështore. Mori pjesë gjithë Lura, burra të ardhur nga Reçi, Dardha e Selishta, erdhën të shumtë edhe nga Mirdita. Në ceremoninë e përmortshme qënrim burror mbajti edhe nëna e tij Dila Marka Ndreca. Ajo ishte një grua e veçantë, me kontribute të jashtëzakonshme gjatë Luftës, përkrah Marka Ndreca. Këtë e tregoi me pritjen e përcjelljen e partizanëve, në aksionet lokale e kombëtare për zhvillimin e Lurës. Ajo u zgjodh kryetare e organizatës së gruas në Lurë dhe e drejtoi me përkushtim e aftësi deri në fund. Ishte shembull në aksione për luftën kundër analfabetizmit, pjesëmarrjes së vajzave e të grave në luftë kundër zakoneve prapanike dhe afirmimit të së resë, modeli i gruas në familje e shoqëri. Kjo familje do të mbetet gjithmonë një trashëgimi e vyer për Lurën dhe lurjanët.

LURA, ME BUKURI PËRRALLORE, LIQENE, QË KRAHASOHEN ME ZVICRËN E VENDET NORDIKE

Profili i Mark Ndreca Vladit, si dhe i nënës së tij Dila Marka Ndreca, plotësohen më së miri në këtë monografi edhe nga opinion/vlerësimet e

shkruara për të nga: Tefta Cami-ish-Ministre e Arsimit dhe Kulturës; prof. dr. Petrit Bara; Ahmet Kaçorri; Ilir Balili; Nezir Buci; Haziz Ndrejoni; Ramazan Vladi; Ded Llesh Doçi; Fadil Asllani; Han Sul Kaci; Lazam Istref Kaci; Ismail Staf Hoti; Qazim Prrejsi; Fatos Daci; Xhaferr Han Mena; Osman Vladi; Zef Vladi; Demir Osman Vladi; Aqif Ademi; Ali Ibrahim Mena; Halit Karasani; Pjetër Lleshi; Elta Lenin Vladi, Mevlud Buci dhe Nikoll Vladi. Këto opinion/vlerësime kanë si emërues të përbashkët atë që shkruan autori Preng Vorfi si dedikim: “Të shkruash për Lurën është sa e vështirë, por edhe kënaqësi, se ke të bësh me një trevë me histori të lavdishme në të gjitha periudhat e historisë, nga Mesjeta, Koha e Artë e Skënderbeut, luftërat, nga dyndjet sllave e deri në Luftën e Parë e të Dytë Botërore, Lufta e lavdishme Nacionalçlirimtare e deri me çlirimin e plotë të vendit. Ke të bësh me një zonë fiziko-gjeografike të rrallë, me bukuri përrallore, liqene, që krahasohen me Zvicrën e vendet nordike. Lurjanët janë një popull kreshnik. Në të gjithë rrjedhat e historisë kanë qëndruar kryelartë, si krahina e Kanunit, e unitetit të besimeve fetare dhe e Karareve. Lura është vendi që ka shkruar faqe të lavdishme të historisë dhe ka nxjerrë heronj, si: Gjok Doçi, burra shteti, si Dom Nikoll Kaçorri, nënkryetar i parë i Qeverisë së Vlorës, 1912, e dëshmorë në luftën për ruajtjen e trojeve shqiptare e deri te Marka Ndrec Vladi, që u flijua në krye të detyrës”

Aktori i mirënjohur i skenës dhe ekranit Bujar Asqeriu në “Dita e letërsisë dibrane”

FUQIA E FJALËS SË SHKRUAR NË RUAJTJEN E IDENTITETIT KULTUROR



- **Nderim për krijuesit e traditës letrare dibrane: Josif Bageri poet dhe gazetar; Haki Sharofi, një personalitet poliedrik: Mësues i Popullit, gazetar, poet dhe levrues i gjuhës shqipe; Haki Stërmilli - autor i tre romaneve, mbi 30 tregimeve të shkurtëra, pesë pjesëve teatrale, dy ditareve dhe disa dyzina artikuj publicistikë, Prof. Dr. Shaban Sinani, akademik, studiues dhe historian i letërsisë, etnolog, eseist dhe publicist shqiptar, etj**

“Fuqia e fjalës së shkruar në ruajtjen e identitetit kulturor”. Nën këtë moto, shkrimtarë të njohur dhe talente të reja u bënë bashkë të enjtën e 10 tetorit 2024 në Bibliotekën e qytetit të Bulqizës, për të prezantuar botimet e tyre dhe për të diskutuar mbi arritjet, por edhe mbi problematikat e letërsisë. Në këtë datë, të Tetorit të Letërsisë, shkrimtarët dibranë, numri i të cilëve kalon mbi 500, bënë apel që të investohet më shumë, që librat të shkojnë në duart e lexuesve.

Iniciatore e këtij takimi qe Bashkia Bulqizë, e cila në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë (LID) dhe Shoqatën atdhetare Bulqiza, organizuan Ditën e Letërsisë Dibrane, në Bibliotekën e

qytetit minator. Shkrimtarë të njohur dibranë dhe talente të reja në fushën e letërsisë nga gjimnazi “Arbëria” dhe Këshilli Rinor Bulqizë, u bënë kështu pjesë të këtij takimi mbresëlënës, duke bashkëbiseduar dhe reflektuar mbi fuqinë e fjalës së shkruar në ruajtjen e identitetit tonë kulturor.

Është vërtetë inkurajues shembulli i kryetares së bashkisë Bulqizë, Festime Mjeshtri, e cila përveç zgjidhjes me kompetencë e përkushtim të problematikave të shumta të kësaj bashkie, i kushton vëmendjen e duhur edhe organizimit të takimeve të tilla. Me këtë rast ajo vlerësoi krijimtarinë e shkrimtarëve dibranë që në shekullin e nëtëmbëdhjetë e deri në ditët e sotme, dhe po ashtu premtoi institucionalizimin e datës 10 tetor si “Dita e Letërsisë Dibrane”.

KRIJUESIT E TRADITËS LETRARE DIBRANE

Në nismën për intucionalizimin e 10 Tetorit si “Dita e letërsisë dibrane”, kryebashkiakja e Bulqizës Festime Mjeshtri gjeti dhe mbështetjen e kryetartit të Lidhjes së Intelektualëve Dibrane, prof. Dr. Shpëtim Cami – autor i disa librave, si dhe të kryetarit të Shoqatës Bulqiza. Bashkim Lami. Në përshëndetjet e rastit ata inkurajuan shkrimtarët dhe talentet e reja dibrane në letërsi, që të lexojnë sa më shumë dhe në krijimtarinë e tyre t’iu qasen, jo vetëm përjetimeve e ndjenjave, burimeve arkivore e dokumentare, por sidomos botimeve të atyre personaliteteve që krijuan traditën letrare dibrane, siç janë: poeti dhe gazetari Josif Bageri nga Reka e Dibrës së Madhe, si i pari poet që ka botuar një libër me vjersha; Haki Sharofi, një personalitet poliedrik: Mësues i Popullit, gazetar, poet dhe lëvruer i gjuhës shqipe; Haki Stërmilli - autor i tre romaneve, mbi 30 tregimeve të shkurtëra, pesë pjesëve teatrale, dy ditareve dhe disa dyzina artikuj publicistikë, Prof. Dr. Shaban Sinani, akademik, studiues dhe historian i letërsisë, etnolog, eseist dhe publicist shqiptar; Agron Tufa – një ndër shkrimtarët e brezit të sotëm që me veprat e tij renditet me elitën krijuese të kombit; Prof. Dr. fatmir Terziu –shkrimtar, studiues, regjisor, kritik i artit dhe letërsisë. botues i suksesshëm i portalit fjala e lire dhe revistës prestigjioze Albanian Post; Hazi Ndreu – Nderi i kombit, të cilin e kanë quajtur “Ezopi i Dibrës”, “Burri i Odës Dibrane”, “magu”, i cili me preken e tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo shqiptari - i veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me

mënyrën e veçantë të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian; Prof. dr. Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, që përveçse si aktor, skenarist e regjisor është autor i disa librave monografikë; Prof. dr. Hajri Shehu – filolog, një nga figurat më të spikatura në fushën e gjuhësisë shqiptare, me një kontribut të shquar në leksikografi dhe leksikologji; Xhafer Martini, i cili me krijimtarinë e tij letrare në prozë e poezi zë vend të veçantë në fondin e artë të letërsisë shqipe; Ahmet Prençi, fuitues i çmimit kombëtar “At Gjergj Fishta” me romanin e tij “Anja” e po aq i kërkuar nga lexuesi me romanin e dytë “Brenga e prokueorit”; Xhelal Ndreu, historian, publicist, romancier, dramaturg, përkthyes; e dhjetra autorë tjerë dibranë.

SHKRIMTARËT E SOTËM DIBRANË PREZANTOJNË BOTIMET E TYRE

Pas fjalëve përshëndetëse të organizatorëve, “Dita e Letërsisë Dibrane” vijoi me prezantimin e botimeve të tyre nga disa autorë pjesëmarrës në këtë takim. Me modesti, përveç monografive (me bashkëautor) kushtuar filozofit popullor Dine Hoxha, kompozitorit të tangos shqiptare Muharrem Xhediku, gjeneralit legjendë Rrahman Parllaku, Liri Belishovës, ikonës së artit e kulturës Skënder Cala, etj, unë prezantova librin tim të ri “40 vepra letrare të 40 autorëve në ‘skaner’” që është i 27-ti në korpusin e botimeve të mia. Për këtë libër, një këndvështrim më të hollësishëm analitik bëri Emmy Krosi, poete, esseiste, analiste dhe një ndër zërat më të spikatur të kritikës së sotme letrare.

“Të lexosh letërsi, sidomos shumë letërsi që shkruhet sot në shumë forma, rryma dhe faqe, të ulesh dhe shkruash përsëri përshtypjet, apo një ese kritike, kumtim apo analizë duhet jo vetëm kohë por edhe kulturë e mjaftueshme. Një ndër autorët, që pothuajse gjendet në çdo shtëpi libri, në “çdo festë libri” është padyshim, miku i të gjithë shkruesve të çdo lloji dhe gjinie, Halil Rama. Pa e mbushur me supërelativa, apo shumë të sheqeror si: ‘kritik i madh’, ‘studiues famoz, përpos titullit ‘Mjeshtër i Madh’, H.Rama ka meritën e një skanimi ose përimitësimi, apo dekodimi të çdo kodi libror qoftë prozaik, poetik apo dokumentar”,-tha ndër të tjera Emmy Krosi.

Më pas Mjeshtri i Madh Fatos Daci, botues i gazetës “Dibra”, autor i mbi 70 librave, tërhoqëi vëmendjen e të pranishmëve, sidomos për veprën

e tij voluminoze “*Enciklopedia e Dibrës*”, si dhe për veprën e tij studimore “*Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër – Turqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës*”.

Sakip Cami, një tjetër autori i njohur dibran në fushën e letrave, ndër dhjetra botimet e tij prezantoi librat: “*Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit*”; “*Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në Dibër*”; “*Mos ma prekni lumin tim*”; “*Fisi ÇAMI i Dibrës*” “*Drejt NATO-s*” dhe “*101 poezi*”.

Dhjetra pjesëmarrësit në këtë takim u impresionuan nga prezantimi i vëllimeve me poezi të poetëve dibranë *Demir Rusi, Barie Çupi, Moza Shehi, Sanie Dëgjoni Ndreka, Miranda Troci, Brunilda Musai, Donika Meta Gjura* (të cilët edhe intrpretuan disa poezi nga botimet e tyre), si dhe nga shkrimtarët e studiuesit e trevës së Bulqizës *Destan Rama e Ilir Puca*.

Më të larmishëm e bëri këtë takim, Bujar Asqeriu, aktor i mirënjohur i skenës dhe ekranit shqiptar, jo vetëm me prezancën e vlerësimin e krijimtarës së autorë dibranë, por sidomos me interpretimin e dy poezive të poetes nga Bulqiza Barie Çupi.

Shkrimtarët e pranishëm i dhuruan disa nga botimet e tyre Bibliotekës modern të Bulqizës.

TALENTET E REJA - SHKRIMTARËT E SË ARDHMES SI DËSHMI E KOHËS SË TYRE

“Nxënësit e talentuar në letërsi të Shkollës së Mesme “Arbëria” dhe anëtarët e Këshillit Rinor Bulqizë qenë ndër më aktivët e takimit me logon “Dita e Letërsisë Dibrane”. Jo vetëm me prezantimin dhe interpretimin e krijimtarisë së tyre poetike, por edhe me pyetjet interesante për shkrimtarët e pranishëm. Këta të fundit, s’kish se si të mos vlerësonin interpretimin e krijimtarisë së tyre poetike nga nxënësit shembullorë Elis Bala dhe Artemida Alla.

Ndërsa nxënësit e talentuar në letërsi të këtij gjimnazi: Raela Cani, Suada Suroçaj, Argita Neziri, Edisar Keta, Orgit Zogu, Mario Kika, Marsilda Llorja, Xheniola Sallaj, Briana Visha dhe Sindi Krosi e shfaqën talentin e tyre nëpërmjet pyetjeve interesante për shkrimtarët e pranishëm, të cilat konsistonin në përzgjedhjen e tematikave, pse shkruajmë, motivet dhe burimet e frymëzimit, metodat shkrimore në rastin e shkrimit të

monografive, titujt e librave të radhës por edhe për burimet e financimit të botimit të librave.

Intersimi i tyre që i vëçantë sidomos për evidentimin dhe vlerësimin e krijimtarisë së tyre. Shkrimtari Fatos Daci si botues i gazetës “Dibra” dhe unë si kryeredaktor i gazetës “Bulqiza”, në përgjigje të interesit të tyre premtuam botimin e krijimtarisë letrare të talenteve të reja nga shkollat e mesme e 9-vjeçare të Bulqizës. Kjo për faktin se ata do jenë shkrimtarët e së ardhmes si dëshmi e kohës së tyre.



BOTIME TË AUTORIT HALIL RAMA NË VITE:

- Dine Hoxha-Një filozof popullor në Oborrin Mbtretëror (*monografi me b/autor, 2006*)
- Muharrem Xhediku – Kompozitori i tangos shqiptare (*monografi me b/autor, 2008*)
- Fundi i Rugës së vetme (*refleksione & kritikë letare, 2011*)
- Testamenti i atdhedashurisë (*Reportazhe, portrete, kritike letare, 2012*)
- Memoria historike e kombit (*Reportazhe, portrete, kritike letare, 2013*)
- Rahman Parllaku-Një legjendë në kufirine dy koheve (*monografi me b/autor, 2014*)
- NJEZET VJET OBVL (*Histori, portrete, me b/autor – 2014*)
- Histori brezazh të familjes së shquar Kazazi të Durrësit (*monografi me b/autor, 2015*)
- LIRI BELISHOVA – Gruaja që sfidoi diktaturën (*Monografi – 2016*)
- Në panteonin e vlerave (*refleksione & profile & kritikë letare, 2016*)
- Bajram Ndreu i Zall Dardhës (*monografi me b/autor, 2017*)

- AGJENDA E NJE MINISTRI (*kushtuar Safet Zhulalit- monografi me b/autor, 2017*)
- Lutfi Ndreu, mësues dhe artist (*Monografi – 2018*)
- Rizgjime meteorësh (*refleksione & profile & kritikë letare & Poezi, - 2018*)
- Skënder Cala në gjerdanin e artë të kulturës shqiptare (*Monografi le-tare ,2019*)
- Gjenerali që sfidoi kohërat (*monografi me b/autor, 2019*)
- MUHURRI-Histori dhe personalitete (*Monografi-2020*)
- Fluturon shqipja mbi Korab (*Reportazhe, portrete, kritike letare, 2021*)
- Zall Dardha në ditarin e Isuf Rashës (*Monografi me b/autor S.Cami -2021*)
- Magjia e fjalës (*Refleksione, kritike letrare -2021*)
- Ekzaminimi i diktaturës në vepra letrare (*Reportazhe, portrete, kritike letare, 2022*)
- AND-ja e pandryshuar e Shefki Karadakut (*monografi letrare -2023*)
- Rilindja e emrave (*Refleksione, kritike letrare*) (2023)
- Të fitosh titullin NJERI (*Refleksione, kritike letrare, 2023*).
- 30 vjet OBVLP – Histori suksesi (*Monografi-2024*)
- Zëra bashkëjohorë (*Profile& Kritika letrare – 2024*)
- 40 vepra letrare të 40 autorëve në skaner – 2024.

KA REALIZUAR 9 DOKUMENTARE TELEVIZIVE

(si skenarist dhe asistent regjisor)

- 2014 – Një legjendë në kufirin e dy kohëve - në 95-vjetorin e lindjes së Heroit të Popullit Rrahman Parllaku (*bashkepunim me RTSH – skenarist dhe as/regjisor*)
- 2018 – Lutfi Ndreu , mesues dhe artist (*bashkepunim me Tv Bulqiza – skenarist dhe as/regjisor*)
- 2019 – Gjenerali që sfidoi koherat (*bashkepunim me RTSH – skenarist dhe as/regjisor*)
- 2019 – Skender Cala në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare (*bash-kepunim me Tv Bulqiza – skenarist dhe as/regjisor*)

DIBRA DHE DIBRANËT NË PANTEONIN E VLERAVE

- 2020 – Fadil Hoxha – Arkitekt i Kosoves se lire (*bashkepunim me RTSH – skenarist dhe as/regjisor*)
- Setki Jashari, poeti dhe prozatori i dhimbjes njerëzore
- 2023 – Rrahman Parllaku – gjenerali që bëri epokë.
- AND-ja e panryshuar e Shefki Karadakut.
- Dali Ndreu, strategu që drejoi luftën për çlirimin e Tiranës



HALIL RAMA

HALIL HIDËR RAMA

Ka lindur në Muhurr, Dibër më 28 Tetor 1960.
Nga 1996 jeton dhe punon në Tiranë.

Është vlerësuar me titujt:

- Mjeshtër i Madh – Dekoruar nga Presidenti i Republikës, me Dekret Nr.11723, datë 17.09.2020;
- “Avokat” me Nr. Liçense 7979, datë 31.10.2014;
- “Qytetar Nderi” i Bashkisë Bulqizë, me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.52, date 31.07.2024;
- “Ambasador për Paqe”, dhënë nga Federata Universale e Paqes, Shqipëri-2022.
- “Akademik” - Anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve, nga data 06.10.2022.



- Profili i tij krijues është përfshirë në vëllimin parë të Enciklopedisë “PORTRETE SHKRIMTARESH” (Faqe 195-204), botim i PROKULT PRESS Prishtinë, të shkrimtarit filozof Zekeria Idrizi, sëbashku me qindra personalitete të letrave të njohura ndërkombëtarisht.

- Është kryeredaktor i gazetave periodike: “BULQIZA” (1992-1996 dhe nga 2014 e në vazhdim); “Bota SD” (1998-2003); “Vizioni Liberal” (2003-2009) dhe “VETERANI” (nga 2003 e në vazhdim).

Nga 2010 boton në vijimësi opinione, dossier, kritikë letrare, prozë, poezi dhe reportazhe në të përditshmet kryesore: “Panorama”, “Gazeta Shqiptare”, “Telegraf”, “Koha jonë”, “Dita” dhe “Standard” e në të përjavshmen kulturore-artistike “NACIONAL”.

- Është autor i 28 librave (monografi & refleksione & reportazhe & kritikë letrare & poezi & tregime).

- Halil Rama është i martuar me Znj.Kimete Rama (Berisha) dhe ka dy djem, Bledarin dhe Arlindin.

* * *

“Libri i 28-të i Mjeshtrit të Madh Halil Rama “Dibra dhe dibranët në pantetonin e vlerave” është një studim i thelluar dhe në kohë, që shpalos portretin e mjaft njerëzve të pazakontë të trevës së lavdishme dibrane. Janë portretizime që vijnë, si nga historia, ashtu dhe njohja e gjatë e autorit me personazhet historikë dhe aktualë nga të gjitha trevat e Dibrës”

Nga Prof. Asoc. Dr. **Bernard Zotaj** - Mjeshtër i Madh



Çmimi 2000 lekë